



Cikli i tretë i studimeve – Studimet e doktoraturës

Tema e disertacionit të doktoratës:

*“Medijacioni si zgjidhje alternative e kontesteve civile në Republikën e Maqedonisë”
(Aspekte krahasimore)*

Kandidat:

Fjolla Kaprolli

Mentor:

Prof. Dr Adnan Jashari

Përmbajtja

| | |
|---|----------|
| 1. Hyrja..... | 1 |
| 2. Lënda e hulumtimit..... | 2 |
| 3. Qëllimi dhe objektivat hulumtuese..... | 4 |
| 4. Arsytimi i hulumtimit..... | 5 |
| 5. Hipotezat..... | 5 |
| 6. Metodologjia e hulumtimit..... | 6 |
| 7. Rëndësia e hulumtimit..... | 8 |
| Pjesa e pare..... | 9 |
| I Zgjidhja alternative e kontesteve..... | 9 |
| 1. Nocioni i kontestit juridik dhe klasifikimi i formave të zgjidhjes të kontesteve juridike..... | 9 |
| 2. ADR – Alternative dispute resolution/Zgjidhja alternative e kontesteve..... | 17 |
| 3. Nevoja për zgjidhje alternative të kontesteve..... | 24 |
| II Medijacioni – rrugë alternative deri te e drejta..... | 36 |
| 1. Nocioni dhe karakteristikat..... | 36 |
| 2. Terminologjia dhe dilemat..... | 42 |
| 3. Llojet e medijacionit..... | 45 |
| 4. Mediabiliteti..... | 49 |

| | |
|--|------------|
| 5. Parimet e procedures së medijacionit..... | 55 |
| 6. Medijatori..... | 63 |
| Pjesa e dytë..... | 70 |
| III Medijacioni VS Procedura kontestimore..... | 70 |
| 1. Subjektet në procedurë..... | 76 |
| 2. Lënda e procedures..... | 99 |
| 3. Procedura – Procedura kontestimore dhe procedura e medijacionit në Republikën e Maqedonisë..... | 112 |
| 3.1 Procedura kontestimore..... | 112 |
| 3.1.1 Nisja, ndërprerja, vazhdimi dhe përfundimi i procedures kontestimore në shkallë të pare..... | 116 |
| 3.2 Procedura e medijacionit..... | 130 |
| 3.2.1 Nisja, zbatimi dhe përfundimi i procedurës të medijacionit..... | 130 |
| IV Pajtimi gjyqësor në procedurën kontestimore dhe marrëveshtja për medijacion në procedurën e medijacionit..... | 145 |
| 1. Natyra juridike e pajtimit gjyqësor..... | 145 |
| 2. Natyra juridike e marrëveshtjes në procedurën e medijacionit..... | 149 |
| Pjesa e tretë..... | 155 |

| | |
|---|------------|
| V Medijacioni ndërkombëtar me theks të veçant medijacionit ndërkombëtar tregtar si metodë e zgjidhjes të kontesteve në të drejtën ndërkombëtar..... | 155 |
| 1. E drejta ndërkombëtare tregtare..... | 156 |
| 2. Kontestet në të drejtën ndërkombëtare tregtare..... | 158 |
| 3. Marrëveshtjet e medijacionit..... | 168 |
| Pjesa e katërt..... | 170 |
| VI Medijacioni në të drejtën krahasimore..... | 170 |
| 1. Procedura e medijacionit në SHBA..... | 171 |
| 2. Procedura e medijacionit në Australi..... | 176 |
| 3. Procedura e medijacionit në Hollandë..... | 179 |
| 4. Procedura e medijacionit në ish-republikat e Jugosllavisë..... | 182 |
| 4.1 Procedura e medijacionit në Republikën e Kroacisë..... | 182 |
| 4.2 Procedura e medijacionit në Slloveni..... | 186 |
| 4.3 Procedura e medijacionit në Malin e Zi..... | 190 |
| 4.4 Procedura e medijacionit në Sërbë..... | 194 |
| Pjesa e pestë..... | 197 |
| Hulumtimi i praktikës së zbatimit të medijacionit në Republikën e Maqedonisë..... | 197 |

| | |
|---|-----|
| VII Paraqitje statistikore të zgjidhjeve të kontesteve me anë të medijacionit nga viti 2016 deri më sot në Republikën e Maqedonisë..... | 198 |
| VIII Anketa dhe përpunimi i të dhënave të fituara nga ajo..... | 214 |
| 1. Anketa për qytetarët..... | 215 |
| 2. Anketa për medijatorët..... | 230 |
| Pjesa e | |
| gjashtë | 246 |
| Përfundime dhe | |
| konkluzione..... | 246 |
| 1. Zgjidhja alternative e kontesteve dhe procedura kontestimore..... | 246 |
| 2. Përparësit dhe dobësit e medijacionit në raport me procedurën kontestimore..... | 247 |
| 2.1 Përparësit e medijacionit..... | 247 |
| 2.1.1 Fleksibiliteti dhe natyra joformale e procedurës së medijacionit..... | 247 |
| 2.1.2 Zgjedhja vullnetare e procedurës..... | 249 |
| 2.1.3 Konfidencialiteti i procedurës..... | 251 |
| 2.1.4 Kursimet në kosto dhe në kohë..... | 254 |
| 2.1.5 Zgjidhje të shumta të kontestit..... | 256 |
| 2.1.6 Procedurë më relaksuese për palët..... | 257 |
| 2.1.7 Kontrolla e palëve ndaj procedurës së medijacionit..... | 258 |
| 2.2 Mangësit e procedurës së medijacionit..... | 260 |

| | |
|--|-----|
| 2.2.1 Medijacioni, procedurë jo e detyrueshme..... | 260 |
| 2.2.2 Përmbartueshmëria e marrëveshtjes së medijacionit..... | 261 |
| 2.2.3 Problemet në lidhje me konfidencialitetin..... | 264 |
| 2.2.4 Bisedimet jo të barabarta – mosbalanc i fuqisë..... | 265 |
| 2.3 A është medijacioni i përshtatshëm për zgjidhjen e kontesteve civile?..... | 265 |
| 3. Ndryshime në legjislacion për procedurën e medijacionit..... | 267 |
| 4. Roli i gjyqtarëve, avokatëve dhe qytetarëve në suksesin e zbatimit të procedurës së medijacionit në Republikën e Maqedonisë..... | 273 |
| 5. Interesim i vogël tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë për medijacionin si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve..... | 276 |
| Përfundim | 279 |
| <i>Shtojca I</i> – Anketa për qytetarët..... | 289 |
| <i>Shtojca II</i> – Anketa për medijatorët..... | 291 |
| <i>Shtojca III</i> - Autorizim për përfaqësim në procedurë të medijacionit për personin juridik i cili inicon procedurë të medijacionit..... | 293 |
| <i>Shtojca IV</i> - Kërkesë për zbatim të procedurës së medijacionit..... | 294 |

| | |
|--|-----|
| <i>Shtojca V</i> – Licenca për trajnues të medijatorëve..... | 295 |
| <i>Shtojca VI</i> – Licenca për medijator..... | 296 |
| Bibliografia | 297 |

1. Hyrje

Jemi dëshmitar të një dinamike të fuqishme të zhvillimit të raporteve shoqërore. Ky zhvillim shoqëror vazhdimisht prodhon konteste të reja të cilat janë shumë të komplikuar dhe për fat të keq të shumta. Njerëzit çdo ditë në bashkësinë ku ato jetojnë dhe veprojnë, si në sferën private ashtu edhe në sferën e punës, hasin situata konfliktuoze. Në një pjesë të tyre ato përfshihen përshkak të një varg të rrethanave ndërsa një pjesë e tyre shkaktohet përshkak të veprimit ose mosveprimit të tyre. Kontestet janë fakt në secilën shoqëri, reaksioni i të cilave manifestohet në ndonjërin prej modeleve apo mënyrave për zgjedhjen e kontesteve. Zgjedhja e kontesteve nga pikpamja e të drejtës (këtu para së gjithash mendohet për procedurën gjyqësore) është metod dominant në trajtimin e mosmarrëveshtjeve respektivisht kontesteve dhe zgjidhjes së tyre. Gjykatat i zgjidhin kontestet dhe mosmarrëveshtjet ndërmjet palëve. Ky qëndrim është i pranishëm në disa qindra vitet e fundit. Mirpo si duket këto vitet e fundit ku gjykatat janë bërë shumë të fuqishme së bashku me zhvillimin dhe modernizimin e shoqërive të sekularizuara - shtetet, këto të fundit ndajnë drejtësinë përmes gjykatave të tyre dhe bazuar në ligje që duhet të jenë të barabartë për të gjithë. Zhvillimi i aparatit ligjor shtetëror i ka vënë nën hije metodat tjera për zgjidhje të kontesteve deri në atë shkallë sa që procedura gjyqësore është bërë sinonim për metodën standarde, të rregullt dhe ndonjëherë edhe si metodë e vetme për zgjedhje të kontesteve juridike. Si pasojë e këtij lloji të perceptcionit është bërë marginalizimi i mundësive tjera të cilat janë në dispozicion për zgjidhjen e kontesteve. Si efekt negativ i zhvillimi të tillë të mehanizmit gjyqësor është pamundësia e të njejtit që të përballet me nevojën e madhe për mbrojtje gjyqësore. Pra, cilado arsya, është e nevojës së madhe reflektimi i rolit të gjykatave mbi zgjidhjen e kontesteve dhe me këtë edhe gjetja e mënyrave tjera të zgjidhjeve të kontesteve. Shoqërit bashkëkohore të cilët edhe pse demokracinë e vënë në piedestal, përsëri nuk mundet t'u ikin numrit të madh të kontesteve të cilët çdo ditë janë në rritje e sipër dhe me këtë edhe mbingarkesa e gjykatave. Për atë shkak të gjith shtetet moderne u lëshuan në kërkimin e metodave të reja të zgjidhjeve të kontesteve të ashtuquajtura, mënyra alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Afirmimi i këtyre mënyrave alternative është një tregues i qartë për problemet me të cilat ballafaqohet gjyqësori në këtë shtet.

Medijacioni është një ndër metodat më të shpeshta të cilat aplikohen si metoda të zgjidhjeve alternative të kontesteve e cila është vlersuar si mënyrë më e shpejtë, efikas dhe më

ekonomik i zgjidhjeve të kontesteve, si dhe si mënyrë më e mirë e shkarkimit të gjykatave. Si rezultat i këtyre vetive, medijacioni i ka të gjitha predispozitat për t'u bërë mënyra dominante e zgjedhjeve alternative të kontesteve. Medijacioni është mënyrë e zgjedhjes të konflikteve dhe tejkalimit të mosmarrëveshtjeve përmes të palës të tretë e cila është neutrale dhe e cila paraqitet në rolin e medijatorit respektivisht të ndërmjetësuesit në mes të dy palëve të cilët kanë kontest në mes veti. Qëllimi i mediacionit është që konfliktit ti drejtohet në mënyrë konstruktive dhe të vijë deri në një zgjedhje të shpejtë dhe të përbashkët rreth të të cilës egziston pajtueshmëri nga të dyja palët.

2. Lënda e hulumtimit

Ideja fillestare për punimin e kësaj teme ishte njoftimi me metodat jashtgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve, përcaktimi i rrethveprimit të tyre të cilat sot njihet me shkurtësën ADR (alternative dispute resolution), si rezultat i të cilës hulumtimi është e koncentruar tek medijacioni si metod i ADR-së. Në këtë kuptim hulumtimi më së tepërmi drejtohet në zbulimin dhe spjegimin e parametrave bazë të cilat e përbëjnë themelin konstruktiv të fenomenit të quajtur medijacion, me ç'rast të njëjtat do të shqyrtohen individualisht dhe në korrelacion me procedurën kontestimore si metod i përgjithshëm dhe i rregullt për dhënjen e mbrojtjes juridike. Në mënyrë analoge shqyrtohen edhe disa çështje aktuale për dallimet e procedurës kontestimore dhe të mediacionit. Për paraqitjen e suksesshme të konceptit të mediacionit, në fillim do të qaset në përcaktimin e plotë të elementeve të cilat e formojnë bazën e mediacionit si mënyrë e zgjidhjeve alternative të kontesteve e cila udhëhiqet me ndërmjetësim të palës së tretë neutrale - ndërmjetësuesit/medijatorit, me qëllim që të arrihet zgjidhje e përbashkët e pranueshme për të dyja palët të cilët janë të involvuar në kontest. Rëndësi të madhe në këtë punim të doktoraturës i kushtohet sqarimit se si medijacioni siguron një vend resp. një mundësi ku palët në kontest do të mundën që ti tregojnë qartë dhe pa rezervë nevojat dhe ndjenjat e tyre, ti ekzaminojnë dyshimet dhe dilemat e tyre, të bisedojnë në mënyrë konstruktive dhe në fund të vijë deri në një zgjidhje të përbashkët. Pra kjo na bën që të konstatojmë se medijacioni mundëson që palët të jenë vetë kreator të fatit të tyre, e jo marrës pasiv të aktgjykimeve të gjykatave si dhe faktin se nëpërmjet mediacionit anashkalohen proceset e gjata dhe te lodhshme gjyqësore, kursehet koha e çmuar, kursehen edhe të hollat, realizohet më lehtë dhe psikologjikisht është më e durueshme si procedurë.

Në këtë hulumtim vëmendje të veçantë i kushtohet edhe medijacionit ndërkombëtar. Si rezultat i globalizmit, filloi qarkullimi i kapitalit shërbimeve e sidomos personave i cili proces ishte i pranishëm edhe në Republikën e Maqedonisë njëjt si në vendet tjera në zhvillim. Me vetë qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe lëvizjen e njerëzve nga një shtet në një shtet tjetër krijohen raporte të reja dhe të llojllojshme shoqërore gjithashtu edhe juridike, të cilët shpesh herë janë shkak edhe për paraqitjen e ndonjë kontesti, zgjidhja e të cilëve mund të bëhet në rrugë gjyqësore. Teoricientët dhe praktikientët të kësaj dicipline i kanë zhvilluar shumë metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve siç janë arbitrazhi dhe mediacioni. Por në krahasim me procedurën gjyqësore, me anë të medijacionit rezultatet e zgjidhjeve të kontesteve ndërmjet palëve shfaqen shumë më shpejt, dhe kjo është arsyeja se përse në nivel ndërkombëtar preferohet zgjidhja e kontesteve me anë të pjesmarjes të mediatorëve.

Në punim rëndësi të veçantë i kushtohet edhe medijacionit si procedurë dhe kontesteve të cilët paraqiten në disa sfera të të drejtës civile si kontesteve familjare, kontesteve që paraqiten në të drejtën e punës dhe kontesteve tregtare të cilët janë mjaft të shpeshta përshkak se medijacionit u bë e detyrueshme për zgjidhjen e tyre nëse vlera e kontestit tejkalonte shumë prej një million denarëve. Shkaqet që kanë sjell deri në aplikimin e medijacionit si metod për zgjidhjen e kontesteve të natyrave të lartpërmendura dhe të cilët trajtohen në një pjesë të veantë të punimit janë: transparencja e madhe, fleksibiliteti procedural, efikasiteti, konfidencialiteti e cila siguron privatësi për palët në procedurë.

Për të fituar një pasqyë të qartë për medijacionin, një pjesë të punimit i kushtohet hulumtimit të përvojave krahasimore dhe të modeleve të shteteve të ndryshme me qëllim të shqyrtimit të faktit se sa janë të aplikueshme ato në legjislacionin tonë, si dhe prezencës të medijacionit në aktivitetet e organizatave ndërkombëtare. Qëllimi i hulumtimit të tillë është të tregohet se medijacioni gjërësisht përdoret për zgjidhjen e kontesteve në disa shtete në botë dhe definimin se ku gjendena ne në rrugën e zhvillimit dhe të avancimit të medijacionit si metodë e zgjidhjes alternative të kontesteve.

Ky hulumtim do të kurrorëzohet me disa të dhëna statistikore për punën e kryer nga ana e medijatorëve në Republikën e Maqedonisë dhe të dhëna të fituara nga anketat të pregaditura për qytetarët dhe medijatorët të cilat u analizuan me shumë kujdes gjat hulumtimit, si dhe në fund do të jepen rekomandime për plotësimin e mungesave si dhe ndryshime në legjislacion të

cilët do të mundësojnë të kuptuarit e palëve për medijacionin dhe pregaditshmëria e tyre që kontestin e tyre t'ia nënshtrojnë medijacionit.

3. Qëllimi dhe objektivat hulumtuese

Zgjidhja alternative e kontesteve paraqet një mënyrë mëndryshe se ajo gjyqësore për zgjidhjen e kontesteve. Ky fakt në asnjë mënyrë nuk don të thot se këto metoda kanë zvendësuar procedurat e rregullta gjyqësore por bëhet fjalë për ofrimin e një numri të madh të mundësive me qëllim që të arrihet deri në zgjidhjen më kualitative dhe efikase të kontesteve. Pra, parashtrahet pyetja, çka në të vërtetë na ofrojnë këto metoda alternative të zgjidhjeve të kontesteve dhe me këto përfshirë edhe medijacioni si një metodë e tillë. Zgjidhja alternative e kontesteve u ofron palëve disa mënyra për zgjidhjen e kontesteve të cilët mund të jenë më të përshtatshme në krahasim me zgjidhjet të cilët ofron procedura gjyqësore si metodë standarde e zgjidhjes të kontesteve.

Si qëllim kryesor i të bërit një hulumtim i tillë është analiza komplekse e medijacionit, procedurës të udhëhequr nga medijatorët, të jepet një pasqyrë kritike të rregullativës juridike me të cilën është e rregulluar procedura e medijacionit, procedura kontestimore por edhe raporti mes medijacionit dhe procedurës kontestimore dhe implementimi në praktikë, të identifikohen pengesat dhe mundësitë në të njëjtën kohë për një procedurë të medijacionit më të suksesshëm dhe me këtë të tregohen mungesat të cilët janë si rezultat i përvojës së vogël dhe të dobët në këtë fushë, sidomos fakti se bëhet fjalë për një kategori të re në sistemin tonë juridik e cila tek duhet të kristalizohet dhe përpunohet. Gjithashtu qëllim tjetër i këtij hulumtimi është që të përcaktohet nevoja për precizimin, ndryshimin dhe plotësimin e rregullave juridike egzistuese si dhe të përcaktohen faktorët kryesor që kanë bërë që medijacioni të jetë i suksesshëm në legjislacionet tjera. Për këtë qëllim do të përpunohen edhe legjislacionet e disa shteteve me qëllim të komparacionit të medijacionit tek ne dhe të me ç'rast përvoja e tyre juridike do të shërbej si shembull dhe drejtim për ndryshime eventuale në legjislacion në të ardhmen.

4. Arsyetimi i hulumtimit

Arritjet apo gjetjet e këtij hulumtimi do të jenë të ndikimit të madh të zhvillimit të medijacionit në Republikën e Maqedonisë. Ato gjithashtu do të sigurojnë pasqyrim të perspektivave të procedurave të medijacionit si metoda alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Konsiderohet i rëndësishëm së madhe bërja e një hulumtimi të tillë përshkakt të asaj se paraqet një studim serioz dhe i gjërë në lidhje me medijacionin në Republikën e Maqedonisë duke gjurmuar zhvillimin dhe hapat në të cilët procedura e medijacionit ka kaluar nga momenti i kyçjes në systemin juridik të Republikës së Maqedonisë. Arsye tjetër e bërjes të këtij hulumtimi shihet edhe në njohjen më nga afër të teorisë së medijacionit dhe në të njejtën kohë kuptimin e zbatimit të kësaj metode në praktikë, pasi që do të mundësohet të shqyrtohen aspektet ligjore të kësaj metode dhe sfidat e pyetjet të cilët ngriten për të njejtën si p.sh çështja e konfidencialitetit dhe përmbarueshmërisë së marrëveshjeve të arritura në procedurë të medijacionit. Punimi i kësaj teme gjithashtu do të kontribuoj edhe në teorinë e drejtësisë dhe drejtësinë dhe lidhshmërinë e tyre me medijacionin respektivisht se si medijatori do t'i qaset kontestit në mënyrë efektive duke i respektuar parimet e paanësisë dhe të pandërmjetësisë.

Ky punim synon të jetë pjesë e doktrinës juridike në Republikën e Maqedonisë në fushën e procedurës civile e cila pothuajse mungon. Punimi synon t'i vijë në ndihmë jo vetëm juristëve dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, por dhe praktikës gjyqësore.

5. Hipotezat

1. Cilët janë përparsit dhe dobësit e mediacionit në raport me procedurën kontestimore
2. Ndryshime dhe plotësime në legjislacion për përcaktimin e raportit të procedurës të mediacionit dhe të procedurës kontestimore
3. Përse mediacioni paraqet mënyrën më të përshtatshme që palët të zgjedhin kontestet mes tyre?
4. Medijacioni - sfidë në Republikën e Maqedonisë

4.1 Avokatët dhe gjyqtarët përball medijacionit

4.2 Shumë përparësi - interesimi i vogël

6. Metodologjia e hulumtimit

Punimi hulumtues është mbështetur tek hipotezat e përmendura më lartë. Me qëllim të vërtetimit të hipotezave të tilla dhe më qëllim të asaj që të arrihet deri në përfundimin e domosdoshëm, do të shfrytëzohen disa metoda me të cilat do të realizohen qëllimet e theksuara në këtë punim. Si metoda të tilla do të përdoren: metodat teorike dhe ato empirike. Pra, nëpërmjet këtyre metodave do të analizohen rregullat juridike qoftë ato të vendit apo të huajat me të cilat rregullohet medijacioni. Pastaj, nëpërmjet këtyre metodave gjithashtu do të analizohet edhe zhvillimi i ligjeve juridike me të cilat rregullohet procedura e medijacionit si dhe zhvillimi i vet procedurës. Gjithashtu do të nxirren edhe pikat e përbashkëta dhe ato dalluese nga analiza e detajuar e medijacionit si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe në shtetet tjera. Përveç kësaj nëpërmjet këtyre metodave punimi do të kurorëzohet edhe me disa të dhëna statistikore si dhe me të dhëna të fituara nga anketat të cilët janë zbatuar me qëllim të arritjes deri në njohuri në lidhje me medijacionin nga qytetarët e rëndomtë dhe nga medijatorët si zbatues të procedurës së medijacionit.

A: Si *metoda teorike* do të përdor:

- **METODËN NORMATIVE:** si një ndër metodat më të rëndësishme e sidomos kur kemi të bëjmë me analizën e procedurave të medijacionit dhe ato gjyqësore, me ç'rast do të përdoret për analizat e rregullave pozitive juridike të vendit ashtu edhe të huaja.
- **METODËN KOMPARATIVE:** të cilën metodë do ta aplikohet me qëllim të studimit më të mirë të medijacionit në disa shtete të huaja me medijacionin e cila udhëhiqet në shtetin tonë respektivisht në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu kjo metodë do ta përdoret me qëllim të studimit sa më të mirë të rregullave juridike si të vendit ashtu edhe të huaja me ç'rast do të arrihet që të nxirren pikat pozitive, negative si dhe ato të përbashkëta dhe dalluese për to.
- **METODËN HISTORIKE** – si metodë e pashmangshme e cila përdoret në shumë punime të ndryshme me rast të hulumtimit shkencor, gjithashtu edhe në këtë punim kjo metodë

do të zë vend të rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave për medijacionin si metodë e suksesshme për zgjidhjen alternative të kontesteve, me ç'rast edhe do të vërehet se çka ka kontribuar deri në futjen e një risie të tillë në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë.

- **METODËN E DEDUKSIONIT** – do të përdoret me qëllim që nëpërmjet të analizimit dhe të studimit të arrihet deri në konstatime të sakta. Pra nëpërmjet metodës së tillë nga konstatime të përgjithshme do të arrihen deri në konstatime konkrete. Përveç metodës së deduksionit do të përdoret edhe metoda analoge të saj, metoda e induksionit.

- **METODËN E INDUKSIONIT** nëpërmjet të cilës nga konstatime konkrete do të nxiren konstatime të përgjithshme.

B: Si *metoda empirike* do të përdor:

- **METODËN STATISTIKORE** – të cilën do ta përdor me qëllim që të përfitoj një pasqyrim sa më të mirë të gjendjes sot me rastin e sjelljes të Ligjit për mediacionin në vitin 2006, sa përdoret medijacioni si mënyrë e zgjedhjes të kontesteve jashtë gjykatave.

- **METODA E ANALIZËS TË PËRMBAJTJES** - të akteve juridike si dhe të aktvendimeve të ndryshme si të vendit ashtu edhe të huaja si dhe të materialeve dhe literaturave tjera të ndryshme të njëjtat si të vendit ashtu edhe të huaja. Me anë të kësaj metode do të arrijmë të kuptojmë dhe të mësojmë shkaqet edhe arsyet si dhe rëndësisë së sjelljes dhe ekzistimit të tyre dhe pasojat juridike të sjelljes dhe ekzistimit të tyre. Në këtë pjesë do të përdoret analiza semantike dhe ajo tematike.

- **METODA E ANKETËS** – e cila metodë do të përdoret me qëllim që të arrihet deri në njohuri më të sakta për gjendjen reale të procedurës së medijacionit si rezultat i të cilës do të mblidhen të dhënat nga dy lloje të anketave të pregaditura dhe zbatuara dhe të njëjtat do të analizohen dhe nëpërmjet varijablave paraprakisht të përcaktuara do të nxiren përfundimet dhe rezultatet në lidhje me përpunimin e atyre të dhënave.

7. Rëndësia e hulumtimit

Si rezultat i procesit të tranzicionit i cili proces sot është prezent në çdo sferë dhe pore të sistemit ekonomik dhe shoqëror të shumë vendeve të botës në zhvillim, ashtu edhe të jetës ekonomike dhe sociale të Republikës së Maqedonisë, ka ndikuar në përshpejtimin e procesit të përsosjes të institucioneve juridike. Ky proces i përsosjes nuk ka tendenca të ndaloj. Për atë shkak risitë të cilët paraqiten në çdo institucion juridik të çdo sistemi juridik pa marrë parasysh zhvillimin e tij, shihet si e domosdoshme realizimi i një hulumtimit të këtillë me qëllim të përsosjes sa më të mirë të institucioneve juridike e në këtë rast të medijacionit si një mënyrë e zgjedhjeve alternative të kontesteve juridike. Medijacioni si e tillë, i plotëson procedurat gjyqësore dhe palët munden në marrëveshtjen kontraktuale të përbashkët të caktojnë dispozita të karakterit obligativ dhe në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti në mes tyre të mundohen që raportin kontestues të lindur ta zgjidhin në rrugë të ndërrmjetësimit para fillimit të procedurës gjyqësore ose të ndonjë procedure tjetër për dhënjen e mbrojtjes juridike, ose edhe munden që edhe pas inicimit të procedurës kontestimore palët me vetë iniciativë ose me udhëzim nga ana e gjyqtarit të mundohen që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të procedurës së medijacionit. Është e rëndësishme së madhe punimi dhe hulumtimi i kësaj teme pasi që medijacioni gjen një përdorim të gjërë në shumë sfera të së drejtës dhe veçanërisht mundet të përdoret në: kontestet juridiko - pronësore, juridiko - familjare, të punës, tregtare, mosmarrëveshtjet lidhur me sigurimet, mosmarrëveshtjet nga fusha e arsimit, për mbrojtjen e mjedisit jetësor, kontestet që kanë të bëjnë me diskriminimin e te tjera.

Përshkak të natyrës së zbatueshmërisë të këtij hulumtimi, të dhënat të cilët fitohen me rastin e këtij hulumtimi janë të përshtatshme për t'iu kyçur problemit në aspekt praktik. Ky hulumtim përqëndrohet në të kuptuarit e përgjithshëm të medijacionit dhe zbatimit të tij në Republikën e Maqedonisë dhe më gjërë si dhe në faktorët të cilët kanë efekt të drejtpërdrejtë në përparimin dhe zhvillimin e tij. Të dhënat të cilët do të fitohen si rezultat i hulumtimit do të përdoret që të gjenerohen dhe të jepen rekomandime të cilët do të ndikojnë në përdorimin më të shpeshtë të procedurës së medijacionit si procedurë alternative e gjykatës si dhe në zvogëlimin e lëndëve të ngelura të pazgjidhura nga gjykatat në Republikën e Maqedonisë.

PJESA E PARË

ZGJIDHJA ALTERNATIVE E KONTESTEVE

1. Nocioni i kontestit juridik dhe klasifikimi i formave të zgjidhjes të kontesteve juridike

Subjektet e së drejtës çdo ditë përfshihen në marrdhënie juridike nga më të ndryshmet nga të cilat ato bëhen bartës i shumë të drejtave por gjithashtu edhe të detyrimeve. Këto subjekte më së shpeshti veprojnë dhe sillen në përputhje me normat juridike. Por e mundshme është edhe të sjellurit e tyre me ç'rast ato norma juridike dhe rendi juridik të prishen dhe njëkohësisht të lëndohen edhe të drejtat e subjekteve dhe pjesmarësve në bashkësinë shoqërore por edhe të drejtat e palës tjetër në një raport juridik, gjë që sjell në mospërpuethshmërinë e rendit normativ dhe të sjelljeve faktike. Një nga të drejtat themelore dhe më të rëndësishme të njeriut është e drejta e mbrojtjes juridike e cila është një e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë¹ si dhe e garantuar në një numër të madh të konventave ndërkombëtare². Kjo e drejtë nënkupton autorizimin e subjektit juridik që të padisë dhe nga gjykatat të kërkojë mbrojtje juridike duke pretenduar se egziston lëndim ose rrezikim i të drejtave subjektive të tij, si dhe se egziston nevoja që ajo e drejtë detyrimisht të realizohet ose të realizohet ndryshimi apo rregullimi i një marrdhënie juridike të caktuar apo situatë të caktuar. E drejta në mbrojtje juridike përfshinë të drejtën e të qasurit të gjykatës dhe të vepruarit kualitativ.

Kontesti është një situatë jetësore dinamike në të cilën dy apo më tepër persona dëshirojnë të realizojnë ndonjë interes të vetin, nevojë apo qëllim. Pra kontesti mundet të definohet më së miri si një mosmarrëveshtje në mes të dy subjekteve në një raport jetësor në të cilën njëri diçka pretendon ndërsa tjetri pretendimin e tillë e hedh posht. Nocioni kontest rrjedh nga fjala mosmarrëveshtje e cila don të thotë mospajtim dhe imponim i mendimit dhe pretendimit

¹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 52 i vitit 1991; Amandmanet I dhe II janë të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr.1 i vitit 1991; Amandmani III është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 31 u vitit 1998, Amandmanet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI,XII,XIII, XIV, XV, XVI, XVII, XVIII janë të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 91 i vitit 2001, Amandmani XIX është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 84 i vitit 2003, Amandmanet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX, XXX janë të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 105 i vitit 2005, Amandmani XXXI është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 03 i vitit 2009 dhe Amandmani XXXII është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 07 i vitit 2011.

² Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirve themelore, neni 6, al. 1, Romë, 1950

të vet ndaj tjetrit si diçka të saktë, të vërtetë respektivisht korrekt. Pra palët në kontest kanë qëndrime se vetëm njëra nga ato është e realizueshme dhe për atë shkak njera me tjetrën paraqiten si pengesë për realizimin e qëllimeve personale. Rrënjët etimologjike të termit “kontest” mundet të gjinden në fjalën latine “confligere” çka don të thotë “të goditurit e njërit me tjetrin”. Edhe pse vet termini na asocon në diçka negative, kontesti si nocion nuk është as i mirë, as jo i përshtatshëm, as pozitiv e as negativ. Kontesti është shenjë se marrdhëniet egzistojnë dhe si të tilla ato janë pjekur mjaftë për ndryshime, ndërsa mënyra se si reagojmë për kontestin dhe mënyra se si veprojmë me të mundet të jetë i mirë apo i keq³. Numri më i madh i kontesteve krijohen në sferën juridike, gjë që është mjaft e kuptueshme duke marrë parasysh faktin se më frekvente janë raportet apo marrdhëniet ndërmjet personave të cilët raporte janë të rregulluara me të drejtën. Pa marrë parasysh atë se kontestet nga raportet juridike janë të llojllojshme dhe shumë të numërta, objekti i drejtpërdrejtë i mosmarrëveshtjes gjithmonë është ndonjë çështje faktike apo edhe ndonjë çështje juridike – pra palët në kontest nuk pajtohen rreth egzistimit, kuptimit ose karakterit të një apo më shumë çështjeve faktike, apo kanë kuptime të ndryshme rreth asaj se çfarë efekti do të jep ndonjë fakt juridik i caktuar dhe çfarë pasoja do të lindin nga i njëjti.

Bashkëjetesa e përditshme e njerëzve në bashkësinë shoqërore, është shkak i lindjes të kontesteve të shumëllojshme. Përvoja tregon atë se asnjë segment i raporteve shoqërore nuk është i kursyer, sepse çdo pikë prek interesat dhe nevojat e personave dhe shoqërisë, gjë që paraqitet si burim potencial i mosmarrëveshtjeve dhe pakënaqësive. Edhe pse në mes të mosmarrëveshtjeve ka dallime të mëdha, çdo kontest nëse vështrohet nga ana përmbajtësore paraqet konflikt i interesave ndërmjet palëve në kontest. Edhe pse kontestet janë të laramanishme por edhe në numër mjaft të konsiderueshme, prap se prap mundet të thuhet se në përbërje repektivisht në strukturë dhe dinamikë janë të ngjajshme⁴. Janë elementet dhe karakteristikat ato të cilët i bëjnë të ngjajshme, pasi që të njëjtat përsëriten dhe ripërsëriten nga raporti në raport. Analiza psikologjike e kontesteve tregon se të sjellurit e personave në kontestet juridike si dhe në të gjitha llojet e kontesteve i përcakton ato si krijesa biologjike, me çka ato ruajnë integritetin e tyre

³Живановиќ. А, Бужанин. О, (2009), Алтернативно решавање спорови, медијација и арбитража, модул 3, Прирачник за стручни соработници и судови, Проект правосудна реформа Канада - Босна и Херцеговина, Сарајево, fq. 17

⁴ Rubin, J.Z, Sander, E.A (1998), When should we use agents, Negotiation Journal, a/1998. fq. 395-401, Pruitt, D.G, Rubin, D.Z, Kim, S.H (1996), Taktike nadmetanja, dhe Socijalni konflikt i karakteristike i nacin resavanja, Gupa Most, Beograd

personal si një vlerë madhështore. Nga ajo çdo sulm i integritetit në kontest nga njëra anë në anën tjetër, provokon në mënyrë të pashmangshme reaksionin mbrojtës palës të sulmuar, e cila më së shpeshti paraqitet në formë të kundërmbrojtjes.

Kontesti ka edhe dinamikën e saj. Në çdo kontest juridik haset procesi i eskalimit të konfliktit e cila si zakonisht manifestohet gjat sjelljes të palëve në kontest. Çdo kontest ndjek një gjendje të caktuar negative psikologjike dhe ky lloj i “ kontestit psikologjik ” paraqet një faktor për zgjidhjen e saj pasi që shpesh ndodh që konflikti apo kontesti të paraqitet përshkak të urrejtjes dhe tërbimit të akumuluar dhe duke haruar qëllimin për të cilën kanë hyrë në kontest palët me ç’rast qëllimi i vetëm i tyre është që palën kundërshtare ta fitojnë dhe ta dënojnë. Në këtë tekst shpesh përmendet fakti i llojllojshmërisë të kontesteve, gjë që është shumë e vërtetë dhe e pakontestueshme.. Por edhe pse egziston një laramani e tillë, prapëseprap kontestet për nga struktura dhe elementet e saja janë të ngjajshme. Sipas natyrës të lëndës të kontesteve të njejtat mundën të ndahen në kategori të ndryshme: konteste juridiko – civile, konteste juridiko – penale, konteste të punës, konteste familjare dhe të tjerë. Gjithashtu sipas asaj se në strukturën e kontestit paraqitet ose jo elementi i huaj, kontestet mundet të jenë me karakter nacional apo karakter ndërkombëtar. Nga ana tjetër mundet të jenë të natyrës juridiko – private apo mundet të jenë të natyrës juridiko – publike si dhe kontestet gjithashtu mundet të jenë konteste individuale apo kolektive varësisht nga ajo se në kontest marin pjesë individë apo grupe të interesit, grupe autonome apo grupe sociale si përshembull: shoqata të punëdhënësve me puntorët. Lloj i veçantë nga të gjitha kontestet e lartpërmendura janë kontestet juridiko – civile, të cilat paraqesin mospajtueshmëri ndërmjet të dy subjekteve të cilët janë të shqetësuar për të drejtat subjektive të tyre qoftë të lënduara apo të kërcënuara. Kjo mosmarrëveshtje ka të bëjë vetëm me të drejtat subjektive – civile të mardhënies juridiko – civile apo të kërkesave juridiko – civile. Si lëndë e kontestit juridiko – civil mundet të jetë ndonjë çështje faktike, çështje juridike ose edhe njëra edhe tjetra. Çështja faktike si lëndë e kontestit juridiko – civil egziston atëherë kur në mes të palëve, kontestuese është ndonjë fakt si për shembull: a është personi tjetër i papaguar për shërbimin e kryer, a është borxhi i vjetërsuar, e të tjerë. Ndërsa çështje juridike egziston atëherë kur lëndë e kontestit është mosmarrëveshtja e krijuar atëherë kur secila palë në kontest pajtohen për egzistencën e një fakti të caktuar por nga ana tjetër për të njejtin fakt ndërmarin veprime të ndryshme, ose rastet kur paraqitet mospajtueshmëri lidhur me pasojat të cilët e drejta objektive i lidh me ndonjë fakt si për shembull: a është lidhur kontrata apo a është marrdhënia e punës e

bazuar⁵. Mbrojtja e të drejtave subjektivo – civile në rast të rrezikimit, lëndimit apo të kansojes së tyre jepet vetëm në rast të kërkesës së paraqitur nga titullari i asaj të drejte⁶. Ky parim rrjedh nga autonomia e vullnetit, që është parim mbizotrues në të drejtën civile, sipas të cilit parim titullari i të drejtës subjektivo – civile mundet por edhe nuk është e patjetërsueshme që ta mbroj apo të kërkoj mbrojtje për të drejtën e tij të lënduar, rrezikuar apo të kërcënuar. Për këtë shkak gjykatat në asnjë mënyrë nuk janë të autorizuar që të fillojnë procedurë kontestimore sipas detyrës zyrtare “ex officio” por vetëm në bazë të kërkesës të titullarit të drejtës së cënuar apo të shkelur “ex privatio”.

Kur jemi te kontestet juridike, mënyrë më e lehtë se si të veprojmë që të mos të paraqiten të njejtat është që të ndërmiren masa të ndryshme në drejtim të prevenimit të tyre. Megjithatë një mendim i tillë hasën në problem në praktikë. Realizimi në praktikë i prevencionit të tyre është i pamundshëm në çdo aspekt, por jo edhe zgjidhja e tyre repektivisht korigjimi i tyre. Për zgjidhjen e tyre egzistojnë modele të ndryshme të cilët modele gjat zhvillimit historik kanë evoluar dhe ndryshuar si mehanizma për zgjidhje të kontesteve paralelisht dhe në përputhje me zhvillimin e bashkësive shoqërore. Ky proces nuk ka tendenca të ndaloj dhe si e tillë do ta vazhdojë rrugëtimin e saj drejt përsosjes pasi që e njejtat është në ndikim të drejtpërdrejtë të traditës kulturore dhe juridike të bashkësisë shoqërore ku ajo vepron, të sistemit të vlerave, zakoneve dhe vetdijes juridike të cilat kanë egzistuar dhe kanë vepruar në bashkësitë shoqërore. Në literaturë të gjithë modelet për zgjidhjen e kontesteve grupohen në tre grupe: zgjidhja e kontesteve me anë të fuqisë, zgjidhja me anë të së drejtës dhe zgjidhja nga aspekti i interesit.

Lloji i parë i modelit repektivisht zgjidhja e kontestit nga aspekti i fuqisë apo forcës paraqet zgjidhjen e kontestit me ç’rast pala më e fuqishme me përdorimin e fuqisë dhe dhunës i’ a imponon palës tjetër mënyrën se si kontesti të zgjidhet, ashtu që mënyra e zgjidhjes t’i konvenoj palës më të fuqishme e jo edhe palës të cilës i imponohet mënyra e zgjidhjes por nga ana tjetër e njejtat palë duhet të jetë e gatshme që ta pranoj atë zgjidhje. Siç shihet për nga elementet që e përbejnë këtë lloj të modelit, mundet të thuhet se ajo si e tillë nuk është e pranueshme si për bashkësitë shoqërore bashkëkohore ku ne jetojmë sot ashtu edhe për idealet demokratike, pasi që një përmbajtje e tillë nuk është aspak e ndershme, është jo morale dhe para së gjithash aspak humane. Fuqia e cila përdoret për zgjidhjen e kontesteve nuk është gjithmonë “fuqi fizike e

⁵ Г. Станковић, (2013), Грађанско процесно право, прва свеска, Парнично процесно право, Nish, 2012, fq. 36

⁶ Бабић Илија, Увод у грађанско право и стварно право, Београд, fq. 218

thjeshtë”⁷. Në këtë pikpamje nuk mendohet vetëm për ato regjime shtetërore të cilët thellë në thelb janë autokratike dhe diktatoriale, por edhe për ato shtetetë cilët ngriten në postulate demokratike ku keqpërdorimi i fuqisë ushtarake, ekonomike, keqpërdorimi i pozitës shoqërore, shtetet të cilët posedojnë teknologji prej gjeneratave më të fundit dhe mjaft të zhvilluar dhe të cilët si fuqi në botë disponojnë me shumë informacione të cilët i përdorin vetëm për qëllime dhe përfitime personale, paraqiten si palë të cilët mundën që në ndonjë rast të përdorin forcën dhe fuqinë për të zgjidhur kontestin e caktuar ashtu siç atyre u konvenon. Shumë shpejtë vërehet fakti se edhe pse ky lloj i zgjidhjeve të kontesteve me element të përdorimit të dhunës dhe fuqisë në shikim të parë duket mjaft e papërshtatshme dhe në kundërshtim me vlerat dhe e kritikuar mjaft, por nga ana tjetër me plot përgjegjësi mundet të thuhet se egziston edhe sot në masë të konsiderueshme. Pasi që ky lloj i modelit për zgjidhje të kontesteve konsiderohet si i papërshtatshëm dhe aspak demokratik për një shoqëri bashkëkohore ku mbisundon e drejta në të gjitha sferat e shoqërisë, ose së paku ku përpiqet të mbisundoj e drejta në një masë të caktuar, të njëjtën do ta anashkalojmë dhe në këtë kapitull do t’i kushtojmë vëmendje të veçantë dy modeleve tjera të zgjidhjeve të kontesteve nga aspekti i së drejtës - procedura gjyqësore dhe nga aspekti i interesit – procedura e mediacionit.

A: Zgjidhja e kontestit nga aspekti i të drejtës

Kur flitet për zgjidhjen e kontestit për nga aspekti i të drejtës respektivisht në rrugë gjyqësore, e pashmangshme është që të mos përmendet zhvillimi i saj nëpër etapat e ndryshme të zhvillimit të bashkësive shoqërore. Në etapat e hershme të saj njejt si sot titullarët e të drejtave subjektive kanë gëzuar të drejta, edhe pse mjaft të kufizuara në krahasim me atë se në çfarë mase gëzojnë sot, të cilët asokohe kanë gëzuar vetëm njohje të atyre të drejtave, por jo edhe mbrojtje të tyre. Për atë shkak, në fazat e hershme të zhvillimit shoqëror mbrojtja e të drejtave realizohej “si mbrojtje private e të drejtave - vetëmbrojtje”⁸. Vetëmbrojtja në shoqëritë e para ka qenë e njohur si mehanizmi i vetëm mbrojtës, të cilën titullarët e të drejtave subjektive e kanë përdorur me qëllim të tejkalimit të konflikteve duke i mundësuar titullarit që vet t’i ndërmer këto mehanizma duke vlersuar përsëri vet për kanosjen e të drejtave të tij subjektive nga personi tjetër

⁷Петрушиќ. Н, Медијација како метод на решавање правни спорови, Темида, Виктимолошко друштво Србије и Прометеј, vol.7, nr.2, Beograd, fq.34

⁸Јаневски.А, Зороска-Камилошка. Т, (2009), Граѓанско процесно право, книга прва, Парнични Право, Правен Факултет Јустиниан Први, Shkup, fq.2

kundërshtar si dhe për lëndimin e të drejtës së tij subjektive. Pra këtu në skenë paraqitet forca fizike e titullarëve të të drejtave subjektive të cilën ato e kanë përdorur në rast të lëndimit të të njejtave, me ç'rast në dyluftimin për atë se kujt i takon ajo e drejtë subjektive, do të fitonte gjithmon më i fuqishmi dhe më i pregadituri fizikisht. Këtu ndërlihem me metodën e parë të lartpërmendur për zgjidhjen e kontestit nga aspekti i forcës, i cili është modeli më primitiv i përdorur nga ana e njeriut në shoqërit më të hershme, por e cila edhe sot e kësaj dite gjen përdorim edhe në shoqërin bashkëkohore por në përmasa më të ralla. Për këtë lloj të mbrojtjes të të drejtave subjektive të kanosura apo të lënduara, mund të thuhet se mbijetoi për aq sa bashkësia shoqërore e toleroj si metodë për zgjidhjen e kontesteve nga mospasja e metodave tjera për të njejtin qëllim, dhe e njejtja u shua atëherë kur filloi të kanos parimet themelore të bashkësisë shoqërore.

Me kalimin e shoqërisë nga një formë në tjetrën, pra nga një shoqëri primitive ku gjithmon mbizotronte friga dhe forca dhe nga më i fuqishmi, në një shoqëri pak më tepër të zhvilluar, bëhen edhe përpjekje që marrdhëniet në mes të personave të rregullohen në mënyra “pak” më bashkëkohore nga ajo se si rregulloheshin deri më atëherë. Këto përpjekje u intensifikuan edhe nga shkakut se marrdhëniet në mes të personave të cilët bashkëtojnë në një bashkësi shoqërore u rritën në numër, dhe me këtë u rrit në mënyrë të barabartë edhe numri i mosmarrëveshtjeve. Si rezultat i kësaj filloi edhe kërkimi i metodave adekuate për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshtjeve dhe me këtë edhe për mbrojtjen e të drejtave të shkelura subjektive. Prap se prap si metodë e cila nuk ishte ende e rrënjosur thellë në shoqëri dhe e cila ende gjente implementim ishte zgjidhja e konflikteve vet nga ana e personave, por nuk mundet të mohohet edhe tentimi i ikjes të këtij lloji të zgjidhjes të konflikteve, duke u pajtuar vet palët që “zgjidhjen e konflikteve t’ua besojnë personave të tretë në të cilët kanë fituar besim (gjyqtarë të zgjedhur, arbitra) të cilët ndërmjetësonin apo arbitronin për zgjidhjen e konfliktit”⁹. Por edhe pse përpjekjet kanë qenë të shumta, prap se prap në këtë fazë të zhvillimit shoqëror ende nuk mundet të flitet për një hap të madh e cila ka ndryshuar mbrojtjen e të drejtave, pasi që mbrojtja e të drejtave në këtë fazë nuk ka pasur formë të organizuar dhe si e tillë mbrojtja është bërë jashtë organit shtetëror.

⁹ Ibid, fq.3

Mbrojtja private dal nga dalë fillon të zbehet në periudhën kur fillon që shteti të forcohet si aparat i dhunës, me ç'rast në pah del forma e organizuar e mbrojtjes të të drejtave subjektive. Shteti si formë më e përsosur dhe më e lartë i organizimit i cili bazohet në parimin thelbësor të respektimit të ligjit, ku secili i nënshtrohet të të njetës së drejtë qoftë ai individ apo qoftë pushtet publik, insiston në paraqitjen e ideve për forma më të aplikueshme dhe më të përshtatshme të mbrojtjes të organizuar të të drejtave subjektive, e cila ide filloi dal nga dalë të bëhet realitet atëherë kur filluan të parashihen rregulla të shkruara dhe të obligueshme për të gjithë, të destinuara për mbrojtjen e të drejtave subjektive, të cilat rregulla nga viti në vit si rezultat edhe i përvojës, nga një numër i vogël u shumëfishuan gjë që rezultoi në realizimin e organizuar të mbrojtjes shtetërore.

Në shoqëritë bashkëkohore zgjidhja e kontesteve nga aspekti i të drejtës paraqet metodën më dominante për eliminimin e kontesteve, e cila do të duhej të mundësonte vendosjen e qetësisë dhe të stabilitetit juridik në mardhëniet juridike. Pra, në sistemet juridike bashkëkohore përmes organeve shtetërore respektivisht përmes gjykatave sigurohet mbrojtja e të drejtave në procedurë të paraparë dhe të rregulluar në mënyrë të përpiktë me ligj, rregullat e të cilëve duhet t'i respektojnë të gjithë pa mar parasysht a janë ato të cilët kërkojnë mbrojtjen e të drejtave subjektive të cënuar, lënduar apo ato të cilët me ligj janë të autorizuar që të japin atë lloj të mbrojtjes. “Çështjes juridike të gjykuar i paraprinë një procedurë e cila është një “luftë” specifike për të drejtën dhe e cila zhvillohet sipas rregullave të caktuara prej më herët dhe me përdorimin e “mjeteve luftarake” të lejuara”¹⁰. Hapsira e manevrimit në të cilën palët gjat luftës për të drejtën përdorin veprime procedurale ofanzive dhe defenzive, është e kufizuar me ndalesë nga ana e parimit e cila parashih ndalim për keqpërdorim të autorizimeve procedurale. Fakt është se keqpërdorimi i autorizimeve procedural nga ana e palëve në procedurë është një fotografi e cila paraqitet çdo ditë, dhe gjykatat jo që nuk mundën ta detektojnë të njëjtën, por ndonjëherë qëndrojnë indiferent përball një sjelljeje të tillë nga ana e palëve. Kjo procedurë e cila siguron mbrojtjen e të drejtave subjektive në mënyrë të organizuar dhe të rregulluar me ligj, paraqet një ndër procedurat më të rëndësishme – procedurën civile. Vendimi i cili sillet në këtë procedurë dhe me të cilën vendoset për çështjen kontestuese, paraqet normë juridike e cila për palët në kontest ka fuqinë e ligjit, dhe të njëjtët janë të detyruar që sjelljet e tyre t’ia përputhin përmbajtjes të vendimit, me ç'rast kur vendimi të bëhet i plotfuqishëm, çështja juridike

¹⁰Петрушиќ. Н, op.cit, fq.35

kontestuese (res litigora) bëhet çështje e gjykuar (res judicata) dhe si e tillë bëhet përfundimtare, e pakontestueshme dhe e pandryshueshme.

B: Zgjidhja e kontestit nga aspekti i interesit

Modeli tjetër i zgjidhjes të kontesteve është i bazuar në “ interesin ” për zgjidhjen e saj. Idea e këtij lloji të zgjidhjes të një mosmarrëveshtjeje të caktuar është ajo se kontesti apo mosmarrëveshtja mundet të zgjidhet, nëse palët në kontest bashkërisht e vërtetojnë kush është arsyeja e mosmarrëveshtjes të paraqitur ndërmjet tyre si dhe të gjejnë një zgjidhje integrative dhe të përbashkët e cila do t'i apsolvojë interesat e të dy palëve të cilët gjinden në kontest të përbashkët. Mënyra më adekuate e cila në vete i ngërthen zgjidhjet e kontesteve duke u nisur nga interesat personale të palëve, pra nga aspekti i interesit siç është emëruar ndryshe apo mediacioni (ndërmjetësimi).

Mediacioni paraqet një ndër mënyrat alternative të zgjidhjeve të kontesteve në mes të palëve apo në gjuhën angleze njihet me termin Alternative dispute resolution dhe si e tillë ajo mundëson që një kontest i caktuar të zgjidhet në mënyrë paqësore dhe miqësore, e cila në fund të procedurës materializohet në zgjidhje të përbashkët dhe të pranueshme për të dy palët të përfshirë në kontest. Pra, në këtë procedurë e cila zbatohet jashtë hapsirave të gjykatave nuk dëshirohet që të vërtetohet kush ka të drejtë e kush jo, ose kush ka faj e kush jo, por dëshirohet të arrihet një zgjidhje e cila është në interes të të dyja palëve në mes të të cilëve ka lindur apo është paraqitur kontesti. “Mediacioni është process në të cilën pala e tretë neutral u ndihmonë palëve të gjejnë një zgjidhje për kontestin me anë të negociatave”¹¹. Sot kjo mënyrë e zgjidhjes të kontesteve konsiderohet si mënyrë më e përshtatshme dhe njëkohësisht më e shpejtë, duke marrë parasysh faktin se gjykatat sot janë të stërmbyshura me lëndë të cilët ende presin në rradhë për zgjidhje por edhe të cilët një kohë të konsiderueshme janë haruar nëpër fiokat e gjyqtarëve. Për atë shkak shpesh herë për mediacionin flitet si për një mënyrë më të përparuar dhe më të përsosur kur kemi të bëjmë me bisedimet dhe negociatat të cilët udhëhiqen në mes të palëve në kontest kur të njëjtit nuk mundin që të mirin vesht ndërmjet veti dhe nuk mundin ta zgjidhin kontestin e paraqitur, dhe për atë shkak ato angazhojnë një mediator/ndërmjetësues i cili është i profesionalizuar për këtë lloj të zgjidhjeve të kontesteve jashtëgjyqësor, pra me anë të

¹¹Цековска, Л, (2006), Арбитража и медијацијата во решавањето на споровите, Judicial review, nr.1/2006, Здружение на судиите во Република Македонија, Шкуп, fq. 110

mediacionit me çka arrihet që të lehtësohet realizimi i saj dhe zgjidhja sa më e shpejtë e kontestit në mënyrë më të lehtë dhe miqësore¹².

Edhe pse zgjidhja e kontesteve me anë të metodave të cilat aplikohen jasht hapsirave gjyqësore duken më të përshtatshme, dhe në faktë janë më efikase, më ekonomike dhe mbi gjithash janë një zgjidhje paqësore prap se prap zgjidhja e kontesteve nga aspekti i të drejtës respektivisht zgjidhja e kontesteve në rrugë gjyqësore qëndron në vend të parë si metod primar për zgjidhjen e kontesteve ne mës të palëve pa mar parasysh edhe faktin se të pranishme janë një numër i madh dhe lloje të ndryshme të modeleve dhe teknikave të zgjidhjeve paqësore të kontesteve të cilët për bazë kanë interesin.

2. ADR - Alternative Dispute Resolution/Zgjidhja Alternative e Kontesteve

Kontestet në mes të personave por edhe në mes të grupeve paraqesin një pjesë të natyrës të raporteve njerëzore. Zgjidhja e kontesteve është një proces interaktiv njerëzor, në të cilën palët mundohen t'i zgjidhin problemet e krijuara ndërmjet tyre. Zgjidhja e problemeve si zakonisht bëhet me anë të mjeteve jo të dhunshme, edhe pse shpesh herë në praktikë ka përjashtime kur palët mundohen që konfliktet t'i zgjidhin me anë të përdorimit të dhunës. Paralelisht me metodat për zgjidhje të kontestit nga aspekti i të drejtës në rrugë gjyqësore dhe me procedurë të rregulluar me ligj në mënyrë të detajuar, sot përdoren edhe metoda të ndryshme për zgjidhjen paqësore të kontesteve, për të cilat si nocion të përbashkët përdoret nocioni " zgjidhje alternative e kontesteve ". Zgjidhjet alternative të kontesteve sot në shumicën e shteteve njihen dhe pranohen si alternativë e klasikes, respektivisht e procedurës gjyqësore klasike. Në sistemet bashkëkohore juridike si dhe në shoqëritë demokratike, teknikat e zgjidhjeve alternative të kontesteve kanë filluar të zejnë vend të rëndësishëm, pasi që kohët e fundit shumë shtete filluan të njohin potencialin e tyre për tejkalimin e krizave dhe të problemeve me të cilat përballet gjyqësori, e sidomos kur vjen tek procedurat gjyqësore të shtrejnta, të ngadalta dhe joefikase. "Zgjidhjet alternative të kontesteve ofrojnë zgjidhje të problemeve të qasjes të qytetarëve më drejtësinë në shumë shtete përshkak të tre faktorëve: numri i kontesteve të paraqitura para gjykatës janë gjithnjë e në rritje, procedurat bëhen më të gjata dhe shpenzimet të cilët paraqiten përshkak të

¹²Кобачевик. Л, (2006), За медијација, Правен живот, Часопис за правна теорија и пракса, Право и културни разлики, пр.12, Здруженињ на правници на Република Србија, Beograd, fq.269

procedurave janë më të larta"¹³. Metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve nëse i shikojmë burimisht, janë paraqitur jashtë sistemit gjyqësor, por në kohrat e fundit shumë shpesh përdoren dhe aplikohen brenda përbrenda tij. Promovimi dhe aplikimi i gjërë i metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve ka të bëjë me ngarkimin e tepërt të gjyqësorit me numër të madh të lëndëve dhe me procedura raskapitëse, por edhe ka të bëjë edhe me faktin se shtetet sot janë gjat gjithë kohës nën presion që sistemi gjyqësor të përmirësohet nga aspekti i efikasitetit por edhe nga aspekti kualitativ i dhënies të vendimeve të drejta, pra me një fjalë që qytetarëve dhe personave juridik t'u mundësohet përdorimi i mehanizmave adekuat për zgjidhje të kontesteve të tyre.

Nocioni i zgjidhjeve alternative të kontesteve në vete ngërthen të gjitha metodat jashtë gjyqësore të zgjidhjes të kontesteve dhe si të tilla definohej "metoda të zgjidhjeve të kontesteve jashtë gjykatave me ndërmjetësim të palës së tretë neutrale, e cila ndihmon për zgjidhjen e një kontesti të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme për arritjen e një zgjidhjeje e cila është e pranueshme për palët"¹⁴. ADR ose Alternative Dispute Resolution siç njihet në gjuhën angleze, si nocion prejardhjen e ka nga gjuha angleze dhe si e tillë pra si ADR sot është globalisht e pranuar dhe përdoret për të nënvizuar metodat dhe teknikat e shumta për zgjidhje të kontesteve, por nga ana tjetër duke mos rrezikuar dhe kompromituar procedurën gjyqësore klasike. E pashmangshme është që të mos përmenden dilemat rreth terminologjisë e cila përdoret për përcaktimin e nocionit të zgjidhjeve alternative të kontesteve. Nocioni "zgjidhje alternative të kontesteve" në vete përmban tre shprehje dhe atë: "zgjidhje", "alternative" dhe "kontest". Shprehja e parë "zgjidhje" është shprehje e cila na tregon veprimet të cilët ndërmiren për të vendosur për një çështje apo problem i cili ka natyrë kontestuese. Kjo shprehje është gjithëpërfshirëse dhe si e tillë konsiderohet e përshtatshme për përdorim në nocion të tillë, me ç'rast në këtë aspekt mundet të thuhet se nuk ka dilema për shprehjen e tillë. Por nga ana tjetër dilema dhe diskutime të shumta ka për shprehjen e dytë të këtij nocioni dhe atë për shprehjen "alternative" si shprehje apo term gjenerik e cila na asocon në një numër të madh të formave të ndryshme të zgjidhjeve të mosmarëveshtjeve jashtë sistemit gjyqësor. Shprehja alternative shpesh herë ka qenë temë e diskutimeve dhe debateve në shumë komisione, ku edhe është biseduar për zëvendësimin

¹³ Direktiva 2008/52/EC e Këshillit Europian dhe të Parlamentit të 21 marsit 2008 në Aspektet e caktuara të Medijacionit në çështje civile dhe tregtare, OJ. Nr L.136/3, 24/5/2008

¹⁴Цековска. Л, (2006), Арбитражата и медијацијата во решавањето на споровите, Shkup, fq. 109

e shprehjes " alternative " në nocionin e gjuhës angleze " ADR " e cila është pranuar gjithandej, me shprehje të tjera të cilët konsiderohen gjithashtu shumë të kapshme respektivisht kompaktibile me nocionin në të cilën përdoren, por edhe qëllimin të cilën ato shprehje e përshkruajnë. Njëra nga shprehjet e cila është paraqitur si propozim është "appropriate" e cila don të thotë e "përshtatshme", në fakt nocioni i plotë në gjuhën angleze dhe shqipe do të vinte, "appropriate dispute resolution" apo "zgjidhje e përshtatshme e kontesteve". Tjetër shprehje e propozuar ka qenë edhe shprehja "additional" në gjuhën angleze apo "plotësuese" në gjuhën shqipe, si rezultat i të cilës nocioni i ADR do të tingëllonte kështu: "additional dispute resolution" në gjuhë angleze apo "zgjidhje plotësuese të kontesteve" në gjuhën shqipe. Tjetër propozim për zëvendësimin e mbiemrit "alternative" në nocionin e ADR është edhe shprehja "amicable" apo "miqësore" në gjuhën shqipe, me ç'rast nocioni ADR do të tingëllonte "amicable dispute resolution" apo në gjuhën shqipe "zgjidhje miqësore e kontesteve", i cili nocion duket mjaft i përshtatshëm në qoftë se meret parasysh natyra e teknikave të cilët përdoren në zgjidhjen e kontesteve. Dhe shprehja e fundit e propozuar është "accelerated" apo që në shqip domethënë "e përshpejtuar" ku nocioni i plotë do të vinte "accelerated dispute resolution" apo zgjidhje e përshpejtuar e kontesteve" e cila për nga aspekti "kohë" respektivisht për nga efikasiteti mundet të thuhet se është mjaft i përshtatshëm si term. Kritikë qendrore sa i përket shprehjes "alternative" qëndron në pyetjen të cilën e parashtron shumë teoricient dhe profesorë, "alternative në çka"? "Komisioni për Reforma në Drejtësi i Irlandës"¹⁵ në njërin nga hulumtimet e saja respektivisht në Revistën për konsultim theksonin se ADR apo zgjidhjet alternative të kontesteve nuk duhet të shihen si një njesi e veçantë nga marëveshtjet të cilët dalin nga gjykatat, por duhet të shihen si një njesi e veçantë nga marëveshtjet të cilët dalin nga gjykatat, por duhet të shihen si një pjesë integrale e një sistemi të tërë"¹⁶. Edhe përkundër kritikave të shumta sipas këtij komisioni shprehja "alternative" në nocionin e ADR konsiderohet i përshtatshëm sidomos kur vijnë në shprehje synimet e asaj shprehje siç janë qëndrueshmëria dhe qartësia. Shprehja "alternative" inicon në atë se bëhet fjalë për diçka që tolerohet brenda kufijve të "vendosjes së

¹⁵ Komisioni për Reforma në Drejtësi është një trup i pavarur i themeluar me Aktin e Komisionit për Reforma në Drejtësi në vitin 1975 dhe e cila ka një rol për shqyrtimin dhe hulumtimin e drejtësisë dhe ligjeve me të vetmin qëllim - ta reformoj drejtësinë. Akti i vitit 1975 e definon reformimin e drejtësisë duke përfshirë zhvillimin e të drejtës, kodifikimin e saj, revizionin si dhe konsolidimin e të drejtës statutoare.

¹⁶ Consultation Paper on Alternative Dispute Resolution, Law Reform Commission, 50 - 2008, në pikën 2.06

drejtë juridike"¹⁷. Megjithatë me kalimin e kohës dhe me këtë edhe me përparimin e metodave dhe teknikave juridike për të vendosur një çështje apo problem por edhe si rezultat i ekspansionit të alternativave të tilla, fillon të ndryshojë të kuptuarit e tyre dhe përshtatshmëria terminologjike si dhe pranimi i tyre më i lehtë por edhe dhënja e vendit të merituar të tyre në sistemet juridike bashkëkohore. Së fundmi në shtetet ku zgjidhjet alternative të kontesteve paraqesin traditë në zgjidhjen e kontesteve, termini i tillë dal nga dalë fillon të zbehet në përdorim sepse metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve kaluan në përdorim të rregullt dhe të përditshëm, ndërsa nga ana tjetër palët shpesh herë këto metoda i shfrytëzojnë si procedura paraprake. Pra në shtetet ku përdorimi i teknikave të zgjidhjeve alternative të kontesteve përdoren çdo ditë e më tepër mundet lirisht për to të bisedohet sikurse për procedura të rregullta dhe të përshtatshme për zgjidhje të kontesteve. Në nocionin e zgjidhjeve alternative të kontesteve përveç shprehjeve "zgjidhje" dhe "alternative", përmban edhe shprehjen "kontest" e cila shprehje duhet pak të analizohet dhe të precizohet. Kontestet në mes të personave paraqesin një pjesë të natyrës të raporteve njerëzore. Ndonjëherë mosmarrëveshtjet e tilla janë të llojeve dhe intensiteteve të ndryshme, dhe për atë shkak natyra e ndryshueshme e tyre kërkon më shumë mënyra për zgjidhjen e tyre. Mosmarrëveshtjet fillojnë atëherë kur dy palët zbulojnë se kanë qëndrime jokompaktibile apo qëllime të ndryshme. Ashtu siç rriten mosmarrëveshtjet, ashtu palët ndërmjet veti fillojnë të detyrojnë njëri tjetrin që mendimet e tyre t'i përputhen mendimeve të tjetrit apo fillojnë që të provokohen, pra paraqitet një situatë e cila çon drejt në një kontest të caktuar. Nëse palët nuk mundën që të gjejnë një kompromis të përbashkët ose të paktën të mundohen që ta largojnë problemin e paraqitur, ato mundën të ndërmarrin një sërë veprimesh si për shembull: pengesa, opstruksione, pasivitet dhe gjithashtu ushtrim dhune për ta vërtetuar anën e tyre respektivisht pretendimet e tyre në mosmarrëveshtjen e lindur. Sot në shoqërit bashkëkohore, kur kontestet e tilla nuk mundën të zgjidhen, rreziku që palët t'i perceptojnë ndryshimet në mes tyre është shumë i madh. Nga kjo mundet të vihet në përfundim se shprehja "kontest" është lloj i mosmarrëveshtjes dhe i konfliktit por jo e të çdo natyrës, por vetëm e natyrës juridike dhe si të tilla janë lëndë e zgjidhjeve alternative të kontesteve, përderisa kontestet dhe konfliktet të natyrave tjera qoftë ato personale, etnike, psikologjike, racore e të tjera edhe pse mundet të miren parasysh gjat zgjidhjes të kontesteve për përmbajtjen e të drejtave në mes tyre, ato nuk mundën

¹⁷Узелац. А, (2004), Мирење како алтернатива на судењето, Мирење на граѓански, трговски, работни спорови, Тим Пресс, Zagreb, fq.2

të konsiderohen lëndë e zgjidhjeve alternative të kontesteve. Pra, egzistimi i kontestit paraqet kushtin kryesor për zbatimin e teknikave të zgjidhjeve alternative të kontesteve.

Gjat gjith kohës përmenden teknikat, metodat ose mënyrat e zgjidhjeve alternative të kontesteve. Pra kjo na asocion në atë se janë disa forma në të cilët manifestohen mënyrat alternative të zgjidhjeve të kontesteve, por të gjitha janë të drejtuara në përmbushjen e të njejtit dhe të vetmit qëllim dhe atë të shkarkimit të gjykatave nga lëndë të tepërta si dhe ekonomizimi por edhe efikasiteti i zgjidhjeve të kontesteve njëkohësisht. Zgjidhjet alternative të kontesteve paraqiten në disa forma respektivisht teknika dhe si më të shpeshta janë: arbitrazhi, mediacioni, *ENE (early neutral evaluation/vlersimi neutral i hershëm)*, *case evaluation or mandatory arbitration (vlersimi i kontestit ose arbitrazh i detyruar)*, *judge hosted settlement conferences (konferenca për arritje të marveshtjes të mbajtur nga ana e gjykatësit)*, *java e marëveshtjeve*, e të tjera. Arbitrazha paraqet një formë të zgjidhjeve alternative të kontesteve e cila është një koncept që përfshin një grup të procedurave për zgjidhjen private të kontesteve. Në Republikën e Maqedonisë arbitrazhi është e rregulluar me " Ligjin mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë "¹⁸. Me këtë ligj janë të rregulluara nocioni i arbitrazhit, gjykatës për arbitrazh, arbitër, vendimit të arbitrazhit, marëveshtja e arbitrazhit dhe shumë çështje të tjera të cilët kanë lidhje me arbitrazhin. Sipas nenit 2 alinesë 1 të këtij ligji, arbitrazhi paraqet atë arbitrazh pa marë parasysh atë se organizimi i saj i është besuar ndonjë institucioni të përhershëm të arbitrazhit, pra është gjykim para gjykatës së arbitrazhit pa marë parasysh a është organizuar e njëjta nga institucioni i arbitrazhit apo jo. Sot shpesh herë fillon të hiqet dorë nga arbitrazhi si pjesë e sistemit të zgjidhjeve alternative të kontesteve nga shkak i karakterit të arbitrazhit si procedurë para gjykatave joshtetërore, e cila në bazë të karakteristikave të saja ka më shumë ngjajshmëri me procedurat gjyqësore klasike se sa ka ngjajshmëri me metodat dhe teknikat e zgjidhjeve alternative të kontesteve¹⁹. Për atë shkak arbitrazha si metodë konsiderohet metodë gjyqësore e zgjidhjeve të kontesteve, zbatueshmërinë e të cilës metodë shteti e lejon sipas disa kushteve e cila bazohet në marëveshtjen e palëve dhe të cilët janë ato të cilët e derogojnë

¹⁸ Ligji mbi arbitrazhën tregtare ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 39 i vitit 2006

¹⁹ Se arbitrazha ndahet nga teknikat e zgjidhjeve alternative të kontesteve parashihet në rregullat e dokumenteve ndërkombëtare të cilët e rregullojnë këtë fushë. Në revistën Green Paper - an alternative dispute resolution in civil laë and commercial laë, Commission of the European Communities, Brusels, 19.04.2002, COM (2002) 190final (në tekst do të përdoret ncoioni Green Paper), në faqen gjashtë parashihet se "Alternative methods of dispute resolution, for the purpose of this Green Paper is defined as out-of-court dispute resolution processes conducted by a neutral third party, excluding arbitration proper"

kompetencën e gjykatës dhe i'a japin gjykatës së arbitrazhit, të cilët e autorizojnë të njëjtin që kontestin e tyre ta zgjidhin në mënyrë meritore. Pra palët pajtohen që së bashku të caktojnë një person neutral ose një person që do të sjell vendim pasi që të dëgjoj qëndrimet e të dy palëve. Përparia e egzistimit të kompromisit ose të pajtueshmërisë të palëve në vend të egzistimit të një zgjidhje juridike detyruese të imponuar, paraqet karakteristikën më të madhe të zgjidhjeve alternative të kontesteve. Tek arbitrazha gjykatat joshtetërore kanë autorizim nga palët që të zgjidhin kontestin në mes tyre me vendim detyrues e cila sipas nevojës mundet të jetë objekt përbarimi.

Early neutral Evaluation- vlersimi neutral i hershëm është proces në të cilën palët në kontest bëjnë një prezentim joformal para personit i cili është neutral dhe i cili gëzon respekt me qëllim të marjes të një vlersimi me gojë ose me shkrim për qëndrimet e palëve , i cili vlersim mund të jetë obligativ ose joobligativ²⁰. Pra vlersimi neutral i hershëm paraqet një procedurë joobligative e cila u'a mundëson palëve që vet ta vlersojnë rezultatin e mundshëm me të cilën do të përfundonte procedura gjyqsore dhe varësisht vlersimit të bërë mund t'i iket kontestit të panevojshëm. Formë tjetër e mënyrave të zgjidhjeve alternative të kontesteve është edhe vlersimi i kontestit apo arbitrazhi i domosdoshëm e cila ne gjuhën angleze njihet me termin "*Case Evaluation or Mandatory Arbitration*". Arbitrazhi i detyrueshëm është një formë e zgjidhjeve alternative e kontesteve në të cilën dy apo më shumë palë duhet ta paraqesin kontestin e tyre para një arbitri dhe jo të zgjedhin zgjidhjen e çështjes së tyre para një gjykate shtetërore²¹. Kjo metodë dallon nga vlersimi i hershëm neutral nga fakti se ajo mundet të realizohet edhe pas fillimit të disa fazave të procedurës kontestimore apo të procedurës të arbitrazhit por me kusht që të filloj para shqyrtimit kryesor. Pra edhe pse palët kanë inicuar procedurë kontestimore apo të arbitrazhit ato munden ende të marrin një vlersim për rezultatin e pritur nga ana e më shumë ekspertve²². *Konferencat për aritjen të marëveshjeve para gjyqtarit* paraqet një praktik mjaft e përhapur në SHBA apo siç njihet në gjuhën angleze *Judge hosted settlement conference*. Kjo formë e zgjidhjes alternative të kontesteve paraqet përpjekjet të gjykatës për të aritur një marëveshje në mes palëve në kontest para gjykatave në SHBA. Nga shkaku se kjo praktikë është shumë e

²⁰ <https://definitions.uslegal.com/e/early-neutral-evaluation/>

²¹ <https://definitions.uslegal.com/m/mandatory-arbitration/>

²² Në arbitrazhin e detyrueshëm palët do të paraqesin provat e tyre para caktimit të arbitrit. Pas saj arbitri do të caktoj shumën e shpërblimit. Përvojat në SHBA tregojnë se vlersimi neutral i hershëm dhe arbitrazhi i detyrueshëm janë arsytet e zgjidhjes të kontesteve të shumta para seancës së shqyrtimit kryesor dhe para sjelljes të vendimit merititor.

shpeshtë dhe është shumë e zhvilluar, në SHBA egzistojnë gjyqtarë të cilet kanë pregatitje profesionale të veçantë për procedura të tilla të cilët në gjuhën angleze quhen *Settlement Judges*. "Ndonjëherë përdoren teknikat e mediacionit nga ana e gjyqtarëve për arritje të marëveshtjeve për të përmisuar komunikimin në mes të palëve për ti provuar kufijtë e marveshtjes dhe për dhënien ndihmë për formulimin e zgjidhjeve"²³. *Java e marëveshtjeve* paraqet një formë tjetër alternative të zgjidhjeve të kontesteve, ku gjykata i ndërpret të gjitha aktivitetet e saja me qëllim që mediatorët të perpiqen ti pajtojnë palët, respektivisht që të arrijnë një marëveshtje në mes tyre lidhur me kontestin e krijuar. Në këto raste si mediator më së shpeshti vullnetarisht paraqiten gjyqtarë dhe avokat në pension. Mundet të thuhet se kjo është mediacion e cila udhëhiqet në hapsirat gjyqësore të cilën e udhëheqin mediatorët e jo gjykatësit. Në qoftë se mediacioni dështon, atëherë rastet do të kthehen në procedurë gjyqësore. Një formë tjetër e menyrave alternative për zgjidhje të kontesteve është edhe *Mini Gjykimi*, gjithashtu i praktikuar në SHBA e cila edhe nga vetë emri "mini" bazohet në prezntimin e verzioneve të shkurtuar nga palët. "Dëgjimi i palëve është jo formale , pa prezencën e dëshmitarëve dhe me regulla relaksuese të të provuarit dhe të procedurës"²⁴. Pas procedurës të të dëgjuarit të palëve, përfaqësuesit e palëve takohen me njëri tjetrin me ose pa ndonjë palë neutrale me qëllim që të arrihet marëveshtje lidhur me kontestin që kanë palët ndermjet. Si rezultat i përhapjes i metodave dhe teknikave të zgjidhjeve alternative të kontesteve në përmasa të mëdha, por edhe si rezultat i karakterit të tyre mjaft fleksibil linden kombinime të shumta të elementeve dhe teknikave. Rasti i tillë më i njohur është metoda *Med - Arb*. Kjo metodë paraqet një lloj hibridi dhe metodë dyshkallësh i zgjidhjeve alternative të kontesteve, mediacionit dhe të arbitrazhit. Siç edhe është emëruar kjo metodë, kuptohet menjëherë se së pari fillohet me mediacion, pra një mediator neutral mundohet që ta ndihmojë palën lidhur me çështjen kontestuese. Në qoftë se nuk arrijnë zgjidhje të mosmarëveshtjes me ndihmë të mediacionit, atëherë çështja e tyre kontestuese kalon në arbitrazh. Kjo metodë hibride është shumë e përshtatshme për të gjitha rastet ku palët edhe pse kanë dëshirë që kontestin ta përfundojnë me vendim meritore dhe me të drejta dhe detyrime të percaktuara për palët, ato gjithashtu insistojnë që procedura e zgjidhjes të kontestit të fillojë me bisedë konstruktive për çështjet kontestuese. Megjithatë palët në kontest mundet të bëhen shumë të pasigurt lidhur me faktin e paraqitjes të sinqertë të rastit para mediatorit gjatë procedurës për

²³ <https://definitions.uslegal.com/j/judge-hosted-settlement-conferences/>

²⁴ R. Niemic, D. Stienstra, R. Ravitz, (2001), Guide to Judicial Management of Cases in ADR, Federal Judicial Centar, Washington, fq. 134

mediacionin sepse ato mundet të supozojnë se mediatori më vonë mundet të bëhet personi i cili do të merte vendimin përfundimtar për kontestin. Përparsia dhe pozitiviteti më i madh i "Med-Arb" është çështja e ikjes të shpenzimeve të tepërta dhe të panevojshme. Me anë të kësaj metode thjeshtëzohet dhe lehtësohet procedura e të vërtetuarit, pasi që shumë pyetje dhe çështje mundet të shqyrtohen me anë të mediacionit pa shpenzime të tepërta dhe të panevojshme dhe për një periudhë shumë më të shkurtër në krahasim me arbitrazhin dhe procedurën e regullt gjyqësore. Në SHBA "Med - Arb" procedura përdoret më shumë në sektorin privat se sa në gjykatat, edhe pse në gjyqësorin amerikan së paku nga një gjykatë federale e rajonit lejon përdorimin e kësaj metode²⁵. Në disa shtete, metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve dalë ngadalë kanë filluar të zbatohen brenda për brenda sistemit gjyqësor. Metodatat të tilla njihen me nocionin *Court annexed ADR* në gjuhën angleze, apo ndryshe në gjuhën shqipe " *Metodat alternative të ngjitura apo të aneksuara me gjykatën* ". Është Libri i Gjëlbert²⁶ për zgjidhje alternative të kontesteve në të drejtën civile dhe tregtare ajo që bën dallimin në mes të zgjidhjeve alternative të kontesteve të cilët zbatohen nga ana e gjykatës dhe zgjidhjeve alternative të kontesteve të cilët i janë besuar palës së tretë nga ana e gjykatës dhe në mes të zgjidhjeve alternative të kontesteve të cilët i përdorin dhe i zbatojnë palët për zgjidhje të kontesteve jashtë hapsirave gjyqësore. Sipas Librit të Gjëlbert zgjidhjet alternative të kontesteve në bazë të drejtës civile dhe tregtare mundet të përfshihen në disa lloje të kategorive e cila varet nga rregullimi juridik specifik²⁷. Në pikën e tretë të pjesës së parë në Librin e Gjëlbert theksohet se duhet të bëhet një ndarje e theksuar në mes të "ADR in the context of judicial proceedings" apo "zgjidhjet alternative të kontesteve në kontekstin e procedurave gjyqësore" e cila nënkupton praktikën kur metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve përdoren nga ana e gjykatave apo të njejtat gjykata u'a besojnë personave të tretë, dhe ndarja tjetër është në mes të "convetional ADR" apo në mes të "zgjidhjet alternative të kontesteve tradicionale" atëherë kur kemi të bëjmë me metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve të cilët palët i përdorin por jashtë procedurës gjyqësore. Më pastaj Libri i Gjëlbert gjithashtu vendos një vijë dalluese brenda kornizës të zgjidhjeve alternative të kontesteve tradicionale, atëher kur pala e tretë mundet të sjellë vendim e cila do të jetë obligative

²⁵ R. Niemic, D. Stienstra, R. Ravitz, op.cit, fq.135

²⁶ Green Paper on alternative dispute resolution in civil and commercial law, Commission of the European Communities, Brussels, April 2004

²⁷ Green Paper, fq.6

për palët në kontest apo ti udhëzojë palët ose t'u propozojë për lirinë që ato kanë për të ndjekur apo jo udhëzimet dhe porpozimet e palës së tretë.

3. Nevoja për zgjidhje alternative të kontesteve

Idetë për zgjidhje alternative të kontesteve nuk janë paraqitur vetëm në kohrat bashkëkohore dhe moderne, por ato egzistojnë prej shumë më herët, dhe atë qysh para egzistimit të gjykatave dhe procedurave gjyqësore. Prej metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve më shpesh të përdorura në kohrat e hershme kanë qenë mediacioni dhe arbitrazhi²⁸. Përdorimi i mediacionit rrënjët e saj i ka qysh në kohrat antike, ku zgjidhja e kontesteve më së shpeshti u është besuar personave më të besuar, apo personave të cilët kanë gëzuar autoritet në shoqëri, ndërsa në procedurë kanë marrë pjesë e gjithë bashkësia. Në Greqin antike Aristoteli (384 - 322 p.k) dhe Ciceroni (106 - 43 p.k) e kanë favorizuar arbitrazhin me fjalë të cilët sot lirisht munden të përdoren për të përshkruar arbitrazhin modern. Sipas tyre arbitrazhi paraqet një alternativ të gjykatave. "Aristoteli ka thënë se arbitrazhi është prezentuar të jep barazi në peshën e duhur, duke bërë të mundshme vlersimin sa më të madh për drejtësi", ndërsa Ciceroni ka thënë se gjykimi është "i saktë i qartë dhe i detajuar" ndërsa arbitrazhi është "i butë dhe i moderuar"²⁹. Sipas Ciceronit një person kur inicon procedurë gjyqësore lidhur me kontestin e caktuar, pret që ose të fitojë ose të humb, ndërsa në qoftë se i njëjti për kontestin e njëjtë inicon procedurë të arbitrazhit, ai nga ajo procedurë pret që të mos fitoj gjithçka por edhe gjithashtu pret të mos humb gjithçka. Një ndër ilustrimet historike më intriguese të fenomeneve të zgjidhjeve alternative të kontesteve, është roli i Muhamedit për t'iu shmang luftës mbi ndërtimin e Qabesë³⁰. Qëllimi i përdorimit të metodave dhe teknikave të zgjidhjeve alternative të kontesteve në kohrat antike kanë qenë zgjidhja e kontesteve të karakterit ndërkombëtar dhe politik. Muhamedi gjat viteve të para të islamit ka promovuar por edhe ka praktikuar arbitrazhin si metod i zgjidhjeve alternative të kontesteve i ashtuquajtur në gjuhën arabe "tahkim". Përveç se në sferën politike dhe atë ndërkombëtare, metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve në mënyrë sporadike fillojnë që të përhapën edhe në sfera tjera, e sidomos në sferën e punës dhe në sferën tregtare.

²⁸ Në vitin 1800 p.k, medijacioni dhe arbitrazhi janë përdorur nga ana e mbretërisë Mari (në Sirinë e sotshme) për të zgjidhur konfliktet me mbretëritë tjera, Boule, Lawrence, A history of alternative dispute resolution, ADR Bulletin, Vol.1, nr.7, Article.3, fq.1

²⁹ Jerome T. Barnet, Joseph P. Barnet, (2004), A history of alternative dispute resolution: the story of a political, cultural and social movement, San Francisco CA, fq. 8

³⁰ Boule, Lawrence, op.cit, fq.1

Shekulli 20 ishte ajo periudhë në të cilën metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve zhvillohen në një shpejtësi të madhe, ndërsa hovin më të madh e mer në vitet 80 të shekullit 20 në SHBA. Para viteve 80 sipas Asociacionit Amerikan për Arbitrazh, e cila është një shërbim publik dhe një organizatë joprofitabile që egziston nga viti 1926, zgjidhjet alternative të kontesteve dhe metodat dhe teknikat e saja në SHBA kan filluar të zhvillohen pas Luftës së parë Botërore, ndërsa kulminacionin e ka arritur kah mesi i vitit 1920 kur u nxor ligji modern për arbitrazhin në Nju Jork, dhe që atëherë zgjidhjet alternative të kontesteve dhe metodat e saja zhvillohen dhe përparojnë gradualisht ndërsa në vitin 1980 zhvillimi i zgjidhjeve alternative të kontesteve pësoi një rritje të madhe e cila ishte rezultat i pranimi të metodave të zgjidhjes alternative të kontesteve nga bizneset Amerikane , menaxhmentet e punës dhe bashkësive legale. Kah fundi i viteve 70 dhe fillimit të viteve 80 metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve fitojnë simpati edhe në disa shtete të Europës, sidomos fiton simpati në mesin e gjyqtarëve dhe ato të cilët praktikojnë procedurat gjyqësore, e sidomos në fushat e biznesit dhe procedurave gjyqësore civile. Metodatat e zgjidhjeve alternative të kontesteve zbatimin e tyre kah vitet 90 e filluan edhe në Britaninë e Madhe dhe atë në këto fusha: tregtare, familjare. Në kontekstin tregtar, gjykatat kishin mjaft shtypje për pranimin e medijacoimit si metodë e ADR, përshkak të pamundësisë të gjykatave që të merren me lëndët të cilët gjithnjë ishin në rritje. Se zgjidhjet alternative të kontesteve dhe metodat e saja sidomos medijacoimi dhe pajtimi rrënjosen thellë në sistemin juridik të Britanisë së Madhe që nga nisja në vitet 90, tregohet vetëm 10 vite më vonë kur një sërë hulumtimesh të bëra nga zyrat e avokatëve për çështjet të cilët duhet reformohen në gjyqësor. Sipas tyre "medijacoimi ose zgjidhjet alternative të kontesteve në përgjithësi popullarizohet mjaft, 41% e të anketuarve e kanë përdorur atë"³¹.

Nevoja për egzistimin dhe zbatimin e metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve është shumë më i madh. Kjo më së miri shihet nga fakti se paraqitja dhe zhvillimi i metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve e sidomos mediacionit paraqet një përgjigje për sistemin juridik mjaft jo efikas, e cila në asnjë mënyrë nuk i plotëson kushtet e "trafikut" të shpejtuar juridik të zgjidhjeve të lëndëve dhe të sjelljeve të venimeve përfundimtare. Një situatë e tillë në masë të madhe e rrezikon gjyqësorin por edhe njërin nga parimet bazë në të cilën mbështetet e gjith procedura gjyqësore - parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm e cila parashihet qartazi në

³¹ Schmidt Verlag Otto, (2003), Global trends in Mediaton, Gjermani, fq.150

Ligjin për procedurë kontestimore³². E drejta për gjykim në afat të arsyeshëm është e drejtë themelore dhe procedurale e njeriut e cila është e garantuar me Konventën Europiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore³³ sipas të cilës secili ka të drejtë që në mënyrë të drejtë dhe publike, në afat të arsyeshëm, para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj, ti shqyrtohen të drejtat dhe obligimet e tij ose bazueshmëria e akuzës kriminale kundër atij personi. "Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit European janë të obliguar që sistemet juridike të tyre t'i organizojnë ashtu që gjykatat e tyre mundet çdo kujt t'i garantojnë të drejtën e sjelljes të vendimit të plotfuqishëm në kontestet të natyrës juridiko - civile në afat të arsyeshëm"³⁴. Qëllimi i kësaj të drejte realizohet ashtu që gjykata, duhet të angazhohet që t'i plotësoj nevojat e palëve të cilët i drejtohen asaj në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti, të cilën kontest duhet sa më shpejt në afat kohor ta zgjidhin dhe vendimin për lëndën e kontestit ta sjell pa zvarritje të panevojshme. Edhe në sistemin tonë juridik proklamohet me të madhe e drejta në gjykim në afat të arsyeshëm me qëllim të paraqitjes në mënyrë sa më të përkryer para publikës nacionale por më shumë para asaj ndërkombëtare, si mjet për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve para gjykatave shtetërore edhe pse në masë të madhe e njejta aspak nuk realizohet dhe nuk gjen zbaueshmëri në praktikë. Në Ligjin për procedurë kontestimore në nenin 10 parashihet obligimi i gjykatës që të zbatoj procedurën pa zvarritje në afat të arsyeshëm, me ç'rast do të zvogëlohen shpenzimet procedurale dhe njëkohësisht do të zvogëlohet edhe çdo manipulim i të drejtave të palëve në procedurë. Përshkak të kritikave të shumta të cilët qeverit e shteteve i marin e sidomos për reformat në drejtësi, qeveritë ndërmarrin disa masa për sigurimin e gjykimit në afat të arsyeshëm. Një pjesë e këtyre masave është edhe promovimi dhe afirmimi i përdorimit të zgjidhjeve alternative të kontesteve, të cilët sigurojnë të drejtën në gjykimin në afat të arsyeshëm, por edhe sigurojnë realizimin e qëllimit kryesor të tyre dhe atë, krijimin e sistemeve juridike efikase për mbrojtje të të drejtave të njeriut, për të cilën janë të rëndësishme edhe kufijtë kohor të procedurave gjyqësore.

Sot me të madhe afirmohet nevoja që palët në kontest të bëhen më shumë guximtar dhe vet të mundohen të ndërmarin veprime për zgjidhjen e situatave kontestuese, por edhe nevoja e

³² Ligji mbi procedurën kontestimore e shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 79 i vitit 2005, me ndryshime dhe plotësime 110/08, nr. 83/09, nr. 116/10, nr. 7/11 dhe nr. 124/15

³³ Konventës Europiane për të drejtat e njeriut në nenin 6, al. 1 parasheh të drejtën në gjykim të drejtë publik dhe në afat kohor të arsyeshëm.

³⁴ Јаневски. Арсен, Зороска-Камилоска. Тајјана, op.cit, fq. 108

angazhimit të personave neutral të cilët do të ndërmjetësonin në kontestin në mes të palëve, me çka kontesti do të zgjidheshte nga ana e vet palëve. Se zbatimi i metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve paraqet një veprim të mirë tregon edhe përdorja e konceptit "bëje vet" e cila u mundson palëve që ti vendos në pozicionin e pronarëve të kontestit të tyre, të cilët lirisht mundën të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të tyre me ç'rast një dhënje e një mundësie të tillë do t'i mundësonte që të fitojnë një rol crucial dhe të rëndësishëm për tejkalimin e krizës me të cilën sot përballlet sistemi gjyqësor, e cila gjat gjithë kohës edhe përkundër reformave të bëra kritikohet nga ndërkombëtarët për procedura të stërgjata dhe shumë të shtrejnta. Ndërsa me anë të metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve vjen deri në situata win - win ose fito - fito siç përdoret në gjuhën shqipe cila vjen si rezultat i gjetjes të një zgjidhjes të përbashkët për palët, kështu që të gjith pjesmarësit në kontest e konsiderojnë veten si fitimtar³⁵. Pra siç edhe shihet, nuk ka nevoj që të dihet rezultati i zgjidhjes të kontestit vetëm pas sjelljes të vendimit përfundimtar, ashtu siç është në procedurat e rregullta gjyqësore, ku deri sa të silllet aktvendimi nga ana e gjykatës, palët vetëm mundet ta supozojnë rezultatit përfundimtar të procedurës. Për atë shkak egzistimi dhe përdorimi i metodave dhe të teknikave të zgjidhjes alternative të kontesteve paraqet si rezultat i institimit të palëve por edhe si kundërpergjigje e kritikave të shumta për reforma, me qëllim të arritjes të një mënyre më të lehtë, më të shpejtë dhe më të thjeshtë të zgjidhjes të kontesteve ndërmjet palëve.

Kur jemi tek nevoja e vendosjes së metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve në sistemet nacionale, mundet të thuhet se ishte praktika e SHBA-ve ajo e cila zgjoi interes tek shtetet evropiane me këtë edhe tek vet Bashkimi Evropian i cili përballështe me situatë të mbingarkesës së gjykatave dhe shumave të mëdha të cilët derdheshin për shkak të shpenzimeve procedurale gjyqësore. Pranimi i alternativave të gjykatës me qëllim të tejkalimit të disa vështirësive në të cilën kalonin sistemet gjyqësore të atyre shteteve rezultoi me krijimin e disa dokumenteve të rëndësishme të cilët lidheshin me metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve në përgjithsi dhe me medijacionin në veçanti. Ndër to të cilët i'a vlen të përmenden përshkak të kontributit që kanë dhënë në sferën e metodave ADR dhe medijacionit gjithashtu janë: Rekomandimi i Komisionit 98/257/EC mbi parimet e zbatueshme për organet përgjegjëse për

³⁵ <https://www.pravdiko.mk/raboti-koi-treba-da-gi-znaete-za-medijatsijata/>

zgjdhjen jashtgjyqësore të kontesteve konsumatore³⁶, Rekomandimi i Komisionit 2001/31/CC mbi parimet për organet jashtgjyqësore të përfshira në përputhjen e zgjidhjeve të kontesteve konsumatore³⁷, Direktiva për ndihmën juridike³⁸, Propozim rregullorja për caktimin e legjislacionit e duhur dhe për njohjen dhe përmbartimin e vendimeve gjyqësore në kontestet martesore dhe për vërtetimin e atësisë³⁹ dhe Propozim direktiva për medijacion në kontestet civile dhe ato tregtare⁴⁰. Kështu në vitin 2002 Komisioni Evropian publikoi Librin e gjelbërt për zgjidhjen alternative të kontesteve në të drejtën civile dhe tregtare⁴¹ si një dokument për diskutimin e zgjidhjeve alternative të kontesteve. Ky dokument ishte kërkesa e Bashkimit Evropian për shtetet anëtare që në masë të madhe të lejojnë për qytetarët e tyre qasjen deri te e drejta në mënyrë sa më të lehtë dhe të shpejtë nëpërmjet të përdorimit të metodave të ADR i cili dokument në mënyrë profesionale i përfshinte të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me këto metoda. “Libri i gjelbërt shprehte nevojën për kode të përbashkëta për veprim në nivel regional dhe global dhe ofronte një numër të garancive procedurale në skemën e ADR-ve të cilët janë në dispozicion në një shoqëri”⁴². Ajo për të cilën Libri i gjelbërt insistonte ishte pikërisht promovimin dhe afirmimin e këtyre metodave si një prioritet të të gjithë shteteve anëtare. Gjithahtu në udhëzimet e Green Paper pretendohet që shtete të mos teprojnë me ngarkesën e legjislacionit të tyre aktual me eksperimente dhe inovacione për sa i përket vendosjes së ADR metodave në sistemet të tyre. Që kjo gjë të arrihet në mënyrë më të padhimbshme për sistemet juridike të shteteve anëtare, këto të fundit do të duhej të ndjekin udhëzimet dhe urdhërat për zbatimin parimor të procedurës dhe përmes promovimit të praktikës më të mirë respektivisht duke mos u ngarkuar aktiviteti legjislativ. Si rezultat i promovimit të përdorimit të metodave të ADR përfshirë këtu edhe medijacionin si një prej atyre metodave, do të ngritej edhe niveli i njohurive për zgjidhjen e kontesteve në mënyra alternative nëpërmjet të metodave të cilët Green Paper parasheh një sërë aktivitetesh për t’u implementuar nëpër sistemet e shteteve si pilot-

³⁶ Commission Recommendation of March 1998 on the principles applicable to the bodies responsible for out of court settlement of consumer disputes, 98/257/EC

³⁷ Commission Recommendation 2001/31/CC on the principles applicable to the bodies responsible for consensual commercial dispute resolution

³⁸ Council Directive 2002/8/EC to improve access to justice in cross-border disputes by establishing minimum common rules relating to legal aid for such disputes

³⁹ Proposal for a Regulation concerning jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial and in matters of parental responsibility.

⁴⁰ Proposal for a directive of the European Parliament and of the Council on certain aspects of mediation in civil and commercial matters, Brussels, 2004, COM(2004) 712 final, 2004/0251 (COD).

⁴¹ Shih në fusnotën 26

⁴² Betancourt. J, A. Crook. J, ADR, Arbitration and Mediation, AuthorHouse, Bloomington USA, fq. 566

projekte, projekte monitorimi për implementimin dhe zbatimin e tyre, mbledhje të ekspertëve, mbajtje e konferencave të ndryshme shkecore dhe profesionale etj. Libri i gjelbërt ose Green Paper gjithashtu theks të veçantë në dokument i jep edhe garancisë të kualitetit të zgjedhjeve alternative të kontesteve, sipas të cilës edhe pse janë ndërmarë një sërë aktivitete në sferën e metodave të ADR, këto aktivitete duhet të bazohen në minimum standardet të cilët duhet të realizojnë dhe sigurojnë kualitetet për zbatimin e metodave të tilla. Por si mundet të sigurohet ky minimum i standardeve e cila do të pasonte në zbatimin kualitativ të zbatimit të metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve përfshirë këtu medijacionin? Kjo do të ishte e mundshme nëpërmjet të krijimit të parimeve themelore të përbashkëta në të cilën do të bazoheshin këto metoda, të cilët parime edhe pse do të zbatoheshin jashtë kufijve do të realizonin qëllimin e tyre – atë të garantimit të minimum standardeve për kualitet të metodave të ADR. Pra, Green Paper shkon deri në atë skaj të harmonizimit të parametrave ligjore të medijacionit. Si parime të tilla të cilët palëve do t'u garantonin atë minimumin e standardeve për kualitet janë pikërisht paansësija, paanshmëria, transparenca, ligjshmëria, efikasiteti dhe respektimi i të drejtës. Teksti i dokumentit të Green Paper në vazhdim është e koncentruar në çështjet se si ato standard duhet të sigurohen respektivisht në çfarë forme të njëjtat të ndërmiren. Ajo të cilën e konsideron si esenciale gjat sigurimit të minimumit të standardeve gjat procedurës është obligimi që ka të bëjë me konfidencialitetin⁴³. Ajo e cila e bën këtë çështje të rëndësishme është fakti se konfidencialiteti mundëson që palët gjat procedurës të metodave të ADR-së si dhe gjat procedurës së medijacionit të jenë të sigurtë dhe të kenë një komunikim të sigurtë dhe të lirshëm të shkëmbyer gjat procedurës⁴⁴. Gjithashtu në këtë dokument përcaktohet edhe ajo se standardet minimale të cilët kanë formën e garancive procedurale respektivisht të parimeve procedurale të cilët fillimisht vendosen në sistemet juridike nacionale, me kalimin e kohës këto parime procedurale mundet të implementohen edhe se si duhet palët të sillen. Si rezultat i kësaj më vonë pas implementimit të minimum standardeve të nevojshme sipas Librit të gjelbërt, përpilohen edhe Kodet e sjelljes për palën e tretë respektivisht për medijatorin, e cila është e formuluar në atë mënyrë që të siguroj paanshmërinë e tij gjat procedurës, si dhe e përcakton në mënyrë të përpiktë rolin e tij gjat procedurës si dhe veprimet procedurale të cilët ai duhet t'i ndërmer me qëllim tq arrihet deri në një zgjidhje përfundimtare të kontestit me anë të

⁴³ Green Paper, 3.2.2.1

⁴⁴ Konfidencialiteti fillimisht konsiderohet e obligueshme vetëm për palën e pastaj edhe për palën e tretë i cili në procedurën e medijacionit paraqitet si medijator, pika 80 dhe 81

marrëveshtjes ndërmjet palëve. Ndërsa nga ana tjetër, për palët gjithashtu këto parime procedurale të cilët palët i zgjedhin vet, do të përcaktojnë edhe mënyrën e të vepruarit të tyre në procedurë të cilët parime marin edhe formën e rregullave etike për ato parime procedurale.

Si rezultat i konkludimeve në Green Paper se e rëndësishme së madhe për rritjen e kualitetit të procedurave në të cilën përdoren metodat e ADR-së është edhe të sjellurit mirë gjat procedurës, dhe ndërmarja e veprimeve procedurale nga palët në procedurë në mënyrë që të mos bëhet keqpërdorim i të tyre që të shkaktohet dëm si mbarvajtjes së procedurës së medijacionit ashtu edhe palës tjetër, Komisioni Evropian në korrik të vitit 2004 në bashkpunim me përfaqësuesit të organizatave për medijacion, shoqata të konsumatorëve dhe shoqata profesionale, solli Kodin Evropian të sjelljes të medijatorëve⁴⁵ me qëllim të sigurimit të kualitetit të procedurës të udhëhequr nga medijatorët. Ky kod përmban një numër të caktuar të rregullave të cilët duhet të respektohen nga ana e medijatorëve si dhe veprimet procedurale të cilët do t'i ndërmarin gjat procedurës së medijacionit t'i mbështesin në ato rregulla. Gjithashtu këto rregulla duhet të respektohen dhe të zbatohen edhe nga organizatat e medijatorëve të cilët ofrojnë shërbime në lidhje me medijacionin. Ky kod mundet të zbatohet si në medijacionin e kontesteve civile ashtu edhe gjat medijacionit të kontesteve tregtare. Ky kod nuk ka të bëjë "kualifikimet minimale", dhe as nuk përcakton se të cilës profesion duhet të jetë medijatori"⁴⁶, por përmban rregullat në lidhje me: kompetencën, caktimin, shpërblimin e medijatorit dhe promoconi i shërbimeve të tyre; pavarësinë dhe paanësisinë e medijatorëve; marrëveshtja për medijacion, procedura dhe arritja e marrëveshtjes dhe konfidencialiteti. Por jo vetëm organet e Bashkimit Evropian kanë të drejtë që të përpilojnë kode të tilla. Janë të mirseardhura edhe tentimet të cilët bëhen nga shoqata, asocijacione dhe organizata të ndryshme dhe pse jo edhe nga medijator individual. I këtij lloji mundet të veçohen Standardet e sjelljes model për medijatorët⁴⁷ të cilët u pregaditën për dy vite respektivisht nga viti 1992 deri në vitin 1994.

⁴⁵ https://ec.europa.eu/civiljustice/adr/adr_ec_code_conduct_en.pdf

⁴⁶ Bilić, V, Drugačiji put do pravde, Hrvatska Gospodarska Komora – Sektor za Trgovinu 27, fq. 24

⁴⁷ Standardet e sjelljes model për medijatorët u pregaditën nga ana e komitetit të përbërë nga dy delegatë nga Asocijacioni Amerikan i Arbitrazhit – American Arbitration Association/AAA, Asocijacioni Amerikan i Avokatëve-American Bar Association, Shoqata e Profesionistëve në zgjidhje të kontesteve – Society of Professionals in Dispute Resolution e cila sot njihet me emrin Asocijacioni për zgjidhjen e konflikteve – Association for Conflict Resolution/ACR. Ky kod përmban 9 standarde të cilët kanë të bëjnë me: vetpërcaktimin; kompetencën; paanësinë; konfliktin e interesave; konfidencialitetin; kualitetin e procedurës; shpallja dhe kërkimi i përdoruesve; çmimi dhe promovimi në praktikën e medijacionit.

Zhvillimi i metodave të zgjidhjeve të kontesteve do të ishte shumë i ngadalshëm nëse nuk shpalleshte si prioritet politik në Bashkimin Evropian. Për këtë shkak në vitin 2008 erdh në jetë edhe Direktiva 2008/52/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian për disa aspekte të medijacionit në çështjet civile dhe tregatë⁴⁸. Qëllimi i kryesor i kësaj directive ishte promovimi i medijacionit si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve me anë të sigurimit të një kornize ligjore. Ajo ishte e dizajnuar që të lehtësonte aksesin tek mekanizmat alternative të zgjidhjeve të kontesteve e sidomos në përdorimin në kontestet ndërkombëtare përfshirë ato familjare dhe tregatë⁴⁹. Gjithashtu edhe kjo direktivë siguron kualitetin e procedurës së medijacionit, i cili sipas nenit katërt i obligon shtetet anëtare që të zhvillojnë kode vullnetare për sjelljen e medijatorëve dhe krijimin e organizatave të cilët do të japin shërbime për medijacionin si dhe krijimin e mekanizmave tjerë efektive të kualitetit të rregullave të shërbimeve të medijacionit, dhe pa mos lënë mbrapa edhe organizimet e trajnimeve të medijatorëve. Gjithashtu kjo direktivë edhe i standardizon edhe parimet bazë të procedurës së medijacionit si: vullnetarizmin e procedurës⁵⁰; konfidencialitetin⁵¹ dhe paanëshmërinë⁵². Direktiva gjithashtu i udhëzon shtetet anëtare që palëve t'ua mundësoj që në rast të kërkesës së njëres palë dhe me pëlqimin e palës tjerë përmbajtja e marrëveshtjes së shkruar të bëhet e përmbarueshme ose nga gjykata ose nga ndonjë autoritet tjetër kompetent (neni 6, al.1 dhe 2 e Direktivës 2008/52/EC).

Pas Rekomandimit nr. R(98)1 për medijacionin në kontestet familjare⁵³, Rekomandimit nr. R(99)19 për medijacionin në çështjet penale⁵⁴ dhe Rekomandimit Rec(2001)9 në alternativat e çështjeve gjyqësore midis autoriteteve administrative dhe palëve private⁵⁵ përshkak të nevojës që të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar gjendjen në lidhje me metodat e zgjidhjeve të kontesteve duke marur parasysh karakteristikat e secilit system gjyqësor të shteteve anëtare, u soll Rekomandimi REC (2002)10 i Këshillit të Europës miratuar nga Komiteti i Ministrave në 18

⁴⁸ Shih fusnotën 13.

⁴⁹ http://www.europarl.europa.eu/cmsdata/157003/EPRS_ATAG_627135_Mediation%20Directive-FINAL.pdf

⁵⁰ Directive 2008/52/EC, neni 3 a)

⁵¹ Ibid, neni 7

⁵² Ibid, neni 3 b)

⁵³ Recommendation No. R(98)1 on family mediation, Council of Europe, Committee of Ministers, CoE Recommendation on Family Mediation

⁵⁴ Recommendation No. R(99)19 on mediation in penal matters, Council of Europe, Committee of Ministers, CoE Recommendation in penal matters

⁵⁵ Recommendation Rec(2001)9 on alternatives to litigation between administrative authorities and private parties, Council of Europe, Committee of Ministers, CoE Recommendation on alternatives to litigation between administrative authorities and private parties.

shtator të vitit 2002 për medijacionin në lëndët civile. Me anë të këtij Rekomandimi shtetet anëtare udhëzohen që ta përmbajnë dhe lehtësojnë medijacionin në çështjet civile atëherë kur ajo është e përshtatshme si dhe për të ndërmar të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e Parimeve udhëzuese për medijacionin në çështjet civile. Në fakt Këshilli Evropës me anë të këtij rekomandimi jep kahje shteteve anëtare për zbatimin e medijacionit në çështjet civile respektivisht kontestet civile, të cilët kahje janë të paraqitura në ato parime. Fillimisht, në këtë Rekomandim paraqitet përcaktimi i definicionit të medijacionit si metodë e zgjidhjes alternative të kontesteve, në të cilën palët negociojnë lidhur me çështjet në kontest me qëllim që të arrijnë deri në një zgjidhje me ndihmën e një ose më shumë medijatorëve. Rrethi i lëndëve respektivisht të kontesteve të cilët mund të zgjidhen me anë të medijacionit si metodë e zgjidhjes alternative të kontesteve janë të përcaktuara në parimin e dytë respektivisht në kontestet tregtare, konsumatore dhe të punës. Organizimi i medijacionit është e rregulluar në parimin e tretë, sipas të cilit shtetet janë të lirë që vet të rregullojnë dhe organizojnë medijacionin në çështjet civile në mënyrën më të përshtatshme të mundshme si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Gjithashtu në kompetencë të shteteve anëtarë është lënë edhe vendosja e baraspeshës ndërmjet afateve veç më të caktuara dhe efektet të cilët ato afate i prodhojnë me qëllim që të arrihet në qasjen e një procedure më të lehtë dhe më të suksesshme. Edhe parimet të cilët janë të pranuar në mënyrë univërzale si parime të medijacionit janë të parapara në parimin e 4 të këtij rekomandimi, respektivisht janë të parapara pavarësia dhe paanësia e medijatorit në njërën anë dhe barabarsia e palëve nga ana tjetër dhe konfidencialiteti si parim bazë në çdo dokument ndërkombëtar i zgjidhjeve alternative të kontesteve. Në parimet tjera janë të rregulluara çështja e zbatimit të procedurës së medijacionit në shtete anëtare të cilët të njëjtën duhet ta zbatojnë në pajtim me parimet bazë të medijacionit, trajnimet dhe përgjegjësitë e medijatorit dhe në fund arritja e marrëveshtjes së medijacionit, dhe në fund promovimi i medijacionit. Ksaj të fundit i jepet shumë rëndësi në Rekomandim me çrast kërkohet nga shtete anëtare që të ndërmarin të gjitha veprimet dhe aktivitetet e nevojshme për një afirmim më serioz të medijacionit në çështjet civile.

Rregullimi i medijacionit dhe promovimi i saj gjithashtu ka qenë objekt i Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit e cila në mënyrë të suksesshme e zbaton medijacionin si metodë e zgjidhjeve alternative të kontesteve. Janë të shumta programet vullnetare të kësaj shoqate të cilët vijnë si rezultat i aktivitetit të pandalshëm në sferën e medijacionit. Një prej programeve të kësaj

shoqate është edhe Rregullorja për medijacionin tregtar⁵⁶. Në këtë rregullore janë të përfshira rregullat që nga fillimi i procedurës me aritjen e marrëveshtjes të palëve që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit, për iniciimin e procedurës së medijacionit, zgjidhjen e medijatorit⁵⁷, obligimet dhe përgjegjësit e medijatorit, gjithashtu edhe rregullat edhe për përgjigjësit e palëve, çështja e privatësisë, konfidencialitetit, përfundimit të procedurës së medijacionit si dhe shpenzimet e procedurës (në të cilën hyjnë edhe shpërblimi i medijatorit për shërbimet e dhëna në procedurë).

UNCITRAL⁵⁸ Model Law on International Commercial Conciliation⁵⁹ ishte një prej dokumenteve ndërkombëtare më të rëndësishme lidhur me medijacionin e Komisionit të Kombeve të bashkuara për të drejtën tregtare. Pasi që filluan shtetet në mënyrë individuale të sjellin ligjet e para të tyre mbi medijacionin Model ligji i UNCITRAL-it u soll me qëllim të standardizimit të atyre ligjeve e cila do të paraqite një udhërefyese i përbashkët për të gjith procedurat e medijacionit në shtetet anëtare. Edhe pse ky model ligj emëroheshte me termin “conciliation” e cila në gjuhë shqipe ka kuptimin “pajtim”, në këtë dokument ky term në vete përfshinte shumë metoda të cilët kanë një qëllim të vetëm, pajtimin dhe zgjidhjen e kontestit me anë të marrëveshtjes ndërmjet palëve me ndihmën e personit të tretë dhe neutral. Edhe vet neni 1 i këtij model ligji në pikën e tretë parasheh procesin e cila parasheh pajtimin si shprehje por edhe medijacionin ose edhe ndonjë shporehje tjetër të ngjajshme me anë të së cilës palët me ndihmën e personit të tretë “pajtuesin” në këtë rast arrijnë në një zgjidhje të përbashkët të kontestit. Në praktik kur kemi të bëjmë me procedurën kur palët me ndihmën e palës së tretë mundohet të zgjidhin kontestin e tyre, atëherë kemi të bëjmë me procedurat si: medijacion, pajtim, evaluim neutral dhe procedura të ngjajshme. Për këtë shkak, në Model Ligjin për zgjidhjen e kontesteve tregtare është përdorur shprehja pjtim e cila më së miri do të nënkuptonte dhe përfshinte të

⁵⁶ Commercial Arbitration Rules and Mediation Procedures, American Arbitration Association, <https://adr.org/commercial>

⁵⁷ Nëse palët nuk mundën vendosin në lidhje me caktimin e medijatorit, i njejt do të caktohet nga Shoqata Amerikane e Arbitrazhi në bazë të njohurisë dhe ekspertizës në fushën e të cilit i takon çështja kontestuese e palëve e cila është lëndë e medijacionit tregtar.

⁵⁸ United Nations on International Trade Law, u krijua në vitin 1966 nga Asambleja e Përgjithshme

⁵⁹ Model Law on International Commercial Conciliation of the United Nations Commission on International Trade Law e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në raportin e Komitetit të Gjashtë A / 57/562 dhe Corr.1 në vitin 2002 përshkak të nevojës së madhe për përdorimin e metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve dhe sidomos për shkak të rëndësisë së madhe që ka përdorimi i metodës për zgjidhjes të kontesteve tregtare në të cilën palët në kontest kërkojnë nga pala/ët e tretë të ju ndihmojë atyre në tentimin e zgjidhjes të kontestit të tyre në mënyrë miqësore.

gjitha procedurat të cilët kanë të njejtin qëllim, arritjen e marrëveshtjes për kontestin në mënyra paqësore. Pra, termi pajtim në këtë model ligj përdoret si një shprehje e gjërë. Edhe kjo procedurë e pajtimit njejt si procedura e medijacionit, konsiderohet e inicuar kur palët arrijnë marrëveshtje për zgjidhjen e kontestsit të tyre në këtë mënyrë⁶⁰. Nëtekstin e këtij model ligji gjithashtu rregullohen të gjitha çështjet që konsiderohen të rëndësishme për zbatim më të suksesshëm dhe pa pengesa të procedurës. Caktimi i pajtuesit/ve, sjellja e palëve dhe pajtuesit gjat procedurës së pajtimit, mënyra e komunikimit gjat procedurës, çështja e konfidencialitetit e cila është një prej parimeve të përbashkëta dhe më të rëndësishme e cila i karakterizon dhe i veçon procedurat e zgjidhjeve paqësore të kontesteve nga procedurat tjera dhe përfundimin e procedurës së pajtimit me lidhjen e marrëveshtjes së palëve e cila duhet të jetë detyrues dhe përmbarues (shtetet detyrohen që të sigurojnë një gjë të tillë për marrëveshtjet e medijacionit). Ajo e cila është e përbashkët për të gjithë procedurat të cilët përfshihen në termin “pajtim” është çështja e paanësisë së palës së tretë, roli i cilit është i kufizuar gjat ndihmës së palëve që të arrijnë në një zgjidhje të përbashkët, i cili sipas nenit 6, al. 4 gjat gjith kohës sa zgjat procedura mundet të jap propozime se si mundet që kontesti të zgjidhet, por në asnjë mënyrë t’ua imponoj atë propozim sit ë detyrueshëm palëve.

Tjetër model ligj i UNCITRAL-it i cili edhe e ndryshoi UNCITRAL Model Ligjin mbi pajtimin ndërkombëtar tregtar dhe e cila u kurorëzua me Konventën që sot njihet si “Konventa e Singapurit mbi medijacionin”⁶¹ është Annex II UNCITRAL Model Law on International Commercial Mediation and International Settlement Agreements Resulting from Mediation⁶² në

⁶⁰ Neni 4, al.1 UNCITRAL Model Ligji për pajtim ndërkombëtar tregtar, neni 4, al. 1

⁶¹ United Nations Convention on International Settlement Agreements Resulting from Mediation, United Nations, New York, 2019. Asambleja Gjenerale më 20 dhjetor të vitit 2018 në bazë të raportit të Komitetit të gjashtë nr. A/73/496 miratoi Konventën e Kombeve të Bashkuara për marrëveshtje ndërkombëtare të cilët vijnë nga medijacionit. Konventa ishte e hapur për nënshkrim më 7 gusht të vitit 2019 në selinë e Kombeve të Bahkuara në Neë York. Kjo konventë ishte rezultat i re viteve punë të grupeve punuese të UNCITRAL-it

⁶²Ky model ligj ishte dizajnuar që të ndihmoj shtete në reformimin dhe modernizimin e ligjeve të tyre mbi procedurat e medijacionit. Përmban rregulla të përbashkëta për procedurat e medijacionit në shtete e ndryshme. Ky model ligj ka për qëllim të promovimit dhe inurajimin e përdorimit të medijacionit duke siguruar parashikueshmëri dhe siguri më të madhe në përdorimin e tyre. Model ligji fillimisht u miratua në vitin 2002 ndërsa në vitin 2018 u ndryshua duke i’u shtuar edhe një pjesë të re që kishte të bëj me marrëveshtjet ndërkombëtare dhe përmbarueshmëria e tyre. Gjithashtu ky model ligj u ndryshua edhe për nga emërimi i tij, kështu nga Model Ligj mbi pajtimin ndërkombëtar tregtar u ndryshua në Model Ligj mbi medijacionin ndërkombëtar tregtar dhe marrëveshtjet ndërkombëtare të cilët vijnë nga medijacionit. Një prej ndryshimeve rrënjësore e cila u bë me miratimin e Model Ligjit të ri ishte edhe zëvendësimi i termin “pajtim” e cila përdoreshte në Model Ligjin e vitit 2002 me termin “medijacion” me qëllim të përdorimit sa më praktik të termeve me qëllim që përdorimi i termit të ri respektivisht medijacionit do të sillte në promovimin sa më të madh të asaj procedure dhe me këtë edhe zbatimit të Model Ligjit të vitit 2018. https://uncitral.un.org/en/texts/mediation/modellaw/commercial_conciliation

vitin 2018. Ky model ligj parashikon një numër të caktuar të rregullave uniforme dhe të përbashkëta për zbatimin dhe përmbarueshmërinë e marrëveshtjeve. Ajo gjithashtu u'a jep të drejtë palëve që në çdo moment gjat procedurës të kërkojnë të lidhin marrëveshtje për kontesitn e tyre në procedurë (neni 3). Gjithashtu ky model ligj parasheh edhe një numër të caktuar të bazave në bazë të të cilave palët mundet të inicojnë procedurën e medijacionit e cila është e paraparë në Model Ligjin⁶³. Ky Model Ligj mundet të përdoret si bazë për miratimin e të legjisacionit për medijacion. Gjithashtu kjo mundet të zbatohet edhe kur është e nevojshme edhe zbatimi i Konventës të Kombeve të Bashkuara mbi marrëveshtjet ndërkombëtare tregtare të cilët vijnë nga medijacionit. Teksti i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi marrëveshtjet ndërkombëtare tregtare të cilët vjnë nga medijacionit përfshinë nga 16 nene të cilët rregullojnë dhe përcaktojnë fushveprimin e aplikimit të saj (sipas nenit 1 Konventa promovon medijacionin në zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare tregtare). Si e tillë ajo shihet jo vetëm si një procedurë e shpejtë dhe më pak e kushtueshme për zgjidhjen e kontesteve por gjithashtu edhe si një mënyrë e mirë për tërruajtur dhe mos rezikuar marrdhëniet tregatre dhe biznesore ndërmjet palëve. Më pastaj, në tekstin e tij Konventa jep edhe definicionin e termeve palë, marrëveshtje⁶⁴ dhe procedurës së medijacionit. Kjo Konventë nuk ishte e dizajnuar për të siguruar përmbarueshmërinë e marrëveshtjeve të medijacionit të arritura në lidhje me kontestete tregatre, por ajo vetëm siguron një lloj kornize ligjore për zbatimin e asaj marrëveshtjesmsi dhe për njohjen e saj e cila do ta bënte procedurën e medijacionit më efikas se sa procedurën gjyqësore.

II Medijacioni - rrugë alternative deri te e drejta

1. Nocioni dhe karakteristikat

E pamundshme është që të flasim për mediacionin, nocionin, karakteristikat e saja pa mos i kushtuar një pjesë në këtë kapitull zhvillimit historik të saj. Mediacioni si formë e zgjidhjes të kontesteve ku janë të involvuara më shumë se vetë palët, egziston qysh nga zanafilla e shoqërive të para njerëzore. Pra zgjidhja e kontesteve jasht hapsirave gjyqësore nuk është një fenomen i ri, por ka egzistuar shumë më herët dhe atë me paraqitjen e vet kontestit, respektivisht me paraqitjen e nevojës që kontestet të zgjidhen jo me dhunë. Mediacioni si metod i zgjidhjeve të konflikteve

⁶³ Model Ligjit 2018, neni 5. Bazat sipas këtij Model Ligji mundet të grupohen në tre kategori: raporti i palëve kontestuese, marrëveshtja e zgjidhjes së kontestit dhe procedura e medijacionit.

⁶⁴ Në nenin e 2, al. 2 Konventa termin marrëveshtje e definojnë si marrëveshtje në formë të shkruar e cila do të konisedorhet se është lidhur në atë formë edhe nëse pëlqimi i palëve regjistohet në çfar do lloj forme tjetër përfshirë këtu edhe nëse pëlqimi jepet edhe në forma të komunikimit elektronik.

është përdorur në shumë kultura të ndryshme më shumë se 3.000 vite më parë. Kjo metodë e zgjidhjes të kontesteve pa ndihmën e gjykatësit ka qenë prezente në traditat e zgjidhjeve të kontesteve të shumë popujve në Afrikë dhe Azi, ku bashkësitë shoqërore si pikënisje në rast të paraqitjes të konflikteve kanë pasur parimin që zgjidhja e konfliktit duhet të jetë në duart e atyre që e kanë shkaktuar apo nisur atë. Pasi që Afrika është një shoqëri patriarkale ku më të moshuarit ende gëzojnë respekt të madh nga të tjerit, në raste të konflikteve, palët gjithmonë e kanë pasur më të lehtë t'u nënshtrohen dhe ta pranojnë zgjidhjen e dhënë nga më të moshuarit, dhe për atë shkak ato me kalimin e kohës e kanë fituar titullin "kujdestarët e zgjidhjeve të kontesteve"⁶⁵. Të moshuarit dhe sundimtarët tradicional shumë e më shumë filluan që t'i përdorin teknikat e zgjidhjeve alternative të kontesteve e sidomos ato në format e bisedimeve dhe ndërmjetësimit apo të mediacionit edhe pse nuk kishin aspak njohuri legale adekuate dhe as trajnim legal për përdorimin e mehanizmave të tillë të cilët edhe në mungesë të këtyre parametrave mjaft të nevojshme sot, në atë kohën kanë kryer një punë të shkëlqyeshme. Afrika gjithmonë ka përdorur mediacionin si proces ku mediatorët kanë ndërmjetësuar gjat paraqitjes të ndonjë kontesti të caktuar. Edhe pse aktivitetet dhe veprimet të cilët janë ndërmar gjat këtij procesi janë të njejta si ato të cilët përdoren sot gjat procedurës të mediacionit, në të kaluarën ky lloj i procesit të zgjidhjeve alternative të kontesteve nuk është njohur me termin "mediacion". Në kulturën e Afrikës ku të rinjtë dhe pleqtë kishin ndonjë formë të konfliktit, e njejta në asnjë mënyrë nuk zgjidheshte me forcë ose revolucion, kështu që të rinjtë e pakënaqur ose do të braktisnin bashkësinë ku ato jetojnë ose ndonjëherë do ti sfidonin parimet egzistuese të shoqërisë⁶⁶. Familjet afrikane dallojnë mjaft nga familjet e shoqërive të tjera dhe pika dalluese e cila i bënë të jenë më ndryshe është se ato brenda për brenda krijojnë rregulla në formë të rregullave tradicionale. Ky është shkakun pse proceset e zgjidhjeve të konflikteve në Afrikë dallojnë dhe nuk mundën t'u përshtaten proceseve perëndimore të zgjidhjeve të kontesteve siç janë: negociatat, mediacioni, arbitrazhi dhe forma tjera hibride. Kjo pasi që terreni në Afrikë është mjaft i ndryshëm nga ato të shteteve perëndimore, për atë shkak ato përdorin metodën apo teknikat e tyre të zgjidhjeve të kontesteve⁶⁷. Sa i përket mediacionit në Azi, në asnjë mënyrë nuk mundet të

⁶⁵ Uwazie. E, (2014), *Alternative Dispute Resolution and Peace - building in Africa*, Cambridge Scholars Publishing, Britania e Madhe, 2014, fq. 88

⁶⁶ Walter. R, (1972), *How Europe Underdeveloped Africa*, Howard University Press, fq. 44 - 45

⁶⁷<http://www.mediationmatterssd.com/mediationmatters/history.html> - Çdo palë në kontest mundet ta lajmëroj apo ta thërras kuvendin e lagjes ku ai jeton e cila quhet " moot " ku një pjestar i lagjes i cili gëzon respekt me rolin e medijatorit, do t'i ndihmoj palët që ta tejkalojnë konfliktin duke bashkëpunuar.

thuhet se është një koncept i panjohur, sidomos kur bëhet fjalë për Kinën, Korenë e Jugut dhe Japoninë. Në Kinë ishte e njohur praktika e zgjidhjes të kontesteve me ndihmën dhe përfshirjen e palës së tretë neutrale i cili ka rolin e mediatorit, në Korenë e Jugut mediacioni ishte mjaft i përhapur dhe mediatorët i ndihmojnë palët që jo vetëm ta zgjidhin kontestin ndërmjet tyre por edhe ta "ruajnë fytyrën"⁶⁸. Ndërsa sa i përket Japonisë, preferonin zgjidhjen e konfliktit me anë të mediacionit dhe jashtë gjykatës, pasi që pjesmarja në procedurë gjyqësore, nga ana e popullit japones konsiderohej si një "zhgënjim personal". Udhëheqësit e fshatrave në Japoni kanë pasur për detyrë që t'u ndihmojë bashëkvendasve të tyre që ti zgjidhin konfliktet dhe problemet. Ndërsa sot në Japoni, mediacioni është një metodë e rregullt e zgjidhjeve të kontesteve e cila mer pjesë në çdo pore të kulturës biznesore dhe si e tillë përdoret për t'i zbutur mardhëniet të cilët krijohen në këtë sferë⁶⁹. Mediacioni gjithashtu praktikohet edhe në shtetet: Malejzi, Indonezi, Tajland dhe Filipine⁷⁰. Në historinë eurpoiane të zhvillimit të mediacionit dhe teknikave paqësore të zgjidhjeve paqësore të kontesteve janë paraqitur shumë mënyra të ndryshme të zgjidhjeve të kontesteve siç ka qenë përdorimi i arbitrazhit për zgjidhjen e kontesteve në mes të poliseve greke si dhe dy institucionet të cilët kanë pasur sukses në involvimin e proceseve të mediacionit në mes të shteteve dhe institucioneve tjera politike, Republika e Venedikut dhe Vatikani, ku të dy palëve u është kërkuar që t'i dërgojnë ambasadorët e tyre të ndihmojnë në konfliktin e krijuar ndërkombëtar⁷¹. Sot e kësaj dite funksioni i Papës ende qëndron në përfshirjen në funksionin ndërmjetësues në nivel ndërkombëtar së bashku me disa institucione ndërkombëtare duke përfshirë këtu edhe Bashkimin Europian. Si një ndër metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve, mediacioni edhe pse me një histori mbresëlënëse si metodë efektive të zgjidhjes të kontesteve, hovin më të madh të zhvillimit e ka pasur nga vitet 80 të shekullit 20, me ç'rast edhe filloi edhe implementimi sistematik dhe i rregulluar i tij dhe i integruar në vet sistemin gjyqësor. Në SHBA dhe në vendet e Evropës perëndimore në këto njëzet ose njëzet e pesë vitet e fundit,

⁶⁸ Ly. L (2003), Mediation Styles and approaches in Asian Culture, Conference Proceedings of the 2nd Asia Practice Forum: Developing of Mediation Culture, Singapore, fq. 19 - 22

⁶⁹ <http://www.mediationmatterssd.com/mediationmatters/history.html>

⁷⁰ Lee. J, Hwee. H. T, (2009), An Asian Perspective on Mediation, Singapore Mediation Center, Academy Publishing, Singapore, fq. 5 - 6 - Në Malejzi rolin e medijatorëve e kanë kryetari i fshatit njohur si: "ketua kampong", udhëheqësit e xhamive të a.q imamët. Në Indonezi kontestet trajtohen në procedurë gjyqësore ku autoriteti i cili sjell vendime takohet me palët kontestuese që të ndërmjetësoj për arritjen e një zgjidhje të përbashkët. Në Tajlandë mediacionin në rast të paraqitjes të një kontesti e bëjnë më të moshuarit e fshatit, murgjit apo fytyra të rëndësishme dhe të respektuar në bashkësinë ku palët jetojnë. Ndërsa në Filipine përdoren komitete të medijatorëve nëpër fshatra ose një formë paqësore e zgjidhjes të kontesteve e institucionalizuar e quajtur "barangay".

⁷¹ Morasso. G. S, (2011), Argumentation in Dispute Mediation, A reasonable way to handle conflict, Amsteran/Philadelphia, fq. 17

mediacioni filloi intenzivisht të zhvillohet. Në fakt mediacionin si profesion së pari është prezantuar nga ana e praktikës amerikane, e cila ka një eksperiencë mjaftë të madhe dhe të pasur për zgjidhje alternative të kontesteve. Ka qenë kryetari Abraham Linkoln ai i cili në vitin 1850 jep rekomandimin për zgjidhje alternative të kontesteve dhe atë: "Dekurajoni procedurat gjyqësore. Bindni fqinjët që të arrijnë kompromis kur ajo është e mundshme. Sqaroni atyre se fituesi në letër është humbës në realitet, duke i mar parasysht të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe kohën e humbur"⁷². Abraham Linkoln nuk është i vetmi kryetar i SHBA - ve i cili ka inkurajuar përdorimin e metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve, dhe me këtë edhe të mediacionit. Gjithashtu edhe John F. Kennedy gjat fjalimit të tij inaugurues në 20 janar të vitit 1961 në Washington të SHBA- ve tha: "Let us not negotiate with fear, but let us not fear to negotiate" që dmth në gjuhën shqipe: "Të mos negociojmë me frigë, por të mos kemi frigë të negociojmë". Ishte fillimi i viteve 60 kur mediacioni lëshoi rrënjët e saja në sistemin juridik të SHBA - ve, pasi që atëherë filloi edhe lulëzimi i interesimit për format alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Në atë kohë në SHBA u hapën shumë fronte, nga njëra anë ishte Lufta e Vietnamit, pastaj vështirësit për të drejtat civile, trazirat e studentëve, trazirat e punëtorëve, gjithashtu ishte edhe rritja e ndërjegjësimin të konsumatorëve, sfidat ndaj rolit gjinor si dhe protestat kundër diskriminimit racor. Gjithashtu shumë e më të shpeshta ishin edhe konfliktet familjare e sidomos shkurorëzimet e tepërta dhe çështjet e përkujdesjes të fëmijëve pas shkurorëzimit, të cilët deri atëherë zgjidheshin në procedura të rregullta gjyqësore të gjata dhe mjaftë raskapitëse. Pra ishte viti 1960 kur filluan të promovohen qendrat private për mediacion, me ç'rast "mediacioni fillon të fitoj popullaritet dhe fillon të përdoret si mjet për zgjidhjen e kontesteve në mes të punëtorëve dhe sindikateve, ngjarjet të cilët krijohen gjat grevave, pra në një mënyrë mediacioni përdoret si mjet për qetësinë sociale"⁷³. Kështu që edhe bashkëshortët të cilët shkurorëzoheshin, shumë më lehtë e pranonin planin për përkujdesje të fëmijëve të pregaditur nga ana e mediatorëve se sa nga ana e gjyqtarëve. Gjithashtu përdorimi i mediacionit u përfshi edhe në kontestet fqinjësore si dhe në kontestet biznesore apo tregtare ku tregtarët nga pamundësia që në aspekt kohor të presin deri në fillim të gjykimit, shpesh e më shpesh filluan të përdorin mediacionin për zgjidhje të konflikteve të tyre. Në fund të vitit 1979 krijohet edhe Judicial Arbitration and Mediation Services e cila si

⁷² Lincoln, Abraham, Notes for a lecture, July, 1850

⁷³ Iuris Dictio (Publicacion Periodica), Revista del Colegio de Jurisprudencia de la Universidad San Francisco de Quito, Folberg, Jay, Año 16, Vol. 17, shkurt - korrik, fq. 38

organizatë private për dhënie e shërbimeve të mediacionit sot është rritur në 25 qendra të saja⁷⁴, me ç'rast në fund të viteve 80 vjend deri në rregullimin juridik të kësaj materije, kështu që shumë shtete të SHBA - ve parashohin mediacionin e obligueshëm për shumë konteste civile. Gjat viteve të kaluara, mediacioni është përhapur shumë në nivel botëror përshkak të shkallës së lartë të efikasitetit si dhe përshkak të zgjidhjes të kontesteve të llojeve të ndryshme në të cilën janë përfshirë persona të profileve të ndryshme qoftë ato persona fizik ose persona juridik.

Që të mund të kuptohet thelbi i procedurës të mediacionit, e patjetërsueshme është që në fillim të shtjellohet në mënyrë të drejtë përmbajtja e saj, qëllimi dhe struktura, gjë që arrihet nëpërmjet përcaktimeve të shumta të rezultateve të fituara nga ana e analizave të përcaktimeve të përkufizimeve të cilët në literaturën juridike janë të shumta. Së pari do të përcaktohen rrënjët etimologjike të nocionit "mediacion". Fjala "mediacion" rrjedh nga fjala latine "medio" e cila don të thotë "mes" dhe e cila përkufizon mediatorin/ndërmjetësuesin apo personin apo palën e tretë neutrale dhe të paanshëm i cili i ndihmon palët në konflikt me qëllim të tejkalimit apo zgjidhjes të konfliktit. Pra, mediacioni definohet si pjesmarje e personit të tretë në bisedime lidhur me çështjet konfliktuozë apo kontestuese, e cila palë është e paanshme për të dyja palët të cilët janë të përfshirë në kontest. Shprehja mediacion fillon të përdoret me të madhe si nocion gjat vitet 70 të shekullit 20. Janë autor të shumtë të cilët mediacionin e definojnë në mënyra të ndryshme, dhe në këtë pjesë do të përmenden vetëm disa nga pamundësia që të përmenden të gjitha pasi që janë të shumta definicionet si rezultat i numrit të madh të autorëve të cilët janë marrë me shtjellimin e kësaj materije. Sipas Valerie F. Butler, "mediacioni është një opsion plotësues e të kërkuarit të drejtësisë"⁷⁵, sipas autorëve John M. Haynes dhe Stephanie Charlesworth të cilët mediacionin e definojnë si shumica e autorëve tjerë kanë shkruar "mediacioni është proces në të cilën pala e tretë u ndihmon pjesmarësve në kontest që ta zgjidhin të njëjtën"⁷⁶, sipas autorëve Stephen B. Goldberg, Frank E.A. Sander dhe Nancy H. Rodgers "mediacioni është negociatë e zbatuar me anë të asistencës të palës së tretë"⁷⁷, sipas David

⁷⁴ Милутиновиќ, Љ, (2004), Медијацијата како алтернативен начин на решавање на спорови, Правен живот, Часопис за правна теорија и пракса, право и културна разлика, Здружение на правници на Србија, том 10, бр. 12, Београд, fq. 241 - 243

⁷⁵ F. Butler, Valerie, (2004), Mediation essentials and expectations, Domance Publishing Co Inc, Pittsburg, Pennsylvania, fq. 1

⁷⁶ M. Hagnes, John, Carlesworth, S, (1996), The fundamentlas of family mediation, The Federation Press, Sydney, Australia, fq. 1

⁷⁷ B. Goldberg, Stephen, E.A. Sander, Frank, H. Rogers, Nancy, (1999), Mediation and other processes, third edition, Aspine Law and Business, Gathersburg and New York, fq. 123

Spencer dhe Michael Brogan "mediacioni është një formë e zgjidhjes të kontestit, e gjetur jashtë hapsirës vendimarrëse të gjykatës, ku palët të cilët janë në kontest përdorin ndihmën e palës së tretë neutrale me qëllim të arritjes të zgjidhjes të kontestit të tyre"⁷⁸ ose sipas Marian Roberts "mediacioni është formë e intervenimit ku pala e tretë - mediatorii i ndihmon palët në konflikt që të negociojnë për çështjet apo pyetjet të cilët i ndajnë të njëjtit"⁷⁹. Pra, lart posht definicionet janë të ngjajshme përshkak të materies e cila është shumë e kuptueshme, edhe pse autorët janë të shumtë. Kështu që mundet të thuhet se mediacioni është zgjerim i negociatave dhe bisedimeve në mes të palëve dhe palës së tretë neutrale dhe të paanshme në diskutimet lidhur me çështjet konfliktuoze e cila do të mundet të ndikoj në raportin në mes të palëve dhe do t'u ndihmoj që të njëjtit të arrijnë në marrëveshje me anë të së cilës do ta tejkalojnë konfliktin, respektivisht kontestin e krijuar në mes tyre. Direktiva 2008/52/EC e Këshillit European dhe Parlamentit për disa aspekte të mediacionit në çështje civile dhe tregtare⁸⁰ e definojnë mediacionin si "procedurë strukturale në të cilën dy apo më tepër palë mundohen që me anë të ndihmës të mediacionit të arrijnë në marrëveshtjen për zgjidhje të kontestit, i cili proces mundet të inicohet nga palët ose të propozohet ose të urdhërohet nisja e saj nga ana e gjykatës ose kur parashihet një gjë e tillë me ligjin e shtetit anëtar"⁸¹. Sipas nenit 3 të Direktivës 2008/52/EC përjashtohet mediacioni të cilën e ka zbatuar gjykata e cila nuk është përgjegjëse dhe e autorizuar për cilën do qoftë procedurë gjyqësore në lidhje me kontestin e cila është në pyetje, dhe në anën tjetër ajo e përjashton edhe ato të cilët nëpërmjet të gjykatës pretendojnë që ta zgjidhin kontestin në procedurë gjyqësore. Këto elemente në definicionin ose përkufizimin e mediacionit si nocion i pranuar në shumë shtete dhe legjislacione, përdoret dhe është e pranuar edhe në legjislacionin tonë. Si rezultat i interesimit dhe dëshirës të Republikës së Maqedonisë për antarësimin në Bashkimin European, filloi edhe nxjerja e ligjeve të reja dhe harmonizimi i ligjeve egzistuese me legjislacionin e Bashkimit European, me ç'rast nisën të përpilohen dhe të hynë në fuqi një numër i madh i ligjeve të reja të rëndësishme, në mes të të cilave edhe "Ligji për mediacionin"⁸². Ky ligj paraqet një risi

⁷⁸ Spencer, D, Brogan, M, (2006), *Mediation Law and Practice*, Cambridge University Press, New York, fq. 3

⁷⁹ Roberts, M, (2008), *Mediation in family disputes, Principles of practice*, Third edition, Ashgate Publishing limited, fq. 7

⁸⁰ Qëllimi i kësaj direktive është zbatimi më i madh i mediacionit si dhe sigurimi i një kornize ligjore më të sigurt për palët të cilët përdorin mediacionin. Rëndësia kyçe e direktivës shihet në atë se ajo përpiket të standardëzoj parimet themelore të mediacionit siç janë: procedurë vullnetare, paanësia, konfidencialiteti dhe neutraliteti.

⁸¹ pika a), neni 3 i Direktivës 2008/52/EC

⁸² Ligji për mediacionin i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 60 i vitit 2006 dhe me ndryshimet dhe plotësimet nr. 117/06, nr. 22/07, nr. 34/07, nr. 114/09, nr. 138/09, nr. 188/13, nr. 148/15, nr. 192/15 dhe nr. 155/16.

dhe një hap të madh dhe të rëndësishëm për legjislacionin e Republikës së Maqedonisë i cili hyri në fuqi më 23 maj të vitit 2006, ndërsa e njejta filloi të zbatohet nga një nëntori i po atij viti. Deri më sot ky ligj ka pësuar disa ndryshime dhe plotësime dhe atë në nëntor të vitit 2009, gusht të vitit 2015, në nëntor të po atij viti dhe plotësimi i fundit i bërë në mars të vitit 2016 të cilët ndryshime dhe plotësime janë bërë në atë drejtim që të sigurohet qasja sa më të lehtë dhe më të madhe të këtij koncepti në zgjidhjen e kontesteve. Edhe Ligji për mediacionin jep një definicion për mediacionin në nenin dy sipas të cilit mediacioni është çdo ndërmjetësim pa mar parasysht emërtimin e tij, gjat zgjidhjes të kontestit në procedurë të mediacionit në të cilën palëve në mardhënien kontestuese u mundësohet që të njejtën ta zgjidhin në rrugë të bisedimeve dhe negociatave, në mënyrë paqësore me ndihmën e një ose të më shumë mediatorëve të licencuar, me qëllim që të arrihet një zgjidhje e përbashkët dhe e paanshme për palët, e shprehur në formë të marrëveshtjes me shkrim. Pra, njëra nga karakteristikat më të veçanta të mediacionit është se ajo zbatohet me pjesmarrjen e palës së tretë neutrale - mediatorit, i cili mer pjesë aktive në procedurën e mediacionit, u ndihmon palëve të arrijnë një marrëveshje të përbashkët për tejkalimin e kontestit, por i cili nuk është i autorizuar që të sjell vendim në lidhje me kontestin dhe as që mund që vendimin e tij t'ua imponojë si detyruese palëve të cilët kanë zgjedhur që kontestin e tyre ta zgjidhin në rrugë të mediacionit. Kjo karakteristikë e bën që të dallojnë skajshmërishtë procedurat e mediacionit me procedurat gjyqësore në të cilën kontesti zgjidhet me sjellje të vendimit gjyqësor, si dhe e dallon edhe me procedurën e arbitrazhit në të cilën arbitëri atëherë kur palët kanë arritur një marrëveshje, autorizohet që të sjell vendim meritor e cila është detyruese për palët, pasi që në të kundërtën do të pësoj përmbarimi i të njejtës. Tek definicioni i mediacionit në Ligjin për mediacion, mes reshtash shihet qartë se në të përfshihen edhe karakteristikat e vetë procedurës të mediacionit: se është procedurë vullnetare, për prezencën e palës neutrale, për kontrollën e palëve gjat zbatimit të procedurës respektivisht besueshmëria e tyre ndaj mediatorit dhe ndaj procedurës të mediacionit të cilët karakteristika janë të pranueshme edhe në instrumentet ligjore ndërkombëtare⁸³.

2. Terminologjia dhe dilemat

Në literatura të ndryshme juridike për zgjidhje alternative të kontesteve dhe për mediacionin në veçanti, përveç për strukturën, karakteristikat dhe qëllimet e teknikave të

⁸³ Direktiva 2008/52/EC për aspekte të caktuara të mediacionit në çështje civile dhe tregtare, UNCITRAL, Model Ligji, al.2, neni 1, Rekomandimi për mediacionin REC(2002)10 nën I.

zgjidhjeve alternative të kontesteve në përgjithsi dhe për mediacionin në veçanti, shpesh herë hasen edhe dilemat të cilët autor të ndryshëm të vendit dhe të jashtëm ndajnë pjesë të veçantë në veprat e tyre ku rëndësi të veçantë i kushtojnë terminologjisë dhe dilemave të cilët paraqiten si rezultat e terminologjisë. Parashtrohet pyetja, përse të paraqiten dilema lidhur me termin "mediacion", term i cili në çdo aspekt konsiderohet i përshtatshëm, i pranueshëm si term teknik dhe i pranuar në gjuhë të ndryshme dhe në vende të ndryshme të botës? Dilemat egzistojnë pasi që në literatura profesionale të autorëve dhe profesionistëve të ndryshëm shpesh herë hasen zëvendësime dhe substitute të nocionit "mediacion" me nocione tjera si për shembull: ndërmjetësim, pajtim, negocijim e të tjera. Sa i përket nocionit ndërmjetësim nuk ka nevoj që të ndalohet në këtë nocion, pasi që lartë poshtë është e njëjtë me nocionin mediacion dhe si e tillë përdoret më rallë, përjashtimisht në literaturat shqiptare ku ky nocion gjen përdorim më të gjërë. Problemi i terminologjisë më së shumti zgjerohet dhe zmadhohet në përdorimin paralel të nocionit "pajtim" ose në gjuhën angjele "conciliation". Nga analizat komperative të burimeve juridike të mediacionit, shihet qartë se mediacioni si nocion më së shpeshti gjen përdorim në tekstet juridike dhe nëpër punimet profesionale, ndërsa pajtimi (conciliation) më së tepërmi përdoret dhe është e pranuar si term nga ana e grupeve punuese të UNCITRAL - it (United Nations Commission on International Trade Law) nga viti 2000 e deri më sot. Këto dy terme paraqesin sinonime dhe të njëjtat nuk paraqesin ndonjë problem gjat përdorimit të tyre nëpër literatura të ndryshme, mirpo janë të shumtë autorët të cilët mundohen t'i gjejnë pikat dalluese ndërmjet tyre, dhe për atë shkak kjo çështje kalon në një dilemë terminologjike. Dallimi primar **në mes të mediacionit dhe të pajtimit bazohet në rolin të cilën e kanë pala e tretë neutrale e zgjedhur nga ana e palëve për të dhënë ndihmën e tij për gjetje të një zgjidhjes të problemit që ato kanë.** Sipas kësaj në procedurën e mediacionit, mediatori më shumë ka rolin e lehtësuesit i cili u ndihmon palëve, ndërsa në konciliacioni (pajtimi) konciliatori/pajtuesi është më shumë si tip intervenuesi i cili siguron zgjidhje të mundshme palëve për të zgjidhur kontestin. Janë katër pika të cilët bëjnë të dallojnë këto dy koncepte. Në pikën e parë, konfidencialiteti si element bazik tek mediacioni varet nga besueshmëria që palët kanë ndaj mediatorit, ndërsa tek konciliacioni konfidencialiteti dhe shtrirja e saj është e rregulluar me ligj. Në pikën e dytë, pala e tretë neutrale tek mediacioni ka rolin e lehtësuesit ndërsa tek konciliacioni ka rolin më gjithpërfshirës dhe atë të lehtësuesit, intervenuesit dhe të vlersuesit. Në pikën e tretë, rezultati i procedurës tek mediacioni si rezultat përfundimtar i procedurës është marëveshtja në mes të

palëve, ndërsa tek konciliacioni si rezultat përfundimtar është marëveshtja e arritur për zgjidhjen e konfliktit. Pika e katërt, marëveshtja tek mediacioni është detyruese e paraparë me ligj, ndërsa marëveshtja e arritur me anë të konciliacionit është i ekzekutueshëm si vendimi gjyqësor. Pra është e dukshme se egzistojnë ndryshime të mëdha në kuptimin e nocioneve "mediacion" dhe "konciliacion". "Mediacioni është kryesisht një procedurë lehtësuese në të cilën proces jepet ndihma nga ana e mediatorit për menaxhim të procesit dhe për t'i mbështetur palët që të marrin vendime për veprimet dhe rezultatet e ardhshme, ndërsa konciliacioni përdoret për t'iu referuar një sërë procesesh të cilët përdoren për të zgjidhur ankesat dhe konfliktet duke mbajtur negociata dhe diskutime jo formale në mes të palëve në kontest dhe të konciliatorit për të shmangur, zgjidhur apo për të menaxhuar një mosmarëveshtje, apo edhe kombinimi i disa proceseve ku konciliatori i lehtëson bisedimet në mes të palëve, u jep këshilla për thelbin e kontestit, u jep propozime për zgjidhjen e të njëjtit dhe kontribon në mënyrë aktive për kushtet e marëveshtjes me anë të së cilës do të zgjidhet kontesti"⁸⁴. Gjetja e vetive dhe dallimeve në mes të mediacionit dhe të konciliacionit respektivisht të pajtimit është lëndë e diskutimeve të shumta të cilët burojnë nga mendimet dhe qëndrimet e shumta, të cilët edhe sot egzistojnë. Kështu, janë të shumta mendimet sipas të cilëve konciliatori apo pajtuesi ka rol më aktiv në dhënien e propozimeve për formulimin e kushteve të marëveshtjes respektivisht për marëveshtjen në përgjithsi, në krahasim me mediatorin i cili më së tepërmi ka rolin e facilitatorit (lehtësuesit). I tillë është edhe mendimi se "mediacioni është proces lehtësues në të cilën palët angazhojnë ndihmë nga pala e tretë - mediatori, i cili u ndihmonë që të arrijnë një zgjidhje në bazë të marëveshtjes për kontestin e tyre. Mediatori nuk ka autoritet të sjell vendime të cilët janë detyruese për palët, por ai përdor procedura të caktuara, teknika dhe aftësi që t'u ndihmoj në negociata për arritjen e një zgjidhje me anë të marëveshtjes për kontestin e tyre pa pasur gjykim"⁸⁵. Edhe Komisioni për Reforma në Drejtësi të vitit 2010 për zgjidhjet alternative të kontesteve: Mediacioni dhe Konciliacioni, thekson se është i vetëdijshëm për egzistimin e termeve të ngjajshme për teknikat e zgjidhjeve alternative të kontesteve e sidomos për egzistimin e këtyre dy termeve, mediacionit dhe konciliacionit të cilët vazhdimisht përdoren por nga ana tjetër dallimi midis tyre aspak nuk është i qartë. Edhe Dowling Hussey thekson se definicionet të cilët përdoren në këto dy fusha të

⁸⁴ Mieke. B, Stodulka. T, A comparative Analysis of the Practice of Mediation and Conciliation in Family Disputes Resolution in Australia: How practitioners practice across both processes, OUTLaw Review, [S.I], v.8, n.1, qershor 2008, ISSN2201-7275, fq.195

⁸⁵ J. Brown, Henry, L. Mariot, Arthur, (1997), ADR Principles and Practice, Second edition, EdSweet and Maxwell, fq. 127

ndryshme, kanë tendencë të krijojnë njëfar pasigurie për atë se çka nënkuptohet me frazën, dhe se logjika do të sugjeronte që përdoruesit dhe ato të cilët e praktikojnë këtë teknik, më pak t'i përdorin apo të rekomandojnë diçka që edhe ato nuk e kuptojnë apo s'janë të sigurtë për kuptimin e nocioneve, me qëllim të ikjes konfuzionit e cila mundet të krijohet në raste të tilla⁸⁶. Komisioni në raportin e tij për zgjidhjet aletrnative të kontesteve, në fakt bën dallimin ndërmjet rolit të mediatorit dhe konciliatorit, sipas të cilit konciliatori është një ndërhyrës aktiv dhe mundet të ketë rol këshilldhënës për atë se si është më mirë të përfundoj procedura, mundet të bëj sugjerime, të jep këshilla profesionale, të përdor teknikat për ndikim aktiv në marëveshje si dhe të inkurajoj palët që të arrijnë një marëveshje, ndërsa nga ana tjetër mediatori i ndihmon palët që nëpërmjet të komunikimit me njëri tjetrin ato të identifikojnë, sqarojnë dhe t'i shqyrtojnë çështjet para se të arrijnë një marëveshje të negociuar reciprocikisht të pranueshme⁸⁷. Pra Komisioni konsideron se ky është një dallim i rëndësishëm në mes të mediacionit dhe konciliacionit (pajtimit) dhe e njëjta duhet të shprehet në mënyrë të qartë çdoherë kur flitet për mediacionin dhe konciliacionin në formë legislative. Gjithashtu edhe në diskutimet për zgjidhje alternative të kontesteve nga ana e Lord Chancellor department⁸⁸ është bërë përpjekje për dallimin e këtyre termeve, të cilët janë të njëjtit mendim siç edhe është theksuar në tekstin më lartë se në krahasim me mediatorin, konciliatori ka një rol më aktiv gjat afrimit të palëve në gjetjen e një gjuhe të përbashkët për zgjidhjen e kontestit me anë të arritjes të një marëveshje të përbashkët dhe të pranueshme për të dy palët. Edhe pse të ndryshme ndërmjet veti, e pashmangshme është që në këtë pjesë të mos përmenden ngjajshmërit ndërmjet mediacionit dhe konciliacionit. Që të dyja miren me çështje kontestuese dhe kërkojnë të gjejnë zgjidhje të tyre, që të dyja janë procese dhe teknika jo gjyqësore, dhe që të dyja janë të natyrës vullnetare pra të dy palët pajtohen me vullnetin e tyre të lirë të zgjidhin kontestin e tyre nëpërmjet të mediacionit apo nëpërmjet të konciliacionit respektivisht nëpërmjet të pajtimit.

3. Llojet e mediacionit

Mediacioni paraqet një proces i cili për nga natyra është mjaft fleksibil pasi që ajo u përshtatet rrethanave dhe nevojave të palëve dhe si një proces i tillë gjat këto 30 vitet e fundit,

⁸⁶ Hussey. D, (2009), Conciliation: Coming out of the shadows?, Commercial Law Practitioner, 16(3), CLP48

⁸⁷ LRC 98-2010 nw 2.23 fq. 18 - 19

⁸⁸ Lord Chancellor Department i krijuar në vitin 1885 nga Lord Selborn me juridiksion mbi Anglinë dhe Ëëlsin. Zoti Kancelar kishte një departament në qeverinë e Mbretërisë të Bashkuar e cila nga krijimi i saj deri në shek. 20 kishte një staf të përbërë nga 22.000 vet. Ky departament sot njihet si Ministria e Drejtësisë.

rritet çdo ditë e më tepër për nga aspekti i popullaritetit si metod i zgjidhjes të kontesteve. Në literaturë shpesh herë haset në ndarjen e disa stileve të mediacionit respektivisht në llojet e mediacionit dhe atë në: mediacionin facilitativ (lehtësues), evaluativ dhe transformativ. Stili apo lloji i parë i mediacionit, **mediacioni facilitativ** apo mediacioni lehtësues është njëri nga stilet e mediacionit më të hershëm dhe më të strukturuar. Ky lloj i mediacionit më tepër vjen në shprehje gjat vitev 1960 dhe 1970, dhe ishte i vetmi stil i cili në atë kohë njiheshte dhe praktikohet. Mediacioni facilitativ u paraqit në periudhën e lindjes të qendrave të zgjidhjeve vullnetare të kontesteve, në të cilët mediatorët vullnetar nuk e kishin të patjetërsueshme që të kenë njohuri profesionale dhe plotësuese lidhur me fushat e kontesteve⁸⁹. Te ky lloj i mediacionit mediatori i ndihmon palët vetëm në procesin e bisedimeve me anë të dëgjuarit, përsëritjes të deklaratave të palëve me qëllim që të eliminohet urrejtja dhe në asnjë mënyrë nuk jep propozime për zgjidhjen e kontestit e as jep mendimin e tij për rezultatin përfundimtar. Roli i mediatorit në këtë stil të mediacionit qëndron në udhëheqjen e procesit të mediacionit respektivisht vendosjen e një lloji të komunikimit në mes të palëve me qëllim të sigurimit të arritjes të një zgjidhje të përbashkët dhe përfundimtare të kontestit. Ndërsa nga ana tjetër palët të cilët janë në kontest janë ato të cilët në dorë kanë rezultatin e të gjithë procesit. Pra, medijatorët "lehtësues" dëshirojnë që palët të jenë ato të cilët do të vijnë deri te një zgjidhje si rezultat i informatave dhe kuptimit të ndërsjelltë, që don të thotë se ato duan që palët të jenë ato të cilët do të kenë më shumë ndikim në marjen e vendimit për zgjidhjen e kontestit se sa të ndikojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar. Mirpo në disa raste është e lejuar që palët të kërkojnë nga mediatorët që ta shprehin mendimin e tyre për kontestin, duke treguar se si do të përfundonte procesi i tillë nëse i njejtë udhëhiqej në procedurë gjyqësore nga ana e gjykatave kompetente. Në këto raste kemi të bejmë me stilin e dytë: medijacionin evolutiv. Ky lloj i medijacionit ishte shumë i përhapur gjat vitet 80 si rezultat i numrit të madh të medijacioneve të urdhëruara nga gjykatat. "Medijatorët evaluativ më tepër janë të brengosur për të drejtat ligjore të palëve se sa për nevojat dhe interesat e tyre, dhe evaulojnë në bazë të koncepteve ligjore të drejtësisë"⁹⁰. Sa i përket këtij lloji të mediacionit, egziston mendimi se si i tillë ky medijacion është mjaft i rrezikshëm pasi që tek palët mundet të krijohet bindja se mediatori më tepër anon nga njëra prej palëve në kontest. Sipas David Richbell

⁸⁹ Zameta. Z, (2016), Styles of Mediation: Facilitative, Evaluative and Transformative Mediation at www.mediate.com, reprinted with permission from the National Association for Community Mediation Washington DC

⁹⁰ Ibid

në "Evaluation mediation" është e preferueshme që t'i iket evaluimit dhe të ruhet atmosfera në të cilën palët do të punojnë për problemin derisa të arrijnë ndonjë zgjidhje të saj. Te ky lloj i medijacionit, mediatorët janë aktiv në atë kuptim se ato gjat gjithë kohës kanë takime me palët por edhe me përfaqësuesit e tyre pa prezencën e palëve ose edhe me palët edhe me përfaqësuesit e tyre njëkohësisht. Pra si rezultat i këtyre fokusimeve të mediatorit në këto pika të rëndësishme, mediatori dhe evaluimi i tij mundet të jenë "çelsi" në ndihmën e palëve për zgjidhjen e kontestit, dhe në fund duke u fokusuar në alternativat jashtë bisedimeve gjat mediacionit, ku mediatori gjat bisedimeve luan një rol të rëndësishëm për evaluimin e zgjidhjeve të propozuara në kontekstin e vërtetë të alternativave, ku gjithmonë fiton propozimi më atraktiv se sa ai më pak atraktiv alternativ⁹¹. Gjithashtu mundësitë janë të mëdha që mediatori evaluativ thjesht të gaboj gjat evaluimit. Pasojat për palët, suksesi i procesit si dhe reputacioni i mediatorit do të ishte dramatike⁹². Gjithashtu mediacioni evaluativ dhe përdorimi i teknikave evaluative nga ana e mediatorit në këtë proces do të krijonte konfuzion tek palët në lidhje me procesin e zgjidhjes të konfliktit, pra do të krijohej hamendje se a përdoren teknika të zgjidhjeve alternative të kontesteve respektivisht a përdoret mediacioni apo ndodhen në procedurë të rregullt gjyqësore. Por nga ana tjetër ka disa benefite. Përveç se nëpërmjet të këtij lloji të mediacionit arrihet një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit të caktuar që kanë palët ndërmjet veti, mediacioni evaluativ palëve u jep më shumë informacione më të cilët palët do të mundën të punojnë në drejtim të gjetjes të zgjidhjes të përbashkët të problemit, si dhe kualiteti i analizave dhe këshillave të cilët jepen nga ana e medijatorit mundet të jetë më e madhe nga çdo informatë tjetër. Edhe pse ka rreziqe dhe benefite në mediacionin evaluativ, megjithatë në praktikë një mediator i shkathët dhe profesionist duhet të dijë se si t'i udhëzoj palët dhe nga ana tjetër të ketë kujdes që të mos e shpreh mendimin e tij duke u fokusuar në statusin e medijatorit në mes të palëve dhe duke e evaluar dinamikën në mes të palëve, lëvizjet e tyre apo edhe mungesën e lëvizjeve të tyre sa u përket ndërmarjes të veprimeve për gjetjen e zgjidhjes si dhe gjetjen dhe identifikimin e pengesave të cilët pengojnë zgjidhjen e kontestit, duke u fokusuar në sjelljet e palëve gjat ndërmjetësimit dhe jashtë saj e sidomos sjelljet të cilët kanë ndikim në suksesin e procesit të mediacionit, duke u fokusuar në prioritetet e palëve ku medijatori duhet të evaluoj prioritetet të cilët janë të rëndësishme për arritjen e një marrëveshjeje si dhe duhet të fokusohen në

⁹¹ Shiko më shumë në Folberg, Jay, L. Millne Ann, Peter Salem, (2004), Divorce and family mediation, Models, techniques and applications, The Guilford Press, New York, fq. 80 - 84

⁹² Folberg, Jay, L. Millne Ann, Peter Salem, op. cit, fq. 75

planet partikulare të propozuara si zgjidhje të konfliktit pasi që jo të gjithë planet të propozuara nga ana e palëve janë të përshtatshme ose janë të zbatueshme për zgjidhjen e konfliktit. Si stil i llojit të tretë të medijacionit njihet "medijacioni transformativ" i cili paraqet një koncept mjaft i ri në krahasim me dy stilet e trajtuara më lartë. Të parët të cilët e kanë përmendur këtë lloj të medijacionit kanë qenë Folger dhe Barusch në librin e tyre "The promise of mediation" i botuar në vitin 1994. Medijacioni transformativ u mundëson palëve që të mund të transformohen gjat procesit të medijacionit, njëra ose secila palë ose marrdhëniet e tyre mundet të transformohen gjat procesit të medijacionit. Në fakt, çka transformohet në këtë stil të medijacionit? Këtu lejohet transformimi i vetë palëve si persona e cila do të mundësonte njëkohësisht njohjen dhe pranimin e ndërsjellët të interesave të palëve në konflikt. Ajo bazohet në vlerat e "fuqizimit" të secilës palë si dhe njohjen e secilës palë palës tjetër, jo vetëm të interesave por edhe të nevojave, vlerave si dhe pikpamjeve të tyre për konfliktin e caktuar⁹³. Ajo e cila i bën të dallojnë medijacionin lehtësues dhe evaluativ me këtë të fundit, transformativ është se në mediacionin facilitativ dhe medijacionin evaluativ, procesin e mediacionit e shohin dhe e konsiderojnë si një situatë afatshkurte e cila ka nevojë të zgjidhet sa më shpejt sa është e mundur dhe nuk ka nevojë të zvarritet, përderisa nga ana tjetër medijacioni transformativ mbështetet në faktin se ky proces por edhe konflikti për nga natyra është mjaft i ndërlikuar dhe si i tillë është i gjatë në aspektin kohor e cila në vete ngërthen një numër të madh të veprimeve, mundësi të shumta për intervenime të ndryshme dhe transformime për sa i përket formave të komunikimit ndërmjet palëve në kontest. "Modeli transformativ nuk e injoron vlerën e zgjidhjes të çështjes së caktuar, por ajo pretendon se në qoftë se medijatorët e kryejnë punën e tyre ashtu siç është e përshkruar, vet palët kanë më shumë mundësi që të bëjnë ndryshime pozitive në interaksionin e tyre, dhe si rezultat i kësaj do të gjejnë kushte të pranueshme për zgjidhje të konfliktit në qoftë se ato kushte në përgjithsi do të egzistojnë"⁹⁴. Në mediacionin transformativ mediatori luan rol mjaft aktiv. Përveç veprimeve standarde të cilët mediatori i ndërmer si zakonisht, tek medijacioni transformativ ai u ndihmon palëve të bëjnë spostime ndërvepruese duke i mbështetur kapacitetin e tyre të fuqisë dhe përgjegjshmërisë nëpërmjet të shqyrtimit të përparsive, komunikimit dhe marrjes të vendimeve.

⁹³ Zumeta. Z, (2018), Styles of Mediation: Facilitativ, Evaluativ and Transformative Mediation, <https://www.mediate.com/articles/zumeta.cfm>

⁹⁴ Folberg. Jay, Milne, Ann, Salem, Peter, (2004), Divorce and Family Mediation: Models, technique and applications, The Guilford Press, New York, fq. 60

Sipas Baruch dhe Folger⁹⁵ si dhe sipas autorëve Folberg, Milne dhe Salem⁹⁶ mediacioni transformativ respektivisht mediatori në procesin e medijacionit ka dy qëllime: trajnim dhe njohje. Barush dhe Folger në librin e tyre, trajnimin e sqarojnë si forcim i kapaciteteve të palëve në kontest për të arritur deri në një zgjidhje të kontestit të tyre duke pasur parasysh qëllimet, mundësit dhe preferencat e njëri tjetrit, ndërsa sipas Folberg, Milne dhe Salem koncepti i parë don të thotë dhënja e mbështetjes palëve gjat diskutimeve dhe marjes të vendimeve gjat gjith kohës gjat procesit çdo herë kur ngriten çështje të rëndësishme për procesin, dhe koncepti i dytë - njohja, Folberg dhe Barush njohjen e lidhin me njohjen e situatës egzistuese dhe me aftësitë për identifikimin dhe shqyrtimin e qëndrimeve të palëve nga ana e palës, perspektivat dhe përvojat e pjesmarësve të tjerë në konflikt e sidomos mënyrës se si ato e kuptojnë kontestin dhe problemin që egziston në mes tyre dhe për të cilën ato dëshirojnë që të gjejnë një zgjidhje, ndërsa sipas Folberg, Milne dhe Salem mediatorët gjat mediacionit transformativ duhet të kujdesen për njohjen nga ana e palëve nëpërmjet të inkurajimit por asnjëherë duke i detyruar që palët vet pa detyrim të arrijnë që të kuptojnë perspektivat e palës tjetër. Nga kjo që është paraqitur për mediacionin transformativ mundet të thuhet se ky stil i medijacionit nuk i vendos në margjina vetëm shqyrtimin e atyre çështjeve dhe problemeve për të cilët lehtë gjendet zgjidhje, pra nuk dëshirohet që me anë të medijacionit transformativ të gjindet apo të mos gjindet zgjidhje e pranueshme për palët në kontest, por edhe tu jepet mundësia dhe të njoftohen palët njëra me tjetrën duke u njohur me interesat, nevojat, vlerat dhe pikpamjet e tyre. Për këtë shkak medijatorët modern transformativ dëshirojnë që të vazhdoj procesi i lejimit dhe përkrahjes të palëve në kontest të cilët kanë zgjedhur medijacionin transformativ, që ato vet ta gjejnë dhe ta përcaktojnë drejtimin e vet procesit të tyre. Për këto shkaqe lejimi i palëve që të njohin më mirë palën kundërshtare nga aspekti i çështjes kontestuese dhe prespektivave ndërmjet tyre, është kyçe për arritjen e rezultateve të qëndrueshme të cilët burojnë nga mediacioni transformativ.

4. Medibijaliteti

Medibijaliteti paraqet aftësinë e një kontesti që të mundet të zgjidhet nëpërmjet të medijacionit. Çështja e përshtatshmërisë të kontestit për zgjidhje me anë të medijacionit praktikohet qysh nga takimet e para të klientin. "Në takimin dhe bisedimin e parë, përfaqësuesi

⁹⁵ Bush, B, A. Robert, P. Folger, Joseph, (1996), Transformative mediation and third party in intervening, Ten hallmarks of transformative a approach to practice in Mediation Quarterly, col. 13, nr. 4

⁹⁶ Folberg, Jay, Milne, Ann, Salem, Peter, op. cit, fq. 59

duhet të siguroj nga klienti i tij informacione për problemin për të cilën klienti kërkon ndihmë nga ai, çka klienti shpreson në arritje në lidhje me problemin dhe si klienti do të dëshironte që përfaqësuesi i tij ta mbështesë atë në arritjen e qëllimit të tij"⁹⁷. Personat të cilët i drejtohen një avokati në lidhje me ndonjë problem apo çështje për të cilët ato kërkojnë ndihmë, mundet të mos kenë njohuri të mjaftueshme se problemi apo kontesti i tyre mundet të zgjidhet edhe në mënyra tjera jashtgjyqësore. ndërsa nga ana tjetër avokati duhet tu jep informata dhe t'i këshilloj klientët në lidhje me rëndësinë e ligjit për problemin e tyre, a mundet të zgjidhet problemi respektivisht kontesti i tillë me anë të metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve, në këtë rastë me anë të medijacionit. Se në praktikë avokatët a i këshillojnë apo jo klientët e tyre për përdorimin e medijacionit është një çështje krejtësisht tjetër e cila duhet veçmas të trajtohet dhe analizohet. Medijacioni në përgjithsi është i përshtatshëm nëqoftë se palët dakordohen apo kanë vullnet që kontestin e tyre ta zgjidhin nëpërmjet të medijacionit, ku hapsirë për një kompromis apo për arritje të marëveshtjes në mes të palëve dhe ndërhyrja e medijatorit do ta ndihmonte gjat bisedimeve dhe me këtë të zgjidhet kontesti"⁹⁸. Direktiva gjithashtu parasheh se këto raste janë më të shpeshta kur janë në pyetje çështjet familjare dhe ato të punës"⁹⁹. Edhe Komiteti për çështje të medijacionit civil dhe penal i nominuar nga qeveria e Zhenevës në vitin 2005 ka prezentuar një lloj doracaku i quajtur "Practical guide for civil mediation"¹⁰⁰ e cila ka për qëllim përgjigjen në mënyra të thjeshta dhe të shkurtëra të disa prej pyetjeve elementare dhe bazë që kanë lidhje me medijacionin. Në mes të atyre pyetjeve bëjnë pjesë edhe pyetjet se kur medijacioni është i përshtatshëm e kur jo. Në pikën tre të këtij doracaku janë të parapara rastet kur është i përshtatshëm medijacioni dhe atë: në kontestete familjare, kontestet në mes të qiradhënësit dhe qiramarësit, kontestet për ndërtim, kontestete në raste të ortakërisë, kontestet për pronësinë intelektuale dhe për detyrime tjera kontraktuale dhe ligjore, në kontestet në të cilën është i përfshirë elementi emocional, kontestet ku përshkak të interesave ekonomik konvergjent apo komplementar do të ishte më mirë që palët të bashkpunonin se sa të nisnin procedurë gjyqësore,

⁹⁷Hardy. S, Randle. O, (2001), Mediation for Lawyers, CCH Australia Limited, Sydney Australia, fq. 19

⁹⁸ Ibid, fq. 19

⁹⁹ Direktiva 2008/52/EC i Këshillit Europian dhe Parlamentit në aspekte të caktuara të mediacionit në çështje civile dhe tregtare

¹⁰⁰A Practical Guide To Civil i shkruar nga Komiteti Kantonal për Rekomandime për mediacionin civil dhe penal në tetor të vitit 2005, i përpunuar nga ana e mediatorëve e cila jep informacione për procesin e mediacionit, rolin e mediatorit, të avokatit, përparsit e mediacionit si dhe çmimi dhe asistencë legale. Ky dokument është e pregaditur në formë elektronike për çdo gjyqtar me listë zyrtare të mediatorëve. Ky doracak është i shkruar në disa gjuhë: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, gjuhë spanjolle, rusisht, gjuhë poljake, gjuhë portugeze dhe greqisht.

kontestet kur kontesti fsheh ndonjë kontest tjetër, kontestet ku është i interesit të palëve që të arrijnë një marrëveshje të përbashkët më të shpejtë se sa të nisin procedurë gjyqësore të gjatë dhe të shtrejtë, ose në rastet kur shpenzimet e procedurës gjyqësore do të ishin jo proporcional me vlerën e kontestit, kontestet në të cilët çështjet janë mjaftë komplekse, sepse ato përmbajnë pohime të shumta apo në të marit pjesë më shumë se dy palë, kontestet në të cilën përfshihen disa shtete të cilët reflektojnë ndryshime të shumta në kulturë dhe në gjuhë, dhe kontestet ku palët dëshirojnë që t'u iket natyrës publike të procedurave gjyqësore.

Përshtatshmëria e kontestit për t'u zgjidhur me anë të medijacionit matet nëpërmjet të dy njësive apo dy kriteriumeve: objektiv dhe subjektiv. Kriteri i parë - kriteri objektiv i medibijalitetit në fakt nënkupton përshtatshmërinë e kontesteve të cilët mundën të zgjidhen nëpërmjet të mediacionit. Çështja e medibijalitetit, apo e përshtatshmërisë të çështjes së caktuar të trajtohet me anë të medijacionit është paraparë edhe në Direktivën e Unionit Europian për medijacionin në preambulën e saj, në pikën e 10 parasheh se medijacioni nuk mundet të zbatohet në rastet kur duhet të vendoset për të drejtat dhe obligimet e palëve të cilët nuk mundën lirshëm dhe vetë të vendosin sipas ligjit përkatës në fuqi. Gjithashtu edhe vetë definicioni se mediacioni paraqet një zgjidhje konsensuale të kontesteve, nënkupton atë se medijacioni është e mundur vetëm në situata apo konteste për të cilat palët mundën të arrijnë një marrëveshje të përbashkët, e cila na drejton në udhëzimin apo rekomandimin e Këshillit të Europës se të drejtat të cilët palët nuk mundën t'i disponojnë, nuk mundën të jenë objekt i medijacionit në mes të palëve. Edhe Ligji për medijacion në alinenë e parë dhe të dytë të nenit të parë parasheh se mediacioni si proces mundet të zbatohet në marrdhëniet kontestuese në të cilat palët mundën lirshëm të disponojnë me kërkesat e tyre (al.1) dhe se mediacioni mundet të zbatohet në kontestet pronësore - juridike, familjare, të punës, tregtare, të konsumatorëve, të sigurimit, konteste nga sfera e arsimit, për mbrojtje të mjedisit jetësor, konteste lidhur me diskriminimin si dhe të gjitha kontestet dhe marrdhëniet kontestuese në të cilat medijacioni mundet të ndihmoj në zgjidhjen e tyre. Në çdo sistem juridik egzistojnë lloje të ndryshme të kontesteve, zgjidhja e të cilëve bëhet ekskluzivisht nga ana e gjykatave shtetërore, dhe si zakonisht kjo është ashtu përshkak të karakteristikave dhe natyrës mbi gjitha të kontesteve e sidomos për ato konteste të cilët prekin interesin publik si dhe për ato marrdhënie të cilët janë të rregulluara me norma *jus cogens* si për shembull: medijacioni në konteste familjare, për mbrojtjen e konsumatorëve apo kontestet e punës të cilët janë të rregulluara me anë të normave *jus cogens*. Ligji për mediacion gjithashtu

parasheh edhe zgjerim të kufijve objektiv për zbatim të mediacionit edhe në konteste penale, vetëm në qoftë se me ndonjë ligj tjetër nuk është e përjashtuar një gjë e tillë¹⁰¹. Pra janë dy kushte të cilët duhen të plotësohen që të mundet të zbatohet mediacioni në kontestet penale, e para mediacioni duhet të jetë kompaktibile me natyrën dhe karakterin e kontestit dhe e dyta ajo që u përmend më lartë, që zbatimi i mediacionit të mos jetë i përjashtuar me ligj. Për zgjerim të kufijve objektiv, mbështetjen e vet e jep edhe Komisioni Europian për efikasitet në drejtësi/European Commission for the efficiency of justice¹⁰², ku komiteti i ministrave të shteteve anëtare të Unionit Europian japin rekomandim për zhvillimin e mediacionit në çështje penale, ku në pjesën e dytë ku janë të parapara parimet e përgjithshme, parashihet që mediacioni në çështjet penale duhet të zbatohet vetëm nëse palët pajtohen me atë (pika 1), se diskutimet gjat procesit të mediacionit janë konfidenciale (pika 2), mediacioni në çështje penale duhet të jetë në përgjithësi një shërbim gjithmon në dispozicion (pika tre), mediacioni në çështje penale mundet të zbatohet gjat të gjitha fazave të procesit gjyqësor penal (pika katër) dhe se shërbimeve të mediacionit duhet t'u jepet autonomi e mjaftueshme brenda sistemit gjyqësor penal (pika pesë). Një hap i madh për njohjen dhe promovimin e mediacionit në Republikën e Maqedonisë u bë me pregaditjen e një doracaku të veçantë për njohjen e kontesteve të përshtatshme për t'u zgjidhur me anë të mediacionit, "Doracak për gjykatësit dhe prokurorët publik për njohje të lëndëve të përshtatshme për mediacion" i pregaditur dhe botuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2011 me ndihmën e Institutit Ndërkombëtar të Financave si anëtar i Grupacionit të Bankës Botërore dhe me mbështetjen e Qeverisë të Holandës. Në këtë doracak mundet të shihet se cilët lëndë civile janë më të përshtatshme për t'u zgjidhur me anë të mediacionit si për shembull: kontestet të cilët zgjasin shumë, kontestet të cilët duhet të rruhet privatësia, kontestet në mes të palëve të cilët janë në mardhënie të përhershme pune dhe të njejtën dëshirojnë ta ruajnë, kontestet në mes të fqinjëve, kontestet për fatkeqësitë në komunikacion, kontestet për gabimet e mjekëve, kontestet për borxhe të papaguara, kontestet juridiko - pronësore në mes të bashkëshortëve dhe në mes të partnerëve jashtmartesor si dhe konteste në bashkësitë familjare si ushtrimi i të drejtave prindërore nga aspekti i interesit të fëmijëve, kontestet për mbajtje të përhershme, konteste për sigurim ku palët nuk njihen ndërmjet veti por i bashkon ngjarja kontestuese, kontestet për qarkullim të mallrave dhe shërbimeve,

¹⁰¹ Ligji mbi mediacionin, neni 1, al. 3

¹⁰² Council of Europe - Committee of Ministers, Recommendation no. R(99)19 of the Committee of Ministers to Member States concerning mediation in penal matters, 15 shtator 1999

konteste për mbrojtje të konsumatorëve, konteste në ndërtim, konteste bankare, konteste të natyrës së pronësisë intelektuale dhe konteste koncesionale. Pra siç edhe mundet të shihet, spektri i kontesteve të cilët mundet të zgjidhen respektivisht i marrdhënieve të cilët mundet të rregullohen me anë të medijacionit është shumë i gjërë dhe mundet të thuhet se në ikjen e mbingarkimit të alinesë 2 të nenit të parë, përdoret formulimi "edhe mardhëniet tjera kontestuese" në të cilën formulim përfshihen të gjitha fushat e lartpërmendura ku medijacioni mundet të gjej zbatim. Përveç këtij doracaku, vlen të përmendet edhe "Doracaku për trajnim të medijatorëve për ripërtirje të njohurive për mediacionin"¹⁰³. E veçanta e këtij doracaku është ilustrimi i disa rasteve dhe ushtrimeve me natyra të ndryshme të kontesteve respektivisht të njëmbëdhjet rasteve si për shembull: kontesti në mes dy kolegëve të punës për mos kthimin e borxhit por të cilët duhet të bashkëpunojnë në punë pasi që janë pjesë e ekipit menaxherial në ndërmarjen publike ku ato punojnë, kontesti për shkak të shkurrorëzimit dhe ndarjes të pronës të përbashkët të fituar në martesë, kontesti në mes dy djemve përshkak të përleshjes fizike, e të tjera. Jo rastësisht u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre doracakëve në këtë pjesë, pasi që të njëjtat janë ato të cilët i zgjerojnë njohurit e kufijve objektiv të medibijaltetit. Megjithatë medijacioni nuk mundet të konsiderohet si zgjidhje e vetme e të gjitha problemeve dhe kontesteve, pasi që jo të gjitha kontestet janë të përshtatshme për t'u zgjidhur me anë të medijacionit. Si konteste të cilët nuk munden të zgjidhen me medijacion dhe të cilët konsiderohen si të papërshtatshme janë: kontestet të cilët kanë të bëjnë me disponime të cilët janë të ndaluara me ligjet në fuqi, kontestet të cilët munden të zgjidhen vetëm me anë të ligjeve dhe vlefshmërinë kushtetuese të akteve, veprat penale përveç atyre për të cilët ligji lejon të zgjidhen me anë të mediacionit, konteste administrative në të cilët palët nuk munden të disponojnë me kërkesat e tyre, kontestet statusore, kontestet për dhunë në familje, konteste ku egziston çekuilibër i madh ndërmjet palëve e sidomos kur njëra nga palët është mjaft e fuqishme para ligjit, kontestet në të cilën eskalimi i konfliktit është jashtzakonisht i lartë, kontestet ku të dy palët dëshirojnë që kontesti i tyre të zgjidhet me vendim gjyqësor, kontestet për falimentim, regjistrim dhe kontesteve statusore në të drejtën tregtare, mosmarëveshtjet për caktimin e mbledhjeve të aksionerëve nga ana e gjykatës, kontestet për mbrojtjen e të drejtave të

¹⁰³ I pregaditur në kornizat e projektit MATRA " Mbështetje për avancim të implementimit të mediacionit në Maqedoni " i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në qershor të vitit 2013. Trajnimi i mediatorëve është mbajtur për dy ditë, 16 orë të plota. Programi i trajnimit ishte prezentuar në nëntë sesione. U trajnuan medijatorët të cilët ishin të regjistruar në Listën e emrave të medijatorëve në Republikën e Maqedonisë.

aksionerëve të vegjël, kontestet në rast të paraqitjes të padive derivative, kontestet në fushën e mborjtjes të konkurrencës, kontestet për caktimin e masave të përkohshme dhe atyre paraprake¹⁰⁴.

Zgjidhja e kontesteve nëpërmjet të medijacionit nuk kufizohet vetëm në aspektin objektiv respektivisht për kontestet dhe llojet e tyre të cilët janë të përshtatshme që të zgjidhen me anë të medijacionit si metod i zgjidhjeve alternative të kontesteve, por gjithashtu këto kufij shtrihen edhe në aspektin subjektiv, e cila ka të bëjë me lejueshmërinë e personave të cilët mundet të jenë palë apo të cilët mundet të jenë pjesmarrës në procedurën e medijacionit. Ligji për medijacionin i vitit 2009 parashihte subjektet e procedurës të medijacionit respektivisht parashihte se në procedurë të medijacionit munden si personat fizik ashtu edhe ato juridik të zgjidhin kontestin e tyre¹⁰⁵. Gjithashtu edhe në alienë katër të nenit dy të po këtij ligji, sqarohet termi palë, sipas të cilës palë janë personat fizik dhe personat juridik të cilët do të marrin pjesë në procedurën e medijacionit dhe pëlqimi i të cilëve është i nevojshëm për zgjidhjen e kontestit. Siç edhe mundet të shihet nga këto dy nene, kufijtë subjektiv të medijabilitetit janë të vendosura mjaftë gjërë. Pasi që edhe personat juridik mundet të jenë palë në procedurë të medijacionit, në këtë kuptim mundet të arrihet në përfundim se si palë munden të paraqiten edhe njesit e vetqeverisjes lokale respektivisht komunitat por edhe vet shteti. Edhe pse Ligji për mediacionin¹⁰⁶ i cili është në fuqi sot nuk i përmban më në tekstin e tij nenet e lartpërmendura, pra nuk i parasheh taksativisht subjektet të cilët mundet të jenë palë në procedurë të medijacionit kjo nuk don të thote në asnjë mënyrë se me këtë kufijtë subjektiv të medijabilitetit janë të paqartë apo janë ngushtuar në një far mënyrë. Ligji mbi procedurën kontestimore e rregullon në mënyrë analoge çështjen e asaj se kush mundet të jetë palë në procedurë. Pasi që me anë të procedurës të medijacionit rregullohet një mardhënie e prishur në mes të palëve për shkak të ndonjë konflikti - situatë e njejtë e cila është lëndë e njejtë si lëndë e procedurës kontestimore mundet të thuhet se lirisht sa i përket përcaktimit të palëve në procedurën e medijacionit, të shërbehena me nenin 70 të Ligjit për procedurë kontestimore e cila e rregullon të njejtën çështje. Në kreun e katërt të Ligjit për procedurë kontestimore parashihet se palë në procedurë mundet të jetë çdo person fizik dhe juridik (al. 1, neni 70). Lidhur me atë se cilët janë subjektet të cilët marrin pjesë në procedurën e medijacionit përveç palëve të cilët e zgjedhin këtë metodë për zgjidhje të kontestit të tyre bëjnë

¹⁰⁴ Milošević. M, (2014), Alternativno rešavanje sporova s posebnim osvrtom na medijaciju, Službeni Glasnik, Beograd, fq. 26

¹⁰⁵ Ligji mbi medijacionin nr. 138/09, neni 1, al. 2

¹⁰⁶ Ligji mbi medijacionin nr. 188/13, nr. 148/15, nr. 192/15

pjesë edhe subjektet të cilëve u besohet zbatimi i procedurës së medijacionit. Këto të fundit përbejnë konceptin organizativo-kompetent të mediacionit, të cilët edhe caktojnë kufijtë organizativo - kompetent lidhur me atë se kush mundet ta dhëheq procedurën e mediacionit. Sipas alines 1 të nenit 46 të Ligjit të medijacionit, medijator mundet të jetë çdo person fizik me aftësi veprimi i cili ka licencë për kryerjen e punëve të medijatorëve. Medijatorët e licencuar janë të organizuar ne Dhomën e Medijatorëve ne Republikën e Maqedonisë (al.1 , neni 32) e cila ka status të personit juridik (al.3 , neni 32) . Medibijaliteti organizativo - kompetent e zgjeron pyetjen se a mundet mediacioni të zbatohet edhe nga organizatat respektivisht qendrat për medijacion. Në shtetet ku mediacioni rrënjët e para i ka lëshuar para 20-30 viteve, kuptohet këtu nuk mer pjesë shteti jonë, medijacioni si zakonisht zbatohet brenda kornizave të organizatave apo qendrave të veçanta të cilat veprojnë si dhënës të shërbimeve të medijacionit të cilët shërbime janë të rregulluara sipas rregullave të tyre autonome. Në shtetet në të cilët medijacioni është paraqitur më vonë dhe në të cilën ende adaptohet kjo metodë e zgjidhjeve alternative të kontesteve në sistemin juridik duhet të stimulohet çdo organizatë dhe institucion i cili ka interes të organizoj dhe të siguroj shërbime të medijacionit njetë si një numer i madh i organizatave të specializuara si për shembull në SHBA të cilët meren me dhënjen e shërbimeve të medijacionit.

5. Parimet e procedures të mediacionit

"Procedura e medijacionit është e karakterit joformal dhe implementohet në shumë çështje të ndryshme kontestuese dhe si i tillë është dhe e qart se ajo nuk mundet të rregullohet në mënyrë strikte dhe të detajuar dhe as që është e mundur krijimi i rregullave të unifikuar të cilët gjithsesi do ta zvoglonin fleksibilitetin e saj"¹⁰⁷. Kjo është kështu pasi që mediacioni zbatohet në menyra të ndryshme dhe me qëllim të përshtatshmërisë të procedurës të mediacionit dhe veçorive të saja me llojet e ndryshme të kontesteve, është bërë një tentim nga autorë të ndryshëm dhe juristë për përcaktimin e parimeve në të cilët do të mbështetet kjo procedurë pa marrë parasysh llojin e kontestit. Parimet e procedurës janë rregulla të përgjithshme dhe themelore të cilët shprehin qëllime të caktuara ligjore por edhe teknike dhe të cilët zbatohen gjat procedurave në përgjithësi dhe gjat procedurës të medijacionit ne veçanti. Ato shërbejnë si udhërefyes gjat procedurës me qëllim të sigurimit sa më të shpejtë të dhënjes të mbrojtjes ligjore. Përcaktimi i parimeve të procedurës të medijacionit në tekstin e Ligjit për medijacionin është i rëndësishë të

¹⁰⁷Петрушиќ. Н, op. cit, fq. 38

madhe për zbatimin e medijacionit e sidomos për faktin se kjo procedurë ende konsiderohet si një procedurë joformale për nga natyra e cila më shumë udhëhiqet nga vullneti i palëve në mardhënien kontesutese. Prej momentit kur palët dakordohen ta pranojnë medijacionin si menyrë e zgjidhjes të kontestit të tyre, prej atij momenti ato dakordohen që të sillen në pajtueshmëri me parimet e asaj procedure. Këto parime paraqesin kornizën themelore të procedurës të mediacionit, udhëzime për sjellje të mediatorit dhe të palëve në kontest si dhe të pjesmarësve tjerë në procedurën e mediacionit dhe të cilët bëjnë të dallojnë procedurat ndërmjet veti, kështu edhe procedurën e medijacionit nga procedurat tjera. Edhe në raportin e Komisionit për Reformat në Drejtësi kushtuar zgjidhjeve alternative të kontesteve si medijacioni dhe pajtimi janë të parapara parimet e medijacionit dhe atë: autonomia e palëve, konfidencialiteti, vetëvendosja, efikasiteti, ndihma juridike, fleksibiliteti, neutraliteti, detyrueshmëria dhe transparencë¹⁰⁸. Në legjislacionin tonë medijacioni si procedurë është e rregulluar me Ligjin për medijacion e cila në krehun e dytë i përmban edhe parimet e kësaj procedure. Parimet të cilët rregullojnë procedurën e medijacionit janë: autonomia e palëve, barazia, neutraliteti, konfidencialiteti, përjashtimi i publikut në procedurën e mediacionit, barazia e palëve, qasje te informatave për mediacionin me procedurat tjera, efikasiteti dhe drejtësia. Siç mundet të vërehet këto parime mundet të ndahen edhe në bazë të tre aspekteve: nga aspekti i palëve (autonomia e palëve dhe barazia e palëve), nga aspekti i mediatorit (neutraliteti dhe paanësia) dhe nga aspekti i vetë procedurës të mediacionit (konfidencialiteti, qasja te informatat për mediacionin në procedurat tjera, efikasiteti dhe drejtësia). "Qëllimi i përcaktimit të parimeve procedurale të cilët i detyrojnë të gjithë pjesmarësit në procedurë para së gjithash është prevenimi i keqpërdorimeve të shumta dhe surprizave të pakëndëshme, si dhe krijimi i kushteve për bisedime të sukseshme"¹⁰⁹.

PARIMI I AUTONOMISË TË PALËVE - është parim themelor në procedurën e medijacionit. Ky parim konsiderohet themel i kësaj procedure pasi që pa vullnetin e palëve nuk mundet të ketë zbatim të procedurës të medijacionit. "Procedura e medijacionit zbatohet në bazë të pëlqimit strikt me shkrim të palëve përveç në marrëdhënjet kontesutese ku me ligj parashihet inicim i procedurës të medijacionit si kusht për mbajtjen e procedurës gjyqësore ose procedurës tjetër"¹¹⁰. Ky nen nënkupton faktin se procedura e medijacionit mundet të zbatohet vetëm në

¹⁰⁸ shiko më tepër në LRC 98-2010, fq. 29 - 64

¹⁰⁹Петрушиќ. Н, op.cit, fq. 35

¹¹⁰ Ligji mbi medijacionin, neni 6, al.1

qoftë se palët dakordohen për një gjë të tillë respektivisht janë palët ato të cilët vendosin se a do të mundohen që kontestin e tyre ta zgjidhin në rrugë të mediacionit apo jo. Pra nuk egziston detyrimi i palëve për zgjidhje të kontestit me anë të mediacionit. Por nga ky rregull ka edhe një përjashtim i cili është i paraparë në nenin e 6, e cila parasheh zbatimin e mediacionit si kusht i inicimit të ndonjë procedure gjyqësore apo ndonjë procedure tjetër. Autonomia përveç se për palët vlen edhe për medijatorin, sipas të cilës ato në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë shtypje pranojnë ose jo që të zbatojnë procedurën e mediacionit. Në këtë kuptim medijatori do ta zbatoj procedurën e mediacionit në atë mënyrë që e konsideron më adekuate duke i marrë parasysh propozimet e palëve, rrethanat si dhe nevojën për zgjidhjen e shpëjtë të kontestit (al.4, neni 6) . Gjithashtu ligji i obligon edhe gjykatësit në gjykatat e Republikës të Maqedonisë që palëve t'ua tregoj mundësinë e zgjidhjes të kontestit të tyre nëpërmjet mediacionit¹¹¹, me ç'rast a do të pranojnë ose jo palët një vendim të tillë të gjykatësve paraqet një çështje krejtësisht tjetër. Duhet të theksohet se ky parim vlen për të gjithë aktivitetet të cilët ndërmiren gjat gjithë kohës në procedurën e mediacionit, para inicimit të procedurës të mediacionit, gjatë procedurës dhe në stadiumet e mëvonshme të saja. Si aktivitete të tilla konsiderohen: vendosja për zgjidhje të kontestit me anë të mediacionit, zgjedhja e medijatorit, zgjedhja e vendit ku do të zbatohet procedura, zgjedhja e rregullave të cilat do të vlejnjë gjat procedurës, çështja e ndërprerjes të procedurës, përmbajtja e marrëveshtjes të aritur, kushtet e marrëveshtjes e të tjerë. Me fjalë të tjera palët janë ato nga të cilët varet e gjithë procedura e mediacionit, në kuptimin se pala e cila është e dakorduar ta zgjidh kontestin nëpërmjet mediacionit, mundet gjat gjithë kohës të procedurës të heq dorë nga e njejta dhe në atë gjë askush nuk mundet ta ndaloj. Pra palët janë ato të cilët e inicojnë, e zbatojnë dhe e përfundojnë procedurën e mediacionit me vullnetin e tyre.

PARIMI I BARAZISË DHE PARIMI I BARAZISË TË PALËVE- janë dy nenet të cilët në përmbajtje janë të njejta, qëllimi i të cilëve është sigurimi i mbrojtjes të barabartë juridike. Ky parim bazohet në faktin se palët në procedurë të mediacionit janë të barabartë (al.1, neni 7) e cila barabarsia vjen si rezultat i të drejtave dhe obligimeve të barabarta që kanë palët. Njëkohësisht Ligji për mediacionin obligon medijatorin që palëve gjat gjithë kohës sa zgjat procedura e mediacionit tu mundësoj pozit të barabartë në procedurë¹¹². Barabarsia e palëve në procedurë rrjedh nga e drejta kushtetuese për barazin e të gjithë qytetarëve para Kushtetutës dhe

¹¹¹ Ligji mbi mediacionin, neni 6, al.2

¹¹² Ligji për mediacionin, neni 7, al. 2

ligjeve¹¹³. Ky parim kërkon që " palëve t'u mundësohet që lirisht ti realizojnë dhe ti mbrojnë interesat e tyre dhe për atë qëllim të mundet ti përdorin të gjith veprimet të cilët u lejohen "¹¹⁴. Kjo nënkupton atë se palët kanë të drejtë të deklarohen për të gjithë pyetjet dhe çështjet kontestuese, të kenë në dispozicion kohë të njejtë si njëri ashtu edhe tjetri për tu sqaruar, të kenë mundësi të njejtë që të qartësojnë problemet dhe ti komentojnë të njejtat gjat procedurës, të vendosin bashkërisht për mënyrën e zbatimit të procedurës të medijacionit si dhe shumë çështje të tjera. Ky parim gjithashtu nënkupton edhe faktin se palët bashkërisht do të marrin pjesë në zgjidhjen e kontestit të tyre por edhe në suksesin e procedurës të medijacionit. Jobarabarsia e palëve plotësisht do ta shkatërontë qëllimin e medijacionit dhe njëkohësisht marrëveshtja e aritur në atë procedurë ku palët nuk kanë qenë të trajtuar si të barabart, nuk do ta plotësonte kushtin e vetëm të marrëveshtjes - kriterin e drejtësisë. Alinea e parë e nenit 11 parasheh edhe çështjen e pjesmarrjes të barabart të palëve në procedurën e mediacionit e cila njëkohësisht e obligon medijatorin që ti informoj palët gjithmonë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme si dhe e obligon atë për trajtim të barabart të palëve gjat procedurës të medijacionit (al.2, neni 12). Kjo nënkupton faktin se medijatori duhet të trajtoj palët njejtë, ti paralajmëroj të njejtët në qoftë se vjen puna deri te pozita jo e barabart e palëve dhe ti udhëzoj se si një pozit e tillë mundet të menjanohet. Medijatori gjat gjithë kohës duhet të ketë një rol mjaft aktiv në atë kuptim se ai duhet ti ndihmoj ato që të arrijnë një marrëveshtje të kapshme për të dyja palët respektivisht të mos lejoj që palët ta zgjidhin kontestin me nënshkrimin e marrëveshtjes e cila është në interes të njërës palë e jo e të dyjave. Jobarabarsia e palëve mundet të jetë e shumë llojshme: psikologjik, ekonomik, material, fizik e të tjerë. Si për shembull jobarabarsia kemi kur njëra palë mundet ti mbulojë shpenzimet e procedurës e ndërsa pala tjetër nuk ka mundësi materiale ose kur njëra palë ka përfaqësues ndërsa pala tjetër jo. Në këto raste medijatori duhet paraprakisht të zbuloj jobarabarsinë ndërmjet palëve dhe të njejtën ta eliminoj.

PARIMI I NEUTRALITETIT DHE PAANËSISË - neni 8 i Ligjit mbi medijacionin parasheh parimin e neutralitetit dhe të paanësisë, sipas të cilit medijatori gjat gjithë kohës në procedurë duhet të veproj në mënyrë neutrale dhe të paanshme si në aspekt të palëve ashtu edhe në marrdhënien kontestuese ndërmjet tyre. Ky parim përcakton sjelljen e mediatorit në

¹¹³ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 9

¹¹⁴Јаневски. А, Зороска - Камилоска. Т, op. cit, fq. 175

procedurë¹¹⁵. Pra me anë të këtij parimi përcaktohet roli i medijatorit i cili në asnjë mënyrë nuk duhet të duket se favorizon njërin anë dhe e disfavorizon palën tjetër, apo se anon më së tepërmi nga njëra prej zgjedhjeve të shumta të mundshme. Por kjo nuk don të thot se medijatori nuk ka qëndrime dhe mendime të tija rreth çështjes kontestuese, por ai është i obliguar që të njejtat mendime dhe qëndrime të mos u'a shpreh palëve e sidomos të mos u'a imponoj. Aspekti neutral i këtij parimi u mundëson palëve që çështjen e tyre e cila është lëndë e procedurës të medijacionit ta shohin në një mënyrë më ndryshe dhe si rezultat i asaj ato vet të jenë dizajnuar të zgjidhjes të saj. Ndërsa aspekti i paanësisë e cila edhe kjo ka të bëjë me mediatorin i cili me qëndrimet dhe mendimet e tyre nuk duhet në asnjë mënyrë që ndonjërisë prej palëve t'u jep përparësi apo të favorizoj ndonjërin nga palët apo zgjidhje të çështjes kontestuese. Pra ky parim praktikisht don të thot se medijatori nuk duhet që palët t'i bind se cila zgjidhje është më e përshtatshme e cila më pak e përshtatshme për kontestin e tyre, por duhet t'i lejoj palët që vet ta gjejnë zgjidhjen më të përshtatshme për to, dhe në fund të procedurës ta vërtetoj zgjidhjen e arritur në mes të palëve. "Realizimi praktik i këtij parimi është një detyrë mjaft e vështirë, sidomos në situatat kur në mes të palëve egziston jobalans i theksuar i fuqisë, kështu që në këto raste egziston nevoja që medijatori të bëjë një balans në mes të palëve, dhe njëkohësisht të ruaj neutralitetin dhe besimin e palëve ndaj tij"¹¹⁶.

PARIMI I PËRJASHTIMIT TË PUBLIKUT NË PROCEDURËN E MEDIACIONIT -

në procedurën e mediacionit publiku është i përjashtuar dhe një gjë e tillë është e paraparë në nenin 10 të Ligjit mbi mediacion. Alinea e parë e këtij neni parasheh shprehimisht se në procedurën e medijacionit publiku përjashtohet. Në procedurë munden të marrin pjesë vetëm palët, respektivisht përfaqësuesit e tyre ligjor në rast të paaftësisë të veprimit apo me aftësi të kufizuar të veprimit si dhe autorizuesit të tyre (al. 3, neni 10). Përveç personave fizik palë në procedurë të medijacionit mundet të jenë edhe personat juridik. Në raste të tilla "personat juridik i përfaqëson përfaqësuesi ligjor respektivisht përfaqësuesi i autorizuar"¹¹⁷. Në krahasim me procedurën kontestimore të cilët gjithmonë janë publike, munden të marrin pjesë të gjithë të interesuarit, duke përjashtuar vetëm disa raste në të cilat publiku përjashtohet¹¹⁸, në procedurat e

¹¹⁵Петрушиќ. Н, op.cit, fq. 38

¹¹⁶Ibid, fq. 38

¹¹⁷ Ligji mbi medijacionin, neni 10, al. 4

¹¹⁸ Për shkaqe të moralit, rendit publik, sigurisë shtetërore sidomos kur gjykohet ndonjë person i mitu ose përshkak të ruajtjes të jetës private të palëve ose në konteste martesore, konteste për njohjen atësisë, për njohjen e amësisë,

medijacionit, sekret paraqet çdo gjë e cila do të thuhet dhe deklarohet në procedurë për pesonat të cilët nuk kanë mar pjesë në procedurë. Duke mar parasysh që publiku në procedurën e medijacionit është e përjashtuar, personat e tretë nuk mundën të marin pjesë gjat procedurës përveç atëherë kur vetë palët në procedurë japin leje që të njejtit të jenë prezent gjat procedurës. Një gjë e tillë është e paraparë në alinenë 6 e nenit 10 të Ligjit mbi mediacionin. Me marje pjesë në procedurën të medijacionit nënkuptohet vetëm vështrim i procedurës me status të publikut, e jo edhe të drejtën e pjesmarjes aktive.

QASJE TË INFORMATAVE TË MEDIACIONIT NË PROCEDURA TJERA - ky parim ka të bëj me rregullat e procedurës të cilët duhet t'i kenë të qarta para fillimit të procedurës të medijacionit. Neni 12 në alinenë 1 parasheh se palët, përfaqësuesit e tyre ligjor dhe të autorizuarit, medijatorët, personat e tretë të cilët marin pjesë në procedurën e medijacionit me leje të palëve, si dhe personat të cilët kryejn punë administrative për nevojat e medijacionit, nuk mundën në asnjë procedurë gjyqësore apo procedurë tjetër të thiren në fakte, apo të dëshmojnë ose të propozojnë dëshmi të cilët janë përdorur në procedurën e medijacionit. Kjo në fakt është përparsia më e rëndësishme e kësaj procedure. Në këtë drejtim, e rëndësisë së madhe është roli i medijatorit i cili duhet t'i njoftoj palët me të gjitha informacionet relevante siç janë udhëheqja e procedurës, kohëzgjatja, gjuha, shpenzimet përfshirë këtu edhe ato informacione të cilët dalin në pah gjat zbatimit të procedurës së medijacionit janë sekrete dhe të njejtat nuk duhet të shfrytëzohen në procedurën gjyqësore dhe procedura tjera. Ligji mbi mediacionin parasheh edhe atë se cilët informata konsiderohen konfidenciale dhe të cilët nuk mundën të përdoren në procedurë gjyqësore dhe procedura tjera. Fakti se njëra prej palëve ka propozuar procedurë të medijacionit ose ka shprehur vullnet për të marrë pjesë në atë procedurë, mendime dhe qëndrime të paraqitura nga palët në procedurën e medijacionit ose propozime të paraqitura në atë procedurë vetëm me arritjen e marrëveshtjes, nuk mundet të jenë publike as edhe menyrat e mundshme për zgjidhjen e kontestit që gjat procedurës të medijacionit i ka paraqitur medijatori dhe faktin se njëra palë e procedurës ka shprehur gadishmëri që të pranoj mënyrën e propozuar të zgjidhjes të kontestit si dhe dokument i pregaditur vetëm për nevojat e procedurës të medijacionit¹¹⁹. Ndalesat e lartpërmendura para së gjithash kanë të bëjnë me llojin e

kontestet lidhur me kujdestarinë dhe adoptimin, kontestet ku duhet të ruhet sekret luftime, sekret profesional, sekret zyrtar si dhe në kontestet ku duhet të mbrohet siguria dhe mbrojtja e Republikës së Maqedonisë.

¹¹⁹ neni 12 i Ligjit mbi mediacion

informacionit e jo me formën e informacionit. Ky parim synon të siguroj pjesmarje sa më aktive të palëve si dhe sa më të lirë dhe pa rezervë në mënyrë që ti paraqesin provat dhe dëshmit e tyre pa asnjë frigë se të njejtat do të jenë publike në një mënyrë ose tjetrën.

PARIMI I BESUESHMËRISË/KONFIDENCIALITETIT - është një ndër parimet më të rëndësishme të procedurës të medijacionit e cila edhe e bën të veçantë këtë procedurë nga procedurat tjera. Konfidencialiteti si një çështje e cila në procedurën e medijacionit siguron efikasitet dhe e rregulluar në nenin 9 të Ligjit për medijacion, e cila parasheh që të gjithë informacionet të cilët dalin në procedurën e medijacionit ose në njërën apo tjetrën mënyrë janë të lidhura me procedurën, do të mbahen konfidenciale. Ky parim para së gjithash e detyron mediatorin që t'i mbaj sekret të gjitha të dhënat, faktet, dëshmit, provat dhe të ngjajshmet të cilët burojnë nga procedura e cila zbatohet apo pas përfundimit të saj, si dhe i detyron edhe palët, personat të cilët marin pjesë në procedurë me lejen e palëve. Neni nëntë gjithashtu parasheh edhe përjashtime me ç'rast lejohet përdorimi i informacioneve të procedurës të medijacionit, vetëm atëherë kur palët me shkrim kanë bërë një marrëveshje të tillë (al.1). Besueshmëria apo konfidencialiteti parasheh që përveç se informacionet nga procedura e medijacionit të cilët do të mundësojnë arritjen e marrëveshjeve të pranueshme dhe të përbashkët për të dy palët në kontest, me çka do t'i jepet fund kontestit të tyre, gjithashtu mundëson edhe mos përdorimin dhe me këtë keqpërdorimin e informacioneve të cilët janë fituar nga bisedimet e medijatorëve me palët në seanca të përbashkëta apo individuale me palët, në procedurë gjyqësore apo në procedura tjera. Këtë çështje në mënyrë analoge e rregullon edhe neni 12. Me ligj parandalohet që gjykatësit apo secili organ tjetër qoftë ajo edhe arbitrazh të mos i pranojnë propozimet e dhëna në procedurën e mediacionit të cilët jepen ekskluzivisht për arritje të marrëveshjeve nëse të njejtat u paraqiten nga ana e palëve apo të autorizuarve të tyre (al.3, 4, neni 9). Me parimin e konfidencialitetit përputhet dhe ka lidhshmëri edhe parimi veç i trajtuar më lartë, parimi i përjashtimit të publikut në procedurën e medijacionit. Kjo është kështu pasi që me anë të moslejimit të marjes pjesë të personave të tretë të cilët nuk kanë ndonjë interes nga procedura e mediacionit, sigurohet edhe mosrjedhja e informacioneve të cilët dalin në pah gjat procedurës të medijacionit jasht seancave të saja. Egzistojnë disa situata të cilët lejojnë përdorimin dhe bërjen publike të informacioneve të procedurës të medijacionit të cilët në situata tjera normale do të kishin karakter konfidencial. Situatat e tilla janë të numëruara taksativisht në Ligjin mbi medijacionin dhe si të tilla janë: do të konsiderohen informacionet e procedurës të medijacionit me karakter jo konfidencial kur një gjë

e tillë është e paraparë me ligj të veçantë, kur një gjë e tillë kërkohet për mbrojtje nga çdo sulm i integritetit fizik apo psikik të personit i cili është i përfshirë në kontest kur këtë e kërkon interesi publik, si dhe në rastet kur kjo është e domosdoshme për zbatimin e marrëveshtjes e cila del nga procedura e medijacionit¹²⁰. Ky parim dhe të gjithë aspektet e këtij parimi kanë vetëm një qëllim, të krijohet një atmosferë në të cilën palët mundën të bisedojnë lirshëm dhe pa frigë në lidhje me problemin, duke i siguruar palët se ndonjë bisedë, informacion apo fakt nuk do të përdoret kundër tyre dhe në dëm të tyre në të ardhmen. Edhe Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit në nenin shtatë parashih çështjen e konfidencialitetit në procedurën e medijacionit. Direktiva parashih që as mediatori e as personat të cilët janë të përfshirë në administrimin e procedurës të medijacionit (përkthyesit, këshilltarët juridik, ekspertët, e të tjerë) nuk duhet t'i japin informatat të cilët dalin nga procedura e medijacionit në procedurë gjyqësore ose të arbitrazhit, përveç se nëse palët dakordohen në të kundërtën¹²¹. Alinea 2 e nenit 7 gjithashtu udhëzon që palët nënshkruese të kësaj direktive të ndërmarin masa më strikte dhe më efektive për të mbrojtur konfidencialitetin në procedurën e medijacionit. Si masa të tilla konsiderohen rregulla të cilët do të kufizojnë të drejtat e palëve për të dëshmuar dhe për të paraqitur fakte dhe prova në procedurën gjyqësore dhe procedura tjera.

PARIMI I EFIKASITETIT - efikasiteti i medijacionit gjithmon ka të bëjë me aspektet e kohës dhe parave, gjë që ndikon në faktin se ky metod alternativ i zgjidhjes të kontesteve ndihmon zgjidhjen e kontesteve më i shpejtë dhe njëkohësisht ndihmon në zvogëlimin e rasteve gjyqësore dhe kështu kursehet koha por edhe shpenzimet janë më të vogla. Indikator tjetër i efikasitetit është edhe "përfshirja e shqetësimeve emocionale si një çmim jo financiar pasi që pjesmarësit mundet të vuajnë nga çmimi psikologjik dhe prishje të mardhënieve shoqërore e cila ndikon negativisht me efikasitetin organizativ edhe në karrierat individuale"¹²². Në Ligjin mbi medijacionin çështja e parimit të efikasitetit është e rregulluar në nenin 13, sipas të cilës procedura e medijacionit është procedurë ekonomike, efikase dhe e shpejtë deri te e cila palët kanë qasje të lehtë dhe të barabartë. Nga kjo nënkuptohet se medijacioni si në aspektin e çmimit të saj ashtu edhe në aspektin e kohëzgjatjes të procedurës, paraqet sinonim për nivelin e lartë të

¹²⁰ Ligji mbi medijacionin, neni 9, al. 5

¹²¹ Direktiva 2008/52/EC e Këshillit Europian dhe Parlamentit në aspekte të caktuara të medijacionit në çështje civile dhe tregtare, neni 7, al. 1

¹²² Bollen. K, Euwema. M, Munduate. L, (2016), Advancing Workplace Mediation through Integration of Theory and Practice, Springer International Publishing, Switzerland, fq.257

pëlqyeshmërisë të palëve dhe qytetarëve për zgjidhjen e kontesteve të tyre në kohë të shkurtë dhe me çmim më të ulët.

PARIMI I DREJTËSISË - "Drejtësia në të drejtën është e rëndësishme por edhe një çështje e përbërë dhe komplekse"¹²³. Por njëkohësisht ajo paraqet një ndër parimet më të rëndësishme dhe si e tillë parashihet edhe në grupin e parimeve tjera të procedurës të medijacionit në Ligjin mbi medijacionin. Prof. Dr Osman Kadriu parasheh faktin se zbatimi i këtij parimi garantohet në dy nivele: niveli i parë ka të bëjë me të vepruarit e drejtë të palëve në procedurën e medijacionit, niveli i dytë ka të bëjë me zbatimin e këtij parimi në zgjidhjen e kontestit¹²⁴. Ndarja në dy nivele të zbatimit të parimit të drejtësisë vjen si rezultat i asaj se në Ligjin për medijacion garantohet veprimi i drejtë në procedurë¹²⁵. Rol kyç ky parim i jep medijatorit si shtytës i zgjidhjes të drejtë të kontestit i cili duhet t'i inkurajoj palët që të bashkëpunojnë, të bisedojnë, të dëgjojnë njëri tjetrin me qëllim që të arrijnë një marrëveshje të përbashkët dhe të pranueshme për të dy palët. Që të mundet të zbatohet në mënyrë të drejtë ky parim në procedurën e medijacionit, paralelisht duhet të zbatohen edhe parimet tjera siç janë autonomia e palëve, barazia, paanësia, konfidencialiteti, përjashtimi i publikut, parimi i qasjes të informatave të procedurës të medijacionit në procedura tjera si dhe parimi i efikasitetit nga ana e medijatorëve ashtu edhe nga ana e palëve.

6. Medijatori dhe organizimi i medijatorëve në Rjepublikën e Maqedonisë

Në Republikën e Maqedonisë në 10 vitet e fundit është paraqitur një profil i një profesion të ri - MEDIJATOR. Medijatori nuk është gjykatës e as arbitër dhe nuk ka të drejtë t'i këshilloj palët por vetëm t'i ndihmoj ato. Medijatori si një profesion u paraqit në kohën më të përshtatshme të mundshme, në kohën kur Republikën e Maqedonisë dhe më gjërë e ka kapluar kriza ekonomike. Medijatorët janë persona të cilët zbatojnë procedurën e medijacionit, pra ai ka një rol mjaft të rëndësishëm për zbatimin dhe për suksesin e përfundimit të procedurës të medijacionit. Ai duhet të jetë person i pregaditur profesionalisht me njohuri të gjëra kulturore i cili do t'u mundësoj palëve një ambient të qetë dhe të këndshëm ku ato do të ndjehen të sigurt gjat bisedave të tyre si dhe gjat zgjidhjes të kontesteve të tyre. Medijatori pra u ndihmon palëve

¹²³ Кадриу, О, (2007), Осврт на некои новости на Законот за медијација, Адвокатура, Адвокатска Комора на Република Македонија, fq.35

¹²⁴ op. cit, fq. 35

¹²⁵ Ligji mbi medijacionin, neni 14, al. 1

që të arrijnë deri në marrëveshtjen e synuar, por pa ndërhyrë tek gjetja e zgjidhjes për kontestin e tyre dhe gjithmon duke u mbështetur në parimet e procedurës të medijacionit. Çështja e medijatorëve në Ligjin mbi medijacionin është e rregulluar në mënyrë të përpiktë në kreun e shtatë, sipas të cilës medijatori mundet të jetë çdo person i aftë për punë, i cili posedon licencë për kryerjen e punëve të medijatorit¹²⁶. Kështu, medijator mundet të jenë avokatë, jurist i diplomuar si dhe persona me profesione tjera me arsim të lartë të mbaruar të cilët kanë më së paku pesë vite përvojë pune, të kenë kryer trajnim për mediator, të mos kenë të shqiptuar masë për ndalesë të ushqimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës dhe kuptohet të jenë të regjistruar në Listën e emrave të medijatorëve¹²⁷. Njëra nga çështjet kyçe e cila i rregullon Ligji për medijacionin është çështja e licencimit të gjithë personave të cilët dëshirojnë të miren në të ardhmen me medijacion. Ky sistem është po aq i rëndësishëm përshkak të sigurimit të nivelit të caktuar të kualitetit të procedurës të medijacionit dhe të krijimit të kushteve për avancim permanent të medijacionit. Sipas al. dy të nenit 46 licenca parashihet t'i jepet personit i cili do t'i nënshtrohet provimit për kontrollin e njohurive teknike dhe të shkathtësive praktike të medijacionit para Komisioni për sigurim, ndjekje dhe vlerim të kualitetit të punës të medijacionit, dhe të njëjtët do t'i kaloj me sukses si dhe i cili do ta prezentoj marrëveshtjen e lidhur për sigurim nga përgjegjësia për dëmin. Bordi përbëhet nga 10 anëtar të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë: një anëtar i propozuar nga Dhoma e medijatorëve nga rradhët e medijatorëve, një anëtar i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë nga rradhët e gjyqtarëve, një anëtarë i propozuar nga Dhoma e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë nga rradhët e avokatëve, një anëtarë i propozuar nga Konferenca Interuniversitare nga rradhët e profesorëve të institucioneve të arsimit të lartë, një anëtarë i propozuar nga Dhoma e psikologëve të Republikës së Maqedonisë nga rradhët e psikologëve të diplomuar me licencë të veçantë për kryerjen e veprimtarisë në psikologji, një anëtarë i propozuar nga Ministri i drejtësisë nga rradhët e të punësuarve që punojnë në çështjet e mediacionit, një anëtarë i propozuar nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, një anëtarë i propozuar nga Ministria e Ekonomisë, një anëtarë i punësuar nga rradhët e dhomave ekonomike si dhe një anëtarë i propozuar nga Shoqata e konsumatorëve të Republikës së Maqedonisë (al.një, neni 57). Kryetari i Bordit emërohet nga ana e Qeverisë së Maqedonisë me mandat prej katër viteve. Gjithashtu edhe anëtarët e bordit

¹²⁶ Ligji mbi medijacionin, neni 46, al. 1

¹²⁷ Кадриу, О, op.cit, fq. 38

emërohen për periudhën prej katër viteve dhe të njejtit nuk mundën të emërohen më shumë se 2 herë të njëpasnjëshme¹²⁸. Medijatori përveç se duhet ta japin provimin për mediatorë¹²⁹, ai gjithashtu duhet t'i plotësoj edhe këto kushte të cilët janë të numëruara taksativisht në Ligjin për mediacion: të kenë fituar diplomë univerziater për kryerjen e arsimit të lartë VII/1 ose 300 kredi të fituar sipas Sistemit evropian për transfer të kredive në Republikën e Maqedonisë ose diplomë të marë në një shtet tjetër me 300 kredi të fituar dhe e nostrifikuar në shtetin tonë, të ketë kryer trajnimin e paraparë dhe të akredituar për trajnim të medijatorëve prej së paku 70 orë në Republikën e Maqedonisë ose jashtvendit me aktvendim të pranimit të trajnimit përkatës, të ketë se paku 3 vjet përvoj pune pas diplomimit, të ketë ndjekur së paku katër procedura për mediacion të zbatuar nga medijatori i cili do të jep vërtetim përkatës për pjesmarje, të ketë kryer testin psikologjik si dhe testin për integritet të dhënë nga personi i licensuar profesional si dhe personi i cili do të siguroj pesë rekomandime nga persona të tjerë të cilët në mënyrë profesionale e njohin personin si dhe i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë. Trajnimi i medijatorëve luan një rol të rëndësishëm në rritjen e kualitetit të procedurës të mediacionit si dhe në rritjen e aftësive të medijatorëve. Ligji për mediacion e parasheh si të detyrueshme kushtin e trajnimit të medijatorëve me qëllim të fitimit të licencës. Trajnimin për medijatorë e kryejnë trajnues të medijatorëve dhe si të tillë mundet të jenë të gjithë personat e aftë për punë të cilët posedojnë licencë për trajnim të medijatorëve¹³⁰. Trajnimi i medijatorëve definohet si edukim dhe aftësim i organizuar për fitimin e njohurive praktike dhe aftësive të cilët janë të nevojshme për kryerjen e punëve të medijatorit, vet, në mënyrë efikase dhe në mënyrë të

¹²⁸ Ligji mbi mediacionin, neni 58, al. 1

¹²⁹ neni 48 parasheh se provimin për mediatorë mundet ta japin personat të cilët Bordit i kanë paraqitur fletparaqitje për dhënie të provimit dhe të cilët i paguajnë shpenzimet për dhënie e provimit lartësia e të cilëve përcaktohet nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Provimi për mediatorë përbëhet nga tre pjesë: pjesa e parë ka të bëjë me kontrollin e njohurive dhe kuptimin e teorisë së përgjithshme, rregullat juridike me të cilat rregullohet veprimtaria e mediatorit, procedura e mediatorit dhe praktika për mediacion në bazë të testeve me shkrim, eseve dhe raporteve. Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga studimi i dy rasteve individuale për zbatimin e procedurës të mediacionit dhe pyetjeve që duhet personi t'u përgjigjet në bazë të analizës së rastit. Ndërsa pjesa e tretë e provimit realizohet nëpërmjet të intervistimit të personit me qëllim të vlersimit të cilësive të tij personale, karakteristikat dhe shkathtësitë e nevojshme dhe aftësitë e tij si mediator.

¹³⁰ al.1,2,3, neni 53 Licenca për trajnues u lëshohet personave të cilët në Bord do të dorëzojnë kërkesën për lëshim të licencës si dhe dëshmi për: trajnime të kryera për trajnues të mediatorëve prej gjithsej më pak se 32 orë në Republikën e Maqedonisë, të ketë diplomë univerzitare për arsim të lartë të kryer VII/1 ose 300 kredi të fituar sipas Sistemit evropian për transfer të kredive në Republikën e Maqedonisë, të ketë njohuri për mediacionin, zgjidhjen e konflikteve, pajtim dhe negociata, të jetë i regjistruar në Regjistrin e mediatorëve apo regjistrin përkatës nga shteti i huaj nëse aplikuesi është i huaj, regjistrim në Regjistrin për evidencë të procedurave për mediacion ose regjistri përkatës nga shteti i huaj nëse është shtetas i huaj për së paku 12 procedura të zbatuara për mediacion në tre vitet e fundit dhe së paku 2 rekomandime nga personat që profesionalisht e njohin aplikuesin dhe dëshmojnë për aftësitë e tij për bartjen e njohurive teorike dhe praktike.

suksesshme mbi gjithash. Programi bazë për trajnim, procedurën për akreditim të trajnimit dhe mbikqyrjen e trajnimit është e rregulluar me ligj respektivisht me nenin 54. Trajnimeve të medijatorëve u kushtohet një rëndësi të madhe në shtetet më të zhvilluara ku medijacioni përdoret në zgjidhjen e një numri të madh të kontesteve. Komisioni për Reforma në Drejtësi në raportin e tij rekomandon atë se trajnimi dhe akreditimi i medijatorëve është esenciale për sigurimin e kualitetit të procedurës të medijacionit¹³¹. Rezultatet e trajnimeve të medijatorëve në fund japin rezultate të papara për sa i përket fitimit të aftësive të medijatorëve. Në fillim medijatori duhet të lej tek palët një përshtypje të mirë me të cilën do të fitoj besim tek ato¹³². Si ilustrim i asaj se si fitohet përshtypja e mirë tek palët, tek Doracaku për trajnim të medijatorëve përmenden: mbajtja në mend e emrave të palëve, gjat bisedave shume shpesh të përdoren nga ana e medijatorit fjalë lavdëruese, fjalë inkurajuese si dhe fjalë falemenderuese për atë se palët kanë zgjidhur këtë metodë për zgjidhje të kontestit të tyre. Gjithashtu para së gjithash medijatori duhet të ketë aftësi së të KOMUNIKUARIT. Medijatorët janë "kujdestarët" e të komunikuarit rrjedhëhëm. Kur flitet për komunikimin, medijatori nuk duhet të ketë kujdes vetëm për atë se si ai komunikon, por edhe për komunikimin e palëve në procedurë. Medijatori duhet të ketë kujdesë që palët ndërmjet veti të komunikojnë në mënyrë të duhur sepse komunikimi i duhur në mes tyre përputhet me bashkpunimin ndërmjet tyre si dhe të ketë kujdes edhe për atë që komunikimi të jetë në atë nivel e cila do të siguroj zgjidhjen sa më të shpejtë të kontestit. Pra, gjat komunikimit duhet të ketë kujdes jo vetëm gjat asaj se çka flasin medijatori dhe palët, por gjithashtu edhe të ndigjohet bashkëbiseduesi pa mar parasysh a flitet për medijatorin apo për palët. Gjat komunikimit e rëndësishme është që mediatori të vendohet vet në pozitën e palës apo të palëve në mënyrë që më së miri dhe nga më afër të ketë qasje në situatën respektivisht problemin të cilën e ka pala apo e kanë palët. Gjat gjithë kohës mediatori duhet që të jetë dëgjues i mirë. Me termin dëgjues i mirë nënkuptohet të dëgjohet pala e cila ka marrë fjalën dhe i njejtë të mos ndërpritet der sa ta përfundoj fjalën. Gjithashtu në asnjë mënyrë nuk i lejohet medijatorit që gjat bisedimit me palët të jetë "dëgjues pasiv". Gjat seancave dhe zhvillimit të bisedimeve medijatori duhet të mundohet që koncentrimin e tij gjat dëgjimit të palëve të jetë në maksimum. Atij në asnjë mënyrë nuk i lejohet që pas mbarimit të bisedës të palëve të pohoj ose t'i përdor fjalët: "po", "aha" e të tjerë. Kjo është kështu pasi që medijatori gjat përdorimit të këtyre fjalëve

¹³¹ LRC 98-2010 pika 11.16

¹³² Прирачник за обука на медијатори за обновување на знаењата за медијација, Проект Матра подржуван од Амбасадата на Кралството Холандија

konsiderohet si i pranishëm fizikisht e jo edhe i koncentruar në atë se çka flitet gjat seancës. Çështja e "dëgjuesit pasiv" është e lidhur ngushtë dhe me "dëgjimin selektiv" e cila nënkupton dëgjimin e asaj apo dëgjimin e palës e cila informatë apo e cila palë është objekt interesimi për medijatorin. Kjo është një veti e cila duhet të përjashtohet nga aftësitë e komunikimit të medijatorëve, pasi që ajo edhe shkel parimin bazë të procedurës të medijacionit, parimin e paanësisë si dhe karakterisitikën e vetme të medijatorit e cila siguron një zgjidhje kualitative të çështjes kontestuese. Rrezik tjetër i dëgjimit selektiv është se medijatori gjat dëgjimit duke mos e dëgjuar një informacion të caktuar i cili në fakt paraqet informacion i një rëndësie të madhe për zgjidhjen e kontestit, të njëjtën mundet të mos e regjistroj gjat seancës me ç'rast do të rezultoj një zgjidhje jokualitative të kontestit. Aftësia për komunikim të mirë është edhe "mosmonopolizimi" i bisedës respektivisht t'u jepet hapsirë palëve ta shprehin mendimin e tyre, të dëgjohet bashkbiseduesi dhe të koncentrohet bisedimi në temat të cilët janë kyçe për problemin, në të cilën drejtim medijatori duhet të jetë mjaft fleksibil dhe të ndjek kahje të ndryshme gjat bisedimeve e jo striktë të qëndrohet bisedimi vetëm në një tem, të komunikohet në gjuhën të cilën munden ta kuptojnë palët dhe të mos përdoren terme të cilët janë profesionale dhe të cilët nuk do të munden të kuptohen nga palët. Gjithashtu gjat bisedës së palëve dhe medijatorit, medijatori nuk duhet të përdor terme apo karakteristika dhe gjeste të cilët janë irrituese dhe të njëjtat i iritojnë palët si për shembull gjat gjithë kohës të gestikuloj me duar apo të luaj me stilografin, e të tjera¹³³. Tjetër veti të cilën duhet ta ketë një medijator është "asertiviteti" apo aftësia e të mbrojturit të asaj çka dëshiron, pra deklarimi i asaj se çka një person dëshiron por në mënyrë të hapur. Mirpo në këtë rast qëllimi nuk është që të sigurohet fitorja, por qëllimi është që të gjendet zgjidhja dhe të nxiret rezultati më i mirë. Pra asertiviteti në asnjë mënyrë nuk duhet të nënkuptoj agresivitet. Te mediacioni asertiviteti do të thotë që mediatori por edhe palët të respektojnë së pari veten por edhe të tjerët, të munden t'i shprehin dëshirat e tyre dhe nevojat lirshëm pa asnjë ngurim, të mundet t'i realizojnë të drejtat e tyre në procedurën e medijacionit në mënyrë të qetë, pa përdorim të forcës dhunës dhe pa kërcënim. Ajo e cila i bën të dallojnë personat të cilët janë asertiv nga personat të tjerë është se ato janë persona të qetë dhe të cilët aspak nuk i duan situatat konfliktuoze. Gjat komunikimit medijatori duhet shpesh herë gjat bisedimit me palët të ndaloj dhe të "përmbledh" atë çka është folur deri në një pikë. Me anë të përmbledhjes medijatori jep një pasqyrim të asaj se çka është thënë deri më atëherë, me çka i

¹³³ op.cit fq. 16

jepet mundësi palëve që të pohojnë ose mohojnë thëniet e tyre me ç'rast medijatori do tu lejoj hapsirë që të njejtit të sqarohen. Gjat përmbledhjes medijatori shpesh e parashtron pyetjen: "Nëqoftë se ju kam kuptuar mirë, ju thatë ..."¹³⁴. "Parafrazimi" gjat bisedës të medijatorit me palët duhet të përdoret shpesh pasi që në atë mënyrë medijatori u'a bënë me dije palëve se i dëgjon me kujdes dhe në mënyrë aktive. Në këto raste medijatori duke përdorur fjalë të veta përsëritën atë që është thënë nga palët. Edhe "rishikimi" si aftësi e medijatorit edhe pse një ndër aftësitë e komunikimit më të vështira dhe më e sofistikuar për përdorim, është edhe shumë e rëndësishme njëkohësisht. Kjo është kështu pasi që ajo përfshin marjen e një deklaratë apo thënie dhe fokusimi në vetëm një segment të sajën e cila duhet të negociohet apo të zgjidhet. Qëllimi i kësaj aftësie të medijatorit është që negativja të bëhet pozitive respektivisht ankesa të bëhet e negociueshme për palët. Medijatori duhet të përdor edhe "degjimin empatik" si një aftësi tjetër të tijën e cila paraqet bazën e aftësive dhe kualiteteve të cilët një medijator duhet t'i posedoj. Duke e përdorur këtë lloj të dëgjimit medijatori shumë shpejt e fiton besimin tek palët, duke pohuar se ai është në rrjedha se çka ndodhë dhe se e kupton perspektivën e palëve, nevojat, vendimet dhe ndjenjat e tyre. Ky lloj i dëgjimit formon një rreth të mbyllur të komunikimit e cila kërkon që ndëgjuesi të demonstroj kuptimin e asaj se çka është thënë më herët si nga ana e medijatorit ashtu edhe nga ana e palëve, duke reflektuar përbërjen e mesazhit të biseduesit. Si dëgjues empatik, medijatorët shpesh herë edhe duhet të kenë kujdes që t'i kushtojnë rëndësi të veçantë asaj çka fshihet pas një përbërjes emocionale të pathënë të palëve. Aftësia e fundit e medijatorit e cila do të trajtohet është "sublimimi". Me anë të sublimimit medijatori e përmbledh gjithë atë e cilë i është paraqitur palës e cila është bashkbiseduese, por në pika kryesore dhe të shkurtëra. Medijatorët gjat seancave të bisedimeve duhet edhe të "parashtrajnëpyetje". Me këtë nuk nënkuptohet vendosja nën hetim të palëve, respektivisht t'i turpëroj apo t'i poshtëroj palët. Pyetjet janë mjet i fuqishëm për vendosjen e fokusit në relevancën e çështjeve. Medijatorët munden të parashtrajnë pyetje në mënyra të ndryshme. Pyetjet e hapura janë një mënyrë perfekte të të provokuarit të palëve për të biseduar hapatazi, e sidomos kur duhet të tregojnë anën e tyre të ndodhisë. Kjo arrihet me parashtrimin e kësaj pyetje: "Si i shikon gjërat?". Pyetjet e mbyllura përfundojnë me përgjigje të tipit "po" ose "jo" ose fraza të shkurtëra. Kështu në rast të pyetjeve të mbyllura nga ana e medijatorëve më së shpeshti përdoret pyetja "A u ndihmon kjo?". Pasi që palët janë përgjigjur, mediatorët kanë mundësi të parashohin se çka do të ndodh më pas.

¹³⁴ op. cit, fq. 17

Gjithashtu të rëndësishme së madhe janë edhe "pyetjet hetuese" të cilët e ndihmojnë mediatorin që ta kuptojnë dhe shohin çështjen më në thellësi. Si pyetje hetuese ose më e shpeshtë e cila përdoret nga ana e medijatorëve është pyetja "pse?". Përveç pyetjeve hetuese, të rolit të madh janë edhe "pyetjet kryesore" të cilët janë të nevojshme kur medijatori dëshiron të konfirmoj diçka apo të vërtetoj ndonjë hipotezë. Në këto raste medijatori më së tepërmi e përdorën pyetjen "a jam i sakt në propozimin se ...?". Pra medijatori në asnjë mënyrë nuk duhet të parashtrojë pyetje për gjera dhe informata për të cilat është kureshtar që ti dijë, por pyetjet duhet të parashtrohen në atë drejtim që të nxiren në pah informatat kyç të cilët do të ndihmojnë në zgjidhjen e kontestit.

Medijatorët në Republikën e Maqedonisë organizohen në Odën e medijatorëve të Republikës së Maqedonisë. Oda e medijatorëve ka status të personit juridik me seli në qytetin e Shkupit. Organ më i lartë i Odës të mediatorëve është Kuvendi i Odës¹³⁵. Oda e medijatorëve ka një funksion mjaft të rëndësishëm: mbron nderin e medijatorëve dhe kujdeset që medijacioni të zbatohet në pajtim me parimet themelore të procedurës të medijacionit të parapara me Ligjin mbi medijacionin dhe në përputhje me Kodeksin etik të medijatorëve, si dhe të ndërmiren hapa dhe veprime për përparimin dhe promovimin e medijacionit në Republikën e Maqedonisë. Sipas nenit 38 Kuvendin e Odës e përbëjnë të gjithë medijatorët e licencuar të regjistruar në Listën e emrave të mediatorëve. Kuvendi i Odës kryen disa punë të cilët në mënyrë të përpiktë janë të parapara në Ligjin për medijacionin dhe atë: sjell Statutin e Odës, sjell Kodeksin Etik të medijatorëve, miraton programin për punë të Odës, miraton programin vjetor për punë të Bordit, debaton për çdo kundërshtim, parashtresë, ankesë apo propozim nga Bordi Drejtues ose cilido anëtar i Dhomës në situata kur ngrihet procedurë për përjashtim të anëtarëve apo shlyerje të medijatorëve nga Lista e emrave të medijatorëve, gjithashtu regjistron dhe shlyen medijatorë nga Lista e emrave të mediatorëve, debaton për çështje që kanë të bëjnë me qëllimet dhe detyrat e Odës, miraton Rregulloren e punës së Kuvendit të Odës, zgjedh kryetarin e Odës, i zgjedh anëtarët e Bordit Drejtues, i zgjedh anëtarët e Bordit mbikqyrës, kujdeset për shfrytëzimin me kujdes të mjeteve financiare, vendos për lartësinë e taksës së anëtarësisë, mënyrën e pagimit dhe shfrytëzimin e tyre si dhe kryerjen e punëve të tjera të caktuara me ligj dhe me Statutin e Dhomës të medijatorëve.

¹³⁵ Ligji mbi medijacionin, neni 37, al. 1

Organe tjera të Odës së medijatorëve janë: Kryetari, Bordi Mbikqyrës dhe Bordi Drejtues. Për Kryetar zgjidhet kandidati i cili mer shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit¹³⁶. Procedura e zgjedhjes të Kryetarit të Odës është e rregulluar me ligj¹³⁷. Kryetari është ai i cili e prezenton dhe e përfaqëson Odën e medijatorëve. Ai njëkohësisht sipas funksionit është edhe kryetar i Bordit Drejtues. Kryetari zgjidhet me mandat prej 2 vitesh me mundësi të rizgjedhjes edhe të njëhershme. Kryetari i Odës ka për detyrë të nënshkruaj të gjitha vendimet e Kuvendit dhe të Bordit Drejtues. Në mungesë të Kryetarit, me autorizim apo vendim të Bordit Drejtues, Odën mundet ta përfaqësoj çdo anëtar i Bordit Drejtues¹³⁸. Organ tjetër i Odës së medijatorëve është edhe Bordi Mbikqyrës. Si organ i tillë ka tre anëtarë të zgjedhur nga ana e Kuvendit të Odës në bazë të procedurës të paraparë për zgjedhje të anëtarëve të Odës në nenin 39 me mandat prej dy viteve me mundësi për rizgjedhje edhe të njëhershme. Alinea e parë e nenit 40 paraqet funksionin kryesor të Bordit Mbikqyrës sipas të cilit ky Bord përcjell zbatimin e dispozitave të Ligjit për mediacion, të Statutit të Odës dhe akteve tjera të përgjithshme të DODës nga ana e organeve dhe trupave të Odës si dhe kontrollon edhe punën materiale dhe financiare të Odës të medijatorëve. Përveç Bordit Mbikqyrës, organ tjetër i Odës është edhe Bordi Drejtues si organ egzekutiv i Kuvendit. Numri i anëtarëve të Bordit drejtues rregullohet me Statut të Odës ndërsa mandati rregullohet me Ligjin mbi mediacionin sipas të cilit mandati zgjat dy vite me mundësi rizgjedhje edhe njëherë. Bordi drejtues përfshin një sferë të gjërë të funksioneve. Ajo i pregadit mbledhjet e Kuvendit të Odës, përcakton propozim të Statutit dhe të akteve tjera të Odës, zbaton politikën dhe realizon konkluzionet dhe vendimet e miratuara nga Kuvendi i Odës, kujdeset për pagesat respektivisht arkëtimin e taksës të antarësisë, menaxhon dhe përgjigjet për mjetet dhe pronën e Odës si dhe përpilon propozim të llogarisë periodike dhe vjetore. Gjithashtu Bordi Drejtues meret edhe me çështjet teknike të ndryshme si për shembull: u jep ndihmë profesionale anëtarëve të Odës për përparim të praktikës në zbatimin e mediacionit, përcjell zbatimin e rregulave më rëndësi për mediacionin, publikon studime, përmbledhje të punimeve, doracakë profesional dhe dokumente tjera në sferën e mediacionit, organizon takime shkencore dhe profesionale për mediacionin, e informon publikun për mediacionin si dhe kryen punë tjera

¹³⁶ Ligji mbi mediacionin, neni 39, al. 9

¹³⁷ Nëse kandidatët për kryetar nuk marrin numrin e mjaftueshëm të votave, organizohet rrethi i dytë i votimit, në të cilën hyjnë dy kandidatët të cilët kanë numër më të madh të votave. Për kryetar të zgjedhur në rrethin e dytë llogaritet kandidati i cili ka mar më shumë vota nga anëtarët e pranishëm në Kuvend zgjedhor, por jo më pak se 1/4 i numrit të përgjithshëm i anëtarëve të pranishëm në Kuvend zgjedhor. Nëse edhe në rrethin e dytë nuk zgjidhet kryetari, procedura do të përsëritet për herë të tretë.

¹³⁸ Ligji mbi mediacionin, neni 42, al. 1, 2, 3, 4

të rëndësishme të përcaktuara me Ligjin mbi medijacion, Statutin e Odës dhe aktet e përgjithshme të Odës së medijatorëve¹³⁹.

PJESA E DYTË

III Medijacioni VS Procedura kontestimore

Në sistemet juridike dhe në përditshmëri, rastet kur të drejtat subjektive të qytetarëve kërcënohen por edhe lëndohen gjithashtu, kërkohet që t'u jepet mbrojtje juridike. Rastet më të shumta të cilëve u jepet mbrojtje realizohet në procedura gjyqësore respektivisht procedura kontestimore. "Procedura kontestimore paraqet mënyrën e rregulluar me ligj të të vepruarit të gjykatës, palëve dhe pjesmarësve tjerë në procedurë, drejtuar kah një qëllimi të caktuar – mbrojtjen e të drejtave subjektive civile të lënduara apo të kërcënuara"¹⁴⁰. Procedura kontestimore paraqet institucionin më të lashtë juridik e cila paraqet metodën primare për zgjidhjen e kontesteve civile nga e cila pastaj rrjedhin procedurat tjera siç janë ajo penale si dhe administrative në kohrat më të fundit¹⁴¹.

Procedura kontestimore në përbërjen e saj karakterizohet me disa pika të cilët e bëjnë të dallohen nga procedurat tjera duke filluar nga ajo se procedura kontestimore është një metodë e rregullt dhe metodë bazë për dhënien e mbrojtjes të organizuar atëherë kur dikujt i lëndohet apo i kërcënohet apo edhe kur ndonjëherë i mohohet ndonjë e drejtë subjektive civile. Pika tjetër e cila i'a përcakton karakterin procedurës kontestimore është edhe ajo se paraqet procedurë ku dhënia e mbrojtjes juridike jepet gjithmonë si rezultat i sjelljes të vendimit të sjellë nga ana e gjykatës kompetente respektivisht është procedurë kognicite. Dhe pika apo karakteristika e fundit është ajo se gjat procedurës kontestimore gjithmonë zgjidhet ndonjë raport apo marrdhënie kontestuese edhe pse janë të një numri të konsiderueshëm edhe rastet të cilët nuk janë edhe aq konfliktuoze apo ndonjëherë mundet të thuhet se kur nuk egziston aspak kontest apo konflikt në mes të palëve por të cilët edhe përkundër kësaj ato përsëri zgjidhen në procedurë kontestimore para gjykatave

¹³⁹ Ligji mbi medijacion, neni 41

¹⁴⁰ J. Арсен, К. Зороска, Тајјана, Граѓанско процесно право, Книга прва, Парнично Право, Правен факултет "Јустиниан Први" Скопје, 2009, fq. 59

¹⁴¹ Čaliја. В, Омановић. S, (2000), Граѓанско процесно право, Универзитет у Сарајеву - Правни факултет, fq. 6

kompetente. Si të tilla janë përshembull: shkurrorëzimi i martesës ku palët të njejtën e kërkojnë me propozim të përbashkët.

Sistemet juridike të shumë shteteve të ndryshme gjithmon janë përpjekur të gjejnë mënyra tjera më efikase dhe në të njejtën kohë më të lehta për të arritur deri te e drejta, kështu duke u dhënë qytetarëve mundësi që të mundet të zgjedhn në mes metodave të cilët mbështeten në parime të ndryshme të dhënies të mbrojtjes juridike respektivisht të zgjedhin në mes të procedurave të rregullta gjyqësore dhe metodave tjera jashtëgjyqësore siç është medijacioni në këtë rast. Në shumë bashkësi shoqërore sidomos në vitet e fundit ka filluar afirmimi dhe promovimi i metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve, përfshirë këtu edhe shteti i Republikës së Maqedonisë. Kjo situatë është si rezultat i kërkesës së madhe dhe nevojës së madhe për t'u përballur me problemet e gjyqësorit të cilët nuk mundemi aspak t'i mohojmë. Kështu që sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë si shumë sisteme tjera, u'ajep mundësinë e zgjidhjes në mes të zgjidhjes të kontestit nga ana e aparatit gjyqësor dhe metodave tjera jashtëgjyqësore apo metodave tjera alternative siç janë: arbitrazhi apo medijacioni. Kështu, është e pashmangshme të mos bëhet analiza në aspektin retroaktiv e mënyrave paqësore të zgjidhjeve të kontesteve para sjelljes të Ligjit për Medijacionin.

Në LPK janë të parapara rregulla ligjore të cilët e rregullojnë çështjen e zgjidhjes të kontesteve në mënyrë paqësore pa patur nevojë që e njejtat të trajtohet dhe të zgjidhet në të gjitha fazat e procedurës, respektivisht të zgjidhet kontesti me anë të pajtimit¹⁴². Pasi që gjyqtari është i obliguar t'i njoftoj palët për mundësinë e aritjes të një zgjidhjeje të përbashkët për problemin e tyre dhe t'i ndihmojë ato gjat këtij procesi mundet të thuhet se këtu flitet për detyrën e një gjyqtari që të përpiqet të zgjidh konfliktin që e ka para vetes në mënyrë paqësore. Pra, gjat praktikës gjyqësore shpesh paraqiten ato raste të cilët nga vet natyra nuk mundet të konsiderohen aspak konfliktuoze, por prap se prap të njejtat zgjidhen në procedurë kontestimore. E tillë është kontesti kur palët lidhin pajtim gjyqësor si dhe më të shpeshta njihen rastet kur bashkëshortët përfundojnë martesën e tyre në rrugë të marrëveshtjes me anë të propozimit për shkurrorëzim nga ana e të dyve.

Edhe në Ligjin mbi familjen përdoret termi “pajtim“ e cila është një metodë paqësore e zgjidhjeve të kontesteve në këtë rast të kontesteve familjare. Në kreun e dytë të pjesës së tretë të

¹⁴² Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 30, al. 1

këtij ligji parashihet procedura e zgjidhjes të kontesteve familjare e cila gjithmon inicohet me padi respektivisht padi e bazuar në një marrëveshje për shkurorëzim të martesës nga ana e të dy bashkëshortëve. Pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose padive për shkurorëzim me anë të marrëveshjes të përbashkët të bashkëshortëve zbatohet procedura për pajtim të bashkëshortëve martesor¹⁴³. Sipas këtij neni gjykata është kompetente që të urdhëroj mbajtjen e seancave të pajtimit në mes të bashkëshortëve dhe më këtë rast të caktoj seancë të veçantë nga ana e kryetarit të këshillit në rastet kur bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë mbi të cilëve është vazhduar e drejta prindërore, si dhe kur i njëjti vleron se mbajtja e një séance të veçantë është e rëndësishme të madhe për të vendosur vet. Në të kundërtën, pra në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore, procedurën e pajtimit e zbaton Qendra për Punë Sociale, procedurë e rregulluar me ligj. Para sjelljes të Ligjit për medijacion, çështjen e zgjidhjeve paqësore të kontesteve e rregullonte edhe Ligji për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar të Republikës së Maqedonisë. Me këtë ligj për herë të parë flitet për zgjidhjen e kontesteve jashtëgjyqësore me theks të veçantë për procedurën e pajtimit me ç’rast palëve u jepet mundësia e zgjidhjes të kontestit të tyre nëpërmjet të arbitrazhit dhe metodave tjera alternative të zgjidhjeve të kontesteve. “Arbitrazhi është secili arbitrazh pa dallim nëse organizimi i tij është besuar një institucioni të përhershëm arbitrazhi“¹⁴⁴ e cila nënkupton faktin se arbitrazhi është një lloj mehanizmi për sjellje të vendimeve për rastet kur pjesmarësit në qarkullimin tregtar-ndërkombëtar nuk mundet të arrijnë marrëveshje në mes tyre. Me shumë bindje mundet të thuhet se arbitrazhi paraqet një procedurë të rregullt në kushtet bashkëkohore të tregtisë ndërkombëtare e cila në mas të madhe dhe si duket tërësisht e ka zavendësuar procedurën e rregullt gjyqësore. Përderisa gjykatat shtetërore krijohen nga ana e shtetit si të përhershme respektivisht si organe permanente tek të cilët palët gjithmon drejtohen kur ato kanë nevoj për mbrojtje juridike të të drejtave të tyre subjektive, nga ana tjetër arbitrazhi funksionon më ndryshe. Gjykata e arbitrazhit konsituohet për secilën rast dhe lëndë veçmas nëpërmjet të emrimit të arbitërve ose arbitrit të cilëve u besohet zgjidhja e kontestit.

Incijativa për futjen e metodave alternative për zgjidhjen e kontesteve përfshirë këtu edhe futjen e medijacionit në Republikën e Maqedonisë ka ndikuar në një rën anënga proceset integrative në Unionin European, ndërsa nga ana tjetër përshkak të problemit të mosfikasitetit të

¹⁴³ Ligji mbi familjen. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 153, 20.10.2014, neni 237

¹⁴⁴ Ligji mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 39, 07.04.2006

gjykatave gjë që ka kontribuar në aktivitetin e përshpejtuar ligjvënës të shtetit për gjetjen e metodave paqësore të zgjidhjeve të kontesteve. Kur jemi te mosefikasiteti i gjykatave, respektivisht te moszgjidhja e rasteve brenda afatit të arsyeshëm ose edhe brenda kufirit të sipërm të afatit të arsyeshëm, mundet të thuhet se problem i tillë nuk është vetëm problem i legjislacionit të Republikës së Maqedonisë, por problem i legjislacioneve të shumta në përgjithsi e sidomos në vendet e rajonit. Për të trajtuar problemin e efikasitetit të gjykatave me të madhe punohet në nxitjen e palëve që problemet dhe kontestet e tyre t'i zgjidhin jasht gjykatave nëpërmjet të negociatave dhe me ndihmën e personave të tretë neutral – arbitër apo medijator¹⁴⁵.

Se punohet në atë drejtim që të arrihet efikasiteti i gjyqësorit dhe shkarkimi i gjykatave në Republikën e Maqedonisë flasin edhe ndryshimet të cilët vlejné të theksohen si përshembull: shkarkimi i gjykatave nga lëndët kontestimore dhe bartja e autorizimeve noterëve sit ë besuar të gjykatave ose edhe ajo e cila trajtohet në këtë punim, nxjerja e Ligjit mbi medijacionin e cila pikënisjen e kanga stërngarkimi i gjykatave dhe numrit të madh të lëndëve të cilët duken se çdo ditë është më i madh dhe më i madh, sidomos për këtë fakt flet edhe aktiviteti i madhi insitucioneve dhe gjykatave njëkohësisht për reforma në gjyqësor me ç'rast janë ndërmarrë një numër i madhi intervenimeve të cilët kanë një qëllim të vetëm – zgjidhjen e joefikasitetit të gjykatave. Si intervenime të tilla konsiderohen intervenimet e Ligjit mbi procedure kontestimore të cilët janë në fakt të shumta, miro ato të cilët mendohet se janë vendimtare për aritjen e efikasitetit të gjyqësorit janë: neni dy i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurën kontestimore i vitit 2010¹⁴⁶ i cili ndryshon alinenë e parë të nenit 10 e cila thekson se gjyqi është i obliguar që procedurën ta zbatoj pa vonesë në afat të arsyeshëm më më pak shpenzime dhe të pamundësoj çdo keqpërdorim të të drejtave të palëve në procedurë si dhe alinea dy të po të njejt

¹⁴⁵ Përveç inkuadrimit të metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve jasht gjykatave, si mënyrë e përmirësimit të mosefikasitetit të gjykatave parashihen edhe: reformat e rregullave procedural (ndryshimi i normave procedural dhe i mënyrës të të vepruarit të gjykatave gjat zgjidhjes të kontesteve më qëllim të përshpejtimit të procedurës), dhënien e autorizimeve shërbimeve publike dhe shtetërore nga ana e gjykatave (si përshembull noterëve) sidomos për ato lëndë të cilët nuk janë ekskluzivisht gjyqësore, ndryshimet e organizimit të gjyqësorit në nivel nacional respektivisht ndryshimet në systemin e drejtësisë ose ndryshimet në nivelin e gjykatave individuale, zhvillimi teknik dhe logjistik e cila nënkupton përdorimin e teknikave të reja e sidomos në IT sektorin, reorganizimin e shërbimeve dhe të regjistrimit gjyqësor, programeve dhe trajnimeve më të shpeshta për krijimin e kualiteteve në kuptimin e njerëzve dhe fytyrave të reja në gjyqësor me anë të edukimit permanent, të përparuar dhe të specijalizuar; V.Uzelac, (2004), A Accelerating Civil Proceedings in Croatia – A history of attempts to improve the efficiency of civil litigation, C.H, van Rhee, History of Delays in Civil Procedure, Maastricht, fq. 283-313

¹⁴⁶Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurë kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 116, 01.09.2010

nen ku parashihen dënimet në të holla 700 deri 1000 euro në kundërvlerë në denarë për personin juridik i cili do t'i keqpërdor të drejtat të cilët i atkojnë në procedurë. Intervenim tjetër i cili ka bërë një hap të madh është edhe Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurën kontestimorei vitit 2015¹⁴⁷ me të cilën është ndryshuar respektivisht është plotësuar neni 461 ku përveç alinesë njëeshtë shtuar edhe alinea dy e cila thekson se në kontestet tregtare me kërkesë në para vlera e së cilës nuk e tejkalon shumën prej 1 milion denarë, e për të cilët procedura ngritet me padi para gjykatës, palët janë të obliguar që para paraqitjes së padisë të tentojnë kontestin ta zgjidhin me anë të medijacionit. Ndërsa alinea tre parasheh obligimin e paditësit që gjat paraqitjes të padisë të bashkangjisë deklaratë me shkrim të lëshuar nga medijatori, se tentimi për zgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit nuk ka pasur sukses.

Sot jeta është shumë dinamike në atë kuptim se shumë më pak e më pak kanë njerzit kohë të lirë dhe të mjaftueshme për obligimet e tyre, gjë që e bënë më të vështirë arritjen e tempos të zhvillimit të jetës në aspektin e drejtësisë. Për atë shkak edhe njerëzit sot insistojnë në shpejtësinë dhe efikasitetin e zgjidhjes të kontesteve e cila në fakt ndonjëherë paraqet tehun tjetër e një shpate e cila edhe nuk miret shpesh parasyshë. Thuhet kështu pasi që shpesh herë niset nga zgjidhja sa më të shpejtë të kontestit e jo të gjetjes të vërtetë dhe të drejtësisë, pra ndonjëherë këmbëngulja për efikasitetin e lartë të gjyqësorit, në një farë mënyre apo mase nënkupton braktisjen e drejtësisë e cila duhet të menjanohet patjetër. Pra në të drejtë, këtu nuk mundemi të flasim për një system efikas në qoftë se një vendim i sjellur nuk është aq kualitativ kur kemi me një të drejtë jo të plotë. Por gjithashtu edhe kur kundërta ndodh, dmth në procedurë të stërzgatur vihet një drejtësi e plotë me plotkuptimin e fjalës, pikërisht edhe në këto raste nuk kemi sistem efikas për arritjen e drejtësisë pasi që zvarritja e gjatë e drejtësisë me një fjalë është padrejtësi dhe njëjtë edhe arritja e një rezultati jo komplet dhe i padrejtë të themi, gjithashtu konsiderohet padrejtësi. Pra, joefikasiteti është e barabartë me padrejtësinë dhe është në kundërshtim me parimet në bazë të të cilave funksionojnë gjykatat.

Në pajtueshmëri me Strategjinë për Reformat e sistemit të drejtësisë të viteve 2004 – 2008, me të vetmen qëllim shkarkimin e gjykatave nga numri i madhi lëndëve si dhe me qëllim të përcaktimit të Republikës së Mqedonisë për integrim në Bashkimin Evropian u promovua sjellja e Ligjit mbi Medijacionin në vitin 2006. Menjëherë pas sjelljes të këtij ligji e cila ishte e

¹⁴⁷ Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi procedurë kontestimore, nr. 124, 23.07.2015

pregaditur në përpuethshmëri të standardeve të Bashkimit Evropian dhe si një model evropian, hap tjetër ishte formimi i Odës të Medijatorëve të Republikës së Maqedonisë dhe njëkohësisht të organeve të saja. Është e pashmangshme të mos përmendet fakti se gjat gjith hapave në të cilët në atë kohë ecte medijacioni gjat krijimit të saj, përkrahje kishte nga Korporata ndërkombëtare financiare si anëtare e Banës Botërore e cila gjat gjithë kohës siguronte mbështetje teknike dhe këshilldhënëse lidhur me nxjerjen e përpilimin e ligjit. Edhe Ministrija e Drejtësisë nuk ishte indiferente gjat kësaj periudhe, e cila gjat gjithë kohës u angazhua nëpërmjet të zbatimit të programeve për zgjidhje alternative të kontesteve. Projektet përveç përpunimit të Ligjit të parë mbi medijacionin gjithashtu përfshinin edhe trajnimin e medijatorëve, themelimin e Qendrës për medijatorë si dhe kampanjë publike për promovimin e medijacionit. Qëllimet të cilët kanë qenë prioritet që të plotësohen ishin: qëllimet të cilët gjithmon janë marë si piknisje në implementimin e metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve, përfshirë këtu edhe përmirsimin e efikasitetit të drejtësisë, zvoglimin e shkallës të ngecjeve të gjykatave në zgjidhjen e lëndëve përshkak të mbingarkesës me lëndë gjyqësore dhe shkarkimi i tyre nga ato lëndë, qasja më e lehtë dhe më e shpejtë e palëve me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të kontestit, dhënies palëve mundësinë që të kenë një rol kyç në zgjidhjen e kontestit të vt gjë që i jep palës guxim dhe vetbesim që t'i njohin dhe t'i kuptojnë nevojat e tyre dhe në bazë të tyre të gjejnë një rrugë për zgjidhjen e kontestit, fokusimi në interesin e përbashkët të palëve me ç'rast kemi një transformim të interesit personal të palëve në atë të përbashkët për të dyja palët e cila në fakt është një mundësi që medijacioni u'a jep palëve si dhe mundësia që palët kanë që vet ta kenë kontrollin në duart e tyre për të zgjidhur kontestin e tyre për mbrojtje të interesave të tyre pa mos patur ndikim nga faktorët e jashtëm shoqëror si për shembull: social, moral, kulturor apo edhe ato ligjor.

1. Subjektet në procedurë

Subjektet në procedurë janë faktori kyç pa të cilët nuk do të kishte kontest dhe me këtë as edhe një procedurë qoftë ajo kontestimore, jokontestimore dhe në këtë rast as edhe procedurë të medijacionit. Subjektete në procedurë konsiderohen edhe pjesmarës në procedurë të cilët ushtrojnë detyra të caktuara dhe të cilët zejn vend të caktuar në pajtueshmëri me ligjin. Të fillojmë me procedurën kontestimore si metodë bazë për dhënien e mbrojtjes juridike të të drejtave subjektive – civile të lënduara apo të kërcënuara. Në kuptim më të gjërë me termin

subjekt në procedurë mundet të konsiderohen palët, gjykata dhe subjektete tjera¹⁴⁸. Kështu që mundet të thuhet se procedura kontestimore paraqet një raport të krijuar brenda një trekëndëshi ku secili kah përfaqësohet nga paditësi, i padituri dhe gjykata si subjekte të cilët konsiderohen si subjekte kryesore apo primare në procedurën kontestimore¹⁴⁹. Pra, si rezultat i këtij raporti, nga gjykata si subjekt kryesor kërkohet të jap mbrojtje juridike me qëllim të mbrojtjes të drejtës e cila konsiderohet e lënduar apo e kërcënuar si rezultat i pretendimeve të paditësit kundrejt palës tjetër të paditurit. Në literaturën juridike shpesh herë jepet definimi i nocionit palë në procedurën kontestimore e cila nuk jepet nga ana e ligjit por e cila deri diku nënkuptohet nga rregullat të cilët i përcaktojnë ato rregulla që përcaktojnë faktin se kush mundet të jetë palë në procedurë. Literatura bën ndarjen e definimit të nocionit të palëve në aspektin material, proceduralo – juridik dhe atë funksional të cilët do të shtjellohen veç e veç.

Në aspektin materijalo – juridik, më thjeshtë shprehur, palë në procedurë kontestimore është ajo palë për të drejtat dhe interesat e të cilit vendoset në atë procedurë. Pra, palët fitojnë statusin e palëve kontestimore në raportin materialo – juridik me vet paraqitjen e tyre për zgjidhjen e kontestit të tyre. Kjo don të thotë se rasti më i shpeshtë kur palët pjesmarës në raportin materijalo – juridik bëhen palë në procedurën kontestimore është kur kontestin e tyre e paraqesin në gjykatë dhe nga i njejtë kërkojnë dhënien e mbrojtjes të nevojshme juridike për të drejtat e tyre subjektivo - civile. Nga dhënia e definicionit për palë në procedurën kontestimore përveç gjykatës si palë primare, përmendet edhe fakti se palë mundet të jenë ato në emër të të cilave zbatohet procedura respektivisht paditësi dhe të paditurit, pala e cila mer pjesë në kontestin si bartës i të drejtave dhe të obligimeve ose si ndonjë person i cili në raportin materijalo – juridik mer pjesë si palë e cila ka lënduar apo kërcënuar ndonjë të drejtë të palës tjetër. “Kjo nënkupton se palët kontestimore janë bartës të autorizimeve materijalo – juridike respektivisht bartës të obligimeve materijalo – juridike për të cilët edhe shqyrtohet procedura“.¹⁵⁰ Në praktikë

¹⁴⁸ Përveç palëve dhe gjykatës, në procedurën kontestimore marin pjesë edhe subjekte tjera të cilët si zakonisht kanë role të ndryshme dhe pjesmarja e tyre në procedurë është për përmbushjen e qëllimeve të ndryshme. Si të tilla janë: përfaqësuesit e palëve, medijatorët, dëshmitarët, ekspertët, procesmbajtësit, interpretuesit, përkthyesit etj. Disa prej tyre marin pjesë në procedurë që t’i mbrojnë interesat e tyre juridike, disa marin pjesë me të vetmin qëllim që palës t’i ndihmojnë që në mënyrë të drejtë ta vërtetojnë gjendjen faktike ose t’ia japin ndihmën e nevojshme palës nga aspekti profesional dhe teknik për zgjidhje të kontestit e të ngjajshme. J. Арсен, К. Зороска, Татјана, вep. cituar, fq. 121

¹⁴⁹ Ibid, fq. 121

¹⁵⁰ Ibid, fq. 168

ky definim nuk përdoret pasi që e njëjta konsiderohet mjaft e vjetëruar. Është kështu përshkak të asaj se teorinë e të drejtës procedurale nuk i përshtatet nocionit të palëve në aspektin materijalo – juridik pasi që nocionet dhe institucionet e të drejtës procedurale definoohen me ndihmën e nocioneve materijalo – juridike dhe në atë mënyrë mundet të vij deri në përzierjen e nocioneve të të drejtës materijalo – civile me nocionet e të drejtës proceduralo – civile¹⁵¹.

Nocioni i palëve mundet të kuptohet edhe në aspektin proceduralo – juridik. Në këtë aspekt asnjëherë nuk niset nga përcaktimi i raportit materijalo – juridik në mes të palëve e cila ka si pasojë kontestin. Sipas prof. Arsen Janevski nocioni palë në aspektin proceduralo – juridik është e përcaktuar me rregullat e të drejtës procedurale¹⁵². Kjo është kështu pasi që për t’u përcaktuar nocioni i drejtë dhe i saktë i nocionit palë në aspektin proceduralo – juridik nuk është me rëndësi egzistimi i raportit materijalo – juridik por pozita që palët kanë në procedurë respektivisht në marrdhënien proceduralo – juridike. Si rezultat i kësaj në pozitën e paditësit në bazë të të cilës kërkon ndonjë mbrojtje të caktuar nga ana e gjykatës ndërsa në pozitën e të paditurit paraqitet personi apo pala tjetër procedural kundrejt kujt paditësi parashtron padinë në të cilën pretendon se i njëjti ka shkelur apo lënduar ndonjë të drejtë subjektivo – civile të tijën. Pra pala në aspektin proceduralo – juridik tregon se kush është pala që padit dhe kush është pala e cila paditet respektivisht paditësi dhe i padituri. Paditës është ai person apo subjekt në marrdhënien materijalo – juridike i cili parashtron padinë para gjykatës kompetente ngai cili kërkon mbrojtje juridike ndërsa i paditur është ajo pala kundrejt të cilit kërkohet mbrojtja e tillë juridike. Pse për nocionin palë në aspektin proceduralo – juridik thuhet se nuk niset nga egzistimi i marrdhënies materijalo – juridike por vetëm për nga pozita e subjektit në procedurë? Është kështu pasi që për të qenë njësubjekt palë në aspektin procedural nuk duhet të jetë pjesmarës në një marrdhënie materijalo – juridike me palën tjetër, por mjafton vetëm që të mundet të parashtror padi. Pra, rrethi i personave të cilët mundet të konsiderohen palë në aspektin proceduralo – juridik automatikisht zgjerohet, kështu që jo vetëm pjesmarësit e marrdhënies materijalo – juridike kanë të drejtë të padisin por edhe personat tjerë të cilët kanë një interes të tillë si për shembull: “të drejtën për padi për anulim të martesës ka prokurori publik si dhe personat tjerë të cilët kanë interes juridik përveç në rastet kur martesë është lidhur me detyrim dhe mashtrim”. Kjo don të thotë se prokurori publik apo të afërmit bashkëshortëve në shembullin e dhënë më sipër edhe

¹⁵¹ Ibid, fq. 168

¹⁵² Ibid, fq. 169

pse nuk janë pjesmarës në marrdhënien materijalo – juridike, prap se prap janë palë në procedurë falë asaj se kanë të drejt të padisë apo të paditet, pra të ndërmer veprime procedural. Gjithashtu nocioni palë kuptohet edhe në kuptimin funksional. Si palë në kuptimin funksional paraqitet personii cili parashtron padi në emër të vetë, por në interes të një personi tjetër. Në këtë rast konkret gjithmon duhet të nisët nga ajo se a ka organi për të drejtat dhe obligimet e një personi tjetër drejtë të nis procedurë sipas detyrës zyrtare të përfaqësoj palën në procedurë. Sa i përket kësaj çështje, egzistojnë dy teori të cilët miren me këtë problematikë. Teorija organike është teoria e parë e cila nënkupton nisjen e procedurës nga ana e organit në interes të një personi tjetër në bazë të detyrës zyrtare me ç’rast ka status të palës në procedurë. Ky person mundet të jetë palë sipas pozitës, detyrës apo funksionit. Ndërsa teoria e dytë – teoria përfaqësuese parashih atë se organi i cili e nis procedurën sipas detyrës zyrtare nuk është palë në procedurë por vetëm përfaqësues ligjor. Si është çështja e pozitës së përfaqësuesit në legjislacionin tonë? Sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë dhe në bazë të rregullave pozitive përcaktohet fakti se një përfaqësues do të ketë apo jo status të përfaqësuesit ligjor. Kështu që mundet të thuhet se në asnjë mënyrë nuk pranohet as teoria organike e as ajo përfaqësuese. Janë disa shembuj të cilët e ilustronë shumë bukur çështjen e pozitës dhe statusit të përfaqësuesit në procedurë si për shembull: prokurori publik mundet të parashtrorj padi për anulim të martesës atëherë kur i njejt ka informata dhe të dhëna se martesa e tillë është e lidhur si rezultat i kërcënimit apo të mashtrimit¹⁵³. Apo edhe Qendra për punë sociale mundet të paraqitet si palë atëherë kur sipas detyrës zyrtare e nis procedurën për vërtetimin e atësisë atëherë kur nëna nuk ka nisur një procedurë të tillë¹⁵⁴ apo edhe në rastet kur Qendra për punë sociale vërteton në bazë të të dhënave që i posedon se nëna nuk kujdeset për fëmijën (neni 60 i Ligjit mbi familjen). Gjithashtu në teori egziston edhe mundësia që pozita e palës t’i njihet edhe administratorit falimentues edhe pse sipas ligjit ton për falimentim administratori falimentues i ndërmer të gjitha veprimet në emër të debitorit dhe kreditorëve gjë që don të thotë se ai është përfaqësues dhe se ka pozitë të palës në procedurë¹⁵⁵.

Teoria juridike njeh disa parakushte të cilët duhet të plotësohen me qëllim të lejueshmërisë të inicimit të procedurës kontestimore, zhvillimit të saj dhe përfundimit të suksesshëm me sjellje të

¹⁵³ Ligji mbi familjen, neni 36, al. 1

¹⁵⁴ Ligji mbi familjen, neni 60

¹⁵⁵ J. Арсен, К. Зороска Таџана, op. cit, fq 170

vendimit meritor dhe të plotfuqishëm. Këto parakushte në literatura të ndryshme juridike ndryshe njihen me termin “prezumime procedurale të cilët janë rrethana relevante juridike”¹⁵⁶. Jane disa kategori të prezumimeve procedurale të cilët kanë të bëjnë me atë se për çka kanë të bëjnë të njëjtat, dhe njëra prej atyre kategorive janë edhe prezumimet procedurale të cilët kanë të bëjnë me palët si: egzistimi i palëve, aftësia për të qenë palë, aftësia procedurale e palëve dhe të tjera. Pra, që palët në procedurë kontestimore që të mundet të ndërmarin veprime procedurale gjat gjith rrjedhjes së procedurës, respektivisht që nga inicimi i saj e deri në përfundimin e saj duhet fillimisht të ketë aftësinë e palës e cila në fakt palës i jep mundësinë por edhe të drejtën gjithashtu që të padisë por nga ana tjetër edhe ta padisin respektivisht që njëkohësisht të mundet të jetë bartës i të drejtave dhe por të detyrimeve të njohura të të drejtën procedurale. Aftësi për të qenë palë munden ta kenë personat fizik¹⁵⁷, personat juridik¹⁵⁸ por edhe disa forma të shoqërive të cilët nuk kanë statusin e personave juridik por të cilët kanë një farë mase pasurore e cila mundet të jetë objekt përmbarimi dhe të cilët në bazë të objektit të kontestit i kanë plotësuar kushtet për fitim të aftësisë për të qenë palë¹⁵⁹. Palët gjithashtu që të munden të ndërmarin veprime procedurale duhet të kenë edhe aftësinë për të qenë palë procedurale. Pala e cila ka aftësinë e plotë për të vepruar mundet vet që ti kryej veprimet në procedurë gjë që nënkupton se pala ka aftësi procedurale¹⁶⁰. Kjo gjithashtu nënkupton se pala e cila ka aftësi procedurale mundet lirshëm që të krijoj ndryshoj dhe të përmbyll ose përfundoj marrdhënie të ndryshme juridike. Kjo është e mundshme vetëm atëherë kur pala është e aftë që të kuptojë rëndësinë e veprimit procedural dhe veprimeve juridike të cilët i ndërmer apo duhet t’i ndërmer i njejt. Që kjo të jetë e mundshme, pala duhet të jetë i zhvilluar psikikisht mjaftueshëm dhe të ketë arritur një shkallë të mjaftueshme të zhvillimit psikik që të mundet të jetë i vetëdijshëm për të drejtat dhe obligimet bartës e të cilëve janë ato. Për tu arritur ajo shkallë e zhvillimit psikik të nevojshëm, personi duhet të ketë kaluar disa vite të caktuara të jetës së tij, i cili kriterium dallon

¹⁵⁶ Јаневски. А, Камилоска – Зороска. Т, op. cit, fq. 71

¹⁵⁷ Aftësi për të qenë palë kanë personat fizik të cilët kanë aftësi juridike të cilën e fitojnë nga moment i lindjes. Kjo don të thotë se personat fizik nga moment i lindjes bëhet bartës i të drejtave dhe detyrimeve të caktuara të cilët i japin të drejtë që të jetë palë në procedurë me kusht që të jetë i lindur i gjallë. Mirpo ka raste të caktuara shprehimisht me ligj kur femija ende i palindur (nasciturus) por i cili presupozohet se është i gjallë në mitrën e nënës dhe në bazë të saj supozohet se do të lind i gjallë dhe si rezultat i asaj i garantohen disa të drejta dhe autorizime njëkohësisht. Këto raste janë më të shpeshta gjat procedurave trashëgimore.

¹⁵⁸ Aftësi për të qenë palë kanë edhe personat juridik, e cila aftësi është e përgjithshme dhe e pakufizuar. Këtë aftësi e kanë të gjithë personat juridik të cilët e fitojnë nga momenti i themelimit respektivisht themelimit dhe të njejtën e kanë deri në momentin e shuarjes.

¹⁵⁹ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 70, al. 2,

¹⁶⁰ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 71, al. 1

nga ligjvënësi nga shteti në shtetsi përshembull në Iran dallon mosha e aftësisë për të vepruar në mes të gjinis femrore dhe asaj mashkullore. Përderisa meshkujt zotësinë për të veprua e fitojnë në moshën 15, gjinia femërore e fiton në moshën 9¹⁶¹. Shembull tjetër kemi Korenë e Veriut, ku zotësia për të vepruar fitohen me arritjen e moshës 17. Në pikën 25 të Konventës për të drejtat e fëmijëve¹⁶², në Korenë e Veriut zotësia për të vepruar arrihet në moshën 17 vjeçare, ndërsa në pikën 26 Komiteti për të drejtat e fëmijëve rekomandon që Koreja e Veriut ta rrisë moshën e fitimit të aftësisë për të vepruar në 18 vjet, shembull i ndjekur nga shumë shtete të ndryshme modern. Ndër to mundet të konsiderohen këto shtete: Republika e Shqipërisë në të cilën personat me aritjen e moshës 18 vjeçare fitojnë aftësinë për të vepruar dhe me këtë edhe fitimin e të drejtave dhe obligimeve civile¹⁶³, në Austri gjithashtu mosha me të cilën një person e fiton aftësinë për të vepruar është mosha 18 vjeçare¹⁶⁴ si dhe Zvicra gjithashtu parashah të njëjtën moshë për fitimin e aftësisë për të vepruar¹⁶⁵. Ka edhe disa shtete legjislacioni i të cilëve parashah moshë më të pjekur për fitimin e aftësisë për të vepruar, si për shembull: Kodi Civil i Koreës së Jugut parashah oshën 19 vjeçare kur personi arrin moshën e pjekurisë dhe me këtë edhe fiton aftësinë për të vepruar¹⁶⁶ si dhe shteti i Alabamës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës parashah moshën 19 vjeçare si moshë kur shtetasit e saj fitojnë aftësinë për të vepruar¹⁶⁷. Zelanda e Re nga ana tjetër parashah një moshë edhe më të pjekur të fitimit të zotësisë për të vepruar, moshën 20 vjeçare¹⁶⁸, Kuvajti¹⁶⁹ dhe shteti i Misisipit¹⁷⁰ në Shtetet e Bashkuara të Amerikës parashohin moshën 21 vjeçare kur shtetasit e tyre fitojnë aftësinë për të vepruar. “Aftësia për të vepruar e personave fizik është aftësia që të drejtat dhe detyrimet e tyre t’i ushtrojnë në mënyrë tëpavarur”¹⁷¹. Ligji për procedurë kontestimore parashah edhe situatat kur një person të ketë aftësi të kufizuar për të vepruar. Çka në kështu raste? Sipas al. dy të nenit 71 personi i rritur por me aftësi të kufizuar të veprimt mundet të ketë aftësi procedural por vetëm brenda kufijve të atij kufizimi. Është për tu habitur fakti se edhe pse këtyre personave deri diku u njihet aftësia për të

¹⁶¹ Kodi Civil i Republikës Islamike të Iranit, neni 1210, a;.1, 23 maj 1928

¹⁶² Konventa për të drejtat e fëmijëve, CRC/C/15/Add.239 1 July 2004

¹⁶³ Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 6, LIGJ - Nr. 7850, datë 29.7.1994

¹⁶⁴ Kodi Civil i Austrisë, neni 21, al.2, nr. 946/1811

¹⁶⁵ Kodi Civil i Zvicrës, neni 14, 10 dhjetor 1907

¹⁶⁶ Kodi Civil i Koresë së Jugut, neni 4, nr. 10645

¹⁶⁷ AL Code § 26-1-1 (2017)

¹⁶⁸ Ligjit të moshës madhore, neni 4, al.1, 1970 tw Zelandës së Re, nr. 137

¹⁶⁹ Kodi Civil, neni 92, al.2, nr. 67, viti 1980

¹⁷⁰ Title 91, Chapter 7, § 91-7-37

¹⁷¹ Aliu. A, (2013), E drejta civile, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë, fq. 240

vepruar dhe brenda atij kufirit sa u njihet kjo aftësi, mund të ndërmarin disa veprime procedurale dhe të njejtat tu konsiderohen të vlefshme, LPK nuk u'a njeh personave të tillë aftësinë procedurale as edhe në pjesën e cila i lejon dhe e konsideron të aftë psikikisht për të ndërmar ndonjë veprim të caktuar procedural. Kjo don të thotë se në kështu raste në ato pjesë ku pala nuk ka aftësi për të vepruar i njejt duhet të përfaqësohet nga një përfaqësues ligjor i cili do të duhet që ti aprovoj veprimet e palës me qëllim që ato veprime të konsiderohen të vlefshme. Pra, është e domosdoshme prezenca e përfaqësuesit dhe lejimi apo pranimi si të vlefshme veprimet e palës me qëllim që të mos cenohen disa nga parimet procedurale të cilët nuk lejojnë në asnjë mënyrë që gjykata të udhëheq me procedura rezultati përfundimtar i të cilëve do të ishte i pasigurt përshkak të marjes pjesë të personave me aftësi të kufizuar për të vepruar respektivisht me pa aftësi procedurale. Sa i përket personave të mitur. ato janë personat të cilët nuk kanë aspak aftësi për të vepruar, dhe si të tillë konsiderohen personat deri në moshën 14 vjeçare. “Mosha 14 vjeçare merret si moshë për fitimin e zotësisë së pjesshme për të vepruar për shkak se ata mund të kryejnë veprime juridike që janë të vlefshme si p.sh: personii moshës 14 vjeçare , në rast të adoptimit duhet ta jep vetë pëlqimin për adoptimin e tij, në qoftë se nuk e jep pëlqimin nuk mund të bëhet adoptimi”¹⁷². Në këto raste me qëllim të mbrojtjes të të drejtave dhe interesave të personave të tillë të cilët përshkak të moshës nuk janë në gjendje që vet t’i mbrojnë të njejtat sipas ligjit parashihet që të përfaqësohen nga përfaqësuesi ligjor si p.sh: për personat e mitur përfaqësues ligjor konsiderohen prindërit e tij, pasi që askush më mirë se sa prindi nuk mundet që t’i mbroj interesat e fëmijut të tij.

Pra, duhet të kenë aftësinë që të jenë palë dhe kjo varet vetëm nga paditësi. Pse është kështu? Kjo pasi që paditësi është ai i cili me parashtrimin e padis në gjykatën kompetente bën përcaktimin e palëve, fillimisht përcakton veten e tij si palë paditëse gjë e cila bëhet gjithmon me vullnetin e tij e jo kundër vullnetit, e pastaj edhe përcaktimin e palës tjetër respektivisht të palës të paditur e cila në krahasim me përcaktimin e palës paditëse, pala e paditur përcaktohet pa vullnetin dhe kundër vullnetit të atij personi. Nuk është kjo e vetmja mënyrë për përcaktimin e palës kontestimore në një procedurë kontestimore. Ka edhe mënyra tjera të cilët janë të parapara shprehimisht me Ligjin për procedurë kontestimore¹⁷³.

¹⁷² Aliu, A, op. cit., fq.243

¹⁷³ Sipas nenit 182 të Ligjit mbi procedure civile, status të palës procedurale një person mundet ta fitoj në rastet kur paditësi deri në përmbylljen e shqyrtimit kryesor do ta ndryshoj padinë, kështu që në vend të paditurit të parë do të

Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë pushteti shtetëror ndahet në atë ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor¹⁷⁴. Sistemi gjyqësor në shtet mbështetet në të drejtën kontinentale dhe në vizionin se vetëm me anë të drejtësisë dhe duke u mbështetur në ligjet pozitive të cilët veprojnë në Republikën e Maqedonisë, mundet të sigurohet dhe të garantohet para së gjithash siguri juridike dhe barabarsi të qytetarëve para gjykatave të këtij shteti. Gjykatat si subjekt në procedurën kontestimore paraqesin organe shtetërore të cilët e ushtrojnë pushtetin gjyqësor dhe me këtë realizojnë funksionet¹⁷⁵ të cilën ato i kanë të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligjet e veçanta, por të cilët këtë funksion e realizojnë dhe ushtrojnë pa mos e cënuar në asnjë moment pavarësinë e tyre një veti e gjykatave e cila proklamohet edhe në Kushtetutë (neni 98) edhe pse shumë shpesh duket sikur ky proklamim të bie në uj dhe të ngritet dilema e pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, pasi që shpesh edhe duket sikur pushteti gjyqësor të jetë në një pozicion i të qenurit i varur nga pushtetit legjislativ respektivisht i pushtetit ekzekutiv. Jo rastësisht edhe në raportet e ndërkombëtarëve në këto 15 – 20 vitet e fundit ai i cili binte në test vazhdimisht ishte pikërisht gjyqësori në Republikën e Maqedonisë. Punën e tyre gjykatat e kryejnë fillimisht duke u mbështetur në Kushtetutë e pastaj në ligje e në marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare. Si rezultat i funksioneve dhe qëllimeve krahas të cilëve gjykatat punojnë dhe veprojnë, sipas nenit 4 të Ligjit mbi Gjykatat¹⁷⁶ të njejtët vendosin për të drejtat e njeriut dhe të qytetarëve dhe interesave të tyre, për kontestetet në mes të qytetarëve dhe subjekteve tjera juridike, për veprat penale dhe veprat tjera të dënueshme me ligj si dhe për çështje tjera të cilët i është lënë gjykatës në kompetencë për të vendosur. Shteti nëpërmjet të gjykatave arrinë që të aplikoj të drejtën në raste konkrete të cilët kanë të bëjnë me nevojën e dhënies të mbrojtjes juridike. Pra përveç se gjykatat japin një siguri qytetarëve se ndonjë e drejtë e tyre e kërcenuar apo e rrezikuar do të mbrohet me të gjithë mekanizmat të parapara me ligj, ajo nga ana tjetër në mënyrë të detyruar siguron zbatimin e normave juridike. Sistemi gjyqësor në Republikën e Maqedonisë organizohet varësisht disa faktorëve të cilët e bëjnë që secili system gjyqësor i çdo shteti të jetë unik dhe i ndryshëm. Kjo është kështu pasi që mënyra se si do të

padisë një person tjetër, me ç'rast do të jetë e nevojshme pëlqimi i atij personi, ndërsa në raste kur i padituri i mëparshëm veç se ka mar pjesë në shqyrtimin kryesor gjithashtu do të duhet edhe pëlqimi i tij.

¹⁷⁴ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 8, al. 1, pika 4

¹⁷⁵ Funksionet e gjykatave përfshijnw: a) zbatimin e paanshëm të së drejtës, pa marrë parasysh pozitën dhe cilësinë e palëve; mbrojtja, respektimi dhe përparimin i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; c) sigurimin e barazisë dhe jodiskriminimit mbi çfarëdo lloj baze; dhe ç) sigurinë juridike dhe krijimin e kushteve për çdo njeri të jetojë i sigurt në kuadër të zbatimit të së drejtës.

¹⁷⁶ Ligji mbi Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 58/2006, 38/2008, 150/10

organizohet gjyqësori në një shtet varet nga kultura juridike, traditave të shoqërisë, religjionit e cila luan një rol mjaft të rëndësishëm dhe sidomos nga faktori shoqëror dhe kushteve të cilët krijohen brenda për brenda shoqëris dhe shtetit. Çështja e organizimit të gjykatave në Republikën e Maqedonisë është e rregulluar me anë të Ligjit mbi gjykatat, e cila edhe vendos njëkufij në mes të çështjeve të cilët mund të konsiderohen si të përgjithshme dhe ato të veçanta apo të specializuara. Kjo ndarje edhe pse nuk egziston shprehimisht në ligj, ajo shumë lehtë vërehet dhe si e tillë përmendet në literaturat juridike të autorëve të ndryshëm dhe si rezultat i kësaj bëhet ndarja e gjykatave në mes të gjykatave themelore, të apelit, administrative dhe gjykata supreme prej të cilës ndarje mund ta shohim se në fakt ndarja në gjykata me kompetencë të përgjithshme dhe ato të specializuara mban, ku gjykatat themelore, të apelit dhe ajo supreme janë të kompetencës së përgjithshme (të gjitha çështjet juridiko - civile) ndërsa nga ana tjetër gjykata administrative është ajo me kompetencë të specializuara dhe e cila mirret vetëm më çështje të karakterit të veçantë respektivisht çështje administrative. Edhe pse gjykatat (themelore, apelit dhe gjykata supreme) në shikim të parë duken se janë të pavarura, dhe të cilët kryejnë funksionin e tyre të përcaktuar në mënyrë të detajuar me ligj, ato janë mjaft të lidhura njëra me tjetrën sidomos në aspektin “ hierarkik të lidhura të cilët përbëjnë një tërësi e vetme si nga aspekti organizimit ashtu edhe nga ajo funksional “¹⁷⁷. Të gjithë gjykatat veprojnë në rajonin në të cilën ajo është themeluar për të kryer funksionin gjyqësor¹⁷⁸ dhe kanë kompetenca për inicim, zbatim dhe përfundim të suksesshëm të procedurës ose për ndërmarjen e ndonjë veprimi të caktuar procedural¹⁷⁹. Çështja e kompetencave të gjykatave rregullohet në mënyrë analoge me Ligjin

¹⁷⁷ Јаневски. А, Зороска-Камилошка. Т, op. cit, fq 123

¹⁷⁸ Gjykatat themelore themelohen në rajonin e një ose më shumë komunave, të cilët rajonë janë të caktuara me ligj (neni 23. al.1 e Ligjit mbi gjykatat). Deri në këtë moment në Republikën e Maqedonisë egzistojnë 27 gjykata themelore në bazë të nenit 28 të Ligjit mbi gjykatat të cilët gjykojnë në shkallë të parë. Të njejtat gjykata themelohen si gjykata me kompetencë themelore dhe me kompetencë të zgjeruar. Si gjykata themelore njihen: gjykatat themelore në Veles, Kavadar, Kriva Pallankë, Negotinë, gjykata themelore civile në Shkup, Gjevgjeli, Kratovë, Kumanovë, gjykata themelore Shkup I, Manastirë, Resnjë, Ohër, Krushevë, Prilep, Strugë, Berovë, Dellçevë, Radovish, Strumicë, Vinicë, Koçan, Sveti Nikollë, Shtip, Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Tetovë. Gjykatat e apelit nga ana tjetër themelohen në rajonet e më shumë gjykatave themelore. Sipas nenit 24 të Ligjit mbi gjykatat në Republikën e Maqedonisë egzistojnë katër gjykata të apelit dhe atë në Bitoll, Gostivar, Shkup dhe Shtip. Ndërsa Gjykata Supreme si gjykatë më e lartë në vend me sli në Shkup, në krahasim me gjykatat themeore dhe ato të apelit funksionin dhe punën e saj e kryen brenda të gjithë teritorit të Republikës së Maqedonisë (neni 26 i Ligjit mbi gjykatat).

¹⁷⁹ Me termin kompetencë nënkuptohet e drejta por edhe obligimi i të vepruarit lidhur me disa çështje të caktuara juridike, por edhe brenda një teritori të caktuar. Kjo don të thot se gjykata përveç se ka të drejtë apo nuk ka të drejtë që të inicioj vendos dhe me këtë edhe ta përfundoj një procedurë të caktuar, ajo gjithashtu duhet të ketë kujdes se a

mbi gjykatat si dhe me Ligjin mbi procedurë kontestimore, dhe në bazë të kësaj duhet të bëhet dallimi midis forum legale (në këtë lloj të kompetencës nuk mundet të ndikojnë në asnjë mënyrë as gjykatat ose palët pasi që e njehta është e përcaktuar shprehimisht me ligj), forum indiciale (kjo kompetencë është e përcatuar në bazë të vendimit të gjykatës dhe në këtë mënyrë mundet të përcaktohet kompetenca territoriale), forum conventionale (kjo lloj kompetence përcaktohet ndërmjet palëve me anë të marrëveshtjes, dhe e njehta mund të jetë e mundshme vetëm në përcaktimin e kompetencës territoriale) dhe forum electivum (ligji jep mundësi që brenda kufijëve të vet tu mundësoj palëve ose vetem njëres palë që të mund të zgjedhin kompetencën tëritoriale)¹⁸⁰. Ligji mbi gjykatat e rregullon në mënyrë të përpiktë kompetencën lëndore të gjykatave themelore në procedurë kontestimore, ndërsa nga ana tjetër Ligji për procedurë kontestimore përmban vetëm një nen respektivisht neni 27 e cila e rregullon këtë kompetencë dhe e cila parasheh që “ gjykatat në procedurë kontestimore gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së tyre të përcaktuar me ligj “. Ky nen në fakt na çon në zbatimin e Ligjit mbi gjykatat respektivisht nenet 30 dhe 31 të Ligjit mbi gjykatat. Ky ligj në këto dy nene tërheq një vijë restriksioni në mes të asaj se çfarë çështje mund të zgjedhin gjykatat, duke mar parasysh edhe faktin se ligji njëkohësisht bën edhe një ndarje të gjykatave e cila është mjaft kryesore kur vjen deri në atë se cilët gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë, ç’farë lënde dhe të cilës vlerë do të jenë kompetente që t’i zgjidhin të njejtat. Si rezultat i këtyre dy kriteriumeve, Ligji mbi gjykatat i ndan gjykatat themelore në gjykata themelore me kompetencë themelore dhe gjykata themelore¹⁸¹ me kompetencë të zgjeruar¹⁸². Gjykatat në Republikën e Maqedonisë

ka të drejtë ose jo që në aspektin territorial të inicoj zbatoj apo përfundoj një procedurë të caktuar. Sipas neneve 14 dhe 15 të Ligjit për procedurë kontestimore gjykatat gjat gjithë kohës sa zgjat procedura që nga fillimi respektivisht pranimi i padisë duhet të kujdesen sipas detyrës zyrtare se a janë kompetentë për zgjidhjen e çështjes të paraqitur para tyre. Në rastë se gjykata vëren se për zgjidhjen e çështjes nuk është kompetente por kompetent është ndonjë gjykatë apo organ tjetër i vendit apo i jashtëm, në ato raste do të shpallë veten jokompetent me ç’rast do të ndërpres të gjitha aktivitetet dhe veprimet procedural dhe do ta hedh posht padinë.

¹⁸⁰ Shih më shumë tek Јаневски. А, Зороска-Камилоска. Т, оп. cit, fq. 126-127

¹⁸¹ Sipas nenet 30, aline 2, gjykatat themelore me kompetencë themelore kanë të drejtë që në shkallë të parë të vendosin në këto procedura kontestimore: për kontestet në marrëdhëniet pronësore-juridike dhe marrëdhëniet tjera civile juridike të personave fizik dhe juridik, vlera e të cilave është 15.000 euro në kundërvlerë në denarë, po që se me ligj nuk është e paraparë kompetenca e gjykatës tjetër; për kontestet për vërtetimin dhe kontestimin e atësisë dhe mëmësisë, vërtetimin e ekzistimit të kurorës, anulim të kurorës dhe shkurorezimit; për alimentacion ligjor; për ruajtje dhe edukim të fëmijëve; për pengim në posedim; për alimentacion jetësor; për kompensim të dëmit e cila nuk tejkalon mbi 15.000 euro në kundërvlerë në denarë; për procedurë për sigurim dhe zbatim; për marrëdhënie pune; për konteste nga marrëdhëniet juridike-trashëgimore; për çështjet jashtë kontestimore dhe trashëgimore; dhe për çështje të tjera të caktuara me ligj.

gjithashtu kanë edhe kompetencë funksionale – një nënloj i kompetencës lëndore e cila kompetencë nuk njihet nga ligji por është një term i përdorur në literaturën juridike. Përderisa me rregullat të cilët rregullojnë çështjen e asaj se kush nga gjykatat themelore do të jenë kompetent për zgjidhjen e një çështjeje, nga ana tjetër kompetenca funksionale përcakton se kush nga disa gjykatat themelore do të jetë kompetente të zgjidh një çështje të caktuar. Pra, me anë të “rregullave të kompetencës funksionale në procedurën kontestimore bëhet kufizimi i më shumë gjykatave të llojit të njejtë, e të vepruarit suksesiv në një çështje juridike të njejtë (kontest), si dhe kufizimin e kompetencës të dy përbërjeve të të njejtës gjykatë në lidhje me ndërmarjen e veprimeve për të njejtën çështje (kontest)”¹⁸³. Kur jemi tek sistemi gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, në procedurë kontestimore për zgjidhjen e një çështje të caktuar kontestimore kompetente janë gjykatat themelore me kompetencë themelore si dhe gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar. Përveç se kompetenca funksionale e gjykatave themelore përcakton rrethveprimin e gjykatave themelore si me kompetencë themelore dhe atë me kompetencë të zgjeruar, ajo gjithashtu i përcakton këto gjykata si kompetente për të vepruar dhe për të vendosur për mjetet juridike remonstrative siç janë: propozimi për përsëritjen e procedurës si dhe kundërshtimi kundër urdhërpagesës¹⁸⁴. Në këtë aspekt gjithashtu përcaktohet edhe ndarja e punëve në mes të gjykatësit të vetëm në procedurë dhe punëve të këshillit gjyqësor¹⁸⁵. Gjykatat

¹⁸² Sipas nenit 31, alinea 2 gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar kanë të drejtë që në shkallë të parë të vendosin në këto procedura kontestimore: për kontestet në marrëdhëniet pronësore-juridike civile dhëmarrëdhëniet tjera juridike civile të personave fizik dhe juridik, vlera e të cilave është mbi 15.000 euro në kundërvlerë në denarë, po që se me ligj nuk është e paraparë kompetenca e gjykatës tjetër; në kontestet tregtare në të cilat të dy palët janë persona juridik ose organe shtetërore, si dhe kontestet nga të drejtat autoriale dhe të drejtave të tjera të ngjashme dhe të drejtave nga pronësia industriale; të udhëheqin regjistër për parti politike; për procedurë për falimentim dhe likuidim; për konteste për vërtetimin dhe sigurimin për ekzekutim të detyrueshëm dhe për kontestet nga personat e huaj dhe të vendit, të cilët dalin nga marrëdhëniet e tyre ekonomike, gjegjësisht marrëdhëniet tregtare. Ne po këtë nen, ligji në alinenë e tretë parasheh edhe gjykatat themelore të cilët kanë kompetenca të zgjeruara për të vendosur për këto çështje gjithsej janë 12 dhe atë: gjykatat themelore të Manastirit, Velesit, Gostivarit, Koçanit, Kumanovës, Ohrit, Prilepit, Strugës, Strumicës, Tetovës, Shtipit dhe gjykatës themelore Shkup dhe Shkup I.

¹⁸³ Јаневски, А, Зороска-Камилооска, Т, оп. cit, fq. 131

¹⁸⁴ Ibid

¹⁸⁵ Sipas nenit 34 të Ligjit për procedurë kontestimore, për kontestetet vendosin këshillet gjyqësore (al.1) ndërsa janë disa raste të caktuara me këtë ligj kur gjykatësi i vetëm mundet të vendos. Atëherë kur këshilli gjyqësor vendos për një çështje në shkallë të parë ajo gjithmon vendos në përbërje 1+2 respektivisht kryetari i këshillit gjyqësor dhe dy gjyqtar porot (neni 35, al.2). Gjykatësi i vetëm sipas ligjit çdo herë vendos për çështjet respektivisht kërkesat juridiko-pronësore por vetëm atëherë kur vlera e lëndës të kontestit nuk e tejkalon vlerën e përcaktuar me ligj respektivisht vlerën pre 1.800.000 denar; për çdo arritje të marrëveshtjeve juridiko-pronësore mundet të vendos gjykatësi i vetëm pa mar parasysh vlerën e kontestit; për pengim posedimi; gjykatësi i vetëm e zbaton dhe vendos për lëndët për dhënie të ndihmës juridike. Ndërsa kontestete nga të drejtat e autorit dhe të drejtave të ngjajshme, si

gjithmon themelohen me anë të ligjit që të veprojnë në një territor të caktuar. Varësisht asaj se sa një shtet është i madh në sipërfaqe por edhe nga ajo se sa është i madh në numër të popullatës të cilët jetojnë në atë shtet, numri i gjykatave varijon, duke i'u përgjigjur nevojave të shtetit apo të qytetarëve të saj për dhënie të mbrojtjes juridike të nevojshme. Kështu, në një shtet mundet të formohen “gjykata të llojit të njejtë dhe të rangut të njejtë”¹⁸⁶. Dhe të gjithë këto gjykata veprojnë në një territor të caktuar brenda shtetit. Ajo e cila i jep dritë jeshile një gjykate që të ndërmer veprime procedurale brenda atij territori për të cilën ajo është formuar konsiderohet kompetencë territoriale e cila është e përcaktuar me ligj dhe e cila parasheh lidhshmërinë që një gjykatë në një territor të caktuar ka me një çështje juridike kontestuese të caktuar. Kjo don të thotë se secila gjykatë ka të drejtë që të ndërmer veprime procedurale të caktuara me ligj vetëm brenda territorit të caktuar, e jo edhe të ndërmer veprime procedurale në territorin e ndonjë gjykate tjetër. Përrjashtimisht nga kjo rregull mundet të devijohet vetëm nëse përmbushen kushtet të parapara me nenin 24 të Ligjit mbi procedurë kontestimore. dhe atë në qoftë se gjykata konstaton se egziston rreziku që veprimet procedurale të cilët duhet të ndërmiren në një afat sa më të shpejtë të miren me vonës dhe me këtë të zvaritet procedura kontestimore pa pasur ndonjë arsye të mbështetur juridike. Kufizimi i gjykatave në aspektin territorial bëhet duke u bazuar në lidhshmërinë e cila egziston në mes të kontestit dhe territorit të një gjykate. Kjo lidhshmëri mundet të caktohet sipas dy kritereve: atë subjektiv dhe objektiv¹⁸⁷. Mënyrat e përcaktimit të kompetencës territoriale janë të ndryshme në krahasim të përcaktimit të kompetencës lëndore. Rregullat janë të përmbajtura në Ligjin për procedurë kontestimore. Si të tilla ato konsiderohen *forum legale* ose kompetence ligjore. Gjithashtu sipas ligjit lejohet përcaktimi i kompetencës territoriale për zgjidhjen e ndonjë çështje të caktuar kontestuese nga ana e ndonjë gjykate më të lartë – *forum iudiciale*¹⁸⁸, ose ka raste kur e autorizon paditësin që të zgjedh kompetencën territoriale respektivisht gjykatën kompetente – *forum electivum*, si dhe mundet t'i lejoj palët që

dhe kontestete që kanë të bëjnë me mbrojtjen ose shfrytëzimin e të drejtave nga pronësia industriale, ose të drejtën e përdorimit të firmës ose të emrit, kontestet nga konkurrenca jolojaleose sjellja monopole i gjykon këshilli gjyqësor pa mar parasysh vlerën e lëndës në kontest (neni 36).

¹⁸⁶ Јаневски. А, Зороска-Камилооска. Т, оп. cit, fq. 132

¹⁸⁷ Kriteri subjektiv përcakton lidhshmërinë palëve kontestimore me territorin e gjykatës ndërsa kriteri objektiv përcakton lidhshmërinë e lëndës të kontestit me territorin e gjykatës., Ibid

¹⁸⁸ nenet 60 – 62 i Ligjit mbi procedurë kontestimore

me anë të marrëveshtjes ndërmjet tyre ta përcaktojnë gjykatën kompetente territoriale – *forum prorogatum*¹⁸⁹.

Kompetenca territoriale e caktuar me ligj mundet të jetë e dy llojshme dhe atë: *forum generale*, kompetencë e përgjithshme apo *forum speciale* ose kompetencë e posaçme. Kompetenca territoriale e përgjithshme (*forum generale*, *forum commune*) është ajo kompetencë sipas të së cilës çdo padi e parashtruar kundër çdo personi parashtrohet në atë gjykatë e cila është e kompetencës të përgjithshme territoriale, vetëm nëqoftë se me ligj nuk është paraparë ndonjë kompetencë e veçantë territoriale¹⁹⁰. Kjo nënkupton se sipas rregullave juridike të cilët e rregullojnë të drejtën procedurale, gjykata e cila konsiderohet kompetente për të gjykuar një çështje kontestuese të caktuar është gjykata e cila për palën e paditur (*actor secutor forum rei*) është e kompetencës të përgjithshme territoriale, respektivisht kompetente është gjykata themelore e në territorin e të cilit i padituri ka vendbanimin¹⁹¹ respektivisht vendqëndrimin¹⁹² në rastet kur personat fizik – i padituri nuk ka vendbanin në Republikën e Maqedonisë për disa shkaqe të ndryshme si p.sh studentët përshkak të studimeve të tyre, puntorët përshkak të punës së përkohshme, këngëtarët, artistët etj. Në fakt kjo lloj i kompetencës është ajo e cila të paditurin e vendos në një pozitë pak më shumë të favorshmeedhe përkundër faktit se paditësi është ai i cili vendos për të gjithë çështjet tjera si objektin e kontestit, subjektin/tët, kohën e paraqitjes të padisë e kështu me rradhë. Pra, ligji të paditurit i jep një mundësi më të mirë për t’u mbrojtur e në fakt një mundësi që deri diku t’i lehtësohet çështja e mbrojtjes nga kërkes padia e paditësit, duke nisur nga ajo se më lehtë dhe me më pak shpenzime do ta ketë të pregaditet që ti kundërshtoj pretendimet e paditësit pasi që e gjith procedura do të zhvillohet në territorin në të cilën ai ka vendbanimin respektivisht vendqëndrimin. Ligji në nenin 39 al. tre të Ligjit mbi procedurë kontestimore gjithashtu parasheh si mundësi të zgjedhjes nga ana e paditësit të gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale në mes të gjykatës në territorin e të cilit i padituri ka vendbanim dhe njëkohësisht edhe gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale të gjykatës në territorin e të cilit i padituri ka vendqëndrimin të karakterit më afatgjatë. Ligji për procedurë kontestimore gjithashtu rregullon edhe çështjen e gjykatës me

¹⁸⁹ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 63

¹⁹⁰ Чавдар. К, Чавдар. К, Закон за парнична постапка со коментари, судска практика, обрасци за практична примена и предметен регистар, Второ изменето и дополнето издание, fq. 98

¹⁹¹ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 39, al. 1

¹⁹² Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 39, al.2

kompetencë të përgjithshme territoriale për shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët përgjithmon jetojnë në një shtet të huaj¹⁹³ si dhe rastet kur i padituri është person juridik¹⁹⁴. Përveç rregullave për caktimin e kompetencës së përgjithshme territoriale, ligji për procedurë kontestimore gjithashtu përmban edhe rregulla ligjore për rregullimin e kompetencave të veçanta territoriale të gjykatave të cilët mundet të jenë: *forum exclusive*, *forum electivum*, *forum subsidiale*, *forum privilegium* dhe *forum retorsionis*. Forum exclusive ose kompetenca territoriale ekskluzive është ajo kompetencë që sipas ligjit e kanë vetëm gjykatat e caktuara për nga aspekti territorial për të qenë kompetentë që të zgjidhin një kontest të caktuar juridik. Kjo don të thotë se kjo lloj kompetence e “përjashton mundësinë që për disa llojë të kontesteve, procedura kontestimore të zbatohet dhe të udhëhiqet para ndonjë gjykate tjetër me kompetencë lëndore, përveç para asaj gjykate e cila me ligj është caktuar si gjykatë me kompetencë territoriale ekskluzive”¹⁹⁵. Si konteste të tilla ligji dhe teoria juridike njeh kontestet në lidhje me sendet e paluajtshme, kontestet në lidhje me anijet dhe fluturaket, kontestet që lindin nga raportet juridiko-civile me njësinë ushtarake dhe kontestet të cilët lindin gjatë procedurës përmbarese dhe të falimentimit¹⁹⁶. Literatura juridike gjithashtu njeh edhe kompetencën territoriale të zgjedhur apo *forum electivum* e cila në fakt paraqet një kombinim e kompetencës të përgjithshme territoriale dhe të ndonjë kompetence territoriale të veçantë tjetër. Kjo i jep mundësi paditësit të zgjedh nga një buket të gjykatave me kompetencë territoriale një gjykatë e cila do të jetë kompetente për të zgjidhur kontestin konkret. Të drejtën e zgjedhjes të gjykatës me kompetencë

¹⁹³ Sipas nenit 41 të Ligjit mbi procedurë kontestimore i kompetencës të përgjithshme territoriale do të jetë gjykata në territorin e të cilit i padituri ka pasur për herë të fundit vendbanimin.

¹⁹⁴ Për personat juridik si të paditur, i kompetencës të përgjithshme territoriale është gjykata në të cilën territor gjendet selia e personit juridik (neni 40 i Ligjit për procedurë kontestimore).

¹⁹⁵ Јаневски. А, Зороска-Камилошка. Т, оп. cit, fq. 134

¹⁹⁶ Sipas nenit 49 të Ligjit për procedurë kontestimore, për zgjidhjen e kontesteve në lidhje me pronësinë dhe në lidhje me të drejtat reale të patundshmërive, për kontestete për pengimin e zotërimit të patundshmërive si dhe për kontestet e marrëdhënieve për hua ose për qira të patundshmërive ose të kontratave për shfrytëzimin e banesës ose lokaleve afariste, ekskluzivisht kompetent do të jetë gjykata në rajonin e të cilit ndodhet ajo patundshmëri. Për gjykimin e kontesteve të cilët kanë të bëjnë me anije apo fluturake si dhe për kontestet për marrëdhënie të qirasë për anijen apo fluturaken përkatëse, kompetente do të jetë ajo gjykatë e Republikës së Maqedonisë në rajonin e të cilit mbahet regjistri në të cilën është regjistruar anija apo fluturakja (neni 50 i Ligjit për procedurë kontestimore). Sa i përket kontesteve kundër Republikës së Maqedonisë në marrëdhëniet me njesitë ushtarake, ekskluzivisht kompetent është gjyqi në rajonin e të cilit gjendet selia e komandës së njesisë ushtarake e rregulluar me nenin 54 të Ligjit mbi procedurë kontestimore. Dhe sipas nenit 56 për zgjidhjen e kontesteve të cilët dalin si rezultat i zbatimit të procedurave përmbarese apo të falimentimit, me kompetencë ekskluzive territoriale do të jetë gjykata në territorin e të cilit gjendet gjykata e cila e zbaton procedurën përmbarese respektivisht gjykata në rajonin e të cilit zbatohet procedura e përmbarimit administrativ.

territoriale paditësi e realizon në momentin e parashtrimit të kërkespadiës. Përveç kësaj mundësie, ligji paditësit gjithashtu i jep edhe një mundësi tjetër dhe atë të ndrimin të gjykatës në të cilën veç më e ka parashtruar kërkespadiën në të cilën mundet të vijpërshkak të ndryshimit të mendimit të tij lidhur me gjykatën kompetente për zgjidhjen e çështjes së tij kontestuese. Mirpo nga ana tjetër ligji gjithashtu e kufizon në aspektin kohor që të mund ta bëjë këtë ndryshim. Kështu “ paditësi mundet më së voni, deri në nisjen e litispëndencës ta ndyshoj zgjidhjen e tij, ashtu që do ta tërheq kërkespadiën dhe pastaj të njëjtën do ta parashtror në ndonjë gjykatë tjetër “¹⁹⁷. Në Ligjin mbi procedurë kontestimore janë të përfshira më shumë raste të cilët në vete përmbajnë kompetencën territoriale elektive. Si të tilla janë gjykimi i kontestëve për ushqimin ligjor¹⁹⁸, kontestet kundër nënshkruesit të kambialit apo të çekut¹⁹⁹, konteste të cilët kanë të bëjnë me kontratat respektivisht kanë të bëjnë me egzistencën e kontratës, për lidhjen apo shkëputjen e kontratës apo kontestet lënda e të cilës është kompensimi i dëmit e cila lind nga mospërmbushja e detyrimeve të cilët janë të parapara në kontratë²⁰⁰, konteste të cilët kanë të bëjnë me vërtetimin e amësisë ose të atësisë²⁰¹, kontestet të karakterit juridiko-pronësore dhe për pengim në zotërim²⁰², kontestet të karakterit juridiko-trashëgimor²⁰³, konteste juridike të punës²⁰⁴ dhe konteste në të cilët si i paditur paraqitet person juridik i caktuar i cili ka njësi afariste jashtë selisë së vet ndërsa kontesti del nga marrdhënia juridike e asaj njesie²⁰⁵. Ligji për procedurë kontestimore gjithashtu përmban edhe disa rregulla ligjore me të cilët rregullon çështjen e caktimit të gjykatës e cila do të jetë kompetente për të vendosur për ato çështje për të cilët nuk mund të vendos gjykatë tjetër përshkak të mospërputhshmërisë të rregullave themelore për kompetencën territoriale. “ Kështu, me to mundësohet që paditësi padinëta paraqesë në gjykatën e shtetit tonë edhe pse për palën e paditur nuk egziston kompetenca e përgjithshme tokësore në vendin tonë, edhe pse për palën e paditur nuk egziston kompetenca e përgjithshme tokësore në vendin tonë si dhe ngritja e padisë kundër më tepër pjesmarrësve në një raport materialojuridik

¹⁹⁷ Јаневски. А, Зороска-Камилошка. Т, оп. cit, fq. 135

¹⁹⁸ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 43

¹⁹⁹ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 57

²⁰⁰ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 466

²⁰¹ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 48

²⁰² Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 49

²⁰³ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 55

²⁰⁴ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 58

²⁰⁵ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 52

ng ai cili ka lindur kontesti civil”²⁰⁶. Të gjithë rastet shprehimisht janë të parapara në Ligjin mbi procedurën kontestimore dhe atë: neni 42 parasheh kompetencë plotësuese territoriale në kontestet kundër bashkndërgjyqësve material nëse për të gjithë bashkndërgjyqësit nuk egziston kompetencë territoriale të gjykatës të njejtë²⁰⁷, në kontestet për ushqim ligjor e cila përmban element të huaj²⁰⁸, në kontestet martesore (neni 46, al.2)²⁰⁹, kontestet për vërtetimin ose kontestimin e amësisë apo atësisë²¹⁰, kontestet për kërkesat juridiko-pronësore kundër personit që nuk ka kompetencë të përgjithshme territoriale në Republikën e Maqedonisë²¹¹ dhe në kontestet kundër personave fizik apo juridik të cilët kanë seli jashtë shtetit për obligimet të cilët janë krijuar në Republikën e Maqedonisë ose duhet të plotësohen në Republikën e Maqedonisë²¹². Si kompetencë tjetër e posaçme konsiderohet edhe kompetenca territoriale e privilegjuar, e cila është një lloj i kompetencës territoriale e cila konsiderohet si e kundërta respektivisht një kompetencë e cila është shumë e ndryshme nga kompetenca territoriale e përgjithshme e cila ndryshueshmëri rrjedh nga vet baza e tyre. Ky ndryshim shifet në faktin se përderisa ligj obligon paditësin që ta parashtroj kërkespadinëqë ka kundrejt të paditurit në gjykatën në territorin e të cilit i padituri ka vendbanimin respektivisht vendqëndrimin e tij dhe

²⁰⁶ Brestovci. F, (2004), E drejta procedurale civile I (Ribotim i katërt), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti juridik, Prishtinë, fq.60

²⁰⁷ Në këto raste kompetente do të jetë gjykata e cila është kompetente për njërin nga bashkndërgjyqësit, ndërsa në qoftë se ndërmjet bashkndërgjyqësve ka debitor kryesor apo dytësor, atëherë me kompetencë territoriale do të konsiderohet gjykata e cila është kompetente për njëri nga debitorët kryesor.

²⁰⁸ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 43, al. 2 dhe 3 - sipas të cilës nëse paditësi ka vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë, i kompetencës territoriale do të jetë gjykata në rajonin e të cilit gjendet vendbanimi ose vendqëndrimi, ndërsa në rast se paditësi ka patundshmëri në Republikën e Maqedonisë nga e cila mundet të arkëtohet asistencë kompetente është gjyqi në rajonin e të cilit gjendet ajo pronë.

²⁰⁹ Kur bashkëshortët kanë vendbanim të fundit të përbashkët në Republikën e Maqedonisë, respektivisht nëse paditësi ka vendbanim në Republikën e Maqedonisë, i kompetencës territoriale do të jetë gjykata në rajonin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët respektivisht në rajonin e të cilit paditësi ka vendbanim.

²¹⁰ Sipas nenit 48, al.2 kompetente në aspektin territorial do të jetë gjykata e Republikës së Maqedonisë në rajonin e të cilit paditësi ka vendbanimin.

²¹¹ Neni 51 al.1 parasheh që në këto raste padia të mund të paraqitet në secalin gjyq në Republikën e Maqedonisë në rajonin e të cilit gjendet ndonjë pronë e atij personi ose lënda e cila kërkohet me atë kërkespadi. Gjithashtu ky nen parasheh rastet kur i padituri është shtetas i ndonjë shteti tjetër ndërsa obligimi ka ndodhur gjat qëndrimit të tij në Republikën e Maqedonisë, kompetente do të jetë gjyqi në rajonin e të cilit ka ndodhur obligimi.

²¹² Neni 53 i Ligjit mbi procedurë kontestimore parasheh se në rastet kur si palë paraqitet ndonjë person fizik apo juridik i cili ka selinë jashtë shtetit të Republikës së Maqedonisë por nga ana tjetër obligimet janë krijuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, në ato raste kompetentë në aspektin territorial do të jetë gjykata e Republikës së Maqedonisë në rajonin e të cilit gjendet përfaqësija e tij e përhershme për Republikën e Maqedonisë ose selia e organit të cilit i është besuar që t'i kryejë punët e tij.

me këtë e vendos paditësin në një pozitë më pak të volitshme në krahasim me të paditurin, nga ana tjetër kompetenca territoriale e privilegjuar i'a jep mundësinë paditësit që kërkespadinë e tij ta parashtroj në atë gjykatë ku atij i konvenon më së shumti. Kompetenca territoriale e privilegjuar është e paraparë si një nga kompetencat e mundshme në kompetencën territoriale zgjedhore e cila në shumicën e rasteve mundet të përdoret në kontestet për dhënien e ushqimit ligjor, për kontestet që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit, ose mundet të përdoret si kompetencë territoriale plotësuese si p.sh në kontestet për vërtetimin e amësisë ose atësisë²¹³. Gjithashtu si kompetencë e posaçme sipas nënit 59 i LPK parashihet edhe kompetenca e ndërsjelltë kundër shtetasve të huaj. Në fakt kjo masë është e paraparë në rastet kur shtetasit të Republikës së Maqedonisë në një shtet të huaj i mundësohet dhe i jepet e drejta që të gjykohet në gjykatë e cila sipas rregullave të Ligji mbi procedurën kontestimore të Republikës së Maqedonisë do të konsiderohet kompetentë për gjykim dhe vendosje të kontestit konkret²¹⁴.

Palët gjithashtu kanë mundësi që vet me anë të marrëveshtjes ndërmjet tyre të zgjedhin kompetencën e gjykatës për zgjidhjen e kontestit të caktuar por vetëm e vetëm kompetencën territoriale jo edhe atë lëndore. Pra Ligji mbi procedurën kontestimore parasheh që nëqoftëse nuk është e paraparë kompetenca territoriale ekskluzive e ndonjë gjykate, palët mundet që së bashku të vendosin që në shkallë të parë cila gjykatë të vendosë për kontestin e tyre e cila gjykatë nuk është e kompetencës territoriale por vetëm me kusht që të jetë potësuar kushti që edhe pse ajo gjykatë nuk ka kompetencë territoriale, të ketë kompetencë lëndore për zgjidhje të kontestit të caktuar²¹⁵. Në këto situata ligji u'a lejon palëve të caktojnë respektivisht të prorogojnë se cila gjykatë do të jetë kompetent për nga aspekti territorial për zgjidhjen e kontestit. Në të gjitha rastet të cilët kanë të bëjnë me kontratën për prorogim, nga ana tjetër ka si pasojë derogimin e kompetencës të një gjykate. Prorogimi kryhet vetëm me anë të kontratës²¹⁶ e cila mundet të lidhet si kontratë e veçantë për një kontest të caktuar apo si kontratë me të cilën kontrahohet kompetenca për të gjitha kontestet e ardhshme që mundet të lindin nga raporti juridiko-civil

²¹³ Јаневски. А, Зороска-Камилошка. Т, op. cit, fq. 138

²¹⁴ Kjo kompetencë do të vlej edhe në rastë në gjykatën e Republikës së Maqedonisë do të gjykohet edhe shtetas i atij shteti të huaj.

²¹⁵ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 63

²¹⁶ Kontrata duhet të jetë e formës së shkruar dhe e njejtë të paraqitet para gjykatës para se të paraqitet padia gjykatës, Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 63, al. 4

ndërmjet pjesmarrësve të atij raporti²¹⁷. Dhe me të mundet të prorogohet vetëm kompetenca territoriale e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu përveç prorogimit shprehimor përmendet edhe prorogimi i heshtur apo prorogation tacita pasi që këtu mungon marrëveshtja e palëve për kompetencën e gjykatës²¹⁸. Ligji mbi procedurën kontestimore gjithashtu parasheh mundësinë e tërheqjes të kompetencës në rastet kur edhe pse për një konteste kompetent është një gjykatë e caktuar mirpo nga ana tjetër në të njëjtën kohë në një gjykatë tjetër veç se është duke u zbatuar procedurë për një çështje të caktuar e cila në njëfar mënyre është e lidhur me procedurën kontestimore e cila zbatohet, dhe përshkak të këtyre rrethanave sidomos përshkak të parimit të ekonomizimit të procedurës dhe të efikasitetit, procedura kontestimore do të zbatohet para gjykatës e cila është më afër atyre procedurave. Kjo lloj e kompetencës ndryshe quhet edhe si *forum attractionis* dhe sie tillë mundet të jetë disa lloje, varësisht a tërhiqet vetëm kompetenca territoriale (jo i plotë) apo edhe ajo territoriale dhe kompetenca lëndore (i plotë), varësisht asaj se kush e tërheq kompetencën, gjykata e ulët apo e lartë e njejta mundet të jetë tërheqje e intensitetit të dobët (kur gjykata e lartë e tërheq lëndën nga kompetenca e gjykatës të ulët) apo e intensitetit të lartë (kur gjykata e ulët e tërheq lëndën nga kompetenca e gjykatës të lartë). Në LPK janë të parapar të gjithë rastet e tërheqjes të kompetencës²¹⁹.

²¹⁷ Sipas Prof. Faik Brestovci kontratata për prorogim të kompetencës territoriale mundet të lidhet edhe si pjesë përbërëse e një kontrate juridiko-civile e njohur si klauzulë prorogacioni duke u caktuar gjykata konkrete e cila do të jetë e kompetencës territoriale për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga kontrata kryesore, Brestovci. F, op. cit, fq. 65

²¹⁸ Јаневски. А, Зороска-Камилошка. Т, op. cit, fq. 142-143

²¹⁹ 1. Gjat kumulimit objektiv respektivisht gjat bashkimit të më shumë kërkespadive në një padi të vetme kundër të njëjtit të paditur, edhe pse ato kërkespadi nuk kan ndonjë lidhshmëri ndërmjet vete si nga aspekti faktit apo juridik, mundet të vij deri në tërheqjen e kompetencës nëqoftë se për secilën kërkesë është e paraparë lloj i njejtë i procedurës dhe kur e njejta gjykatë është kompetentë nga aspekti lëndor për secilën prej atyre kërkesave (neni 178 i Ligji mbi procedurën kontestimore), në kontestet kur paraqitet kundërpadia, në këto raste gjykata e cila e udhëheq apo e zbaton kontestin e tillë do të jetë kompetent edhe për të vendosur edhe për kundërpadinë e paraqitur nga ana e të paditurit kundër paditësit (neni 179 Ligji mbi procedurën kontestimore) dhe në këto raste tërheqja konsiderohet elective, në kontestet kundër bashkëndërgjyqësve material për të cilët nuk egziston e njejta kompetencë territoriale e të njejtës gjykatë (neni 42 Ligji mbi procedurën kontestimore) edhe në këto raste tërheqja konsiderohet elective, për zgjidhjen e kontesteve që kanë të bëjnë me dhënien e ushqimit ligjor kur kjo procedurë zbatohet njëkohësisht kur zbatohen edhe procedurat për kontestet martesore, për vërtetimin e amësisë ose atësisë (neni 43 Ligji mbi procedurën kontestimore) edhe këto tërheqja është elective, në kontestet juridiko-trashëgimore si dhe kontestet për kërkesat e kreditorëve të trashëgimlënësit (neni 55 i Ligji mbi procedurën kontestimore) edhe këtu kemi tërheqje elective të kompetencës, për kontestet në procedurën falimentuese dhe atë përmbartuese (neni 56 Ligji mbi procedurën kontestimore) edhe këtu tërheqja është elective ku kompetent do të jetë gjykata e rajonit e të cilit zbatohet procedura falimentuese respektivisht procedura e përmbartimit dhe në kontestet të cilët veç se zbatohen parashtrahet padi për ndërhyrje me ç'rast edhe këtu kemi tërheqje elective ku ndërhyrësi kryesor mundet të drejtën e

Deri më tani u shtjelluan palët në procedurën kontestimore. Por kush janë palët në procedurën e medijacionit? Palët kryesore në procedurën e medijacionit janë palët në të dy këndet e trekëndëshit dhe medijatori në këndin tjetër. Është një fakt i ditur se palët si në procedurë kontestimore gjithashtu edhe në atë të medijacionit janë persona me interesa dhe pretendime të kundërta të cilët në këtë rast nga medijatori si palë neutrale kërkojnë që t'u ndihmoj që ta tejkalojnë problemin respektivisht kontestin e tyre. Pra, “midis tyre egziston mosmarrëveshtja lidhur me mënyrën e rregullimit të raportit juridik në të cilën mbështetet e drejta subjektive”²²⁰ e njëres palëdhe detyrimit të palës tjetër. Palët mundet të jenë si persona fizik ashtu edhe persona juridik. Nëqoftë se palët janë persona fizik ato munden të marin pjesë gjat seancave në procedurën e medijacionit personalisht ose me anë të përfaqësuesit të tyre, ndërsa kur si palë paraqitet person juridik atëherë atë do ta përfaqësoj përfaqësuesi i tij ligjor ose përfaqësuesi i tij i autorizuar. Dmth njëjtë si në procedurën kontestimore palët munden që të gjith veprimet t'i ndërmarin me anë të përfaqësuesit respektivisht përfaqësuesit me prokurë (i cili duhet të ketë autorizim respektivisht prokurë të veçant për të ndërmar veprime në procedurën e medijacionit) të tyre²²¹. Siç parasheh neni 80 i Ligjit mbi procedurën kontestimore, medijatori edhe pse përfaqësuesit me prokurë veç më kanë dhënë deklaratë në lidhje me çështjen kontestuese, ai gjithsesi mundet t'i ftojë palët që të njëjtit të prononcohen apo të deklarohen. Ligji mbi procedurën kontestimore gjithashtu rregullon edhe pyetjen se kush mundet të jetë përfaqësues me prokurë²²² dhe të njëjtat zbatohen edhe në procedurën e medijacionit. Ky ligj e detyron medijatorin që të ketë kujdes nga fillimi i procedurës të mos lejoj që si përfaqësues me prokurë të paraqitet person i cili nuk ka prokurë të veçantë për të ndërmarë veprime gjat

tij ta realizoj edhe me padi të posaçme ndaj të dy palëve por përderisa procedura nuk përfundon plotfuqishëm (neni 188 i Ligji mbi procedurën kontestimore).

²²⁰ Brestovci. F, op. cit, fq. 75

²²¹ Në pajtim me Ligjin mbi medijacionin, çështja e përfaqësuesve me prokurë është e rregulluar nga neni 80-91 në Ligjin mbi procedurën kontestimore

²²² Sipas nenit 81, al.1, përfaqësues me prokurë mundet të jenë: avokatët, juristët e diplomuar i cili me palën është në marrdhënie pune, familjar nga gjaku në vijë të drejtë, vëlla, motër ose bashkëshort/e por vetëm nëse është plotësisht i aftë për punë. Gjithashtu neni 82 parasheh edhe në rastet kur vlera e kontestit tejkalon shumë prej 1.000.000 denar në të cilët raste si përfaqësues me prokurë mundet të jetë vetëm jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës dhe i cili është në marrdhënie pune me personin juridik.

procedurës së medijacionit pasi që sipas Kodit penal të Republikës së Maqedonisë²²³ një veprim i tillë konsiderohet i dënueshem²²⁴

Sa i përket termit medijator, vet definicioni i medijacionit si procedurë të cilën e zbaton personi apo pala e tretë neutral na lejon që të shohim qart pikën apo vijën e cila diferencon procedurat e medijacionit dhe ato kontestimore ndërmjet veti. Pika e parë dalluese ndërmjet këtyre procedurave siç edhe është cekur shpesh gjat punimit të disertacionit është ajo se tek procedurat e medijacionit nuk mundet të flitet për një procedurë ku do të imponohet apo detyrohet zgjidhja e kontestit për palën siç është tek procedurat klasike kontestimore ku roli i gjykatës është dukshëm dominant në krahasim me rolin e medijacioni në procedurën e medijacionit, i cili ka për detyrë por nga ana tjetër edhe të drejtë të siguar nga Ligji mbi procedurën gjyqësore të vendos në mënyrë autoritative për atë se a është kërkespadija e bazuar, për çështjen kryesore dhe për kërkesat e palëve, ndërsa palët mundet të ndikojnë gjat gjith kësaj kohe vetëm në mënyrë indirekte kurse gjykata është ajo e cila e ka fjalën e fundit për kufijtë e atyre kërkesave. Në krahasim me gjykatësin i cili me vendimin etij e përfundon procedurën dhe e njejta kur bëhet e plotfuqishme bëhet edhe përmbartuese, tek procedura e medijacioni, medijatori nuk e ka atë fuqi të të vendosurit, pra në asnjë mënyrë nuk mundet që me vendimin e tij ta zgjidh kontestin dhe t'ua bëj obligative palëve vendimin e tij si të detyrueshëm. Kjo është e paraparë edhe në Direktivën 2008/52 të Parlamentit dhe Këshillit të Europës. Por nga ana tjetër kjo direktivë u'a jep të drejtën palëve që nga shtetet anëtare tu'a mundësojnë palëve ose njëres prej palëve por vetëm me pëlqimin e palës tjetër të kërkoj nga shteti që përmbajtja e marrëveshtjes së shkruar e arritur nëpërmjet të medijacionit të jetë e përmbartueshme por vetëm me kusht që përmbajtja e asaj marrëveshjes të mos jetë në kundërshtim me ligjet e shtetit anëtar në të cilën ajo kërkesë është dërguar²²⁵. Tek medijacioni palët janë ato të cilët vendosin ndërsa medijatorët janë ato të cilët vetëm u japin një të shtyrë që sa më lehtë dhe më shpejtë të vijnë deri në atë vendim të përbashkët me të cilën do të zgjedhin kontestin ndërmjet tyre. Medijatori ka një rol mjaft të madh për sa ai përket kahjes të procedurës por edhe të suksesit të të njejtës pa marrë parasysh të vetive apo kualiteteve të palëve. Ai gjithmon ndërmer veprimet si lider sidomos kur vjen puna tek zbatimi i diskutimeve me ç'rast i thjeshtëson dhe i zbulon qëllimet e palëve. E gjith

²²³ Kodi penal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 37/96, 82/99, 4/02, 43/03, 17/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13 dhe 82/13

²²⁴ Kodi penal, neni 381a

²²⁵ Directive 2008/52EC, neni 6, al.1

kjo i ndihmon medijatorit që sa më mirë dhe sa më suksesshëm ta kryej punën e cila i është besuar. Medijacioni gjithashtu bazohet edhe në aftësit dhe dijet e medijatorit e cila mundet të jenë faktorë vendimtar për arritje të marrëveshtjes të përbashkët për palët, e cila mundet të arrihet nëpërmjet të të bindurit të palëve në kontest se ato janë ato të cilët më së mirë e din se ku qëndron problem dhe se ato janë ato të cilët më së miri e din se si mundet të vij deri në një zgjidhje të problemit të tyre e cila zgjidhje do të jetë e pranueshme për të dy palët dhe e cila do t'u përgjigjeshte nevojave dhe interesave të tyre. Gjithashtu medijatori do t'i udhëzonte palët që të gjejnë atë zgjidhje të problemit respektivisht të kontestit të tyre e cila do të ishte më e lehtë, më e pranueshme dhe në fund të fundit më e lehtë për tu zbatuar dhe me këtë t'i jepet fund kontestit të tyre.

Sa i përket palëve në procedurën e medijacionit, janë ato për të drejtat respektivisht interesat e tyre vendoset në procedurën e medijacionit. Pika dalluese sai përket këtij aspekti ndërmjet procedurës kontestimore dhe asaj të medijacionit është në atë se përderisa tek procedura e medijacionit medijatori gjithmon insiston në atë që marrëveshtja e cila do të jetë e përbashkët në anjë mënyrë të mos i dëmtoj interesat e palëve si dhe të vendoset për të drejtat e tyre, procedurën kontestimore gjithmon është ajo procedurë e cila bazohet vetëm në të drejtat, respektivisht insistohet në atë se kush ç'far të drejte ka, cila e drejtë i cenohet apo kërcënohet e kështu me radhë. "Medijatori i cili bazohet në interesin e palëve mundohet t'u ndihmoj palëve që të arrijnë marrëveshtjen duke i inkurajuar ato që të konsiderojnë interesat-nevojat, shqetësimet, frikën e cila shtrihet tek pozicioni i secilit prej palëve"²²⁶. Ajo e cila dëshirohet të arrihet sipas kësaj pikpamje është se edhe pse në fund të fundit për nga aspekti juridik vërehet se është e pamundur një pajtim në mes të palëve, ndoshta do të jetë e mundur që nga pikpamja tjetër – ajo e interesit të palëve të jetë pika e cila do t'i bashkoj palët dhe do t'i ulë në tavolinë para medijatorit si lehtësues i bisedimeve ndërmjet tyre dhe më në fund të arrihet një marrëveshtje e mundshme për të cilën nuk ka egzistuar aspak shpresa ashtu sic duket drita në fund të një tuneli. Nga kjo mundemi të vijmë në përfundim që për çdo medijacion të suksesshëm dhe që e njejta të mundet të funksionoj, duhet që gjat bisedimeve të jenë prezentë të dy palët dhe atë personalisht gjë e cila e dallon nga procedura kontestimore në të cilën procedura mundej të zbatohet dhe të përfundoj pa prezencën e palëve ose të palës ose vetëm me prezencën e përfaqësuesve të tyre ose edhe

²²⁶ Goldberg. B Stephen, Brett. M Jeanne, Blohorn-Brenneur. Beatrice, Rogers.H Nancy, How mediation works: Theory, Research and Practice, Emerald Group Publishing, UK, fq. 8

atëherë kur procedura zbatohet dhe përfundonte edhe pa vullnetin respektivisht kundër vullnetit të palëve/ës. Ndërsa kur jemi tek përfaqësuesit, nuk janë të ralla rastet kur palët drejtohen tek medijatori për zgjidhje të kontestit të tyre me anë të përfaqësuesit pa mar parasysht a është ai përfaqësues ligjor në këto raste i familjes, mik ose përfaqësues me prokur e cila është rasti më i shpeshtë në praktik. Kontakti i parë i medijatorit me palën dhe qasja e tij ndaj problemit apo kontestit dallon në rastet kur pala vetë i drejtohet medijatorit pasi që medijatori është ai i cili i pari diskuton për problemin për të cilën pala kërkon një zgjidhje, si dhe në rastet kur pala udhëzohet nga ana e gjykatës apo përfaqësuesit të tij që kontestin ta zgjidh me anë të medijacionit. Në rastin e dytë për shqetësimet dhe për kontestin e tij, pala para se të diskutoj me medijatorin, të njejtat i shpalos me gjykatën ose përfaqësuesin e tij. Si shqetësime të tilla të cilët mund të diskutohen me medijatorin, gjykatën ose përfaqësuesin e tij, më e dobishme dhe më frutdhënëse do të ishte që kontakti i parë i palës të ishte me medijatorin. Kjo është kështu sidomos në rastet kur tek pala thellë thellë në ndërgjegjen e tij është rrënjosur dyshimi i tij ndaj medijatorit si dhe procedurës së medijacionit, një dukuri shumë e shpeshtë sot sidomos në shtetin tonë. Detyra e medijatorëve në këto raste do të ishte se pala duhet të mos jetë e shqetësuar, pasi që edhe pse dyshimet e palës duken mjaft me vend, veçoritë e medijacionit janë ato që e bëjnë këtë procedurë të jetë më e lehtë, më e shpejtë dhe më të suksesshme se procedura kontestimore. Përderisa në procedurën kontestimore si dhe atë të arbitrazhit, avokatët janë ato të cilët kanë rolin më aktiv gjat zbatimit të procedurës, medijacionit këtë rol u'a rezervon palëve e cila u'a lejon atyre që ti shpallin interesat e tyre, të kuptojnë nevojat dhe njëkohësisht interesat e njëri tjetrit por edhe të kuptojnë më së miri qëllimet e vet procedurës. Pasi që janë ato shkaktar të vet problemit apo kontestit, është shumë më mirë që ato të jenë vet dizajnerët e zgjidhjes të të njejtave dhe kjo gjë u'a jep të drejtën atyre që të vendosin, e cila vendosje do të ishte e një rëndësie të madhe dhe si rezultat jo vetëm i prezencës personalisht të tyre, por edhe për qasjen aktive të tyre në diskutime dhe bisedime me palën kundërshtare dhe në presencën e medijatorit. Kjo u jep atyre mundësinë që të mund t'i shprehin ndjenjat e tyre, shqetësimet dhe në të njejtën kohë gjat kësaj të jenë të qetë se nga ana tjetër me vëmendje i degjon pala tjetër si dhe medijatori, ky i fundit edhe pse në shikim të parë duket se rolin në procedurën e medijacionit e ka të njejtë si gjykatësi në procedurë kontestimore ajo e cila e bën të dalloj nga gjykatësi i rëndomtë është se ai gjat gjithë kohës komunikon në mënyrë të vazhdueshme me palët dhe atë nga fillimi deri në përfundimin e procedurës me anë të marrëveshtjes apo përfundimit pa sukses.

Përveç se mund në mënyrë aktive të komunikoj dhe ti dëgjoj palët, ai gjithashtu mundet edhe t'u propozoj palëve mënyra të zgjidhjes të problemeve të tyre mirpo në asnjë mënyrë nuk duhet ta kaloj çakun dhe të insistoj për një zgjidhje të caktuar, një lëvizje apo veprim i cili mund të bëj që të dyshohet në paanësinë e tij. Përveç zgjidhjeve ai palëve mundet t'u propozoj edhe tekste në marrëveshtjen finale e cila është e paraparë edhe nënenin 7, al. 4 të Model ligjit të UNCITRAL-it për Medijacionin ndërkombëtar tregtar dhe marrëveshtjet ndërkombëtare të medijacionit²²⁷. Pra, nga medijatori gjat medijacionit të palëve kërkohet që të kenë përvojë për trajtimin e palëve gjat situatave konfliktuale, të jenë të aftë në komunikim dhe në përdorjen e teknikave negociuese, të jenë të aftë që të hartojnë një marrëveshje e cila do të shprehte mënyrën dhe llojin e zgjidhjes së mosmarrëveshtjes dhe më e rëndësishmja se si ajo marrëveshje do të pranohet nga palët. Gjithashtu e preferueshme nga gjith këto veti të cilët e kualifikojnë një medijator si të aftë dhe profesional është që të ketë edhe sadopak njohuri për procedurat gjyqësore. Në bazë të kësaj s'i kualifikuar do të konsiderohej medijatori i cili si profesion bazë ka drejtësinë, si p.sh gjykatësit apo avokatët. Kur përmendet gjykatësi si medijator, mundet të thuhet se qëndrimi i ashpër i tij dhe qëndrimet e tij të bazuara vetëm në ligje nuk e bën aq të përshtatshëm për të qenë medijator. Përshtatshëm më i përshtatshëm do të ishte një gjyqtar i pensionuar, i cili ka dije dhe njohuri të mjaftueshme edhe për nga aspekti i drejtësisë. Praktika gjithashtu ka treguar se si medijator të suksesshëm përveç gjyqtarëve të pensionuar për zgjidhje të kontesteve me marrëveshje të medijacionit konsiderohen edhe avokatëpërshkak të njohjes të mirë të ligjeve. Pse konsiderohet edhe njohja e ligjeve e rëndësishme për një medijator edhe pse nga ana tjetër me përmasa të mëdha në promovime, trajnime për medijacionin dhe punime shkencore të ndryshme si të vendit ashtu edhe ato ndërkombëtare thuhet se medijatori nuk është e thënë të jetë gjyqtar, jurist apo avokat. Kjo është kështu pasi që do të zvogëlohen rastet kur me anë të marrëveshtjes për medijacion të jetë me të meta ligjore. Mirpo kjo nuk është shkak që medijator të mos jetë edhe ndonjë person i ndonjë profili tjetër si: kontabilist, inxhinjer, psikolog, pedagog, mjek, ndërtimtar etj. "Mungesa e njohurisë juridike tek këto persona gjat procedurës së medijacionit do të menjanohet me anë të pranisë të avokatëve të palëve të cilët do të kujdesen për të gjitha aspektet juridike të marrëveshtjes të medijacionit²²⁸". Por nga ana tjetër fakti se juristët dhe avokatët kanë më tepër përvojë se si trajtohen lëndët gjyqësore, nuk don të thot se ato kanë ndonjë përparsi më

²²⁷Model ligji i UNCITRAL-it për Medijacionin ndërkombëtar tregtar dhe marrëveshtjet ndërkombëtare të medijacionit, 2018, Aneksi 2

²²⁸ Šimac. S, Medijacija – alternativnen nacin na rjesavanja sporova, Hrvatska pravna revija, 3:5/2003, fq. 131

tepër se sa medijatorët të cilët janë të profileve respektivisht të profesioneve tjera. Të shumta janë rastet të cilët kanë treguar se sa janë të suksesshëm medijatorët të profileve si psh: psikolog, professor apo inxhinjer. E kush mundet të jetë tregues më i mirë për suksesin e një medijatori se sa vetë palët në procedurën e medijacionit dhe si rezultat i suksesit të medijatorit do të varet edhe angazhimi i tij si medijator në të ardhmen. Momenti i rëndësishëm kur jemi tek medijatorët është edhe caktimi i medijatorëve. Kjo pikë konsiderohet si pikë dalluese ndërmjet procedurës së medijacionit dhe të procedurës kontestimore. Përderisa në procedurën kontestimore palët në asnjë mënyrë nuk mundet tëndikojnë në caktimin e gjykatësit i cili do të jetë ai i cili do të gjykojë dhe do të vendos për kontestin e tyre, në procedurën e medijacionit janë palët ato të cilët e caktojnë medijatorin, kjo e paraparë në nenin 16 të Ligjit për medijacionin. Palët pas shqyrtimit të listës së medijatorëve e cila është e publikuar dhe azhurnuar nga ana e Odës të medijatorëve caktojnë medijatorin i cili për to duket më i përshtatshëm pasi miren parasys faktorët si: përvoja, trajnimet, fakti se a është njohës i mirë i drejtës dhe ligjeve e të ngjajshme. Përve se palët mund të zgjedhin medijatorin i cili do të jetë i ngarkuar për zgjidhjen e kontestit, ato gjithashtu mundet të zgjedhin edhe numrin e medijatorëve të cilët do të jenë të angazhuar për zgjidhjen e kontestit të tyre. Sipas rregullit palët me marrëveshje mund të përcaktojnë nëse procedurën e medijacionit do ta zbatojnë një apo më shumë medijator, dhe me anë të marrëveshtjes caktojnë respektivisht emrojnë personat që do të bëhen medijator nga Lista e medijatorëve (neni 16 i LM). Edhe në Model Ligjin e UNCITRAL-it parashihet e njejta gjë për sa i përket numrit të medijatorëve. Sipas saj çdo herë do të ketë një medijator, përjashtimisht atëherë kur palët do të miren vesht që të ketë dy ose më shumë medijator²²⁹. Nëse palët nuk mund të mirren vesht për numrin ose personat që do të caktohen si medijator, mund të kërkojnë që Oda e medijatorëve të rekomandojë ose ta caktoj numrin e medijatorëve ose ta caktoj medijatorin në kontestin e caktuar²³⁰. Në rastet kur palët vendosin për numërin e medijatorëve të jetë më shumë se një medijator. Në këto raste kemi të bëjmë me medijacionin kolegjial apo komedijacionin, dhe atëherë egziston hapsira që të mund të kombinohen medijatorët të profesioneve dhe profileve të ndryshme.

2. Lënda e procedurës së medijacionit

²²⁹ Model ligji i UNCITRAL-it për Medijacionin ndërkombëtar tregtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare të medijacionit, neni 6

²³⁰ Ligji mbi medijacionin, neni 16, al. 2

Në të drejtën bashkëkohore metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve me të madhe janë duke u përparuar dhe me këtë edhe përdoren në përmasa të mëdha. Kjo falemenderuar faktin se sot egziston mendimi se qasja deri te e drejta nuk realizohet vetëm nëpërmjet të procedurës kontestimore si procedurë klasike gjyqësore por edhe në procedura tjera jokontestimore në rradhët e të cilës mer pjesë edhe medijacionit si një procedurë e tillë. Mbingarkesa e madhe e gjykatave në të cilën me vite me rradhë pritet zgjidhja e kontesteve të themi jo edhe aq të komplikuar ka bërë që sistemet gjyqësore të modernizohen dhe të thjeshtëzohen e kjo don të thotë të dilet nga ajo lëvizje e vrazhdë e dhënies të mbrojtjes juridike në procedurë gjyqësore dhe kjo mbrojtje të kërkohet jasht procedurës gjyqësore në një procedurë më të thjeshtë, më të shpejtë, më ekonomike dhe më efikase. Kjo çështje rregullohet nga secili shtet në mënyrë individuale pasi që është e drejtë ekskluzive e çdo shteti që të mbaj monopolin në disa fusha të së drejtës, dhe me këtë të vendos se cilat raporte do të vendosen në procedurë gjyqësore dhe me këtë të përjashtoj mundësinë që për ato raporte të vendoset në procedura të organeve tjera joshtetërore. Ato konteste janë ato për të cilat vendoset për të drejtat dhe obligimet themelore të njeriut dhe qytetarëve apo kontestet të cilët kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesit publik. Pra, nocioni kryesor i procedurës civile është çështja apo lënda kontestuese. Nga aspekti i të drejtës material, lënda kontestuese nënkupton të drejtën apo raportin juridik në të drejtën materiale e cila në aspektin procedural është sinonimi i kërkes padisë. Për gjykatën të rëndësishme janë vetëm ato rrethana të cilët i konsideron relevante në raport me rregullat juridike. Në këtë mënyrë gjykata i përzgjedh ato raporte të cilët i konsideron të rëndësishme dhe normat të përshtatshme në të drejtën pozitive.

Medijacioni është metod alternative e zgjidhjeve të kontesteve e cila gjen një përdorim të gjërë në shumë fusha të raporteve shoqërore. Kufijtë se për cilët raporte mund të përdoret caktohen nga ligjet e secilit shtet duke pasur parasysh vetitë e raportit e cila është kontestuese. Kur paraqiten konteste të tilla shumë e rëndësishme është që të analizohet raporti juridik kontestues e sidomos fakti se a është i përshtatshëm që i njejtë të zgjidhet me anë të medijacionit ose jo. Me fjalë tjera kjo paraqet medijabilitetin e cila u shtjellua në pjesën e parë të këtij punimi. Pse është e rëndësishme të kryhet analiza e secilit raport juridik? Është kështu pasi që jo të gjith raportet kontestuese janë të përshtatshme që të mundet të zgjidhen me medijacion, ndërsa nga ana tjetër të gjith mundet të zgjidhen në procedurë kontestimore. Që të mundet të vendoset që një lëndë kontestuese të zgjidhet me anë të procedurës së medijacionit duhet të shqyrtohen dhe

shikohen qëllimet e palëve, nevojat dhe interes të tyre si dhe ajo më e rëndësishmja – të përcaktohet marrdhënija në mes palëve kontestuese. Gjithashtu është shumë e rëndësishme edhe qasja e tyre ndaj medijacionit si procedurë alternative e zgjidhjeve të kontesteve. Kjo është kështu pasi që nëqoftë se tek njëra nga palët kontestuese egziston bindja se drejtësinë dhe mbrojtjen e nevojshme juridike do ta gjej vetëm në procedurë gjyqësore, dihet se ajo palë në asnjë mënyrë nuk do të dakordohet që kontestin e tij ta zgjidh me anë të medijacionit. Gjithashtu duhet të kiet edhe shumë kujdes kur vjen puna deri në paraqitjen e ndonjë kontesti me të cilën kërkohet që të rregullohet dhe të vendoset për ndonjëçështje juridike, në të cilët raste medijacionit aspak nuk është i lejuar. Por në praktikë kontestet të cilët paraqiten në numër të madh janë ato të cilët nuk kanë të bëjnë me fushat të cilët rregullohen me norma imperative dhe si të tilla janë të përshtatshme të jenë lëndë të medijacionit. Konflikti është pika vendimtare dhe fokusi tek medijacionit, pasi që tek ajo nuk vështrohet raporti kontestues vetëm për nga rrethanat të cilët janë relevante për nga aspekti juridik, por vështrimi zgjerohet edhe tek aspekti jo-juridik i rrethanave të cilët e përbëjnë përmbajtjen e raporteve ndërmjet palëve kontestuese. Ligji ynë mbi medijacionin në vetë nenin e parë parasheh lëndën e saj dhe fushën e veprimit të medijacionit sipas të cilit medijacionit mundet të përdoret në ato raporte kontestuese me të cilët palët munden lirshëm të disponojnë me kërkesat e tyre vetëm nëqoftë se me ndonjë ligj tjetër nuk është e paraparë kompetencë ekskluzive e ndonjë gjykate apo organi tjetër²³¹. Më tej, në alinenë e 2 të nenit të parë ligji parasheh edhe raportet kontestuese të cilët mundet të jenë lëndë e përshtatshme për medijacion sidomos duke parë natyrën e raporteve kontestuese si dhe përshtatshmërinë e medijacionit që të jet si lehtësues dhe ndihmës për zgjidhjen e tyre të cilët veçmë janë të përmendura tek medibijaliteti por në këtë nënpjesë do të shtjëllohen më gjërësisht secila prej tyre.

Medijacioni në **kontestet juridiko-pronësore** janë ato konteste të cilët paraqiten ndërmjet dy palëve ku pala paditëse pretendon për shkelje ose cënim të të drejtave subjektivo-pronësore nga ana e të paditurit. Lënda e këtij kontesti është gjithmonë i shprehur në vlerë në të holla respektivisht në kundërvlerë në të holla. Sipas Ligjit mbi procedurën kontestimore, kontestet juridiko-pronësore zgjidhen në procedurë kontestimore dhe si të tilla rregullohen me Ligjin mbi procedurën kontestimore. Ky ligj gjithashtu u'a mundëson palëve që këtë kontest ta

²³¹ Ligji mbi medijacionin, neni 1, al.1

zgjidhin edhe në mënyra tjera përfshirë këtu edhe në procedurë të medijacionit²³². Kontestet juridiko-pronësore të bashkëshortëve martesor dhe atyre jashtmartesor si dhe kontestet juridiko-pronësore të personave të cilët jetojnë në bashkësi konsiderohen si konteste të përshtatshme për t'u zgjidhur me anë të medijacionit nga shkak se përshkak të natyrës së raporteve të tilla ato janë dispositive dhe si të tilla at munden lirshëm të disponohen nga ana e palëve. Para së gjithash kur flitet për raportet të cilët krijohen në martesë, jasht martesë apo brenda në një familje, flitet për raporte ndërmjet personave të cilët jetojnë në një familje e cila jetesë bënë që ndërmjet tyre të lindin marrdhënie të shumë llojshme, të përhershme por edhe marrdhënie të cilët varen nga një tjetra. Për atë shkak në rast të prishjes të marrdhënive të tilla dalin në pah emocione e cila e zmadhon nevojën që ndërmjet tyre të rritet komunikimi e cila do të rezultoj me zvogëlimin apo menjanimin e tërë të konfliktit dhe të paraqitjes të kushteve normale për normalizim të kontakteve personale.

Medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve përdoret edhe për zgjidhjen e **kontesteve familjare**. Këto konteste konsiderohen konteste mjaft specifike për nga natyra e tyre dhe përshkak të raporteve të ngushta të cilët krijohen brenda për brenda familjeve. Ligji mbi procedurën kontestimore nuk përmban rregulla të veçanta me të cilat rregullohen këto konteste, por është Ligji mbi familjen²³³ ajo e cila i rregullon të gjitha procedurat e posaçme të kontesteve familjare. Procedura e pajtimit të bashkëshortëve²³⁴ në kontestet martesore, është një procedurë komplementare me procedurën e medijacionit. Bile mundet të thuhet se nga të gjith metodat e zgjidhjes paqësore të kontesteve, pajtimi është ai i cili është shfaqur që nga ligji e parë mbi familjen²³⁵ pas pavorsimit të Republikës së Maqedonisë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi medijacionin në vitin 2006 dhe me ndryshimet e Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 2008 u hapën mundësitë për hyrjen e medijacionit në procedurat respektivisht kontestet familjare dhe atë pajtim gjyqësor dhe jashtgjyqësor gjat kontesteve familjare si dhe medijacioni pas shkurorizimit të martesës. Pajtimin sipas rregullit e zbaton gjykata nëqoftë se bashkëshortët nuk kanë fëmijë respektivisht është kryetari i këshillit ai i cili cakton seancë të posaçme për pajtim të

²³² V. Jovanović, (2014), Pravni okvir primene medijacije u Srbiji, u: T. Džamonja Ignjatović (ur), Medijacija – principi,

proces, primena, Beograd, fq. 162

²³³ Ligji mbi familjen, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14 dhe 115/14)

²³⁴ Ligji mbi familjen, nenet 237-248

²³⁵ Ligji mbi familjen, neni 237, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 80/92

bashkëshortëve, dhe e njejta mbahet vetëm në prezencën e këtij të fundit dhe të bashkëshortëve²³⁶, ndërsa sipas nenit 237 nëse bashkëshortët të cilët kërkojnë shkurorizimin e martesës kanë fëmijë atëher procedurën e pajtimit e zbaton Qendra për punë sociale, e cila procedurë rregullohet me ligj. Gjat procedurës të pajtimit të bashkëshortëve detyra e personit i cili tenton të ndërmjetësoj dhe pajtoj bashkëshortët me marrdhënie të acaruar është i detyruar që ti gjej dhe t'i analizoj shkaqet që çuan deri në probleme në marrdhëniet martesore, dhe të mundohet që në çfar do mënyre së bashku me bashkëshortët t'i eliminoj të njejtit, dhe njëkohësisht t'i njoftoj bashkëshortët për pasojat të cilët i bie shkurorëzimi i një martese si për nga aspekti juridik ashtu edhe për nga ai psikik e pse jo edhe ai material. Ndonjëherë në seancën për pajtim të bashkëshortëve edhe pse nuk arrihet pajtim midis tyre, por nga ana tjetër ndërmjetësuesi respektivisht kryetari i këshillit gjyqësor për pajtim vëren fakte dhe shenja për një pajtim të mundshëm, ai mundet të caktoj edhe një seancë tjetër për pajtim (neni 241). Kur ndërmjetësuesi e sheh si të arsyeshme, ai ka të drejtë që të bisedoj veçmas me secilin bashkëshort me qëllim që të arrihet sa më shpejt efekti i pajtimit në mes tyre. Gjithashtu detyrë e ndërmjetësuesit është që bashkëshortët ti udhëzoj në këshillim për martesë ose të drejtohen në ndonjë institucion tjetër e cila mundet t'u jep të njejtëve ndonjë këshill ose mendim më profesional i cili mendim nuk konsiderohet aspak i detyrueshëm. Mendimi profesional i marë nga insitucionet e profesionalizuara për këtë problematikë përmban "informacione për zgjedhjen e medijatorit, anamnezën sociale të bashkëshortëve, të dhëna mbi dinamikën e marrdhënieve familjare si dhe vlersimin e mundësisë së rruajtjes të mardhënieve të përbashkëta në të ardhmen"²³⁷. Dhe në fund nëqoftë se asnjëra nga këto veprime nuk kanë sukses, atëher kryetari i këshillit gjyqësor do të caktoj seancën për shqyrtimin kryesor për shkurorizimin e martesës. Gjithashtu si rezultat i nxjerjes të Ligjit mbi medijacion si dhe me qëllim të promovimit të medijacionit si procedurë për zgjidhje më të shpejtë të kontesteve, Ministrija për punë dhe politik sociale në tetor të vitit 2013 dhan propozim për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi familjen. Një prej ndryshimeve thelbësore të cilët vërehen në këtë propozim ligj është ajo e ndryshimit dhe plotësimit të nenit 34 ku në alinenë tre kërkohet që të shtohet se martesë përfundon me marrëveshtjen për shkurorëzim të martesës e arritur në procedurë të medijacionit, e vërtetuar në

²³⁶ Ligji mbi familjen, neni 238

²³⁷ Uzelac. A, Aras. S, Maršić. M, Mitrović. M, Kauzlarić. Ž, Stojčević. P, (2010), Aktualne trendove mirnog rješavanja sporova u Hrvatskoj: Dosezi i ograničenja, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol. 60 No. 6, fq. 1293

noter në pajtim me Ligjin mbi medijacionin²³⁸. Neni pesë i këtij propozim ligji gjithashtu kërkon që të ndryshohet dhe të plotësohet neni 39 i cili parasheh që nëqoftëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur ose fëmijë të rritur për të cilët u është vazhduar e drejta prindërore, martesë shkurorrëzohet me marrëveshje për shkurorrëzim të martesës në procedurë të medijacionit. Gjithashtu në nenin 78 pretendohet të bëhet një plotësim i rëndësishëm. Ky nen ka të bëjë me çështjen e mbajtjes dhe edukimit të fëmijës në rastet kur bashkëshortët nuk mundet të mirren vesht për atë çështje dhe në ato raste kur kanë arritur një lloj marrëveshjeje por e njëjta nuk është aspak në interes të fëmijës. Propozohet që në këtë nen respektivisht në alinenë e parë të shtohet fjalia se Qendra për punë sociale mundet t'i udhëzojë prindërit që në procedurë të medijacionit të mund të arrijnë deri në marrëveshjen për atë se tek cili prind fëmija do të gjendet me qëllim të përkujdesjes dhe edukimit, si dhe në qoftë se me anë të medijacionit nuk munden që prindërit të arrijnë ndonjë marrëveshjeje të pranueshme për të dy, atëherë për këtë do të vendos Qendra për punë sociale. Gjithashtu në këtë nen propozohet që të shtohen edhe tre alineja të reja me të cilët do të rregullohej çështja e afateve të zgjidhjes të medijatorit si dhe të afatit deri kur medijatori është i obliguar që ta zbatoj këtë procedurë. Dhe si plotësime më rrënjësore konsiderohet propozimi për t'u shtuar tre nene të reja respektivisht neni 237a, 237b dhe 237 c. Neni 237 të ligjit aktual mbi familjen më lartë u shtjellua e cila ka të bëjë me zbatimin e pajtimit në mes të bashkëshortëve të cilët kërkojnë shkurorrëzimin e martesës së tyre. Sipas propozimit të nenit të ri 237a kërkohet që të shtohet se procedura do të zbatohet nga ana e medijatorit në qoftë se bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur ose fëmijë të rritur për të cilët u është vazhduar e drejta prindërore, ndërsa në qoftë se kanë fëmijë të mitur apo fëmijë të rritur për të cilët u është vazhduar e drejta prindërore, atëherë procedurën për pajtim të bashkëshortëve do ta zbatojnë Qendra për punë sociale ose medijatori. Gjithashtu në nenin 14 të këtij propozim ligji parashihet që në rastet kur bëhet pranimi i kërkesë padisë për shkurorrëzim, gjyqtari në seancën e parë do t'i pyes bashkëshortët se a kanë dëshirë që procedura e pajtimit të zbatohet nga ana e qendrës për punë sociale apo nga ana e medijatorit dhe si rezultat i zgjidhjes së tyre ato të nënshkruajnë pëlqim me shkrim. Më pastaj bashkëshortët në afat prej 3 ditëve nga dhënia e pëlqimit me shkrim kanë të drejtë që bashkarisht të caktojnë medijator nga lista e medijatorëve dhe për këtëta njoftojnë gjykatën. Dhe në rastet kur bashkëshortët nuk arrijnë që të vendosin bashkarisht se kush do ta zbatoj procedurën e pajtimit ose nuk kanë arritur që të vendosin për medijatorin, gjykata

²³⁸ Propozim ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi familjen, neni 4

sipas detyrës zyrtare do ta njoftoj qendrën për punë sociale për iniciimin e procedurës për pajtim të bashkëshortëve ndërsa Qendra për punë sociale është e obliguar në ato raste që në afat kohor prej tre muajve ta përfundoj procedurën për pajtim të bashkëshortëve. Sipas propozim ligjit nëqoftëse procedurën e zbaton medijatori, atëherë ai është i obliguar që në afat prej 45 ditëve ta zbatoj procedurën për pajtim të bashkëshortëve. Marrëveshtjen e arritur medijatori menjëherë e dërgon deri tek qendra kompetente për punë sociale e cila do të vërtetoj se a është marrëveshtja në interes të fëmijëve të mitur ose fëmijëve të rritur për të cilët prindërve u është vazhduar e drejta prindërore, dhe për mendimin e dhënë, Qendra për punë sociale e njofton gjykatën dhe medijatorin. Ndërsa sipas propozim ligjit nëqoftë se në afat prej 45 ditëve bashkëshortët nuk arrijnë marrëveshtje me nihmën e medijatorit, ky i fundit është i obliguar për këtë në afat prej tre ditëve me shkrim ta njoftoj gjykatën dhe qendrën kompetente për punë sociale e cila është e obliguar që brenda 45 ditëve të dërgoj mendim me shkrim deri tek gjykata se për cilin bashkëshort fëmijët e mitur apo të rritur por me të drejtë prindërore të vazhduar duhet të jipen fëmijët për ruajtje dhe edukim. Neni 237b parasheh kushtet që duhet një medijator t'i plotësoj²³⁹. Sipas Prof. Dr Alan Uzelac në punimin e tij shkencor të publikuar në Revistën e fakultetit juridik në Zagreb egzistojnë dy teori për sa i përket asaj se a mundet rregullat juridike të përgjithshme të Ligjit mbi medijacionin respektivisht medijacionit të zbatohet në kontestet juridiko-familjare të cilët nuk janë të parapara në Ligjin mbi familje. Sipas teorisë së parë medijacioni pa problem mundet të zbatohet për rregullimin juridik të marrdhënieve midis bashkëshortëve dhe anëtarëve tjerë të familjes si p.sh partnerët jashtmartesor, ish-bashkëshortët ose edhe ndoshta të afërmit tjerë, sidomos kur bëhet fjalë për të drejtat të cilët ato kanë të drejtë t'i disponojnë lirshëm e këtu e ka fjalën për të drejtat pronësore pa marr parasysh se për atë a është e paraparë me ligj medijacionit apo jo. Ndërsa sipas teorisë së dytëmedijacionit i cili është i rregulluar me Ligjin mbi medijacionin është medijacion i cili është i përshtatshëm për t'u zbatuar në fushat tjera të ligjit siç janë: kontestet tregtare ose ato të punës, dhe sii tillë është i papërshtatshëm me tiparet thelbësore të të drejtës familjare dhe me këtë edhe të raporteve dhe kontesteve familjare. Ajo që e bënë të veçantë të drejtën familjare dhe me këtë edhe raportet të cilët krijohen në familje është prezenca në masë të madhe të emocioneve, një veçori të cilën nuk e hasim në përmasa të mëdha në raportet dhe kontestet e natyrave tjera. Sot kemi njohuri për një

²³⁹ Sipas nenit 14 të propozim ligjit, medijator në konteste familjare dhe martesore mundet të jetë jurist i diplomuar, pountor social, pedagog, psikolog të cilët e kanë kryer trajnimin për medijator dhe kanë përvoj pune nga fusha e martesës dhe familjes prej së paku 5 vite.

shkallë të zmadhuar të procedurave për shkurorëzim të martesave, por gjithashtu edhe për faktin se nga ky numër i shkurorëzimeve janë të shumtë rastet kur prindërit nuk e ushtrojnë të drejtën prindërore përshkak të mosmarrëveshtjeve të shumta. “Qëllimi i medijacionit familjar është që t’u ndihmohet prindërve që të arrijnë ndërmjet veti një marrëveshtje e cila do të mundësonte pjesmarje të vazhdueshme të të dy prindërve në kryerjen e të drejtës prindërore si dhe bashkpunim ndërmjet të njejtëve”²⁴⁰. Konsiderohet e nevojës të madhe implementimi i medijacionit edhe në raportet familjare përfshirë këtu edhe ato martesore dhe prindërore sidomos nga fakti se fëmijët janë ato të cilëve më së shumti u cënohen interesat dhe janë ato emocionet e të cilëve preken më shumë. Kështu që lidhja në mënyrë të vazhdueshme e të dy prindërve dhe bashkpunimi i tyre për t’u tejkalluar mosmarrëveshtjet e vazhdueshme ndërmjet tyre të cilët rezikojnë psikikën dhe shëndetin e fëmijëve do t’u ndihmonte që të tejkalojnë të gjithë vështirësit, e cila procedurë dhe kush më së miri mundet të j’ju ndihmojë këtyre në këto raste përveç se procedura e medijacionit dhe medijatori si zbatuesit e njëjtës.

Medijacioni në *kontestet tregtare* – si konteste tregtare konsiderohen ato konteste të cilët rrjedhin nga marrdhëniet tregtare. Kontestet tregtare quhen ato konteste midis subjekteve tregtare lidhur me kontratat dhe transaksionet tjera të cilët janë të nevojshme për aktivitetin tregtar të atyre subjekteve tregtare²⁴¹. Sipas Prof. Dr Adnan Jasharit, mundet të shfaqen konteste të ndryshme tregtare, jo vetëm ndërmjet subjekteve të ndryshme afariste por edhe ndër themeluesit e shoqërive, midis themeluesve dhe organeve të shoqërive si dhe midis anëtarëve të vetë shoqërive²⁴². Konsiderohen se janë të përshtatshme për t’u zgjidhur me anë të medijacionit nga shkaku se subjektet në raportet tregtare mundet që lirshëm dhe me vullnetin e tyre të disponojnë me të drejtat e tyre. Si konteste tregtare mundet të paraqiten konteste nga qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve, nga transaksioni i pagesave, mosmarrëveshtjet nga fusha e sigurimeve, mosmarrëveshtjet bankare, për mbrojtje të pronësisë intelektuale e të ngjajshme. Ajo që i bën më së shumti subjektet në raportet tregtare që të vendosen që kontestin e tyre t’ia besojnë një medijatori të licencuar është shkaku i zvoglimeve të shpenzimeve të cilët do t’i kushtonte shuma të majme për zgjidhje në procedurat gjyqësore si dhe faktori kohë, i cili është i një rëndësisë së madhe për tregtarët, përshkak të lëvizjes së tyre nga vendi në vend dhe transaksionet e shumta të

²⁴⁰ Stevenson. M, (2000), Family Mediation: Working to Support Separated Families, y: M. Liebmann, Mediation In Context, Jessica Kingsley Publishers, London, fq. 41.

²⁴¹ Brestovci. F, (2004), E Drejta Procedurale Civile II. Prishtinë, fq.137

²⁴² Jashari. A, (2009), Subjektet e së drejtës afariste, Tetovë, fq. 142

cilët i bëjnë si brenda ashtu edhe jasht vendit si rezultat i qarkullimit të mallrave të tyre dhe shërbimet të cilët ato i japin. Gjithashtu para se të vendosën që kontestin e tyre ta dërgojnë në gjykatë i cili pas një procedure të gjat e të shtrejtë dhe shumë raskapitëse, duhet vetes t'ia parashtrajnë pyetjen: a i'a vlenë barra qirasë që me anë të procedurës gjyqësore ta prishin dhe ta humbin marrdhënien tregtare me subjektin tjetër e cila shumë lehtë mundet të shkatërohet falë procedurës gjyqësore? A nuk është më lehtë që të gjejnë metoda tjera që ta tejkalojnë atë mosmarrëveshtje dhe kështu të vazhdojnë me bashkpunim në të ardhmen? Në Republikën e Maqedonisë kontestet tregtare rregullohen me Ligjin mbi procedurën gjyqësore dhe atë në kreun e 31. Me ndryshimet e vitit 2015²⁴³ për zgjidhjen e kontesteve tregtare bëhet e obligueshme medijacionit si metodë alternative e zgjidhjes të kontesteve. Sipas nenit 47 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurë kontestimore, plotësohet neni 461 tek e cila shtohen katër alineja të reja, të cilët rregullojnë çështjen e përdorimit të medijacionit në zgjidhjen e kontesteve tregtare. Alineja e dytë e nenit 461 parasheh që për kontestet tregtare vlera e të cilit nuk e tejkalon shumën prej 1.000.000 denarë, palët janë të obliguara që para parashtrimit të kërkespadiës në gjykatë të përpiqen që kontestin e tyre ta zgjidhin në rrugë të medijacionit. Këto dispozita ligjore aplikohen si për kontestet nga marrdhëniet tregtare në të cilën të dy palët janë persona juridik, gjithashtu edhe për kontestet të cilët kanë të bëjnë me anijet dhe lundrimin në ujrat e brendshëm si dhe në kontestete ndaj të cilët aplikohet respektivisht zbatohet e drejta e lundrimit²⁴⁴. “Medijacioni sot konsiderohet një nga instrumentet kyç të qeverisjes të korporatës sepse fleksibiliteti i procesit mbi të cilën mbështetet mundet gjithmon të përshtatet për nevojat specifike të partnerit – për zgjidhjen aktive të mosmarrëveshtjeve të pjesmarësve dhe rolin e “kontrolluesit “ të rezultatit të procesit të medijacionit²⁴⁵. Fokusi i medijacionit si metodë tek kontestet tregtare më shumë anon në përmbushjen e interesave personale të palëve në kontest se sa në zgjidhjen e çështjeve juridike, e cila më së tepërmi arrihet në procedura gjyqësore. Kështu funksionon bota e tregtarëve dhe tregtia në përgjithsi. Pala paditëse është e obliguar që gjykatës kompetente për zgjidhjen e kontestit të tij, t'i dorëzoj dhe t'ia provojë faktin se ai sëbashku me palën tjetër kundërshtarë janë përpjekur që kontestin e tyre tregtar ta zgjidhin me medijacion

²⁴³ Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurë kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12 e 23.07.2015

²⁴⁴ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 462, al.1

²⁴⁵ A. Spaić, (2013), Medijacija u privrednim sporovima - Praktikum, Podgorica, fq. 48.

mirpo e njehta nuk ka patur sukses²⁴⁶. Në këto raste pala paditëse gjykatës mund t'ia dorëzoj deklaratën me shkrim të medijatorit se pas kryerjes të konsultimeve me palët është konkluduar se zbatimi i mëtejshëm i procedurës të medijacionit nuk është e arsyeshme, me deklartë me shkrim të palëve deri tek medijatori se procedura e medijacionit është përfunduar në ditën e parashtrimit të deklaratës, si dhe me deklaratë me shkrim të cilësdo palë në procedurë deri tek palët tjera dhe medijatori se procedura e medijacionit është përfunduar në ditën e parashtrimit të kërkesës²⁴⁷. Nga ana tjetër nëqoftëse medijacioni në mes palëve ka sukses, ajo përfundon me lidhjen e marrëveshtjes në formë të shkruar për zgjidhjen e raportit kontestues në mes të palëve, në ditën e lidhjen e marrëveshtjes (neni 20, al.1 pika 1 Ligjit mbi medijacion).

Kontestet nga *marrdhëniet e punës*—marrdhëniet e punës në Republikën e Maqedonisë rregullohen me Ligjin mbi marrdhënie të punës²⁴⁸ të cilët këto marrdhënie i definon si marrdhënie të cilët krijohen në mes të puntorëve dhe punëdhënësve me rastin e lidhjes të kontratës për punësim²⁴⁹. Në qoftë se i krahasojmë kontestet civile dhe ato tregtare me kontestet nga marrdhëniet e punës këto të fundit konsiderohen konteste të cilët janë të një numri të madh, pasi që për nga natyra e marrdhënies dhe kontaktet e përditshme në mes subjektet e kontestit e bëjnë që të dalloj nga kontestet e tjera. Pse përmendet kontakti i përditshëm në mes subjekteve? Pasi që është e pashmangshme që gjat përditshmërisë të këtyre marrdhënieve interesat e punëtorëve dhe të punëdhënësit të bien në kundërshtim. Çështja e mbrojtjes të të drejtave të punëtorëve dhe punëdhënësve gjithashtu, ka qenë temë diskutimi për shumë vite në shumë mbledhje të organizatave të ndryshme të punës botërore e cila temë sot e kësaj ditë është mjaft aktuale e sidomos në disa vende të botës ku të drejtat e punëtorëve nuk përfillen aspak. Në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe të punëdhënësve, rol të rëndësishëm në rregullimin dhe përcaktimin e marrdhënieve të punës ka edhe shteti, pasi që është e interesit të çdo shteti fakti se realizimi i të drejtës për punë dhe për të ardhura të mjaftueshme janë prezumin i drejtësisë shoqërore dhe stabilitetit të rendit shoqëror. Pra, konfliktet dhe mosmarrëveshtjet në këto raporte janë të

²⁴⁶ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 461, al.3

²⁴⁷ Ligji mbi medijacionin, neni 20, al. 1, pika 2, 3, 4

²⁴⁸ Ligji mbi marrdhënie pune, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 62/2005, 161/2005, 139/2005, 134/2005, 187/2005, 111/2006, 188/2006, 170/2006, 106/2008, 161/2008, 200/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 176/2009, 20/2009, 16/2010, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 263/2009, 158/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 52/2012, 13/2013, 25/2013, 54/2013, 170/2013, 187/2013, 34/2014, 62/2013, 113/2014, 145/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 74/2015, 129/2015, 167/2015, 27/2016, 114/2014.

²⁴⁹ Ligjit mbimarrdhënie pune, neni 1, al. 1

paevitueshme. Kontestet e punës mundet të jenë të dylojshme: konteste individuale dhe konteste kolektive²⁵⁰. “Në kontestet individuale palë janë punëdhënësi dhe një ose më shumë punëtor të cilët veprojnë si individë, ndërsa në kontestet kolektive si subjekt paraqiten organizata e cila i përfaqëson dhe mbron interesat e punëtorëve (sipas rregullit sindikata) ndërsa në anën tjetër punëdhënësi dhe organizata e tij”²⁵¹. Nga kjo mundet edhe të kuptojmë se lënda e kontestit dallon për nga ajo se tek kontestet individuale lëndë e kontestit është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të cilët rrjedhin nga marrdhënia individuale e punës, përderi sa në kontestet kolektive lëndë është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të cilët rrjedhin nga marrdhëniet kolektive të punës. Kohët e fundit medijacioni shumë e më shumë përdoret gjat zgjidhjeve të kontesteve në mes të punëtorëve dhe punëdhënësve. Përdorimi i shpeshtë i saj rezulton nga shkak se me anë të medijacionit mundet të arrihet që të zgjidhet dhe të tejkalohet përfundimisht një konflikt në mes të subjekteve të një raporti të punës nëpërmjet të komunikimit të tyre dhe në të ardhmen u ndihmon punëdhënësve që të mos njollosen. Jo çdo kontest i punës është i përshtatshëm për t’u zgjidhur me anë të medijacionit. Kështu, medijacionit nuk mundet të zbatohet në zgjidhjen e kontesteve për të cilët është e paraparë shqiptimi i masave të përkohshme nga ana e gjykatës të cilët masa do të ndalonin që me anë të dhunës dhe kanosjes të shkaktohet ndonjë dëm i cili do të ishte i përmasave të mëdha²⁵². Në kontestet individuale dinamika e medijacionit dallon në krahasim me në kontestet kolektive të punës. Kjo sepse “nëqoftë se paraqitet kontest e cila prek një punëtor individual, nënkupton angazhimin dhe praninë e atij punëtori për zgjidhjen e të njejtit”²⁵³. Sa i përket kontesteve kolektive të punës, këtu dinamika e medijacionit është shumë më e përshpejtuar sepse nga ajo se si medijacionit do të funksionoj në zgjidhjen më të shpejtë të kontestit varet ikja e pasojave të dëmshme që greva si organizim i punëtorëve të pakënaqur i ka. Janë tre akte kryesore të cilët në mënyrë analoge rregullojnë mënyrën e zgjidhjeve të kontesteve të punës qoftë ato individuale apo kolektive në Republikën e Maqedonisë dhe atë Ligji mbi marrdhëniet e punës, Ligji mbi zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës²⁵⁴ dhe Rregullorja për

²⁵⁰ Ligjit mbi marrdhënie pune, neni 235

²⁵¹ Uzelać. A, Aras. S, Maršić. M, Mitrović. M, Kauzarić. Ž, Stojčević. P, op. cit, fq. 1286

²⁵² Lovenheim. P, Guerin. L, (2004), Mediate dont litigate, Strategies for Successful Mediation, Berkeley, fq.12/2.

²⁵³ Foley. K, Cronin. M, (2015), Professional conciliation in collective labour disputes: a practical guide, ILO Decent Work Technical Support Team and Country Office for Central and Eastern Europe. - Budapest: ILO, fq. 15

²⁵⁴ Ligji për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 87/2007, 27/2014, 104/2014, 30/2016

marrdhënie të punës²⁵⁵. Sipas Ligjit mbi marrdhënie të punës me termin kontest kolektiv nënkuptohet kontesti e cila paraqitet si rezultat i lidhjes, ndryshimit, plotësimit ose zbatimit të kontratës kolektive të punës, realizimi i të drejtave në organizimin sindikal dhe grevë. Si palë në konteste kolektive sipas këtij ligji konsiderohen pjesmarrësit në lidhjen e kontratës kolektive në pajtim me ligjin²⁵⁶ ndërsa si kontest individual të punës konsiderohet ai kontest i cili paraqitet si rezultat i ndërprerjes të kontratës së punës dhe përshkak të mospagesës së rrogës. Si palë në kontestin individual sipas ligjit konsiderohen punëtori dhe punëdhënësi²⁵⁷. Në kreun 17 të Ligjit mbi marrdhënie të punës është e paraparë zgjidhja paqësore e kontesteve individuale dhe kolektive respektivisht në nenin 182 sipas të cilës palët (punëtori dhe punëdhënësi) kanë të drejtë që të miren vesht që kontestin e tyre t'ia besojnë një organi të veçantë për zgjidhje e caktuar me ligj. Gjithashtu në këtë ligj parashihet edhe fakti se me marrëveshje kolektive paraprakisht të zgjedhin palët arbitrazhën në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti ndërmjet tyre në të ardhmen dhe sëbashku me këtë të caktohet edhe përbërja, procedura dhe shumë çështje tjera me rëndësi²⁵⁸. Në mënyrë analoge këtë problematik e rregullon në mënyrë të detajuar edhe Ligji mbi zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, sipas të cilës zgjidhjen e kontesteve individuale dhe kolektive në mënyrë paqësore e bëjnë medijatorët dhe arbitrat në kushte dhe mënyrë të caktuar me ligj (neni 7). Edhe Rregullorja për zgjidhjen e kontesteve të punës me nenet 69, 70 dhe 71 parashih mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Kështu, sipas nenit 69 me qëllim të realizimit të të drejtave individuale nga marrdhënia e punës, punëtori ka të drejtë të kërkojë mbrojtje tek punëdhënësi, para gjykatës kompetente, sindikata, organet për inspektim dhe organe tjetra të caktuara me ligj. Me anë të arbitrazhës zgjidhen në mënyrë paqësore të gjithë kontestet individuale të cilët kanë të bëjnë me ndërprerje të kontratës të punës ose përshkak të mospagesës së rrogës nga ana e punëdhënësit, e cila paraqet llojin e kontestit më të shpeshtë në këtë shtet. Këtë lloj të procedurës e udhëheq arbitri i cili është i obliguar që të caktoj seancë për shqyrtim në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të propozimit dhe dokumentacionit për lëndën e kontestit për çka i informon palët në kontest²⁵⁹. Shqyrtimi mbahet gjithmonë në prani të palëve e cila sipas nenit 31 është publike por përjashtimisht arbitri është ai i cili mund të vendosë që ta përjashtoj publikun

²⁵⁵ Rregullorja për marrdhënie të punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 9/2008

²⁵⁶ Ligji për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, neni 2

²⁵⁷ Ligji për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, neni 3

²⁵⁸ Ligji mbi marrdhënie pune, neni 183, al. 1, 2

²⁵⁹ Ligji për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, neni 30, al.1

nëse për një gjë të tillë egzistojnë arsye. Gjith procedura para arbitërit është e rregulluar shprehimisht me ligj. Ligji e obligon këtë të fundit që të bie vendim për lëndën kontestuese në afat prej 30 ditëve nga disa e fillimit të shqyrtimit²⁶⁰. Ndërsa llojet tjera të kontesteve individuale të punës mundet të zgjidhen nëpërmjet të medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve e cila është e rregulluar me anë të Ligjit mbi medijacionin si dhe Ligjit mbi zgjidhje paqësore të kontesteve të punës. Tek kontestet kolektive pjesmarësit në marrëveshtjen kolektive mundet të paraqesin propozim²⁶¹ deri tek Këshilli për pjesmarje të medijatorit për t'i ndihmuar që të arrijnë marrëveshje kolektive me qëllim që t'i ndihmoj për të penguar paraqitjen e ndonjë kontesti. Sipas al. dy, këtë propozim palët munden ose bashkarisht me pjesmarësit tjerë t'ia parashtrorjnë Këshillit. Në periudhën e kaluar kemi qenë dëshmitarë të pakënaqësive të mëdha të puntorëve me kushtet e punës të cilët këtë pakënaqësi e kanë shprehur me anë të grevës. Ligji parasheh që në raste të tilla dhe në raste të kontesteve të veprimtarive²⁶² të cilët konsiderohen të interesit të përgjithshëm, ose veprimtarit ndërprerja e të cilëve do të rrezikonte jetën ose shëndetin e njerëzve ose të shkaktoj dëme të përmasave të mëdha, palët në kontest janë të obliguar që të drejtohen kah zgjidhja paqësore e kontestit të punës në afat prej 10 ditëve nga dita kur është parashtruar kërkesa²⁶³. Ligji gjithashtu përcakton edhe hapat e procedurës për pajtim. Medijatori është i obliguar që të caktoj seancën brenda tre ditëve nga dita e pranimit të propozimit dhe të dokumentacionit për lëndën e kontestit dhe për këtë t'i lajmëroj palët (neni 21, al.1). Gjat procedurës para medijatorit palët mundet të marin pjesë personalisht ose të caktojnë përfaqësues të tyre, të cilët ne seancë i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre. Pas përfundimit të procedurës medijatori i mbyll bisedimet dhe me anëtarët e Këshillit miraton rekomandim e cila përmban mënyrën e zgjidhjes të kontestit e cila në asnjë mënyrë nuk konsiderohet e obligueshme për palët, pasi që ata janë ato të cilët pas shqyrtimit të së njëjtës do të vendosin se a do ta pranojnë ose jo nga e cila edhe varet a do të nënshkruhet Marrëveshja për

²⁶⁰ Ligji për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, neni 35

²⁶¹ Propozimi përmban: llojin e marrëveshtjes kolektive, pjesmarësit, vendin dhe kohën e bisedimeve, propozimin e përbashkët, emrin, mbiemrin dhe adresën e medijatorit. Neni 16, al.4 Ligjit për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës.

²⁶² Si veprimtari të tilla konsiderohen veprimtarit në sferën e elektro-ekonomisë, ekonomisë së ujrave, komunikacionit, radiotelevizionit, veprimtarit themelues i të cilëve është Republika e Maqedonisë ose njësitë e vetadministrimit local, shërbimet e PTT-së, veprimtarisë komunale, prodhimtaria e produkteve themelore ushqimore, mbrojtja shëndetësore dhe veterinerë, arsimit, mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja sociale, policia dhe mbrojtja.

²⁶³ Ligjit për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, neni 18, al. 1

zgjdhjen e kontestit apo jo²⁶⁴. Pra rezultati i punës së medijatorit në Këshill është i dyanëshëm: palët në kontest nuk e pranojnë rekomandimin në të cilët raste duhet të tregojnë edhe shkaqet për një gjë të tillë, apo ta pranojnë rekomandimin sipas nenit 27, dhe si rezultat i kësaj ta nënshkruajnë marrëveshtjen për zgjidhjen e kontestit brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e hapjes së bisedimeve dhe me këtë të përfundoj procedura e medijacionit.

Që një raport shoqëror të jetë raport kontestues, duhet të egzistoj kontesti²⁶⁵. Në qoftë se vështrojmë procedurat kontestimore dhe ato të medijacionit në thelb, ajo që do të në bie në sy do të jetë dallimi i tyre për nga qasja e tyre ndaj kontestit si dhe për mënyrën se si do të zgjidhet e njejta. Kështu, tek procedurat kontestimore ajo e cila kërkohet të bëhet është që të vërtetohet se tek kush qëndron faji për situatën konfliktuoze të krijuar, në atë mënyrë që njëra palë e cila është titullar i të drejtës subjektive kërkon nga pala tjetër i cili është bartës i ndonjë detyrimi ligjor ta kryej apo ta përmbush obligimin që ka ndaj tij ndërsa nga ana tjetër i dyti kërkon që ti ik atij obligimi. Ndërsa te procedurat e medijacionit, ajo që i bën si procedura më paqësore të zgjidhjeve të kontesteve si dhe jo aq stresuese dhe të vrazhda sa procedurat kontestimore është se ajo nuk insiston në gjetjen e fajtorit dhe nga ana tjetër të atij i cili ka të drejtë, por mbi tavolinë shpalosen para së gjithash nevojat, interesat si dhe në shumicën e rasteve edhe ndjenjat e palëve. Përderisa tek procedurat kontestimore palët sulmohin njëri me tjetrin me fakte dhe argumente që të provojnë të drejtën respektivisht pafajsin e tyre, tek procedurat e medijacionit këto veprime të palëve nuk egzistojnë, pasi që palët ulen dhe bashkarisht punojnë për tejkalimin e problemit duke kooperuar ashtu që në vend të konfrontimit të tyre ato ulen së bashku para problemit për ta zgjidhur të njejtin. Dhe në fund ç'far rezultate arrihen? Nëqoftë se raporti kontestues është lëndë e procedurës gjyqësore klasike efekti përfundimtar do të jetë gjithmon një pastrim llogarish armiqësore ndërmjet palëve kontestuese, si dhe armiqësi me njëri tjetrin deri në fund të jetës përderisa tek medijacionit ky efekt përfundimtar nuk arrihet. Nëse shkohet në atë varijant që një procedurë kontestimore të zgjidhet me anë të pajtimit gjyqësor, këtu arrihet që çështja kontestuese dhe kontesti të zgjidhen në mënyrë paqësore dhe miqësore. Edhe pse kjo veçori e bën që efekti i pajtimit të duket i njejtë si ai efekt i cili arrihet me anë të medijacionit, në fakt nuk është ashtu, pasi që me anë të medijacionit përveç se arrihet marrëveshtje për zgjidhjen e një

²⁶⁴ Ligjit për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, neni 25, al. 1, 2, 3

²⁶⁵ "Në kuptimin më të gjërë, termi contest përdoret për të përcaktuar atë situatë shoqërore në zhvillimin e një raporti, kur ndërmjet subjekteve të raportit egziston mospajtueshmëri për një çështje relevante për atë raport", Яаневски. А, Зороска-Камилоска. Т, вер. cituar, fq. 60

kontesti apo raporti kontestues, gjithashtu rregullohen edhe shum raporte tjera ndërmjet palëve në kontest të cilët gjat procedurës dalin në pah ndërmjet tyre. Ajo që është më e rëndësishme në këto raste është se problem zgjidhet ndërsa marrdhëniet ndërmjet palëve nuk acarohen as prishen nga vet shkakut se deri në zgjidhjen e kontestit e cila është lëndë e procedurës së medijacionit shkohet me vet iniciativën e palëve me përshtatjen e propozimeve dhe intersave ndërmjet tyre. Pikë tjetër e cila e dallon pajtimin gjysësor në procedurë kontestimore është se janë një varg veprimesh të cilët nuk ndërmiren tek medijacionit si p.sh: pranimit i fajit nga njëri prej palëve me çka ai shpallet fajtor, pastaj gaditshmëria e tij të kërkoj falje si dhe të paguaj dëmshperblimin e kështu me rradhë. Pra, parashtrahet pyetja a i'a vlenë që palët të kalojnë në një procedurë aq të gjat e të komplikuar të pajtimit gjyqësor kur kontesti mundet të menjanohet shumë më thjeshtë dhe më shpejtë nëpërmjet të medijacionit? Faktori kohë dhe thjeshtësia janë treguesi më i mirë për zgjidhjen e medijacionit përpara procedurës kontestimore respektivisht para pajtimit gjyqësor.

3. Procedura – Procedura kontestimore dhe procedura e medijacionit në Republikën e Maqedonisë

3.1 Procedura kontestimore

Procedura civile paraqet një rënë nga metodat bazë të mbrojtjes të të drejtave subjektive civile të lënduara apo të kërcënuara nga ana e organeve kompetente shtetërore të caktuara me ligj. Si organ i cili gjithmon u del qytetarëve në ndihmë në raste të lëndimit apo kërcënimit të të drejtave subjektive është gjykata. Profesor Faik Brestovci kuptimin e termit procedurë gjyqësore civile e ndan në dy kuptime: në kuptimin material dhe atë formal. Përderisa në kuptimin material ai me procedurën gjyqësore nënkupton aktivitetin e cila është e përbërë nga tërësia e veprimeve të caktuara të subjekteve të ndryshme pa të cilët subjekte mbrojtja juridike nuk do të mundeshte të jepej e as e drejta subjektive e shkelur do të mundej të realizohej, ndërsa për nga kuptimi formal me termin procedurë gjyqësore nënkuptohet tërësinë e rregullave juridike me të cilat përcaktohen pjesmarësit në procedurë, të drejtat dhe obligimet e tyre procedural, forma dhe afatet e kryerjes si dhe efektet që prodhojnë këto veprime²⁶⁶. Termi procedurë civile është një

²⁶⁶ Brestovci. F, op. cit, fq. 9

termë i gjërë i cili nënkupton më shumë metoda dhe procedura të ndryshme të mbrojtjes të të drejtave subjektive civile të cilët për nga natyra dhe përmbajtja e tyre dallojnë njëra nga tjetra (procedura kontestimore, procedura jokontestimore dhe procedura përmbarese). Ky term konsiderohet si term i lindur brenda kornizave të teorisë juridike pasi që e njëjta aspak nuk bën pjesë të dispozitat juridike të ligjeve. Procedura kontestimore është procedura kryesore dhe e rregullt për mbrojtjen e të drejtave subjektive të qytetarëve. Rregullat e ligjit të cilat rregullojnë këtë procedurë në Republikën e Maqedonisë e autorizojnë gjykatën që menjëherë të veprë kur para tij paraqitet kërkesa e qytetarit për nevojën e dhënies të mbrojtjes të nevojshme juridike, përjashtimisht në rastet kur në bazë të ligjit e cilla rregullon këtë procedurë apo të ndonjë ligji tjetër, kompetente për këtë do të jetë ndonjë organ tjetër, respektivisht mbrojtja do të jepet me anë të ndonjë metode apo procedure tjetër. Procedura kontestimore është një procedurë të cilën nëqoftëse e ilustruam për nga ana figurative, mundemi ta kuptojmë si një kutij me mjete pune, ku secila prej atyre veglave apo mjeteve ka qëllimin e përdorimit të tyre. Kështu, edhe procedura kontestimore që të fillojë, zbatohet dhe të përfundohet suksesshëm duhet të ndërmerren disa veprime të caktuara për secilin subjekt në një rradhitje të caktuar si dhe nën kushte dhe formë të caktuar. Si pasojë e kësaj në mes të subjekteve në procedurën kontestimore krijohen disa marrdhënie të caktuara e cila marrdhënie egziston deri në përfundimin e procedurës kontestimore në mënyrë të plotfuqishme.

Procedura kontestimore nuk do të konsiderohej procedurë e rregulluar me ligj nëqoftëse nuk do të ndërtohej duhe u mbështetur në disa parime të cilët nëqoftë se nuk do të ndiqen në ato raste procedura nuk do ta përmbush qëllimin për të cilën ajo inicohet. *Parimi i ligjshmërisë dhe kushtetueshmërisë* është parimi i parë i cili kërkon që procedura kontestimore të zbatohet që nga fazat fillestare deri në përfundimin e saj duke u mbështetur në Kushtetutën dhe ligjet si dhe të gjithë veprimet procedurale të cilët do të ndërmerren nga subjektet në procedurë duhet gjithashtu të jenë në përputhshmëri me ato veprime të cilët i parasheh ligji, ndërsa “parimi i legalitetit e siguron objektivitetin në punë të gjykatës si dhe barabarsinë e palëve në gjykim”²⁶⁷. *Parimi i dispozivitetit dhe oficijalitetit* – parimi i dispozivitetit don të thotë se palët mund të lirisht të disponojnë me të drejtat e tyre subjektive civile, pra çështja e fitimit, ushtrimit dhe shuarjes të atyre të drejtave varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e atij që e posedon atë të drejtë

²⁶⁷ Ibid, fq. 31

respektivisht titullarit të të drejtës subjektive civile. Nga ana tjetër oficaliteti don të thotë se procedura kontestimore nga filli deri në fund zbatohet zyrtarisht nga ana e gjykatës (sipas detyrës zyrtare)²⁶⁸. *Parimi i pandërmjetësisë* – ky parim është sinonim i metodës apo mënyrës se si mbliidhet dhe analizohet materiali procedural. Ky parim nënkupton atë se nga gjykata kërkohet që ai vetë me shqisat e veta ta vërej materialin provues përfshirë këtu përmbajtjen, natyrën si dhe të gjithë vetitë që e përbëjnë atë. Gjithashtu ky parim kërkon që ajo gjykatë e cila në mënyrë të pandërmjetme ka egzaminuar mjetet provuese, të jetë po ai i cili do të vendos për çështjen kontestuese duke u bazuar në ato mjete provuese. Por në praktik egzistojnë edhe disa raste kur ndonjë mjet provues të pandërmjetëm të duhet ta shqyrtoj një gjykatë tjetër e jo ai i cili vendos për lëndën kontestuese – shqyrtim i ndërmjetëm i mjeteve provuese²⁶⁹. *Parimi i zhvillimi të gjyqimit gojarisht dhe me shkrim* – janë parime të cilët kanë të bëjnë me formën në të cilën ndërrmeren të gjitha veprimet procedural në procedurën kontestimore²⁷⁰. *Parimi i publicitetit* don të thotë se sipas ligjit për procedurë kontestimore procedura kontestimore në shtetin tonë është publike, gjë që lejon marrjen pjesë të një numri të papërcaktuar të personave në seancat gjyqësore²⁷¹. Përdorimisht nga ky parim mundet të hiqet dorë nëqoftë se gjykata vleron se pjesmarrja e publikut është i nevojshëm përshkak se gjat seancave do të shtjellohen marrdhënie të palëve të cilët janë të karakterit personal apo intim. *Parimi i dëgjimit të palëve* realizohet me kryerjen e obligimit të gjykatës që të degjoj të gjitha palët para se të mer vendim meritör me të cilën do ta përfundoj procedurën²⁷². *Parimi i gjuhës në procedurë* – rregullon çështjen e përdorimit të gjuhës në procedurë. Gjuhë zyrtare në procedurë para gjykatës është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik si dhe gjuha të cilën e flasin 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj. Me propozim ligjin e ri për përdorimin e gjuhëve²⁷³ në procedurat gjyqësore u jepet e drejta si palëve dhe pjesmarrësve tjerë ashtu edhe gjyqtarëve dhe prokurorve publik nëqoftë se janë persona të cilët flasin gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonsië, që procedura të zbatohet në atë gjuhë si dhe të gjithë veprimet procedural të

²⁶⁸ Георгиевски, С, (1984), Парнична Постапка, Shkup, fq. 72

²⁶⁹ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 101

²⁷⁰ Parimi i zhvillimit me gojë kërkon që veprimet e caktuara procedurale të ndërmeren gojarisht ndërsa parimi me shkrim parasheh veprimet të cilët duhet të ndërmeren me shkrim gjat procedurës. Si zakonisht gjat seancave në gjykatë veprimet procedural ndërmeren me gojë, ndërsa jasht seancave gjyqësore me shkrim.

²⁷¹ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 4

²⁷² Brestovci, F, op. cit, fq. 32

²⁷³ Propozim ligji për përdorimin e gjuhëve

ndërmiren në atë gjuhë pa marr parasyshë a bëhet fjalë për veprime të cilët duhet të ndërmiren gojarisht apo me shkrim²⁷⁴. *Parimi i konstatimit të vërtetës* – thelbi i këtij parimi është ajo se gjykata duhet saktë dhe në mënyrë të drejtë t'i vërtetoj faktet të cilët janë të rëndësishë të madhe për sjelljen e një vendimi të drejtë dhe ligjor pasi që nga ajo varet aplikimi i drejtë i të drejtës materiale. Dhe në atë mënyrë do të rregullohet rendi juridik i çrregulluar²⁷⁵. Parimi i shqyrtimit dhe hetimit – paraqesin metoda të të vepruarit të gjykatës dhe të palëve në lidhje me mbledhjen e materialit procedural në bazë të të cilës gjykata do të sjell vendim meritor. Në të drejtën tonë, bara e mbledhjes tëfakteve dhe të propozojnë prova me të cilët vërtetohen ato fakte qëndron tek palët, ndërsa gjykata është i autorizuar që ti vërtetoj faktet të cilët palët nuk i kanë nxjerur si dhe t'i nxjerë provat të cilët palët nuk i kanë propozuar, nëse vërteton se palët nuk mundën të disponojnë me ato kërkesa. *Parimi i konstatimit të vërtetës* gjithashtu është metodë të cilën e përdor gjykata gjat mbledhjes të materialit procedural si rezultat i të cilës ai duhet të sjell vendim meritor lidhur me lëndën kontestuese²⁷⁶. Gjat analizës së provave gjykata, varësisht asaj amungojnë ose jo rregullat ligjore mbi zgjedhjen, analizën dhe fuqinë e mjeteve provuese, mundet të përdor sistemin e vlerësimit të lirë të provave apo sistemin e vlersimit legal të provave. *Parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm* – është parim i cili kërkon nga gjykata që të insistoj që procedura të zbatohet dhe të përfundoj pa zvarritje dhe në afat të arsyeshëm. Pasi që me ligj nuk mundet të caktohet një afat i përgjithshëm për të gjith kontestet duke mar parasysh natyrën komplekse dhe përmbajtjen unikate të të gjith kontesteve veç e veç, kërkohet nga gjykata që procedurën të mos e stërzgjas pa nevojë si dhe gjithashtu kërkon edhe nga palët që të kenë kujdes gjat ndërmarjes së veprimeve procedural, dhe të njejtat t'i ndërmarin në kohë, pa zvarritje dhe pa qëllime dytësore. *Parimi i ekonomisë procedurale* gjithashtu ka të bëj me udhëheqjen e procedurës nga ana e gjykatës pa vonesa, zvarritje dhe me më pak shpenzime respektivisht kontesti të përfundoj me përdorimin e sa më pak veprime dhe mjete materiale por nga ana qetër të arrihet rezultati i volitshëm²⁷⁷. *Parimi i shfrytëzimit me mirbesim të autorizimeve procedural* – nënkupton se titullari i të drejtave procedurale nuk guxon që t'i keqpërdor ato²⁷⁸ sepse në të kundërtën do të pasoj dënim me të holla personin i cili do të bëj keqpërdorime të tilla pa mar

²⁷⁴ Propozim ligji për përdorimin e gjuhëve, neni 9

²⁷⁵ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 90

²⁷⁶ Ibid, fq. 80

²⁷⁷ Ibid, fq. 110

²⁷⁸ Brestovci, F, op, cit, fq. 36

parasysh a bëhet fjalë për palët, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi me prokur apo ndërhyrës. *Parimi i koncentrimin të procedurës dhe unitetit të shqyrtimit kryesor* – ky parim kërkon nga Këshilli respektivisht gjyqtarit të vetëm që lëndën e kontestit të shyrtohet mirë, por nga ana tjetër procedura të mos zvarritet ashtu që shqyrtimi të mundet të përfundoj në një seancë të vetme²⁷⁹.

3.1.1 Nisja, ndërprerja, vazhdimi dhe përfundimi i procedurës kontestimore në shkallë të parë

Veprimi procedural i parë me të cilën inicohet secila procedurë kontestimore është padia e cila parashtrëhet nga paditësi kundrejt të paditurit tek gjykata kompetente e përpiluar në formë dhe me përmbajtje të caktuar me ligj²⁸⁰. Paraqitja e padisë varet nga paditësi dhe me këtë manifestohet vullneti i tij për inicim ose jo të procedurës kontestimore. Kjo është një veti e cila e bën të ngjajshme me procedurën e medijacionit, pasi që edhe atje çështja e inicimit varet nga vullneti i palëve. Me padinë paditësi kërkon nga gjykata që në bazë të shqyrtimit të fakteve dhe provave të cilët janë të rëndësishme të madhe për kërkespadinë e tij, të sjell vendim me të cilën do ta pranoj kërkesën të cilën paditësi e ka parashtruar në padi dhe me këtë të siguroj mbrojtje të të drejtës së tij subjektive. Deri më tani krijohet raport i dyanshëm vetëm ndërmjet palës paditëse dhe gjykatës. Përgaditja e shqyrtimit paraprak vijon pas paraqitjes të padisë në gjykatë nga paditësi. Kjo fazë është faza e parë dhe e obligueshme me të cilën bëhen përgaditjet për shqyrtimin kryesor. Në këtë fazë gjykata ndërmer një sërë veprimesh me të cilën shqyrtohet padia, a është e njejta e kompletuar, i shqyrton edhe përmbushjen e prezumimeve

²⁷⁹ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 116

²⁸⁰ Sipas nenit 98 të Ligji mbi procedurën kontestimore padia duhet të përpilohet në formë të shkruar, të jetë e kuptueshme dhe doemos duhet të përmbaj gjithçka që është e nevojshme që të mund të veprohet për ato. Gjithashtu padia duhet të përmbaj edhe të dhëna për gjykatën, emrin, profesionin dhe vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin e palëve përkatësisht firmën dhe selinë e personit juridik, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë nëse të njejtë i kanë, lëndën e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe nënshkrimin e parashtruesit. Pala gjithashtu duhet ta shënoj edhe numrin e vetë amë të qytetarit dhe numrin tatimor, si dhe faktet në të cilën bazohet kërkesa dhe provat të cilët i provojnë ato fakte nëse kjo është e nevojshme. Nëqoftëse padia dorëzohet në gjykatë nga ana e avokatit të palës paditëse, atëherë ajo detyrimisht duhet të përmbaj edhe vulën e avokatit dhe markën e avokatit të paraparë me ligj të veçantë, sepse në të kundërtën parashtrësia do të konsiderohet si jo e rregullt dhe gjykata do ta hedh posht. Ndërsa neni 101 parashih se nëqoftë se padia është e pakuptim dhe nuk i përmban të gjitha elementet e nevojshme dhe të parapara me ligj, gjykata parashtruesit do t'ia kthej për përmirësim apo plotësim brenda afatit të cilën ai do t'ia caktoj por e cila nuk mundet të jetë më e gjatë se 15 ditë. Në qoftë se brenda atij afati parashtruesi nuk e dorëzon padinë atëherë do të konsiderohet se e njejta është tërhequr, ndërsa në qoftëse e dorëzon por të papërmisuar atëherë padia do të hidhet posht.

procedurale²⁸¹. Kur gjykata konstaton se padia i plotëson të gjitha kushtet për sa i përket formës dhe përmbajtjes të paraparë me ligj, i'a dorëzon të paditurit për t'u deklaruar. Ky është momenti kur raporti nga i dyanshëm bëhet i treanshëm, pasi që në "loj" hynë edhe i padituri. Gjykata deri në këtë stadium të procedurës gjat gjithë kohës "ex officio" kujdeset a zbatohet njëkohësisht ndonjë procedurë tjetër me të njejtët palë, sepse nëse vërtetohet për egzistimin e ndonjë procedure e cila veç më rrjedh do ta hedh posht padinë"²⁸². Kur në loj bashkangjitet edhe i padituri atëherë me të dy palët kontestuese në një të anë dhe me gjykatën në anën tjetër konsiderohet se plotësohet skema më e thjeshtë në kuptimin subjektiv e procedurës kontestimore e cila edhe është e mjaftueshme për zbatimin e një procedure kontestimore. Kjo nuk don të thotë se të gjithë rastet apo edhe në rastet kur fillohet me këtë skemë, e njejta nuk mundet të ndryshohet në fazat e më tutjeshme të procedurës. Sipas nenit 186, al. 2 deri në mbarimin e shqyrtimit kryesor padia mundet të zgjerohet ndaj paditësve të ri me kusht që i njejtë ta pranojë kontestin në atë gjendje në të cilën është në momentin e hyrjes apo inkuadrimin të tij. Teoria juridike këtë dukur e njeh me termin ndryshim subjektiv të padisë. Parashtrahet pyetja çka do të ndodh me palën kundërshtare kur tek adresa e tij arrin padia? Në atë moment kjo palë e marrdhënies juridiko-materiale kontestuese në procedurën e inicuar kontestimore fiton statusin e palës kontestimore të paditur – *reus*. Dërgimi i padisë të paditurit për përgjigje përbënë fazën e dytë të pregaditjes të shqyrtimit kryesor. Para të paditurit janë disa zgjedhje të cilët ai i ka në dispozicion që ti bëjë, dhe nga të cilët do të varet edhe qëndrimi²⁸³ i tij ndaj padisë. Sipas LPK të vitit 1998 kur padia i dërgoheshte të paditurit, ky i fundit nuk kishte për obligim që të përgjigjet me shkrim në padinë. Dmth edhe pse kryetari i këshillit përshkak të kërkesave të shumta të cilët paditësi i ka paraparë në padi si dhe përshkak të natyrës mjaft të komplikuar të lëndës kontestuese kërkonte ngai padituri që të përgjigjet e shkrim dhe të prononcohet për kërkesat e padisë, i padituri mundeshte të përgjigjet në padi, mundeshte të përgjigjet edhe në rastet kur kryetari i këshillit nuk kërkonte një gjë të tillë por mundeshte edhe të mos përgjigjet aspak për të cilën veprim nuk do të kishte asnjë pasojë. Mirpo gjat praktikës gjyqësore u pa se mosdhënia e

²⁸¹ Në bazë të materialit procedural që gjykata disponon do të konstatojë se a egziston ose jo kompetenca lëndore dhe tokësore, a egzistojnë shkaqet për përjashtimin e gjyqtarit, a kanë palët zotësinë për të qenë palë dhe zotësinë procedural dhe a janë të përfaqësuar rregullisht, dhe a është paraqitur padia me kohë. Brestovci. F, op. cit, fq. 200

²⁸² Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 387

²⁸³ I padituri mundet të përmbahet nga çdo deklaratë për padinë, ta pohoj kërkespadinë, të lidh pajtim gjyqësor me paditësin ose të kundërshtoj padinë respektivisht të mbrohet nga padija e cila është rasti më i shpeshtë në praktikën gjyqësore.

përgjigjes në padinga ana e të paditurit rrezikon koncentrimin e procedurës kontestimore e sidomos të procedurës të mbledhjes dhe sistematizimit të materialit procedural. Për këtë shkak me sjelljen e ligjit të ri të procedurës kontestimore në vitin 20015 në nenin 269, al. 1 parashihet detyrueshmëria e të paditurit që në afat jo më të shkurt se 15 ditë e as më të gjat se 30 ditë tëparashtrorj përgjigje me shkrim në padi. Në krahasim më ligjin e vjetër gjykata gjat dërgimit të padisë tek i padituri duhet ta njoftoj se në rast se nuk përgjigjet me shkrim në padinë atëher do të pasojnë pasojat juridike²⁸⁴.Përgjigjja me shkrim e padisëështë shumë i rëndësishëm pasi që kursehet kohë dhe punë kur vjen puna tek paraqitja e fakteve në të cilët i padituri i mbështet pretendimet e veta si dhe provat me të cilët i vërteton ato fakte pasi që këto i padituri i paraqet në fazat fillestare të procedurës e kështu arrihet të sigurohet përshpejtim i procedurës. Se si do të vijoj procedura kontestimore varet nga përmbajtja e përgjigjes në padi²⁸⁵.Seanca pregaditore është fazë e cila nuk është e detyrueshme dhe në të cilën ndërmiren të gjitha veprimet me të cilët pregaditet shqyrtimi kryesor që e njehta të vijoj pa pengesa apo probleme sidomos çështja e mbledhjes dhe sistematizimit të materialit provues. Mbajtja e kësaj seance do tëkonsiderohej e panevojshme nëse i padituri në përgjigjen në padi si dhe në bazë të padisë paraprakishte të parashtruar nga paditësi gjykata do tëmundet t'i konstatoj të gjitha rrethanat të cilët konsiderohen kontestuese dhe cilët nuk konsiderohen kontestuese për palët në kontest. Në qoftë se vendoset për mbajtjen e seancës pregaditore, atëherë ajo do të mbahet para kryetarit të këshillit respektivisht para gjykatësit të vetëm varësisht se në çfar përbërjevendos gjykata për lëndën kontestuese²⁸⁶. Edhe në këtë seancë bëhet shqyrtimi i çështjes kryesore mirpo vetëm brenda kufijve sa është e nevojshme shqyrtimi i tillë. Ligji e autorizon gjykatën që pas pranimit të përgjigjes në padi ose pas skadimit të afatit për paraqitjen e përgjigjes në padi, brenda atit prej 15 ditëve të caktoj seancën pregaditore. Në seancë palët thiren me anë të ftesës përmbajtja e të

²⁸⁴ Gjykata duhet ta njoftoj të paditurin se nëqoftë se nuk e parashtron përgjigjen me shkrim në padi në afatin e caktuar, në ato raste a'i do ta hum btë drejtën për të kundërshtuar kërkes padinë.

²⁸⁵ Në rastet kur i padituri në përgjigje në padi do të pranoj kërkespadinë ose do të hek dorë nga e njehta, gjykata do të sjell aktgjykim në bazë të pranimit ose heqjes dorë pa mos hyrë në shqyrtim kryesor; sipas nenit 270, al.4 dhe nenit 321 nëse vërteton në përgjigjen e padisë se në mes paditësi dhe të paditurit nuk është kontestuese gjedja faktike dhe se nuk egzistojnë penegsa tjera për sjelljen e vendimit, do të sjell aktgjykim pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor; në rastet tjera pas pranimit të përgjigjes në pad inga i padituri, kryetari i këshillit respektivisht gjyqtari i vetëm do të caktoj seancë pregaditore ose nëse konsideron se nuk është e nevojshme caktim i një séance të tillë atëherë do të caktoj seancë për shqyrtim kryesor (neni 270)

²⁸⁶ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 405

cilës është e caktuar me ligj²⁸⁷. Gjat kësaj faze, palët mundet të miren vesht që kontestin e tyre ta zgjidhin në procedurë të medijacionit para medijatorit. Në këto raste gjykata respektivisht kryetari i këshillit ose gjyqtari i vetëm do të sjellin aktvendim me të cilën do ta ndërpres procedurën kontestimore²⁸⁸. Këtë veprim procedural të gjykatës në mënyrë analoge e rregullon edhe ligji mbi medijacionin në nenin 29, alinenë e dytë, sipas të cilës gjykata me pajtimin e palëve mundet që në çdo fazë të procedurës ta ndërpres të njejtën dhe palët t'i udhëzoj që të nisin procedurë të medijacionit. Në këto raste është e domosdoshme që procedura kontestimore të ndërpritet përkohësisht dhe brenda kësaj periudhe të mos ndërmiret asnjëveprimprocedural lidhur me lëndën kontestues deri sa të arrihet qëllimi i ndërprerjes të procedurës. Përveç ndërprerjes përshkak të asaj se palët dëshirojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin në procedurë të medijacionit, ligji parasheh edhe rastet tjera të cilët konsiderohen si ndërpresrej *ex lege* apo ndërprerje në fuqi të ligjit, të cilët nga momenti kur ato paraqiten, në mënyrë automatike do të shkaktojnë ndërprerje të procedurës²⁸⁹. Nga shkakut se ndërprerja e procedurës vjen si rezultat i fuqisë së ligjit, procedura kontestimore ndërpritet qysh në momentin kur paraqitet rrethana apo shkak i cili shkakton ndërprerje të procedurës, për atë shkak vendimi i gjykatës në këto raste është e karakterit deklarativ. Në rastin e ndërprerjes të procedurës përshkak të vendosjes që palët kontestin e tyre t'ia besojnë një medijatori, ndërprerja do të shkaktohet nga momenti kur palët do të nënshkruajnë deklaratën se pajtohen që të marrin pjesë në medijacion, e cila deklaratë jepet në procesverbal para gjykatës dhe nga ky moment fillojnë paraqitja e disa pasojave juridiko-procedurale si p.sh: sipas nenit 202, al.1 si pasojë e ndërprerjes të procedurës është pushimi i rrjedhjes të afateve të caktuara për kryerjen e veprimeve kontestimore, veprimet procedurale të cilët i ndërmer njëra palë nuk prodhojnë asnjë efekt kundrejt palës tjetër. Përveç kësaj gjykata

²⁸⁷ Në thirrjen për seancë pregaditore palët do të urdhërohen që në seancë t'i sjellin të gjitha dokumentet që do t'u shërbejnë si provë si dhe të gjithë lëndët që duhet të shqyrtohen në gjykatë. Gjithashtu në ftesën për seancën pregaditore do të shënohen edhe pasojat e mungesës nga kjo seancë, si dhe obligimin e tyre që më së voni në seancën e parë të shqyrtimit kryesor t'i parashirojnë të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin pretendimet e tyre respektivisht provat me të cilët i vërtetojnë faktet si dhe t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet të cilët kanë për qëllim t'i përdorin gjat procedurës si prova.

²⁸⁸ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 200, al. 1, pika 6

²⁸⁹ Procedura do të ndërpritet *ex lege* kur: pala do të vdes; pala do të humbë aftësinë kontestimore kurse nuk ka të autorizuar në atë procedurë; kur i autorizuari ligjor i palës do të vdes ose do të pushoj autorizimi i tij për përfaqësim, ndërsa pala nuk ka të autorizuar në procedurë; atëherë kur pal ai cili është person juridik do të pushoj së egzistuari; kur do të paraqiten pasojat juridike nga hapja e procedurës kontestimore; në shkaqe të luftës ose shkaqeve tjera dhe në raste tjera të përcaktuara me ligj. neni 200 i Ligji mbi procedurën kontestimore; Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 290

nuk mundet të ndërmar asnjë veprim procedural nëprocedurë, përjashtimisht në rastet nëse ndërprerja është paraqitur pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, në bazë të atij shqyrtimi gjykata ka të drejtë të ndërmar vendim. Kyveprim i gjykatës gjat ndërprerjes të procedurës konsiderohet jo shumë i arsyeshëm nga fakti se gjat procedurës të medijacionit palët mundet të arrijnë në një marrëveshje të përbashkët të tyre kështu që mundet të vij deri në ndeshje të vendimit të gjykatës me marrëveshjen e arritur të palëve me ndihmën e medijatorit. Pra, është e preferueshme që deri sa të zgjas procedura e medijacionit e cila është shkak i ndërprerjes të procedurës kontestimore, gjykata duhet të përmbahet nga çdo veprim respektivisht sjellje të vendimeve deri sa procedura e medijacionit të mbaroj, pa marr parasysh rezultatin e saj. Kështu si zgjidhje më e mirë konsiderohet që në këtë nen të bëhet ndryshim respektivisht në alinenë e dytëtë neni 202, të mos i jepet gjykatës e drejta që të marrë vendim nëse ndërprerja e procedurës është paraqitur pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, pasi që kështu do t'i iket zgjidhjes së një çështjes kontestuese në dy mënyra të ndryshme.

Të dy ligjet si Ligji mbi procedurën kontestimore gjithashtu edhe Ligji mbi medijacionin në mënyrë analoge parashohin afate ligjore brenda të cilës duhet që të përfundon procedura e medijacionit. Procedura kontestimore do të konsiderohet e ndërpritur deri sa zgjasin apo egzistojnë shkaqet të cilët kanë bërë që procedura e tillë të ndërpritet. Nga momenti kur këto shkaqe menjahen, gjykata ashtu si e ka ndërprerë procedurën, në atë mënyrë do ta vazhdoj atë. Procedura kontestimore e ndërprerë përshkak të vendimit të palëve që kontestin ta zgjidhin me medijacion mundet të vazhdohet kur palët e kërkojnë ose së paku njëra palë me ç'rast gjykata do të bie aktvendim për vazhdim të procedurës²⁹⁰. Por neni 203 gjithashtu parasheh edhe mundësinë që ka gjykata nëse asnjëra nga palët nuk parashtron kërkesë për vazhdim të procedurës kontestimore. Në këto raste sipas ligjit gjykata do të vazhdoj procedurën atëherë kur do të kalojnë 45 ditë nga dita e ndërprerjes të procedurës. Por nga ana tjetër ligji mbi medijacionin parasheh një afat më të gjat të mbarimit të procedurës së medijacionit se sa afatin të cilën e parasheh ligji për procedurën kontestimore. Në nenin 20, alinenë e dytë afati i cili parashihet për zgjidhje të kontestit me anë të medijacionit është 60 ditë nga dita e dhënies të deklaratës për nisje të procedurës të medijacionit pa mar parasysh rezultatit të saj. Konsiderohet që ky afat duhet të jetë në përputhje me afatin e cila është e paraparë në nenin 203 të ligjit për procedure

²⁹⁰ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 203, al.2

kontestimore ose anasjelltas me qëllim që t'i iken problemeve të interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe me këtë të shfaqen probleme të aspektit procedural gjat procedurave ku tek vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me këto çështje të vihet në pikpyetje prodhimi i efekteve procedurale. Kur palët do të arrijnë marrëveshje të kontestit të tyre apo kur medijacioni për to ka qenë i pasuksesshëm me ç'rast medijatori apo palët deklarojnë me shkrim se zbatimi i procedurës të medijacionit është i paarsyeshëm respektivisht deklaratën me shkrim palët i'a dorëzojnë medijatorit ose medijatorit dhe palës tjetër se procedura e medijacionit është përfunduar, gjykata do ta vazhdoj procedurën kontestimore. Pra nga rezultati i procedurës të medijacionit varet edhe ardhëmria e procedurës kontestimore për çështjen konkrete kontestuese. Nëqoftë se medijacioni ka qenë i suksesshëm, gjykata cakton seancë në të cilën do ta konstatoj në procesverbal marrëveshtjen e arritur ndërmjet palëve në procedurën e medijacionit dhe me aktgjykim do ta përfundoj procedurën si pajtim gjyqësor. Në të kundërtën procedura kontestimore vazhdon prej aty ku është ndërprerë, me ç'rast të gjithë afatet do të fillojnë të rrjedhin përsëri nga dita kur gjykata do ta dërgoj vendimin për vazhdimin e procedurës (neni 203, al. 5).

Caktimi i seancës për shqyrtim kryesor është faza e fundit e pregaditjes së shqyrtimit kryesor. Kryetari i këshillit e cakton këtë seancë menjëher pasi ta pranoj padinë nëqoftë se konstaton se në bazë të materialit procedural në padi dhe përgjigjen e padisë dhe si rezultat i natyrës të kontestit nuk është e nevojshme mbajtja e seancës pregaditore, ose në rast të përfundimit të seancës pregaditore. Para se të përfundoj seancën pregaditore, gjykata do të caktoj ditën dhe kohën e mbajtjes të seancës për shqyrtim kryesor si dhe do t'i njoftoj palët se cilët prova do të paraqiten respektivisht cilët dëshmitar dhe ekspert do të jenë të ftuar në seancën e parë të shqyrtimit kryesor²⁹¹. Shqyrtimi kryesor paraqet pjesën kryesore të procedurës kontestimore në shkallë të parë e përbërë nga tërësia e veprimeve procedurale të palëve dhe të gjykatës si dhe të pjesmarësve tjerë në procedurë me qëllim të shqyrtimit të materialit procedural të cilët veprime ndërmiren në një ose më shumë seanca varësisht kompleksitetit të lëndës kontestuese. Zhvillimi i seancës së shqyrtimit kryesor gjithmon mbështetet në disa nga parimet të cilët konsiderohen parime bazë të procedurës kontestimore²⁹². Pjesmarja e palëve apo përfaqësuesve të tyre në seancën e shqyrtimit kryesor është e domosdoshme. Për ditën dhe kohën

²⁹¹ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 278, al.1; Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 408

²⁹² Parimi i shqyrtimit dhe në disa raste edhe parimi i hetimit e cila ka të bëj me mënyrën se sikryhet mbledhja e materialit procedural, parimi i publicitetit, parimi i barabarsisë së palëve gjat seancës si dhe parimi i kontradiktorialitetit.

e mbajtjes të seancës gjithmon do të njoftohen nga ana e gjykatës. Në rast të mos ardhjes të ndonjërit prej palëve nuk plotësohen kushtet për mbajtjen e seancës²⁹³. Sipas ligjit është detyrë e gjyqtarit të vetëm respektivisht kryetarit të këshillit që ta hap shqyrtimin kryesor dhe të parashtrij objektin e shqyrtimit. Se si do të vijoj seanca e shqyrtimit kryesor varet a është mbajtur paraprakisht seanca pregaditore apo jo sepse nga ajo varet se a janë paraqitur faktet dhe provat e nevojshme me të cilët vërtetohen ato fakte në procedurën pregaditore, ose në rastet kur nuk është mbajtur kjo seancë atëherë faktet dhe provat secila palë do t'i paraqes në seancën e parë të shqyrtimit kryesor si dhe të deklarohen lidhur me pretendimet e palës kundërshtare. Palët duhet të jenë shumë të kujdesshëm për faktet të cilët duhet t'i paraqesin për vërtetimin e pretendimeve të tyre, pasi që me përfundimin e kësaj faze të shqyrtimit kryesor përfundon edhe e drejta e palëve që të paraqesin fakte dhe të propozojnë prova të reja²⁹⁴. Përbashimisht palëve u lejohet që të paraqesin fakte dhe të propozojnë prova të reja për vërtetimin e atyre fakteve vetëm në qoftë se vërtetojnë se nuk ka qenë përshkak të fajit të palës pamundësija e paraqitjes të fakteve të nevojshme dhe propozimi i provave në seancën e parë të shqyrtimit kryesor (neni. 284, al. 2). Hap tjetër pas grumbullimit të materialit provues është sjellja e aktvendimit nga ana e gjykatës me të cilën caktohet se cilët fakte kontestuese do të vërtetohen dhe cilët prova do të nxirren për vërtetimin e të njejtave si dhe cilët prova të cilët veç më janë të propozuara nga ana e palëve do të refuzohen nga ana e kryetarit të këshillit respektivisht gjyqtarit të vetëm të cilët konsiderohen si të parëndësishme për vërtetimin e fakteve kontestuese. Pra në këtë fazë të procedurës bëhet shoshitja e të gjithë materialit provues i cili veprim procedural është i rregulluar detajisht me Ligjin mbi procedurën kontestimore²⁹⁵.

Stadi i fundit i procedurës kontestimore në shkallë të parë është sjellja e vendimit përfundimtar. Nuk është fakt i ditur se kur do të ndërmirret ky veprim procedural nga ana e gjykatës respektivisht kryetarit të këshillit respektivisht gjykatësit të vetëm. Kjo është kështu pasi

²⁹³ Nëqoftë se në seancën e parë të shqyrtimit kryesor apo në ndonjë seancë të mëvonshme nuk do të jetë present paditësi i cili është rregullisht i thirur ndërsa nga ana tjetër mos ardhjen e tij nuk e arsyeton, padia të konsiderohet si e revokuar nëse në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit për revokim të padisë i padituri nuk do të kundërshtoj një gjë të tillë. Gjithashtu nëse në seancën e parë të shqyrtimit kryesor nuk vjen i padituri i cili gjithashtu është rregullisht i thirur dhe nuk e arsyeton mosaridhjen e tij ndërsa nga ana tjetër nuk ka kushte për sjellje të vendimit për shak të mungesës si dhe në rastet tjera kur në ndonjë seancë të mëvonshme mungon i padituri, seanca mundet të mbahet (neni 280, al.1 dhe 2).

²⁹⁴ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 284, al. 1

²⁹⁵ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 205-261

që nuk dihet se kur mund të përfundoj një procedurë e inicuar. Mundet të përfundoj në fazat fillestare apo mundet që procedura t'i kaloj të gjitha fazat dhe vendimi të miret me plotkuptimin e fajlës në fund të procedurës²⁹⁶. Sjellja e aktgjykimit paraqet një proces të komplikuar për nga aspekti psiqik-mendor të gjykatësit me të cilën përveç se rregullohet dhe zgjidhet çështja kontestuese konkrete me anë të konkretizimit të normës juridike, me të gjithashtu gjykata i udhëzon palët se si duhet të sillen dhe veprojnë në bazë të asaj se si është vendosur në aktgjykim. Pra, aktgjykimi i gjykatës është obligative dhe detyruese për palët pasi që ajo paraqet një normë juridike – “Aktgjykimi bëhet normë juridike konkrete, burim i të drejtës për marrdhënien juridiko-shoqërore konkrete – res judicata facit jus inter partes”²⁹⁷. Në procedurën kontestimore të shkallës së parë vendimet me të cilën procedura përfundon në mënyrë meritore mundet të miret në dy forma: aktgjykimit dhe të aktvendimit. Sipas rregullit gjykata me aktgjykim vendos për lëndën e kontestit respektivisht për bazën e kërkespadiës. Pra, aktgjykimi është vendimi përfundimtar me të cilën përfundon procedura kontestimore në shakllë të parë. Sipas nenit 311 al. 1 të ligjit mbi procedurë kontestimore, me aktgjykim vendoset për çështjen kryesore si dhe për kërkesat të cilët konsiderohen të dorës së dytë²⁹⁸. Sipas ligjit por edhe sipas teorisë juridike aktgjykimet mundet të jenë të disa llojshme varësisht kritereve të caktuara. Kështu teoria juridike i ndanë aktgjykimet sipas përmbajtjes në: aktgjykime deklarative, konsitutive dhe kondemnatore ose dënuese. Sipas vëllimit të mbrojtjes juridike e cila jepet në rastin konkret aktgjykimet mundet të ndahen në të plota dhe jo të plota, ashtuqë aktgjykimet jo të plota mundet të jenë aktgjykime të pjesshme, plotësuese dhe aktgjykime të ndërmjetme. Më pastaj sipas mënyrës se si krijohen aktgjykimet, ato ndahen në kontradiktore dhe jokontradiktore dhe sipas kriterit se çfarë qëndrimi mer gjykata ndaj kërkespadiës aktgjykimet mundet të jenë: aktgjykime me të cilët pranohet në tërësi kërkespadija, me anë të së cilave refuzohet në tërësi kërkespadija dhe aktgjykime të përziara me të cilët pjesërisht pranohet ose refuzohet

²⁹⁶ Procedura kontestimore mundet të përfundoj me aktvendim qysh në fazën e pregaditjes të shqyrtimit kryesor ose në vet shqyrtimin kryesor. në qoftë se gjykata konstaton se nuk egzistojnë prezumimet procedurale për vendosje meritore të padisë. Gjithashtu procedura kontestimore e shkallës të parë mundet të përfundoj edhe në fazat fillestare të procedurës dhe në bazë të ndonjë veprimi dispozitiv të palëve siç p.sh: revokimi i padisë, pranimi i kërkespadiës nga ana e të paditurit, lidhja e pajtimit gjyqësor e kështu me rradhë. Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 417

²⁹⁷ Triva, S, Dika, M, (2004), Gradansko parnično procesno parvo, Narodne Novine, Zagreb, fq, 579

²⁹⁸ Si kërkesa të dorës së dytë konsiderohen bazat e të gjithë kërkes padive, baza e kërkesave juridiko-materiale tjera të parashtruara si mosegzistimi i kërkespërshtkak të paraqitjes të kompenzimit, kompenzimi i shpenzimeve gjyqësore nëse ndonjëra nga palët ka paraqitur kërkesë për atë, dhe të ngjajshme.

kërkespacia²⁹⁹. Ndërsa nga ana tjetër ligji bën një ndarje tjetër të aktgjykimeve dhe atë aktgjykime të pjesshme, ndëraktgjykime, aktgjykimi në bazë të pranimit, aktgjykimi mbi bazë të heqjes dorë, aktgjykimi për mosparaqitje përgjigje në padi, aktgjykimi përshkak të mungesës dhe aktgjykimi pa mbajtjen e shqyrtimit³⁰⁰. Është shumë i rëndësishëm momenti kur shpallet aktgjykimi pasi që nga ai moment aktgjykimi nuk mundet në asnjëfar mënyrë të ndryshohet. Prof. Faik Brestovci aktgjykimin e tillë e quan “akt perfekt” i cili edhe nëse nuk shpallet, mjafton që kopja e aktgjykimit të del nga objekti gjykatës që e njejta të konsiderohet si akt i cili nuk mundet të ndryshohet më nga ana e gjykatës. Aktgjykimi i cili sillet nga ana e gjykatës sipas rregullit duhet të shpallet dhe ta përpunoj në mënyrë shkrimore më qëllim që të njejtën t’ua dërgoj palëve në formë të kopjeve të vërtetuara³⁰¹, edhe pse kur gjat shpalljes të aktgjykimit nga kryetari i këshillit respektivisht gjykatësi i vetëm palëtkanë qenëprezent në gjykatë. Është i rëndësishëm së madhe çështja e shpalljes të aktgjykimit sepse nga ai moment fillojnë të rrjedhin afatet për ankim³⁰², bëhet i plotfuqishëm dhe e njejta nuk mundet të ankimohet³⁰³, afati për të kërkuar aktgjykim plotësues³⁰⁴ si dhe fakti se nga moment i shpalljes të aktgjykimit pala mund të heq dorë nga e drejta e ankesës³⁰⁵.

Aktvendimi vjen në skenë atëherë kur gjykata nuk vendos me aktgjykim. Pra, gjykata do të vendos me aktvendim vetëm atëherë kur nuk do të vendos për lëndën e kontestit. Edhe pse dallojnë shumë për nga raportet që ato rregullojnë, prap se prap kanë pika të përbashkëta. Njëra prej tyre është se për nga aspekti i të krijuarit është i njejtë, pra si rezultat i procesit mendor dhe shprehjes të vullnetit të gjykatës në pajtim me dispozitat ligjore. Gjithashtu pikë tjetër e përbashkët është natyra e çështjeve që rregullohen me aktvendim. Përderi sa aktgjykimi është i lidhur vetëm për kërkesën e palës respektivisht për zgjidhjen e një raporti juridik-civil konkret, me aktvendim gjithashtu rregullohen raporte konkrete në procedurën kontestimore të cilët lindin gjat procedurës dhe me të cilët ndihmohet mbarvajtja e procedurës. Si të tilla mundet të

²⁹⁹ Më tepër për llojet e aktgjykimeve në Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 419-434

³⁰⁰ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 315-321

³⁰¹ Sipas nenit 326, al. 1 të Ligjit mbi procedure kontestimore, aktgjykimi duhet të përpilohet në formë të shkruar brenda afatit prej 8 ditëve. kurse kur lëndët për nga natyra janë më të komplikuar ligji parasheh afat më të gjatë, respektivisht afat prej 15 ditëve.

³⁰² Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 337, al.1

³⁰³ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 332, al. 1

³⁰⁴ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 328

³⁰⁵ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 338

konsiderohen raportet të cilët krijohen në mes të subjekteve në procedurë. Këtu nuk e kemi fajlën vetëm për raportin i cili krijohet në mes të palëve kontestuese, por poashtu edhe për raportin i cili krijohet në mes të gjyqtarit dhe palëve, apo të qytetarëve të cilët marrin pjesë në gjykim. Gjithashtu mundet të rregullohet edhe raporti ndërmjet gjykatës dhe personave tjerë të cilët si pjesëmarrës në procedurë ndërmarin veprime të caktuara procedural p.sh ekspertët, përkthyesit, etj. Sipas kësaj mundet edhe të bëhet grupim i llojeve të aktvendimeve të cilët mundet të sillen në procedurë kontestimore. Sipas Prof. Dr Arsen Janevskit aktvendimet mundet të jenë: aktvendime për drejtim të procedurës, aktvendim me të cilat vendoset për prezumimet procedurale, aktvendimet me të cilat vendoset për autorizimet procedural të palëve, aktvendimet me të cilat ndërpritet procedura kontestimore, aktvendime me të cilat shqiptohen dënime përshkak të keqpërdorimit të autorizimeve procedural, aktvendime me të cilat vendoset për kompenzim të shpenzimeve procedural, aktvendime me të cilat shqiptohen dënime përshkak të jodisciplinës procedural si dhe aktvendimet me të cilët vendoset në mënyrë meritore³⁰⁶. Sipas ligjit aktvendimet mundet të mirren në seancë (neni 332) dhe jasht saj (neni 333). Kur ajo mirret në seancë atëherë ajo fillon të vlejë nga moment i shpalljes së saj. Aktvendimi i shpallur do të përpilohet me shkrim dhe nga një kopje do t'u dërgohet palëve vetëm kur kundër saj është e lejuar ndonjë ankesë e veçantë apo kur nëbazë të atij aktvendimi mund të kërkohet përmbartimi. Ndërsa aktvendimet të cilët mirren jasht seance gjithmon u dërgohet palëve kopja e vërtetuar e aktvendimit. Edhe çështja e përmbajtjes të aktvendimit është e rregulluar me ligj³⁰⁷. Sipas ligjit aktvendimet gjithashtu kanë edhe fuqinë përmbartuese, dhe të njejtat përmbartohen ex officio.

Jemi njerëz dhe një nga vetitë e cila na bën të dallohena nga krijesat tjera e sidomos krijesat artificiale është bërja e gabimeve gjat ndërmarjes të veprimeve të caktuara. Është e njerzishme që të bëjmë gabime. Poashtu edhe gjykatësi pa marrë parasysh a gjykon si kryetar këshilli apo gjykatës individual mundet që gjat ndërmarjes të veprimeve të caktuara procedurale të ndodh të vijë deri në ndonjë lëshim respektivisht gabim e cila mundet të shprehet nëpërmjet të lëndimit të ndonjë dispozite juridike të procedurës kontestimore ose ndonjë gabim

³⁰⁶ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 439

³⁰⁷ Për dallim nga përmbajtja e aktgjykimit, aktvendimi ka përmbajtje më të reduktuar. Ajo përmban vetëm hyrjen dhe urdhërin. Arsyetimi i aktvendimit nuk shënohet çdo herë, por vetëm në rastet kur me aktvendim gjykata e refuzon propozimin e palës ose nëse me aktvendim do të vendoset për propozime të palëve të cilët ndërmjet veti janë të kundërta, si dhe në të gjitha rastet për të cilat gjykata do të vendos se një gjë e tillë është e nevojshme (Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 334, al. 1 dhe 2)

gjat të vendosurit³⁰⁸, me ç'rast palëve të pakënaqura ligji u'a jep të drejtën të mundën të parashtrojnë mjete juridike. Mjetet juridike janë veprime procedural të palës të cilët ndërmiren pas përfundimit të procedurës kontestimore në shkallë të parë. Me to palët ose personat e autorizuar të tyre kërkojnë nga gjykata e shkallës më të lartë në krahasim me at që e ka sjell vendimin, të njejtën ta shqyrtoj dhe si rezultat i saj ta shfuqizoj atë dhe ta ndryshoj respektivisht ta zavendësoj me ndonjë vendim tjetër. Pala e cila gjithmon përdor mjetet juridike konsideron se gjykata ka sjellur një vendim i cili për tëështë jo i ligjshëm dhe jo i drejtë. Në praktik jo gjithmon vendimet e gjykatës më të cilën ai e përfundon procedurën kontestimore përfundojnë me goditje me mjete juridike përshkak se me të vërtet gjykatësi ka bërë ndonjë shkelje ligjore apo gabim i cili ka ndikuar që lënda kontestuese të zgjidhet në atë mënyrë e cila është jo e volitshme për njëriën prej palëve. Shpesh herë si veprim i palës dhe personit të autorizuar të tij paraqitja e mjeteve juridike paraqesin edhe keqpërdorime me të cilët ato fitojnë në kohë deri në plotfuqishmërinë e vendimit. Përrjashtimisht janë rastet të cilët vërtet kanë nevoj për kontroll të vendimeve gjyqësore e sidomos për nga aspekti i paligjshmërisë dhe rregullsisë të tyre dhe nga ana tjetër zbatimi i të drejtave të qytetarëve të garantuara me kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare: e drejta në ankesë kundër vendimeve të sjellura në shkallë të parë³⁰⁹ si dhe e drejta në gjykim të drejtë³¹⁰. Në varësi të asaj se mjetet juridike a përdoren kundër vendimit jo të plotfuqishëm ose vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, ajo mundet të jetë mjet i rregullt ose jo i rregullt juridik. Ligji mbi procedurën kontestimore njih tre lloje të mjeteve juridike dhe atë: ankesë kundër aktgjykimit, ankesë kundër aktvendimit dhe kundërshtimi kundër urdhërpagesës. Ankesa është mjet i rregullt juridik të cilën pala e pakënaqur mundet ta parashtroj në afatin e caktuar me ligj kundër aktgjykimit ose aktvendimit të gjykatës të shkallës së parë jo të plotfuqishme. Sipas nenit 337 ky afat është 15 ditë nga dita e gërgimit të kopjes të aktgjykimit. Si pasojë e parashtrimit të ankesës është parandalimi i aktgjykimit të bëhet i plotfuqishëm dhe për të njejtën vendos gjykata e shkallës së dytë³¹¹. Forma dhe përmbajtja e ankesës është e përcaktuar me ligj³¹². Ligji gjithashtu parasheh edhe shkaqet për të cilët mundet të parashtrohet

³⁰⁸ Këtu mundet të kemi gabime të cilët paraqiten gjat vërtetimit të gjendjes faktike ose gabime të cilët kanë të bëjnë me zbatimin e të drejtës materijale.

³⁰⁹ Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë, neni 15, al.1

³¹⁰ Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, neni 6, nëntor 4, 1950, Eurot. T.S. Nr. 5,213 U.N.T.S. 221

³¹¹ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 337, al. 2 dhe 3

³¹² Ankesa mundet të parashtrohet në formë të shkruar ose me gojë në procesverbal para gjykatës. Ajo duhet t'i përmbaj këto të dhëna: shënimin se cili aktgjykim goditet, a goditet në tërësi ose pjesërisht ai aktgjykim, shkakun e

ankesa dhe atë: cenimi esencial i dispozitave të procedurës kontestimore³¹³, gjendja gabimisht e verifikuar ose jo e plotë faktike³¹⁴ dhe përshkak të aplikimit të gabuar të drejtës materiale³¹⁵. Si rezultat i mbajtjes të diskutimit të seancë të këshillit, gjykata e shkallës së dytë në bazë të ankesës së parashtruar mundet të vendos në disa mënyra: me aktvendim ta hedh posht ankesën si të paraqitur jo në kohë, jo të plotë dhe të palejuar, me aktgjykim me të cilën do ta refuzoj ankesën si të pabazuar dhe do ta vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë, me aktvendim do të vendos për anulim të aktgjykimin e shkallës së parë dhe do ta kthej lëndën në gjykatën e njëjtë të shkallës së parë ose do t'ia dërgoj lëndën gjykatës kompetente të shkallës së parë, me aktvendim do të anuloj për anulim të aktgjykimit të shkallës së parë dhe do ta hedh poshtë padinë si dhe me aktgjykim do ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë³¹⁶. Gjkata e shkallës së dytë mund të vendos edhe për ankesat kundër aktvendimeve, përveç në rastet kur një gjë e tillë është e ndaluar me ligj. Ankesa kundër aktvendimeve është mjet i cili edhe pse përkundër terminologjisë respektivisht për kah emri dallon nga ankesa e aktgjykimeve si dhe për nga çështjet të cilët rregullojnë si njëri lloj i vendimeve ashtu edhe tjetri, për nga forma dhe për nga procedura se si ato ndërmiren nuk ka asnjë dallim. Gjkata e shkallës së dytë sipas nenit 370 të ligjit mbi procedurën kontestimore ka të drejtë që: ta hedh poshtë ankesën sit ë dërguar jon në kohë, jo të plotë dhe të palejuar, ta refuzoj ankesën sit ë pabazë dhe ta vërtetoj vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta vlersoj ankesën dhe me këtëta ndryshoj apo ta hedh poshtë vendimin dhe sipas nevojës lëndën ta kthej përsëri për vendosje. Por egziston mundësia që në shkallën e dytë që rezultati përfundimtar të mos i plotësoj pritshmëritë e njëres prej palëve e ndonjëherë edhe të dy palëve. Në këto raste ligji lejon që palët të mund të deklarojnë mjete të jashtzakonshme juridike. Ligji mbi procedurën kontestimore njih tre lloje të mjeteve të jashtzakonshme juridike dhe atë: revizionin kundër aktgjykimit, revizionin kundër aktvendimit dhe përsëritja e procedurës. Kundër aktgjykimit që të mundet të parashtrohet revizioni duhet që ta kalohen të gjitha fazat e sjelljes të vendimeve sin ë shkall të parë ashtu edhe në shkallë të dytë. Kështu,

ankesës dhe nënshkrimi i parashtruesit. Ankesa mundet të përmbaj fakte dhe prova të reja të cilët janë tregues i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Neni 339 dhe 341 Ligji mbi procedurën kontestimore

³¹³ Cenim esencial i dispozitave të procedurës bëhet atëherë kur gjykata gjat procedurës nuk e aplikon ose e aplikon gabimisht ndonjë dispozitë të Ligjit mbi procedurën kontestimore.

³¹⁴ Gjendja gabimisht e verifikuar faktike egziston kur gjykata ndonjë fakt vendimtar gabimisht e ka verifikuar apo kur nuk e ka verifikuar aspak, ndërsa gjendja jo në tërësi e verifikuar faktike egziston atëherë kur nuk janë vërtetuar faktet apo provat të cilët palët i kanë propozuar në procedurë (Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 344).

³¹⁵ Egziston kur gjykata nuk ka aplikuar dispozitën e të drejtës material të cilën është dashur ta aplikoj apo kur nuk e ka aplikuar në mënyrë të drejtë

³¹⁶ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 355, al.1

aktgjykimi i shkallës së parë duhet të jetë goditur me ankesë, e pastaj kundër aktgjykimit të shkallës së dytë të sjellur për ankesën e aktgjykimit të shkallës së parë të mundet të deklarohet nga palët revizioni. Për revizionin gjithmonë vendos gjykata e shkallës së tretë respektivisht Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Janë disa kushte të cilët lejojnë parashtrimin e revizionit kundër aktgjykimeve. Kushti i parësiç u përmend më lartë është që të goditet aktgjykimi i shkallës së dytë. Pastaj, sipas ligjit revizioni mundet të parashtrohet vetëm kundër aktgjykimit të shkallës së dytë nëse vlera e lëndës të kontestit të pjesës së hedhur posht e tejkalon shumë prej 500.000 denar³¹⁷. si dhe në rastet kur përjashtohet al. 2 e nenit 372, pra kur lejohet deklarimi i revizionit pa mar parasysh vlerën e kontestit dhe atë në kontestet në lidhje me ushqimin ligjor, kontestet për kompensim të dëmit për humbje të ushqimit ligjor për shkak të vdekjes së personit i cili ishte dhënësi i udhëqimit ligjor, kontestet nga marrdhënia e punës me rastin e ndalimit të marrdhënies të punës, kontestet për të drejtën e autorit dhe në kontestet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përdorimin e zbulimeve dhe përparimit teknik, mostrave, modeleve dhe të drejtën e përdorimit të emrit dhe firmës si dhe në kontestet e garave jolojale dhe sjelljeve monopoliste (neni 372, al. 3).Përveç kushteve të cilët duhet të plotësohen, ligji gjithashtu parashih edhe shkaqet e parashtrimit të revizionit³¹⁸. Gjatë procedurës së revizionit gjykata e shqyrton dhe vendos për aktgjykimin e goditur por vetëm në atë pjesë në të cilën ai goditet me revision si dhe në kufijtë e shkaqeve të cilët thksohen në revizionin e deklaruar nga palët. Këto të fundit kanë të drejtë që në revision të nxjerrin fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja. Kusht për paraqitjen e fakteve respektivisht të provave të reja është që me to të mundet të vërtetohen çënimet e përmbajtjes të dispozitave të procedurës kontestimore³¹⁹. Pala gjithmonë revizionin e parashtron në gjykatën e shkallës së parë e cila e ka shqiptuar aktgjykimin edhe pse për të vendos gjykata më e lartë i cili pasi që konstaton se a i plotëson revizioni kushtet për nga aspekti formal, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme procedurale do t'ia dergoj gjykatës së revizionit ku do të caktohet gjyqtari njoftues. Kur revizioni do të arrijë në gjykatën kompetente për revision, pa mos mbajtur seancë për shqyrtim do të vendos ashtu që: me aktvendim do ta hedh posht revizionin të paraqitur jo në kohë, jo të plotë, të pa arsytuar apo revizionin e palejuar; kur përshkak të lëndimit të dispozitave të procedurës kontestimore për të

³¹⁷ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 372, al.2

³¹⁸ sipas nenit 375 al. 1 shkaqet e parashtrimit të revizionit kundër aktgjykimit janë: çënimi esencial i përmbajtjes të dispozitave të procedurës kontestimore në gjykatën e shkallës së parë, çënim i përmbajtjes të dispozitave në procedurën gjyqësore në shkallë të dytë dhe për shkak të zbatimit në mënyrë të gabuar të të drejtës materiale.

³¹⁹ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 378

cilët mundet të parashtrohet revizioni, gjykata e shkallës së tretë do të shqiptoj aktvendim me të cilin do ta anuloj në tërësi apo pjesërisht aktgjykimin egjykatës së shkallës së dytë dhe atë të gjykatës së shkallës së parë, ose vetëm aktgjykimin eshkallës së dytë dhe lëndën do ta kthej në gjykim të përsëritur gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht gjykatës së shkallës së dytë; në rastet kur është bërë tejkalimi i kërkespadi së “extra petitum”³²⁰ me çrast është vendosur për diçka tjetër e jo për atë që është kërkuar të vendosë në kërkespadinë, me aktvendim do të anuloj aktgjykimin e shkallës së dytë dhe lëndën do t’ia kthej gjykatës së shkallës së dytë; me aktvendim do të vendos qëta anuloj vendimin e shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë dhe kështu do ta hedh posht padinë sidomos në rastet kur bëhet fjalë për kërkes në kontest e cila nuk bie nën kompetencën e gjykatës ose kur është vendosur për kërkesën e cila më herët veç më është vendosur me aktgjykim të plotfuqishëm ose për të cilën është lidhur pajtim gjyqësor dhe gjykata e shkallës së tretë më aktgjykim do ta pranoj revizionin dhe do ta ndryshoj aktgjykimin e goditur atëherë kur vërtetohet se është zbatuar gabimisht e drejta materijale³²¹.

Palët gjithashtu mundet të paraqesin revision si mjet të jashtzakonshëm kundër aktvendimeve të plotfuqishme të gjykatës të shkallës së dytë me të cilët vendime procedura është përfunduar në mënyrë të plotfuqishme për kontestet të cilët me ligj është i lejuar revizioni³²². Procedura do të zbatohet në të njëjtën mënyrë si procedura e revizionit kundër aktgjykimit, pra të njëjtat dispozita me të cilët rregullohet procedura e revizionit kundër aktgjykimit do të përdoren edhe në procedurën kundër aktvendimit të gjykatës të shkallës së dytë.

Në krahasim nga revizioni i cili mundet të deklarohet në afatin e paraparë ligjor kundër aktgjykimit të shpallur vetëm në shkallë të dytë, përsëritja e procedurës paraqet mjet të jashtzakonshëm juridik të cilën palët në afatin e paraparë me ligj në të cilën munden ta deklarojnë kundër aktgjyqimeve të plotfuqishme si në shkallë të parë ashtu edhe në shkallë të dytë. Në ligjin mbi procedurë kontestimore respektivisht në nenet 392 dhe 400 të këtij ligji ky mjet mundet të parashtrohet: përshkak të egzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. në rast kur ndërmiren nga palët në procedurën kontestimore, veprime të cilët janë si rezultat i veprave penale; në rastet kur paraqiten fakte dhe prova të reja, si dhe

³²⁰Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 474

³²¹ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 383-288

³²² Revizioni është gjithmonë i lejuar kundër aktvendimit të gjykatës të shkallës së dytë me të cilën hidhet posht ankesa e deklaruar respektivisht me të cilën vërtetohet vendimi i gjykatës të shkallës së dytë për të hedhur posht revizionin. Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 391, al. 2

përshkak të lëndimeve të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të vërtetuara më aktgjykim nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg. Sipas nenit 394 të ligjit mbi procedurën kontestimore, propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet në afat prej 30 ditëve dhe çdo herë propozimi parashtrahet në gjykatën e cila ka marrë vendimin në shkallë të parë. Edhe përmbajtja e propozimit për përsëritje të procedurës është e rregulluar me ligj³²³. Qëllimi i procedurës e cila inicohet sipas propozimit për përsëritje të procedurës është që aktvendimi me të cilën është përfunduar procedura në shkallë të parë në mënyrë të plotfuqishme të anulohet, që pastaj të hapen rrugët për t'u mbajtur gjykim i ri. Kryetari i këshillit të gjykatës të shkallës së parë është ai i cili shqyrton se a është paraqitur propozimi brenda afatit të parapër me ligj si dhe a është i lejueshëm propozimi për përsëritjen e procedurës. Kjo në fakt përbën fazën e parë të procedurës e cila në literaturën juridike konsiderohet si fazë në të cilën vendoset për lejimin e propozimit. Pas kësaj faze pasojnë 2 fazat tjera të cilët gjithashtu janë mjaft të rëndësishme dhe atë: faza në të cilën shqyrtohet baza e propozimit për përsëritje të procedurës dhe faza e shqyrtimit të çështjes kryesore³²⁴. Me shpalljen e aktvendimit të plotfuqishëm për përsëritje të procedurës, nga ana tjetër anulohet vendimi i sjellë në procedurë të mëhershme. Kështu, caktohet me aktvendim mbajtja e seancës për shqyrtimin kryesor e cila do të zhvillohet sipas rregullave të cilët rregullojnë procedurën kontestimore. Si rezultat pëfundimtar i përsëritjes së procedurës do të jetë vendim i gjykatës së shkallës së parë kundër të cilës do të mundën palët të parashtrajnë të gjitha mjetet juridike nën kushtet e përcaktuara me ligj³²⁵.

3.2 Procedura e medijacionit

3.2.1 Nisja, zbatimi dhe përfundimi i procedurës së medijacionit

Procedura e medijacionit inicohet dhe zbatohet në bazë të marrëveshtjes e cila lidhet në mes të palëve qoftë para ose pas nisjes së procedurës kontestimore me ose paudhëzimin e gjykatës³²⁶. Udhëzimi i palëve nga ana e gjykatës që të mundën kontetsin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit, në asnjë mënyrë nuk është e karakterit detyrues. Kjo në fakt është një term të cilin ligjvënësi e ka përdorur në ligj me qëllim që t'ua bëj me dije palëve se egziston edhe

³²³ Ligji mbi procedurën kontestimore neni 395, al.2, Propozimi për përsëritje të procedurës përmban: bazën ligjore sipas të cilës kërkohet përsëritja, rrethana prej të cilave del se propozimi është paraqitur në afatin e parapër ligjor dhe dëshmitë me të cilët mbulohen thëniet e propozuesit.

³²⁴ Brestovci, F. (2004), E drejta procedurale civile II, (Ribotim i katërt), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti juridik, Prishtinë, fq. 109

³²⁵ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 483

³²⁶ Ligji mbi medijacionin, neni 1, al.4

mënyrë tjetër me të cilën ato mund ta zgjidhin kontestin e tyre dhe nga ato varet fati i zgjidhjes të kontestit të tyre. Kjo është kështu pasi që në Republikën e Maqedonisë medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjes të kontesteve është e karakterit fakultativ, është vullnetar dhe nuk është e detyrueshme e cila don të thotë se moment i nisjes së procedurës së medijacionit varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve dhe nga asnjë tjetër. Nuk ka të drejtë askush që palëve t'ua imponoj zgjedhjen e medijacionit si procedurë me të cilën do ta vendosin çështjen e tyre kontestuese, e këtu më së paku gjykata apo avokatët ose pjesmarësit tjerë. Inicimi dhe zbatimi i procedurës kontestimore respektivisht procedurës së medijacionit nuk paraqet ndonjë parakusht ose prezumim procedural për nisjen e procedurës kontestimore respektivisht të asaj të medijacionit. Në fakt këto dy procedura edhe pse mundet të veprojnë bashkë duke i ndihmuar njëra tjetrës ato gjithashtu mundet të jenë të pavarura me plotkuptimin e fjalës dhe të veprojnë në mënyrë të pavarur. Por në rastet kur inicohet procedura kontestimore dhe gjat saj edhe procedura e medijacionit, ato pa problem mundet të koegzistojnë të veprojnë së bashku dhe t'i ndihmojnë njëra tjetrës për zgjidhjen e kontestit të pëlvë në procedurë kontestimore. Për sa i përket asaj se kur mundet procedura e medijacionit të inicohet në raport me atë a ka nisur ose jo procedura kontestimore lëndë e të cilës është po ajo çështje kontestimore e cila dëshirohet të zgjidhet me anë të medijacionit, dispozitat ligjore parashohin se ajo mundet të inicohet si para ashtu edhe pas inicimit të procedurës kontestimore, respektivisht gjat procedurës kontestimore. Kështu neni 15, al. 6 e Ligjit mbi medijacionin parashih rastet kur palët gjat lidhjes të ndonjë marrëveshjeje për aktivitet ekonomik ndërmjet tyre të miren vesht që në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti të tyre ta zgjidhin të njëjtën në procedurë të medijacionit para inicimit të procedurës gjyqësore ose ndonjë procedure tjetër. Neni 22 poashtu rregullon çështjen e plotfuqishmërisë të marrëveshjes për medijacion si para ashtu edhe pas nisjes të procedurës kontestimore³²⁷ si dhe në pjesën e pestë të ligjit respektivisht nenet 29, 30 dhe 31 të ligjit mbi medijacionin rregullojnë marrdhënien e medijacionit me procedurën gjyqësore, sipas të cilës gjykata është i autorizuar që gjat gjith fazave të procedurës të shkallës së parë kontestimore t'i udhëzoj palët që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit, me ç'rast nëse palët vendosin për një zgjidhje të tillë, gjykatësi është i obliguar që në çdo fazë të procedurës ta ndërpres të njëjtën dhe t'i udhëzoj palët në zgjidhje të kontestit me medijacion. Sipas kësaj mundemi të konstatojmë se në Republikën e Maqedonisë janë të pranuar të dy modelet e medijacionit, edhe ajo e cila inicohet para fillimit të

³²⁷ Ligji mbi medijacionin, neni 22, al.1 dhe 2

procedurës kontestimore e njohur si medijacion privat dhe medijacionit i aneksuar gjyqësor e cila paraqitet kur medijacionit inicohet deri sa procedura kontestimore është duke vazhduar.

Procedura kontestimore mundet të ndërpritet nëse palët bien dakord që kontestin e tyre të mundohen që ta zgjidhin me anë të medijacionit. Autorizim për një veprim të tillë jep ligji për procedurën kontestimore në nenin 200 të cilën e shtjelluam më lartë në pjesën e ndërprerjes të procedurës kontestimore. Sipas këtij neni procedura kontestimore do të ndërpritet me fuqi të ligjit atëherë kur palët do të vendosin që çështjen e tyre kontestuese ta zgjidhin me anë të medijacionit. Parashtrohet pyetja, kur konsiderohet moment i përshtatshëm për ndërprerje të procedurës kontestimore dhe inicim të procedurës të medijacionit? A do të ishte e arsyeshme që kjo ndërprerje të bëhet edhe në fazat tjera të procedurës kontestimore, e këtu e kemi fjalën për procedurat e shkallës së dytë e të tretë, apo vetëm ndërprerja e procedurës kontestimore e shkallës së parë? Ligji i parë mbi medijacionin, pra ai i vitit 2006 parashihte se gjykata mundet ta ndërpresë procedurën në çdo fazë të procedurës kontestimore³²⁸. Edhe pse nuk është e shënuar në mënyrë shprehimore, vetë termi “çdo fazë e procedurës kontestimore” nënkupton se ky veprim mundet të mirret si në procedurën kontestimore të shkallës së parë ashtu edhe në procedurat e shkallës së dytë e të tretë. Por a konsiderohet e logjikshme, që pasi që është sjellur një vendim i formës të plotfuqishme në shkallë të parë të procedurës kontestimore, gjykata në procedurë të shkallës së dytë ose të shkallës së tretë, ta ndërpresë procedurën e ti udhëzoj palët në medijacion për zgjidhjen e çështjes kontestuese e cila njëherë është zgjidhur. Si rezultat i kësaj mospërpuethshmërie e sidomos për t'i ikur ngarkesës të procedurës kontestimore u bënë ndryshime në ligjin aktual për medijacionin sipas të cilit shprehimisht parashihet se “gjykata gjat ***procedurës të shkallës së parë*** mund t'i udhëzoj palët që kontestin ta zgjidhin në rrugë të medijacionit”³²⁹. Konsiderohet se edhe gjat interpretimit të dispozitave ligjore të cilat rregullojnë procedurën kontestimore në njëërën anë dhe procedurën e medijacionit në anën tjetër, hasen shumë papërpuethshmëri. Ajo e cila mundet që gjat zbatimit të procedurës kontestimore të shkaktoj probleme dhe paqartësi gjat interpretimit është momenti kur mundet dhe duhet të ndërpritet procedura kontestimore dhe të udhëzohen palët nga gjykata që të inicojnë procedurë të medijacionit për zgjidhjen e kontestit të tyre. Situata është identike edhe me ligjin mbi procedurën kontestimore si me ligjin mbi medijacionin e vitit 2006 por e ndryshuar në ligjin

³²⁸ Ligji mbi medijacionin i vitit 2006, neni 29, al.1

³²⁹ Ligji mbi medijacionin, neni 29 al. 1

aktual mbi medijacionin. Edhe në ligjin mbi procedurë kontestimore pika problematike qëndron në atë se në nenin 307 al. 1 ligjvënësi parasheh se pajtimi gjyqësor objekt i të cilit mundet të jetë marrëveshtja e palëve arritur në procedurë të medijacionit e inicuar gjat procedurës kontestimore, “palët munden ta lidhin gjat gjithë procedurës para gjykatës kontestimore”³³⁰. Edhe këtu haset situata problematike e njejtë siç u shtjellua më lartë me çështjen e interpretimit të nenit 29, al. 1 të ligjit mbi medijacionin sipas të cilës edhe këtu mund që gjat interpretimit të mundet të nënkuptojmë se ky pajtim gjyqësor mundet të lidhet edhe në fazat tjera të procedurës kontestimore repektivisht në procedurën e shkallës së dytë. Pra ky nen automatikisht bie në kundërshtim me nenin 29 të ligjit mbi medijacionin në të cilën në ligjin aktual me po atë nen siç edhe u shtjellua më lartë, parashihet që gjykata gjat procedurës së shkallës së parë mundet t’i udhëzoj palët në procedurë të medijacionit. Vlen të përmendet gjithashtu edhe ndryshimi me anë të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurën kontestimore³³¹ me të cilën ligjvënësi e obligon gjykatën që për kontestet ndaj të cilave është e lejuar medijacionit, gjat dërgimit ftesës për seancë pregaditore t’i njoftoj palët për të drejtën e tyre që kontestin ta zgjidhin me anë të medijacionit. Një gjë e tillë në ligjin mbi procedurën kontestimore nuk ishte e paraparë deri në vitin 2010 me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit edhe pse nga ana tjetër ligji mbi medijacionin i vitit 2006 (neni 29 LM) e parashihte obligimin e gjyqtarit që t’i njoftoj dhe t’i udhëzoj palët që kontestin ta zgjidhin me medijacionin. Kështu, sipas ndryshimeve dhe plotësimeve të vitit 2010 të ligjit mbi procedurën kontestimore gjykata qysh në fazën e dërgimit të ftesës për seancën pregaditore i udhëzon për mundësin që ato kanë për zgjidhjen e kontestit në procedurë të medijacionit. Megjithatë me këto ndryshime është e paraparë që më së voni deri në seancën pregaditore repektivisht në seancën e parë të shqyrtimit kryesor, palët të prononcohen a pajtohen që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit apo jo. Kjo na çon në përfundim se palët e kanë patjetër që të vendosin për zgjidhjen e kontestsit të tyre në procedurë të medijacionit ose në procedurë kontestimore më së voni në seancën pregaditore repektivisht në seancën e parë të shqyrtimit kryesor. Çka ndodh në rastet kur fillimisht palët nuk dëshirojnë medijacionin si zgjidhje të kontesteve e më pastaj ndrojnë mendjen? A duhet vallë të ketë dispozitë e cila do ta rregulloj këtë çështje? Nuk është e pamundur që edhe pse fillimisht palët nuk e konsiderojnë të përshtatshme medijacionin por duke kaluar procedura kontestimore në faza

³³⁰ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 307, al. 1

³³¹ Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurë kontestimore, neni 59, al. 2 dhe 4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 116/10

të mëvonshme, palët të binden se zgjedhja e tyre më e mirë do të ishte pikërisht medijacioni. Jemi të mendimit se një e drejtë e tillë duhet t'u jepet palëve, me ç'rast edhe pas përfundimit të seancës pregaditore respektivisht të seancës së parë të shqyrtimit kryesor palëve tu jepet e drejta që të deklarohen se dëshirojnë të provojnë kontestin ta zgjidhin me medijacion edhe në fazat e mëvonshme të shqyrtimit kryesor por jo edhe pas përfundimit të saj.

Kur palët vendosin që do të provojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit, ato nënshkruajnë deklaratë me të cilën pajtohen se do të marrin pjesë në medijacion e cila deklaratë jepet në procesverbal para gjykatës kompetente³³². Kështu për gjykatën ngelet që ta ndërpresë procedurën në pajtim me nenin 200, al. 6 të LPK dhe i njëjti është i obliguar që tëpres dhe të mos ndërmer asnjë veprim procedural lidhur me lëndën kontestuese deri sa të kalojnë 45 ditë nga dita e ndërprerjes, brenda të cilit afat ligjor kërkohet që procedura të ketë mbaruar pa mar parasysh rezultatin e saj. Mirpo, rezultati përfundimtar gjithsesi është shumë i rëndësishëm për atë se çka më tutje me procedurën e ndërprerë kontestimore. Sepse nga ajo varet vazhdimi ose përfundimi i procedurës kontestimore. Nëse medijacionit nuk përfundon me arritjen e marrëveshtjes, është e qartë situata se procedura kontestimore do të vazhdoj prej aty ku është ndërprerë dhe do të vendoset me aktgjykim. Por çka ndodh nëqoftë se aktgjykimi i gjykatës të shkallës së parë është ankimuar por në ndërkohë deri sa zgjat procedura para gjykatës të shkallës së dytë, palët vendosin që t'i japin shancë medijatorit që ta zgjidh kontestin e tyre. Vështirësit paraqiten atëherë kur në procedurën e medijacionit palët do të arrijnë deri në një marrëveshtje të përbashkët e cila njëkohësisht paraqet bazë për arritjen e pajtimit gjyqësor. Cilët veprime procedural gjykata e shkallës së parë do t'i ndërmer? A do ta pranoj marrëveshtjen për medijacion dhe ta regjistroj si pajtim gjyqësor dhe me këtë ta shfuqizoj aktgjykimin e shkallës së parë ose duhet që vet të sjellë vendim në lidhje me këtë? Në këto raste gjykata e shkallës së parë procesverbalin në të cilën e ka regjistruar pajtimin gjyqësor ndërmjet palëve do t'ia dërgoj gjykatës së shkallës së dytë i cili është kompetent për të vendosur për ankesën kundër aktgjykimin të shkallës së parë. Pasi që me anë të atij procesverbali dëshkohet se çështja e cila ishte kontestuese ndërmjet palëve tashmë si rezultat i zgjidhjes së saj nuk konsiderohet më në asnjë element kontestuese, e bën që pala i cili e ka parashtruar ankesën, me situatën e re të krijuar të konsiderohet si person i cili nuk ka asnjë interes juridik për paraqitjen e ankesës kundër

³³² Ligji mbi medijacionin, neni 15, al. 1

aktgjykimit të shkallës së parë, dhe me këtë rast gjykata e shkallës së dytë do të mundet që ankesën ta hedh poshtë si të palejuar³³³.

Procedura e medijacionit gjithashtu mundet të inicohet edhe para se të nis procedura kontestimore nga palët kontestimore. Që të mund të inicohet procedura e medijacionit ndërmjet palëve, ndërmjet tyre duhet të egzistoj kontest i cili lind nga një raport juridik ndërmjet tyre të cilët me bazë juridike me të cilën krijohet mundësia që kontesti i tyre të zgjidhet me anë të medijacionit, palët fitojnë të drejtën respektivisht detyrimin që kontestin e tyre ta zgjidhin në këtë mënyrë. Por, “që të mund të inicohet procedura e medijacionit, e nevojshme është egzistimi i ndonjëres nga këto bazat: egzistimi i pajtimit të dhënë me vullnetin e lirë të palëve për inicim të procedurës së medijacionit; dispozita në aktin juridik i cili e rregullon marrdhënien ndërmjet palëve, me të cilën medijacioni parashihet si mënyrë e rregullimit të çështjeve kontestuese të cilët mund të lindin nga ai raport; deklarata me të cilën palët japin pëlqim për medijacion e cila deklaratë duhet të jepet para gjykatës në proçesverbal dhe egzistimi i ligjit e cila rregullon këtë materie respektivisht Ligji mbi medijacionin”³³⁴. Por kur medijacioni inicohet para se palët të kenë inicuar procedurë kontestimore, atëherë si fillim i medijacionit konsiderohet dita kur palët në formë me shkrim do të pajtohen se do të marrin pjesë në medijacion. Inicimi bëhet ashtu që palës i dërgohet ftesë me propozim për inicim të medijacionit kështu që fjala përfundimtare i ngelet palës së cilës i adresohet ftesa, a do ta pranoj ose do ta refuzoj medijacionin si mënyrë e zgjidhjes të kontestit të tij me palën tjetër. Në këto raste pala ka për detyrë që shtatë ditë nga dita kur ka pranuar ftesën për medijacion të paraqitet në takim me medijatorin ose në takim me medijatorin dhe palën i cili e ka propozuar medijacionin³³⁵. Gjat këtij takimit pala e cila është ftuar në medijacioni duhet të prononcohet në lidhje me atë a dëshiron që së basku me palën tjetër ta zgjidhin kontestin e tyre para medijatorit, Nëse nuk ajtohet për një gjë të tillë, në pajtim me nenin 15, al. 4 këtë deklaratë gjithashtu duhet ta jap me shkrim. Ligji gjithashtu jep kufizim kohor prej 15 ditëve brenda të cilëve pala e ftuar me ftesën për medijacion të propozuar nëse nuk prononcohet se e pranon ose jo të mer pjesë në medijacion, atëherë do të konsiderohet se propozimi për inicim të medijacionit nuk është pranuar nga ajo palë. Por kur propozimi pranohet, respektivisht kur palët me shkrim miren vesht për nisjen e procedurës së medijacionit, e njejta

³³³ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 347, al.1 dhe 2

³³⁴ <https://akademik.mk/postapkata-za-medijacija-nekolku-fazi-do-prifatlivo-reshenie/>

³³⁵ Ligji mbi medijacionin, neni 15, al. 3

mundet të përfundoj në mënyrë të suksesshme ashtu që palët do të lidhin marrëveshje, gjë që e bën të panevojshme iniciimin e procedurës kontestimore për të njejtin kontest. Por në rastet kur medijacioni do të ishte i pasuksesshëm, në ato raste palët kanë të drejtë që kontestin ta zgjidhin në procedurë klasike kontestimore. Ligji parasheh edhe rastet kur iniciimi i medijacionit respektivisht procedurës kontestimore të jetë parakusht për iniciim të procedurës kontestimore respektivisht të procedurës së medijacionit. Kështu mundet që me ligj të veçantë të parashihet iniciimi i procedurës së medijacionit si kusht për zbatimin e procedurës gjyqësore nëse palët gjat lidhjes të kontratës për biznes në mes tyre obligohen që në rast të paraqitjes të ndonjë mosmarrëveshje në mes tyre të njejtën ta zgjidhin me anë të medijacionit, ose së paku të mundohen që ta zgjidhin me anë të medijacionit para se të inicohet procedura kontestimore ose edhe ndonjë procedurë tjetër³³⁶. Gjithashtu janë edhe rastet kur iniciimi i procedurës kontestimore deri sa është duke rrjedhur procedura e medijacionit është e patjetërsueshme, sepse në të kundërtën do të pasonte humbja e të drejtës për mbrojtje juridike.

Çka ndodh me afatet prekluzive për iniciim të procedurave tjera deri sa zgjat procedura e medijacionit? Si është e rregulluar çështja e këtyre afateve me ligjet të cilët rregullojnë materien e medijacionit? Fillojmë me ligjin mbi medijacionin i cili nuk është më në fuqi. Sipas ligjit të vitit 2006 në nenin 15 është e rregulluar ndërprerja e parashkrimit, sipas të cilës me rastin e fillimit të procedurës të medijacionit fillon ndërprerja e parashkrimit të kërkesës e cila është lëndë e kontestit, i cili afat zgjat deri në mbarimin e procedurës të medijacionit. Ndërsa në rastet kur medijacioni ishte i pasuksesshëm afati vazhdonte që të rrjedh nga momentii përfundimit të medijacionit pa rezultat përfundimtar³³⁷. Ky ligj respektivisht ky nen nuk e rregullonte situatën kur gjat zbatimit të procedurës të medijacionit palët nuk kanë të drejtëqë në të njejtën kohë respektivisht deri sa zgjat procedura e medijacionit të inicojnë procedurë kontestimore ose arbitrazh ose ç'far do procedure tjetër për kontestsin e cila është lëndë e medijacionit³³⁸. Kjo pyetje në mënyrë plotësuese u rregullua me ligjin aktual të medijacionit e cila është në fuqi³³⁹ por edhe më kryesorja është se këto nene ishin në pajtim edhe me Propozim Direktivën e

³³⁶ Ligji mbi medijacionin, neni 15, al. 6

³³⁷ Ligji mbi medijacionin 2006, neni 15, al. 2

³³⁸ Përfundimisht me ligjin mbi medijacion të vitit 2006 rregullohen njejt si me ligjin aktual përjashtimi iniciimit të procedurave tjera përderisa zgjat procedura e medijacionit kur bëhet fjalë për masa të përkohshme ose masave të sigurisë, sipas të cilit palët deri sat ë përfundoj procedura e medijacionit nuk kanë të drejtë që të nisin procedurë gjyqësore.

³³⁹ Ligji mbi medijacionin, neni 16, al. 3

Parlamentit Evropian dhe këshillit³⁴⁰ sipas të cilës rrjedhja e të gjithë afateve të caktuara të cilët afate kanë të bëjnë me kërkesën e cila është lëndë e medijacionit, duhet të ndërpritet nëse pas paraqitjes së kontestit: palët do të dakordohen të marrin pjesë në procedurën e medijacionit, kur medijacionit është urdhëruar nga gjykata ose kur egziston detyrimi i inicimit të procedurës së medijacionit sipas të drejtës nacionale të shtetit anëtar, si dhe në Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e cila parasheh që shtetet anëtare duhet të sigurojnë që palët të cilët zgjedhin medijacionin që të mundohen me anë të saj të zgjidhin kontestin e tyre, duhet të parandaloj që ato të iniciojnë procedura gjyqësore ose të arbitrazhit në lidhje me kontestin e cila është lëndë e medijacionit me ndalimin e rrjedhjes të afatit të parashkrimit gjat procedurës të medijacionit³⁴¹. Nga ana tjetër ligji respektivisht neni 16 i ligjit aktual mbi medijacionin nisja e procedurës së medijacionit nuk shkakton ndërprerje të rrjedhjes të afateve të parashkrimit si dhënk ndikon edhe në rrjedhjen e afateve prekluzive për inicimin e procedurës. Ligjvënësi në këtë mënyrë mbron dhe siguron rrjedhje të medijacionit pa ndërprerje dhe pa probleme. Në këtë mënyrë ai siguron ikjen nga manipulimet dhe keqpërdorimet të cilët mundën të bëhen nga palët të cilët kanë qëllime dytësore përveç zgjidhjes të kontestit. Këto keqpërdorime mundet të bëhen në atë mënyrë që palët me anë të inicimit të procedurës kontestimore ose të ndonjë procedure tjetër pa patur nevojë do të ndërpres procedurën e medijacionit dhe nga ana tjetërdo ta prolongonte dhe pamundësonte dhënien e mbrojtjes të nevojshme juridike.

Nga ana tjetër duhet të analizohet dhe qëndrimi i procedurës gjyqësore ndaj medijacionit kur kjo e fundit është duke u zbatuar. Është një e ditur botërisht se gjykatat janë organet primare të drejtësisë të cilët në çdo moment të nevojshëm janë të gatshëm që të japin mbrojtjen juridike të nevojshme kur atë e kërkojnë qytetarët me të drejta subjektive të lënduara dhe të cënuara. Në pjesën e tretë të Rekomandimit e cila pjesë rregullon organizimin e medijacionit, deklarohet se "edhe pse palët marrin pjesë në procedurën e medijacionit, hyrja respektivisht aksesit i tyre në gjykatë duhet t'u jetë gjithmonë në dispozicion pasi që gjykata është ajo e cila siguron dhe garanton dhënien të mbrojtjes të të drejtave të palëve"³⁴². Në rast të paraqitjes të padisë në gjykatë për inicim të procedurës kontestimore, dhe pas konstatimit se për kontestin e tillë është inicuar

³⁴⁰ Proposal for a directive of the European Parliament and of the Council on certain aspects of mediation in civil and commercial matters, neni 7, SEC (2004) 1314, Brussels, 22.10.2004

³⁴¹ Directive European Parliament and of the Council on certain aspects of mediation in civil and commercial matters, neni 8, 2008/52/EC of 21 May 2008.

³⁴² Recommendation Rec (2002)10 of the Committee of Ministers to member States on mediation in civil matters, miratuar nga Komiteti i ministrave në 18 shtator 2002 në mbledhjen e 808-të Zëvendësministrave.

procedurë e medijacionit ndërmjet palëve e cila është ende duke rrjedhur, për gjykatën ngelet të vendos a do të ndërmer veprim procedural në lidhje kërkes padinë e cila i është paraqitur nga pala paditëse apo do ta ndërpres procedurën dhe do të pres deri sa të përfundoj procedura e medijacionit pa mar parasysht a përfundon me sukses apo pa suksese, dhe në bazë të atij rezultati i cili do të arrihet, do ti happen rrugët e të vepruarit më tej. Dmth, këto janë dy zgjedhjet të cilët mundet t'i bëj gjyqtari, dhe jo të inicioj procedurë paralele, sepse një gjë e tillë është e palogjikshme, e sidomos edhe fakti se për një çështje kontestuese nuk duhet të vendoset dy herë pasi që “marrdhënia juridike kontestuese e cila është vendosur në mënyrë të plotfuqishme (res iudicata) është pengesë për inicim të procedurës në mes të njejtëve palë dhe për të njejtën çështje juridike”³⁴³. Por nga ky variant ka një përjashtim i cili lejohet në rastet kur egziston reziku i përfundimit të rrjedhjes të afatit për parashtrim respektivisht afatit prekluziv për inicim të procedurës kontestimore, si dhe nga ana tjetër prognozatat e zgjidhjes të kontestit me anë të medijacion janë shumë të vogla e cila si pasojë do të kishte mosdhënia e mbrojtjes juridike të nevojshme për palët në kontest. Por kush ka përparsi nga procedurat nëse në praktik paraqitet një rast i tillë? Procedura e medijacionit duhet të ndërpritet apo procedura kontestimore? Evidente është se më pak e logjikshme është varianti e parë, respektivisht ndërprerja e procedurës së medijacionit dhe zbatimi i procedurës kontestimore. Themi se është e pa logjikshme nga fakti se procedura e medijacionit është procedurë shumë e shpejtë dhe efikase, dhe si e tillë ajo siguron një zgjidhje të kontestit në afat shumë më të shkurtër se sa procedura kontestimore dhe atë zgjidhje për një ditë, ose për disa ditë e cila kohëzgjatje as që mund t'i afrohet afër kohëzgjatjes të procedurave kontestimore. Për atë shkak konsiderohet si zgjedhje më e mirë ajo që gjykata menjëherë pasi që do të kuptojë për faktin se për çështjen e njejtë kontestuese veç më është duke u zbatuar procedura e medijacionit i cili ka si lëndë të njejtën çështje kontestuese dhe si palë paraqiten palët e njejtë si në procedurën kontestimore, ta ndërpresë procedurën dhe të pres dhe të përmbahet nga çdo veprimi të cilët do të kishin kontra efekt si për çështjen kontestuese ashtu edhe për procedurën e më së shumti për palët për të cilët pasojat do të ishin shumë të mëdha. Kështu, nëse procedura e medijacionit përfundon pa sukses procedura kontestimore do të vazhdojë sipas rregullave të caktuara me ligj, ndërsa nëse procedura e medijacionit përfundon me sukses atëherë marrëveshtja e arritur në procedurën e medijacionit ndërmjet palëve do të shërbej si bazë për lidhjen e pajtimit gjyqësor.

³⁴³ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 441

Hapi parë i cili bëhet me rastin e zbatimit të procedurës është që me lidhjen e marrëveshtjes për medijacion është palët përcaktojnë kush do të jetë medijator i cili do ta udhëheq procedurën dhe i cili do t'i ndihmoj që ta zgjidhin konstatin. Në marrëveshtjen për medijacion palët mundet që nëse e shofin të arsyeshme, p.sh nëse kontesti i tyre përfshin më shumë fusha ose është më i komplikuar për nga natyra, të mundet të zgjedhin më tepër se një medijator. Gjithmon medijatorët zgjidhen nga Lista e medijatorëve të regjistruar. Nëse palët nuk mundet të bien dakord për medijatorin, atëherë çështja e zgjidhjes të medijatorit do t'u ngelet Odës së medijatorëve, nga të cilët palët do të kërkojnë ndihmë për caktimin e numrit të medijatorëve ose për caktimin e medijatorit për kontestsin e tyre³⁴⁴. Medijatori gjat udhëheqjes të procedurës është i obliguar që palët t'i njoftoj me medijacionin nga më afër, përfshirë këtu mënyra se si do të zbatohet procedura e medijacionit, parimet e procedurës të cilët do të ndiqen nga filli deri në fund³⁴⁵, rregullat me të cilët rregullohet kjo procedurë si dhe shpenzimet e saj. Ai gjithashtu i informon palët se edhe pse gjat gjithë kohës sa zgjat procedura ai do t'u ndihmojë që të gjejnë bashkë një zgjidhje të kontestit e cila do të jetë e përbashkët, vet ato do të jenë ato të cilët do ta sjellin vendimin përfundimtar për kontestin. Kështu, medijatorët gjat procedurës së medijacionit nuk janë asgjë tjetër përveç se ato të cilët do të drejtojnë procedurën e medijacionit sipas rregullave të cilët do t'i përcaktojnë palët, me ç'rast rolin kryesor këtu e kanë palët dhe përfaqësuesit e tyre të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në rezultatin e procedurës. Nga kjo vërehet dallimi i rolit të medijatorit nga ajo e gjykatësit, sepse medijatori këtu paraqitet vetëm si ndihmës respektivisht lehtësues gjat bisedimeve ndërmjet palëve i cili u ndihmon që të zbus komunikimin ndërmjet tyre dhe kështu të gjenjnë pika të përbashkëta të interesave të tyre, të nevojave të tyre dhe kështu të vijnë në zgjidhjen sa më të mirë të mundshme të kontestit të tyre. "Ato duhet të krijojnë një atmosferë të favorshme për komunikim dhe shkëmbim të informacioneve ndërmjet palëve duke arritur një ekuilibër ndërmjet pozitave të kundërta të tyre e cila do tu mundësonte që në mënyrë të lirshëm të negociojshin interesat e tyre me një sy të një marrëveshtjes së përbashkët"³⁴⁶. Kështu medijatori gjat kontrollit dhe udhëheqjes të procedurës ai gjithashtu arrinë që të kontrolloj dhe t'i tejkaloj të gjitha vështirësit dhe problemet të cilët dalin gjat bisedimeve të palëve në procedurën e medijacionit. Gjat procedurës të medijacionit palët mundet

³⁴⁴ Ligji mbi medijacionin, neni 17, al.1

³⁴⁵ Parimet e procedurës të medijacionit janë: mënyra vullnetare e inicimit dhe marjes pjesë nga palët, parimi i neutralitetit dhe të paanshmërisë, besueshmëria, barazia e palëve, trasparenca, efikasiteti dhe legaliteti ose drejtësia, të cilët parime u shtjelluan një nga një në kapitullin e dytë të pjesës së parë.

³⁴⁶ Family mediation in Europe, (1998), proceedings, 4th European conference on Family Law, Strasburg, fq. 81

të jenë si persona fizik ashtu edhe juridik. Nëse palët janë persona fizik atëherë ato duhet që personalisht të jenë prezentë ndërsa e njejta situatë paraqitet edhe kur si palë paraqitet personi juridik, me ç'rast e njejta gjë vlen edhe për përfaqësuesin e tij. Çështja e të përfaqësuarit në procedurën e medijacionit është pikë dalluese e cila e dallon këtë procedurë me atë kontestimore. Përderisa në procedurën kontestimore lejohet që palët të përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre dhe të njejtit mundet të mos jenë prezentë në shumicën e seancave, në procedurën e medijacionit është e nevojshme dhe e rëndësishme së madhe prezenca personale e të dy palëve. Kjo është kështu përshkak të disa arsyeve. Njëra prej tyre është nevoja e prezencës aktive të palëve në procedurë. Përse quhet prezencë aktive? Nga shakku se ajo është e vetmja mënyrë që palët të mundën për nga aspekti formal t'i shprehin qëndrimet e tyre dhe të tregojnë pozicionet e tyre në procedurë, e cila prezencë do t'i mundësoj atyre që deri në fund të procedurës të vijnë deri në një zgjidhje të përbashkët të problemit pa mar parasysh përmbajtjes së saj e cila në fakt paraqet edhe arsyen e dytë për rëndësinë e prezencës aktive. Pra, jo rastësisht në procedurë të medijacionit ligjvënësi kërkon pjesmarjen e palëve personalisht në të, pasi që rezultati përfundimtar i saj varet nga vet vullneti i palëve e cila mundet të vjen në shprehje vetëm nëpërmjet dhe si rezultat i pjesmarjes së tyre gjat procedurës edhe pse edhe këtu nuk përjashtohet e drejta e përfaqësimit të palëve me përfaqësues me prokurë pjesmarja prapalele edhe e përfaqësuesev respektivisht avokatëve të palëve në procedurën e medijacionit aspak nuk e vështirëson këtë procedurë, por përkundrazi ndihmon në arritjen e një zgjidhjes përfundimtare të kontestit brenda kornizës të të drejtës. Procedura e medijacionit zbatohet në mbledhjet të cilët i cakton medijatori në pajtueshmëri me vullnetin e palëve. Edhe pse nuk është e paraparë me ligj, si zakonisht ato mbahen dhoma të cilët nuk janë të njejtat ku mbahen procedurat gjyqësore, respektivisht në dhoma të veçanta ku medijatori konkret i zhvillon seancat e tij. Sipas nenit 18 alinesë 3, medijatori mundet që bisedat me palët t'i ketë të përbashkëta, pra të bisedoj me palën në prani të palës tjetër, por mundet edhe që këto bisedime t'i kryej veçmas, nëse këtë e konsideron si më frytdhënëse për përfundim sa më të shpejtë të procedurës. Por në asnjë mënyrë ligji nuk e ndalon atë që informacionet të cilët i fiton gjat bisedave ndarazi me palët, t'ia komunikoj palës tjetër pasi që shkëmbimi i informacioneve në këtë procedurë është e rëndësishme për palët dhe medijatorin që t'i shtjellojnë dhe ti kanalizojnë propozimet e tyre e cila do të sjell deri në një zgjidhje më të përshtatshme për kontestin ndërmjet tyre.

Faza e parë e procedurës së medijacionit është faza ku palët njihen nga afër me procedurën e medijacionit. Kjo fazë vjen menjëherë pasi që palët me medijatorin takohen dhe caktojnë me marrëveshje takimin e ardhshëm ose mundet që ky takim të vazhdoj direkt në fazën e parë. Në fazën e parë si zakonisht marin pjesë palët dhe medijatori, përjashtimisht mund të marin pjesë edhe përfaqësuesit e tyre kur të njejtit kanë angazhuar një të tillë. Hapi i parë i medijatorit në takimin e parë me palët dhe eventualisht përfaqësuesit e tyre është që të konstatoj a kanë palët dhe përfaqësuesit e tyre autorizimet³⁴⁷ e nevojshme për lidhjen e marrëveshjes së medijacionit ose jo. Është e rëndësishme ndërmarrja e një hapi të tillë nga fakti se gjithë puna e medijatorit dhe palëve përfshirë këtu edhe përfaqësuesve të tyre si këshilltar ligjor të palëve do të “bie në uj” sepse vendimi përfundimtar nuk do të miratohet nga personat e autorizuar³⁴⁸. Pas kësaj vijon njoftimi i palës me rolin e tyre në procedurën e medijacionit, respektivisht për të drejtat dhe obligimet e tyre si dhe kufizimet e tyre në procedurë, do tu tregoj në lidhje me mënyrën e mbajtjes të takimeve, nevojën për prezencën e tyre, nevojën që të jenë dëgjues të mirë dhe të kujdesshëm, për konfidencialitetin e të dhënave dhe informacioneve të cilët do të shpalosen gjat takimeve dhe mbi gjithë do ti njoftoj me rolin kyç që palët kanë në zgjidhjen e kontestit. *Faza e dytë* e procedurës së medijacionit është faza ku prezentohen pozitat e palëve dhe ku bëhet analiza e fakteve nga palët respektivisht përfaqësuesve të tyre. Kjo fazë konsiderohet si faza qendrore e procedurës së medijacionit pasi që në këtë periudh të procedurës së medijacionit palët paraqesin qëndrimet e tyre në lidhje me çështjen e cila paraqitet kontestuese ndërmjet palëve, bëhet shkëmbim i informacioneve nga të dyja palët, parashtrihen pyetje dhe jepen përgjigje. Gjithë këto veprime ndërmiren në prezencë të medijatorit i cili gjat gjithë kohës u ndihmon që emocionet të mos e tejkalojnë kufirin qetësisë të palëve. Faza e cila pason pas kësaj është *faza e konstatimit të opsioneve dhe alternativave*. Gjat kësaj faze mbahen mbledhjet me palët nga medijatori të cilët mbledhje mund ti përfshijnë të dy palët së bashku ose do të jenë mbledhje të veçanta në të cilën medijatori do të ketë takim me secilën palë veç e veç. Në këto mbledhje palët tregojnë pikpamjet e tyre për kontestin në fjalë, zbulojnë interesat dhe nevojat e tyre. Në bazë të kësaj me ndihmën e medijatorit arrihen që të nxiren interesat e përbashkëta dhe prioritetet për palët, dhe në lidhje me këto fitohet një pasqyrë e përafërt se si do të mund të duket deri diku zgjidhja e kontestit të tyre. Që medijatori gjat mbledhjeve të fitoj njohuri për këto të

³⁴⁷ Neni 84 i Ligji mbi procedurën kontestimore

³⁴⁸ Šimac, S, Mirenje - alternativni način rješavanja sporova, Zb. Prav. fak. Sveuč. Rij. (1991) v. 27, nr. 1, 611-632, fq. 625

dhëna ng palët, duhet që të veprojnë gjat gjithë kohës si një dëgjues i mirë dhe aktiv por gjithashtu edhe si rezultat i parashtrimit të pyetjeve por gjat gjithë kohës duhet të ketë kujdes që të ruaj pozitën neutrale të tijë, e cila në të kundërt do të rezikonte tërësisht procedurën e medijacionit. Gjithashtu gjat kësaj faze nga palët shpallen edhe propozimet se si mund të zgjidhet kontesti i tyre me anë të medijacionit, dhe është obligim i medijatorit që të dy palëve t’ua jep mundësinë që të propozojnë mënyratbe zgjidhjes të kontestit ndërmjet tyre³⁴⁹. Pas fazës ku në tërësi bëhet shtjellimi i problemit, nis *faza e dialogut dhe negociimit*. “Në këtë fazë medijatori do t’i sqarojë dhe do ti përmbledh qëndrimet dhe pritshmëritë e palëve dhe do t’i inkurajojë që propozimet e tyre për zgjidhjen e kontestit t’i harmonizojnë në mënyrë racionale në pajtueshmëri me interesat e palës tjetër”³⁵⁰. Medijatori gjithashtu gjat kësaj fazës e cila konsiderohet faza e parafundit, i përgëzon palët për zgjidhjen e medijacionit, i përkujtonë palët se zgjedhja e tyre për pjesmarje në medijacion i ka përparësitë e veta ndaj kontestit të tyre për sa i përket suksesit i cili pritet të arrihet, shpenzimet, kohëzgjatja e zgjidhjes të kontestit të zgjidhur me anë të medijacionit, dhe dallimi i asaj se si do të kalonin palët për zgjidhjen e të njëjtit kontest në procedurë kontestimore për sa i përket suksesit, shpenzimet e kohëzgjatja e procedurës kontestimore. Këtëprezentim komperativ medijatori e bën me qëllim që palët t’i inkurajojë që të zgjidhin kontestin me anë të marrëveshtjes për medijacion. Dhe në fund, si fazë përfundimtare me të cilën përmbillet procedura e medijacionit është *faza e lidhjes të marrëveshtjes për medijacion* në mes të palëve. Në këtë fazë, medijatori ka një rol krejtësisht të kundër në krahasim me gjyqtarët të procedurës e kontestimore sa i përket përfundimit të procedurës. Kështu, medijatori nuk sjell vendim përfundimtar dhe autoritativ si gjyqtarët, i cili vendim do të ishte i detyrueshëm për palët. Në këtë fazë janë palët ato të cilët me ndërmjetësimin e medijatorit arrijnë një kompromis lidhur me çështjet të cilët janë kontestuese ndërmjet tyre, dhe më pastaj lidhin marrëveshtje me të cilën e zgjidhin situatën konfliktuoze. Si rezultat i asja se çka për palët deri më tani ishte e kontestueshme dhe e cila në këtë fazë lirisht mundet të konsiderohet si pakontestuese ose edhe varijanta më e keqe është kur ende edhe në këtë fazë vazhdon të jetë kontestuese, hap i ardhshëm është përpilimi i marrëveshtjes për medijacion³⁵¹. Para se përfundimisht të arrihet marrëveshtja ndërmjet palëve, medijatori duhet t’u ndihmojë palëve nëse vëren se asnjëra prej tyre nuk hekin dorë nga

³⁴⁹ Ligji mbi medijacionin, neni 19, al. 1 dhe 2

³⁵⁰ Japunčić. T, (2016), Mirenje kao alternativni način rješavanja sporova u Republici Hrvatskoj, Pravnik, 50, 1 (100), Zagreb, fq. 37

³⁵¹ Ligji mbi medijacionin, neni 21

qëndrimet dhe pretendimet e tyre duke mbajtur llogari për atë që marrëveshtja e palëve e cila do të duhet të lidhet ndërmjet palëve duhet të jetë i arsyeshëm dhe i zbatueshëm e sidomos në pajtueshmëri me ligjin. Është e preferueshme që palët të jenë ato të cilët do ta përpilojnë këtë marrëveshtje, përjashtimisht rasteve kur palët kërkojnë nga medijatori që ta bëjë këtë në vend të tyre. Pasi që marrëveshtja për medijacion përpilohet ajo duhet të nënshkruhet nga palët, dhe atë në afat prej tre ditëve të punës i cilia fat fillon të rrjedhë nga dita kur arrihet marrëveshtja ndërmjet palëve. Këtë marrëveshtje më pastaj e vërteton me nënshkrimin e vet edhe medijatori³⁵². Në rast se në këtë fazë palët nuk mund të arrijnë një gjuhë të përbashkët për zgjidhjen e kontestit të tyre, ata të njëjtit do të tentojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin në procedurë kontestimore, në të cilën në asnjëfar mënyrë nuk do të tolerohet që të dhënat të cilët janë fituar dhe të cilët i kanë nxjerur palët gjat seancave të procedurës së medijacionit nuk mundet të përdoren edhe në procedurën kontestimore.

Ligji mbi medijacionin përveç këtyre dy mënyrave se si mund të përfundojë procedura kontestimore, parasheh edhe këto mënyra: me lidhjen e marrëveshtjes me shkrim për zgjidhjen e kontestit ndërmjet palëve; me deklaratën me shkrim të medijatorit pas konsultimeve të kryera me palët se nuk janë të arsyeshme tentimet e mëtejme për medijacion; me deklaratë me shkrim nga palët tek medijatori se procedura për medijacion ka përfunduar si dhe me deklaratën me shkrim nga cilado palë e procedurës të palët tjera dhe të medijatori nëse i njëjti është emëruar, se procedura për medijacion ka përfunduar. Për të gjitha këto raste me ligj gjithashtu është e paraparë edhe fakti se cila ditë do të konsiderohet si ditë e përfundimit të procedurës së medijacionit, kështu atëherë kur procedura përfundon me deklaratë me shkrim, si ditë e përfundimit të procedurës do të konsiderohet dita kur është lidhur ajo marrëveshtje, ndërsa kur procedura e medijacionit përfundon me deklaratë me shkrim, atëherë si ditë e përfundimit të procedurës do të konsiderohet dita kur ajo deklaratë është dorëzuar. Gjithsesi, pa marrë parasysh rezultati përfundimtar i procedurës së medijacionit, ajo duhet të përfundojë në afat prej 60 ditëve i cili afat fillon të rrjedhë nga dita e dhënies të deklaratës për inicim të procedurës së medijacionit (neni 21, al. 2 LM). Me ligjin mbi medijacionin është paraparë që nëse në marrëveshtje është përcaktuar ndonjë detyrim i palës, ajo marrëveshtje mund të përmbajë klauzulë për përbarim.

³⁵² Sipas nenit 21, al. 2 të gjitha marrëveshtjet të cilët mbarojnë me anë të medijacionit dhe të cilët vërtetohen nga ana e medijatorëve me nënshkrim, paraqiten në Ministrinë e Drejtësisë me qëllim që e njëjta të regjistrohet në Regjistrin për evidentim të procedurave të medijacionit.

Sipas nenit 22, al, 1 kur procedura e medijacionit është inicuar para nisjes së procedurës kontestjimore, dhe palët dëshirojnë që marrëveshtjes t'i japin fuqinë përmbaruese, ato marrëveshtjen mundet ta vërtetojnë tek noteri, me ç'rast ajo marrëveshtje fiton cilësinë e dokumentit përmbarues.

Kur procedura për medijacion është inicuar gjat procedurës kontestjimore dhe e njejta është përfunduar me lidhje të marrëveshtjes për medijacion, kjo marrëveshtje për gjykatën kontestjimore paraqet bazë që palët të lidhin pajtim gjyqësor e cila pasi që do të konstatohet dhe do të nënshkruhet në procesverbal, procedura kontestjimore e cila ishte e inicuar do të përfundoj. Ndërsa në rastet kur procedura e medijacionit përfundon me deklaratë me shkrim të medijatorit ose të palëve ose nëse përfundon nga shkaku se kanë kaluar 45 (neni 203, al. 2 LPK) ditë nga dita e ndërprerjes të procedurës kontestjimore, atëherë procedura e ndërprerë kontestjimore vazhdon prej atje ku është ndërprerë. Pavarësisht rezultatit përfundimtar të procedurës së medijacionit e inicuar me kërkesë të palëve ose me propozim të gjykatës gjat procedurës kontestjimore, medijatori është i obliguar që në afat prej tre ditëve të punës ta njoftoj gjykatën për mënyrën e përfundimit të procedurës³⁵³. Ky detyrim ligjor i medijatorit është në favor të moszvarritjes të procedurës dhe dhënies sa më të shpejtë të mbrojtjes juridike, me ç'rast menjofitim e medijatorit për përfundimin e procedurës të zbatuar nga vet ai, i jep mundësi gjykatës që mendjëherë ta vazhdoj procedurën e ndërprerë kontestjimore nëse procedura ka përfunduar pa sukses, respektivisht të caktojn seancë në të cilën marrëveshtjen e arritur me anë të medijacionit ta regjistroj në procesverbal për lidhje të pajtimit gjyqësor në rastet kur medijacionit ka qenë i suksesshëm. Por, çka do të ndodh atëherë kur palët e kanë inicuar procedurën e medijacionit para se të inicojnë procedurë kontestjimore dhe kur e njejta përfundon pa sukses? A kanë të drejtë që ato të inicojnë procedurë kontestjimore? Normalisht se po, pasi që inicimi i procedurës së medijacionit dhe rezultati i saj nuk paraqet ndonjë parakusht për inicimin ose mosinicimin e procedurës kontestjimore, pra nuk paraqet asnjë pengesë procedural për të inicuar procedurë kontestjimore.

Me përfundimin e procedurës së medijacionit si të gjith procedurat tjera, paraqitet nevoja e mbulimeve të shpenzimeve të procedurës të cilët janë bërë deri në përfundimin e saj të cilët shpenzime paraqiten përshkak të ndërmarjes të veprimeve të medijatorit, palëve respektivisht

³⁵³ Ligji mbi medijacionin, neni 22, al. 2

përfaqësuesve të tyre, si dhe personave të tjerë të cilët kanë marë pjesë dhe kanë ndërmarrë veprime në procedurë të medijacionit. Pa marë parasysh mënyra se si është inicuar apo përfunduar procedura e medijacionit, ajo shkakton disa shpenzime për palët të cilët varen nga natyra dhe vlera e lëndës së kontestit si dhe nga vëllimi i punës së medijatorit. Sipas rregullit secila palë personalisht i mbulon shpenzimet e veta në procedurë, ndërsa shpenzimet e përbashkëta i mbulojnë bashkarisht me palën tjetër të ndara në pjesë të barabarta, përjashtimisht nëse palët nuk miren vesht më ndryshe për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve të procedurës³⁵⁴. Shpenzimet e përbashkëta në fakt përbëjnë shpërblimin e cila i takon medijatorit për punën e kryer. Ajo u takon në ty palëve. Medijatorit i takojnë t'i mbulohen edhe shpenzimet reale të cilët janë shpenzimet shkaktuara përshkak të veprimeve administrative-teknike të cilët i mbulojnë të gjitha shpenzimet të cilët konsiderohen si të nevojshme për zbatimin e procedurës. Gjithashtu neni 25 në alinenë e tij të fundit u mundëson palëve që procedura e medijacionit të jetë pa pagesë atëherë kur palët dhe medijatori do të merren vesht për këtë gjë ose kur një gjë e tillë është e rregulluar me ligj. Gjithashtu medijatori me qëllim që të ketë si garanci se palët do t'i mbulojnë shpenzimet e procedurës së medijacionit pasi që e njëjta të përfundojë pa marë parasyshë rezultatin final të saj, mundet nga palët që të kërkojë që të deponojnë avancë për shpenzimet e procedurës³⁵⁵. Nëse palët nuk e paguajnë shumë e caktuar për avancë në tërësi, medijatori është i obliguar që ti pres të njejtit në afat prej tetë ditëve nga dita e kërkesës së medijatorit. Nëse edhe pas këtij afati palët nuk deponojnë avancë, atëherë medijatori ka të drejtë që me deklaratë me shkrim të heq dorë nga procedura për ndërmjetësim. Sipas neni 25 al. 3, medijatori me qëllim të transparencës, është i obliguar që palët në fund të procedurës t'i njoftoj për mjetet e shpenzuara. Ndërsa sa i përket mjeteve të cilët mund të ngelin të pashpenzuara, atëherë ato menjëherë u kthehen palëve.

IV Pajtimit gjyqësor në procedurën kontestimore dhe marrëveshtja për medijacion në procedurën e medijacionit

1. Natyra juridike e pajtimit gjyqësor

³⁵⁴ Ligji mbi medijacionin, neni 25, al. 1

³⁵⁵ Ligji mbi medijacionin, neni 26, al. 1

Ligji mbi procedurën kontestimore lejon që palët gjat periudhës sa zgjat kontesti të mundet që të mundet të pajtohen për kërkesat me të cilët ato disponojnë lirshëm dhe të cilët i kanë paraqitur në procedurën kontestimore. Pajtimi gjyqësor ose *res iudicialiter transacta* është një lloj marrëveshjeje a kontrate e cila lidhet ndërmjet palëve në kontest respektivisht ndërmjet paditësi dhe të paditurit para gjykatës kompetente për zgjidhjen e kontestit të tyre. Për nga forma ajo gjithmonë duhet të jetë e përpiluar në formë shkrimore. Me të palët rregullojnë marrdhënie juridiko-civile ndërmjet tyre me kërkesat e të cilëve ato disponojnë lirshëm. Ky pajtim gjyqësor mundet të lidhet si në kontest ashtu edhe jasht saj. Nëqoftë se lidhet pajtimi gjyqësor gjat procedurës kontestimore, e njëjta ka fuqinë e barabartë si aktgjykim i plotëfuqishëm të cilën e sjell gjykata me rastin e përfundimit të procedurës së rregullt kontestimore. Në rastet kur me anë të pajtimit gjyqësor vendoset për ndonjë detyrim të njëjës prej palëve, atëherë ai dokument respektivisht marrëveshja për pajtim gjyqësor do të fitoj fuqinë e dokumentit përmbarues. “Pajtimi gjyqësor e zavendëson vendimin gjyqësor, e cila në teorinë juridike si zakonisht përdoret me termin “surogat i vendimit gjyqësor”.³⁵⁶ Edhe pse ky lloj i veprimit procedural të palëve ndërmjet përderi sa rrjedh procedura kontestimore, me të mundohet që t’i iket zgjidhjes së kontestit me vendim gjyqësor dhe nga ana tjetër e njëjta të zgjidhet në mënyrë paqësore, gjë e cila në shikim të parë duket shumë kontradiktore por në fakt është ashtu. Pra, palët në kontest në lidhje me kërkesat të cilët ato disponojnë lirshëm dhe të cilët pajtohen me përmbajtjen e kontestit, ndërmarin secili veprime të caktuara procedurale kontestimore që të zgjidhin me marrëveshjeje dhe pa vendim gjyqësor kontestin e tyre. Sipas nenit 307, al. 3, gjat procedurës gjyqësore gjykatësi respektivisht kryetari i këshillit ose gjyqtari i vetëm duhet t’u tregoj palëve dhe t’i informoj ato se ato mundet që të lidhin marrëveshjeje për pajtim gjyqësor dhe se i njëjti do t’u jetë palëve në dispozicion për të arritur një marrëveshjeje të tillë. Ky lloj i sjelljes së gjyqtarit për t’i motivuar palët që të zgjidhin kontestin në këtë mënyrë, aspak nuk don të thotë se ai i udhëzon palët që të iniciojnë procedurë të medijacionit edhe pse tingëllonë ashtu. Sipas rregullit pajtimi gjyqësor ndërmjet palëve mundet të lidhet gjat gjithë kohës deri sa zgjat procedura gjyqësore në shkallë të parë bile bile ajo mundet të lidhet edhe deri sa gjykata e shkallës së dytë të sjell vendim në lidhje me ankesën kundër vendimit të shkallës së parë. Që të jetë mundshëm lidhja e pajtimit gjyqësor dhe e njëjta të prodhoj efekte juridike, duhet të përmbushen disa prezumime procedural. Si prezumime të cilët duhet të përmbushen

³⁵⁶ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 338

konsiderohen: pajtimi gjyqësor duhet të lidhet para gjykatës kompetente; përbërja rregullt e gjykatës; palët të cilët e lidhin pajtimin gjyqësor të konsiderohen të aftë për një gjë të tillë; të egzistojt interesi juridik për lidhjen e pajtimit gjyqësor; lënda dhe përmbajtja e pajtimit gjyqësor të jenë të lejueshme dhe pajtimi gjyqësor të lidhet në formë shkrimore³⁵⁷. Neni 310 parasheh atë se propozimi më pajtim gjyqësor mundet të paraqitet edhe para se të iniciohet procedura kontestimore nga ana e paditësit, me ç'rast paditësi mundet që para parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente të shkallës së parë e cila në fakt është gjykata në rajonin e të cilit personi i paditur ka vendbanim respektivisht vendqëndrim, do të parshtroj propozimin për pajtim gjyqësor, nga rezultati i të cilit do të varet rrjedha e më tutjeshme e zgjidhjes të kontestit (do të inicohet ose jo procedurë kontestimore). Nëse propozimi për pajtim gjyqësor paraqitet gjat zbatimit të procedurës kontestimore respektivisht pasi që vendimi i shkallës së parë mer formë të prerë, në ato raste nuk thuhet se është arritur që ndërmjet palëve të lidhet pajtim gjyqësor. Në fakt në këto raste kemi të bëjmë me një “kontratë të thjesht juridiko-civile e jo me pajtim gjyqësor”³⁵⁸. Pa mar parasysh se lënda kontestuese është në procedim në gjykatën e shkallës së parë ose në gjykatën e shkallës së dytë, në rast të paraqitjes të propozimit për pajtim gjyqësor gjithmon vendos gjykata e shkallës së parë i cili edhe nëse në atë kohë gjykata e shkallës së dytë vendos për ankesën e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në rast se pajtimi lidhet deri sa procedura në shkallë të dytë është duke u zbatuar, atëherë gjykata e shkallës së parë kopjen e pajtimit gjyqësor do t’ia dërgoj gjykats së shkallës së dytë.

Pajtimin gjyqësor mundet ta lidhin palët personalisht ose me anë të përfaqësuesve të tyre³⁵⁹. Me pajtim gjyqësor mundet të vendoset për gjith kërkespadinë ose vetëm për një pjesë të saj. Por nuk përjashtohet fakti që gjat lidhjes së pajtimit gjyqësor, palët me të të rregullojnë edhe disa marrdhënie të cilët nuk janë të përfshira në kërkespadinë, por me kusht që ndërmjet atyre marrdhënieve dhe kërkesës kryesore e cila është ose mundet të jetë lëndë e padisë respektivisht kontestit të ketë një lidhshmëri të caktuar. Propozimi për pajtim gjyqësor duhet të përfshijë vetëm ato kërkesa të cilët sipas nenit tre të ligjit palët munden lirshëm të disponojnë e jo edhe at me të cilët palët nuk munden lirshëm të diponojnë. Në rast të paraqitjes të kërkesave të llojit të

³⁵⁷ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 339

³⁵⁸ Brestovci, F, E drejta procedurale II, fq. 15

³⁵⁹ Nëse pajtimin gjyqësor palët do ta lidhin nëpërmjet të përfaqësuesve të tyre, atëherë këto të fundit në emër dhe llogari të palës dhe vetëm nëse ka autorizim për një gjë të tillë, mundet të lidhin pajtim gjyqësor. Për përfaqësimin nëpërmjet të autorizimit për lidhjen e pajtimit gjyqësor vlejnë rregullat juridike të cilët rregullojnë prokurën ose autorizimin në Ligjit mbi procedurën kontestimore nga neni 81 deri në nenin 92.

dytë, gjykata me vendim të veçantë do ta hedh posht propozimin si të palejuar³⁶⁰. Në rastet kur pajtimi gjyqësor ka të bëjë me kërkespadinë në tërësi, atëherë procedura kontestimore shuhet në tërësi, ndërsa nëse ajo përmban vetëm një pjesë të kërkespadiës, atëherë procedura kontestimore do të shuhet vetëm për atë kërkesë e cila është zgjidhur me anë të pajtimit gjyqësor ndërsa për pjesën tjetër e cila nuk ka qenë lëndë e pajtimit gjyqësor, procedura kontestimore do të vazhdojë që të rrjedh dhe të zbatohet. E çka mund të ndodh nëqoftë se për një kërkesë është lidhur pajtimi gjyqësor, e më vonë e njëjta kërkesë është lëndë e padisë respektivisht procedurës kontestimore, me të cilën kërkohet që për të të vendos gjykata kontestimore në procedurë të rregullt gjyqësore? Nga shkaku se pajtimi gjyqësor ka fuqinë e aktgjykimit të plotfuqishëm. Sipas nenit 309, gjykata i cili sipas detyrës zyrtare kujdeset për atë se për lëndën e kontestit për të cilën është parashtruar kërkespadi është lidhur pajtim gjyqësor, atëherë padinë do ta hedh posht duke u bazuar në rregullin se nuk mundet të gjykohej çështja juridike e cila veç është e gjykuar dhe ndërmjet palëve të njëjtë – *ne bis in idem*³⁶¹. Ajo për të cilën vendoset me pajtimin gjyqësor shënohet në procesverbal. Do të konsiderohet sii lidhur pajtimi gjyqësor atëherë kur palët pasi që do ta lexojnë përmbajtjen e procesverbalit, do ta nënshkruajn atë. Pas kësaj palëve do t'u pregaditet nga një kopje e vërtetuar e procesverbalit në të cilën është e shënuar përmbajtja e pajtimit gjyqësor (neni 308). Është e kuptueshme që palët me rastin e lidhjes të pajtimit gjyqësor, të presin që detyrimi i cili është i përfshirë në të të mundet të përmbrohet, e kur të përmbrohet të konsiderohet se përfundimisht kontesti ndërmjet palëve të jetë i zgjidhur. Sipas Ligjit mbi përmbarrim³⁶² i cili në nenin 12, al. 1 pikën e parë parasheh se përveç të vendimit gjyqësor, si dokument përmbarrues konsiderohet edhe pajtimi gjyqësor. Kjo do të sjell përmbarrim të detyrueshëm sipas ligjit mbi përmbarrimin të detyrimit të konstatuar në pajtimin gjyqësor nëse pala nuk e përmbush atë në mënyrë vullnetare. Ajo e cila e karakterizon dhe e veçon pajtimin gjyqësor është karakteri i dyfishtë juridik ose natyra e dyfishtë juridike e saj, pra është institut edhe matejrijalo-juridik edhe procedural-juridik. Përshkak të kësaj natyre të pajtimit gjyqësor, egzistojnë mendime të ndryshme dhe kundëthënëse në praktik në raport me goditjen e pajtimit gjyqësor me mjete juridike. Përderi sa disa autor konsiderojnë se pajtimi gjyqësor mundet të

³⁶⁰ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 307, al. 4

³⁶¹ Nëse vërtetohet se gjykata me aktgjykim ka vendosur për kërkesë e cila veç më është e vendosur me pajtim gjyqësorë, atëherë do të konsiderohet se egziston cënik esencial i dispozitave të procedurës kontestimore si: neni 343, al. 2, pika 11 dhe neni 375, al. 1, pika 1 i Ligjit mbi procedurën kontestimore e cila mundet të jetë bazë për parashtrimin e mejeteve juridike të goditjes respektivisht, ankesë dhe revision.

³⁶² Ligji mbi përmbarrimin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 35/05, 50/06, 129/06, 08/08, 83/09, 50/10, 83/10, 88/10, 171/10, 148/11, 187/13 dhe 72/16

goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike si dhe me padi për anulim, nga ana tjetër autorë tjerë e përjashtojnë të drejtën e parashtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme kundët pajtimit gjyqësor dhe konsiderojnë se mundet vetëm të parashtrohet padi për anulim. Por edhe pse teoria juridike e ndihmon dhe e plotëson praktikën juridike, nga ana tjetër praktika juridike është ajo e cila me kalimin e kohës dhe si rezultat i të vepruarit të vazhdueshëm për një periudhë kohore më të gjatë, e ndihmon që të konstatoj se çka do të ishte më e arsyeshme dhe më e lehtë si zgjidhje në këto raste. Kështu, sipas saj pajtimi gjyqësor mundet të goditet vetëm me padi për anulim si mjet specifik i jashtëzakonshëm juridik në seancë të veçantë të procedurës kontestimore. Si fakte të cilët mundet të sjellin në përdorimin apo parashtrimin e këtij lloji të mjeti të jashtëzakonshëm juridik mundet të jenë: nëse mungon deklarimi i lirë i vullnetit, pra kur pajtimi gjyqësor është lidhur si rezultat i kanosjes, detyrimit ose lajthimit; kur lëndë e pajtimit gjyqësor janë kërkesat e palëve të cilët nuk mundën lirshëm të disponojnë; kur pajtimi gjyqësor është lidhur para gjykatës ose gjyqtarit porot i cili sipas ligjit është dashur të përjashtohet ose kur me vendim është përjashtuar e kështu me radhë³⁶³.

2. Natyra juridike e marrëveshtjes në procedurën e medijacionit

Në këtë pjesë do t'i kushtohet rëndësi asaj se ç'far natyre juridike kanë marrëveshtjet e procedurës së medijacionit të lidhura në procedurë gjyqësore respektivisht si marrëveshtje të përlidhje të pajtimit gjyqësor dhe për marrëveshtjet të cilët lidhen në procedurë të medijacionit por pa pasur asnjë lidhshmëri me procedurat gjyqësore, pra të lidhura para inicimit të procedurës kontestimore të cilët konsiderohen si marrëveshtje të medijacionit me fuqi juridike të pajtimit jashtëgjyqësor. Njëra nga mënyrat me të cilën zgjidhet një kontest i caktuar ndërmjet palëve është arritja e marrëveshtjes në procedurë të medijacionit. Marrëveshtja e cila në këto raste është e përbashkët për palët përpilohet në fomë shkrimore dhe nga vetë palët (përjashtimisht mundet edhe të kërkojnë që atë ta përpiloj medijatori). Që të mundet të konsiderohet e lidhur marrëveshtja për medijacion ajo sipas ligjit duhet të nënshkruhet nga palët (neni 21, al. 1). Ligji mbi medijacionin i vitit 2006 në nenin 22 parashihte rregullat për marrëveshtjen e palëve të arritur në procedurën e medijacionit. Ajo parashihte se “marrëveshtja e arritur me anë të

³⁶³Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 342

medijacionit me shkrim e përpilojnë palët vetë ose me kërkesën e tyre e përpilon medijatorit, ndërsa e nënshkruajnë palët”³⁶⁴ dhe “marrëveshtjen e arritur në procedurën e medijacionit e nënshkruar nga palët, e vërteton medijatori me nënshkrimin e vet”³⁶⁵. Ndërsa sipas nenit 21 të ligjit aktual mbi medijacionin ajo gjithashtu nëse marrëveshtja është lidhur para inicimit të procedurës kontestimore, nënshkruhet edhe nga medijatori i cili e vërteton me anë të nënshkrimit të tij atë marrëveshtje dhe të njejtën e dorëzon për regjistrim në Regjistrin për evidentim të procedurave të medijacionit. Edhe pse në shikim të parë neni 21 me të dy alinetë e parë duket pak konfuze në lidhje me atë se kush kur e nënshkruan marrëveshtjen, nëse bëjmë interpretim të këtij neni, do të vijmë në përfundim se medijatori do të nënshkruaj marrëveshtjen vetëm atëherë kur ajo arrihet ndërmjet palëve para inicimit të procedurës kontestimore e jo edhe për marrëveshtjen e cila arrihet në procedurë të medijacionit por pas inicimit të procedurës kontestimore. Nëse bëjmë një interpretim të të dy neneve të cilët rregullojnë çështjen e arritjes të marrëveshtjes së palëve, respektivisht të neneve 22 të ligjit mbi medijacionin e vitit 2006 dhe nenit 21 të ligjit aktual, do të vërejmë se ligji i vitit 2006 nuk bënte dallim se kur e nënshkruan marrëveshtjen medijatori e kur nuk e nënshkruan por e nënshkruajn vetëm palët, ashtu siç e bënte dallimin ligji aktual mbi medijacionin. Janë disa arsye të cilët kanë kontribuar në atë që ligjvënësi të jetë më i përpiktë për sa i përket këtyre çështjeve veç të shpaluara. Njëra prej tyre është obligimi i çdo medijatori që ti paraqes për regjistrim në Ministrinë e Drejtësisë të gjitha marrëveshtjet të cilët janë arritur në procedurë të medijacionit i cili obligim nuk parashihej në ligjin e vitit 2006, e sidomos do të ishte problematike kur nuk do të egzistonin evidence të marrëveshtjeve të medijacionit atëherë kur procedura kontestimore ndërpritet dhe palët arrijnë që të lidhin marrëveshtje për medijacion në procedurë të medijacionit, ndërsa medijatori i cili sipas ligjit të vitit 2006 nuk është i obliguar që në afat prej 3 ditëve (ashtu siç urdhërohet me ligjin aktual të medijacionit respektivisht me nenin 21, al. 1) ta dorëzoj marrëveshtjen e arritur ndërmjet palëve në gjykatën kompetente e cila marrëveshtje do të shërbente si bazë për lidhjen e pajtimit gjyqësor³⁶⁶. Nëse arrihet marrëveshtja për medijacion përderisa është në ndërprerje

³⁶⁴ Ligji mbi medijacionin 2006, neni 22, al. 1

³⁶⁵ Ligji mbi medijacionin 2006, neni 22, al. 2 dhe 3

³⁶⁶ Gjithashtu me ndryshimet e LPK me Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurë kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr 116/10 sipas të cilit neni 308 i shtohet edhe një aline e re respektivisht alinea 4 sipas të cilës parashihet obligimi i palëve që marrëveshtjen e arritur në procedurë të medijacionit ta dorëzojnë në gjykatën kompetente në afat prej 8 ditëve të punës nga dita e lidhjes së saj. Si rezultat, gjykata cakton seancë në të cilën me procesverbal do ta konstatoj marrëveshtjen e lidhur e cila do të fitoj fuqi të pajtimit gjyqësor kur janë të plotësuara kushtet për lidhje të pajtimit gjyqësor në pajtim me nenin 307.

procedura kontestimore, kjo gjë nuk don të thotë se automatikisht procedura e ndërprerë kontestimore përfundon, një situatë e cila kështu nënkuptoheshte me ligjin e vjetër nga vet fakti se obligim nuk kishin as medijatorët e as palët qëta njoftonin gjykatën kompetente për një marrëveshje të tillë të arritur i cili obligim egziston sot me ligjin aktual mbi medijacionin. Procedura kontestimore do të përfundonte kur palët do ta nënshkruanin proesverbalin për pajtim gjyqësor e cila do të vërtetohet dhe konstatohet nga marrëveshja e arritur ndërmjet palëve me ndihmën e medijatorit në procedurë të medijacionit të cilën marrëveshje medijatori dhe palët e dërgojnë në gjykatën e cila është kompetente për zbatimin e procedurës së ndërprerë kontestimore, ndërsa fuqi juridike njejt si pajtimi gjyqësor do të fitonte marrëveshja vetëm atëherë kur ajo do të regjistrohet në proesverbalin e pajtimit gjyqësore. Pra, në rast se paraqitet që e njejta çështje juridike dhe ndërmjet palëve të njejta, atëherë i padituri ka të drejtë të përdorë njëherë nga mjetet për mbrojtje juridiko-procedurale, respektivisht ka të drejtë që të përdorë njëherë nga mjetet për mbrojtje juridiko-procedurale, respektivisht ka të drejtë që të përdorë “kundërshtim se është lidhur pajtim gjyqësor³⁶⁷” edhe pse për këtë gjë duhet që gjykata të kujdeset sipas detyrës zyrtare, me anë të këtyre veprimeve procedurale i padituri i tregon gjykatës për egzistimin e pengesave procedural që pengon vendosjen meritorë për çështjen e caktuar kontestuese. Sa i përket vëllimit të fuqisë juridike të marrëveshjes për medijacion dhe me këtë edhe të marrëveshjes për pajtim gjyqësor, ashtu si edhe është përmend më lartë, ajo mundet të përfshij gjithkërkespadinë ose vetëm njëherë pjesë të saj. Pra, nga ajo varet edhe ardhmëria e procedurës kontestimore, a do të përfundoj e gjitha ose do të përfundoj deri në atë pjesë e cila ka qenë lëndë e marrëveshjes për medijacion e me këtë edhe lëndë e marrëveshjes për pajtim gjyqësor. Që të arrihet zgjidhje e kontestit me anë të marrëveshjes së arritur pas inicimit të procedurës kontestimore, duhet që të egzistoj një aktivitet i rregulluar me ligj i palëve dhe përfaqësuesve të tyre si dhe të gjykatës nga ana tjetër. Me këtë aktivitet arrihet kënaqësia e ndërsjelltë si për palët në njëherë anë ashtu edhe për gjykatën nga ana tjetër, për ikjen e procedurës së gjat e të shtrejtë dhe mbi gjithash ikjes së vendimit të gjykatës i cili mundet të jetë i pafavorshëm për palën, ndërsa kënaqësia e gjykatës nga ana tjetër tregohet nga fakti se çështja kontestuese e palëve është zgjidhur në një mënyrë me atmosferë paqësore me ç’rast nuk paraqitet nevoja që mbrojtje juridike t’i jep vetëm njëherë nga palët në kontest. Pikë tjetër e cila e dallon marrëveshjen e arritur në procedurë të medijacionit dhe asaj të arritur me rastin e lidhjes të marrëveshjes për pajtim gjyqësor është se marrëveshjen e llojit të parë e nënshkruajnë vetëm

³⁶⁷ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T, op. cit, fq. 389

palët e jo edhe përfaqësuesit e tyre në rastë së kanë ato gjat procedurës së medijacionit, ndërsa në marrëveshtjen e lidhur me lidhjen e pajtimit gjyqësor e cila bazohet në marrëveshtjen e aritur në procedurë të medijacionit, atëherë marrëveshtja nënshkruhet nga përfaqësuesit e palëve nëse ato kanë të caktuar një të tillë. Edhe më herët është thënë se pjesmarja e përfaqësuesve të palëve respektivisht të avokatëve të tyre nuk e vështirëson por përkundrazi e ndihmon dhe paraqet përparësi për sa i përket zgjidhjes të kontestit për nga aspekti i të drejtës. Kjo është kështu pasi që për dallim për procedurën kontestimore ku çështja zgjidhet vetëm për nga aspekti i të drejtës dhe me anë të aplikimit të të drejtës materiale, në procedurën e medijacionit më tepër rëndësi i jepet çështjes për nga aspekti i interesave dhe nevojave të palëve të cilët e përbëjnë problemin i cili duhet të zgjidhet. Për këtë arsye është e pëlqyeshme prezenca e tyre gjat seancave e sidomos gjat përpilimit të marrëveshtjes përfundimtare. Konsiderohet se nuk do të ishte aspak i dëmshëm por në fakt shumë i dobishëm qëproçesverbalin për lidhjen e pajtimit gjyqësor ta nënshkruajnë edhe përfaqësuesit e palëve të cilët me nënshkrimin e tyre ë vulosin lidhjen e marrëveshtjen për nga aspekti i të drejtës. Kështu do të arrihej kjo pasqyr e situatës së përshkruar: marrëveshtjen e arritur në procedurë të medijacionit do ta nënshkruanin vetëm palët ndërsa procesverbalin për të pajtimit gjyqësor përveç palëve të njejtën ta nënshkruajnë edhe përfaqësuesit e tyre. Kjo do të kishte si pasoj një siguri më të lartë juridike sidomos në rastet kur me anë të marrëveshtjes përcaktohet ndonjë detyrim i ndonjërës prej palëve, ku me nënshkrimin e tyre ai procesverbal do të bëhej edhe përmbarues. Kjo mënyrë është garantues se detyrimi i caktuar në marrëveshtje do të jetë qindpërqind e përmbarueshme, e cila është një obligim të cilën Bashkimi Evropian e kërkon nga shtetet anëtare në sferën e medijacionit³⁶⁸. Gjithashtu është edhe një pikë tjetër të cilës duhet t'i kushtohet rëndësi. Janë dy parimet e procedurave të medijacionit dhe asaj kontestimore të cilët janë kontradiktore për sa i përket seancave të cilët

³⁶⁸Në pjesën e katërt të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për medijacionin në kontestet familjare parashihet obligimi i shteteve që të lehtësojnë pranimin e marrëveshtjeve të arritura në procedurë të medijacionit nga ana e gjykatave ose ndonjë organi tjetër kompetent kur një gjë e tillë kërkohet nga palët, si dhe të parashohin mekanizma për përmbarim të marrëveshtjeve të tilla të pranuar në pajtueshmëri me legjislacionin e çdo shteti - Recommendation No. R (98) 1, Committee of Ministers to member States on family mediation, Council of Europe, 1998; Në pikën e 19 në hyrjen e vet direktivës potencohet se medijacionit nuk duhet të konsiderohet si alternativë më e varfër e procedurës gjyqësore në kuptimin e arritjes së marrëveshtjes së medijacionit e cila marrëveshtje varet ekskluzivisht nga vullneti i mirë i palëve për përmbarimin e tij dhe për këtë shkak duhet që sigurohet që çdo shtet anëtar të ndalojë që një marrëveshtje të jetë përmbaruese nëse përmbajtja e saj do të jetë në kundërshtim me ligjin përfrshirë këtu edhe të drejtën ndërkombëtare private ose nëse ligji nuk parasheh përmbarimin e përmbajtjes e ndonjë marrëveshtje të caktuar (këto raste do të konsideroheshin në marrëveshtje si të natyrës jopërmbaruese) – Direktiva 2008/52/EC.

duhet të mbahen dhe shpallja në procesverbal e pajtimit gjyqësor në procedurë kontestimore. Përderi sa në procedurën e medijacionit të gjithë informacionet të cilët dalin gjat procedurës dhe të cilët mundet të paraqiten si prova në procedura tjera janë të llojit konfidencial dhe si tillë konsiderohet procedurë konfidenciale. Por çka ndodhë atëherë kur marrëveshtja e cila është arritur ndërmjet palëve do të duhet të shënohet në procesverbal për pajtim gjyqësor e cila duhet të bëhet në seancë ku do të mbizotroj parimi i publicitetit, sipas të cilës seancat në procedurë kontestimore janë publike dhe të gjithë personat e interesuar mund të marrin pjesë në të³⁶⁹. Në këto raste konsiderohet si zgjidhje më e mirë, pjesmarja e publikut në seancën e përpilimit dhe nënshkrimit të procesverbalit për pajtim gjyqësor nëse palët lejojnë një gjë të tillë, ndërsa në rastet kur në seancën e përpilimit dhe të nënshkrimit të procesverbalit konstatohet se do të dalin në pah informacione të cilët janë të karakterit personal dhe intim me të cilët do të vireshin në pikpyetje interesat e palës përshkak të bërjes publike të informacioneve të karakterit zyrtar, afarist, kur me shpalljen e informacioneve gjithashtu do të vireshin në pyetje rendi publik ose morali i palëve.

Nga gjithë kjo që tham mundemi të nxjerrin disa pika dalluese ndërmjet të marrëveshtjes së arritur nëpërmjet të pajtimit gjyqësor dhe marrëveshtjes së medijacionit. Dallimi i parë qëndron në atë se pajtimi gjyqësor ka për qëllim gjetjen e shpejtë të një zgjidhje të përbashkët të bazuar në ligj, ndërsa nga ana tjetër marrëveshtja për medijacion qëllimin e vet e realizon nëpërmjet të zgjidhjes së kontestit dhe gjetjes të zgjidhjes së përbashkët për palët duke u bazuar në interesat dhe nevojat e palëve e cila edhe kontribuon në rregullimin e marrëdhënieve të prishura ndërmjet tyre në të ardhmen. Dallimi i dytështë se procedura e medijacionit e cila inicohet para procedurës kontestimore çështja e inicimit dhe lidhjes së marrëveshtjes për medijacion në krahasim me lidhjen e marrëveshtjes për pajtim gjyqësor (e cila mundet të kalojë në disa faza më të gjata si p.sh në rastet kur palët vendosin në seancën pregaditore ose ndonjëherë edhe në seancën e parë të shqyrtimit kryesor që të provojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin me pajtim gjyqësor) kalon në faza më të shkurta dhe më të shpejta. Dhe dallimi i tretështë ajo e nevojës së zyrtarizimit të marrëveshtjes së arritur në procedurë të medijacionit e cila është bazë për lidhjen e pajtimit gjyqësor me anë të përpilimit dhe të nënshkrimit të procesverbalit për pajtim gjyqësor që paraqet punë të dyfishtë në krahasim me marrëveshtjen për medijacion e arritu në procedurë të medijacionit e cila është inicuar pavarësisht procedurës kontestimore.

³⁶⁹ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 292, al. 1

Përveç se me lidhjen e pajtimit gjyqësor, palët munden që çështjen e tyre kontestuese të munden ta zgjidhin në procedurë të medijacionit pavarësisht inicimit të procedurës kontestimore. Marrëveshtja e arritur në këtë mënyrë konsiderohet si marrëveshtje me fuqi juridike të pajtimit jashgjyqësor. Në këto raste përshkak të mosegzistimit të lidhshmërisë të marrëveshtjes së arritur dhe procedurës gjyqësore, palët nuk janë të obliguar që marrëveshtjen e tillë t'ia dërgojnë gjykatës për procedim respektivisht që të jetë bazë për lidhjen e pajtimit gjyqësor. Nëqoftë e shofim për nga aspekti i të drejtës së detyrimeve, marrëveshtja e cila arrihet në procedurë të medijacionit konsiderohet kontratë e cila prodhoh efektë juridike ndërmjet palëve ose siç njihet në terminologjin juridike latine inter partes. Përmbajtja e saj caktohet ekskluzivisht nga ana e palëve dhe me vullnetin e tyre, dhe gjithashtu realizimi i saj respektivisht kryerja e detyrimeve të përcaktuara në të varen nga vet palët dhe nga vullneti i tyre. Në rast se njëra nga palët nuk e përmbush detyrimin që ka dhe e cila është e përcaktuar në përmbajtjen e marrëveshtjes për medijacion, pala tjetër ka të drejtë që të inicioj procedurë kontestimore me të cilën do të kërkoj përmbushjen e detyrimit të papërmbushur. Mirpo kjo nuk do të ishte ajo që palët do të dëshironin duke e parë atë se fillimisht ato janë dakorduar që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit, e pastaj përshkak të mos respektimit të marrëveshtjes të iniciojnë procedurë kontestimore! Ligji ka paraparë një mundësi e cila mundet t'u ofrohet palëve që t'u ikin situatave të tilla. Këtë e parasheh ligji mbi medijacionin. Në ligjin e vjetër mbi medijacionin të viti 2006 respektivisht në nenin 22, al. 4 marrëveshtja e medijacionit do të fitonte fuqinë e dokumentit përmbarues nëse e njehta vërtetoheshite te noteri. Sipas këtij ligji marrëveshtja do të bëhej dokument përmbarues vetëm nëse vërtetoheshin nga noteri nënshkrimet e palëve. Me ligjin aktual mbi medijacionin, kërkohet që përveç nënshkrimit, noteri të vërtetonte edhe anën përmbajtësore të marrëveshtjes³⁷⁰. Në mënyrë analoge çështja e solemnizimit të marrëveshtjes së arritur në procedurë të medijacionit nga ana e noterit si dokumenti karakterit publik. Çështja e solemnizimit ose vërtetimit të dokumenteve private për çështje juridike është e rregulluar në Ligjin mbi notarijatin³⁷¹ sipas të cilës vërtetimin e dokumenteve noteri gjithmon e bën në pajtim me nenin 3, al. 3 sipas të cilës dokumenti i cili vërtetohet nga ana e noterit konsiderohet dokument përmbarues, si dhe sipas neneve 29, 30, 31, 32 dhe nenit 54 të këtij ligji konstaton s enuk ka anjë pengesë për vërtetim, të njejtën do ta vërtetojë – solemnizoj. Në rastet kur

³⁷⁰ Ligji mbi medijacionin, neni 22, al. 1

³⁷¹ Ligji mbi notarijatin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 72/16, 172/16 и 233/18

marrëveshtja sipas formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e parapara meligj, në ato raste vërtetimi do të bëhet përmes hartimit të nja akti të veçant noterial, me ç'rast dokumenti privat respektivisht marrëveshtja e medijacionit do t'i bashkangjitet aktit noterial dhe kështu do të konsiderohet si pjesë përbërëse e aktit noterial. Ky dokument do të nënshkruhet si nga noteri ashtu edhe nga palët e marrëveshtjes së medijacionit³⁷². Gjithashtu edhe neni 53 i ligjit mbi notarijatin parahesh procedurën e përbarimit të dokumenteve noteriale sipas të cilës të gjithë dokumentet noteriale sipas fuqisë janë dokumente përbaruese nëse në të parashihet ndonjë detyrim i caktuar për të cilën detyrim palët mundet që të mirren vesht që në rast të mospërmbushjes së detyrimit mundet të realizohet përbarimi i detyrueshëm³⁷³. Kështu nëse pala e cila ka për detyrim përmbushjen e ndonjë detyrimi të caktuar në marrëveshtjen e medijacionit respektivisht në marrëveshtjen e solemnizuar nga noteri nuk e përmbushë atë në mënyrë vullnetare, pala tjetër e cila kërkon përmbushjen e detyrimit mundet që me anë të kërkesës me shkrim dhe deklaratë të vërtetuar tek noteri për arritjen e kërkesës, në bazë të të cilave noteri do të vëndos klauzulën për përbarim të dokumentit³⁷⁴.

Për s ai përket natyrës juridike, marrëveshtja e medijacionit si marrëveshtje jashtgjyqësore dallon nga marrëveshtja për lidhje të pajtimit gjyqësor si marrëveshtje gjyqësore, për nga ajo se marrëveshtja e medijacionit nuk ka fuqinë e aktgjykimit të sjellur në procedurë kontestimore, dhe kështu çështja kontestuese e zgjidhur në procedurë të medijacionit me marrëveshtje të medijacionit nuk paraqet çështje e gjykuar-res iudicata ashtu si ishte situata me marrëveshtjen e lidhjes së pajtimit gjyqësor. Kështu në rast të paraqitjes të padisë për të njejtën çështje kontestuese dhe me palë të njejtë, gjykata nuk është i obliguar që për të të kujdeset ex officio se a është vendosur për të njejtën çështje njëherë ose jo. Kështu në këto raste edhe përjashtohet ajo që i padituri të mund të parashtrij kundërshtim se për atë çështje veç më është lidhur pajtim gjyqësor. Por nga ana tjetër ligji mbi medijacionin lejon që marrëveshtja për medijacion të jetë lëndë e padisë në procedurë kontestimore. Kështu në përputhje dhe në pajtim me nenin 23 të ligjit mbi medijacion, mundet të parashtrijet padi për konstatimin e pavlefshmërisë respektivisht me padi për anulim për të cilët do të vlejnjë dispozitat juridike nga Ligji për marrdhënie

³⁷² Ligji mbi notarijatin, neni 55, al. 4

³⁷³ Ligji mbi notarijatin, neni 53, al. 1

³⁷⁴ Ligji mbi përbarim, neni 12, al.1, pika 3

obligative³⁷⁵. Si pasoja juridike të këtyre dy mjeteve juridike mundet të vijnë deri në shpalljen e marrëveshtjes të pavlefshme e cila vepron menjëherë respektivisht *ex tunc*, apo mundet të vijnë deri në anulimin e marrëveshtjes për medijacion e cila do të konsiderohet nule që nga momenti i lidhjes së saj. Në praktik rastet e mospërbushjes të marrëveshtjes së medijacionit janë të ralla, pasi që ajo rregullisht dhe në tërësi përmbushet nga palët pasi që është e interesit të tyre përmbushja e saj, që t'i iket përmbushjes së detyrueshme ose edhe procedurave kontestimore.

PJESA E TRETË

V Medijacioni ndërkombëtar me theks të veçantë medijacioni ndërkombëtar tregtar si metodë e zgjidhjes të kontesteve në të drejtën ndërkombëtare

Ne dekadat e fundit sistemet gjyqësore europiane si dhe të vendeve të ballkanit përfshirë këtu edhe sistemin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë ballafaqohen me shumë probleme si dhe sfida serioze. Këto probleme në shumë vende të botës me plotë kuptimin e fjalës konsiderohen edhe si krizë e sistemit juridik të një shteti respektivisht të sistemit gjyqësorë. Intenziteti i kësaj lloji të krizës në sistemet të ndryshme të cilat kanë për obligim të sigurojnë mbrojtje ligjore personave të cilëve u lëndohen apo kërcenohen të drejtat subjektivo - civile, është i ndryshëm. Edhe përkundër kesaj, tipari i përbashkët i tyre është dinamika e shteteve. Kjo dinamikë sot prodhon konflikte të natyrave të ndryshme dhe mosmarrëveshtje. Sot edhe si rezultat i dinamizmit të përshpejtuar, e drejta themelore e qytetarëve e cila atyre u siguron qasje në gjykatë të pavarur dhe të paanëshme është e drejtë e proklamuar nga secili shtet, e njejtja gjë vlen edhe për efikasitetin e gjykatave. Në shumë shtete zgjidhja e çështjeve të rëndësisë së madhe nga ana e gjykatave ka për pasojë zgjatjen e kohës së zgjidhjeve të kontesteve respektivisht stërzgjatja e procedurave gjyqësore. Gjithashtu si problem kyç në mosfunksionimin e duhur të procedurës gjyqësore mundet të konsiderohet edhe fakti se sot në shtetin tonë reputacion të madh gëzojnë në radhë të parë gjykatësit e pastaj edhe avokatët dhe profesionet e tyre, gjë që shkakton ritje të

³⁷⁵ Ligji mbi marrdhëniet obligative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 18/01, 04/02, 05/03, 84/08, 81/09, 161/09. Sipas nenit 95 të Lmbi marrdhënie obligative marrëveshtja e cila nuk është e lidhur na pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe zakonet e mira konsiderohet i pavlefshëm. E drejta për të shpallur marrëveshtjen si të pavlefshme nuk shuhet asnjëherë, respektivisht palë aka të drejtë që të kërkojë në çdo kohë pasi që kjo e drejtë nuk është e lidhur me ndonjë afat. Ndërsa sipas nenit 103, marrëveshtja mundet të anulohet kur atë e ka lidhur pala me aftësi të kufiuzar të veprimit, kur gjat lidhjes së saj është bërë si rezultat i të metave në vullnetin e palëve dhe në rastet kur kjo është e paraparë me ligj.

madhe të kostos të dhënies të mbrojtjes juridike. Që të mundet të anashkalohen situata të tilla të cilët dukshëm janë shkaktar të krizave të shumta të sistemit gjyqësorë në shtetin tonë, insistohet në zgjidhjen e kontesteve përveç se me anë të procedurave gjyqësore të cilat janë procedura të rregullta, gjithashtu të promovohen edhe më shumë procedurat alternative të zgjidhjeve të kontesteve (arbitrazhi, medijacioni).

5.1 E drejta ndërkombtare tregtare

Si rezultat i globalizimit e cila është duke u përhapur me hapa intenzive në tregun ndërkombëtar dhe në sferën e shkëmbimit të mallrave dhe të shërbimeve, paraqitet e drejta ndërkombtare tregtare. Kjo disiplinë shkencore është drejt për drejtë e lidhur me formulimin, përcaktimin dhe njëkohësisht edhe me rregullimin e marrëdhënieve ndërkombtare të sferës tregtare e cila përcakton rregullat të cilat rregullojnë mënyrën e të vepruarit gjatë shkëmbimit ndërkombëtar ekonomik të mallrave dhe shërbimeve. Por fakti se niveli apo shkalla e lartë e tregtisë jashtë shtetit është shumë e madhe respektivisht e lartë, ka si pasojë edhe paraqitjen e shpeshtë të mosmarrëveshtjeve apo kontesteve në mes të pjesmarësve në atë marrëdhënie. E drejta ndërkombëtare tregtare përveç se i rregullon marrëdhëniet juridike ajo gjithashtu parasheh edhe rregullat të cilat rregullojnë procedurën për zgjidhjen e kontesteve eventuale të cilët mundet të paraqiten në mes të pjesmarësve në atë marrëdhënie, pra kjo bën që kjo disiplinë shkencore të jetë e rëndësishme të madhe. “E drejta ndërkombëtare tregtare është një përmbledhje e sistemeve të ndryshme nacionale”³⁷⁶ e cila nënkupton përmbledhjen e rregullave juridike të cilat përfshijnë disa sisteme të shteteve të ndryshme. Janë të shumta burimet e të drejtës ndërkombëtare tregtare. Duke marrë parasysh faktin se e drejta ndërkombëtare tregtare ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimeve tregtare siç janë: shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve në mes të pjesmarësve në një marrëdhënie juridiko – tregtare, por të cilat i kalojnë kufijtë nacional të shtetit, don të thotë se përveç burimeve nacionale të të drejtës, këto marrëdhënie i rregullojnë edhe burimet ndërkombëtare. Nga rradhët e këtyre burimeve prej më të rëndësishmeve janë marrëveshtjet ndërkombëtare. Pas tyre vijnë zakonet ndërkombëtare, principet juridike të përgjithshme të pranuar nga kombet e civilizuar dhe vendimet gjyqësore dhe shkrimet apo punimet shkencore. Marrëveshtjet ndërkombëtare kanë të bëjnë me marrëveshtjet multilaterale ose me traktatet multilaterale. “Traktat është marrëveshtje ndërkombëtare në mes të shteteve e rregulluar nga e

³⁷⁶ Di Matteo. L, (2017), Routledge, International Business Law and the legal environment: A Transactional Approach, New York, fq. XVIII

drejta ndërkombëtare të parapara në një instrument të vetëm ose në dy apo më shumë instrumente të lidhura me të pa mar parasyshtë qëllimin e tij³⁷⁷. Burimi primar i cili gjithmon meret parasyshtë në rastë të paraqitjes të kontesteve është marrëveshtja ndërkombëtare. Në këto raste mundet të paraqiten situata të cilët në faktë dhe nuk mundet të sigurojnë zgjidhje të kontestit në mes të palëve nga shkak se jo çdo herë interpretimi i kontratës dhe ajo se si palët i kuptojnë të drejtat dhe obligimet e tyre në kontratë mundet të jetë e njëjtë nga të dy anët. Shumë të shpeshta janë rastet kur këto kuptime janë krejtësisht të ndryshme. Në shumicën e rasteve mundet të thuhet se këto marrëveshtje kanë karakter politik. Kjo gjë nuk e përjashton faktin se marrëveshtjet ndërkombëtare përshkak të inkorporimit të faktorit politik të shteteve e humb rëndësinë që ato kanë për marrëdhëniet ndërkombëtare tregtare. Është kështu nga shkak se ato inkorporojnë principe të cilët janë shumë të rëndësishme e sidomos atëherë kur ato nënshkruhen nga palët respektivisht nga shtetet dhe me këtë automatikisht ato bëhen bartës i të drejtave dhe obligimeve të cilët burojnë nga ato marrëveshtje. Sot janë të shumta marrëveshtjet ndërkombëtare tregtare të cilët janë të shfaqura në të gjitha sferat si rezultat i zgjerimit të shpejtë të shkëmbimit të mallrave, të licensave dhe kombinuar me zgjerimin teknologjik të marrëdhënieve tregtare. E gjithë kjo është e njohur si proces i globalizimit. Nga ana tjetër kemi edhe zakonet ndërkombëtare si burim i të drejtës të cilët gjithashtu zejn një vend të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare tregtare sidomos për shkak të asaj se në kohërat më të hershme kanë qenë pikërisht zakonet apo sjelljet e pa shkruara të njerëzve të cilët kanë rregulluar marrëdhëniet juridike në mes tyre përfshirë këtu edhe marrëdhëniet juridiko – tregtare ndërkombëtare. Këto zakone bëhen obligative ashtu që të njëjtat kodifikohen dhe sistemohen në burime tjera të të drejtës. Burim tjetër janë edhe principet juridike të të drejtës ndërkombëtare tregtare dhe të njëjtat konsiderohen mjaftë të rëndësishme. Kjo është si rezultat i asaj se shumë parime, rregulla dhe principe të cilët kanë qenë pjesë përbërëse të marrëveshtjeve ndërkombëtare tregtare më vonë janë konvertuar në principe të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare tregtare. Si shembull i principeve të tilla janë principet apo rregullat për të drejtat minimale të tregtarëve të huaj, principet apo rregullat për mbrojtjen e pronësisë të të huajve, etj. Edhe praktika gjyqësore konsiderohet burim plotësues. “Vendimet gjyqësore janë mjete ndihmëse për përcaktimin e rregullave të së drejtës të cilat rregulla mundet të jepen ose nga gjykata ndërkombëtare siç është Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë ose nga ana e ndonjë gjykate

³⁷⁷ Konventa e Vienës për ligjin e traktateve, neni 2, Vienë, maj 1969.

nacionale e cila vendos për çështjet nga sfera e të drejtës ndërkombëtare “³⁷⁸. Pasi që rastet më të shpeshta vinë nga gjykatat nacionale ku kërkohet zgjidhja e kontesteve nga sfera e të drejtës ndërkombëtare, për këtë shkak duhet që gjykatat nacionale të bëjnë shumë kujdes që për zgjidhjen e rasteve të tyre të aplikojnë të drejtën ndërkombëtare e jo ligjet nacionale të tyre.

5.2 Kontestet në të drejtën ndërkombëtare tregtare

Në qarkullimin tregtar në fushën ndërkombëtare, njëjtë si në fushën nacionale, nuk mundet të thuhet se janë të pakta marrëveshtjet në mes të shteteve e cila situatë është si pasojë i lulzimit të tregtisë globale në dekadat e fundit. Kjo njëkohësishtë ka sjellë në shumzimin e kontesteve tregtare. Me rritjen e tregtisë globale kuptohet se njëkohësishtë rritet edhe numri i lidhjeve të marrëveshtjeve ndërkombëtare tregtare. Përshkak të rritjeve të investimeve dhe tregtisë ndërkufitare me shpejtësinë e dritës, subjektet (shtete, investitor publik dhe privat, etj) e mardhënieve të cilët krijohen gjat atyre investimeve apo gjat shkëmbimit ndërkombëtar tregtar të mallrave dhe të shërbimeve, kërkojnë mënyra të përshtatshme për të vendosur për konfliktet apo për shkeljet e supozuara të marrëveshtjeve tregtare ndërkombëtare. Karakteri dhe struktura e përbërë dhe e komplikuar e kontesteve tregtare ndërkombëtare gjat zgjidhjes së tyre kërkon një shkallë të lartë të kujdesit. Kjo është kështu pasi që gjat shkëmbimit tregtar, palët të cilët marin pjesë insistojnë dhe kanë për qëllim që të risin fitimet dhe beneficionet e tyre financiare, gjë që shkakton konteste mes tyre. Të njëjtën situatë e hasim edhe në shkëmbimet tregtare të karakterit ndërkombëtarë. Është e interesit të palëve që të mos krijohen aspak mosmarrëveshtje në mes tyre, por edhe kur të njëjtat të krijohen të insistohet në zgjidhjen e tyre më të shpejtë me qëllim të mos shkaktimin të ngecjes të mëtutjeshme të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet shteteve tjera të ndryshme, pra insistohet në zgjidhjen e kontestit në një afat shumë të shkurtër kohor pasi që ai faktor është i rëndësisë enorme për mbarvajtjen e tregtisë ndërkombëtare. “Është fakt i ditur botërisht se secili shtet është tërësisht sovran për përcaktimin e kompetencave të gjykatave të tyre. Gjithmon gjat këtyre përcaktimeve secili shtet mundohet që të ketë kujdes që gjat vendosjes për konfliktet tregtare ndërkombëtare të respektohen disa principe të të drejtës ndërkombëtare tregtare si: mos përzierja në punët e brendshme të shteteve tjera apo ekzekutimi i detyrimeve kontraktuale”³⁷⁹. Sot egzistojnë dhe veprojnë disa institucione të cilët së bashku me gjyqësorin ndërkombëtar tregtar kan një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e kontesteve

³⁷⁸ Malone A Linda, (2008), International Law, Aspen Publishers, New York, fq. 26

³⁷⁹ Јездић. М., (1965), Меѓународно Приватно Право, Београд, fq. 163

ndërkombëtare tregtare. Në këtë pjesë do të përqëndrohemi pikërisht në tre institucionet gjyqësore që janë pjesë e gjyqësorit ndërkombëtar tregtar si Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë e Kombeve të Bashkuara, Gjykata Evropiane e Drejtësisë si gjykatë supreme e bashkimit Evropian dhe trupi apelues i Organizatës Botërore të Tregtisë. Historikisht parë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është ajo e cila u paraprijnë Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe trupit apelues të OBT – së për sa i përket periudhës të krijimit. GJND është organ themelor i Kombeve të Bashkuara i cili është kompetent për zgjidhjen e kontesteve në mes të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara. E krijuar në vitin 1945 dhe ka filluar me punë në vitin 1946 si pasardhës i Gjykatës së Përhershme të drejtësisë³⁸⁰. Sipas Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, gjykata është e përbërë nga një trup i gjykatësve të pavarur të zgjedhur pavarësisht nacionalitetit të tyre në mes të personave me karakter të lartë moral të cilët i plotësojnë kualifikimet të kërkuara në shtetet nga të cilët ato vijnë³⁸¹, i cili trup duhet të jetë i përbërë nga 15 anëtarë³⁸². Çka është *Ratione Materiae* e kësaj gjykate? Kjo gjykatë mbulon dy lloje të rasteve sipas dokumenteve të publikuara në web faqen e saj: kontestet juridike në mes të shteteve të parashtruara nga to apo rastet kontestuese dhe për kërkesat nga ana e organeve dhe agjencioneve speciale të Kombeve të Bashkuara për dhënien e mendimeve këshilluese. Koncepti *Ratione Materiae* e GJND përfshinë të gjitha kategoritë e rasteve të cilët gjykata duhet t'i ketë parasyshtë. “Fusha e lëndëve është e gjërë pasi që ato të cilët e kanë përpiluar Statutin kanë dëshiruar që gjykata të mundet të zgjidh të gjithë llojet e kontesteve dhe përshkak se është dashur të arrihet ajo që shtetet të mundin lirshëm të parashtrorjnë kontestet e tyre tek gjykata në bazë të vullnetit të lirë”³⁸³. Neni 36 al. e parë e Statutit parasheh se gjykata është kompetente që ti zgjidh dhe të vendos për të gjitha rastet të cilët palët i paraqesin, ndërsa si klauzulë opcionale neni 36 al. e dytë në fushën e kompetencave të gjykatës parasheh edhe interpretimin e traktateve, secilën çështje e cila parashtrohet lidhur me të drejtën ndërkombëtare, çdo fakt e cila do të shkaktonte prishje të ndonjë obligimi ndërkombëtar nga palët nënshkruese të ndonjë marrëveshjeje apo të përmirësimit të ndonjë obligimi veçse më të prishur. Pasi që me Statut nuk janë të përcaktuara shprehimisht e as të numëruara taksativisht çështjet apo kontestet për të cilët kjo gjykatë mundet të vendos, përkundrazi parashihet se lëndë e zgjidhjes mundet të jetë çfardo lloj kontesti. Atëherë

³⁸⁰ Gjykata e përhershme e drejtësisë ka vepruar nga viti 1922 deri në vitin 1946.

³⁸¹ Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, neni 2

³⁸² Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, neni 3

³⁸³ Kolb, R, (2014), *The international Court of Justice*, Hart Publishing, Gjenevë, fq.362

kjo na çon në përfundimin se lëndë e zgjidhjes të kontesteve nga kjo gjykatë mundet të jenë edhe ato ndërkombëtare tregtare. Gjykata Europiane e Drejtësisë ose siç njihet ndryshe Gjykata e Drejtësisë e cila njëherit është edhe gjykata e shkallës më të lartë të Bashkimit Evropian. Është krijuar në vitin 1952 në Luksemburg. Procedura para kësaj gjykate është e rregulluar me rregullat e parapara në Statutin e Gjykatës të Drejtësisë³⁸⁴. Kjo gjykatë edhe pse ka karakter regional, prap se prapë ka dhënë një kontribut të madh për gjyqësorin ndërkombëtar tregtar pasi që ka kontribuar në disfunktionin e qëndrimeve të shumë shteteve anëtare për shumë çështje në fushën e shkëmbimit ndërkombëtar tregtar të mallrave dhe të shërbimeve si dhe ka pasur një rol shumë të rëndësishëm dhe të veçantë në krijimin e tregut të vetëm të përbashkët. Gjykata është e përbërë nga 28 gjyqëtar dhe 11 avokatë general. Jo rastësisht është 28 numri i gjyqtarëve, pasi që secili shtet anëtar përfaqësohet me nga një gjyqtar. Rastet mundet të degjohen nga Odat e gjyqtarëve të përbërë nga 3, 5 apo 15 gjyqtarë varësisht prej shkallës së rëndësisë së rastit. Gjyqtarët zgjidhen në afat prej gjashtë viteve me mundësi të rizgjedhjes, ndërsa Kryetari dhe Nënkryetari i gjykatës në afat prej tre viteve gjithashtu me mundësi të rizgjedhjes³⁸⁵. Janë disa kompetenca të cilët gjykatës i janë siguruar me Statutin e tij. Si kompetencë themelore parashihet referenca për vendimet paraprake³⁸⁶. Sipas kësaj, Gjykata e Drejtësisë është e obliguar që gjat gjithë kohës të bashkëpunoj me gjykatat nacionale të shteteve anëtare të cilët zbatojnë ligjet e BE – së. Kjo gjykatë ndihmonë gjykatat e shteteve anëtare në rastet kur gjat zbatimit të ligjeve të BE – së hasin vështirësi përshkask të interpretimeve divergjente me ç’rast kjo gjykatë sqaron pikat të cilat kanë nevojë për sqarime dhe interpretime shtesë. Pra kjo kompetencë e Gjykatës të Drejtësisë tregon se sa ligjet e shteteve anëtare janë kompaktibile dhe të përafërta me ato të BE – së. Përgjigjja apo vendimi i sjellur nga ana e kësaj gjykate, nuk paraqet vetëm një mendim të thjeshtë këshilldhënës por ka fuqin e urdhërit dhe për këtë shkak të njejtat janë detyruese për shtetet anëtare. Kompetencë tjetër e Gjykatës është edhe ndërmarrja e veprimeve për përcaktimin e asaj se një shtet anëtar e ka përmbushur apo jo obligimin e paraparë me ligjet e BE – së. Në këto raste palë janë Komisioni dhe shteti antëtar kundër të cilit Komisioni parashtron rastin para Gjykatës së Drejtësisë. “Para se të sjell vendim Gjykata e Drejtësisë, Komisioni do të udhëheqë me një procedurë paraprake në të cilën shtetit anëtarë kundër të cilit udhëhiqet ajo procedurë, i

³⁸⁴ Rules of Procedure of the Court of Justice, OJ2265, 29.09.2012, fq.1-42

³⁸⁵ https://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo2_7024

³⁸⁶ Rregullat mbi procedurën e Gjykatës të Drejtësisë, neni 94

jepet mundësia që të jep përgjigjen e saj lidhur me rastin “³⁸⁷. Ne qoftë se shteti anëtarë kundrejt të cilit është parashtruar ankesa dhe i cili urdhërohet të përmirësoj veprimet e tij, nuk bën përmirësimin e urdhëruar atëherë lënda kundër tij automatikisht kalon tek Gjykata e Drejtësisë e cila gjykatë nëse pas shqyritimit të fakteve dhe provave vjen në përfundim se shteti anëtarë nuk e ka përmbushur obligimin e tij, shteti anëtarë duhet pa vonësë dhe pa zvarritje të përmirësoj gabimet. Nëse edhe pas këtij urdhëri shteti anëtarë përsëri nuk ndërmer asnjë veprim bazuar në urdhërin e Gjykatës atëherë Gjykata ka të drejtë që ti shqiptoj dënim në të holla i cili dënim mundet të shqiptohet për një periudhë fikse apo periodike. Kompetencë tjetër e kësaj gjykate është edhe ndërmarja e veprimeve për anulim të një mase respektivisht rregulle, direktive apo të ndonjë vendimi të miratuara nga nodnjë institucion, organ, zyrë apo agjencion të BE – së³⁸⁸. Në këto raste palë paditëse mundet të jetë shteti anëtar i BE– së dhe ankesa mundet të parashtrohet nga ana e ndonjë institucioni të BE – së apo mundet të parashtrohet nga ana e ndonjë institucioni të BE – së kundër një institucioni tjetër gjithashtu të BE – së. Gjithashtu brenda fushës të kompetencave të Gjykatës të Drejtësisë hyjnë edhe veprimet të cilët i ndërmer në rast të dështimit të institucioneve, organeve, zyrave ose agjensive të BE – së me ç’rast Gjykata e njejtë u shqipton masa adekuate. Nga neni 197 deri në nenin 170 është e rregulluar çështja e procedurës të apelit e cila mundet të cilësohet edhe si kompetenca e fundit e Gjykatës të drejtësisë e cila kompetencë e autorizonë këtë gjykatë të vendosë si gjykatë e shkallës më të lartë për ankesat e parashtruara kundër Gjykatës së Përgjithshme. Gjykata e Drejtësisë mundet vet të vendos për gjith rastin në rastet kur shteti anëtar i cili paraqitet si palë e lejonë një gjë të tillë. Në të kundërtën do t’ia kthej rastin Gjykatës së Përgjithshme për vendosje. Gjithashtu neni 147 i Rregullores për procedurën e Gjykatës të Drejtësisë rregullon edhe çështjen e zgjidhjeve paqësore të kontesteve. Sipas saj, në qoftë se para se gjykata ta jep vendimin e tij për lëndën kontestuese palët arrijnë të gjejnë një zgjidhje pqr kontestin e tyre dhe për të e njoftojnë gjykatën, kryetari i gjykatës do të urdhëroj që rasti të shlyhet dhe të largohet nga regjistri dhe do të sjell vendim për rastin si rezultat i asaj marrëveshtjes së arritur.

Shumica e kontesteve të cilët paragqiten në mes të shteteve dhe të cilët kanë të bëjnë me tregtinë ndërkombëtare zgjidhen nga sistemi i Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) si organizatë primare në tregtinë ndërkombëtare. Mirpo çka në fakt është OBT – ja? Kjo organizatë

³⁸⁷ https://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo2_7024

³⁸⁸ ibid

është njëra nga organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare e cila është mjaftë e re në moshë - e krijuar më 1 janar të vitit 1995. Në qoftë se e shohim për nga aspekti historik, interesimi për krijimin e një organizate e cila do të meret me tregun botëror dhe me çështjen e punësimit, është paraqitur që nga periudha e pas luftës së dytë botërore. “Prej vitit 1948 deri në vitin 1994, Marrëveshtja e Përgjithshme për Tarifatat dhe Tregtinë³⁸⁹ siguronte rregulla për pjesën më të madhe të tregtisë botërore dhe kryesonte në periudhat në të cilët u shfaqën disa prej shkallëve më të larta të zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare³⁹⁰. Ishte Runda e Uruguajt pika e kthimit për tregtinë ndërkombëtare. Kjo rundë ishte runda e tetë e pas rundave të Gjenevës, Anesit, Turguajt, Gjenevës – runda e dytë, runda e Dillonit, e Kenediut dhe runda e Tokios. Runda e tetë – e Uruguajt është e njohur përshkak të krijimit të një organizate të re ndërkombëtare për tregtinë, këtë herë të quajtur “Organizata Tregtare Botërore”³⁹¹. OBT – ja u krijua nga marrëveshtja e Marakeshit e nënshkruar nga mbledhja e minsitrave në Marakesh Maroko. Mekanizmi për zgjidhje të kontesteve të OBT është i ndërtuar në bazën e sistemit të zgjidhjeve të kontesteve të MPTT. “ Në kushtet e sotme të globalizimit ekonomik është e pakontestueshme që e drejta e OBT – së është pjesë përbërëse e së drejtës ndërkombëtare, rëndësia dhe roli i së cilës gjithnjë e më shumë fiton në peshë.”³⁹² Ku ka shumë pale ka edhe mosmarrëveshtje të shumta. Këto mosmarrëveshtje brenda OBT – së si zakonisht kanë të bëjnë me mosrespektimin e obligimeve. Është një praktikë e përdorur brenda OBT – së që nëse anëtarët i shkelin dhe nuk i respektojnë rregullat të cilët rregullojnë tregtinë, në ato raste shtetet anëtare të saj kanë rënë dakord që për zgjidhjen e kontesteve të përdorin sistemin apo mehanizmin e zgjidhjeve të kontesteve të vet OBT- së e jo të ndërmarin veprime procedurale të njëanshme. Kur një shtet anëtarë konsideron se tjetri ka shkelur një marrëveshtje të OBT – së? “Një kontest paraqitet kur një shtet miraton një masë të politikës tregtare ose ndërmer ndonjë veprim për të cilën një ose më shumë anëtarë tjerë të OBT – së e konsiderojnë si shkelje të marrëveshtjes së OBT – së ose kur nuk kanë arritur t’i

³⁸⁹ Marrëveshtja e Përgjithshme për Tarifatat dhe Tregtinë ishte një marrëveshje ligjore mes shumë shteteve, qëllimi i përgjithshëm i të cilave ishte të nxiste tregtinë ndërkombëtare duke ulur ose eliminuar barrierat tregtare siç janë tarifatat ose kuotat. Sipas preambulës së saj, qëllimi i saj ishte reduktimi i ndjeshëm i tarifave dhe barrierave të tjera tregtare dhe eliminimi i preferencave, në baza reciproke dhe reciprokisht të favorshme. u nënshkrua nga 23 vende në Gjenevë më 30 tetor 1947 dhe hyri në fuqi më 1 janar 1948. Ajo mbeti në fuqi deri në nënshkrimin e 123 shteteve në Marrakesh më 14 prill 1994, të Marrëveshjeve të Raundit të Uruguajt, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) më 1 janar të vitit 1995. Shih më tepër në https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/fact4_e.htm

³⁹⁰ https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/fact1_e.htm

³⁹¹ Surya P. Subedi, Phil. B, (2012), International Trade and Business Law, The people public security publishing house, Hanoi, fq. 56

³⁹² Van den Bossche, P, Memeti, A, Bilalli, A, Jashari, A, (2013), E drejta e Organizatës Botërore të Tregtisë, Shtip

përmbushin detyrimet e tyre “³⁹³. Si subjekte apo palë ne kontestet brenda OBT janë shtetet anëtare, që don të thotë se vetëm shtetet mundet të jenë palë apo palë e tretë e jo edhe individët. Kështu që nëse ndonjë individ i cili është shtetas i shtetit anëtarë të OBT-së ose ndonjë kompani apo shoqatë e konsideron veten si palë dhe mendon se duhet të aktivizoj mekanizmin e zgjidhjes së kontesteve brenda OBT-se, ai duhet që me anë të provave dhe fakteve të bind shtetin shtetas i të cilit është që të parashtrij ankes kundër palës tjetër respektivisht ndonjë shteti tjetër anëtar i OBT-së. Çështja e zgjidhjes të kontesteve brenda kornizave të OBT-së është e rregulluar me Marrëveshtje për themelimin e OBT-së³⁹⁴, më saktë në aneksin e dytë e quajtur Kuptimi i rregullave dhe procedurave që rregullojnë zgjidhjen e mosëmarveshjeve e cila përmban 27 nene dhe 4 shtojca. Si organe të cilat janë të përfshira në procesin e zgjidhje të kontesteve brenda OBT-së janë: Organi për zgjidhje të kontesteve³⁹⁵, panelet³⁹⁶ dhe trupi apelues si shkalë e dytë dhe përfundimtare e sistemit të zgjidhjeve të kontesteve në OBT³⁹⁷. Jo vetëm nëpërmjet të Organit për zgjidhje të kontesteve, paneleve dhe trupit apelues zgjidhen kontestet brenda sistemit të zgjidhjeve të kontesteve të OBT-së. Neni 5 i aneksit të dytë të Marrëveshtjes të OBT-së parasheh si procedura të cilat mundet të ndërmeren në mënyrë vullnetare nëse palët në kontest pajtohen që ti përdorin, mundet të jenë: Zyrat e mira (Good Offices) pajtimi dhe mediacioni³⁹⁸. Gjithashtu edhe arbitrazhi mundet të përdoret si zgjidhje alternative e kontesteve për gjetjen e zgjidhjes të caktuar në mes të palëve të cilat njëkohësisht janë shtete anëtare të OBT-së. “Në qoftë se palët dëshirojnë të përdorin arbitrazhin ato paraprakisht duhet të bien dakord për një

³⁹³ https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/displ_e.htm

³⁹⁴ WTO Agreement: Marrakesh Agreement Establishing the World Trade Organization, April, 15, 1994, 1867 U.N.T.S 154, 33 I.L.M (1994)

³⁹⁵ Sipas nenit 2.1 të Kuptimit të rregullave të procedurave që rregullojnë zgjidhjen e kontesteve, Organi për zgjidhje të kontesteve është kompetente të krijoj panelet për zgjidhje të kontesteve, të miratoj raportet e paneleve të trupit apelues, të kujdeset për mbikqyrjen e implementimit të rregullave dhe rekomandimeve të cilat i miraton dhe të autorizoj suspendimin e koncesioneve dhe obligimeve tjera të cilat janë të përfshira në marrëveshtjen e OBT – së në qoftë se vendimet dhe rekomandimet nuk ndërmeren në kohë nga ana e shteteve anëtare të OBT – së.

³⁹⁶ Të cilat janë institucione gjysëm gjyqësore të krijuara nga Organi për zgjidhje të kontesteve të trajtojnë ato konteste të cilët nuk janë të zgjidhura në fazën e konsultimit. Sipas nenit 6.1 panelet krijojnë në mbledhjen e fundit të Organit për zgjidhjen e kontesteve pas mbledhjes në të cilën kërkesa për themelimin shfaqet për së pari here si pike në rendin e ditës të Organit për zgjidhje të kontestit. Shih më tepër në Dr Surya P. Subedi, DPhil, Barrister, vep. cituar, fq. 187-188

³⁹⁷ Trupi gjyqësor është një institucion i pavarur gjysëm gjyqësor dhe i përhershëm i përbërë nga 7 persona të zgjedhur për afat prej 4 viteve me të drejtën e rizgjedhjes. Nëse ndonjëra nga palët parashtron ankesë kundër vendimit të panelit, atëherë trupi apelues do ta rishikoj dhe shqyrtoj çështjen juridike të ankimit dhe si rezultat i saj do të dërgoj një raport deri te Organi për zgjidhje të kontestit të cilën mundet ta pranoj ashtu se si është vendimi i panelit, ta ndryshoj ose modifikoj vendimin e apelit.

³⁹⁸ Sipas nenit 5 al.3 këto metoda mundet të kërkojnë të përdoren nga palët në çfarë do kohë të kontestit si dhe mendet të përfundojnë në çdo kohë, dhe në rast të përfundimit, pala paditëse mundet të kërkojë krijimin e panelit.

procedurë të caktuar e cila duhet të zbatohet si dhe për shpërblimin e arbitrazhit³⁹⁹. Sistemi i zgjidhjes të kontesteve tregtare të OBT-së përfshinë ato kontestet tregtare të cilat kanë të bëjnë me ndonjë masë specifike si psh ligj, regullativë e ndonjë qeverie, vendim gjyqësor, praktik egzistuese, etj të cilët kanë ndikim në kushtet e tregtisë, kushtet për qasje në treg për ndonjë shtet anëtar të OBT-së apo kur me ndonjë veprim të ndonjë shteti anëtar të OBT –së shkakton shkelje të regullave të OBT –së.

Rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet çështjes të zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare tregtare përshkak të natyrës së transaksioneve, natyrës së kontesteve e sidomos lidhshmërisë me elementin e huaj respektivisht atë ndërkombëtarë. Gjithashtu kujdes të veçantë duhet ti kushtohet edhe përshkak të paraqitjes eventuale edhe pse nuk janë shumë të shpeshta dhe ndikuese faktorët të cilët paraqiten në kontestete vendase tregtare siç janë: politike, ekonomike, juridike dhe kulturore. “Gjat viteve zgjidhja e kontesteve transnacionale janë trajtuar ekskluzivisht nga një numër i vogël i të ashtuquajturit “agjencione ndërkombëtare të të drejtës “të cilët janë të njohur për natyrën e ndërlikuar të proceurës gjyqësore ndërkombëtare dhe arbitrazhit “⁴⁰⁰. Jo edhe rastësisht për sa i përket këtyre dy metodave të zgjidhjeve të kontesteve, qendra apo agjenci të cilët miren me zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare tregtare konsiderohen si qendra dhe agjenci të cilët kanë të punësuar persona me pregaditje të lartë në këto sfera. Mirpo në këtë dekadën e fundit vërehet një ekzpanzion i madh i teknikave tjera të cilët ofrojnë zgjidhje shumë më të shpejta dhe më efektive të zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare tregtare të cilët karakterizohen me vullnetarizmin e tyre si dhe me rritjen e besimit në tregti. Si metoda të tilla njihen: negocijimi, medijacioni, pajtimi dhe mini senacat gjyqësore. Medijacioni kohët e fundit është popullarizuar mjaft si metod e zgjidhjeve të kontesteve nga sfera ndërkombëtare tregtare. Kjo përshkak të asaj se siguron efikasitet të zgjidhjes së problemit, ku palët përshkka të obligimeve të tepërta dhe mungesës shumë të madhe të faktorit kohë në ditët e sodit, preferojnë zgjidhjen e medijacionit për të zgjidhur një kontest të tyre. Kjo më shumë vlen për ato të cilët janë në pozitën më të favorshme në kontest – kreditorët të cilët janë në pritje të pagesës të kërkesave të tyre. Në faktë jo më se kotë edhe përdoret shprehja se kreditorët janë ato të cilët më së shumti janë të interesuar për zgjidhje të kontestit të tyre jasht hapsirave gjyqësore, ndërsa nga

³⁹⁹ Neni 25 i aneksit 2 të Marrëveshtjes së OBT – së.

⁴⁰⁰ Coombe, George W. Jr. (1999) "The Resolution of Transnational Commercial Disputes: A Perspective from North America," Annual Survey of International & Comparative Law: Vol. 5: Iss. 1, Article 3, fq. 14

ana tjetër janë debitorët të cilët preferojnë nga ana tjetër procedurat gjyqësore të cilët janë të njohura për stërzgjatjen e procedurës. Kjo është kështu nga shkakut se debitorët me zvarritjen e procedurës gjyqësore fitojnë në kohë dhe në fakt manipulojnë me kohën me qëllim që të vonohen në përmbushjen e detyrimeve të tyre. Ligji për Medijacionin parashah mundësinë e trajtimeve dhe zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare të çfarëdo lloji natyre por me kusht që të jetë e lidhur me elementin e huaj dhe atë: nëqoftë se palët në momentin e arritjes të marrëveshtjes për medijacion kanë venqëndrim ose seli në ndonjë shtet të huaj, nëqoftë se ndonjë nga obligimet e palëve të cilët rrjedhin nga kontrata detyimore duhet të kryhet në ndonjë shtet tjetër dhe nëqoftë se pala e cila është pjesëmarrëse në një mardhënie kontestuese i vuan mardhëniet në një shtet tjetër⁴⁰¹. Është për tu përmendur fakti se shumë shtete të cilët janë anëtarë të Unionit Europian kanë filluar me të madhe që ti miratojnë dhe ti pranojnë rregullat për medijacion kontraktual. Mirpo pse është aq shumë e aplikuar ky lloj i medijacionit në këto shtete, është një çështje e cila duhet të shtjellohet. Klauzola e medijacionit kontraktual përcakton kushtet dhe çështjet të cilët konsiderohen të rëndësishme të madhe për nisjen, zbatimin dhe përfundimin dhe me këtë edhe rezultatin përfundimtar të medijacionit. Si çështje e parë e cila është e rëndësishme për medijacionin është përcaktimi i kohës së duhur për nisjen dhe ndërprejren e medijacionit. Ajo që është e rëndësishme dhe duhet të merret në konsideratë gjat përcaktimit të kohës së duhur për zbatim të medijacionit, palët gjithmonë duhet të nisen nga ajo se a mundet që ti sigurojnë dokumentet dhe provat të cilët mundet tu nevojiten gjat procedurës së medijacionit dhe a mundet ti përballojnë shpenzimet të cilët mundet të shkaktohen si rezultat i sigurimit të tyre⁴⁰². Çështja e njohjes së mirë të të drejtës materiale por edhe ligjit të medijacionit të cilët e rregullojnë këtë materie në legjislacionet nacionale secili shtet individualisht dhe e cila duhet të aplikohet gjat medijacionit është e lidhur ngushtë me përcaktimin e kohës të medijacionit. Njohja e mirë e ligjit e cila duhet të aplikohet për zgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit kontraktues është një faktor i cili do të kishte ndikim shumë të madh për përcaktimin e kohës së nisjes si dhe të zhvillimit dhe përfundimit të procedurës. Kjo është pasi që njohja jo shumë e mirë e ligjit e cila duhet të përdoret për zgjidhjen e kontestit në fakt e ngadalson nisjen e zbatimit të medijacionit dhe me këtë edhe ngadalson dhe e zvarrit gjetjen e zgjidhjes të duhur duke u bazuar në ligj jo të duhur. Është kështu nga shkakut se bëhet fjalë për konteste tregtare tek të cilët e pranishme është

⁴⁰¹ Ligji për Medijacionin, neni 4, al. 1

⁴⁰² Arthur W. Rovine, (2011), Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation: The Fordham Papers 2010, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden-Boston, fq 389

element i huaj. Vendi ku do të zbatohet medijacioni dhe gjuha në të cilën do të kryhet medijacioni janë çështje të rëndësishme të madhe. Ligji mbi Medijacionin i Republikës së Maqedonisë nuk përmban ndonjë nen e cila e rregullon çështjen e vendit ku do të mbahet dhe zbatohet procedura e medijacionit. Por nga ana tjetër ekzistojnë rregullativa ndërkombëtare të cilët rregullojnë çështjen e tillë teknike. Instituti për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konfliktëve⁴⁰³ në rregulloren për regullimin e procedurë të medijacionit më saktë në nenin 3.4 pika b), medijatori përcakton kohën dhe vendin për çdo seancë. Edhe pse jo të gjithë ligjet apo rregulloret nuk përfshijnë një nen të tillë e cila do të rregullonte çështjen e vendit ku do të mbahen seancat e medijacionit, mundet të prezumohet se medijatori është ai i cili do të propozoj një vend të përshtatshëm për palët në rradhë të parë e pastaj edhe për vete si përmbushës i obligimeve të cilët përcaktohen me ligj. Ndërsa sa i përket gjuhës e cila do të përdoret gjat seancave të medijacionit, është një pikë shumë e rëndësishme e cila vlen të trajtohet, pasi që në këtë pjesë shtjellohen kontestete tregtare me element të huaj, të cilët kanë lidhshmëri me dy e më tepër shtete të ndryshme me kultura dhe gjuhë të ndryshme. Çka do të ndodh në këto raste? Ligji jon për medijacionin në nenin 4 parasheh rastet kur kemi medijacion ndërkombëtar ndërsa në alinenë e dytë të këtij neni urdhëron në zbatimin e ligjit të Republikës së Maqedonisë në qoftë se procedura e medijacionit zbatohet në shtetin tonë. Kjo gjë automatikisht na çon në përdorimin paralel të neneve të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë⁴⁰⁴ dhe në Ligjin për procedurë kontestimore⁴⁰⁵ të cilët parashohin se gjuha zyrtare e në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrdhëniet ndërkombëtare është gjuha maqedone dhe shkrimi kirilik, dhe se gjuhë tjetër e cila flitet nga së paku 20% e qytetarëve gjithashtu konsiderohet si gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj. Çka don të thotë kjo? Nëqoftë se në Republikën e Maqedonisë zbatohet medijacioni e cila ka lidhshmëri me elementin ndërkombëtarë atëherë si gjuhë e cila do të përdoret gjat zbatimit të medijacionit do të jetë gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj kirilik. Në qoftë se ndonjëra nga palët dëshiron që të përdor gjuhën e tij gjat seancës të medijacionit, atëherë sipas nenit 93 al. 3 të Ligjit për procedurë kontestimore të njejtit do ti sigurohet përkthyes në gjuhën e tij. Janë të shumta dokumentete ndërkombëtare të cilët e rregullojnë problematikën e gjuhës gjat medijacionit ndërkombëtar. Kështu, rregullorja e cila i rregulon mënyrat e zgjidhjeve alternative

⁴⁰³ I themeluar në vitin 1977, si një organizatë e pavarur jofitimprurëse që ndihmon bizneset globale të parandalojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet tregtare në mënyrë efektive dhe efikase.

⁴⁰⁴ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, amandmani V, al. 1

⁴⁰⁵ Ligji mbi procedurë kontestimore, neni 6, al. 1

të kontesteve e Odës Ndërkombëtare Tregtare parasheh se gjuha e cila do të përdoret gjat medijacionit ndërkombëtarë përcaktohet me anë të marrëveshtjes të palëve, ndërsa në mungesë të asaj marrëveshtje është medijatori ai i cili do të vendosë se cila gjuhë do të përdoret⁴⁰⁶. Gjithashtu edhe Qendra Ndërkombëtare për zgjidhje të kontesteve në rregulloren e cila rregullon Procedurën e zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare parasheh se palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjuha e medijacionit do të jetë ajo gjuhë në të cilën është përpiluar dokumenti që përmbanë marrëveshjen e medijacionit⁴⁰⁷, si dhe Gjykata e Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar në Rregulloren për Medijacionin është medijatori ai i cili vendos për gjuhën në të cilën do të zbatohet procedura e medijacionit⁴⁰⁸. Dhe në fund shumë është e nevojshme që në një procedurë të medijacionit pa mar parasyshë kjo a është ndërkombëtar apo jo, palët të zgjedhin një medijator cilësor dhe të pregaditur profesionalisht që i njëjti ta udhëheq dhe përfundoj me rezultat të suksesshëm medijacionin. Që të arrihet një zgjidhje e shpejtë dhe e suksesshme me anë të medijacionit, nuk mundet të përjashtohet fakti se cilësit e medijatorit skan rëndësi, bile mundet të thuhet se medijatori është faktori vendimtar për një medijacion të suksesshëm. Njohuritë e medijatorit për çështjet substanciale, njohuritë e medijatorit për ligjet dhe për të drejtën material e cila duhet të aplikohet te rastet, njohurit e tij për diversitetet kulturore, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me medijacion ndërkombëtar ku si palë paraqiten shtetas të shteteve të ndryshme dhe të cilët u përkasin kulturave të ndryshme, si dhe përvoja e tij në çështje të ndryshme apo të ngjajshme konsiderohen faktorë shumë domethënës dhe të rëndësishëm për një medijator. Përcaktimin e medijatorit e bëjnë palët me anë të marrëveshtjes. Këtë e parasheh Ligji për medijacion⁴⁰⁹ por edhe dokumentet ndërkombëtare të cilët e rregullojnë këtë materije⁴¹⁰. Prandaj, “në medijacionin ndërkombëtar roli dhe autoriteti i medijatorit, rregullat e medijacionit

⁴⁰⁶ Rregullorja mbi medijacion e Odës Ndërkombëtare Tregtare, neni 5.4

⁴⁰⁷ Rregullorja e Procedurës për zgjidhjen e kontesteve tregtare e Qendrës Tregtare për zgjidhjen e Kontesteve, neni 18

⁴⁰⁸ Rregullorja për Medijacionin i Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar, neni 5.5

⁴⁰⁹ Ligji për medijacionin, neni 17, al.4 dhe 2

⁴¹⁰ Instituti Ndërkombëtar për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konflikeve do të thërrasë palët, personalisht ose me telefon, në përpjekje për të zgjedhur medijatorin me marrëveshje. Nëse palët nuk arrijnë menjëherë marrëveshjen, Instituti Ndërkombëtar për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konflikeve do t'i paraqesë palëve emrat e jo më pak se tre kandidatëve, me biografitë e tyre dhe lartësinë e çmimit të orës. Nëse palët brenda shtatë ditëve nga marrja e listës, nuk mundet të bien dakord për një kandidatët nga lista secila palë, brenda 10 ditëve do t'i dërgojnë InstitutitNdërkombëtar për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konflikeve listën e kandidatëve të cilët ato i preferojnë; <https://www.cpradr.org/resource-center/rules/international-other/mediation/european-mediation-procedure>

të përzgjedhur dhe metoda e medijacionit që do të përdoret duhet të përcaktohet dhe të sqarohet paraprakisht për palët”⁴¹¹.

5.3 Marrëveshtjet e medijacionit

Marrëveshtjet e medijacionit janë të rëndësishme të madhe sidomos në sferën e tregtisë ndërkombëtare të lidhjes të marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare për shkëmbimin e mallrave dhe të shërbimeve në përgjithsi dhe në zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare tregtare në veçanti. Kjo është kështu pasi që medijacioni ka ndikim të drejtpërdrejtë në kursimin e kohës, si dhe ndikim në aspektin material e duke mos e përjashtuar edhe zgjidhjen efektive dhe efikase të kontesteve të paraqitura gjat shkëmbimit ndërkombëtar të mallrave dhe të shërbimeve. Në preambulën e Konventës të Kombeve të Bashkuara për Marrëveshtjet për Zgjidhje Ndërkombëtare që rezultojnë nga Medijacioni⁴¹², parasheh të nevojshme krijimin e një strukture për marrëveshjet ndërkombëtare të zgjidhjeve të kontesteve që vijnë nga medijacioni dhe të cilët do të jenë të pranueshme për shtetet me sisteme juridike por edhe sociale dhe ekonomike të ndryshme të cilët do të ndikonin në kontribuimin e zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare tregtare. Marrëveshtja e medijacionit e arritur nga palët dhe me anë të ndihmës të medijatorit përmban rregulla kontraktuale të cilët rregullojnë çështjen konfliktuale e cila ka qenë objekt i kontestit. Kjo konventë parasheh disa kushte të cilët duhet të plotësohen që të mundet të aplikohet dhe të vlej një marrëveshje e medijacionit. “Të paktën dy palë në marrëveshjen e zgjidhjes të kontestit të kenë selinë e bizneseve të tyre në dy shtete të ndryshme dhe shteti në të cilin palët kanë seli të bizneseve të tyre të jetë ndryshe nga shteti në të cilin zbatohet pjesa më e madhe e detyrimeve sipas marrëveshtjes dhe të jetë më ndryshe nga shteti me të cilin objekti i marrëveshtjes me të cilin është zgjidhur kontesti është më ngushtë i lidhur”⁴¹³. **Në literaturë përmenden dy lloje të medijatorëve ndërkombëtar tregtar: medijatorë të thjesht tregtar dhe medijator të berzës**⁴¹⁴. Edhe forma e marrëveshtjes është një çështje shumë e rëndësishme.

⁴¹¹ <https://www.uww-adr.com/zupload/wp-content/uploads/2015/03/International-Mediation.pdf>

⁴¹² United Nations Convention on International Settlement Agreements Resulting from Mediation, A/73/17

⁴¹³ Neni 1 i Konventës të Kombeve të Bashkuara të Marrëveshjeve Ndërkombëtare të Zgjidhjeve të cilët rezultojnë nga Medijacioni.

⁴¹⁴ Medijatorët e berzës e kryejn veprimtarin e tyre në berzë pa mar parasyshë të llojit të berzës. Medijator i berzës nuk mundet të jetë secili medijator tregtar. Sipas rregullit medijatorët i zgjedh organ ii veçantë berzës i autorizuar me Statut. Pra këto medijator nuk mundet të miren me punë dhe çështje tregtare por vetë me medijacion në berzë. Pra ky lloj i medijacionit zgjidh të gjitha kontestet eventuale të cilat do të paraqiteshin gjat punës së berzës. Николовски. А, Плавшиќ. С, (1994), Меѓународно стопанско (трговско) право, Скопје, fq. 329; ndërsa

Sot në tregun ndërkombëtar lidhen kontrata të ndryshme dhe të cilët janë të shumtë dhe të cilët përshkak të shpeshtësisë së tyre dhe lidhjes së përditshme të tyre mundet të lidhen në forma të ndryshme. Si formë primare është ajo e shkruar, por mundet të lidhet edhe në forma tjera si nëpërmjet të telefonit, me anë të korrespondencës apo edhe nëpërmjet të e-mailit e cila sot dukshëm është forma më tepër e përdorur për lidhjen e kontratave. Sipas ligji të medijacionit e cila është në fuqi sot, marrëveshtja e medijacionit lidhet në formë të shkruar e përgaditur nga ana e palëve ose nga ana e medijatorit në bazë të kërkesës së palëve dhe e nënshkruar nga ana e palëve në afat prej 3 ditëve nga dita kur është arritur marrëveshtja për kontestin e tyre⁴¹⁵. Sipas neni 21 medijatori është i obliguar që marrëveshtjen e tillë ta vërtetoj me nënshkrim dhe të njëjtën ta paraqes tek Ministria e Drejtësisë me qëllim që e njëjta të regjistrohet në Regjistrin përkatës për mbajtjen e evidencës për procedurat e medijacionit. Palët mundet që në marrëveshtjen e tyre detyrimore të përcaktojnë disa rregulla të cilët do të obligohen që në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti në mes tyre të njëjtën ta zgjidhin nëpërmjet të medijacionit⁴¹⁶, pra ajo mundet të caktohet edhe para se të inicohet procedurë gjyqësore për zgjidhjen e kontestit. Në këto raste në qoftë se palët arrijnë të miren vesht për kontestin e tyre në procedurë të medijacionit, dhe të njëjtit duan që ajo marrëveshtje të ketë fuqinë e dokumentit ekzekutiv, atë marrëveshtje ato duhet ta solemnizojnë në noterë në përputhje me ligjin (neni 22 al. 1), ndërsa në qoftë se procedura e medijacionit zbatohet pas inicimit të procedurës të rregullt gjyqësore, medijatori është i obliguar që pas sjelljes të marrëveshtjes për zgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit ta njoftoj gjykatën për menyrën e përfundimit të kontestit dhe të njëjtën marrëveshtje ta dorzoj në atë gjykatë e cila do të paraqesë bazë për pajtim gjyqësor.

PJESA E KATËRT

VI Medijacioni në të drejtën krahasimore

Nëqoftë se bëjmë një krahasim nga aspekti i zhvillimit historik të zgjidhjeve paqësore të kontesteve dhe të zgjidhjeve alternative të kontesteve në kuptimin në të cilën përdoret sot, zhvillimi historik i kësaj të fundit konsiderohet shumë më i shkurt se sa zhvillimi historik i

medijatorët e thjeshtë tregtar nuk janë të lidhur për vende të caktuara ose berza, por mundet që punët e tyre ti kryejn në cilën do mënyrë që ata dëshirojnë. Đurović. R, (1991), Međunarodno privredno parvo, Beograd, fq. 241-242

⁴¹⁵ Ligji mbi Medijacionin, neni 21, al. 1

⁴¹⁶ Ligji mbi Medijacionin, neni 3

zgjidhjeve paqësore të kontesteve, e cila mënyrë e zgjidhjeve të kontesteve është paraqitur qysh në fazat e para të bashkësive shoqërore. Egziston mendimi ndërmjet historianëve se ka pasur raste kur është përdorur medijacioni në kontestet të cilët janë paraqitur në tregti me fenikasit e lashtë dhe babilonasite lashtë. Medijacioni në Greqinë e lashtë më shpeshtështë përdorur në kontestet martesore dhe familjare. Nga ana tjetër Romakët e lashtë përdornin procedura të caktuara të ngjajshme me medijacionin ndërsa zgjidhja paqësore si mënyrë e zgjidhjes të kontestit në këtë periudh mundet të gjindet në librin Digesta të Kodit të Justinianit. Gjat krijimit të konceptit themelor të zgjidhjeve alternative të kontesteve, ka një ngajshmëri me përpjekjet historike për krijimin dhe përcaktimin e konceptit të zgjidhjes paqësore të kontesteve. Kur jemi te medijacioni ose tek metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve atëherë kemi të bëjmë me një mënyrë shumë më të ndryshme të mënyrës së zgjidhjes së kontestit në krahasim me procedurën kontestimore por edhe arbitrazhit, ku personi i tretë neutral i ndhmon palët që të arrijnë deri në një zgjidhje të përbashkët. Sa i përket procedurës së medijacionit në të kaluarën dhe asaj e cila zbatohet sot qëndron në teknikat të cilët përdoren në medijacion të cilët janë sistemuar bazuar përveç se në praktikat amerikane ashtu edhe në praktikat e vendeve evropiane dhe kontinenteve tjera. Medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve është e pranuar dhe implementohet si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe në shumë vende të ndryshme të botës. Në këtë pjesë të disertacionit vëmendje të veçantë do t'i kushtohet përshkrimit komparativ të procedurave të medijacionit të vendeve të ndryshme të botës e cila do të na mundësonte të nxjerrim pikat e përbashkëta dhe ato dalluese ndërmjet procedurës së medijacionit në vendin tonë dhe të procedurës së medijacionit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Australi, Hollandë, në ish republikat e Jugosllavisë si në Republikën e Kroacisë, Sllovenisë, Malit të Zi dhe Sërbisë.

1. Procedura e medijacionit në SHBA

Nga gjith vendet e botës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës konisedrohen si vend i cili mban vendin e parë për nga numri më i madhi kontesteve në raport me numrin e banuesve në

të⁴¹⁷. Mbingarkesa e gjykatave në SHBA, ka rezultuar me procedura kontestimore të gjata dhe të lodhshme si rezultat i të cilave janë derdhur një shumë e madhe e parave për mbulimin e shpenzimeve procedurale dhe në fund “feedback-u” final është pala e pakënaqur. Për atë shkak hapet e para për të shkarkuar gjykatat ka qenë vendosja e metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve në systemin juridik. Gjat viteve 1970 dhe 1980 shumë gjykata federale të SHBA-ve filluan që të zbatojnë metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve si medijacionin, arbitrazhin dhe vlersimin neutral të hershëm ose siç njihet në gjuhën angleze *early neutral evaluation*. Përprjekja e parë për futjen e medijacionit në SHBA është ndërmar në vitin 1983. Në këtë vit është ndryshuar Ligji federal për procedurë kontestimore⁴¹⁸ respektivisht është ndryshuar neni nr. 16 i cili ndryshim ka mundësuar që palët të udhëzohen në procedura jashtgjyqësore të zgjidhjeve të kontesteve të tyre. Më pastaj në vitin 1990 me miratimin e Ligjit për reforma në gjyqësi - Civil Justice Reform Act, i cili bëri vërtet ndryshime në këtë sferë, respektivisht urdhëronte të gjithë gjykatat federale dhe ato të rrethit që të formojnë borde këshilluese që të mundën të gjejnë mënyra për të shkurtuar procedurat e gjata gjyqësore, me çka këshillohen që gjykatat të përdorin metoda të ndryshme për zgjidhjen alternative të kontesteve. Në vitin 2001 është miratuar Uniform Mediation Act, dispozitat e të cilës u përfshinë në të ishin të përbashkëta për legjislacionet e shteteve të SHBA-ve. Nisja e aplikimit të metodave alternative për zgjidhje të kontesteve fillimet i ka nga viti 1985 e cila është filluar si një program eksperimental e sponsoruar nga Oda e avokatëve⁴¹⁹. Në vitin 1987 miratohet në Teksas Ligji mbi zgjidhjen alternative të kontesteve - *Texas Alternative Dispute Resolution Act*⁴²⁰. Ky ligj përmban dispozita me të cilët rregullohen procedura e shumë metodave alternative të zgjidhjes të kontesteve si arbitrazhi - *arbitration*, konferenca e për zgjidhje të moderuar -*moderated settlement conference*, gjykimi përmbledhës i jurisë – *summary jury trial* dhe mini gjykim – *mini trial* përfshirë këtu edhe medijacionin e cila nga të gjithë metodat, konsiderohet si metoda më e përdorur për zgjidhje të kontesteve. Në vitin 1988 medijacioni filloi të rregullohet edhe në Florida⁴²¹ dhe

⁴¹⁷ А. Марковић, Е. Крстић, Ј. Цветковић, М. Благојевић, М. Живковић, (2009), Медијација на територији града Ниша – ставови грађана и искуства професионалаца, Зборник радова Правног факултета у Нишу, број 53, Нисх, fq. 261

⁴¹⁸ United States Code Annotated Federal Rules of Civil Procedure for the United States District Courts, neni 16, al. 1, pika 5

⁴¹⁹ American Bar Association, <https://www.americanbar.org/>

⁴²⁰ Me këtë ligj u është dhënë gjyqtarëve që palët t'i udhëzojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin nëpërmjet të njëjës nga disa metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve të cilët janë të parapara në ligj.

⁴²¹ Në Florida ligji me të cilën rregullohet zgjidhja alternative e kontesteve hyri në fuqi në janar të vitit 1988. Hapat e para u hodhën në vitin 1978 kur edhe u emërua Komiteti i Gjykatës Supreme për zgjidhjen alternative të kontesteve.

Oklahoma. Në Oklahoma në vitin 1988 hyri në fuqi Rregullorja nr. 16.3533. Në Oklahoma gjat zbatimit të procedurës kontestimore tentohet që në mënyrë paralele me zgjidhjen e kontestit, palët të arrijnë marrëveshje në seanca të veçanta siç quhen në gjuhën angleze *Settlement Conferences*. Shumë shpejt mbas arritjes të futjes të medijacionit në legjislacionet e tyre, në vitin 1990 një tentim i tillë u bë edhe në New Jersey. Ky tentim erdhi si rezultat i Ligjit për reformat të gjykatave juridiko-civile e vitit 1990⁴²². Në Minestota zgjidhja alternative e kontesteve rregullohet me Rregullën nr. 114 e miratuar në korrik të vitit 1994 të Rregullave të përgjithshme mbi procedurën kontestimore (General Rules of Civil Practice). Kjo rregull më së shumti zbatohet për zgjidhjen e kontesteve nga fusha juridiko-civile dhe juridiko-familjare. Në këtë rregull është përfshirë gjithë sqarimi i procedurës para gjykatës i cili do të udhëzojë palët respektivisht avokatët e tyre që kontesti të zgjidhet me anë të ndonjërit prej metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve përfshirë këtu edhe medijacionin si metodë e tillë. Pas kësaj avokatët janë të cilët këshillojnë palët respektivisht klientët e tyre për zgjidhjen alternative të kontestit të tyre me anë të medijacionit. Më pastaj avokatët të të dy palëve kundërshtare do të diskutojnë njëri me tjetrin për zgjidhjen alternative të kontestit të palëve. Në këto raste gjykata nuk rin aspak passive. Ajo mundet që të udhëroj palët që të përdorin arbitrazhin e detyrueshëm nga njëra anë ose medijacionin si procedurë jo detyruese si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve.

Në vitin 1998 u miratua Ligji për zgjidhje alternative të kontesteve⁴²³, i cili ligj për qëllim kishte që në nivel federal të sigurohet një besueshmëri më të madhe të programeve të shumta në lidhje me metodat e zgjidhjeve alternative të kontesteve të përgjithësi dhe medijacionit në veçanti të cilët programe veç ishin të adoptuara nga gjykatat e shteteve amerikane. Përderisa në fillim gjykatat kanë pasur të drejtë dhe obligim ga ana tjetër që palët t'i udhëzojnë të përdorin medijacionin si metodë e zgjidhjeve të kontesteve të tyre, me hyrjen në fuqi të këtij ligji gjykatat e shkallës së parë ligji i urdhëronte që të implementojnë programat në lidhje me zgjidhjet alternative të kontesteve përfshirë këtu edhe medijacionin si dhe të promovojnë këto metoda

Në vitin 1985 si rezultat i përvijës së këtij Komiteti, u realizua një studim i cili rekomandoi zbatimin gjithëpërfshirës të medijacionit dhe arbitrazhit në gjykatat e Floridës e cila u pranua dhe si pasojë e të cilës u miratua „Chapter 44, Florida Statutes“ në shtetin e Floridës.

⁴²² Deri në vitin 1992 u emëruan 29 medijator ndërsa në vitin 1993 ky tentim u konsiderua si shumë i suksesshëm dhe kështu medijacionit filloi të zbatohet në shumë sfera. Si rezultat i kësaj në po atë viti u miratu Rregulli 49 – Rule 49 of the Local Rules e cila rregullon shumë çështje të cilët kanë të bëjnë me medijacionin dhe procedurën e saj si psh: emrimin të medijatorëve, shpërblimi i medijatorit, çështjet të cilët janë të përshtatshme për zgjidhje me anë të medijacionit, procedura dhe fazat në të cilat kalon medijacionit, udhëzimet për medijacion të suksesshëm dhe standardet etike të medijatorëve.

⁴²³ Alternative Dispute Resolution Act, Pub. L. No. 105-315, § 2, 112. Stat. 2993 (1998)

respektivisht medijacionin si zgjidhje alternative të kontesteve. Qëllim tjetër i këtij ligji ishte edhe që medijacionit të filloj të trajtohet si procedurë e detyrueshme. Edhe në vitin 2001 u bë një tentim i cili vlen të përmendet pasi që i njejtë doli i suksesshëm- propozimi një ligj të vetëm për medijacionin – *Uniform Mediation Act*⁴²⁴. Rregullat të cilët përbëjnë këtë ligj të përbashkët për të gjithë shtetet e SHBA-ve u përpiluan si rezultat i praktikave të procedurës së medijacionit në shtetet e SHBA-ve.

Në SHBA, modelet e shumta të medijacionit e autorizojnë gjykatën që ato vetë me bindjen e tyre të vlersojnë çdo rast konkret dhe në bazë të atij vlersimi të vendosin se një çështje kontestuese është apo jo e përshtatshme për t'u zgjidhur me anë të medijacionit. Gjithashtu gjykatave u është lënë që vetë të caktojnë rregullat sipas të cilave do të zbatohet procedura e medijacionit gjë e cila shkakton laramani në atë se si vendosin gjykatat në lidhje me lëndët të cilët mund të zgjidhen me anë të medijacionit, si p.sh mundet të paraqiten rastet kur disa gjykata lejojnë që palët dhe gjithashtu i udhëzojnë të njejtë që të inicojnë procedurë të medijacionit në të gjithë llojet e lëndëve juriidiko-civile, ose disa nga ana tjetër mundet të ndalojnë medijacionin në një numër të caktuar të lëndëve. Por pavarësisht kësaj në SHBA është e pamohueshme fakti se edhe pse gjykatat mundet që palët t'i udhëzojnë në tentimin e zgjidhjes të kontestit të tyre me anë të medijacionit, prap se prap vendimin kryesor e kanë palët nga të cilët varet çështja e inicimit të medijacionit, ndërsa gjykata nga ana tjetër nuk është asgjë më shumë se sa një faktor i cili i ndihmon palës që të zgjedh në mes dy mundësive, medijacionit ose procedurës kontestimore. Gjykata mundet që palët gjat gjithë procedurës kontestimore ta udhëzojë që çështjen e tyre kontestuese ta zgjidhin me anë të medijacionit. Sidomos neni 16 kërkon nga gjykata që vëmendje të veçantë t'i kushtohet seancës pregaditore sidomos për të vërejtur se a egziston mundësia dhe mbi gjitha a mbizotron atmosfera ndërmjet palëve për zgjidhje të kontestit të tyre nëpërmjet të medijacionit. Këtë bindje gjyqtari e fiton pasi që konsultohet me palët para se të njetëve t'ua propozoj medijacionin.

Procedura e medijacionit fillon atëherë kur palët i paraqesin medijatorit parashtrirat të cilët janë të karakterit konfidencial në të cilët është e përcaktuar pozicioni i tyre në kontestin e

⁴²⁴ Uniform Mediation Act, National Conference of Commissioners on Uniform State Laws, nr. 312/915-0195, Chicago Illionis. Në këtë ligj fillimisht përcaktohen nocionet themelore të medijacionit si palët e medijacionit, medijatori, procedura e medijacionit e kështu me rradhë. Pastaj në pjesët tjera përcaktohetL fushveprimi i medijacionit, e drejta e refuzimit të pranimit, pranueshmëria dhe zbulimi; heqja dorë nga e drejta e pranimit; përjashtime nga e drejta e pranimit nga ana e palëve; konfidencialiteti; pjesmarja në procedurën e medijacionit; zbatim i përbashkët; klauzola e pjesshme; mjetet juridike të goditjes dhe aplikimi i marrëveshtheve egzistuese.

caktuar. Hap i ardhëshëm i medijatorit menjëher pas kësaj është caktim i një seance e cila ka për qëllim takimin e palëve dhe uljen e tyre në bisedime me qëllim që të arrihet marrëveshtja ndërmjet tyre. Varësisht nga natyra e kontestit, disa arrihen që të zgjidhen qysh në seancën e parë të medijacionit ndërsa ato të natyrës më të komplikuar ndonjëherë duhet më shumë kohë dhe më shumë seanca për t'u zgjidhur kontesti në tërësi. Në procedurën e medijacionit në SHBA, lejohet përzierja e gjykatës gjat procedurës atëherë kur pala mer pjesë në procedurë të medijacionit me qëllime të këqija (edhe pse këto raste janë shumë të ralla pasi që palët janë ato të cilët me vetdëshir dëshirojnë që të zgjidhin kontestin me marrëveshtje për medijacion) dhe në të cilët raste të njejtit mundet të sanksionohen⁴²⁵. Në SHBA çështja e asaj se kush mundet të emërohet si medijator rregullohet më ndryshe se tek ne. Medijatorët duhet të marrin pjesë në programe të ndryshme si dhe trajnime të cilët caktohen nga gjykatat para se të emërohen si medijator në Listën e emrave të medijatorëve. Sa u përket kushteve të përgjithshme të cilët duhet ti përmbushin mediatorët të caktuar nga gjykata dallojnë nga shteti në shtet, pasi që secili mban të drejtën ekskluzive që të përcaktoj rregulla me të cilat rregullohen çështje të tilla. Si kusht bazë konsiderohet trajnimi i medijatorëve. Gjykatat si zakonisht kërkojnë që medijatorët të kenë kaluar minimum 20 orë deri në 40 orë trajnim të aprovuar për medijacion⁴²⁶. Përse trajnimeve në SHBA u kushtohet rëndësi e madhe? Kjo pasi që ajo përfshin të gjith aspektet e procedurës, nga fillimi deri në fund, siç janë: krijimi i rregullave themelore, tejkalimi i situatave problematike, se si të përfundoj bisedat ndërmjet palëve dhe të mbajturit mend të zgjidhjes përfundimtare. Gjat trajnimeve të medijatorëve të ri gjithmon mbas u rinë medijatorët me përvojë nga të cilët medijatorët e rinjë përfitojnë nga përvoja e pasur e tyre, ashtu që gjithmon gjat puntorive të cilët organizohen nëpër trajnime, medijatorët e rinjë marrin shembuj konkret për zgjidhje dhe të njejtën e zgjidh në prani dhe sipas instruksioneve të medijatorit me përvojë. Në SHBA kërkohet me të madhe që trajnimet të bëhen në mënyrë të pandërprerë me qëllim që medijatorët ti azhurnojnë vazhdimisht njohurit dhe aftësit e tyre.

Me përfundimin e bisedimeve përfundon edhe procedura e medijacionit ndërmjet palëve e cila rezulton me lidhjen e marrëveshtjes ndërmjet palëve. Mirpo jo gjithmon kjo është rezultat i procedurës së medijacionit. Edhe pse në teorinë juridike medijacioni në përgjithsi është e vullnetare, në praktikë nuk konsiderohet ashtu, si për nga dispozitat juridike të cilët e rregullojnë

⁴²⁵ Sanksioni në rastet të tilla më së tepërmi ka të bëjë me mbulimin e të gjith shpenzimeve procedural të procedurës së medijacionit.

⁴²⁶ <https://legalstudiesms.com/learning/court-certified-mediator-qualification-requirements/#FL>

këtë procedurë sitë obligueshme ashtu edhe për nga udhëzimi i detyrueshëm nga ana e gjyqtarit që gjithsesi të mundohen që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit. Edhe përkundër insistimit të tij, në asnjë mënyrë nuk don të thotë se palët janë të lidhura për urdhërin respektivisht udhëzimin e gjykatës për ta zgjidhur kontestin me anë të medijacionit. Ato kanë të drejtë që në çdo fazë të procedurës të hekin dorë nga ajo dhe të njejtën të mundohen ta zgjidhin në procedurë kontestimore para gjykatës kompetente. Kur procedura e medijacionit përfundon në mënyrë të suksesshme, pra me marrëveshje të medijacionit ndërmjet palëve, për dallim nga Republika e Maqedonisë, marrëveshja nuk inkorporohet në procesverbal për lidhje të pajtimit gjyqësor. Sot në gjykatat federale të SHBA-ve nuk egzistojnë mekanizma speciale për ta bërë një marrëveshje të arritur me anë të medijacionit të përmbarueshëm⁴²⁷. Kjo është kështu pasi që në kulturën për nga aspekti juridik në këtë vend, marrëveshja e arritur përmbushet nga palët në mënyrë vullnetare dhe pa patur nevojë të egzistoj ndonjë dispozitë e cila do të urdhëroj përmbushjen e detyrueshme të saj me ç'rast edhe nevoja për t'u konsideruar kjo marrëveshje si dokument përmbarues si konsiderohet tek ne është e panevojshme bile bile edhe e pakuptimtë.

Ajo që e bën specifike procedurën e medijacionit është se medijatori gjat seancës së parë në të cilën takohen palët dhe avokatët e tyre përveç se sqaron natyrën e procedurës së medijacionit e cila e bën të dallojë atë nga procedura kontestimore, rolin e medijatorit dhe të drejtat dhe obligimet e palëve, ai gjithashtu edhe sqaron çështjen e shpenzimeve palëve⁴²⁸. Nëse tëk ne shpenzimet procedurale të cilët shkaktoheshin si rezultat i zbatimit të medijacionit mbuloheshin nga të dyja palët në mënyrë të barabartë, në SHBA shpenzimet procedurale dhe ajo sekush do t'i mbuloj zgjidhet në mënyrë të ndryshme por prap se prap ato janë në barrë të vetë palëve. Shpenzimet e medijacionit përmbajnë: shpenzimet të cilët janë bërë si rezultat i organizimit të medijacionit, shpenzimet dhe shpërblimet e medijatorit i cili është zgjedhur për të zbatuar medijacionin dhe shpenzimet direkte të palëve⁴²⁹. Mënyra se si vendoset për shpenzimet procedurale të medijacionit në SHBA dallon nga shteti në shtet⁴³⁰. Gjithashtu gjykata ka të drejtë

⁴²⁷ F. Ali. Sh, (2018), Court Mediation Reform: Efficiency, Confidence and Perceptions of Justice, Edward Elgar Publishing, Cheltenham UK, pika 8.3.6

⁴²⁸ Ibid, pika 8.3.3

⁴²⁹ <https://settlethedispute.com/cost-of-mediation-lawsuit>

⁴³⁰ Për shembull në New York nëse bëhet dallimi i shpenzimeve të cilët duhet të mbulohen nga palët për shkurorzim në procedurë kontestimore dhe atë të medijacionit do të vërejmë një dallim të madh të shumës e cila kuptohet se ajo e cila shkakton shpenzimet më të mëdhaja është procedura kontestimore. Sipas web faqes www.settlethedispute.com shpenzimet mesatare të një shkurrorrëzimi në rocedurë kontestimore mundet të jenë rreth 50.000 dollarë ndërsa në procedurë të medijacionit kjo shumë mundet të jetë në mes 5.000 dhe 8.000 dollarë. Në Majami të Floridës shpenzimet caktohen në bazë të të ardhurave të palëve, kështu p.sh nëse pala ka të ardhura prej 100.000 dollarë

që të intervenoj në lartësinë e shpenzimeve nëse konsideron se medijatori ka caktuar një çmim jo të arsyeshëm për shërbimet e medijacionit.

Përshkak të rezultateve të suksesshme si dhe mbështetja në masë të madhe si nga ana e palëve, avokatëve të tyre dhe gjykatës gjithashtu, zgjidhja e kontesteve me anë të medijacionit konsiderohet su mënyrë shumë e përshtatshme e zgjidhjeve të kontesteve por njëkohësisht edhe për rregullimin e disa problemeve të cilët egzistojnë në systemin gjyqësor. Kjo nënkupton se në të ardhmen do të vazhdoj përdorimi më i madh i metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve përfshirë këtu medijacionin si metodë alternative e cila është më e përdorta nga gjith metodat jashtgjyqësore në SHBA, dhe nga ana tjetër nënkupton edhe përdorimin më të dobët të procedurës kontestimore si procedurë e rregullt gjyqësore.

2. Procedura e medijacionit në Australi

Në systemin juridik të Australisë, medijacion fillimisht është konsideruar si medijacion vullnetar. Rrënjët e karakterit vullnetar të zgjidhjes alternative të kontesteve në Australi hasen qysh nga koha kur “në Australi janë përdorur disa forma jasht-gjyqësore të zgjidhjeve të kontesteve që nga kohrat koloniale nëpërmjet të dispozitave të arbitrazhit të trashëguara nga e drejta Angleze dhe nga krijimi gjykatave joformale dhe të sistemit të ombudsmanit”⁴³¹. Kjo procedurë gjithmon është zbatuar atëherë kur për të kanë vendosur palët pa mar parasysh a ka filluar të zbatohet para ose pas inicimit të procedurës kontestimore. Por ekspertët e kësaj fushe vërejtën se egzistojnë vështirësi gjat zbatimit të medijacionit përshkak të karakterit vullnetar të tij, kështu filluan edhe të ndërmren masa për t’u përmirësuar situata e tillë. Hapi parë i cili u ndërmor ishte ajo i vitit 1976 me sjelljen e Ligjit për gjykatën federale të Australisë⁴³². Me këtë ligj gjyqtarët autorizohen që gjat procedurave kontestimore të cilët janë duke u zbatuar, t’i udhëzojnë palët që për gjith pjesën ose vetëm një pjesë të procedurës kontestimore e cila zbatohet të drejtohen tek medijatorët për zgjidhje të kontestit në rrugë të medijacionit⁴³³. Hapi i ardhshëm për vendosjen e medijacionit të detyrueshëm ishte vendosja e programit për

atëherë shpenzimet për seancë për palën të cilët duhet t’i mbuloj janë 120 dollar, ndërsa nëse ka të ardhura më pak se 50.000 dollar atëherë 60 dollar do ti kushtojnë shpenzimet palës për një seancë të medijacionit. Në Detorit Michigan, shpenzimet përcaktohen në orë. Çmimi i orës së medijatorit varion nga 150 deri në 350 dollar varësisht prej asaj sa e komplikuar është çështja kontestuese, rezultati i cili arihet si dhe faktorët tjerë.

⁴³¹ Spencer. D, Brogan. M, (2006), Mediation Law and Practice, Cambridge University Press, Cambridge, fq. 31

⁴³² Federal Court of Australia Act. 1976

⁴³³ Section 53A of Federal Court of Australia Act 1976

medijacionin e detyrueshëm në Australi e cila filloi gjat vitit 1980 të cilët edhe u paraqitën edhe para gjykatave federale të Australisë. Nxjerja e Ligjit për zgjidhje të kontesteve civile⁴³⁴ e viti 2011 e cila kishte të vetmen qëllim, dhe atë të arritjes të fitimit të bindjes tek qytetarët që të ndërmarin veprime për zgjidhje të kontesteve para se të inicohen procedurat kontestimore në lidhje me kontestin e caktuar. Qëllimi i kësaj ndërmarje të veprimit të qytetarëve ishte që të “ndalohet shpenzimi i kohës dhe i parave”⁴³⁵. Si parakusht i cili për t’u tentuar që kontesti i palëve të zgjidhet me anë të ndonjëres nga metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve përfshirë këtu edhe medijacionin si metodë e tillë, palët duhet të ndërmarin një veprim e cila lejon iniciimin e medijacionit para se ato të inicojnë procedurë kontestimore para gjykatës kompetente. Bëhet fjalë për dhënien e deklaratës⁴³⁶ e cila duhet të përcaktoj se cilët hapa janë ndërmarë nga palët për zgjidhjen e kontestit dhe arsyet se përse asnjë hap nuk është ndërmarë. Gjat përshkrimit të hapave të cilët mendohen të ndërmiren për zgjidhjen e kontestit nga ana e palëve, kjo deklaratë mund të përmbaj edhe medijacionin si mënyrë të cilët palët dëshirojnë që ta zgjidhin kontestin e tyre duke mos u përfshirë në procedurën e gjatë dhe të shtrejtë gjyqësore⁴³⁷. Ndërmarja e hapave të cilët deklarohen nga palët janë të rëndësishme për mbarvajtjen e procedurës të zgjidhjes së kontestit të tyre, si dhe një detyrim i palëve të cilët gjat gjithë kohës sa zgjat procedura të cilën ato kanë zgjedhur që ta zgjidhin kontestin jashtë gjykatës respektivisht në procedurën e medijacionit por edhe detyrim i gjykatës që gjat gjith kohës të qëndroj si vëzhgues se a ndërmiren hapat ashtu siç palët i kanë deklaruar në deklaratën e parashtruar. Kështu nëqoftë se pala nuk ndërmer ndonjëren prej hapave respektivisht veprimeve ashtu se si është deklaruar ose edhe nëse nuk mer pjesë në medijacioni ose e anulon medijacion përshkak të veprimeve ose mosprezencës së tij, atëherë gjykata ka të drejtë që palën ta sanksionoj në atë mënyrë duke i’u vënduar në barrë të tij i gjith shpenzimet procedural të medijacionit përfshirë edhe shpenzimet e procedurave kontestimore të cilët do të pasojnë pas kësaj⁴³⁸.

⁴³⁴ Civil Dispute Resolution Act of 2011

⁴³⁵ F. Ali. Sh, op. cit, pika 9.2.1

⁴³⁶ Sipas pikës së katër të Ligjit për zgjidhje të kontesteve civile janë të paraparë të gjitha procedurat të cilët janë të përjashtuara tërësisht nga zgjidhja me metoda tjera të zgjidhjeve të kontesteve përveç se në procedurë kontestimore, për të cilat nuk është e nevojshme që të jepet deklaratë ndërsa për ato procedura të cilët janë pjesërisht të përjashtuara nga zgjidhja me anë të metodave tjera përveç se në procedurë kontestimore, është e lejuar që deklarat nga palët të jepet vetëm për atë pjesë të procedurës e cila nuk është e përjashtuar, <https://www.legislation.gov.au/Details/C2011A00017>

⁴³⁷ Ibid, pika 9.3.1

⁴³⁸ Ibid

Në Australi janë palët ato të cilët vet e zgjedhin medijatorin. Pasi që palët të bien dakord me orarin dhe me procedurën e medijacionit në përgjithësi, medijatorët e gjykatës ndjekin disa hapa të strukturuar ndaj medijacionit. Gjat kësaj faze përfshihet mirëseardhja nga ana e medijatorit dhe deklarata haëpse⁴³⁹. Medijatori duhet të kujdeset për diskrecionin gjat gjith procedurës por edhe pas përfundimit të saj e cila është një veçori që e bën të veçantë procedurën e medijacionit nga procedurat tjera të zgjidhjeve të kontesteve si gjyqësore ashtu edhe jashtgjyqësore në të gjitha vendet e botës përfshirë këtu edhe medijacionin në Australi. Në rastet kur takimet me palët mbahen ndarazi, palët tregojnë verzionin e tyre të çështjes kontestuese dhe me këtë rast tregojnë edhe nevojat e tyre. Ajo që e bën medijatori që sa më lehtë dhe më pa dhimbje të tejkalojnë kontestin palët është mënyra se si do t'i përmbledh thëniet e palëve duke mos lejuar që ato të tingëllojnë në mënyrë fyese për palën tjetër kundërshtare⁴⁴⁰. Procedura e medijacionit dhe takimet e medijatorit dhe palëve gjithmon realizohen nëpër salla takimesh dhe salla të cilët do të ofrojnë komoditet dhe një atmosferë më të qetë për palët. Këto salla janë të vendosura jasht objektit gjyqësor.

Edhe pse në sistemin juridik të Australisë, medijacioni mundet të inicohet si medijacion i vullnetshëm kur palët vet me iniciativën e tyre e inicojnë procedurën e medijacionit, por edhe si medijacion gjyqësor i detyrueshëm – *mandatory court mediation* kur gjykata i udhëzon palët në medijacion gjat gjith procedurës kontestimore. Si zakonisht gjykata i udhëzon palët gjat fazave fillestare të procedurës kontestimore. Kur palët vendosin për inicim të procedurës së medijacionit, gjykata do ta anuloj seancën e cila ishte në rradhë për tu mbajtur dhe në urdhërin e tij do të caktoj afatin kohor brenda të cilit procedura e medijacionit duhet të përfundoj. Nëqoftë se palët nuk mundën që në procedurë të medijacionit të gjejnë ndonjë zgjidhje të përbashkët për çështjen kontestuese të tyre, atëherë procedura kontestimore e cila është vënë në pritje nga ana e gjykatës do të vazhdoj. Ndërsa kur procedura e medijacionit tregohet e suksesshme dhe vjen deri në lidhjen e marrëveshtjes ndërmjet palëve, marrëveshtja e tillë do të inkorporohet në procesverbal. Detyrim ligjor nuk kanë as palët e as medijatori që marrëveshtjen e arritur në

⁴³⁹ Deklarata hapëse përcakton rrugën nëpër të cilën do të ec procedura e medijacionit. Nga medijatorët kërkohet që palët të jenë të lirë sidomos atëherë kur duhet të parashtrihen pyetje në lidhje me procedurën e medijacionit për të cilën medijatori është gjithmon i gatshëm dhe në dispozicion që të eliminoj frigën dhe dyshimet e palëve kundrejt procedurës së medijacionit.

⁴⁴⁰ Kur medijatori do ta shoh si të përshtatshme momentin, mundet që të arrijë që të identifikoj bazat dhe nevojat e përbashkëta për të dy palët dhe të punoj drejt ndihmës së palëve që të zbulojnë dhe gjejnë zgjidhjet të cilët mundën t'i aplikojnë për zgjidhjen e kontestit të tyre. <https://web.archive.org/web/20070928163824/http://www.leadr.com.au/ROBSON.PDF>

procedurë të medijacionit t'ia dërgojnë gjykatës që i njehti ta vërtetoj atë dhe ti jep fuqi juridike. Kjo varet nga “palët që kërkojnë nga gjykata që ta shënoj marrëveshtjen në procesverbal që të fitoj të njejtën fuqi juridike si vendimi gjyqësor dhe të konsiderohet e detyrueshme”⁴⁴¹.

3. Procedura e medijacionit në Hollandë

Ideja për futjen e ndërmjetësimit në sistemin juridik të Hollandës paraqiste një interes të madh si për qeverinë e Hollandës nga e cila kërkoheshin reforma në gjyqësor, njëkohësisht për gjyqësorin, avokatët gjithashtu si dhe qytetarët të cilët do të përfitonin më së tepërmi nga këto. Për dallim nga shteti jonë, në Hollandë procedura e medijacionit funksionon dhe zbatohet edhe pse mungon ligji i cili i rregullon të gjitha çështjet e medijacionit duke filluar nga nocionet, parimet, procedura, shpenzimet e kështu me rradhë, ashtu siç është rasti me Republikën e Maqedonisë. Për atë shkak edhe mungon një definicion i vetëm i dhënë nga ligji. Këtu hasim shumë definicione të cilët jepen nga autorë të ndryshëm dhe të cilët mundohen të definojnë atë nga pikpamjet e tyre. Njëra prej tyre është dhe IMH (Instituti i medijacionit në Hollandë) e cila procedurën e medijacionit e përshkruan si “mënyrë e zgjidhjes të kontestit me ndihmën e medijatorit”⁴⁴² ku ky i fundit parashihet si pavarur dhe i pandërmjetshëm. Hapat e para të medijacionit në Hollandë hasen në vitin 1990⁴⁴³. Në vitin 1993 u themelua Instituti i medijacionit Holandez⁴⁴⁴ e lidhur me Ministrinë e Drejtësisë e cila kishte për qëllim që të zhvillimit, përparimit dhe informimit më të mirë dhe më të madh të medijacionit si metodë e zgjidhjeve të kontesteve jashtgjyqësore. Aktiviteti i parë i ministrisë për zhvilloj dhe zgjeroj konceptin e medijacionit ishte në vitin 1996 me *Platformën ZAK* os enë gjuhën angleze *Platform ADR*⁴⁴⁵. Qëllimin të cilën Ministrija e Drejtësisë dëshironte ta arrijë me anë të metodave alternative të

⁴⁴¹Ficks. E, Models of General Court-Connected Conciliation and Mediation for Commercial Disputes in Sweden, Australia and Japan, Deutsch-Japanische Juristenvereinigung e.V., Max-Planck-Institut für ausländisches und internationales Privatrecht, Nr. / No. 25 (2008), Haburg, fq. 139

⁴⁴²<http://www.nmi-mediation.nl>

⁴⁴³ Deri atëherë termi “medijacion” nuk egzistonte aspak në vokabularin juridik. Prej asaj periudhe medijacioni filloi që t'i zavendësoj mënyrat tjera të zgjidhjeve të kontesteve në mënyrë paqësore dhe jashtgjyqësore.

⁴⁴⁴*Netherlands Mediation Institute* – është një platformë nacionale e medijacionit në Hollandë e cila si organizatë private ka filluar me aktivitetin e tij që nga viti 1995. Ky institut ofron një platformë për konsultim multilateral në lidhje me medijacionin, infrastrukturë nacionale e aplikueshme për medijacionin në formën e rregullave dhe modeleve të medijacionit të unifikuar, rregullat për formën e akreditimit dhe regjistrimin e medijatorëve, përmban edhe rregulla për procedurën e mjeteve juridike dhe të ngjajshme.

⁴⁴⁵ Platforma ADR kishte për qëllim që të bëhen hulumtime nga ana e gjykatësve, avokatëve dhe juristëve, akademikve dhe përfaqësuesve nga ministrija gjithashtu me qëllim të vetëm – të eksperimentohet me medijacionin të aneksuar nga gjykata.

zgjdhjeve të kontesteve si mënyrë tjetër për zgjidhje të kontesteve, ishte të zvogëloj lëndët që kanë ngel të papërfunduara nëpërmjet të zgjidhjes të kontesteve jasht gjykatës në mënyrë me kualitative me anë të realizimit të formave të ndryshme përfshirë këtu medijacionin si formë më e shpeshtë e përdorur, me të cilët arrihet qasja sa më e lehtë dhe më e shpejt deri te e drejta.

Si rezultat i bashkpunimit të Institutit të medijacionit në Holandë dhe Ministrisë së Drejtësisë janë zbatuar dy pilot projekte e quajtur “Shumë rrugë deri te e drejta, dokument për politikën e zgjidhjes alternative të kontesteve 2000-2002” i cili dokument i’u paraqit parlamentit të Holandës për vlersim në të cilën shprehet karakteri kontesues i holandezve sii pashmangshëm ndërsa nga ana tjetër mosmarrëveshtjet janë në rritje e tepër, dhe për shkak të këtyre dy faktorëve preferohet në këtë dokument që tenotjnë ta zgjidhin kontestin përveç se në gjykatë edhe me anë të medijacionit me ç’rast do të zvogëlohet barra nëpër gjykata dhe do të zvogëlohet kohëzgjatja e zgjidhjeve të kontesteve⁴⁴⁶. Në këtë projekt nuk egzistonin kriteret të caktuara të cilët do të ndihmonin që të përcaktojnë lëndët kontestimore të cilët do të ishin të përshtatshme për tu zgjidhur me anë të medijacionit por potencoheshin tretregues: dëshira e palëve që të zgjidhin kontestin e tyre me anë të medijacionit dhe pritshmëria e rezultateve jo aq të mira nga përfundimi i kontestit me vendim gjyqësor respektivisht në procedurë kontestimore si dhe konfidencialiteti dhe mbajtja sekrete e të dhënave në procedurën e medijacionit⁴⁴⁷. Pritshmëritë e projektit ishin që palët të marin pjesë nëzgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit në mënyrë aktive dhe vullnetare pa patur asnjë kërcënim. Sipas këtij projekti medijacioni për palët është pa pagesë, respektivisht të gjithë shpenzimet procedural dhe shpërblimet e medijatorëve i mbulon Ministrija e Drejtësisë. Kjo paraqitet atëherë kur medijacioni urdhërohet nga gjykata në procedurë kontestimore dhe nëse lirohen në procedurë kontestimore nga shpenzimet procedurale. Por nëse nuk lirohen nga shpenzimet procedurale në procedurë kontestimore aëtherë për to dy e gjys orët e para konsiderohen pa pagesë ndërsa për vazhdimin e saj do të mbulohen shërbimet e medijatorit nga palët në mënyrë të barabartë. Ndërsa kur medijacioni inicohet pavarsisht inicimit

⁴⁴⁶ Ky projekt përbëhet prej dy pjesëve, *pjesa e parë* ka të bëjë me iniciimin e medijacionit nëpërmjet të gjykatës ndërsa pjesa e dytë nëpërmjet të ndihmës juridike. Sipas pjesës së parë të projektit medijacioni jepet si shërbim plotësues në procedurën kontestimore, me ç’rast gjykata i urdhëron palët në medijacionin pasi që të mar pëlqimin e tyre për një gjë të tillë. Nëse edhe pas kësaj medijacioni përfundon si i pasuksesshëm atëherë procedura kontestimore vazhdon. Ndërsa pjesa e dytë e cila ka filluar të zbatohet më von se sa pjesa e parë e projektit, ka të bëjë me të drejtën e palëve të cilët kanë të drejtë të zgjidhin kontestin e tyre me anë të medijacionit pa mar parasysh se a kanë të drejtë në ndihmë juridike.

⁴⁴⁷ Këto rregulla janë të përmbajtura edhe në neni 14, UNCITRAL Conciliation Rules, General Assembly Resolution 35/52 i vitit 1980. Ky parim i obligon medijatorin dhe palët kontestuese për një detyrim kontraktues ndërmjet tyre, duke nënshkruar marrëveshtjen për medijacion në fillim të procedurës së medijacionit.

të procedurës kontestimore kusht i vetëm i cili kërkohet nga projekti që duhet të plotësohet është që së paku njëri prej palëve të pranoj ndihmë juridike por mundet që edhe të dy palët të pranojnë ndihmë juridike. Në këto raste palët duhet të paguajnë një tarifë të caktuar e cila përcaktohet në bazë të të ardhurave të tyre⁴⁴⁸. Pra, Holanda për nga shpenzimet procedurale të procedurës së medijacionit është vendosur për një zgjidhje shumë interesante në krahasim me mënyrën e si mbulohe shpenzimet proceurale të medijacionit në Republikën e Maqedonisë.

Si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe në Hollandë procedura e medijacionit mundet të inicohet si para ashtu edhe pas inicimit të procedurës kontestimore ku udhëzimi i gjykatës për palët mundet të bëhet “me ftesë me shkrim, gojarisht në seancë gjat procedurës ose edhe me kërkesë të palëve”⁴⁴⁹. Edhe një veçori tjetër e cila e veçon Hollandën nga Republika e Maqedonisë është egzistimi i zyrtarëve të medijacionit të cilët ndodhen në secilën gjykatë të Hollandës dhe të cilët veprojnë në mënyrë aktive për të motivuar palët në procedurën kontestimore pas udhëzimeve të gjykatës për të zgjidhur kontestin e tyre me medijacion. Pra ato janë ura lidhëse e procedurës së medijacionit me procedurën kontestimore. Ato kanë për detyrë që t’i informojnë palët për medijacionin në përgjithësi, procedura se si zhvillohet dhe si mundet të jetë rezultati i saj përfundimtar, kush janë dhe si mundet të ndihmojnë medijatorët gjat procedurës së tyre. Gjithashtu çka është interesante palëve u ofrohen disa formular për vetëtestim në lidhje me procedurën e medijacionit e cila do t’u ndihmoj atyre që të vendosin përfundimisht për atë se a të inicojnë procedurë të medijacionit ose jo e të vazhdojnë me procedurën kontestimore nëse të njejtën veç e kanë inicuar, ose në rastet kur atë nuk e kanë inicuar ende, të vendosin që kontesti i tyre do të ishte më i përshtatshëm që të zgjidhet me anë të aktgjykimit të gjykatës të sjellë në procedurë gjyqësore. Në rastet kur palët vendosin për zgjidhjen e kontestit në procedurë të medijacionit por pasi që paraprakisht është inicuar procedura kontestimore, procedura kontestimore njejt sin ë Republikën e Maqedonisë ndërpritet dhe palët inicojnë procedurë të medijacionit, të cilën janë të obliguar që ta përfundojnë pa mar parasysht rezultatit final në afat prej tre muajve⁴⁵⁰. Veprimtaria e zyrtarëve të medijacionit nëpër gjykata është për t’u përshëndetur, një aktivitet i cili mungon në sistemin juridik të shtetit tonë dhe pse jo të huazohet nga praktika e medijacionit hollandez. Ato gjat gjithë kohës sa zgjat procedura e

⁴⁴⁸ Nëse pas procedurës së medijacionit i cili rezulton s ii pasuksesshëm, kjo tarifë nuk duhet të paguhet përsëri nga palët.

⁴⁴⁹ Combrink-Kuiters. L, Customized Conflict Resolution: Court-connected Mediation in the Netherlands 1999-2009, Judiciary Quarterly, Hagw, 2011, fq. 17

⁴⁵⁰ Ibid, fq. 22

medijacionit vëzhgojnë se si vijonë procedura e medijacionit e cila është udhëzuar nga gjykata i cili me vendim ka ndërprerë procedurën kontestimore me shpresë se palët do ta zgjidhin kontestin me medijacion. Qëllimi i vëzhgimit është që të vërtetohet se procedura e medijacionit do të përfundoj më shpejtë dhe nuk do ta kaloj afatin e caktuar nga gjykata. Gjithashtu vëzhgimi bëhet edhe që të informohet gjykata se si do të përfundoj procedura e medijacionit, me qëllim që të dij dhe vendos se çka do të bëj me procedurën e ndërprerë kontestimore – do të vazhdojë për gjithë kërkespadinë ose për vetëm një pjesë të kërkespadisë ose do të përfundoj e tëra përshkak të asaj se objekti i kërkespadisë në procedurën kontestimore është zgjidhur tërësisht në procedurë të medijacionit. Marrëveshtja për medijacion e arritur ndërmjet palëve sipas rregullit paraqet një kontratë të lidhur ndërmjet tyre dhe si e tillë nuk ka fuqi juridike dhe as mundet të bëhet e përmbarueshme⁴⁵¹.

4. Procedurat e medijacionit në sistemet juridike të ish-republikave të Jugosllavisë

4.1 Procedura e medijacionit në Republikën e Kroacisë

Në systemin juridik të Republikës së Kroacisë mënyrat alternative të zgjidhjeve të kontesteve nuk kanë ndonjë traditë të madhe dhe të lashtë, edhe pse tek tuku medijacioni në forma të ndryshe por jo në formën e pastërt si medijacion si p.sh pajtim në mosmarrëveshtjet martesore. Para sjelljes të ligjit e cila do të rregullonte medijacionin, njëra nga çështjet e cila ngriheshte si çështje diskutimi gati në të gjitha projektet të cilët organizoheshin për promovim të medijacionit në Republikën e Kroacisë, ishte rregullimi ligjor i medijacionit si dhe mundësia që edhe pa sjelljen e ligjit mbi medijacion kjo materije të rregullohet me zbatimin e pilot-projekteve pa mos patur një kornizë ligjore për medijacionin siç ishte shembulli i Hollandës të cilën e përpunua më lartë⁴⁵². Si rezultat i mungesës së përvojës nacionale në Republikën e Kroacisë u përpiluan disa modele ndërkombëtare në lidhje me medijacionin në të drejtën krahasuese si

⁴⁵¹ Nëqoftë se palët dëshirojnë që marrëveshtjes për medijacion t'i japin fuqi juridike dhe përmbaruese të njëjtë si vendimi gjyqësor atëherë atë mundën ta vërtetoj noteri në procesverbal apo të vërtetohet në aktgjykim gjyqësor nëse procedura e medijacionit është inicuar si rezultat i udhëzimit nga ana e gjykatës. <http://www.baseswiki.org/en/Netherlands.html#Mediation>

⁴⁵² Edhe pse nuk ishte sjellur ligji mbi medijacionin në Republikën e Kroacisë, përdorimi i medijacionit nuk ka qenë edhe i pamundur dhe i papërdorshëm pasi që në mënyrë analoge lejimin e medijacionit e kanë stimuluar Ligji mbi procedurën kontestimore - Zakon o parničnom postupku „Narodnenovine“, nr.53/91, 91/92, 58/93, 112/99, 88/01, 117/03, 88/05, 02/07, 84/08, 123/08, 57/11, 148/11, 25/13 i 89/14 dhe Ligji

Green Paper on alternative dispute resolution in civil and commercial law dhe UNCITRAL Model Law on International Commercial Conciliation. Hapa serioze për vendosjen e medijacionit në systemin juridik të Republikës së Kroacisë u hodhën atëherë kur ishte në fazë punimi hartimi i projekt ligjit për ndryshim të Ligjit mbi procedurën kontestimore, m'ç' rastpara organeve punuese të Qeverisë dhe Parlamentit të Republikës së Kroacisë u paraqit një propozim që Ligji mbi procedurën kontestimore të përmbante më shumë dispozita ligjore mbi medijacionin. Mirpo nga shkaku i vëllimit të zgjeruar të punëve të grupeve punuese të cilët mireshin me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi procedurën kontestimore, e sidomos numri i madh i propozimeve të cilët jepeshin në atë periudhë, shkaktonte pamundësinë që tëndiqen të gjithë propozimet një nga një dhe të ndryshohej dhe plotësohej gjith ajo që dëshirohej, si zgjidhje më e mirë e kësaj pune kaotike shiheshte në hartimin e një ligji të veçantë e cila do të rregullonte medijacionin se sa të ngarkohej teksti i ligjit mbi procedurë kontestimore e cila edhe pa u ngarkuar në mënyrë plotësuese veç se konsiderohet si një ndër ligjet më të mëdha për nga aspekti i numrit të neneve të cilët ajo i përmban. Kështu u bënë përpjekjet e hartimit të ligjit e cila do të rregullonte medijacionin dhe kështu medijacioni si mënyrë e zgjidhjes të kontesteve përfundimisht rrënjët e para i lëshoi në vitin 2003 me sjelljen e Ligjit mbi medijacion⁴⁵³. “Me këtë ligj rregulloheshte medijacioni në kontestet juridico-civile si: kontestete tregtare, juridiko-pronësore, të punës si dhe në të gjitha kontestete tjera në të cilët palët mundën që lirshëm ti disponojnë me të drejtat e tyre”⁴⁵⁴. Qëllimi i sjelljes të këtij ligji ishte qasja më e lehtë e medijacionit si mënyrë e zgjidhjes të kontesteve ndërmjet palëve, qasja e sigurt në medijacion si dhe ngritja e vetëdijes tek qytetarët që palët të zgjedhin procedurën e medijacionit për zgjidhje të kontesteve të tyre. Sa i përket rregullimit të medijacionit në Republikën e Kroacisë, medijacioni është i rregulluar vetëm me Ligjin mbi medijacion. Nga ana tjetër Ligji mbi procedurën kontestimore nuk përmban dispozita me të cilët rregullohet kjo materij. Sipas nenit tre të ligjit mbi medijacionit, medijacioni është çdo procedurë pa mar parasysh se a zbatohet në gjykatë, në

⁴⁵³Zakon o mirenju, Narodne Novine, nr. 163/03 dhe ligji i ri nr. 18/11 në të cilën në nenin 3 të këtij ligji parashihet që për të drejtat të cilët palët mundën vet t'i disponojnë lirshëm mundet të jenë objekt i marrëveshtjes dhe neni 321, al.3 ku gjykata do të mundet që gjat gjithë kohës sa zgjat procedura kontestimore ti informoj palët për mundësinë e marrëveshtjes dhe t'u ndihmoj të njejtëve që të arrijnë deri në një marrëveshtje dhe Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore – Zakon o obveznim odnosima, Narodne Novine, nr. 35/05, 41/08, 125/11 dhe 78/15 në të cilën parashihen: neni 19 me të cilën inkurajohet zgjidhja e kontesteve jashtgjyqësore dhe neni 102 në të cilën rregullohet situata e cila paraqitet kur procedura kontestimore nuk mundet të zbatohet nëse vjen deri në paraqitjen e kontestit pasi që palët janë mar vesh për zgjidhje të kontestit jash gjykatës.

⁴⁵⁴ Šimac, S. (2004), Zakon o mirenju – Pravni Okvir za Mirenje, Hrvatska pravna revija broj 3, fq. 121-126

ndonjë institucion për medijacion ose jasht saj në të cilët palët kërkojnë një zgjidhje miqësore të kontestsit të tyre më ndihmën e një ose më shumë medijatorëve që u ndihmojnë palëve që të arrijnë një zgjidhje pa autoritetin për t'ua imponuar palëve këtë zgjidhje si detyruese. Ligji gjithashtu parasheh edhe parimet e procedurës së medijacionit të cilët janë: parimi i inicimit vullnetar të procedurës së medijacionit, parimi i efikasitetit të procedurës, parimi i barazisë së palëve në procedurë, parimi i autonomisë së palëve në procedurë. parimi i konfidencialitetit të procedurës dhe paanshmërisë⁴⁵⁵.

Sipas ligjit mbi medijacion, medijatori definohet si person i cili në bazë të marrëvehtjes së palëve, është ai i cili e zbaton procedurën e medijacionit⁴⁵⁶. Si medijator në një procedurë të medijacionit mundën të paraqiten një ose më shumë medijator. Se kush do të zjidhet nga lista e medijatorëve si zbatues të procedurës së medijacionit varet nga vet palët. Neni 16 i ligjit mbi medijacion gjithashtu parasheh se medijator nuk mundet të jetë gjyqtari i cili ka qenë kompetent të vendos për lëndën kontestuese në procedurë kontestimore të ndërprerë e cila lëndë është objekt i medijacionit. Një ndër fazat e para të procedurës së medijacionit është caktimi i seancave në të cilët palët do të takohen dhe do të bisedojnë nevojat dhe interesat e tyre⁴⁵⁷. Gjat takimeve medijatori mundet që gjat gjithë kohës të propozoj mënyrën se sitë zgjidhet kontesti në mes palëve (neni 11 LM). Si rezultat i këtyre takimeve procedura e medijacionit varet edhe mënyra se si porcedura e medijacionit do të përfundoj⁴⁵⁸. Nëse procedura e medijacionit përfundon me lidhjen e marrëveshtjes ndërmjet palëve e cila do të jetë obliguese vetëm për palët nënshkruese të marrëveshtjes⁴⁵⁹. Gjithashtu ligji mbi medijacionin parasheh edhe përmbarueshmërinë e marrëveshtjes respektivisht të vendosjes së klauzulës për përmbarim nëse marrëveshtja e medijacionit ka të bëjë me ndonjë detyrim të caktuar. Kështu sipas nenit 13, al. 3 nëse marrëveshtja për medijacionin përmban klauzulën e përmbarimit, kur kalon koha për

⁴⁵⁵ Ligjit mbi medijacionin, neni 4, al. 2

⁴⁵⁶ Ligjit mbi medijacionin, neni 3

⁴⁵⁷ Ligjit mbi medijacionin në nenin 10 gjithashtu parasheh që takimet medijatori kur e shih të arsyeshme t'i mbaj edhe ndarazi, pra të mbaj takim me secilin prej palëve. Mbajtja e takimeve ndarazi është shumë e rëndësishme për rezultatin e medijacionit pasi që medijatori në këtë mënyrë mundet nga secila palë të mer informata të cilët në takimet e përbashkëta ndoshta nuk do t'i kishte marrë.

⁴⁵⁸ Ligjit mbi medijacionin në nenin 12 parasheh mënyrat e përfundimit të medijacionit dhe atë: kur njëra palë i ka dërguar palës tjetër deklaratë të shkruar se tërhiqët nga procedura e medijacionit; nëse palët i dërgojnë medijatorit deklaratë me shkrim për përfundim të procedurës; vendimi i medijatorit për të pezulluar procedurën e medijacionit pasi palëve u ishte dhënë mundësia të japin deklaratat e tyre dhe se përshkak se përpjekjet e mëtejshme për të zgjidhur një zgjidhje paqësore të kontestit nuk është më e arsyeshme; nëse marrëveshtja nuk përfundon brenda afatit prej 60 ditëve i cilia fat është i njëjtë si e procedurën e medijacionit në Republikën e Maqedonisë dhe kur procedura e medijacionit përfundohet me marrëveshtje për medijacion ndërmjet palëve.

⁴⁵⁹ Ligji mbi medijacionin, neni 13, al.1

përmbushjen e detyrimit dhe e njejta nuk përmbushet ngapala e cila është e detyruar ta bëjë atë, atëherë do të pasoj përbarimi i detyrueshëm. Palët mundet të vendosin që kjo marrëveshje të hartohet si akt notarial, pajtim gjyqësor ose vendim i arbitrazhit me bazë të marrëveshtjes. Që të mundet të konsiderohet e vlefshme lidhja e marrëveshtjes për medijacionin ajo duhet të lidhet në pajtim me nenin 13, al. 4⁴⁶⁰ sepse në të kundërtën për të nuk mundet të kërkohet përbarimi i detyrueshëm. Inicimi i procedurës së medijacionit në pajtim me Ligjin mbi medijacionin, nuk e humbin të drejtën e zgjidhjes të kontestit në rrugë gjyqësore përshkak të parashkrimit ose afateve prekluzive. “Kur me ligj e drejta e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës – padia është e kufizuar me afate prekluzive, ai afat fillon të rrjedh nga dita kur propozimi për procedurë të medijacionit është refuzuar ose konsiderohet e refuzuar, respektivisht kur pajtimi përfundon pa marrëveshje”⁴⁶¹. Ndërsa sai përket çështjes të shpenzimeve procedurale të medijacionit, palët mundet të miren vesht me medijatorin për mënyrë se si do të bëhet ndarja e barrës së shpenzimeve, ndërsa nëse palët nuk miren vesht paraprakisht për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve gjyqësore atëherë sipas rregullit secila palë do t’i mbulojë shpenzimet e veta, ndërsa shpenzimet e përbashkëta do t’i ndajnë në mënyrë të barabartë⁴⁶². Në mënyrë të njejtë rregullohet çështja e shpenzimeve procedurale të medijacionit edhe në Republikën e Maqedonisë.

4.2 Procedura e medijacionit në Republikën e Sllovenisë

Medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ka hyrë mjaft vonë në sistemin juridik të Republikës së Sllovenisë edhe pse si praktikë egzistonte qysh nga viti 2001 në të shumtën e rasteve si medijacion i aneksuar gjyqësor. Deri në hyrjen në fuqi të ligjit të parë mbi medijacionin, medijacioni në Republikën e Sllovenisë ka kaluar fazat e zhvillimit por pa patur një ligj e cila do të rregullonte këtë materije. Gjat këtyre fazave të zhvillimit të medijacionit, edhe pse me mungesë të rregullimit me një kornizë ligjore, kontribut të madh dhan pilot projektet të cilit kishin qëllimin e njejtë si në shtetet tjera në të cilët për së pari herë filloi promovimi i metodave alternative të zgjidhjes të kontesteve përfshirë këtu edhe medijacionit. Në Republikën e Sllovenisë, hapin e parë për vendosjen e medijacionit e bënë pikërisht gjykatat e jo institucionet

⁴⁶⁰ Marrëveshtja për medijacion nuk od të mundet të përbarohet nëse lidhja e marrëveshtjes nuk është e lejuar; kur ajo është e lidhur në kundërshtim me rednin publik ose nëse përmbajtja e saj është e pazbatueshme ose e pamundur.

⁴⁶¹ Šimac. S, op. cit, fq. 124

⁴⁶² Ligji mbi medijacionin, neni 20

shkencore si ishte rasti me SHBA – në. Kështu pilot-programi i parë i medijacionit të aneksuar nga gjykatat u shpall nga Gjykata e Qarkut në Lubljanë i cili më pastaj u prezentua edhe tek gjykatat tjera qarkore dhe lokale. Kështu, gjykatat kur shihnin nevojën e përballjes me mbingarkesën e gjykatave nga lëndë të mbetura ende të pazgjidhura, filluan përdorimin e këtyre programeve të cilët përmbanin rregulla për procedurën e medijacionit dhe parimet e saj identike të cilat përmbahen nga ligjet e veçanta të cilët rregullojnë medijacionin. Ligji mbi gjykatat⁴⁶³ parasheh se nëse një gjykatë konstaton se numri i lëndëve të mbetura pa zgjidhur nga gjykata është shumë i lartë, atëherë është obligim i kryetarit të gjykatës që të miratoj pilot-programin për zbatimin e medijacionit me qëllim që të arrihet zvogëlimi i lëndëve të mbetura të pazgjedhura nëpër tavolinat e gjyqtarëve⁴⁶⁴. Menjëherë pasi u formua medijacioni i aneksuar nga gjykata filloi të zhvillohet edhe medijacioni jashtgjyqësor, e cila u pasua menjëherë me krijimin e Shoqatës Sllovene të Medijatorëve⁴⁶⁵ dhe MEDIOS Shoqata e Organizimit të medijacionit në Slloveni⁴⁶⁶.

Në fillim të vitit 2008 një grup ekspertësh nga Fakulteti i Drejtësisë të Lubljanës dhe një grup praktikantësh u pregadit Propozim ligji mbi medijacionin⁴⁶⁷, drafti i parë i të cilit u pregadit duke u bazuar në UNCITRAL ligjin model në pajtimin ndërkombëtar tregtar⁴⁶⁸. Rezoluta e përgjithshme e Kuvendit të Kombeve të Bashkuara insiston që gjith shtetet duhet të shërbehen me ligjin model e cila do t'u ndihmojë në masë të madhe për krijimin e një kornize ligjore të

⁴⁶³ Zakon o sodiščih, Uradni list RS, št. 94/07 – uradno prečiščeno besedilo, 45/08, 96/09, 86/10 – ZJNepS, 33/11, 75/12 – ZSPDSLS-A, 63/13, 17/15, 23/17 – ZSSve, 22/18 – ZSICT in 16/19 – ZNP-1. Neni 62 i ligjit mbi gjykatat

⁴⁶⁴ Që të arrihet ky qëllim gjithashtu u bë një revolucion në gjyqësor me sjelljen e Ligjit për zgjidhjen alternative të kontesteve për çështjet gjyqësore e cila u miratua në vitin 2009, e cila i obligoi të gjithë gjykatat e shkallës së parë dhe shkallës së dytë që palëve t'u ofrojnë medijacionin në kontestet qoftë ato të natyrës familjare, tregtare ose të punës. Zakon o alternativnem reševanju sodnih sporov, ZARSS, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, Nr. 97/2009, 30 Nëntor, 2009

⁴⁶⁵ Kjo shoqatë u themelua në vitin 2006 me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të medijacionit dhe metodave tjera alternative të zgjidhjeve të kontesteve në Republikën e Sllovenisë. Selia e shoqatës ndodhet në Slloveni. <http://www.slo-med.si>

⁴⁶⁶ Kjo shoqatë është themeluar pak më vonë se Shoqata Sllovene e Medijatorëve respektivisht 23 prill të vitit 2008. Kjo shoqatë u krijua me iniciativën e Qendrës për Informim Ligjor të Organizatave Joqeveritare – PIC, Instituti Rakmo, Instituti për medijacion Concordia dhe Instituti për menaxhim dhe konsulencë, me qëllim kryesor që të ofroj organizatave medijacionin, ta zhvilloj kulturën e medijacionit sinë Slloveni ashtu edhe jashtë kufijve të Sllovenisë, si dhe të përpiloj standarde dhe rekomandime për kryerjen e procedurave të medijacionit dhe të organizoj dhe rregulloj trajnimin e medijatorëve. <https://www.medios.si>

⁴⁶⁷ Predlog Zakona o mediaciji v civilnih in gospodarskih zadevah, Ljubljana, 21.2.2008. Ajo në të cilën Propozim ligji mbi medijacionin insistonte në mënyrë të vazhdueshme, ishte se medijacionit nuk duhej të rregullohej në mënyrë të njejtë si procedura gjyqësore-kontestimore pasi që dalloj nga ajo si për nga fleksibiliteti ashtu edhe nga natyrë joformale e saj. Gjithashtu medijacioni si alternativë e procedurës gjyqësore duhet të mbrojt në mënyrë të njejtë të drejtat e palëve ashtu siç synon edhe procedura kontestimore.

⁴⁶⁸ The UNCITRAL Model Law on International Commercial Conciliation, 2002; Official Records of the General Assembly, Fifty-seventh Session, Supplement No. 17 (A/57/17), annex I.

harmonizuar për zgjidhjen e drejtë dhe efikase të mosmarrëveshtjeve sidomos të atyre që burojnë nga fusha e marrdhënieve ndërkombëtare tregtare⁴⁶⁹. Ligji mbi medijacionin në çështjet juridike dhe tregtare u miratua në 23 maj të vitit 2008 dhe hyri në fuqi në 21 qershor të po atij viti. Ky ligj u krijua si rezultat i punës pregaditore për ligjin mbi medijacionin e cila ishte vazhdimi e ligjit model si për nga struktura ashtu edhe përmbajtja. Medijacioni në Republikën e Sllovenisë i përket medijacionit të “modelit ligjot” dhe si e tillë paraqitet si vazhdimësi i gjykatës. “Medijatorët zgjidhen nga gjykata, ndërsa procedura e medijacionit zbatohet në hapsirat e gjykatës”⁴⁷⁰. Edhe pse medijacionit shohet si një procedurë e cila zbatohet nën hijen e procedurës kontestimore, këto dy procedura janë të ndryshme dhe zbatimi respektivisht inicimi i njëres ose tjetër nuk nënkupton ndonjë parakusht për iniciimin e procedurës tjetër respektivisht procedurës së medijacionit apo të procedurës kontestimore. Në ligjin mbi medijacionin më sakt në nenin gjashtë të këtij ligji është paraparë momenti kur një procedurë e medijacionit do të konsiderohet e inicuar. Atëherë kur palët janë pajtuar paraprakisht qënë rast të paraqitjes të kontestit të përbashkët, medijacionit do të filloj në ditën në të cilën palët e pranojnë propozimin për iniciim të procedurës së medijacionit nga pala kundërshtarë⁴⁷¹. Zgjedhja e medijatori bëhet nga vet palët, përjashtimisht nëse ato nuk mundën ta zgjedhin një i cili do të ishte i përshtatshëm për të dyja palët, kanë mundësi që t’i drejtohen ndonjë personi të tretë ose institucioni që ta bëj përzgjedhjen e medijatorit (neni 7). Ligji mbi procedurën kontestimore të Republikës së Kroacisë⁴⁷² gjykata gjat gjithë procedurës kontestimore sa ajozhvillohet, duhet që palëve t’ua tregoj mundësinë që ato kanë të zgjedhin kontestin e tyre me anë të arritjes së marrëveshtjes gjyqësore. Sipas nenit 305 al.1 të ligjit mbi procedurë kontestimore, gjykata cakton një seancë për arritjen e marrëveshtjes në mënyrë paqësore, në të cilën seancë palët i njofton edhe për përdorimin e medijacionit, të cilën palët e kanë në dispozicion si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Në këto seanca informimin për medijacionin mund ta bëj gjyqtari ose edhe asistenti i tij⁴⁷³. Nëqoftë se palët pranojnë që të tentojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të

⁴⁶⁹ Jovin Hrastnik. B, (2011), The Slovenian Legislation Implementing The EU Mediation Directive, Directorate General for Internal Policies, Brusel, fq. 10

⁴⁷⁰ Kis. Z, (2006), Mirenje u Republici Hrvatskoj i Republici Sloveniji, Pravni fakultet u Zagrebu, Zagreb, , fq. 8, <http://alanuzelac.from.hr/izborni/radovi/KisZHrvSlomed.pdf>

⁴⁷¹ Ligji mbi medijacionin në çështje civile dhe tregtare, neni 6, al.1

⁴⁷² Zakon o pravdnem postupku Uradni list RS, št. 73/07, 45/08 – ZArbit, 45/08, 111/08 – odl. US, 57/09 – odl. US, 12/10 – odl. US, 50/10 – odl. US, 107/10 – odl. US, 75/12 – odl. US, 40/13 – odl. US, 92/13 – odl. US, 10/14 – odl. US, 48/15 – odl. US, 6/17 – odl. US, 10/17 in 16/19 – ZNP-1

⁴⁷³ Ligji mbi zgjidhjet alternative të kontesteve në çështjet gjyqësore, neni 18

medijacionit atëherë gjykata do ta ndërpresë procedurën deri në tre muaj (neni 305 i LPK). Kështu në procedurat kontestimore gjykata u garanton palëve se do t'u jep hapsirë palëve që kontestin ta zgjidhin në procedurë të medijacionit deri në 3 muaj i cili afat fillon të rrjedh nga dita kur palët arrijnë marrëveshtjen për medijacion. Por nga ana tjetër as ligji mbi medijacion e as ai mbi procedurën kontestimore nuk parashohin ndonjë kufizim kohor për sa i përket afatit brenda të cilës duhet të përfundoj procedura e medijacionit e nisur pas inicimit të procedurës kontestimore. Kufizim nuk egziston as edhe për procedurën e medijacionit e inicuar pavarësisht inicimit të procedurës kontestimore. Pra, procedura e medijacionit zgjat aq sa është e nevojshme për palët që të zgjidhin kontestin e tyre, e cila pikë dallon nga procedura e medijacionit në Republikën e Maqedonisë, pasi që sipas ligjit mbi medijacion në shtetin tonë egziston kufizim kohor brenda të cilit palët së bashku me medijatorit duhet ta përfundojnë procedurën e medijacionit pavarësisht rezultatit të procedurës (neni 20, al. 2 LM të R. Maqedonisë). Ndërsa nëse palët nuk pranojnë vendimin e gjykatës për zgjidhjen e kontestit të tyre me medijacion, atëherë procedura kontestimore aspak nuk do të ndërpritet ndërsa procedura e medijacionit nga ana tjetër as që do të inicohet. Çështja e konfidencialitetit dhe ruajtjes secrete të të dhënave të cilët dalin si rezultat i takimeve të palëve në procedurë të medijacionit janë të rregulluara në nenet 10 dhe 11 të ligjit mbi medijacion. Sipas neni 10, medijatori të dhënat të cilët i fiton nga seancat e takimeve dhe bisedimeve me njërin palë mundet t'ia shpalosë palës tjetër nëse informata e cila i është dhënë medijatorit nga pala kërkohet që të mbahet si konfidenciale. Përderisa me nenin 10 rregullohet çështja e konfidencialitetit gjat procedurës së medijacionit, me nenin 11 rregullohet konfidencialiteti jasht procedurës së medijacionit, respektivisht ndalon dhënien e informacioneve të cilët burojnë direkt nga takimet e palëve palëve të treta, përjashtimisht nëse palët janë pajtuar për një gjë të tillë ose kur kjo gjë është e pamundshme për shkak të asaj se kërkohet përmbarimi i marrëveshtjes për zgjidhje të kontesteve. Sa u përket të dhënave, dëshmive dhe provave lidhur me çdo informacion e cila është fituar me anë të medijacionit nuk duhet t'i përdorin ato si prova dhe dëshmi në procedura tjera si p.sh procedurën e arbitrazhit ose procedurë gjyqësore. Përjashtimisht kjo gjë do të lejohet respektivisht do të lejohet një informacion i tillë të përdoret përpara gjykatës kompetente kontestimore, gjykatës së arbitrazhit osepara ndonjë organ ose autoritet tjetër vetëm nëse këtë ligji e kërkon⁴⁷⁴.Edhe në Republikën e Maqedonisë puna e konfidencialitetit është e rregulluar në mënyrë të njejtë në një

⁴⁷⁴ Ligji mbi medijacion, neni 12

nen të vetëm – neni nëntë. Sipas një studimi të kryer nga viti 1995 deri në vitin 1998, është konstatuar se deri në 80% të lëndëve të medijacionit është arritur marrëveshtja qysh në fazat e hershme të procedurës dhe atë në shumicën e rasteve në seancën e parë⁴⁷⁵. Kjo është një tregues i mirë se sa më herët bëhen tentimet për zgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit aq edhe pritshmëria e rezultatit të suksesshme është më e madhe. Për atë shkak edhe pilot-projektet për medijacionin insistonin që gjykatat palëve t'u ofrojnë mundësinë e zgjidhjeve alternative të kontesteve menjëherë sa ato paraqesin padinë në gjykatë.

Përmbaueshmëria e marrëveshtjes për medijacion në Republikën e Sllovenisë është e rregulluar në mënyrë analoge si nga Ligji mbi medijacionin në çështjet civile dhe tregtare (neni 14) ashtu edhe në Ligjin mbi procedurë kontestimore (neni 306 dhe 309) varësisht asaj se a bëhet fjalë për marrëveshtjet të cilët arrihen në procedurë të medijacionit përderisa rrjedh procedura kontestimore⁴⁷⁶, marrëveshtja gjyqësore në rastet e medijacionit jashtëgjyqësor⁴⁷⁷ dhe përmbaueshmëria e aktit noterial⁴⁷⁸.

Për dallim nga Republika e Maqedonisë, medijatorët në Republikën e Sllovenisë nuk janë të organizuar në Odën e medijatorëve por në shoqata të medijatorëve. Në raport me shpenzimet të paraqitura në procedurën e medijacionit në Republikën e Sllovenisë, vlejné të njejtat rregulla si për rregullimin e çështjes të shpenzimeve procedural të medijacionit në Republikën e Maqedonisë. Sipas nenit 18, al.1, medijatori ka të drejtë në shpërblim por edhe mbulim të shpenzimeve të cilët janë shkaktuar gjat zbatimit të procedurës së medijacionit. Se kush sa do t'i mbuloj ato shpenzimet varet nga marrëveshtja ndërmjet palëve. Mundet që për këtë palët të mos kenë rënë dakord, dhe në këto raste secila palë do t'i bartë shpenzimet e veta, ndërsa ato shpenzime të cilët do të konsiderohen sit ë përgjithshme, do të barten nga të dyja palët në mënyrë të barabartë⁴⁷⁹.

⁴⁷⁵ Betetto. N, (2007), Court-Based Mediation and its Place in Slovenia, Public and Private Justice, Dispute Resolution in Modern Societies, Intersentia, Oxford, fq. 219, 220

⁴⁷⁶ Ligji mbi procedurën kontestimore në nenin 306 parasheh se palët të cilët mundet të lidhin marrëveshtje në secilën fazë të procedurës kontestimore, mundet të lidhin marrëveshtjen në formë të shkruar në dhe në formë të pajtimit gjyqësor menjëherë pas përfundimit të procedurës së medijacionit.

⁴⁷⁷ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 309, ku palët mundet të kërkojnë nga gjykata që marrëveshtjen të cilët ato e kanë arritur të bëhet e përmbaueshme në formë të lidhjes së pajtimit gjyqësor.

⁴⁷⁸ Zakon o notariatu Uradni list RS, št. 2/07 – uradno prečiščeno besedilo, 33/07 – ZSReg-B, 45/08 in 91/13, Palët mundet që marrëveshtjen të cilën e nënshkruajnë, të njejtën ta vërtetojnë tek noteri, me ç'rast dokumenti i tillë fiton fuqinë e dokumentit përmbaues.

⁴⁷⁹ Ligji mbi medijacion, neni 18, al. 2

4.3 Procedura e medijacionit në Republikën e Malit të Zi

Medijacioni në sistemin juridik të Malit të Zi është e rregulluar me Ligjin mbi medijacionin⁴⁸⁰ dhe Ligjin mbi procedurën kontestimore⁴⁸¹. Medijacioni për së pari herë u vendos në sistemin juridik të Republikës së Malit të Zi në vitin 2004 me sjelljen e Ligjit mbi procedurën kontestimore i cili në nenin 369 parasheh mundësinë e ndërprerjes të procedurës kontestimore që ka gjykatësi kur vleron se kontesti mundet me sukses të zgjidhet me anë të medijacionit me ç'rast palët i udhëzon që kontestin e tyre të provojnë ta zgjidhin në procedurë të medijacionit me ndihmën e medijatorit. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit mbi procedurë kontestimore, në vitin 2005 u soll Ligji mbi medijacionin i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2012 dhe me të cilën rregullohet procedura e medijacionit në kontestet juridiko-civile⁴⁸². Me sjelljen e ligjit mbi medijacionin u bë një ndryshim për sa i përket procedurës kontestimore dhe autorizimeve të gjyqtarëve në procedurë kontestimore. Për dallim nga ligji mbi procedurë kontestimore, ligji mbi medijacionin në Republikën e Malit të Zi parashihte obligimin e gjykatave që palët në procedurë kontestimore t'i udhëzojnë në takim me medijatorin në raste të caktuara⁴⁸³. Në ligjin mbi medijacion kjo situatë njihet me emrin "medijacion i detyrueshëm" (neni 27a). Sipas ligjit nëse palët veç më kanë tentuar që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit por nuk kanë pasur asnjë sukses dhe për këtë gjë ato i dorëzojnë gjykatës prova për të vërtetuar se kanë inicuar procedurë të medijacionit para inicimit të procedurës kontestimore, atëherë gjykata nuk do t'i udhëzojë palët që të mbajnë takim me medijatorin.

Menjëherë pas sjelljes të Ligjit mbi medijacionin, janë ndërmarë edhe hapa tjera të cilët në aspektin juridik e plotësojnë kornizën ligjore të medijacionit në Republikën e Malit të Zi⁴⁸⁴. Një prej hapave të tilla është edhe formimi i një komisioni i formuar sipas propozimit të

⁴⁸⁰ Zakona o posredovanju, "Službeni list Republike Crne Gore", nr. 030/05, 29/12

⁴⁸¹ Zakon o parničnom postupku, " Službeni list Republike Crne Gore", br. 22/2004, 28/2005 - odluka US i 76/2006 i br. 47/2015 - dr. zakon, 48/2015, 51/2017, 75/2017 - odluka US, 62/2018 - odluka US, 34/2019 i 42/2019 - ispr.

⁴⁸² Ligji mbi medijacionit në nenin 1 parasheh se medijacionit është i përshtatshëm që të zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve familjare, tregatë, të punës dhe marrëdhëniet tjera juridiko-pronësore sit ë personave fizik ashtu edhe personave juridik si dhe marrëdhëniet me element të huaj ose ato ndërkombëtar.

⁴⁸³ Si raste të caktuara me ligjin mbi medijacionin në nenin 27a parashihen: rastet të cilët janë të parapara me ligj; kur gjykata vleron se kjo është në interes të fëmijës të drejtat dhe interesat e të cilit janë lëndë e procedurës; kur është inicuar procedurë për kontestet juridiko-pronësore në të cilën kërkohet të përmbushet ndonjë detyrim dhe atë: kontestet në të cilën është e paditur Republika e Malit të Zi; kontestet me vlerë të vogël; kontestet tregtare; kontestet në të cilën njëra palë kundërshtare është e përbërë nga më shumë se pesë palë dhe kontestet për ndarjen e pronës së bashkëshortëve.

⁴⁸⁴ Rregullorja për trajnim të medijatorëve dhe Rregullorja për mënyrën e mbajtjes të regjistrave për medijacion, "Službeni list Republike Crne Gore", nr. 18/03 dhe 146/04

Ministrisë së Drejtësisë të Malit të Zi për emrim dhe shkarkim të medijatorëve si dhe krijimi i Qendrës për medijacion⁴⁸⁵ e cila për dallim të Republikës së Maqedonisë në të cilën hapja e një qendre të tillë u promovua në korik të këtij viti, në Mal të Zi qendra për medijacion është themeluar qysh nga viti 2008. Themelimi, kompetencat, organet, aktet, financimi dhe mbikqyrja e qendrës është e rregulluar me ligjin mbi medijacion nga neni 11a deri në nenin 11 f. Me themelimin e Qendrës për medijacion udhëheqjen me projektin për medijacion në Malin e Zi kaloi nga Ministrija e Drejtësisë në duart e Qendrës për medijacion. Si rezultat i kësaj në vitin 2004 hyri në fuqi edhe Kodi etik i medijatorëve⁴⁸⁶ e cila hynte në kompetencat e qendrës. Përveç kësaj qendra për medijacion i përfaqëson dhe mbron të drejtat dhe interesat e medijatorëve, siguron kushtet dhe ndihmë për zbatimin e procedurave të medijacionit, kryen trajnime si për medijatorët ashtu edhe për gjykatësit, prokurorët dhe avokatët në përputhje me programin për trajnim, përgadit edhe manual profesionale, informatorë dhe botime tjera në fushën e medijacionit, gjithashtu organizon konferenca profesionale dhe shkencora nga kjo fushë, bën promovim të medijacionit për publikun e gjërë, lëshon çertifikata të trajnimeve të përfunduar për medijatorët dhe kryen punë tjera të caktuara me ligj.

Kreu 23 i ligjit mbi procedurën kontestimore i është dedikuar zgjidhjes paqësore të kontesteve respektivisht pajtimit gjyqësor dhe medijacionit. Sipas nenit 329, al.1 nëse gjykata vleron se kontesti mundet të zgjidhet me anë të medijacionit do ta ndërpresë procedurën kontestimore dhe palët do ti udhëzoj në procedurë të medijacionit. Afati brenda të cilit gjykata do të ndërpresë procedurën dhe do të pres që palët kontestin ta zgjidhin me anë të medijacionit, sipas ligjit është 60 ditë. Nëse palët brenda atij afati nuk arrijnë që ta zgjidhin kontestin e tyre atëherë gjykata do të caktoj seancë dhe kështu do ta vazhdoj procedurën kontestimore të ndërprerë⁴⁸⁷. Kjo është njëra nga mënyrat e inicimit të procedurës së medijacionit sipas ligjit mbi medijacion (neni 2). Mënyra e parë është ajo e inicimit të procedurës së medijacionit si rezultat i marrëveshtjes ndërmjet palëve që kontestin ta zgjidhin me medijacion. Kur palët në këtë marrëveshje veç më caktojnë mënyrën se si do të udhëhiqet procedura e medijacionit, medijatori

⁴⁸⁵ Qendra për medijacion u krijua nga Qeverija e Malit të Zi, Shoqata e medijatorëve dhe Banka Qendrore e Malit të Zi, me status të personit juridik e cila ka për detyrë të meret me punë profesionale dhe administrative në lidhje me medijacionin., "Službeni list Republike Crne Gore", nr.51/12. Qendra për medijacion është i përbërë nga këto organe: bordi i drejtorëve dhe drejtori ekzekutiv. Kontroll mbi punën e qendrës kryen Ministrija e Drejtësisë. <https://www.posredovanje.me>

⁴⁸⁶ "Službeni list Republike Crne Gore", nr. 146/04

⁴⁸⁷ Ligji mbi procedurën kontestimore të Malit të Zi, neni 329m al, 2

është i obliguar që procedura të zbatohet ashtu siç palët kërkojnë. Sipas rregullit, medijatori me palët komunikon gojarisht dhe mban takime të cilët mundet të jenë takime të përbashkëta ose takime ndarazi në të cilët takime përveç palëve mundet të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e tyre ligjor ose ato me prokurë respektivisht avokatët e tyre. Nëqoftë se gjat takimeve me palët të cilët zhvillohen ndarazi medijatori fiton ndonjë njohuri ose informacion relevant për zgjidhjen e kontestit, të njetën informacion mundet ta ndaj me palën tjetër kundërshtare përveç se në rastet kur informacioni i tillë është i karakterit konfidencial⁴⁸⁸.

Gjithashtu edhe sipas ligjit mbi medijacionin në Malin e Zi egziston mundësia që procedura e medijacionit të inicohet pavarësisht inicimit të procedurës kontestimore, respektivisht me propozim për inicim të procedurës së medijacionit. Kështu nëse pala konsideron që kontesti të zgjidhet me anë të medijacionit, palës tjetër në formë të shkruar i dërgon propozim për inicim të procedurës së medijacionit⁴⁸⁹. Nga pranimi ose mospranimi i këtij propozimi varet inicimi i procedurës kontestimore e cila si lënd do të ketë të njetën çështje kontestuese e cila ka qenë objekt i propozimit për inicim të procedurës së medijacionit. Kështu, sipas nenit 28 al. 2 nëse pala nuk deklarohe në lidhje me propozimin në afat prej 30 ditëve atëherë procedura e medijacionit do të konsiderohet si jo e inicuar dhe kështu pala e cila propozoi inicim të procedurës ka të drejtë që të inicoj procedurë kontestimore për të njetin kontest. Caktimi i medijatorit në Malin e Zi bëhet në disa mënyra varësisht asaj se a është inicuar para procedurës së medijacionit procedura kontestimore ose jo. Kështu, sipas rregullit gjithmon medijatorin e caktojnë palët. Por nëqoftë se palët nuk mundet të mirren vesht, ndërsa procedura kontestimore është ndërprerë me qëllim që palëve tu jepet mundësia që kontestin ta zgjidhin në medijacion, atëherë medijatorin do ta zgjidh gjykata nga lista e medijatorëve.⁴⁹⁰ Ndërsa në rastet kur procedura kontestimore nuk është inicuar para procedurës së medijacionit, ndihmë në lidhje me caktimin e medijatorit do t'u jep Qendra për medijacionit të cilët do të zgjedhin medijatorin nga lista e medijatorëve⁴⁹¹. Gjithmon gjat përcaktimit të medijatorit mirren parasysh shumë rrethana si p.sh rrethanat në lidhje me kontestin, karakteristikat e medijatorit apo edhe rrethanat të cilët paraqiten nëse kemi të bëjmë me njëkontest me element ndërkombëtar.

⁴⁸⁸ Ligji mbi medijacionin, neni 26, al. 1 dhe 2

⁴⁸⁹ Ligji mbi medijacionin, neni 28, al. 1

⁴⁹⁰ Ligji mbi medijacionin, neni 29, al. 3

⁴⁹¹ Ligji mbi medijacionin, neni 29, al. 4

Menjëherë pas caktimit të medijatorit bëhet caktimi i takimit të parë ndërmjet medijatorit dhe palëve. Sipas nenit 32 të ligjit mbi medijacion, data, koha dhe vendi i takimit për medijacionin e caktojnë palët me marrëveshje ose e cakton medijatori nëse palët këtë gjë nuk mundin ta caktojnë me marrëveshje. Në takimin për medijacionin bëhet njoftimi i palëve me medijatorin si dhe nga ai shpallet objekti i kontestit para palëve dhe çështjet të cilët duhet të zgjidhen ndërmjet palëve⁴⁹². Procedura e medijacionit sipas ligjit përfundon: kur arrihet një marrëveshje ndërmjet palëve; kur palët e pranojnë propozimin e medijatorit se vazhdimi i medijacionit nuk është më i arsyeshëm; në rastet kur njëra prej palëve heq dorë me deklaratë me shkrim drejtuar medijatorit, nga procedura e mëtutjeshme e medijacionit dhe në rastet tjera të caktuara me ligj⁴⁹³. Nëse procedura e medijacionit përfundon me arritje të marrëveshjes së përbashkët ndërmjet palëve atëherë me të përfundon edhe procedura e medijacionit. Nëse kjo marrëveshje vërtetohet në procesverbal nga ana e gjykatës, do të ketë fuqinë e njëjtë të cilën e prodhon edhe pajtimi gjyqësor (neni 36 LM). Në momentin kur procesverbalin paraprakisht të lexuar, palët e nënshkruajnë, atëherë konsiderohet se procedura e medijacionit është mbaruar me sukses. Marrëveshtja e tillë prodhon efekte si dokument përmbarues, kështu nëse me atë marrëveshje është vendosur për ndonjë detyrim të palës atëherë medijatori duhet t'ua sqaroj atyre efektin të cilën kjo marrëveshje mund ta prodhojë në rastet kur detyrimi nuk kryhet nga pala e cila është e ngarkuar për një gjë të tillë. Shpenzimet e procedurës së medijacionit ligji mbi medijacionin në Malin e Zërrë rregullon duke i përshtatur ato me disa aspekte të çështjes kontestuese e cila është zgjidhur me anë të medijacionit. Si rrethana të tilla meren parasysh natyra e komplikuar e çështjes dhe rëndësia e çështjes e cila është objekt i medijacionit. Ligji parasheh rastet kur palët lirohen nga pagesa e shpenzimeve të procedurës⁴⁹⁴, si dhe atë se palët shpenzimet individuale i mbulojnë individualisht ose sekush shpenzimet e veta ndërsa ato të përbashkëta i mbulojnë bashkarisht të ndara në mënyrë të barabartë. Në shumën e shpenzimeve të përbashkëta hyn edhe shpërblimi i medijatorit për punën dhe shërbimet të cilët i ka bërë gjat procedurës së medijacionit.

4.4 Procedura e medijacionit në Republikën e Serbisë

⁴⁹² Ligji mbi medijacionin, neni 33, al. 1

⁴⁹³ Ligji mbi medijacionin, neni 35

⁴⁹⁴ Ligji mbi medijacionin, neni 39, al. 2, Sipas këtij nen nëse palët janë të urdhëruar nga gjykata për inicim të procedurës së medijacionit, dhe nëse sipas rregullave të procedurës kontestimore sipas të cilëve palët lirohen nga pagesa e shpenzimeve të procedurës kontestimore, ato gjithashtu do të lirohen edhe nga pagesa e shpenzimeve të procedurës së medijacionit.

Në Republikën e Sërbisë egziston një raport i ngushtë i Ligjit mbi medijacion⁴⁹⁵ dhe Ligjit mbi procedurë kontestimore⁴⁹⁶ të cilët përmbajnë rregulla të përbashkëta për rregullimin e procedurës së medijacionit. Në Republikën e Sërbisë, medijacioni dhe procedura e saj janë të parapara në kornizat e parimit për zgjidhje paqësore të kontesteve të ligjit mbi procedurë kontestimore sipas të cilës palët dhe gjykata do të insistojnë para dhe pas inicimit të procedurës kontestimore që kontestet juridiko-civile të zgjidhen me anë të medijacionit ose në ndonjë mënyrë tjetër paqësore⁴⁹⁷. Të kthehmi pas në hapat e para që u ndërmorën me qëllim të vendosjes së medijacionit në sistemin juridik të Republikës së Sërbisë. Nevoja e vendosjes së medijacionit në sistemin juridik të këtij shteti kushtëzoheshte përshkak të përpunueshmërisë së ligjeve dhe standardeve ligjore të shtetit me ato të Bashkimit Evropian si dhe përshkak të qëllimeve të cilët dëshiroheshin të arrihen me këtë veprim, dhe atë: zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura në gjykatë, zvogëlimin e shpenzimeve të procedurës dhe kohëzgjatja e procedurës, rritja e cilësisë të zgjidhjeve të kontesteve dhe përfshirjes së palëve në procesin e zgjidhjes të kontesteve, gjë që do të rezultonte me përfshirjen e gjyqësorit në reformat bashkëkohore e sidomos do të shkaktonte rritjen e besimit të qytetarëve ndaj gjyqësorit. Kështu ky proces filloi me sjellejn e Ligjit për procedurë kontestimore i vitit 2004⁴⁹⁸ i cili në nenin 11 parashihte obligimin e palëve dhe gjykatës që para dhe pas inicimit të procedurës kontestimore të mundohen që kontestin ta zgjidhin me anë të medijacionit ose me ndonjërin nga metodat tjera paqësore. Me sjelljen e këtij ligji në fakt u hodh vetëm bazamenti mbi të cilës do të ndërtoheshte medijacioni si alternativë e gjykatës, por e cila nuk e përjashtoi nevojën e sjelljes së ligjit të veçantëe cila do të rregullonte medijacionin pasi që nuk ishte e mundshme që ligji për procedurë kontestimore të rregullonte edhe medijacionin përshkak të hapësirës së vogël që kishte. Kështu në vitin 2005 u soll Ligji mbi medijacionin⁴⁹⁹ e cila për lëndë rregullimi kishte vetëm medijacionin. Ky ligj në nenin 2, al. 3 medijacionin e definonte si çdo procedurë pa mar parasysh emërtimin e tij në të cilën palët dëshirojnë që marrdhënien kontestuese të tyre ta zgjidhin në mënyrë paqësore me ndihmën e një ose më shumë medijatorëve të cilët palëve do t'u ndihmojnë që të arrijnë një marrëveshje. Shumë shpejt filluan ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji

⁴⁹⁵ Zakon o posredovanju u rešavanju sporova, "Sl. glasnik RS", br. 55/2014

⁴⁹⁶ Zakon o parničnom postupku, "Sl. glasnik RS", br. 58/2003, 85/2003, 74/2005, 63/2007, 105/2008 - odluka US, 45/2009 - odluka US, 49/2009 i 61/2013

⁴⁹⁷ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 11

⁴⁹⁸ Zakon o parničnom postupku, „Sl. Glasnik RS“, br. 125/04

⁴⁹⁹ Zakon o posredovanju-medijaciju, "Sl. Glasnik RS", br.18/05

përshkak se koha tregoi se me sjelljen e këtij ligji nuk u arrit të ndërtohet një system i qëndrueshëm dhe stabil i medijacionit. Për shkak të paraqitjes të nevojës të përmirësimit dhe ndryshimit të shpeshtë të kornizës së mëparshme ligjore të medijacionit u paraqit edhe nevoja e sjelljes për një afat të shkurt të ligjit të ri për medijacion e cila do të ishte një version më i avancuar i ligjit të vjetër por i plotësuar me zgjidhje të reja të çështjeve të cilët me ligjin e vjetër nuk ofroreshin zgjidhje të plota. Kështu sjellja e Ligjit të ri mbi medijacionin⁵⁰⁰ erdh si rezultat i aplikimit më të suksesshëm të medijacionit në marrdhëniet kontestuese. Ligji aktual mbi medijacionin bëri zgjerim të fushës së veprimit të medijacionit respektivisht të kontesteve të cilët mundën të zgjidhen me anë të medijacionit. Kështu nëse sipas ligjit mbi medijacion të vitit 2005 medijacioni mundeshtë të përdoret në zgjidhjen e kontesteve juridiko-pronësore, tregtare, familjare, të punës dhe kontestet tjera juridiko-civile, administrative dhe penale të cilat palët mundën lirshëm t'i disponojnë⁵⁰¹, këtij numri të kontesteve me ligjin e ri aktual i'u shtuan edhe kontestet kundër mjedisit jetësor dhe kontestet konsumatore por ligji nuk e përjashton edhe emundësinë që me anë të medijacionit të mundën të zgjidhen edhe kundërvajtjet kundër kërkesave juridiko-pronësore.

Sipas nenit 18 të ligjit aktual mbi medijacionin, procedura e medijacionit konsiderohet e nisur kur palët ndërmjet veti lidhin marrëveshtjen për nisje të medijacionit⁵⁰². Kjo është atëherë kur palët dëshirojnë që të inicojnë procedurë të medijacionit para se të kenë parashtruar padi në gjykatën kompetente. Ndërsa në rastet kur procedura e medijacionit nisët si rezultat i ndërprerjes të procedurës kontestimore përshkak të udhëzimit të palëve nga gjykata që kontestin e tyre të mundohen ta zgjidhin me anë të medijacionit, atëherë procedura e medijacionit do të konsiderohet e inicuar atëherë kur para gjykatës do të dorëzohet marrëveshtja për medijacion të lidhur ndërmjet palëve. Zgjidhjen e medijatorit e bëjnë palët me anë të marrëveshtjes ndërmjet tyre. Gjithashtu me anë të marrëveshtjes ato vendosin edhe për numrin e medijatorëve të cilët do ta zbatojnë procedurën e medijacionit. Ndërsa nëse ato nuk mundën të arrijnë marrëveshtje për caktimin e medijatorit, atëherë ato mundën që nga gjykata e cila ka ndërprerë procedurën

⁵⁰⁰ Zakon o posredovanju u rešavanju sporova, "Sl. Glasnik RS", br.55/14

⁵⁰¹ Ligji mbi medijacionin i Republikës së Sërbisë të vitit 2005, neni 1, al. 1

⁵⁰² Marrëveshtja për medijacion lidhet në formë të shkruar me të cilën caktohet medijatori, rregullohen të drejtat dhe obligimet e palëve dhe medijatorit në pajtueshmëri me parimet e medijacionit, caktohen shpenzimet të cilët do të shkaktohen në procedurën e medijacionit dhe çështje tjera të cilët janë të rëndësishme për zbatimin e procedurës së medijacionit.

kontestimore deri satë perfundoj procedura e medijacionit të caktohet medijatori⁵⁰³. Medijatori gjat zbatimit të procedurës së medijacionit do të caktoj edhe takimet të cilët do t'i bej me palët, të cilët njëjtë sinë Republikën e Maqedonisë mundet të jenë të përbashkëta ku mund të marin pjesë të dy palët ose mundet të bëhen ndarazi për secilën palë, porkjo nuk e përjashton faktin se informacionet të cilët medijatori do t'i mer nga secila palë t'ia tregoj palës tjetër kundërshtare (neni 23, al.3 LM 2014). Në Republikën e Sërbisë, nisja e procedurës së medijacionit nuk shkakton ndërprerje të afateve të parashkrimit dhe e njëjta nuk ndikon as edhe në afatet prekluzive për inicim të procedurës kontestimore, përveç se në rastet kur medijacionit paraqitet si kusht procedural për inicimin e procedurës kontestimore⁵⁰⁴. Sa i përket afatit brenda të cilit duhet të përfundoj procedura e medijacionit, neni 26 al. 1 e ligjit aktual mbi medijacionin parasheh afat prej 60 ditëve, afat ky i njëjtë si në Republikën e Maqedonisë (neni 16 al. 1 LM). Afati prej 60 ditëve parashihet edhe si afat i cili në qoftë se kalohet atëherë do të shkaktoj përfundim të procedurës. Këtë afat ligjvënësi e ka vendosur si afat optimal për të arritur një marrëveshje për kontestin e caktuar. Mirpo ligjvënësi ka lënë një mundësi që edhe në rast të tejkalimit të këtij afati procedura të vazhdoj, nëse palët miren vesht për një gjë të tillë⁵⁰⁵. Ligji gjithashtu parasheh edhe mënyrat se si përfundohet procedura e medijacionit (neni 24, al.1). Një prej atyre mënyrave është edhe me anë të lidhjes së marrëveshjes për medijacion me të cilën palët arrijnë që të zgjidhin kontestin e tyre. Marrëveshjet e tilla do të fitojnë fuqinë e një dokumenti ekzekutiv nëse plotësohen disa kushte dhe atë të përmbaj klauzolën për përmbarrim dhe nëse nënshkrimi i marrëveshjes të vërtetohet nga gjykata ose noteri. Në këtë mënyrë palët munden të kërkojnë përmbarrim në procedurë përmbarruese pa patur nevojë që të inicojnë procedurë kontestimore. Kjo dispozitë nuk është detyruese për palët respektivisht për çdo marrëveshje e cila arrihet të lidhet në procedurë të medijacionit, porkjo paraqet një siguri për palët se një mundësi e tillë egziston dhe kjo e liron atë që në të ardhmen të mos inicoj procedurë kontestimore për mos përmbushjen e detyrimit të palës. Për nga aspekti i shpenzimeve procedural, është paraparë që secila palë i mbulon shpenzimet e veta, ndërsa shpenzimet e përbashkëta e cila edhe përmban edhe shpërblimin e medijatorit për punën e kryer do të mbulohen bashkarisht nga palët në pjesë të barabarta, nëse nuk janë marrë vesht ndryshe⁵⁰⁶.

⁵⁰³ Ligji mbi medijacion të vitit 2014, neni 20, al. 2

⁵⁰⁴ Neni 25, Ligji mbi medijacionin 2014

⁵⁰⁵ Neni 24, al.1, pika 4 Ligji mbi medijacionin 2014

⁵⁰⁶ Neni 29 Ligji mbi medijacionin 2014

PJESA E PESTË

Hulumtimi i praktikës të zbatimit të medijacionit në Republikën e Maqedonisë


Metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve janë relativisht metoda të reja në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë dhe si të tilla palët para të cilëve në tavolinë u paraqitet mundësija e zgjedhjeve në mes tyre dhe procedurës gjyqësore, shpesh herë tërhiqen nga shkak i besimit të vogël të cilët kanë për medijacionin në zgjidhjen e kontestit të tyre. Ky besim shkaktohet nga frika e tyre se mundet të dëmtohen nëse kontestin e tyre e zgjidhin me anë të medijacionit. Për atë ato çdo herë zgjasin dorën tek procedura gjyqësore dhe gjyqtari në të cilën procedurë palët paditen gjykohen dhe në fund me anë të aktgjykimit jepet mbrojtja e nevojshme juridike dhe përcaktohet kush ka të drejtë e kush jo me ç’rast përcaktohet edhe detyrimi për njërën prej palëve. Një prej arsyt edhe përse u vendos për një temë të tillë të shtjellohet dhe përpunohet në dizertacionin e doktoraturës ishte fakti se në Republikën e Maqedonisë kjo metodë e zgjidhjes paqësore të kontesteve është shumë pak e hulumtuar në literaturën juridike në krahasim me shtetet në të cilët medijacionit zbatohet shumë më gjatë se sa në shtetin tonë. Kjo pjesë e punimit do t’i kushtohet përpunimit të të dhënave të fituara me anë të metodave empirike përkatësisht metodës statistikore, metodës së analizës së përmbajtjes dhe anketës.

VII Paraqitje statistikore të zgjidhjes të kontesteve me anë të medijacionit nga viti 2016 deri më sot në Republikën e Maqedonisë

Me qëllim që të arrijmë deri në përfundime të cilët do të na ndihmojnë që të kemi një pasqyrim më të qartë në lidhje me situatën e cila mbizotron sot në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë në lidhje me procedurat e medijacionit, vend të rëndësishëm ndër metodave empirike i është dhënë metodës statistikore me të cilën do të vërejmë sa procedura të medijacionit janë zbatuar ndër vite, sa janë të përmyllura me sukses e sa jo, ç’far konteste kanë qenë ato, qëllimet e paraqitjes të kontesteve, nga cilët medijator janë zbatuar ato procedura, palët në procedurë të medijacionit kanë qenë persona fizik ose juridik, mënyrat e përfundimit të

procedurave të medijacionit, kohëzgjatja e tyre e të ngjajshme. Më poshtë do të paraqiten të dhënat statistikore⁵⁰⁷ nga viti 2016 nga i cili vit edhe u paraqit obligimi ligjor i medijatorëve që të paraqesin të gjitha procedurat e inicaura dhe të përfunduara me marrëveshje ose pa arritjen e marrëveshjes për medijacion deri më sot.

Nga viti 2016 deri në shtator të vitit 2019 janë zbatuar gjithsej 1462 procedura të medijacionit. Në përshkrim me anë të grafeve kjo gjendje e procedurave të medijacionit duket



kështu:

Grafikoni nr. 1: Totalii procedurave të medijacionit të zbatuara ndër vite

Nga numri i përgjithshëm prej 1462 i lëndëve për të cilët janë inicuar procedura të medijacionit, 1105 procedura të medijacionit kanë qenë të suksesshme ndërsa 357 procedura të medijacionit kanë qenë të pasuksesshme respektivisht kanë përfunduar pa mos u lidhur marrëveshje për medijacion.

⁵⁰⁷ Të dhënat u siguruan nga Ministrija e Drejtësisë në bazë të kërkesës për sigurimin e të dhënave për lëndë të zgjidhura në procedurë të medijacionit e regjistruar me numër 09-5005/1 e 25.10.2018.

Në vitin 2016 ishin të paraqitur nga ana e medijatorët 64 lëndë nga të cilët 26 janë zgjidhur me marrëveshje për medijacion, ndërsa tek 38 lëndë zgjidhja me anë të medijacionit ka qenë e pasuksesshme.




Grafikoni nr. 2: Zgjidhja e kontesteve në vitin 2016

Kontestet të cilët kanë qenë lëndë e procedurës së medijacionit në vitin 2016 kanë qenë të gjithë kontestet tregtare.




Grafikoni nr.3: Baza e kontesteve në vitin 2016

Medijatorët të cilët kanë marrë pjesë në zbatimin e procedurave të medijacionit gjat viti 2016 kanë pasur selinë në Shtip ku janë zbatuar 36 procedura të medijacionit, në Kavadarci janë zbatuar 15 procedura të medijacionit, ndërsa në Shkup janë zbatuar 13 procedura të medijacionit.



Grafikoni nr. 4: Selija e medijatorëve

Si palë gjatë këtyre procedurave janë paraqitur persona fizik kundër personave fizik në një procedurë të medijacionit, person fizik kundër personit juridik në tre procedura dhe persona juridik kundër personit tjetër juridik në gjashtëdhjetë procedura të medijacionit.



Grafikoni nr. 5: Palë në procedurë të medijacionit në vitin 2016


Në vitin 2017, 982 lëndë janë paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë nga ana e medijatorëve në Republikën e Maqedonisë, nga i cili numër 902 procedura të medijacionit kanë përfunduar me sukses me lidhjen e marrëveshtjes për medijacion ndërmjet palëve, ndërsa 80 kanë përfunduar pa



sukses.


Grafikoni nr. 6: Zgjidhja e kontesteve në vitin 2017

Nga 982 lëndë të cilët janë paraqitur nga ana e medijatorëve, kontestet për të cilët janë inicuar procedura të medijacionit kanë qenë: konteste të punës, konteste tregtare, kontestet të sigurimit dhe konteste pronësoro – juridik.




Grafikoni nr. 7: Baza e kontesteve në vitin 2017

Në vitin 2017 kanë mbizotruar kontestet e punës dhe atë me 857 nga 982 konteste, nga i cili numër të gjithë kontestet janë zgjidhur me anë të medijacionit.




Grafikoni nr. 8: Kontestet e punës të inicuar me procedurë të medijacionit

92 kontestet kanë qenë konteste tregtare nga të cilët 19 janë zgjidhur me anë të marrëveshtjes për medijacion, ndërsa 73 konteste zgjidhja në procedurë të medijacionit ka qenë e pasuksesshme.




Grafikoni nr. 9: Kontestet tregtare të inicuar me procedurë të medijacionit

Edhe kontestet e sigurimit kanë qenë kontestet të cilët kanë qenë lëndë e zgjidhjes në procedurë të medijacionit nga ana e palëve dhe me ndihmën e medijatorit. 32 kontestet kanë qenë konteste të sigurimit prej të cilëve 26 janë zgjidhur me anë të medijacionit ndërsa gjashtë konteste kanë qenë të pasuksesshme për sa i përket zgjidhjes me anë të medijacionit.




Grafikoni nr. 10: Kontestet e sigurimit të inicuar me procedurë të medijacionit

Si dhe një kontest në vitin 2017 ka qenë kontest pronoësor – juridik procedura e të cilit është përfunduar pa sukses.




Grafikoni nr. 11: Kontestet juridiko-pronësore të inicuar me procedurë të medijacionit

Medijatorët të cilët kanë qenë në krye të procedurave të medijacionit të cilët janë zbatuar brenda vitit 2017, kanë pasur seli në këto qytete: Kavadarci – 654 procedura, në Shtip ku janë zbatuar 13 procedura të medijacionit dhe në Shkup ku medijatorët kanë zbatuar 315 procedura të medijacionit.




Grafikoni nr. 12: Selija e medijatorëve

Palët të cilët kanë pasur kontest ndërmjet tyre dhe të cilët kanë zgjedhur procedurën e medijacionit për të zgjidhur kontestin e tyre kanë qenë: persona fizik kundër personit fizik në një procedurë të medijacionit, në 842 procedura të medijacionit si palë janë paraqitur persona fizik kundër personave juridik dhe në 139 procedura të medijacionit në cilësinë e palës kanë qenë persona juridik në të dyja anët.




Grafikoni nr. 13: Palë në procedurë të medijacionit në vitin 2017

Në vitin 2018 nga ana e medijatorëve në Republikën e Maqedonisë janë paraqitur 293 procedura nga të cilët 137 procedura janë kryer me sukses ndërsa në 156 procedura zgjidhja e kontestit me anë të medijacionit ka qenë i pasuksesshëm.




Grafikoni nr. 14: Zgjidhja e kontesteve në vitin 2018

Si bazë të kontesteve për të cilët në këtë vit është zbatuar procedura e medijacionit kanë qenë: konteste të punës, konteste tregtare, konteste nga sfera e sigurimeve dhe konteste juridiko – pronësore.




Grafikoni nr. 15: Baza e kontesteve në vitin 2018

Prej kontesteve të punës, për 66 konteste është inicuar procedurë e medijacionit dhe të gjitha janë përfunduar me sukses me arritjen e marrëveshtjes për medijacion ndërmjet palëve.




Grafikoni nr. 16: Kontestet të punës të inicuar me procedurë të medijacionit

Numri më i madh i kontesteve këtë vit kanë qenë konteste tregtare nga të cilët 68 konteste janë zgjidhur me anë të marrëveshtjes për medijacion, ndërsa në pjesën dërmuese të kontesteve, procedura e medijacionit ka qenë e pasuksesshme.




Grafikoni nr. 17: Kontestet tregtare të inicuar me procedurë të medijacionit

12 konteste në vitin 2018 kanë qenë kontestet nga sfera e sigurimeve prej të cilave tre janë zgjidhur me anë të medijacionit ndërsa në nëntë konteste nuk është arritur marrëveshja për medijacion ndërmjet palëve.




Grafikoni nr. 18: Kontestet e sigurimit të inicuar me procedurë të medijacionit

Numri më i vogël i kontesteve edhe në vitin 2018 i takon kontesteve juridiko – pronësore, respektivisht me një kontest i cili njejt si në vitin pasues nuk është zgjidhur me anë të procedurës së medijacionit.




Grafikoni nr. 19: Kontestet juridiko-pronësore të inicuar me procedurë të medijacionit

Sa i përket selisë së medijatorëve, në vitin 2018 shumica prej procedurave të medijacionit janë zbatuar në Shkup dhe atë 141 procedura të medijacionit, katër në Gjevgjeli, 50 në Kavadarci, 88 procedura të medijacionit në Shtip, tre procedura në Bogovinë dhe shtatë në Veles.



Grafikoni nr. 20: Selija e medijatorëve

Palë në procedurat e medijacionit në vitin 2018 kanë qenë: 4 procedura të medijacionit ku palë janë paraitur të dyja anët persona fizik, në 102 procedura, palë janë paraqitur në njërën anë personi fizik e në anën tjetër person juridik dhe në 188 procedura të medijacionit të dy palët kanë qenë persona juridik.




Grafikoni nr.21: Palë në procedurë të medijacionit në vitin 2018

Ndërsa për vitin 2019 të siguruar nga Ministrija e Drejtësisë janë të dhënat deri në muajin shtator. Deri atëherë medijatorët kanë paraqitur 123 procedura të medijacionit të inicuar. Nga ky numër 40 procedura janë të zgjidhura me marrëveshje për medijacion ndërsa dyfishi i saj konsiderohen të përfunduara pa sukses respektivisht 83 lëndë të cilët nuk janë arritur të zgjidhen me marrëveshje për medijacion.




Grafikoninr. 22: Zgjidhja e kontesteve në vitin 2019

Deri në shtator çështjet kontestuese janë qenë të natyrave të ndryshme njëjtë si në vitet tjera pasuese dhe atë: kontestet tregatere të cilët kanë mbizotruar me numër më të madh të procedurave të inicuar, konteste të sigurimit, kontestet të punës, kontestet civile dhe konteste pronësoror – juridike. Raporti ndërmjet tyre në shfaqje grafike duket kështu:



Grafikoni nr. 23: Baza e kontestit në vitin 2019

Nga 123 lëndë, 117 konteste kanë qenë tregtare nga i cili numër 38 kontestet janë zgjidhur me anë të marrëveshtjes për medijacion ndërmjet palëve ndërsa 73 konteste nuk janë zgjidhur me anë të medijacionit.



Grafikoninr. 24: Kontestet tregtare të iniciuara me procedurë të medijacionit

Konteste të sigurimit kanë qenë vetëm dy dhe të dyja kanë qenë të pasuksesshme për sa i përket zgjidhjes me anë të medijacionit si procedurë alternative e zgjidhjeve të kontestit.




Grafikoni nr.25: Kontestet të sigurimit të iniciuara me procedurë të medijacionit

Numër shumë i vogël në krahasim me vitin 2017 dhe 2018 të cilët karakterizoheshin me numër të madh të kontesteve të punës sidomos viti 2017, vërehet deri në shtator të vitit 2019 ku vetëm 1 kontest ka qenë i punës dhe e njëjta nuk është arritur që ndërmjet palëve të zgjidhet me anë të procedurës së medijacionit.




Grafikoninr. 26: Kontestet të punës të inicuar me procedurë të medijacionit

Dy konteste kanë paraqitur medijatorët si lëndë të procedurës së medijacionit nga i cili numër njëra nga procedurat është zgjidhur me sukses e tjetra nuk është zgjidhur me marrëveshje për medijacion.




Grafikoni nr. 27: Kontestet civile të inicuar me procedurë të medijacionit

Dhe në fund, vetëm një procedurë e inicuar e medijacionit ka pasur lëndë çështje kontestuese të natyrës juridiko – pronësore e cila fatmirësisht është zgjidhur me anë të marrëveshtjes për medijacion nga ana e palëve.




Grafikoni nr. 27: Kontestet juridiko-pronësore të inicuar me procedurë të medijacionit

Medijatorët të cilët kanë inicuar këto procedura të medijacionit deri në shtator të viti 2019 kanë pasur seli në Kavadarci ku janë inicuar 11 procedura të medijacionit, në Shkup ku janë inicuar 85 procedura të medijacionit, në Gostivar ku janë inicuar tre procedura të medijacionit, në Bogovinë me dy procedura të medijacionit, në Gjevgjeli janë inicuar 14 procedura të medijacionit dhe në Veles janë inicuar tetë procedura. Kjo gjendje në shfaqje grafike duket kështu:



Grafikoni nr. 28: Selija e medijatorëve



Grafikoni nr. 29: Palët në procedurë të medijacionit

Palët të cilët janë paraqitur në këto procedura kanë pasur cilësi si palë fizike nga të dy anët dhe atë në tre procedura të inicuar të medijacionit, në tre procedura të medijacionit palë kanë qenë person fizik dhe person juridik në anën tjetër dhe në 117 procedura të dy palët kanë qenë persona juridik.

Gjithashtu si rezultat i kërkesës time mu lejua që të kem qasje në regjistrat e evidentimit të procedurave të medijacionit të cilët nga viti 2016 mbahen në mënyrë elektronike. Gjatë kësaj u realizuan analiza më të detajuara për sa i përket faktorëve tjerë të cilë kanë ndikim shumë të madh në zbatimin e suksesshëm për procedurën e medijacionit. Një nga një u analizuan procedurat e medijacionit pa marrë parasysh rezultatit përfundimtar të tyre. Nga ajo analizë u konstatua se procedurat e medijacionit zgjatnin maksimum deri në 2 muaj, aq edhe sa është afati ligjor i paraparë me ligj brenda të cilit palët duhet të përfundojnë procedurën e medijacionit. Ndërsa minimum këto procedura zgjatnin nga katër ditë. Si palë nga viti 2016 siç edhe u theksua më lartë, ishin persona fizik ose persona juridik. Vetëm në dy raste respektivisht në dy procedura të medijacionit si palë u paraqitën persona juridik të huaj (Gjermanisë dhe Bosnës dhe Hercegovinës) ndërsa të tjerit ishin të gjithë persona fizik dhe juridik të vendit.

Si shkaqe të kontesteve tregtare më së tepërmi ishin të potencuara: kërkesa për kthimin e borxhit, kompensim të dëmit material, kërkesa për kthim të sendit, fitim i pabazë e të ngjajshme. Si kërkesa të cilët paraqiteshin nga palët me rastin e paraqitjes të kontesteve të punës në procedurë të medijacionit ishin: vërtetimi i të drejtës nga marrdhënija e punës dhe mënyra e pagesës së kërkesavë të marrdhënieve të punës, realizim i të drejtës në marrdhënie pune, mosrealizim i të drejtës në marrdhënie pune e të ngjajshme. Në kontestet e sigurimeve palët më së tepërmi kërkojnë, shpërblimin e dëmit si dhe regresin ose kthimin e dëmit material dhe shpenzimeve. Ndërsa në të gjitha kontestet juridiko-pronësore, shkaku i kontestit ishte ndarja e pronës ndërmjet palëve.

Kur medijacioni ishte i suksesshëm ajo përfundonte me marrëveshje për medijacion ndërmjet palëve. Por ajo mundet edhe të përfundoj pa sukses kur nuk arrihet marrëveshja ndërmjet palëve, respektivisht të ndërpritet para se të arrihet marrëveshja ndërmjet palëve. Si raste më të shpeshta të cilët u konstatuan nga analiza individuale e procedurave në regjistrin e procedurave të medijacionit ishin: kur palët deklarorin se e tërhekin kërkesën për medijacion, kur medijatori pregadit deklaratë në formë të shkruar se përpjekja për medijacion ishte e pasuksesshme sidomos në rastet kur palët ose njëra prej tyre mungonin në takimin e e caktuar dhe atë mungesë aspak nuk e arsyetonin si dhe në rastet kur medijatori vepron në pajtim me nenin 20, al.1 pika 2 e ligjit mbi medijacionin respektivisht kur medijatori pas konsultimeve me palët përpilon deklaratë me shkrim se nuk është e arsyeshme më vazhdimi i zbatimit të procedurës së medijacionit.

VIII Anketa dhe përpunimin e të dhënave të fituara nga ajo

Hulumtimi aktual i ndërmar me anë të anketës kishte për qëllime arritjen në konstatime në dy drejtime. Për këtë shkak edhe u përpiluan dy lloje të anketave të cilët kishin qëllime të ndryshme. Njëra u kushtoheshte qytetarëve të rëndomtë pa mar parasysh moshës, gjinisë, nivelit të arsimit, profesionit dhe që kishte të bëj me konstatimin e situatës konkrete aktuale në lidhje me mënyrën e zgjidhjeve të kontesteve me anë të medijacionit sidomos përcaktimi i shkallës së përdorimit të medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve, numri i të cilëve ishte 170. Kurse anketa e dytë u kushtoheshte medijatorëve të licencuar në Republikën e Maqedonisë, i cili numër sot është 40, ndërsa në kohën kur u realizua hulumtimi nëpërmjet anketës, numri total i medijatorëve të licencuar ishte 38. Qëllimi i anketës së dytë kushtuar medijatorëve ishte të

vihet në njohuri në lidhje me atë se si medijatorët në Republikën e Maqedonisëshohin përparësit dhe potencialin e procedurës së medijacionit dhe çka ato mendojnë në lidhje me kornizën ligjore e cila rregullon këtë procedurë dhe si e shohin ardhmërinë e medijacionit në Republikën e Maqedonisë. Anketa u realizua nga muaji tetor deri në fillim të muajit dhjetorë të vitit 2018. Pyetsësorët anketues përmbanin pyetje konkrete, të thjeshta dhe të përpiluara në atë mënyrë që të jenë të kuptueshme për të gjithë pa mar parasysh nivelin e arsimit të përgjigjet e të cilëve do të ndihmonin që të arrihet deri në një pasqyrim të qartë të fushës hulumtuese. Të dy anketat ishin të përpiluara ashtu që përgjigjet e pyetjeve ishin të shënuara në vetë anketën në formë të opsioneve me rrethim. Pasi që mblidhen këto të dhëna respektivisht informacione të fituara nga fletat e anketave, vijon procesi i analizës së tyre e cila analizë kryhet në bazë të numrit të përgjigjeve opsionale të rrethuara i cili numër llogaritet në raport me numrin e përgjithshëm të fletëve anketuese e cila rezulton me të shprehurit relativ të rezultateve, e cila na jep një përshkrim të situatës aktuale në Republikën e Maqedonisë në përgjithsi për medijacionin si metodë alternative dhe jashtgjyqësore të zgjidhjeve të kontesteve.

1. Anketa për qytetarët

Zbatimi i anketës për qytetarët ishte instrumenti bazë për zbatimin e hulumtimit për situatën konkrete në Republikën e Maqedonisë për zbatimin e medijacionit si mënyrë jashtgjyqësore të zgjidhjeve të kontesteve, si dhe për të parë sa janë të njoftuar qytetarët e këtij shteti me egzistimin e metodës së tillë. Gjat këtij procesi të hulumtimit u përdor një pyetsësor me pyetje dhe përgjigje të përshtatshme për të anketuarit respektivisht me pyetje dhe përgjigje të qarta dhe kocize që të mos shkaktojnë paqartësi dhe hamendësim gjat procedit të anketimit. Siç edhe u potencua më lartë, përgjigjet ishin të përpiluara në formë të përgjigjeve me rrethim, ku i anketuari kishte të drejtë që të përgjigjet dhe të rrethoj vetëm njërën prej përgjigjeve të parashtruara. Qëllimet themelore të këtij lloji të hulumtimit ishin: të përcaktohet niveli i informimit të qytetarëve në lidhje me medijacionin; të përcaktohet niveli i qytetarëve në lidhje me qëndrimet e tyre për medijacionin si një koncept të ri në shtetin tonë; të përcaktohen kushtet për një procedurë të medijacionit të suksesshëm; të zbulohet numri i qytetarëve të cilët kanë pasur kontakt me medijacionin; të zbulohen faktorët e pritshmërive të qytetarëve për medijacionin, e të ngjajshme.

Nëse të dhënat e fituara do të jenë pozitive atëherë me atë nënkuptojmë se medijacioni si metodë alternative në Republikën e Maqedonisë zbatohet në shkallë të kënaqshme dhe me këtë automatikisht qytetarët do të motivohen që edhe në të ardhmen të vazhdojnë me përdorimin e saj në atë drejtim. Ndërsa nëse rezultatet e hulumtimit nëpërmjet të anketës do të rezultojnë negative atëherë me këtë situatë do të nënkuptojmë se në Republikën e Maqedonisë, qytetarët nuk e përdorin medijacionin si metodë alternative në procesin e zgjidhjes të kontesteve të tyre, dhe si rezultat i kësaj do të paraqiten rekomandime se sit ë tejkalohet dhe të përmirsohet një situatë e tillë.


Si detyra të hulumtimit me anë të anketës për shkallën e zbatimit të medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve janë: konstatimi i përvojës së qytetarëve me zgjidhjen e kontesteve në procedurë gjyqësore; të arrihet deri në njohurit për atë se a mendojnë qytetarët se medijacionit është më e mirë si zgjidhje për kontestet e tyre kundrejt procedurës klasike gjyqësore; të konstatohet fakti se a janë të njohur qytetarët për egzistimin e medijacionit si alternative e gjykatës; të konstatohen qëndrimet e të anketuarve për idenë e zgjidhjes të kontesteve me medijacion; të konstatohet se nga kush janë të njoftuar të anketuarit medijacionin; të konstatohet se a kanë njohuri të anketuarit për rregullimin me kornizë ligjore të medijacionit; të konstatohet se a kanë njohuri për medijatorët dhe punën të cilën ato e kryejnë; të konstatohet se a kanë pasur të anketuarit përvojë me medijatorë; të konstatohet për zgjedhjen e metodës së zgjidhjeve të kontesteve respektivisht në gjykatë ose me anë të medijacionit dhe në fund të konstatohet fakti se a mendojnë të anketuarit se ka një ardhmëri për medijacionin në Republikën e Maqedonisë ose jo.

Sa i përket organizimit të hulumtimit, anketa u pregadit në dy gjuhë, gjuhën shqipe dhe atë maqedonase. Anketa u pregadit në dy forma, në atë të printuar dhe në formën elektronike për personat për të cilët fillimisht mendoheshte se përshkak të kohës së caktuar nuk do të kenë mundësi që të përgjigjen në formë shkrimore, dhe të njejtëve do t'u mireshin e-mail-at që tu dërgohen të njejtat. Mirpo gjat zbatimit të anketës u konstatua se të gjith ishish të gatshëm që të përgjigjen në fletat anketuese në formë të printuar. Popullsisë mbi të cilën u zbatua ky hulumtim kryesisht janë qytetarë të rëndomtë të Republikës së Maqedonisë të moshave, gjinive dhe profesioneve të ndryshme. Numri i plotë it ë anketuarve është 170 qytetarë.

Gjat procesit të zbatimit të hulumtimit për shkallën e përdorimit të medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve, miren parasysht disa variabla të cilët do të na ndihmojnë të bim në përfundime të realta. Këto variabla mundet të jenë variabla të varura dhe variabla të pavarura. Si variabël e pavarur në këtë hulumtim konsiderohet mendimi i të anketuarit për përdorimin e medijacionit si metodë e zgjidhjes të kontestit të tij në të ardhmen. Ndërsa si variabël e varur konsiderohet lidhshmëria e shkallës të infomuarit të të anketuarve për egzistimin e medijacionit si metodë e zgjidhjeve të kontesteve në Republikën e Maqedonisë dhe rregullimi i tij juridik me përdorimin e tij real në praktikë për zgjidhjen e kontesteve të krijuara.


Pyetësi apo fletët anketuese përveç pjesës ku shënohen të dhënat personale të të anketuarve si: mosha, gjinia dhe shkollimi, përmbante dhjetë pyetje përgjigjet e të cilëve të gjithë ishin me opzione me rrethim. Duhet të potencohet se kjo lloj e anketës ishte anonime gjegjësisht në të nuk është e paraparë mundësia që të anketuarit të shënojnë emrin dhe mbiemrin e tyre.

Pas përfundimit të anketës dhe pas mbledhjes të të dhënave nga hulumtimi i zbatuar për përdorimin e medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve është kryer analizë e atyre të dhënave nga e cila analizë janë fituar këto rezultate:




Grafikoni nr. 30: Mosha e qytetarëve

Nga 170 të anketuar 11 nga të anketuarit ose 6.5% i përkisnin grupmoshës prej 18-25 vjet, 47 të anketuar ose 27.6% i takonin grupmoshës 26-35 vjet, 53 të anketuar i takonin grupmoshës 36-50 vjet ose 31.2% dhe 59 të anketuar u takojnë grupmoshës 51-70 vjet respektivisht 34.7% i të anketuarve.



Grafikoni nr. 31: Gjinja e të anketuarve

Sa i përket gjinisë, 73 të anketuar ishin të gjinisë mashkulloreose 42.9% ndërsa të gjinisë femërore ishin 97 të anketuar respektivisht 57.1%.



| | | |
|-----------|-----|------|
| Fillor | 7 | 4.1 |
| I mesëm | 45 | 26.5 |
| I lartë | 18 | 10.6 |
| Fakulltet | 100 | 58.8 |

Grafikoni nr. 32: Shkollimi i të anketuarve

Niveli i shkollimit u nda në 4 grupe dhe atë fillor, të mesëm, i lartë dhe fakulltet. Shtatë të anketuar ose 4.1% ishin me shkollim fillor, 45 ose 26.5% i të anketuarve ishin me shkollim të mesëm, 18 të anketuar ose 10.6% ishin me shkollim të lartë dhe 100 të anketuar ose 58.8% ishin me fakulltet.


| 1. A keni pas ju ose ndonjë i afërt i juaj përvojë në gjykatë deri më sot? | | | |
|--|-----|------|---|
| | Nr. | % | |
| Po | 94 | 55.3 | <p>A keni pas ju ose ndonjë i afërt i juaj përvojë në gjykatë deri më sot?</p> <p>Legend: Po (Blue), Jo (Green)</p> |
| Jo | 76 | 44.7 | |

Grafikoni nr. 33: A keni pas ju ose ndonjë i afërt i juaj përvojë në gjykatë deri më sot?

Në pyetjen e parë - A keni pas ju ose ndonjë i afërt i juaj përvojë në gjykatë deri më sot? 94 nga të anketuarit ose 55.3% u përgjigjën me atë se kanë paur përvojë ose ndonjë i afërt i tyre

ka pasur përvojë në gjykatë, ndërsa 76 të anketuar ose 44.7% janë përgjigjur se as ato e asj ndonjë i afërt i tyre nuk kan pasur asnjë përvojë në gjykatë.

Këto rezultate janë një tregues i qartë se në Republikën e Maqedonisë kontestet janë të shumta dhe një dukuri e shpeshtë ndërmjet qytetarëve dhe ajo e cila është me brengosëse është fakti se këto qytetar shpëtimin në rast të paraqitjes të kontestit e kërkojnë tek gjykatat dhe procedura gjyqësore.




Grafikoni nr. 34: A mendoni se është ide e mire që kontestet të zgjidhen me anë të marrëveshjeve në mes të palëve në kontest pa përzierjen e gjykatës në atë marrëveshje?

Në pyetjen e dytë - A mendoni se është ide e mirë që kontestetet gjyqësore të zgjidhen me anë të marrëveshjeve në mes të palëve në kontest pa përzierjen e gjykatës në atë marrëveshje? 123 nga të anketuarit ose 72.4% e të anketuarve janë përgjigjur se është ide e mirë që kontesti të zgjidhet me anë të marrëveshjes ndërmjet palëve dhe jasht gjykatave të Republikës së Maqedonisë, 18 të anketuar ose 10.6% janë përgjigjur se nuk është ide e mirë

zgjidhja e kontesteve me anë të marrëveshtjes ndërmjet palëve, pra ato preferojnë zgjidhjen e kontestit në procedurë gjyqësore, dhe 29 i të anketuarve ose 17.1% janë të pavendosur për këtë çështje.


Ky rezultat është mjaft inkurajues duke marrë parasysh faktin se për të anketuarit në shikim të parë zgjidhja e kontestit me anë të marrëveshtjes ndërmjet tyre duket mjaft atraktive dhe e kapshme si mënyrë e zgjidhjes të kontestit të tyre.



Grafikoni nr. 35: Në sistemin tone gjyqësor egziston mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve e njohur me termin “ Medijacion “. A keni dëgjuar për një alternativë të tillë?


Në pyetjen e tretë - Në sistemin tonë gjyqësor egziston mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve e njohur me termin "Medijacion". A keni dëgjuar për një alternativë të tillë? Në këtë pyetje 99 e të anketuarve ose 58.2% janë përgjigjur se kanë njohuri për egzistimin e metodës të medijaconit si alternativë e gjykatës, ndërsa 71 nga numri total 170 ose 41.8% janë përgjigjuit se nuk kanë njohuri për egzistimin e një metode të tillë.

Edhe pse numri dërmues i të anketuarve është përgjigjur se kanë njohuri për egzistimin e medijacionit në shtetin tonë në krahasim me ato 77 të anketuar të cilët janë pronocuar se nuk kanë ndëgjuar deri më tani për egzistimin e medijacionit në shtetin tonë, të dhënat e fituara nga hulumtimi në lidhje me këtë pyetje konsiderohen shumë dëshpëruese nga fakti se numrat e dy përgjigjeve janë shumë të përafërt respektivisht nëse e analizojmë ne numrin total të 170 të anketuarve,71 është numër mjaft i lartë.



Grafikoni nr. 36: Medijacioni është procedurë e cila nënkupton atë se dy palët në kontest mes veti arrijnë marrëveshje për të gjetur një zgjidhje të kontestit të tyre pa ndihmën e gjykatës dhe me ndihmën e palës së tretë neutrale/Medijatorit. Pa mar parasysh a keni pasur ose jo përvojë të tillë, si ju duket ideja e zgjidhjes të kontestit?

Në pyetjen e katërt - Medijacioni është procedurë e cila nënkupton atë se dy palët në kontest mes veti arrin marrëveshje për të gjetur një zgjidhje të kontestit të tyre pa ndihmën e gjykatës dhe me ndihmën e palës së tretë neutral/Medijatorit. Pa mar parasysh a keni pasur ose jo përvojë të tillë, si ju duket ideja e zgjidhjes të kontestit? Në këtë pyetje 130 e të anketuarëve janë përgjigjur se zgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit e konsiderojnë si ide shumë të mirë ose 76.5%, shtatë të anketuar ose 4.1 % nuk konsiderojnë se kjo është ide e mirë, pra këto më shumë anojnë nga zgjidhja e kontestit në procedurë kontestimore se sa në zgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit si alternativë e procedurës kontestimore, dhe 33 nga të anketuarit ose 19.4% janë përgjigjur se nuk e din se a është ide e mirë ose jo zgjidhja e kontestit me anë të medijacionit. Nga analiza e të dhënave të cilët dalin nga pyetja e katërt numri i të anketuarve të cilët e mbështesin medijacionin si metodë e zgjidhjeve të kontesteve mundet të konsiderohet si një numër shumë i kënaqshëm në raport me numrin e atyre të cilët janë përgjigjur se nuk e konsiderojnë medijacionin si zgjidhje e mirë për kontestete e tyre. Por nga ana tjetër është edhe numri i të anketuarve të cilët nuk janë të vendosur për atë se a do të prononcoheshin për procedurën e medijacionit ose procedurës kontestimore si procedurë e rregullt e zgjidhjes të kontesteve të tyre. Konsiderohet se te ky numër mundet të ndikohet që të njejtit të anojnë nga medijacioni gjë e cila mundet të arihet me informim më të mirë me kyçjen e të gjithë mjeteve të informimit publik si dhe informimi nga gjykata për egzistimin dhe përparësit e medijacionit si metodë e zgjidhjeve të kontesteve.




| | | | |
|------------------|----|------|--|
| Miq dhe të afërm | 30 | 17.6 | |
| Në mënyrë tjetër | 19 | 11.2 | |
| Nuk kam dëgjuar | 50 | 29.4 | |

Grafikoni nr. 37: Nëse keni dëgjuar për medijacionin, nga kush jeni njoftuar për këtë?

Në pyetjen e pestë - Nëse keni dëgjuar për medijacionin, nga kush jeni njoftuar për këtë? Në këtë pyetje të anketuarve u janë ofruar 6 opsione, nga të cilët për opcionin e parë respektivisht se janë njoftuar nga medijat janë përgjigjur 54 të anketuar ose 31.8%, dhjetë të anketuar ose 5.9% janë përgjigjur se janë njoftuar nga gjykatat, shtatë të anketuar ose 4.1% janë përgjigjur se për medijacionin janë informuar nga institucione tjera, 30 ose 17.6% janë përgjigjur se janë informuar nga miq dhe të afërm, 19 të anketuar ose 11.2% janë përgjigjur se se janë informuar në mënyrë tjetër ndërsa 50 të anketuar respektivisht 29.4% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë ndëgjuar aspak për medijacionin si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve.

Është një çështje e rëndësishme çështja e informimit të qytetarëve të çdo shteti në lidhje me metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve të cilët ato i kanë në dispozicion për të zgjidhur kontestin e tyre dhe për medijacionin në veçanti përfshirë këtu edhe si çështje e rëndësishme edhe në Republikën e Maqedonisë duke ditur faktin se këto metoda përfshirë këtu edhe medijacionin janë metoda relativisht të reja të cilët përdoren në praktikën e zgjidhjes të kontesteve në botë përfshirë këtu edhe në shtetin tonë. Konsiderohet një numër relativisht i mirë i të anketuesve të cilët pretendojnë se informacionet bazë për medijacionin i kanë marrë nga medijat si mjete kryesore të informimit publik. Por ajo e cila duket më alarmante është numri dhe fakti se edhe pse kanë një obligim ligjor që palëve t'ua japin informacionet për zgjidhjen e kontestit me anë të kësaj metode, gjykatat pak e kryesjnë këtë obligim të tyre. Numri 10 në raport me numrin total 170 i të anketuarve është një numër shumë i vogël i cili kërkon shumë punë në atë drejtim që të rritet respektivisht që qytetarëve tu ofrohet një qasje e lehtë dhe e shpejtë tek medijacioni si rezultat i informimit më të mirë të tyre. Gjithashtu konsiderohet shumë


i vogël dhe kritik numri i të anketuarve të cilët janë përgjigjur për informimin e tyre nga institucionet tjera. Në këtë drejtim duhet të bëhet një informim më i mirë, i përmasave të mëdha dhe më serioz nga ana e Odës së medijatorëve në Republikën e Maqedonisë si një organizatë joprofitabile duke mbajtur dhe organizuar trajnime dhe puntori të ndryshme në të cilët përveç medijatorëve gjyqtarët, avokatët t'i kyçin edhe qytetarët e thjeshtë që nga afër të shohin përparësit e medijacionit në krahasim me procedurat klasike gjyqësore. Por edhe më alarmante dhe më dëshpëruese është numri i të anketuarve të cilët aspak nuk kanë ndëgjuar për medijacionin. Që të përmirësohet kjo situatë duhet të mbledhin forcat të gjithë institucionet përfshirë këtu edhe gjykatat të cilët jo vetëm kur është medijacioni i detyrueshëm të informojnë palët por edhe në rastet tjera kur do ta vlersoj se kontesti i palëve mundet të zgjidhet me anë të medijacionit. Kjo është shumë e rëndësishme për të cilën edhe shteti duhet të investoj nga fakti se në këtë mënyrë jo vetëm palët të cilët do të lirohen nga shumata e mëdha të cilët do të duhet t'i pagujn në formë të shpenzimeve gjyqësore por përparësi kanë edhe gjykatat dhe me këtë edhe shteti sepse në këtë mënyrë do të bëhej shkarkimi i gjykatave nga numri i madh i lëndëve të pazgjidhura gjyqësore,



Grafikoni nr. 38: A keni njohuri se medijacioni është i rregulluar me ligj në Republikën e Maqedonisë?

Në pyetjen e gjashtë - A keni njohuri se medijacioni është i rregulluar me ligj në Republikën e Maqedonisë? 65 të anketuar respektivisht 38.2% janë përgjigjur se kanë njohuri se medijacioni në Republikën e Maqedonisë është i rregulluar me kornizë ligjore, ndërsa 105 të anketuar ose 61.8% janë përgjigjur se nuk kanë njohuri për një gjë të tillë.

105 nga të anketuarit nuk dinë asak se medijacioni është i rregulluar me Ligjin mbi medijacionin është një numër shumë i madh. Gjithashtu edhe kjo e dhënë është një alarm për zgjimin e institucioneve shtetërore për informimin e subjekteve për egzistimin e medijacionit si metodë, rregullimit të tij, përparësit e kështu me rradhë.




Grafikoni nr. 39: A dini kush janë medijator dhe çka bëjnë ato?

Në pyetjen e shtatë - A dini kush janë medijator dhe çka bëjnë ato? Njëkëtë pyetje 76 të anketuar janë përgjigjur se e din kush janë dhe me çfar pune miren medijatorët ose 44.7% i të anketuarve, ndërsa 94 të anketuar ose 55.3% janë prononcuar se nuk kanë asnjë njohuri për medijatorët dhe për punën të cilën ato bëjnë.

Të dhënat e analizës së kësaj pyetje janë të dhëna që pasqyrojnë një dështim të madh. Pjesa dërmuese e qytetarëve të anketuar nuk dijnë për medijatorët dhe për punën dhe veprimtarin


të cilët ato bëjnë gjat procedurës së medijacionit. E vetmja gjë që i asocion te medijatori është pikërisht Matthew Nimetz i cili medijonte zgjidhjen e çështjes së emrit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë. Edhe në këtë drejtim preferohet informim më i madh në lidhje me medijacionin, me çrast qytetarët së bashku për procedurën e medijacionit do të marin informata edhe për medijatorët si persona neutral të cilët ndihmojnë në zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve dhe për obligimet dhe përgjegjësit e tij gjat procedurës.



Grafikoni nr. 40: A keni pasur përvojë me medijatorë?

Në pyetjen e tetë - A keni pasur përvojë me medijator? Nga numri i përgjithsëhm i të anketuarve janë përgjigjur 14 respektivisht 8.2% për atë se kanë pasur përvoj me medijator, ndërsa 156 ose 91.8% i të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë pasur deri më tani ndonjë përvoj me medijator.

Nga analiza e të dhënave të fituara me pyetjen se sa persona kanë pasur përvojë me medijatorë shihet se një numër shumë i vogël i të anketuarve kanë përdorur medijacionin dhe ndihmën e medijatorit për zgjidhjen e kontestit të tyre. Kjo në shikim të parë nuk është edhe aq alarmante duke pasur parasysh faktin se ishte në vitin 2006 kur medijacioni u lëshua në rregullimin juridik të saj. Më alarmant është fakti se 94 të anketuar në pyetjen e parë kanë pasur përvojë në gjykatë pro nga ana tjetër zgjedhja primare e qytetarëve është procedura gjyqësore.



Grafikoni nr. 41: Në qoftë se keni ndonjë kontest, a do të vendosni që të njëjtin ta zgjidhni:

Në pyetjen e nëntë - Në qoftë se keni ndonjë kontest, a do të vendosni që të njëjtin ta zgjidhni: qytetarët kishin mundësi të zgjedhin si opzione ndërmjet gjykatës dhe medijacionit si

procedurë alternative. 20 nga të anketuarit ose 11.8% janë përgjigjur se kontestin e tyre do ta zgjidhnin në gjykatë ndërsa 76 të anketuar ose 44.7% u prononcuan se do të drejtohen tek medijatori për zgjidhjen e kontestit të tyre. Një numër relativisht i madh është edhe i personave të cilët nuk mundën të vendosin se a do ta zgjidhin në gjykatë ose në procedurë të medijacionit respektivisht 74 të anketuar ose 43.5%.

Edhe pse numri më i madh i të anketuarve të cilët gjat zbatimit të anketës morën informacione bazike dhe jo shumë të thelluara mbi medijacionin, u përgjigjën se janë të gatshëm që në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti në të ardhmen do të drejtohen në procedurë të medijacionit që të zgjidhin kontestin e tyre, numër i barabartë me atë numër është edhe numri i të anketuarve të cilët nuk mundën të vendosin se kujt do t’ia besojnë zgjidhjen e kontestit, gjykatës ose medijatorëve. Kjo situatë përsëri paraqitet përshkak të mos pasjes besim tek procedura e medijacionit si dhe frikë se a do t’u sigurohet mbrojtje juridike ashtu siç do t’u sigurohet në procedurë gjyqësore edhe pse e kanë parasysh faktin se deri satë mbërijnë tek dhënia e mbrojtjes juridike në procedurë gjyqësore do të duhet të kaloj një kohë relativisht e gjatë dhe të shpenzojnë shuma të mëdha të parave në emër të shpenzimeve gjyqësore procedurale. Pra, ato edhe pse e shofin si një alternativë të mirë ende nuk kanë bindje të formuar se medijacionit mundet vërtet të jetë zgjidhje e mirë për kontestet e tyre.

| 10.A mendoni se do të mbijetoj medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve? | | | |
|--|-----|------|---|
| | Nr. | % | A mendoni se do të mbijetoj medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve? |
| Po | 67 | 39.4 | <p>A mendoni se do të mbijetoj medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve?</p> <ul style="list-style-type: none"> Po: 39.41% Jo: 3.53% Nuk jam i/e sigurtë: 57.06% |
| Jo | 6 | 3.5 | |
| Nuk jam i/e sigurtë | 97 | 57.1 | |

Grafikoni nr. 42: A mendoni se do të mbijetoj medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve?

Në pyetjen e dhjetë - A mendoni se do të mbijetoj medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve? Janë 67 të anketuar ose 39.4% të cilët janë përgjigjur se kanë shpresë se kjo metodë do të mbijetoj në systemin juridik të Republikës së Maqedonisë, gjashtë të anketuar ose 3.5% janë përgjigjur se nuk mendojnë se medijacioni do të mbijetoj kundrejt procedurës gjyqësore, dhe 97 të anketuar ose 57.1% janë përgjigjur se nuk janë të sigurtë se do të mbijetoj ose jo.

Pika e fundit kritike është në pyetjen se a mendojnë të anketuarit se medijacionit do të mbijetoj si metodë e zgjidhjeve të kontesteve. Numri më i madh i të anketuarve respektivisht 97 të anketuar janë përgjigjur se nuk janë të sigurtë për një gjë të tillë, pra edhe këtë çështje e shohin me dyshim si pasojë e gjërave se si rrjedhin në sistemin tonë gjyqësor edhe pse është një numër i madhi të anketuarve të cilët medijacionin e shohin me optimizëm në Republikën e Maqedonisë në krahasim të atyre të cilët nuk shohin ansjë ardhmëri të procedurës së medijacionit në Republikën e Maqedonisë.

2. Anketa për medijatorët

Gjithashtu përveç zbatimit të anketës kushtuar qytetarëve me të cilët u fituan njohuri në lidhje me mendimin dhe zbatimin e procedurës së medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontestëve nga ana e qytetarëve, si instrument tjetër për zbatimin e hulumtimit për situatën në Republikën e Maqedonisë në lidhje me zbatimin e medijacionit në praktikë dhe për konstatimin e asaj se çfarë përvoja kanë medijatorët në Republikën e Maqedonisë, si medijatorët e shohin potencialin dhe anët positive dhe ato negative të medijacionit dhe ardhmërinë e medijacionit si metodë alternative në Republikën e Maqedonisë, u pregadit dhe zbatua edhe një anketë e dytë e cila këtë rradhë i'u kushtua medijatorëve si zbatues të procedurës së medijacionit dhe si palë e tretë neutral në atë procedurë i cili u ndihmon palëve në tejkalimin e problemit të tyre. Kjo anketë u zbatua paralelisht me anketën kushtuar qytetarëve, pra pyetësi i pregaditur për këtë anketë u lëshua në të njëjtën kohë kur u lëshua edhe anketa kushtuar qytetarëve pra nga tetori deri në fillim të dhjetorit.


Si detyra të hulumtimit me anë të anketës për shkallën e zbatueshmërisë të medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve janë: konstatimi i qëndrimeve të medijatorëve të anketuar në lidhje me atë se a është medijacionit metodë e mirë për zgjidhjen e kontesteve; të tregojnë medijatorët se në cilën fushë të së drejtës medijacionit është më tepër i zbatueshëm; konstatimi i asaj se a janë të mendimit medijaotrët se medijacionit me ligj duhet të jetë i obligueshëm edhe për zgjidhjen e kontesteve të natyrave tjera përveç të kontesteve tregtare; të konstatohet fakti se a ka kontribuar medijacionit në rritjen e efikasitetit të zgjidhjeve të kontesteve; gjithashtu konstatimi i faktit se a ka kontribuar vëndosja e medijacionit si zgjidhje alternative të zgjidhjeve të kontesteve në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë në shkarkimin e gjykatave nga lëndët e tepërta dhe të pazgjidhura të gjykatave; të arrihet deri në konstatimin si rezultat i praktikës së medijatorëve se si palët kanë ardhur deri në atë që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit; të konstatohet niveli i kënaqësisë të palëve për zbatimin e procedurës së medijacionit; të konstatohet se a është shkalla ezbatimit të medijacionit e mjaftueshme në Republikën e Maqedonisë; të konstatohet se a vërehet nga ana e medijatorëve progress në fushën e medijacionit në Republikën e Maqedonisë; të konstatohet fakti se a mendojnë medijatorët se në sistemin e Republikës së Maqedonisë është i rregulluar në mënyrë adekuate; të konstatohet se a mendojnë medijatorët se a kanë nevojë për ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi medijacion e cila rregullon çështjet e medijacionit; të arrihet në konstatimin për nivelin e trajnimit të medijatorëve, a është i mjaftueshëm ose duhet ende të investohet në këtë drejtim; të konstatohet perspektiva e medijacionit në Republikën e Maqedonisë dhe të konkludohet në bazë të qëndrimeve të medijatorëve se çka duhet të ndërmirret për një zbatim më të gjërë dhe më të suksesshëm të medijacionit si metodë alternative në Republikën e Maqedonisë.

Hulumtimi u organizua në të njejtën mënyrë si anketa për qytetarët. Pra, u përpiluan pyetje dhe përgjigje me opsione me rrethim në fletat anketuese. Kjo anketë përmbante edhe një pyetje me plotësim, respektivisht pyetja e dytë me të cilën nga medijatorët kërkoheshte të shprehin qëndrimet e tyre individuale të cilët kuptohen, janë të ndryshme, dhe për atë shkak u pa e arsyeshme përpilimi i asaj pyetje që përgjigjja të jepeshte në formën e tillë. Anketa u pregadit në formë elektronike pasi që ajo u pa si mënyrë e vetme më e përshtatshme për zbatimin e anketës për medijatorët, duke pasu parasysh faktin se medijatorët e licencuar jetojnë në qytete të

ndryshme në Republikën e Maqedonisë. Kështu në Listën e medijatorëve⁵⁰⁸ të siguruar nga web faqja e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë u siguruan e-mail-at e të gjithë medijatorëve dhe fletat anketuese të pregaditura në dy gjuhë, gjuhë shqipe dhe maqedonase u lëshuan me kërkesë që të njëjtët të japin kontributin dhe ndihmën që me anëtë anketës të arrihet deri në përfundime dhe konkluzione më të sakta lidhur me medijacionin në Republikën e Maqedonisë.

Pyetësi apo fletët anketuese përveç pjesës ku shënohen të dhënat personale të medijatorëve si të anketuar: mosha dhe gjinia, përmbante 14 pyetje. Kjo lloj e anketës nuk u zbatua si anonime pasi që paraprakisht diheshte identiteti i të anketuarve respektivisht të medijatorëve.


Pas përfundimit të anketës dhe pas mbledhjes të të dhënave nga hulumtimi i zbatuar për përdorimin e medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve është kryer analizë e atyre të dhënave nga e cila analizë janë fituar këto rezultate:



Grafikoni nr. 43: Mosha e medijatorëve


⁵⁰⁸<http://ëëë.pravda.gov.mk/resursi/3>

Nga 15 të anketuar, katër të anketuar i takonin grupmoshës 25-40 vjet ose 26.7%; tetë e të anketuarve i takonin grupmoshës 41-55 vjet ose 53.3%; dhe tre të anketuar i takonin grupmoshës 56-70 vjet ose 20%.



Grafikoni nr. 44: Gjinia e medijatorëve

Ndërsa sa i përket gjinisë, shtatë e të anketuarve ishin të gjinisë mashkullore ose 46.7% ndërsa tetë prej të anketuarve ishin të gjinisë femërore ose 53.3%.




Grafikoni nr. 45: A është medijacionit metoda më e mirë për zgjidhje të kontesteve?

Në pyetjen e parë - A është medijacioni metoda më e mirë për zgjidhjen e kontesteve? Janë 14 të anketuar ose 93.9% të cilët konsiderojnë se medijacionit është metodë e mirë dhe e përshtatshme për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve, me përgjigjen se nuk konsiderohet si mënyrë e mirë për zgjidhje të kontesteve nuk është përgjigjur asnjë nga të anketuarit ndërsa vetëm një nga të anketuarit ose 6.7% është përgjigjur se medijacionit është pjesërisht metodë e mirë për zgjidhjen e kontestit.

Përqindja e fituar si rezultat i hulumtimit në pyetjen e parë konsiderohet si një përqindje e cila është tregues i arritjes të pritshmërive për metodën e medijacionit nga ana e medijatorëve, të cilët këtë metodë e konsiderojnë si metodë e mirë, e përshtatshme, e duhur për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve.

Në pyetjen e dytë – Në cilën fushë mendoni se medijacionit më së tepërmi përdoret? Përshkak se pyetja e dytë ishte pyetje në të cilën i'u dha medijatorëve mundësinë që vet të shënojnë përgjigjen, pa pasur munësinë e zgjedhjes të të njejtës. Nga analiza e përgjigjeve u bënë një përmbledhje e tyre të cilët posht lartë ishin të njejtja, dhe atë, medijatorët mendojnë se medijacioni më së shumti përdoret së pari në kontestet tregtare, pastaj në ato të punës, në kontestet të cilët rrjedhin nga marrdhëniet e obligacioneve, në kontestet juridiko – pronësore dhe kontestete familjare.



| | | | |
|---------------------|---|---|--|
| Nuk jam i/e sigurtë | 0 | 0 | |
|---------------------|---|---|--|

Grafikoni nr. 46: A mendoni se duhet që medijacioni të jetë obligativ për disa lloje të kontesteve?

Në pyetjen e tretë - A mendoni se duhet që medijacioni të jetë obligativ për disa lloje të kontesteve? Në lidhje me këtë pyetje 14 të anketuar ose 93.3% u ishin të mendimit se medijacionit duhet të jetë e karakterit obligativ për disa lloje të kontesteve, e jo vetëm për kontestet tregtare, vetëm njëri nga të anketuarit respektivisht 6.7% u përgjigj se nuk duhet të jetë obligative për lloje tjera të kontesteve ndërsa asnjëri nga të anketuarit nuk u përgjigj me përgjigjen nuk jam i/ e sigurtë për atë se a duhet ose jo medijacionit detyrues të jetë edhe për kontestet tjera.


Situatë e njejtë si në hulumtimin e pyetjes së parë haset edhe në hulumtimin e analizave të të dhënave të cilët janë fituar nga përgjigjet e dhëna nga ana e të anketuarve. Pjesa dërmuese e medijatorëve janë të mendimit se objekti i medijacionit të detyrueshëm ose obligativ duhet të zgjerohet edhe në zgjidhjen e kontesteve të natyrave tjera sia to familjare, pronësore, të punës etj dhe jo të ngel vetëm në zgjidhjen e kontesteve tregtare me medijacion të karakterit obligativ.

| 4.A mendoni se medijacioni ka kontribuar në efikasitetin e zgjidhjeve të kontesteve? | | | |
|--|-----|------|--|
| | Nr. | % | |
| Po | 14 | 93.3 | <p>A mendoni se medijacioni ka kontribuar në efikasitetin e zgjidhjeve të kontesteve?</p> <p>Legend: Po (Blue), Jo (Green)</p> |
| Jo | 1 | 6.7 | |
| Nuk jam i/e sigurtë | 0 | 0 | |

Grafikoni nr. 47: A mendoni se medijacioni ka kontribuar në efikasitetin e zgjidhjeve të kontesteve?

Në pyetjen e katërt - A mendoni se medijacioni ka kontribuar në efikasitetin e zgjidhjeve të kontesteve? Në këtë pyetje 14 medijator ose 93.3% u përgjigjën se pajtohen me atë se medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ka kontribuar në efikasitetin e zgjidhjeve të kontesteve, vetëm një i anketuar ose 6.7% ishte i mendimit se nuk është arritur shkalla e nevojshme e efikasiteteit me zbatimin e metodës së medijacionit, ndërsa asnjë nga të anketuarit nuk ishin të mendimit se nuk janë të përcaktuar në atë se a ka ndikim ose jo medijacionit në efikasitetin e zgjidhjes të kontesteve.

Edhe në këtë pyetje janë arritur rezultatet e njejta sin ë pyetjet paraprake. Është një qëndrim i përbashkët dhe i njejtë për të gjithë të anketuarit se me anë të vendosjes të medijacionit si alternativë e gjykatës në sistemin e zgjidhjeve të kontesteve në Republikën e Maqedonisë është arritur efikasitet i zgjidhjeve të konetsteve ndërmjet palëve, i cili efikasitet sigurohet me zgjidhjen e shpejtë të kontesteve me anë të marrëveshtjes së përbashkët, me shpenzime minimale, mundësia e përbarueshmërisë së marrëveshtjes së medijacionit në mënyrë të lehtë duke i ikur procedurës kontestimore, dhe në fund rezultati përfundimtar i gjith këtij efikasitetei të siguar është ajo se palët janë shumë të kënaqur.



Grafikoni nr. 48: A mendoni se medijacioni ka kontribuar në shkarkimin e gjykatave?

Në pyetjen e pestë - A mendoni se medijacioni ka kontribuar në shkarkimin e gjykatave? Ishin vetëm gjashtë të anketuar ose 40% të cilët u shprehën se zbatimi i medijacionit në zgjidhjen e kontesteve ndikuan në shkarkimin e gjyqësorit nga lëndët e tepërta dhe të pazgjdhura të gjykatave, tre të anketuar ose 20% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve u përgjigjën se nuk mendojnë se uarrit një shkarkim i gjykatës, ndërsa gjashtë ose 40% i të anketuarve ishin të mendimit se nuk kanë asnjë qëndrim për atë se a është arritur shkarkim ose jo i gjykatave në Republikën e Maqedonisë nga lëndët e tepërta dhe të pazgjdhura të tyre.

Në analizën e të dhënave të fituara nga hulumtimi me këtë pyetje mundet të themi se kemi një përqindje solide por jo shume të kënaqshme. Kjo pasi që dyshimet dhe pesimizmi nuk përjashtohet nga përgjigjet e medijatorëve për atë se nuk janë të sigurtë apo edhe se nuk është arritur fare shkarkimi i gjykatave në Republikën e Maqedonisë me fillimin e zbatimit të medijacionit në zgjidhjen e kontesteve.


| 6.Sipas përvojës tuaj si medijator, në të shumtën e rasteve: | | | |
|--|-----|------|---|
| | Nr. | % | |
| Gjykata u'a ka propozuar palëve medijacionin | 0 | 0 | <p>Sipas përvojës tuaj si medijator, në të shumtën e rasteve:</p> <p>Legend: ■ Avokatët e palëve kanë propozuar medijacionin ■ Palët kanë propozuar medijacionin</p> |
| Avokatët e palëve kanë propozuar medijacionin | 4 | 26.7 | |

| | | | |
|-----------------------------------|----|------|--|
| Palët kanë propozuar medijacionin | 11 | 73.3 | |
|-----------------------------------|----|------|--|

Grafikoni nr. 49: Sipas përvojës tuaj si medijator, në të shumtën e rasteve:

Në pyetjen e gjashtë - Sipas përvojës tuaj si medijator, në të shumtën e rasteve: gjykatat kanë propozuar palëve medijacion, avokatët e palëve kanë propozuar medijacion dhe palët vetë kanë propozuar medijacion. Sipas këtij hulumtimi asnjë nga të anketuarit nuk është përgjigjur se palët janë drejtuar nga gjykatat e Republikës së Maqedonisë që të inicojnë procedurë të medijacionit, katër ose 26.7% e të anketuarve u përgjigjën se ishin avokatët e palëve ato të cilët palët i drejtuan që të përzgjedhin medijacionin për të zgjidhur kontestin e tyre dhe 11 nga të anketuarit respektivisht 73.3% u prononcuan se palët vetë kanë qenë ato të cilët kanë zgjidhur që kontestin e tyre ta zgjidhin nëpërmjet të medijacionit.

Edhe pse është një përparim i madh se palët vet kanë filluar të vetdijësohen se ka mënyra tjera alternative se sim und ta zgjidhin kontestin e tyre në mënyë më të shpejtë dhe më të lirë se sa në procedurë gjyqësore, prap se prapë është një e dhënë dështuese çështja e mos propozimit të palëve nga gjykatat, të cilët e kanë obligimin ligjor që ti informojnë palët dhe t'u tregojnë për këtë mënyrë të zgjidhjes të kontestit të tyre.




| | | | |
|----------|---|------|--|
| Nuk e di | 3 | 20.0 | |
|----------|---|------|--|

Grafikoni nr. 50: A janë të kënaqur palët me medijacionin?

Në pyetjen e shtatë - A janë të kënaqur palët me medijacionin? Në këtë pyetje të anketuarit janë përgjigjur në këtë mënyrë. 12 prej tyre ose 80% mendojnë se shumica e palëve të cilët janë drejtuar tek to për zgjidhjen e kontestit të tyre janë të kënaqur nga zhvillimi i procedurës dhe mënyra se si kontesti i tyre është zgjidhur, asnjë nga medijatorët nuk mendojnë se palët të cilët kanë zgjedhur medijacionin në fund të procedurës dalin të pakënaqur ndërsa vetëm tre prej të anketuarve ose 20% nuk janë të sigurt për atë se a janë ose jo palët të kënaqur nga procedura e medijacionit dhe puna e medijatorit.


Rezultati i fituar nga analiza e të dhënave të pyetjes së gjashtë tregon se feedback-u i palëve është pozitiv për zbatimin respektivisht mënyrën e zbatimit, rrjedhën dhe përfundimin e procedurës së medijacionit si metodë alternative e zgjidhjes të kontesteve si dhe për punën që medijatori e bën gjat kësaj procedure që të realizohet qëllimi i procedurës – lidhja e marrëveshtjes për zgjidhjen e kontestit ndërmjet palëve edhe pse një numër i vogël i të anketuarve në këtë drejtim shohin me një pesimizëm të cekët.



Grafikoni nr. 51: A është shkalla e zbatimit të medijacionit e mjaftueshme?

Në pyetjen e tetë - A është shkalla e zbatimit të medijacionit e mjaftueshme? asnjë nga të anketuarit s'janë të mendimit se medijacioni zbatohet mjaftueshëm, respektivisht asnjëri nga to nuk është përgjigjur me opcionin “po”. 13 ose 86.7% nga të anketuarit janë të mendimit se shkalla e zbatimit të medijacionit në Republikën e Maqedonisë nuk është e e mjaftueshme dhe nuk zbatohet aq sa duhet, ndërsa vetëm 2 medijator ose 13.3% mendojnë se medijacioni pjesërisht zbatohet në Republikën e Maqedonisë.


I qartë është rezultati i cili konsiderohet mjaft dëshpërues duke marrë parasysh numrin e madh të lëndëve të cilët paraqiten dita ditës, dhe e njejta gjë konfirmohet njëzëri nga medijatorët. Një gjë e tillë vërtetohet edhe nga statistikat ku nga viti 2016 deri në vitin 2019, brenda të cilës periudhë fillimisht vërehet një rritje e dukshme e lëndëve për të cilët është inicuar procedura e medijacionit ku në vitin 2016 nga 64 numri është rritur në 982 në vitin pasues, por pastaj në vitet tjera ky numër ashtu si dukshëm u rrit, dukshëm edhe bie gjegjësisht në 293 shkon numri i procedurave të inicuar me anë të medijacionit në vitin 2018. Kjo është një tregues se zbatimi i procedurës së medijacionit është mjaft i ulët dhe e cila mbështet dhe provon pretendimet e medijatorëve.



Grafikoni nr. 52: A vëreni progres në fushën e medijacionit deri më sot?


Në pyetjen e nëntë - A vëreni progres në fushën e medijacionit deri më sot? janë vetëm katër medijator ose 26.7% të cilët mendojnë se nga viti 2006 kur edhe është bërë rregullimi juridik definitiv i medijacionit ka progres në fushën e medijacionit. vetëm njëri nga të anketuarit medijator ose 6.7% janë të mendimit se nuk ka asnjë progres për sa i përket medijacionit ndërsa shumica ë të anketuarve ose dhejtë prej tyre respektivisht 66.7% mendojnë se egziston një progres i medijacionit po i cili nuk mundet të konsiderohet si progres me plotkuptimin e fjalës, por një progres i pjesërishëm vetëm në disa fusha të caktuara.

Nga analiza e të dhënave të arritura nga hulumtimi i pyetjes së tetë mundemi të vërejmë se medijatorët janë të qëndrimeve të ndara,por të mendimit të përbashkët se duhet edhe shumë të punohet në atë drejtim që të kontibohet në zbatimin më të madh dhe të ketë gjithashtu edhe progres më të madh dhe më gjithpërfshirës së medijacionit si manyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve në Republikën e Maqedonsië në praktikë.



Grafikoni nr. 53: A mendoni se medijacioni në sistemin tonë është i rregulluar në mënyrë adekuate?


Në pyetjen e dhjetë - A mendoni se medijacioni në sistemin tonë është i rregulluar në mënyrë adekuate? dy prej të anketuarve ose 13.3% janë përgjigjur se medijacioni është i rregulluar në mënyrë adekuate me Ligjin bi medijacionin, pesë ose 33.3% janë të mendimit se nuk është e rregulluar në mënyrë adekuate ndërsa tetë prej medijatorëve ose 53.3% janë të mendimit se është i rregulluar mirë por duhen të rregullohen në mënyrë plotësuese edhe disa çështje tjera në Ligjin mbi medijacionin në Republikën e Maqedonisë.



Grafikoni nr. 54: A duhet të bëhen ndryshime dhe plotësime të rregullave ligjore në Ligjin për medijacionin?

Në pyetjen e njëmbëdhjetë - A duhet të bëhen ndryshime dhe plotësime të rregullave ligjore në Ligjin për Medijacion? janë nentë medijator ose 60% i të anketuarve të cilët ndajnë mendimin e njejtë se duhet të bëhen ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi medijacion, vetëm një i anketuar ose 6.7% është i mendimit se ligji është në rregull dhe në atë mënyrë e rregullon mirë procedurën e medijacionit, ndërsa pesë ose 33.3% janë të mendimit se edhe pse në shikim të parë ligji i plotëson kushtet për të siguruar një procedurë të suksesshme të medijacionit, ka hapsirë për ndryshime dhe plotësime në të.

Analiza e të dhënave të hulumtimit të kësaj pyetje është e lidhur me analizën e pyetjes paraprake, të asaj se a është e rregulluar medijacioni në mënyrë adekuate dhe për atë shkak do të jepet mendim i përbashkët për të dyja këto pyetje. Shumica e medijatorëve janë të mendimit që Ligji mbi medijacionin në Republikën e Maqedonisë duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve me qëllim që çështjet të cilët janë të rëndësishme së madhe por të cilët nuk janë të rregulluara në ligjin aktual të rregullohen me qëllim të sigurimit të mbarvajtjes të procedurës së medijacionit. Si rezultat i kësaj medijatorët janë të mendimit p.sh me ligj mundet të përcaktohen ambientet ku do të zhvillohej procedura e medijacionit ose të rregullohet medijacioni i detyrueshëm për lloje të caktuara kontesteve përveç kontesteve tregtare e të ngjajshme.



Grafikoni nr. 55: A është niveli i trajnimit të medijatorëve i mjaftueshëm?

Në pyetjen e dytëdhjetë - A është niveli i trajnimit të medijatorëve i mjaftueshëm? Medijatorët janë të mendimit se niveli i trajnimit është i mjaftueshëm respektivisht nëntë ose 60% i të anketuarve e ndajnë këtë mendim, katër prej tyre ose 26.7% mendojnë se nuk është i mjaftueshëm niveli i trajnimit dhe se duhet që të investohet më shumë në këto trajnime dhe organizime ndërsa dy prej medijatorëve ose 13.3% i të anketuarve janë të papërcaktuar në këtë drejtim.


Nga analiza e të dhënave të hulumtimit të pyetjes se a mendojnë se trajnimi dhe niveli i saj është i mjaftueshëm për medijatorët që të përfitojnë aftësi për të qenë një medijator i mirë dhe i suksesshëm në punën që bën, shumica e medijatorëve e konsiderojnë vetëm të trajnuar sa duhet për të zbatuar procedurën e medijacionit dhe se trajnimet e tilla kanë kontribuar në përfitimin e njohurive juridike të cilët do t'i zbatojnë në procedurën e medijacionit. Por ato janë edhe të mendimit se janë të gatshëm për trajnime edhe më profesionale me të cilët do t'i përmirësojnë aftësitë e tyre si medijator ndër të cilët: të kenë nivel më të lartë të durimit gjat procedurës, të përmirësojnë aftësitë e tyre të negocimit, të përmirësojnë dhe rrisin nivelin e komunikimit me palët, të rrisin aftësitë e tyre për të kryer një psikoanalizë më të thellë për palët kontestimore si dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre në lidhje me zbatimin e procedurës.

| 13. A mendoni se medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ka perspektivë në Republikën e Maqedonisë? | | | |
|--|-----|-----|--|
| | Nr. | % | A mendoni se medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ka perspektivë në Republikën e Maqedonisë së Veriut? |
| Po | 15 | 100 | |
| Jo | 0 | 0 | |
| Nuk jam i/e sigurtë | 0 | 0 | |

Grafikoni nr. 56: A mendoni se medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ka perspektivë në Republikën e Maqedonisë?

Nëpyetjen e trembëdhjetë -A mendoni se medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ke perspektivë në Republikën e Maqedonisë? nga tre opcione të dhëna për këtë pyetje respektivisht po – medijatorët mendojnë se medijacioni ka perspektivë në Republikën e Maqedonisë, se nuk mendojnë se medijacioni si zgjidhje alternative e zgjidhjeve të kontesteve nuk kanë perspektivë në Republikën e Maqedonisë dhe se nuk janë të sigurtë se në të ardhmen a do të ketë procedura e medijacionit një perspektivë në shetetin tonë, të gjithë medijatorët si grup anketues respektivisht 15 medijatorët ose 100% u përgjigjën se janë të mendimit se medijacioni do të ketë perspektivë në Republikën e Maqedonisë.

Nga përgjigjet e dhëna në pyetjen e trembëdhjet vërehet se medijatorët janë të mendimit se medijacioni ka perspektivë në Republikën e Maqedonisë dhe si e tillë do të vazhdojë të zbatohet si metodë e zgjidhjeve të kontesteve jashtgjyqësore në të ardhmen në praktikë.



| | | | |
|---|---|------|--|
| nga ana e gjykatës | | | |
| Njoftim më i mirë i qytetarëve nga ana e institucioneve | 5 | 33.3 | |

Grafikoni nr. 57: Çka duhet të ndërmiret për zbatim më të gjërë dhe më të suksesshëm të medijacionit?

Në pyetjen e katërbëdhjetë - Çka duhet të ndërmiret për zbatim më të gjërë dhe më të suksesshëm të medijacionit? Ishin tetë të anketuar ose 53.3% të cilët ishin të mendimit për njoftim më të mirë të qytetarëve nga ana e mediave, dy të anketuar ose 13.3% janë të mendimit se duhet të bëhet njoftim më i mirë i qytetarëve nga ana e gjykatës dhe pesë ose 33.3% janë të mendimit se duhet të bëhet njoftim më i mirë i qytetarëve nga ana e institucioneve.

Medijatorët ishin shumëinventivë për propozimin e masave të cilët duhet të ndërmiren në mënyrë që medijacioni të përdoret më gjërësisht dhe atë populërizim përmes masave mediave, publicitet më të madh me të cilën publiku do të njoftohet se mbrojtja juridike e siguruar me përmbartimin e marrëveshtjeve të medijacionit, publiku duhet vazhdimisht të jetë i njoftuar për përparësit dhe qëllimet e medijacionit, e të ngjajshme.

PJESA E GJASHTË

Përfundime dhe konkluzione

1. Zgjidhja alternative e kontesteve dhe procedura kontestimore

Si rezultat i një kornize konceptuale e cila përfshinë teorinë e medijacionit, procedurës kontestimore dhe të drejtës në përgjithsi, ky punim ka rishikuar literaturën egzistuese lidhur me procedurën e medijacionit dhe procedurën kontestimore gjithashtu në Republikën e Maqedonisë si dhe procedurat e medijacionit në shtete të ndryshme si SHBA, Australi,

Hollandë, Republikën e Sërbisë, Malit të Zi, Koracisë e Sllovenisë. Në shtetet si SH.B.A dhe Australi gjat analizës së literaturave dhe ligjeve, u vërejtë një rritje dhe sofistikim i metodës të medijacionit si dhe trajnimit të medijatorëve të cilët edhe në fakt kanë qenë çelsi për përmirësimin të situatës respektivisht të zvogëlimit të numrit të lëndëve të pazgjidhura nga ana e gjykatave në këto shtetevc. Nëse e shohim me një sy kritikë atë çka është bërë në shtetet në fjalë dhe ajo çka është arritur në këto shtete, edhe përkundër faktit se rruga e zhvillimit të procedurës së medijacionit si në këto shtete ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë, zhvillimi dhe praktika ose përdorimi i medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ngelet shumë larg dhe mbas në krahasim me shtete të cilët këtë metodë e kanë të zhvilluar në shkallë të lartë dhe për një periudhë të gjatë kohore. Medijacioni në Republikën e Maqedonisë është i njohur nëzyrtarisht në sistemin juridik nga viti 2006, i cili ishte vit reformues për gjyqësorin e shtetit tonë, nga shkakut se u nxor ligji i parë mbi medijacionin si një procedurë alternative e gjykatës, ndërsa ndryshimet dhe plotësimet dhe në fund edhe nxjerrja e një ligji të ri në vitin 2009 i'a hapën rrugën edhe më tej zhvillimit të procedurës së medijacionit. Duke pasur parasysh se medijacionit paraqet një ide relativisht e re, në teori dhe në praktik qëllimi, elementet dhe pritshmërit e saja nuk janë shumë të përpunuara. Por lart posht ideja e e zgjidhjes së kontesteve me anë të medijacionit si metodë alternative e zgjidhjes të kontesteve pa pjesmarjen e elementit të drejtësisë në fakt nuk paraqet një ide jo e mirë. Edhe pse mendohet se me anë të kësaj mënyre shumë do tëndikohet në zgjidhjen e problemit me mbingarkesën e gjyqësorit në shtetin tonë, medijacionit konsiderohet i potencialit të mirë për t'u nisur këtij drejtimi, por puna më e madhe i ngelet vetë sistemit gjyqësor, e cila duhet ta ndjek medijacionin për nga efektshmëria e zgjidhjes së kontesteve, e pse jo edhe për nga ekonomizimi i saj. Në një numër relativisht të madh të rasteve metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve përfshirë këtu edhe medijacionin si metodë e tillë mundet të arrijnë deri në zgjidhjen e një kontesti më kreativ si dhe më të shpejtë dhe më të lirë gjithashtu në krahasim me zgjidhjen e cila mundet të arrihet në gjykatë. Gjithashtu edhe shteti duhet të zgjat dorë në atë që metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve përfshirë këtu edhe medijacionin të kenë sukses dhe sa do paktë japin rezultatin e tyre në sferën e shkarkimit të gjykatave në Republikën e Maqedonisë, ky një problem i kahmotshëm i cili nuk është duke u zgjidhur as edhe sot. Pra, shteti është ai i cili në bazë të detyrimit që ka për organizimin e një sistemi për zgjidhjen e kontesteve, duhet të financoj dhe të rregulloj mënyrën e

zbatimit të metodave alternative të zgjidhjeve të kontestit në të njëjtën mënyrë se si e rregullon mënyrën e zbatimit të procedurës së rregullt gjyqësore

2.Përparësit dhe dobësit e medijacionit në raport me procedurat kontestimore

Janë të shumta përparësit e zgjidhjes të kontesteve civile me anë të medijacionit në krahasim të asaj të zgjidhjes me anë të procedurës të rregullt gjyqësore. Përcaktimi i këtyre dy faktorëve është shumë i rëndësishëm për palët të cilët janë në prag të vendosjes se me anë të cilës metodë do të zgjidhin kontestin e tyre, me anë të medijacionit ose në procedurë kontestimore. Kështu ato peshojnë të gjitha përparësit dhe dobësit ose avantazhet dhe disavantazhet e të dy procedurave dhe në fund do të zgjidhin atë të cilën ato e konsiderojnë si më të përshtatshmen për të zgjidhur kontestin e tyre. Kjo pjesë do t'i kushtohet ekskluzivisht përparësive dhe dobësive të medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve.

2.1 Përparësit e medijacionit

2.1.1 Fleksibiliteti dhe natyra joformale e procedurës së medijacionit

Përshkak të zhvillimit rapid të medijacionit si metodë alternative e shkaktuar nga zhvillimi i tregut dhe iniciativave politike të gjykatave por edhe të qeverive, parashtrohet pyetja se si mundet të stimulohet dhe shtyhet zhvillimin edhe ajo që është më e rëndësishmja zbatimi më i gjërë dhe më i madh i medijacionit. Egziston edhe mendimi se nëse me qëllim të zhvillimit të medijacionit fusin duar gjykatat e sidomos qeverija, ndoshta do të vij edhe deri tek rrezikimi i disa tipareve të procedurës përfshirë këtu edhe fleksibilitetin. Ky tipar në fakt edhe paraqet njërin nga përparësit e procedurës së medijacionit e cila e bën që të dalloj kjo procedurë në masë të madhe nga procedura kontestimore. Përderi sa procedura kontestimore është një procedurë shumë formale dhe e ngurtë, procedura e medijacionit është e kundërta e saj, fleksibile dhe elastike. Kjo nënkupton atë se palët mundet të zgjedhin procedurën të cilën ato e konsiderojnë më të përshtatshme për to. Kështu përshembull në procedurë të medijacionit palët mundet të zgjedhin procedurën e medijacionit përshkak se ato veç se e din për afërsisht se si munden ta zgjidhin problemin respektivisht kontestin e tyre. Këtë gjë nuk munden ta arrijnë asnjëherë në procedurë kontestimore. Në krahasim me procedurën gjyqësore e cila është shumë formale dhe zbatohet ashtu siç është e paraparë në ligj, medijacioni nuk zbatohet si ajo. Medijacioni mundet të zbatohet si procedurë e vetme, pa pasur ndonjë lidhje me ndonjë procedurë tjetër si një mënyrë

spontane e zgjidhjes të kontestit ndërmjet palëve me ndihmën e ndonjë personi të tretë neutral. Dmth deri në këtë shkall shihet joformaliteti i kësaj procedure. Për atë edhe jo rastësisht ligji i cili e rregullon këtë procedurë konsiderohet shumë i vogël në krahasim me ligjin voluminoz të procedurës kontestimore. Me qëllim që të ruhet fleksibiliteti dhe joformaliteti i procedurës së medijacionit preferohet që ligjet apo edhe dokumentet ndërkombëtare si p.sh UNCITRAL Model Law i cili ka vetëm 15 nene të cilët rregullojnë vetëm çështjet të cilët konsiderohet kyçe për mbarvajtjen dhe përfundimin e suksesshëm të procedurës së medijacionit të mos përmbajnë shumë rregulla juridike të cilët edhe nuk mundën plotësisht të përjashtohen ose të mos egzistoj fare ligj i cili rregullon këtë materije ose procedurë, nga shkak se atëherë do të shkaktonte problem dhe jo siguri tek palët të cilët do të dëshironin që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit, portë njëjtë nga pasiguria dhe friga se nuk janë të mbrojtur së paku në një masë të vogël edhe për nga aspekti juridik, të njëjtën nuk do ta zgjedhin si metodë për zgjidhjen e kontestit të tyre dhe kështu do t'u drejtohen procedurave të rregullta gjyqësore. Edhe ligji ynë mbi procedurën e medijacionit nuk konsiderohet si ligj shumë voluminoz. Ligji aktual mbi medijacionin përmban 70 nene, ndërsa ligji i parë ose ai i vitit 2006 konsiderohej edhe më i vogël për sa i përket numrit të neneve të cilët rregullonin medijacionin – 37 nene. Pra, pothuajse nuk ka rregulla zyrtare të procedurës dhe për atë shkak vetë procedura konsiderohet shumë fleksibile dhe joformale. Ky joformalitet i lejon palët në procedurë dhe medijatorin gjithashtu si palë të tretë që të jenë vetë ato të cilët do të udhëheqin dhe dizajnojnë si procedurën si dhe përshkak asaj se u lejohej palëve një pjesmarrje më të madhe në marrëveshtjen e cila do të mbyll procedurën ato gjithashtu konsiderohen edhe si pjesmarrës aktiv edhe në dizajnimin e zgjidhjes përfundimtare të kontestit. “Joformaliteti i procedurës të medijacionit është një përparësi e madhe për palët të cilët nuk kanë përvojë dhe trajnim për rregullat juridike, zhargonin juridik si dhe për ritualin misterioz dhe të tërën e cila është baza e procedurës kontestimore”⁵⁰⁹. Në procedurën e medijacionit formaliteti është e reduktuar në masë të madhe, dhe e njëjta përdoret vetëm aty ku vërtet është e nevojshme si p.sh nënshkrimin e ndonjë kërkesë e cila duhet të jetë në formë të shkruar ose joformaliteti mundet të shihet edhe gjat procedurës së medijacionit ku të gjitha veprimet ndërmiren me gojë ku në krahasim me procedurën gjyqësore ku mbajtja e procesverbalit ishte e paevitueshme këtu nuk mbahet asnjë lloj procesverbali.

⁵⁰⁹ R. Clarke, G. T. Davies. I, ADR-Argument for and Against use of the Mediation Process particularly in family and neighbourhood disputes, Queensland University Technology Law Journal, 7: 81-96, fq. 86, <https://doi.org/10.5204/qutlr.v7i0.343> 6

2.1.2 Zgjedhja vullnetare e procedurës

Në krahasim me procedurën kontestimore e cila konsiderohet një procedurë detyruese, procedura e medijacionit nga ana tjetër është procedurë jodetyruese. Palët janë ato të cilët pajtohen bashkarisht që kontestin e tyre t'i besojnë medijatorit që në procedurë të medijacionit të arrijnë zgjidhje të kontestit. Kjo është pika themelore e cila e karakterizon procedurën e medijacionit si procedurë vullnetare. Në këtë kuptim kjo karakteristik nënkupton edhe atë se palët mundën vet me vullnetin e tyre në çdo kohë të hekin dorë nga procedura e medijacionit nëse vërejnë se nuk egziston ndonjë arritje e madhe në këtë procedurë, një gjë e cila është e paraparë edhe në nenin 20, al.3 e ligjit mbi medijacion. Kjo nënkupton atë se palët vendosin që të inicojnë procedurë të medijacionit nga shkakun se ato i kuptojnë dhe i pranojnë përparësit e medijacionit dhe pranojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin duke u mbështetur në këto përparsi. "Tashmë është sugjeruar që medijacionit i detyrueshëm është term kontradiktor"⁵¹⁰ me karakteristikën e procedurës së medijacionit e cila e bën të dallohet nga procedurat tjera. Në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë u vendos "medijacionit i detyrueshëm" për kontestet tregtare në ligjin mbi procedurën kontestimore⁵¹¹. Edhe pse në shikim të parë termi medijacion i detyrueshëm e cenon karakterin vullnetar të medijacionit, në fakt nuk është ashtu, nga shkakun se deri satë vijë deri tek pajtimi i palëve që të lëshohen në ujrat e medijacionit, asgjë nuk është detyruese për to. Detyruese bëhet medijacioni nga momenti kur palët hedhin nënshkrimin e tyre në marrëveshtjen e tyre për medijacion. Kjo don të thotë se edhe në rastet kur palët do të udhëzohen nga gjykata ose ndonjë organ tjetër por palët nuk shprehin pajtueshmërinë e tyre për inicim të procedurës së tillë, procedura e medijacionit asesi nuk mundet të inicohet pa pëlqimin e tyre. Parashtrrohet pyetja, a mundet palët të detyrohen nga ana e gjykatës që për kontestin e tyre të zgjidhin medijacionin si metodë e zgjidhjes të kontestit para procedurës kontestimore. Në fakt medijacioni i detyrueshëm më ligj siç është rasti edhe në tek ne me medijacionin e detyrueshëm për kontestet tregtare me vlerë deri në një milion denar, nuk është asgjë tjetër veç se njështrje e palëve që të bëhen të guximshëm që kontestin ta zgjidhin jashtë gjykatave, respektivisht me ndihmën e palës së tretë neutrale – medijatorit. Por a mundet që palët të detyrohen me

⁵¹⁰ R. Clarke, G. T. Davies. I, op. cit, fq. 85

⁵¹¹ Neni 28, al. 2 i Propozim Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurën kontestimore parasheh që në nenin 461 të këtij ligji në kontestet tregtare për kërkesa në të holla vlera e të cilëve nuk e tejkalon shumën prej një milion denar, i cili kontest inicohet me padi në gjyq, palët janë të obliguar që para parashtrimit të padisë të tentojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit.

plotkuptimin e fjalës që të zgjidhin kontestin e tyre me anë të medijacionit edhe pse të njejtit nuk e shohin si një procedurë të përshtatshme apo metodë e cila nuk paraqet ndonjë siguri juridike për to? Shpesh herë kjo temë ka qenë temë diskutimi në shumë grupe të ndryshme punuese, tavolina të rrumbullakta ndërkombëtare e të ngjajshme, të cilët njëzëri për atë se me anë të bërjes të procedurës së medijacionit të detyrueshme mund të vij deri në nenin gjashtë të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut për të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik në kohë të arsyeshme. Por nga ana tjetër e tavolinës janë edhe ato të cilët nuk pajtohen me këtë mendim se mund të çenohet neni gjashtë i Konventës. Sipas gjykatësit në Gjykatën Supreme në Britaninë e Madhe, medijacioni i detyrueshëm e urdhëruar nga ana e gjykatës, nuk kërkohet nga palët që të heqin dorë nga të drejtat e tyre për gjykim të drejtë, por vetëm do ta ngadalsoj rrugën deri në gjykim para gjykatave kompetente, e në disa raste edhe nëse është e planifikuar dhe mirë organizuar procedura e medijacionit, të mos ketë nevojë aspak që të vij puna deri në procedurë gjyqësore⁵¹².

Edhe pse hapi i parë u bë me vendosjen e medijacionit të detyrueshëm për kontestet tregtare, në Republikën e Maqedonisë tendenca e vendosjes të medijacionit të detyrueshëm edhe në sferat tjera të të drejtës nuk ka shenja të të ndalurit. Kjo paraqitet si rezultat i praktikës së suksesshme në shtetet ku medijacioni përdoret me të madhe si, në SH.B.A, Australi dhe Kanadë⁵¹³. Si rezultat i kësaj janë pikërisht medijatorët dhe Oda e medijatorëve në Republikën e Maqedonisë, të cilët kërkojnë medijacionit të shtrihet edhe në fusha tjera si p.sh në zgjidhjen e martesës me anë të marrëveshtjes të arritur nga bashkëshortët në procedurë të medijacionit. Kjo konsiderohet një zgjidhje shumë më e mirë, më e lehtë dhe më e shpejtë e shkurorëzimit se sa shkurorëzimi i cili kalon nëpër fazat e procedurës kontestimore, rezultati i të cilës është jo miqësore, dhe në fund palët përfundojnë me raporte të tensionuara dhe të përkeqësuar, të cilët ndikojnë shumë në të ardhmen si për to ashtu edhe për fëmijët nëse ato dy do të ndajnë përkujdesjen e fëmijëve. Kështu konsiderohet si një zgjidhje e mirë ajo që gjykatësi në rastet

⁵¹² <http://www.jplegal.com.uk/mediationreporturladded.pdf>

⁵¹³ Sipas të dhënave statistikore në SHBA vetëm 5% e lëndëve përfundojnë në procedurë klasike gjyqësore, ndërsa 95% të lëndëve tjera përfundojnë me anë të medijacionit. Kjo është kështu nga shkakun se me ligjin mbi medijacionin është e rregulluar medijacionit në procedurat civile, të drejtat familjare dhe të drejtat e punës. Në Kanadë kontestet sipas të dhënave statistikore me anë të marrëveshtjeve për pajtim gjyqësore zgjidhen rreth 75%, nga i cili numër 50% janë të arritura në procedurë të medijacionit. Edhe në Australi medijacioni njejtë si në Kanadë dhe SHBA konsiderohet i detyrueshëm dhe lart posht rezultatet nga të dhënat statistikore janë të njejtat. Сотироски, Љ, Задолжителен обид на медијација во Република Македонија, Решавање на спорови-Медијација, Научен труд, Original research paper, УДК: 347.919.1 (497.7), fq. 137

kur para tij paraqitet padi për zgjidhjen e martesës, ti udhëzoj palët që këtë çështje ta zgjidhin në rrugë të medijacionit si metodë paqësore.

Konsiderohet se karakteri vullnetar i medijacionit luan një rol shumë të rëndësishëm për suksesin e arritjes deri në zgjidhjen më të shpejtë të kontestit. Është kështu pasi që në mas të madhe vullnetarizmi dhe mos detyrimi me anë të presionit ndikon në mas të madhe edhe në aspektin psikologjik të palëve. Ashtu siç është sot medijacioni vullnetar por edhe i detyrueshëm e jo në plotkuptimin e fjalës i detyrueshëm por si një procedurë e cila urdhërohet nga ana e gjykatës, është më i lehtë që të pranohet nga palët si e tillë, pra si jo e detyrueshme të cilët deri në fund të procedurës nuk janë të obliguar që të rrijnë deri në përfundimin e procedurës me arritje të marrëveshtjes për medijacion.

2.1.3 Konfidencialiteti i procedurës

Është njëra ndër karakteristikat e cila e dallon këtë procedurë nga procedura gjyqësore dhe procedurat tjera. Përderi sa procedura kontestimore është procedurë e karakterit publik, seancat janë publike përjashtimisht të disa rasteve të caktuara me ligj në të cilat përjashtohet publiku, procedura e medijacionit karakterizohet për nga konfidencialiteti i saj dhe përjashtimi i publikut në seancat e saja.⁵¹⁴ Është pikërisht ky karakter e cila e bën procedurën e medijacionit të suksesshëm dhe unik në mënyrën se si i qaset kontestit dhe si e zgjidh të njëjtin. Për palët çështja e konfidencialitetit në disa raste është e rëndësishë së madhe, sidomos kur në procedurë me qëllim të zgjidhjes së rastit dalin në pah shumë informacione të cilët për palët nuk është e interesit që pala tjetër kundërshatave të ketë dijeni për. Konfidencialiteti si çels i suksesit të procedurës së medijacionit përveç se kërkohet dhe rregullohet në ligjet nacionale, përfshirë këtu me Ligjin mbi medijacionin në Republikën e Maqedonisë në nenin 9, ajo gjithashtu është e rregulluar edhe ne dokumentet ndërkombëtare të cilët rregullojnë medijacionin dhe të cilët janë të përpunuara në pjesën e parë të këtij punimi⁵¹⁵. Konfidencialiteti përveç se i obligon palët ajo gjithashtu e obligon edhe palën e tretë neutral respektivisht medijatorin. Kështu çdo informacion e cila mundet të shkëmbehet ndërmjet palëve në asnjë mënyrë nuk mundet të përdoren si prova në ndonjë procedurë tjetër përfshirë këtu edhe në procedurë kontestimore, përjashtimisht në rastet

⁵¹⁴ Sipas nenit 9 të Ligjit mbi medijacionin, të gjithë informacionet të cilët dalin dhe kanë lidhshmëri me procedurën e medijacionit do të ngelen konfidenciale, përveç se në rastet kur palët do të miren vesht ndryshe.

⁵¹⁵ Green paper, 3.2.2.1-Confidentiality; neni 23, Directive 2008/52/EC of the European Parliament and of the Council on certain aspects of mediation on civil and commercial matters.

kur palët do të miren vesht me anë të marrëveshtjes ndërmjet tyre. Ligji mbi medijacionin në Republikën e Maqedonisë palëve të cilët vendosin që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit u garanton atyre privatsinë gjat procedurës së medijacionit.⁵¹⁶ Kështu njëra nga palët për të cilën është shumë e rëndësishme rruajta e informacioneve si konfidenciale të cilët ai i paraqet gjat seanceve të bisedimeve ndërmjet palës tjetër dhe në prezencë të medijatorit si palë neutral, do të jenë më të qetë për nga fakti se informacionet e tilla por edhe informacioni se ai së bashku me një person tjetër kanë ndonjë kontest dhe për të kanë inicuar procedurë të medijacionit nuk do të del në sipërfaqe dhe të afërmit dhe miqt e tyre nuk do të kenë dijeni për një situatë të tillë të krijuar për to. Por konfidencialiteti e obligon edhe palën e tretë neutral respektivisht edhe medjatorin por edhe të gjithë personat tjerë të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e medijacionit. Kjo është e paraparë edhe në ligjin mbi medijacionin⁵¹⁷ si edhe në dokumentet ndërkombëtare si p.sh në Librin e gjelbërt mbi zgjidhjen alternative në të drejtën civile dhe tregtare. Green paper ose Libri i gjelbërt parasheh që pala e tretë të cilit palët në kontest i japin informacione të karakterit konfidencial në asnjë mënyrë nuk duhet që ato informacione t'ia jep palës tjetër kundërshtare, e sidomos atëherë kur pala e tretë respektivisht mediatori i cili përshkak të rolit të tij aktiv për të ndihmuar palët për gjetjen e zgjidhjes të duhur për kontestin e tyre si rezultat i të cilës kur e shef të nevojshme të mbaj edhe takime ndarazi me secëlën prej palët dhe informacionet të cilët do t'i mer nga ato takime nuk ka të drejtë që në asnjë mënyrë t'i shkëmbetj me palën tjetër kundërshtare. Pra, gjithçka që thuhet gojarisht gjat procedurës së medijacionit dhe gjithçka që përpilohet në formë të shkruar nuk duhet të zbulohet as nga ana e palëve e as edhe nga ana e medijatorit. Nga ndalimi i zbulimit të provave janë të përjashtuara dokumentet të cilët kanë të bëjnë me kontestin portë cilët nuk pregaditur ekskluzivisht për zbatimin e procedurës së medijacionit, sepse në të kundërtën ajo do të ndalonte palët të njejtat në mënyrë të lirë dhe haptazi ti prezentojnë dhe t'i përdorin për arritjen e marrëveshtjes.⁵¹⁸

Si rezultat i kësaj që u shtjellua më lartë, që të ketë medijacionit sukses si për palët dhe gjithashtu edhe për medjatorin, duhet që gjat seanceve të bisedimeve ndërmjet tyre t'i shprehin maksimalisht të gjith informacionet të cilët konsiderohen të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit

⁵¹⁶ Ligjit mbi medijacion, neni 10, al. 1

⁵¹⁷ Ligjit mbi medijacion, neni 9, al. 2

⁵¹⁸ Uzelac. A, Komentimi i Ligjit mbi medijacionin të Bosnjës dhe Hercegovinës, http://www.alanuzelac.from.hr/pubs/D01Zakon%20o%20mirenju_s_kom_biljeskama.pdf, fq.18

të tyre. Që të mundet të arrihet kjo, medijatori duhet gjat gjithë kohës sa zgjasin këto seanca të parashtroj shumë pyetje duke i përdorur teknikat të cilët janë karakteristike për medijatorin dhe procedurën e medijatorit me qëllim që të nxjer të dhëna dhe informata bile bile edhe ato të cilët palët nuk do të kishin vendosur që ti nxirnin në procedura tjera e sidomos ato të karakterit personal e sensitiv të cilët përndryshe konsiderohen si informacione konfidenciale. Është detyrë e medijatorit që të krijoj një atmosferë të mirë dhe të përshtatshëm e cila do t'i bënte palët që të ndjehen të sigurtë gjat bisedimit me medijatorin i cili gjat gjithë kohës t'i siguroj të njëjtit që çdo gjë e cila do të shpaloset gjat këtyre seancave para medijatorit në asnjë mënyrë nuk do të mundet të dalin në publik, përjashtimisht atëherë kur palët do të pajtohen që informacionet të mundet ti tregohen palës tjetër.

Çka ndodh nëse pas përfundimit të medijacionit, medijatori thirret që të jep deklaratë si dëshmitar në një procedurë kontestimore? Në këto raste, medijatori për informacionet të cilët i ka marrë nga palët, por për të cilët palët nuk kanë dhënë leje që të mundet të përdoren dhe nxiren në procedurë kontestimore, respektivisht për të cilët pala nuk e ka liruar nga detyrimi i mbajtjes apo ruajtjes së sekretit nukka të drejtë që të dëshmoj në lidhje me ato që ai ka mësuar gjat procedurës së medijacionit. Nëse pala e liron nga ky detyrim atëherë, medijatori ka të drejtë që përveç informacioneve tjera në të cilët medijatori ka ardhur në mënyra tjera si p.sh nga ekspertëve ose dëshmitarëve të cilët kanë mar pjesë në procedurë të medijacionit, edhe informacionet të cilët janë marrë nga palët gjat procedurës së medijacionit t'i tregoj gjat dëshmisë së tij si dëshmitar në procedurë kontestimore.

2.1.4 Kursimet në kosto dhe në kohë

Shpenzimet e mëdha të kohës dhe të parave të cilët shkaktohen nga zbatimi i procedurës kontestimore janë një ndër arsytet se përse në skenë u paraqitën metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve si alternativë e procedurës gjyqësore, përfshirë në këtë grup edhe medijacionin si metodë e tillë. Edhe pse procedura kontestimore paraqet një procedurë e cila tek palët paraqet një siguri më të madhe kur vjen puna tek dhënija apo sigurimi i mbrojtjes juridik, si dhe metodë e cila siguron përmbarueshmërinë e menjëherëshëm të vendimit gjyqësor, por kur nga ana tjetër shihet se për të arritur deri aty duhet të kalojë një kohë e gjat si zakonisht kohë e cila shprehet me muaj e vite e jo me ditë, si dhe shpenzohen shuma të mëdha të parave, për palët të cilët në të

vërtet dhe pa qëllime dytësore dëshirojnë që ta zgjidhin kontestin e tyre, kjo metodë konsiderohet jo edhe aq e përshtatshme. Kjo është kështu sidomos kur medijacioni paraqitet si metodë e pranueshme për tregtarët por edhe kompanitë për të cilët koha dhe paratë janë dy faktorë mjaft të rëndësishëm për ato. Por sot në këtë grup lirisht mundemi të themi se hyjnë edhe nejrëzit e rëndomtë të profesioneve dhe profileve të ndryshme të cilët nuk dëshirojnë që të mirren me procedura gjyqësore të komplikuar dhe të gjata por edhe me shpenzime të mëdha në emër të shpenzimeve procedurale, kur të njëjtit kanë mbi tavolinë mundësi tjera të zgjedhjeve dhe rezultati përfundimtar të jetë i njëjtë si në procedurën kontestimore – zgjidhja e kontestit. Medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve është procedurë e cila i përmban në vetë këto dy elemente të cilët sot konsiderohen shumë të çmueshme, elementin kohë dhe para. Për atë shkak palët sot në gjithë botën por edhe në shtetin tonë edhe pse duhet ende punë për sa i përket informimit sa më të mirë të qytetarëve për atë çka ka pro procedura e medijacionit që të mundet medijacioni edhe tek ne të zbatohet në masë të madhe, para procedurës kontestimore zgjedhin procedurën e medijacionit përshkak të asaj se kanë dijeni të zgjidhjes të shpejtë të kontestit të tyre dhe me më pak shpenzime. Palët janë ato që ndikojnë drejt për së drejti në atë se sa zgjat procedura dhe sa do të jenë shpenzimet procedurale. Nga ato varet se si do të përfundoj procedura dhe sa shpejt pasi që ato janë ato të cilët udhëheqin me procedurën e medijacionit. Është ligji mbi medijacionin ai i cili e kufizon zbatimin e procedurës për nga aspekti kohor, respektivisht të përfundoj brenda afatit prej 60 ditëve respektivisht brenda muajve. Zgjatje të këtij afati nuk ka, dhe në rast se palët dhe medijatorët nuk mundet të vijnë deri në një zgjidhje të përbashkët atëherë kontesti i tyre do të zgjidhet në procedurë kontestimore.

Në Republikën e Maqedonisë shpërblimi, lartësia e saj dhe mënyra e pagesës së shpërblimit të medijatorëve për punën e kryer rregullohet me Tarifën mbi medijacionin⁵¹⁹ dhe Rregulloren mbi kriteriumet e përafëtra për mënyrën e subvencionimit dhe forma për pagesën e shpërblimit dhe shpenzimeve të medijatorëve.⁵²⁰ Sipas Rregullosës e cila rregullon tarifën e shpërblimeve të medijatorëve, shpërblimi i medijatorëve nënkupton kompensimin mbi punën dhe kohën e kaluar në procedurën e medijacionit. Sipas saj shpërblimi nuk mundet të jetë më e ulët se

⁵¹⁹ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Tarifnik-za-medijatsija-1.pdf> Sipas nenit 25, al.3 Tarifa për medijacionin e miraton Ministria e Drejtësisë pas mendimit të marë nga Oda e Medijatorëve në Republikën e Maqedonisë.

⁵²⁰ Rregulloren mbi kriteriumet e përafëtra për mënyrën e subvencionimit dhe forma për pagesën e shpërblimit dhe shpenzimeve të medijatorëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 50 e 15.03.2016

15 euro respektivisht 1500 denar për çdo orë të filluar në procedurë të medijacionit. Dmth minimumi i shpërblimit është i caktuar, ndërsa palëve së bashku me medijatorin u ngelet që me marrëveshje të caktojnë shpërblimin e medijatorit duke pasur parasysh, kontesti dhe natyra e saj, kompleksiteti i kontestit, numri i palëve si dhe puna të cilën medijatori ka bërë gjat procedurës së medijacionit dhe koha e shpenzuar për të njejtën⁵²¹. Shteti me qëllim që të ndihmoj në promovimin dhe në rritjen e zbatimit të procedurës së medijacionit, ka sjellur Rregulloren mbi kriteriumet e përafëtra për mënyrën e subvencionimit dhe forma për pagesën e shpërblimit dhe shpenzimeve të medijatorëve i cili në nenin e parë të kësaj rregullore parasheh obligimin e Ministrisë së Drejtësisë që të siguroj mjete në të holla me qëllim të subvencionimit, me të cilët do të paguhet nga 15 euro respektivisht 1500 den për katër orët e para të zbatimit të procedurës së medijacionit. Ky veprim i Ministrisë së Drejtësisë vjen si rezultat i asaj që të motivohen palët që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit, më saktë që të ndërmarin hapin e parë me ç'rast më nga afër do të shohin se sa më efikase dhe më ekonomike është kjo procedurë në krahasim me procedurën kontestimore. Sipas ligjit mbi medijacionin është e rregulluar ajo sekush do t'i mbuloj shpenzimet dhe shpërblimet e procedurës së medijacionit. Përderisa në procedurën kontestimore pala e cila e humbën kontestin do t'i mbuloj të gjitha shpenzimet procedural, në procedurën e medijacionit secila palë sipas rregullit i mbulon shpenzimet e veta në procedurë, ndërsa shpenzimet e përbashkëta i ndajnë palët në mënyrë të barabartë përjashtimisht në rastet kur palët miren vesht ndryshe. Pikërisht shpenzimet e përbashkëta në fakt përbëjnë shpërblimin e medijatorit por edhe shpenzimet të cilët medijatori i ka bërë gjat procedurës së medijacionit. Ky çmim i ulët i cili u dedikohet shpenzimeve procedural të medijacionit vijnë si rezultat i procedurës së shpejtë dhe njëkohësisht të shkurt të procedurës së medijacionit dhe kuptohet, sa më shpejt t'i qasemi medijacionit aq më të mëdha do të jenë kursimet si rezultat i shpenzimeve të ulta.

2.1.5 Zgjidhje të shumta të kontestit

Si edhe çdo metodë e zgjidhjes të kontestit gjithashtu edhe medijacioni si metodë alternative e zgjidhjes të kontesteve ka një qëllim të vetëm, zgjidhjen e kontestit ndërmjet palëve. Por ajo çka e bën medijacionin të dalloj nga procedurat tjera, këtu mbi të gjithash është fjala nga procedura kontestimore, është se kontesti me anë të medijacionit zgjidhet për nga shprehja e

⁵²¹ Ligji mbi medijacion, neni 25, al. 4

interesit dhe nevojave të palëve. Kështu palët gjat tentimit të tyre të përbashkët për gjetjen e një zgjidhjeje e cila do të ishte e përbashkët për të dyja ato, shkojnë në atë drejtim kundë vend të parë i vendosin interesat personale të tyre. Në procedurën e medijacionit nuk kërkohet fajtori ashtu siç kërkohet në procedurë kontestimore, por kërkohet zgjidhja e cila do t'i përmbushte interesat e të dyja palëve nga e cila situatë të dyja palët do të dalin të kënaqur nga rezultati përfundimtar i kontestit dhe procedurës së medijacionit, për dallim nga procedura kontestimore në të cilën në shumicën e rasteve njëra palë gjithmonë ngelë e pakënaqur me vendimin e gjykatës, por janë edhe ato raste kur edhe pala e cila del fituese në fund të procedurës, edhe ajo është e pakënaqur me vendimin e kontestit. Që në procedurë të medijacionit të vihet deri në një rezultat të kënaqshëm si për palët ashtu edhe për medijatorin, të gjithë veprimet të cilët ndërmiren në drejtim të kësaj bëhen që të zbulohen në plan të parë interesat respektivisht nevojat bazë të palëve të cilët kanë lidhshmëri me çështjen kontestuese e cila shqyrtohet dhe mundohet të gjendet zgjidhje në procedurë të medijacionit. Medijatori gjat procedurës e sidomos në seancat e para të bisedimeve të tij me palët, lëshohet në një analizë psikologjike të këtyre të fundit. Nga ai analizohen të gjitha momentet dhe detajet kyçe të cilët konsiderohen të rëndësishme fillimisht nga palët e pastaj edhe nga vet medijatori. Gjithashtu analizohet edhe pse janë aq të rëndësishme këto momente për palët në raport me çështjen kontestuese, si ndikojnë ato momente tek palët dhe çka mendon se mund të ndryshohet në lidhje me ato momente kur do të gjendet një zgjidhjeje me anë të medijacionit. Bile medijatori shkon edhe më tej gjat procedurës, analizon dhe shqyrton anën emocionale të palëve të cilët shpesh herë edhe e shprehin përshkak të atmosferës të sigurtë dhe të afërt që medijatori e krijon për ato si dhe ndjenjat e fshehura të tyre, në procedurë kontestimore një analizë e tillë aq e thellë as që vjen parasysh të bëhet.

Medijacioni si procedurë është e njohur sidomos për nga karakteri kreativ, nga shkakun se palëve u mundëson të zgjedhin nga një paletë me shumë opsione se si do të duket zgjidhja e kontestit të tyre, dhe më pastaj i lëshon palët vetë që të jenë dizajner të asaj zgjidhjeje. Ajo që e bën të dalloj nga procedura kontestimore, është se medijacioni për zgjidhjen e kontestit konkret gjithmonë nis nga parimi se të dy palët duhet të jenë fitues në këtë rast ose siç njihet në gjuhën angleze me termin win-win. Edhe pse gjat seancave të bisedimeve me palët, medijatorit i lejohet që të jep propozime se simund të duket zgjidhja e kontestit në fjalë, prap se prap janë palët ato të cilët me autonominë e vullnetit të tyre kanë fjalën e fundit për të. Kështu, ato asnjëherë nuk kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet dy solutioneve të mundshme siç paraqitet në rastet kur

kontesti zgjidhet në gjykatë, por ato kanë një listë të tërë të zgjidhjeve të cilët në bazë të përshtatshmërisë të interesave, nevojave, dëshirave dhe motiveve të palëve e jo të palës siç është rasti në procedurë gjyqësore, do ta zgjedhin atë e cila do të ishte e përbashkët për ato dhe e cila do t'i bënte të ndjehen fitimtar dhe të kënaqur me zgjedhjen të cilët ato kanë bërë. Gjith ky veprim i medijatorit dhe i palëvenë fund kurorëzohet me një vendim kualitativ dhe konstruktiv për kontestin ndërmjet palëve, ndërsa për palët nuk don të thot vetëm një përfundim i suksesshëm, por edhe një fillim i ri i marrëdhënieve të tyre të ripërtirra.

2.1.6 Procedurë më relaksuese për palët

Medijacioni është një procedurë e cila tek palët krijonë një atmosferë qetësie dhe pozitive në krahasim me procedurën e medijacionit, duke e zhvilluar dhe përparuar komunikimin dhe bashkpunimin ndërmjet palëve në drejtim të gjetjes të zgjidhjes të përbashkët për kontestin e tyre, në krahasim me procedurën e medijacionit e cila që nga fazat e para të procedurës tek palët krijon një ankth për palët, stres të papërshtatshëm, dhe pse jo të mos përmendim edhe frikën nga ajo se çka i pret gjat edhe në fund të procedurës. Ajo nga e cila shkaktohet stresi më i madh tek palët kur sidomos tek pala paditëse me rastin e marrjes të padisë, është pikërisht në pasojat negative të procedurës gjyqësore. Ky nuk është rasti në procedurën e medijacionit. Pse është kështu? Nga shkak se medijacionit stresin dhe frikën nuk i njeh si forma e të shprehurit të ndjenjave emocionale dhe psikike të palëve përshkak të asaj se kontestet në këtë procedurë në krahasim me procedurën kontestimore, zgjidhen në mënyrë më pak stresuese nga shkak se palët paraprakisht e dinë se cili do të ishte rezultati përfundimtar si dhe e dinë se çka do të humbin e çka jo. Pikërisht kjo i bënë ato të ndjehen më të relaksuar që nga momenti i inicimit të procedurës e deri në fund të saj. Përveç asaj se palët kanë dijeni se si përafërsisht do të përfundoj procedura dhe si do të duket marrëveshtja përfundimtare për medijacion, faktor tjetër me rëndësi e cila bën që palët të ndjehen më të relaksuar dhe jo të stresuar përball njëri tjetrit dhe përball medijatorit është pikërisht medijatori dhe aftësit e tij të komunikimit. Se si do të komunikohet dhe çfarë metoda do të përdoren gjat bisedimeve me palët që ato të ndjehen se janë në një ambient miqësor dhe relaksues varet nga medijatori. Çështje me rëndësi janë aftësit e medijatorit i cili do të ndikoj dhe ndihmoj që ndërmjet palëve të rivendoset komunikimi dhe të menjahet disponimi armiqësor ndërmjet tyre me qëllim që të mundet të hyjnë në bisedime.⁵²² Medijatori në

⁵²² Šimac. S, Mirenje i Suci, Kako suci mogu doprinijeti široj primjeni mirenja u svakodnevnjoj praksi

procedurën e medijacionit paraqitet si një zbutës i mardhënieve të acaruar ndërmjet palëve, të cilët marrdhënie deri në fund të procedurës ka shumë gjasa që të përmirësohen me qëllim që në të ardhmen të krijohen raporte më miqësore në krahasim në fillim të procedurës së medijacionit. Kjo gjë arrihet me ndihmën e medijatorit si palë neutral i cili në fakt paraqitet një urë lidhse ndërmjet palëve të cilët japin oferta për zgjidhjen e kontestit të tyre. Në këtë mënyrë ndërtohet dhe krijohet një komunikim më i frytshëm dhe zbuten raportet armiqësore. Në procedurën kontestimore, gjykatësit nuk i intereson për raportet të cilët palët do të kenë pas përfundimit të procedurës me aktgjykim të plotfuqishëm. Por në procedurën e medijacionit nuk është kështu. Është e rëndësishme së madhe rindërtimi i raporteve të prishura për shkak të egzistimit të çështjes kontestuese ndërmjet palëve. Kjo është kështu sidomos në rastet kur kontesti paraqitet në sferën tregatë, ku interesi i palëve është që edhe më tej të bashkëpunojnë dmth ku interesi shprehet në aspekt monetar, por edhe në kontestet të natyrës familjare ku interesi i vazhdimit dhe përmirësimit të raporteve brenda familjes janë të karakterit personal dhe emocional.

2.1.7 Kontrolla e palëve ndaj procedurës së medijacionit

Se palët janë ata të cilët në duar kanë kontrollin e procedurës së medijacionit, shihet në ligjin mbi medijacionin si dhe në UNCITRAL Model Law në nenin gjashtë ka paraparëse gjith koncepti i medijacionit varet nga vullneti i palëve. Përderisa procedura gjyqësore si metodë e zgjidhjeve të kontesteve kontrollin ndaj procedurës e delegon fillimisht tek gjykata si palë e tretë në procedurë e pastaj edhe tek avokatët si përfaqësues të palëve, tek medijacioni vërehet një situatë më ndryshe. Nëse palët në procedurë kontestimore për të drejtat dhe interesat e të cilëve vendoset kanë një rol mjaft pasiv lidhur me atë si do të shkoj dhe si do të përfundoj procedura dhe kontesti i tyre, në procedurë të medijacionit ato kanë një rol mjaft aktiv, në kuptimin e asaj se ato kanë kontrollin ndaj procedurës së medijacionit ashtu siç gjyqtarët dhe avokatët kanë kontrollin e asaj si do të vijonte procedura kontestimore. “Qëllimi i medijacionit është që palët duhet të marin nën kontrollë jetën e tyre, e jo t’ia dorëzojnë atë shtetit”⁵²³. Medijacioni është ai i cili të drejtën e të vendosurit u’a dorëzon në dorën e atyre të cilët konsiderohet shkaktar të fajit në plotkuptimin e fjalës, dhe në këtë mënyrë palëve u’a jep gjith fuqinë në procedurë duke fituar një pozitë mjaft dominante në të sidomos kur është fjala tek kontrolli ndaj procedurës.

rješavanja sporova? fq. 1, http://mirenje.hr/wp-content/uploads/2018/06/mr.sc_.Sr%C3%84%E2%80%98an-%C4%B9-imac-Mirenje-i-suci.pdf

⁵²³ R. Clarke. G, T. Davies. I, op. cit, fq. 86

Një pozitë aq e fuqishme e palës në procedurë të medijacionit është e mundshme nga shkakut se shumica e normave të cilët rregullojnë procedurën e medijacionit janë të karakterit dispozitiv, të cilët u'a japin të drejtën palëve që të jenë ato të cilët do të ndërmarin veprimet dhe vendimet kyçe për procedurën si dhe edhe për vendimin me të cilën do të përfundoj procedura e medijacionit gjithashtu dhe për faktin se ato mundet të jenë ato të cilët në bazë të vullnetit të tyre do të hekin dorë nga zbatimi i kësaj procedurë në çdo kohë edhe përkundër asaj se procedura e inicuar përfundon pa sukses. Kështu, këto norma lejojnë që palët në mënyrë të plotë të kenë kontrollë ndaj zbatimit të procedurës së medijacionit përfshirë këtu edhe ndaj marrëveshtjes me anë të të cilës do t'i japin fund kontestit të tyre. Palët i caktojnë vet rregullat e "lojës" mbi të cilat do të mbështetet procedura e medijacionit. Kështu, ato janë ato të cilët japin dritën jeshile për iniciimin e procedurës së medijacionit. Fuqia e palëve në procedurë të medijacionit pra shihet nga momenti i inicimit të saj. Procedura e medijacionit do të konsiderohet e inicuar vetëm atëherë kur të dy palët dakordohen për një gjë të tillë me deklaratë me shkrim.⁵²⁴ Kontrolli i palëve ndaj procedurës së medijacionit më pastaj shihet edhe në përcaktimin e rregullave se si do të zbatohet procedura e medijacionit. Këtë gjë ato e bëjnë me anë të marrëveshtjes së përbashkët. Fakti se palët vet deri diku me ndihmën e medijatorit arrijnë deri tek zgjidhja e cila do t'i jepte fund kontestit të tyre, rrit shancën për zbatimin respektivisht përmbushjen e marrëveshtjes së tyre, pasi që e njëjta është arritur pa kërcënim, presion ose kundër vullnetit të tyre, pasi që është e interesit të tyre që të mos ketë epilog në vazhdimsi në procedurë kontestimore.

2.2 Mangësit e procedurës së medijacionit

2.2.1 Medijacioni, procedurë jo e detyrueshme

Edhe pse kjo karakteristikë e medijacionit duket si përparësi e medijacionit sepse tek palët nuk paraqet një procedurë e detyrueshme si procedura gjyqësore, dhe njëkohësisht nuk shkakton efektin negativ psikik që procedura gjyqësore paraqet tek palët, frikën dhe pasigurinë e asaj se si do të ndikoj vendimi gjyqësor në të ardhmen për to, nga ana tjetër kjo karakteristikë konsiderohet edhe si mangësi, e cila në masë të madhe edhe arsyetohet. Përse duhet të arsyetohet e kundërta e një gjëje e cila konsiderohet e mirë dhe e përshtatshme? Kjo është kështu pasi që në

⁵²⁴ Ligjit mbi medijacion, neni 15, al. 1

praktikë jo detyrueshmëria e procedurës së medijacionit keqpërdoret. Keqpërdorimi mundet shumë lehtë të shihet se mundet të bëhet edhe nga vet definimi i medijacionit sipas të cilës, medijacionit paraqet një procedurë jo detyruese. Ajo që nënkuptohet nga ky definim është se për palët nuk paraqitet obligimi ose detyrimi që të vazhdojnë me procedurën kur ato të kenë dëshirë. Pra nuk janë të obliguar që të vazhdojnë me procedurën nëse e shohin si të panevojshme zbatimin e saj. Palët munden që në çdo kohë të hekin dorë nga medijacionit nëpërmjet të dhënjes së deklaratës me shkrim.⁵²⁵ Kur themi palët, këtu hynë edhe pala e cila konsiderohet fajtores për kontestin e paraqitur. Kështu ligji dhe karakteri jodetyrues i procedurës së medijacionit i jep asaj liri dhe komoditet që të tërhiqet nga procedura e medijacionit, sidomos në rastet kur do të vërej se si do të jetë rezultati përfundimtar i procedurës. Kjo është ai keqpërdorimi i karakterit jodetyrues i procedurës së medijacionit e cila u cek më lartë.

Problem tjetër i karakterit jodetyrues, procedura e medijacionit hasën edhe përshkak të asaj se palët e dinë se kjo procedurë mundet të përfundoj me marrëveshje, por ka edhe gjasa që e njejta të mos përfundoj me anë të marrëveshjes. Pra mundet të thuhet se paraqitet një far josigurie tek palët se mundet që mundi i tyre dhe i medijatorit të mos paguhet në fund, për shkak se njëra prej palëve nuk është i kënaqur me ecurin e procesit dhe të rezultatit përfundimtar i cili në procedurën e medijacionit shihet shumë më herët në krahasim në procedurën gjyqësore. Kjo josiguri ndoshta vin edhe si rezultat i asaj se njerëzit veç më janë të mësuar që në kështu raste të ketë një autoritet më i lartë se to, dhe të vendos për të drejtat dhe interesat e tyre, respektivisht të vendos për kontestin e tyre. Ende tek njerëzit egziton ajo siguria e vendimit i cili sjellet nga ana e gjykatësit, ndërsa vendimin të cilën e sjellin vet e quajn jo shumë të sigurtë dhe të besueshëm. Pikërisht përshkak të këtij mendimi i njerëzve apo palëve të cilët fillimisht vendosin që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit e pastaj hekin dorë ende pa përfunduar procedura, medijacionit dështon. Dhe pikërisht fajin pse medijacionit sot nuk ka suksese është mu përshkak të palëve të cilët ende kanë problem t'i besojnë medijacionit plotësisht, e arritja e besimit të plotë është pikërisht nga njohja më e mirë dhe më nga afër e avantazheve dhe disavantazheve të procedurës së medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve.

2.2.2 Përmbartueshmëria e marrëveshjes së medijacionit

⁵²⁵ Ligji mbi medijacion, neni 20, a; 3 dhe 4

Përderi sa për procedurën gjyqësore përmbarueshmëria e vendimit gjyqësor paraqitet një avantazhë, ky element deri diku mungon në marrëveshtjen mbi medijacionin të arritur ndërmjet palëve në procedurë të medijacionit. Përsëri edhe në këtë aspekt krijohet një pasiguri tek palët, dhe në mungesë të kësaj sigurie ato gjithmonë lëshohen në procedurat gjyqësore si procedura vendimi i të cilave jep një siguri më të madhe se sa marrëveshtja e cila del nga procedura e medijacionit. Ato e dinë se kur vendimi i gjykatës do të bëhet i plotefuqishëm, i njejtë do të bëhet edhe i përmbarueshëm, pra ato nuk kanë nevojë të ndërmarin asnjë veprim ekstra që vendimi i gjykatës të zbatohet. Por çka ndodh me marrëveshtjen e cila arrihet në procedurë të medijacionit në mes palëve? A është për nga fuqija e njejtë si vendimi i gjykatës edhe pse qëllimi i të dyjave është i njejtë – zgjidhja e kontestit ndërmjet palëve kontestuese? Sipas neni 22 al. 1 të ligjit mbi medijacion nëse palët arrijnë marrëveshtjen në procedurë të medijacionit para se të inicohet procedura kontestimore, që kjo marrëveshtje të ketë fuqinë e një dokumenti të përmbarueshëm, ku palët në procedurë gjyqësore nuk kishin nevojë të ndërmarin asnjë veprim, tek marrëveshtja e medijacionit ato duhet që përmbajtjen e marrëveshtjes në formë shkrimore të nënshkruar nga palët ta vërtetojnë respektivisht ta solemnizojnë në noter. Në të kundërtën, nëse ky veprim nuk do të ndërmirret nga ana e palëve atëherë procedura e medijacionit do të konsiderohet i kryer me sukses, por marrëveshtja e arritur nuk do të mundet të përmbarohet në rast të mos përmbushjes të detyrimit të palës. Ndërsa nëse procedura e medijacionit inicohet pas incimit të procedurës kontestimore dhe si rezultat i udhëzimit të palëve nga ana e gjykatës, medijatori është i obliguar që në afat prej tre ditëve të punës pas përfundimit të procedurës të medijacionit ta njoftoj gjykatën për mënyrën e përfundimit të procedurës respektivisht a është kryer me sukses ose jo, si dhe në afat prej tre ditëve të punës pas nënshkrimit të marrëveshtjes të arritur si rezultat i udhëzimit të palëve në procedurë të medijacionit përshkak të ndërprerjes të procedurës gjyqësore, medijatori është i obliguar që marrëveshtjen ta dërgoj në gjykatë i cili të njejtën do ta vërtetojë në procesverbal me ç'rast do të bëhet dokument përmbarues.⁵²⁶

Edhe dokumentet ndërkombëtare të cilët janë marrë me rregullimin e medijacionit si metodë alternative e zgjidhjes së kontesteve në vete përmbajnë nene të cilët rregullojnë çështjen e përmbarueshmërisë të marrëveshtjeve të medijacionit të arritur ndërmjet palëve në procedurë të

⁵²⁶ Ligji mbi medijacionin, neni 22, al. 2

medijacionit. Kështu UNCITRAL Model Ligji⁵²⁷ në nenin 15 parasheh vetëm atë se nëse palët lidhin marrëveshtjen për zgjidhjen e kontestit në procedurë të medijacionit, atëherë ajo marrëveshtje konsiderohet detyruese dhe i njëjti mundet të përmbrohet. Edhe UNCITRAL Model Ligji i vjetër respektivisht ai i vitit 2002 në nenin 14 parashihte të njëjtën gjë në lidhje me përmarueshmërin e marrëveshtjeve të arritura në procedurë të medijacionit. Pra këto dokumente u'a lejnë në dorë të shteteve rregullimin më të detajuar të kësaj çështje me anë të ligjeve të tyre nacionale me të cilët do të rregullojnë procedurën e medijacionit. Gjithashtu edhe Direktiva 2008/52/EC përmban disa rregulla për rregullimin e përmarueshmërisë ose zbatueshmërisë të marrëveshtjes së medijacionit. Sipas saj obligohen shtete anëtare që të sigurojnë për palët ose nëse njëra prej tyre kërkon por gjithmon me pëlqimin e palës tjetër që marrëveshtja e arritur në procedurë të medijacionit të bëhet e përmarueshme. Njëjtë si me nenin 22 të ligjit mbi medijacionin në Republikën e Maqedonisë, edhe kjo Direktivë parasheh atë se marrëveshtja do të bëhet e përmarueshme vetëm nëse vërtetohet nga gjykata ose ndonjë organ tjetër. Kjo Direktivë i kushton rëndësi të madhe përmarueshmërisë të marrëveshtjeve të arritura në procedurë të medijacionit sidomos në medijacion të detyrueshëm sepse ajo numërohet si njëra prej arsyeve kur medijatori dhe personat tjerë të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e medijacionit lirohen nga mbajtja sekrete e informacioneve të cilët i kanë marrë gjat procedurës së medijacionit. Për atë shkak edhe kjo Direktivë i detyron shtete anëtare që të vendosin mehanizma me të cilët do të lehtësojnë që marrëveshtjet e medijacionit të bëhen të zbatueshme.

Nëse aq shumë konsiderohet papërmarueshmëria e marrëveshtjes për medijacion problem për palët të cilët me hamendje i qasen medijacionit, dhe përshkak të kësaj çështjes heqin dorë nga ajo, përse mos të ndiqet shembulli i Bosnës dhe Hercegovinës sipas ligjit mbi medijacionin⁵²⁸, sipas të cilit në nenin 25 është e paraparë që marrëveshtja e arritur ndërmjet palëve në procedurë të medijacionit fiton menjëherë fuqinë e dokumentit përmarues. Por nga ana tjetër pse të bëhen kështu përpjekje kur për t'u bërë një marrëveshtje e karakterit përmarues nuk duhet të ndërmiren kush e di se çfar veprime nga ana e palëve. Thjesht nevojiten të bëhen disa formalitete si nënshkrim i palëve dhe marrëveshtja në formë të shkruar të dërgohet në noter për vërtetim apo solemnizim të të njëjtës i cili veprim do ta bëjë marrëveshtjen e zbatueshme.

⁵²⁷ UNCITRAL Model Law on International Commercial Mediation and International Settlement Agreements Resulting from Mediation, 2018

⁵²⁸ Zakon o postupku medijacije, Službeni glasnik BiH, br. 37/04.

Edhe për nga ana materijale, respektivisht shpenzimeve të cilët bëhen me rast të solemnizimit nga ana e noterëve, çmimi është i arsyeshëm nëse marim parasysh edhe shpenzimet e vogla të procedurës së medijacionit në krahasim me shpenzimet të cilët mund të shkaktohen në procedurë kontestimore dhe e cila në fund jep një vendim gjyqësor të zbatueshëm. Kshtu, llogaritë tregojnë se edhe pse marrëveshtja në fund të fundit nuk është e zbatueshme i'a mban barra qiranë si për nga përfundimi i shpejt dhe i lirë i kontestit ashtu edhe për nga arritja e qëllimit – zbatueshmëria ose përmbarueshmëria e marrëveshtjes, të cilët kanë efekt të njëjtë si kur kontesti të zgjidhet në procedurë kontestimore me vendim të gjykatës por me dallim të asaj se që të vijë deri në vendimin e plotfuqishëm të gjykatës në procedurë kontestimore nevojitet të kaloj shumë kohë dhe të shpenzohen shumë para.

Por, pse palët të bëjnë problem për zbatueshmërinë e marrëveshtjes, kur atë marrëveshtje ato e kanë arritur si rezultat i vullnetit të mirë. Përse të mos e përmbushin detyrimin e tyre, kur në fakt të dy palët konsiderohen fitimtar në procedurën e medijacionit. Dhe në fund përse të kërkohet përmbushje e detyrueshme e obligimit, kur qëllimi i medijacionit është që pikërisht të mos vijë deri aty. Atëherë palët le të drejtohen në procedurë kontestimore nëse e shohin më të arsyeshme egzistimin e përmbushjes të detyrueshme të vendimit me të cilën zgjidhet kontesti. Sipas mendimit tonë çështja e përmbarueshmërisë të marrëveshtjes së medijacionit nuk duhet të paraqes problem pasi që palët janë ato të cilët shumë kanë investuar për të arritur deri në atë marrëveshtje. Pse për një detyrim për të cilën janë marrë vesht bashkarisht të kërkojnë zbatim të detyrueshëm për të njëjtin. Ndoshta problem këtu qëndron në karakteret e palëve, e jo në vet mundësinë e përmbarueshmërisë të marrëveshtjes, por nga ana tjetër këtë të fundit e paraqesin si një dizavantazh të procedurës së medijacionit.

2.2.3 Problemet në lidhje me konfidencialitetin

Konfidencialiteti përveç se ka anën positive të saj ajo konsiderohet edhe si mangësi e procedurës së medijacionit, sidomos në rastet kur ajo keqpërdoret. Por si mundet konfidencialiteti të keqpërdoret? Janë palët ato të cilët përshkak të qëllimeve të tyre dytësore respektivisht përshkak të qëllimit që kanë përveç të atij të zgjidhjes të kontestit me anë të medijacionin, e përdorin dhe e keqpërdorin të njëjtën. Kështu, ato pranojnë që çështja kontestuese e tyre të jetë lëndë e medijacionit, dhe të njëjtët lëshohen në procedurë. Marrin informacionet e nevojshme nga seancat e bisedimeve të palëve me medijatorët. Dhe duke ditur se

këto informacione janë të tipit konfidencial, të njejtat i përdorin për qëllimet e tyre. Si zakonisht këto informacione përdoren në procedurë kontestimore pasi që pala ka hekur dorë nga procedura e medijacionit me qëllim të përfitimeve personale të cilët është i sigurt se do të arrijë ti fitoj falë informacioneve të cilët i ka për palën kundërshtare. Por si mundet t'i ikin përgjegjësisë se informacionet të cilët i kanë marrë në procedurë të medijacionit? Pala në gjykatë mundet të deklaroj se informacionet të cilët konsiderohen të tipit konfidencial në procedurë të medijacionit nuk janë marrë nga procedura e medijacionit por nga ndonjë burim tjetër jashtë procedurës së medijacionit.⁵²⁹ Por si mundet të zbulohen këto qëllime të fshehura nga ana e medijatorit, pasi që ai konsiderohet filtri i parë për këto keqpërdorime pasi që nuk është detyrë e medijatorit që të konstatoj gatishmërinë e një pale për të marrë pjesë në procedurën e medijacionit; kush ka meritat për iniciimin e kontestit ndërmjet palëve dhe sidomos a është pjesëmarrja në procedurë të medijacionit është e bazuar në parimin “*bona fide*” apo me besim të mirë dhe pa qëllim të mashtrimit. Çështja e besimit të mirë në procedurën e medijacionit është temë e rregullimit edhe në dokumentet ndërkombëtare si Libri i gjelbërt në nenin 65⁵³⁰, UNCITRAL Model Ligji mbi medijacionin ndërkombëtar tregtar dhe marrëveshtjet për zgjidhjen e kontesteve të cilët dalin nga medijacionit në nenin 2, al. 1⁵³¹ por të njejtat nuk japin ndonjë spjegim më të detajuar të asaj se çka nënkuptohet me termin *bona fide* dhe si mundet e njejtat të identifikohet. Pra detyra më e rëndë e ngelë medijatorit i cili nëse sheh ndonjë shenjë në lidhje me keqpërdorimin e informacioneve të cilët burojnë nga procedura e medijacionit apo kur medijatori sheh se ndonjëra nga palët nuk vepron në pajtueshmëri me parimin “*bona fide*”, menjëherë duhet ta ndërpres procedurën e medijacionit me qëllim të ndërpriten në kohë keqpërdorimet nga pala i cili nuk vepron me besim të mirë.

2.2.4 Bisedimet jo të barabarta – mosbalanc i fuqisë

Është shumë e rëndësishme që sa herë që medijatori ulet në tavolinë përball të dy palëve të cilët me marrëveshtje janë pajtuar që të zgjidhin kontestin e tyre me anë të medijacionit, të mos shprehet në pah mosbalanci i fuqisë ndërmjet palëve në procedurën e medijacionit. Çka në fakt don të thotë kjo? Këtu kemi fjalën për atë jo barabarsin e palëve për nga aspekti emocional dhe

⁵²⁹ R. Clarke, G. T. Davies, I, op. cit, fq. 90

⁵³⁰ Refuzimi i pjesëmarrjes në ADR do të konsiderohej si shkelje e detyrimit të besimit të mirë.

⁵³¹ Në interpretimin e këtij Model Ligji, duhet të kihet parasysh origjina e tij ndërkombëtare dhe për nevojën për të promovuar uniformitetin në zbatimin e tij dhe respektimin e së besimit të mirë.

psikologjik, çka domethënë, aftësia për të kontrolluar të tjerët. Kjo e bën medijacionin e papërshtatshëm. Për ta kuptuar më mirë këtë mosbalanc, mundemi ta spejgojmë në këtë mënyrë, p.sh nëse në një procedurë të medijacionit, njëra palë në raport me palën tjetër ka qenë më autoritative, ndërsa pala tjetër në nivel më të ulët se sa ajo. Kështu për palën e dytë krijohet përshtypja se nuk është e aftë që të mund t'i shpreh dhe mbroj interesat dhe nevojat e saj në procedurë të medijacionit. Pra këtu nuk kemi të bëjmë me barabarsinë e palëve për nga aspekti i edukimit, profesionit, pozicionit social, financiar e të ngjajshme. Që të mundet më së miri të zgjidhet problematika e çekuilibrit të fuqisë ndërmjet palëve, preferohet që palët të kenë përfaqësues të tyre me prokurë, respektivisht avokatë të tyre të cilët do të munden edhe palës e cila nuk është e aftë për nga aspekti emocional dhe psikik që të mbroj interesat e tij, në vend të atij këtë ta bëj avokati. Por edhe nëse palët nuk anagazhojnë përfaqësues me prokurë nga shkakut se financiarisht është e pamundshme për to, dhe të njëjtit vazhdojnë që vet në procedurë të mbrojnë interesat dhe nevojat e tyre, është medijatori ai i cili duhet të bëj shumë kujdes kur vjen puna në situatat të tilla me qëllim që të mos dëmtohet dhe rëzohet balanci i fuqisë të palëve. E në raste kur ai vëren se në të vërtetë ka një mosbalanc i fuqive të palëve, duhet me aftësitë e tij të mundohet që këtë vështirësi ta tejkaloj si një profesionist i vërtetë.

2.3 A është medijacioni i përshtatshëm për zgjidhjen e kontesteve civile?

Si rezultat i shtjellimit dhe analizimit të përparësive dhe mangësive të procedurës së medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve vërehet një avantazh e përparësi ndaj mangësive të medijacionit. Kjo tregon se medijacioni mundet me plotkuptimin e fjalës të konsiderohet si metoda më e përshtatshme nga rradhët e metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Përse të përdoret medijacioni? Është efektiv, i shpejtë, i lirë, i përshtatshëm për sai përket kohës dhe vendit të mbajtjes, jep shumë mundësi të zgjidhjeve si dhe është konfidenciale. Është efektive pasi që mundet të thuhet se në Republikën e Maqedonisë afër 85% të lëndëve të medijacionit përfundojnë me sukses me arritjen e marrëveshtjes për medijacion ndërmjet palëve. Është e shpejtë pasi që mund të përfundoj brenda ditëve maksimum brenda dy muajve. Është i lirë pasi që për katër orët e para pagesën prej 15 euro në orë e mbulon Ministrija e Drejtësisë në formë të subvencioneve. Gjithashtu konsiderohet e përshtatshme pasi që seancat mundet të mbahen në çdo vend dhe në çdo kohë. Medijacioni jep shumë mundësi të zgjidhjeve pasi që palët në dispozicion kanë një paletë të zgjidhjeve të cilët munden në bazë të

përshtatshmërisë për të dyja palët të vendosin se cilët do ta zgjedhin, dhe cila do të jetë mënyra e zgjedhjes të kontestit, si dhe është procedurë konfidenciale e cila e bën që të gjitha deklaratat të cilët do të jepen gjat procedurës së medijacionit si dhe dokumentet të cilët pregaditen gjat kësaj procedure do të ngelen konfidenciale dhe të njejtat nuk do të mundet të përdoren në asnjë mënyrë pa dhënien paraprak të pëlqimit të palëve.

Medijacioni konsiderohet i përshtatshëm para së gjithash nga shkakut se me anë të saj mundësohet dhënia e shpejtë dhe kualitative e mbrojtjes juridike të palëve të cilët e kërkojnë atë, gjithashtu ajo ndikon edhe në shkarkimin e gjykatave, edhe pse në shtetin tonë përshkak të asaj se medijacioni tash shpejt është futur në systemin juridik të zgjidhjeve të kontesteve, ende nuk shihen mirë pasojat zbatimit të medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve, si dhe nga shkakut se ajo si rezultat i përparsive të përdorimit të saj mundëson që palët të zgjedhin atë përpara procedurës kontestimore si metodë e zgjidhjes të kontestit të tyre. Medijacioni u mundëson palëve që ato të udhëheqin me procedurën gjat gjithë kohës, dhe ato të jenë ato të cilët do të gjejnë një zgjidhje të kontestit të tyre në bazë të interesave dhe nevojave të tyre. Pra këtu medijatori nuk është ai i cili sjell vendimin se si do të zgjidhet kontesti i palëve. Fokusi në procedurën e medijacionit e sidomos në zgjidhjen e kontestit gjithmonë qëndron në nevojat dhe interesat e palëve, pasi që me anë të zgjidhjes e cila do t'i jepte fund kontestit të palëve është pikërisht ajo e cila konsiderohet më e përshtatshme për të kënaqur nevojat dhe interesat e palëve. Kjo procedurë gjithashtu ndihmon në transformimin e marrdhënieve ndërmjet palëve, pasi që atë bashkon, i ul në të njëjtën tavolinë dhe i bën që të fillojnë të komunikojnë me njëri tjetrin, e cila dallon nga marrdhënija e cila krijohet në procedurë kontestimore në të cilën palët gjithnjë e më tepër largohen nga njëri tjetri, armiqësohen dhe sulmohen me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të tyre. Në këtë mënyrë interesin personal të tyre ato e përputhin me interesin e palës tjetër me qëllim që të mundësohet zgjidhja e kontestit. Edhe satisfaksioni i lartë i palëve të cilët zgjedhin procedurën e medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve është ajo e cila e bën të përshtatshme zgjidhjen e kësaj mënyrë për të zgjidhur kontestin. Kjo është kështu pasi që angazhimi i lartë i tyre që të vijë deri tek zgjidhja e kontestit, dhe përfundimi i procedurës me zgjidhjen e tillë të cilët ato vetë e kanë dizajnuar i bën ato që të ndjejnë kënaqësi më të madhe se sa atëherë kur për palën është fitimtarë vendimi i gjykatës në procedurë gjyqësore. Medijacioni është një procedurë në të cilën palët mundet të ndjehen më mirë dhe më komod se sa ato mundet të ndjehen në procedurë kontestimore. Kjo është rezultat i joformalitetit

apo mos pasjes të rregullave strikte të procedurës. Por përkundrazi është shumë fleksibile dhe u lejon të përfshihen në përpilimin e marrëveshtjes dhe caktimin e përmbajtjes së saj. Gjithashtu medijacioni është shumë i përshtatshëm edhe për rastet kur kontestete të cilët paraqiten ndërmjet palëve konsiderohen të rëndësisë së vogël. Cilët mundet të jenë kontestet e rëndësisë së vogël? Janë pikërisht ato kontestet të cilët përshkak të natyrës së kontestit janë të papërshtatshme që të zgjidhen në procedurë kontestimore. Jo se ato nuk mundet të zgjidhen në procedurë kontestimore, por zgjidhja e atyre kontesteve do të shkaktonte shpenzime të mëdha dhe do të shpenoheshte shumë kohë për t'u zgjidhur. Pra, nuk janë të arsyeshme për të qenë shkak i inicimit të procedurës kontestimore. Për t'i ilustruar më mirë këto konteste do të marim shembuj nga më banolet por të cilët në procedurë kontestimore mundet të eskalojnë deri në atë shkallë satë janë shkak i inicimit edhe të procedurave tjera përveç procedurës kontestimore, p.sh: marrdhënie të pa pastruara, lëndimi i ndjenjave e të ngajshme. Që t'u iket këtyre situatave të cilët mundet të shkaktojnë kontest më të madh edhe se sa në fakt është kontesti, preferohet që palët të drejtohen tek medijatori për tejkalimin e situatës konfliktuoze të paraqitur ndërmjet tyre e cila do të rezultonte me marrdhënie më të mira e më të shëndosha ndërmjet tyre në të ardhmen.

3. Ndryshime në legjislacion për procedurën e medijacionit

Përshkak se medijacioni në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë është një kategori e re e metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve, në praktikë është ende shumë pak e zhvilluar. Sot mundet të konsiderohet se medijacioni në fakt më së tepërmi egziston si procedurë e shkruar në ligje dhe dokumentë ndërkombëtare e punime shkencore se sa si procedurë e cila zbatohet në praktikë. Kjo mundet të jetë si pasojë e disa faktorëve të cilët pengojnë lulëzimin e saj në praktikën juridike të Republikës së Maqedonisë. Si faktorë të tillë të cilët me të madhe potencohen nga medijatorët, ekspertët por edhe profesionistëve të cilët miren me hulumtimet nga fusha e medijacionit numërohen: mos informimi i drejtë dhe me përmasa të mëdha të qytetarëve për përparësit e medijacionit por edhe për egzistimin e saj si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve; angazhimi në minimum i subjekteve respektivisht organeve të cilët kanë për detyrë të promovojnë këtë metodë të zgjidhjeve të kontesteve; mosbesimi i qytetarëve ndaj procedurës së medijacionit përshkak të mos dhënies të sigurisë të nevojshme për marjen e mbrojtjes së nvojshme juridike si rezultat i zgjidhjes të kontestit me anë të procedurës së medijacionit dhe me këtë zgjatjen dorën ndaj procedurës klasike gjyqësore; mos

edukimi i mirë i palëve dhe mos patja e kulturës së nevojshme juridike e tyre për përzgjedhjen e medijacionit në grupin e metodave të shumta për zgjidhjen e kontestit të tyre e të ngjajshme.

Lëvizja më goditur e cila shkaktoj revolucion në gjyqësorin e Republikës së Maqedonisë, e cila kishte për qëllim zgjidhjen më të shpejtë dhe kualitative të kontesteve dhe njëkohësisht të arrihet shkarkimi i gjykatave, me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi procedurë kontestimore u kërkua që në ligjin mbi medijacionin të parashihet nen i cili do të obligoj gjyqtarët në gjykatat kontestimore të Republikës së Maqedonisë që palët të informohen për të drejtën e tyre që kontestin e tyre të mundet ta zgjidhin me anë të medijacionit.⁵³² Medijatorët në Republikën e Maqedonisë janë ato të cilët njëzëri kërkojnë që me ligjin mbi procedurën kontestimore, medijacionit të bëhet procedurë detyruese jo vetëm për kontestete tregtare por edhe për kontestet të natyrave tjera si p.sh kontestet familjare, martesore, të punës, pronësore e të ngjajshme të cilët konsiderohen se janë të përshtatshme për tu zgjidhur me anë të medijacionit. Ky interesim i medijatorëve për tu bërë një ndryshim i tillë në ligjin mbi procedurën kontestimore shihet edhe nga analiza e të dhënave të cilët dolën nga pyetja e tretë nga e cila 93.3% e medijatorëve të anketuar janë të mendimit se medijacionit duhet të jetë i karakterit obligativ edhe për kontestet tjera përveç kontesteve tregtare. Sipas kësaj nëse një kontest konsiderohet i përshtatshëm të zgjidhet me anë të medijacionit, palët para se të inicojnë procedurë kontestimore janë të obliguar që të mundohen që palët ta zgjidhin kontestin me anë të medijacionit, e në rastet kur medijacionit rezulton i pasuksesshëm atëherë kanë të drejtë kontestin e tillë ta zgjidhin në procedurë kontestimore. Konsiderohet se kjo nuk do të ishte një zgjidhje e mirë për procedurën e medijacionit e as për medijatorët, pasi që sukcesi nuk do të ishte aq i madh nga shkaku i ngarkesës me lëndë të tepërta të cilët do të mblidhen tek medijatorët përshkak të laramanisë të kontesteve të cilët mundet të zgjidhen me anë të medijacionit. Pikërisht përshkak të kësaj duhet të ndiqen shembujt e shteteve në të cilët medijacionit përdoret shumë më herët dhe shumë më shumë se sa në shtetin tonë. Kështu, “hulumtimet në Hollandë, SH.B.A dhe Kanadë treguan se medijacioni i udhëzuar nga ana e gjykatës gjat seancës së shqyrtimit kryesor, japin rezultate më të mira”.⁵³³ Në këto shtete njëjtë edhe si në praktikën e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, e cila deri më sot është treguar shumë e suksesshme, pikërisht udhëzimi për tentim të zgjidhjes të kontestit me anë të medijacionit ka treguar rezultate shumë të larta. Se cila

⁵³² Neni 50, al. 2 i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi procedurë kontestimore

⁵³³ Šimac. S, Mirenje - alternativni način rješavanja sporova, fq. 620

prej kontesteve do të konsideroheshte e përshtatshme për t'u zgjidhur me anë të medijacionit para së gjithash është barrë e gjyqtarëve të cilët si profesionist të vërtetë dhe falë përvojës së tyre shumë vjeçare do të vlersojnë përshtatshmërinë e kontestit të caktuar për t'u zgjidhur me anë të medijacionit.

Tjetër çështje e cila duhet të konsiderohet që të përpunohet në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë është edhe çështja e keqpërdorimit të procedurës së medijacionit nga ana e palëve, dhe parandalimi i atyre rasteve. Pse mundet të keqpërdoret nga palët? Është përmendur disa herë gjat punimit fakti se palët mundën procedurën e medijacionit ta përdorin që të arrijnë disa qëllime dytësore me të cilët qëllime ato dëmtojnë palën tjetër si dhe procedurën e medijacionit, pasi që automatikisht procedura e tillë do të konsiderohet procedurë e pasuksesshme. Është përsëri detyrë e gjykatës që të konstatoj dhe të mas mirë terenin në të cilën palët do të lëshohen me rastin e medijacionit. Këshilli i Shoqatës së sigurimeve të Sllovenisë në mars të vitit 2019 miratoi disa rregulla⁵³⁴ në formë të ligjit e cila rregullon punën e qendrës për medijacion dhe procedurën e medijacionit të Shoqatës së sigurimeve të Sllovenisë në fushën e kontesteve të konsumatorëve. Në të parashihen rastet kur kërkesa për medijacion nga ana e palëve do të refuzohet nga ana e Sekretariatit të Qendrës për medijacion dhe bazën e refuzimit të tyre. Njëra prej to është edhe kur “kërkesa është joserioze ose nënkupton keqpërdorim të qartë të procedurës”.⁵³⁵ Si keqpërdorim i tillë mundet të jetë kur pala e përdor medijacionin si mehanizëm që të mund të fitojë kohë në procedurë kontestimore, respektivisht kur qëllimet e tij dëshiron ti arrijë në procedurë kontestimore por e përdor medijacionin që të arrijë deri tek ato qëllime sepse në të kundërtën do të humbte procesin gjyqësor. “Mangësia e medijacionit është edhe në atë se ai mundet të përdoret si një mjet për zbulimin ose kërcënim ose mund të shfaqet i humbje kohe nëse njëra ose të dy palët nuk janë të gatshme të bëjnë kompromis”.⁵³⁶ Në këtë drejtim edhe Rekomandimi i Komitetit të Minsitrave e shteteve anëtare për medijacionin në çështjet civile, parasheh se gjat organizimit të medijacionit, shtetet duhet që të kushtojnë rëndësi të veçantë në atë se si mundet t'u ikin anulimeve të panevojshme të medijacionit dhe përdorimit të

⁵³⁴ Rules on mediation procedure in domestic and cross-border consumer disputes of the mediation centre of the Slovenian Insurance Association, Ljubljana. 2019

⁵³⁵ Rules on mediation procedure in domestic and cross-border consumer disputes of the mediation centre of the Slovenian Insurance Association, neni 9

⁵³⁶ Mediation Can Resolve Disputes Faster, at Less Cost Than Litigation, shkurt 2019, <https://www.reliasmmedia.com/articles/143903-mediation-can-resolve-disputes-faster-at-less-cost-than-litigation>

medijacionit si taktikë për anulim të tillë.⁵³⁷ Gjithashtu jemi të mendimit se ligji mbi medijacion duhet të përmbaj dispozitë, qëllimi i të cilës do të ishte sanksionim i palëve të cilët keqpërdorin procedurën e medijacionit. Për shembull konsiderohet si e përshtatshme, që palët të cilët fillimisht kanë pranuar dhe kanë inicuar procedurën e medijacionit e pastaj të njëjtit për shkaqe të tyre vendosin që të hekin dorë, të cilët shkaqe për medijatorin janë evidente se përdoren për qëllime keqdashës, të gjithë shpenzimet e palëve të cilët mbulohen nga secila palë individualisht por edhe shpenzimet e përbashkëta në të cilën hyjnë edhe shpërblimet e medijatorëve, të mbulohen dhe të jenë në barrë të palës e cila keqpërdorën procedurën e medijacionit. Gjithashtu mendohet se do të ishte një zgjedhje e mirë që në fillim të procedurës medijatorët të informojnë palët jo vetëm për qëllimet e procedurës, rolin e medijatorit si dhe rregullat e procedurës dhe shpenzimet e saj, por edhe për detyrimin e palëve që të jenë të përpiktë, parimor dhe respektues ndaj palës kundërshtare, medijatorit por edhe ndaj procedurës kontestimore. Kjo kërkesë e medijatorit ndaj palëve mundet të shtohet në nenin 18, al.1 të ligjit mbi medijacion. Në këtë mënyrë është zgjidhur kjo problematikë edhe në Angli, kështu në ratet kur palët të cilët dhe pse kanë detyrim që të inicojnë procedurë të medijacionit për zgjidhjen e kontestit të tyre, dhe atë detyrim ato e anashkalojnë, për këtë do t'i nënshtrohet shpenzimeve të favorshme për palët.⁵³⁸

Një pikë tjetër e cila konsiderohet shumë e rëndësishme për medijacionin por edhe për dhënien e mbrojtjes juridike të nevojshme për palët të cilët atë e kërkojnë në procedurë të medijacionit por edhe në procedurë gjyqësore, është edhe ajo se edhe gjyqtarët përveç palëve duhet të jenë të kujdesshëm kur vjen puna tek procedura e medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve. Pse kërkohet kujdes i veçant edhe nga ana e gjyqtarëve? Pasi që ato janë ato të cilët vendosin a t'i udhëzojnë palët të inicojnë procedurët medijacionit në lidhje me kontestin të cilën ato kanë, dhe a mendojnë se medijacioni do të ishte më i përshtatshëm për kontestin dhe zgjidhjen e saj.⁵³⁹ jemi të mendimit se në ligjin mbi procedurë kontestimore duhet të përmbahet një nen i cili do të specifikonte obligimin e gjyqtarëve që të kenë kujdesë kur do të duhet t'i udhëzojnë palët për medijacion. Me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi procedurë

⁵³⁷ Parimi udhëzues III, pika 7, Recommendation Rec(2002)10 adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 18 September 2002

⁵³⁸ <https://www.lordhacking.com/Documentation/Can%20mediation%20become%20international.pdf>

⁵³⁹ Në kështu raste kur gjyqtari konsideron se kontesti i palëve nuk është i përshtatshëm që të zgjidhet me anë të medijacionit por vetëm në procedurë kontestimore ato nuk duhet që të udhëzohen në procedurë të medijacionit. E njëjta gjë vlen edhe atëherë kur palët dëshirojnë që çështjet juridike të tyre të zgjidhen me anë të vendimit autoritativ të gjykatës.

kontestimore⁵⁴⁰ të nenit 272 në alinenë e dytë obligohet gjykata që për kontestete për të cilët është e lejuar medijacioni si metodë e zgjidhjeve të kontesteve palët së bashku me ftesën për seancën pregaditore t'i udhëzoj që kontestin e tyre mund ta zgjidhin edhe me anë të medijacionit. Udhëzimi për medijacion mundet të zhvendoset pak më lartë në ligjin mbi procedurën kontestimore, si dhe në të njejtin nen të potencohet edhe obligimi i gjyqtarit që të veproj me kujdes të lartë kur do t'i udhëzoj palët në kontest, duke marr parasysh natyrën e kontestit, kërkesat dhe qëllimet e palëve, përshtatshmërinë e zgjidhjes me anë të medijacionit e të ngjajshme.

Ndryshim respektivisht plotësim në ligjin mbi procedurën kontestimore mendohet të bëhet edhe në sferën e të vepruarit të gjykatës atëherë kur palët para paraqitjes të kontestit respektivisht para inicimit të procedurës kontestimore lidhin marrëveshtje me klauzulë të medijacionit, me të cilët ato dakordohen që në të ardhmen nëse ndërmjet tyre paraqitet ndonjë kontest e cila ka lidhshmëri me objektin e marrëveshtjes, të njejtën ta zgjidhin në procedurë të medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve. Këtë lloj të zgjidhjes të kontesteve e njih edhe Ligji për marrdhëniet detyrimore⁵⁴¹ në nenin 13 i cili parasheh qëpjesmarësit e marrdhënies detyrimore para së gjithash në rast të paraqitjes të kontestit ndërmjet tyre të mundohen të njejtën ta zgjidhin në mënyrë paqësore respektivisht me anë të medijacionit. Gjithashtu edhe Libri i gjelbërt parasheh rastet kur palët janë të lirë që të disponjnë me të drejtat e tyre, dhe në rast të mos përmbushjes të ndonjë detyrimi nga marrëveshtja e zgjidhjeve alternative të kontesteve atëherë zgjidhja do të kërkohet në interpretimin e vullnetit të palëve në pajtueshmëri e rregullat e të drejtës kontraktuese. Konsultimet me gjykatat kanë treguar se refuzimi i zgjidhjes të kontestit me anë të metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve edhe përkundër asaj se një gjë e tillë është e parashikuar në marrëveshtjen kontraktuese ndërmjet palëve, mundet të sanksionohet pasi që paraqet mosrespektim të detyrimit kontraktues. Libri i gjelbërt parasheh mënyrën se si duhet të veproj gjyqtari kur para tij paraqitet situatë kur edhe përkundër egzistimit të marrëveshtjes me klauzulë të medijacionit si mënyrë e zgjidhjes të kontesteve ndërmjet palëve në rast të paraqitjes të kontestit, pala vendos që inicoj për të njejtën kontest procedurë kontestimore. Kështu gjyqtari në këto raste është i obliguar që ta hesh posht

⁵⁴⁰ neni 59, Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi procedurë kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr 116/10

⁵⁴¹ Ligji për marrdhëniet detyrimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 18/01, 04/02, 05/03, 84/08, 81/09, 161/09,

padinë sit ë palëjuar.⁵⁴²Sipas kësaj konsiderohet e përshtatshme që të plotësohet ligji mbi procedurën kontestimore nëpjesën e shqyrtimit paraprak të padisë⁵⁴³, në të cilën do të shënohet se si duhet të veprojnë gjykata në rastet kur në gjykatë parashtrahet padia ndërsa nga ana tjetër në mes të paditësit dhe të paditurit ka marrëveshje të lidhur me klauzulë që medijacioni të jetë metodë e zgjidhjeve të kontesteve nëse ndërmjet tyre në të ardhmen paraqitet kontest, kështu në këtë rast duhet të potencohet në këtë nen se gjykata këtë padi duhet ta hedh posht sitë palejuar.

Tjetër pikë e cila në një far mase e rrezikon konfidencialitetin e procedurës së medijacionit dhe me këtë edhe të përmbajtjes të marrëveshtjes të arritur ndërmjet palëve në procedurë të medijacionit, është se palët të cilët janë udhëzuar nga gjykata pas inicimit të procedurës kontestimore që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit dhe të njejtit i'a kanë arritur qëllimit, pra e kanë zgjidhur kontestin me sukses, përveç se medijatori ka obligim që në afat prej tre ditëve ta njoftoj gjykatën për rezultatin e procedurës. gjithashtu edhe palët kanë për obligim që marrëveshtjen e tillë t'ia dorëzojnë gjykatës që i njejtë ta shpallë respektivisht ta vërtetojë në procesverbal me qëllim që të fitoj ai dokument fuqi përmbarese. Thuhet se e rrezikon konfidencialitetin pasi që me shpalljen në procesverbal ajo do të bëhet dokument publik i cili mundet të jetë në dispozicion për publikun. E njejtë gjithë vlen edhe kur marrëveshtja për medijacion ndërmjet palëve nga procedura e medijacionit të cilët e kanë inicuar pa marrë parasysh procedurën kontestimore, solemnizohet në noter për të fituar fuqinë e dokumentit përmbarese me qëllim që palët të jenë të sigurt se në të ardhmen detyrimi i përmbajtur në atë marrëveshje të përmbushet. Edhe në këtë mënyrë përmbajtja e marrëveshtjes e cila sipas ligjit mbi medijacionin konsiderohet e tipit konfidencial, çënohet të zbulohet. Jemi të mendimit se duhet të lihet në duar të palëve ajo se a duhet të shpallet marrëveshtja e medijacionit në procesverbal ose jo, sidomos kur flasim për medijacionin e urdhëruar nga gjyqtari në procedurë kontestimore dhe kështu të mos jetë e detyrueshme, por palët të vendosin dhe të kenë ato në dorë zgjedhjen se a pajtohen ose jo që marrëveshtja e tyre të vërtetohet në procesverbal.

4. Roli i gjyqtarëve, avokatëve dhe qytetarëve në suksesin e zbatimit të procedurës së medijacionit në Republikën e Maqedonisë

⁵⁴² pika g5, Libri i gjelbërt

⁵⁴³ Nenët 265, 266, 267 dhe 268 të LPK

Medijacioni mundet të konsiderohet një praktikë ose profesion i ri në Republikën e Maqedonisë, dhe si çdo risi edhe kjo ka qenë temë diskutimi dhe debatimi si nga publiku ashtu edhe nga profesionistët e kësaj lëmie. Që të ketë sukses medijacionit duhet të punohet shumë në drejtimin e promovimit të saj dhe promovimit të avantazheve të cilët ajo i jell me vete. Dhe me fillimin e zbatimit të saj në masë të konsiderueshme do të arrihen të gjithë pritshmëritë të cilët pretendohen që të arrihen e mbi të gjitha ajo më kryesorja shkarkimi i gjykatave nga lëndët e pazgjidhura. Janë tre faktor të cilët njihen si faktorë kyç të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në zbatimin e medijacionit përveç mjetit më të fuqishëm të informimit public – mediave. Gjykatat, avokatët dhe vetë qytetarët janë ato të cilët mundet të vendosin për fatin e medijacionit në një shtet si shteti jonë në të cilën saka filluar të lulëzoj medijacionit si një praktikë respektivisht metodë e zgjidhjeve alternative të kontesteve.

Së pari, janë gjyqtarët dhe mënyra e tyre e të menduarit sidomos qëndrimet e tyre ndaj procedurës së medijacionit të cilët kanë një impakt të madh në atë se a e bllokojnë ose jo medijacionin. Problemi kryesor e cila në fakt e vështirëson ecurin pa pengesë të medijacionit në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë është pikërisht ajo se gjyqtarët janë të trajnuar për çështje gjyqësore dhe jo edhe për ato të medijacionit. Për atë shkak si rezultat i programeve të ndryshme për reforma në gjyqësi me të cilët kërkohet që të nxitet zhvillimi dhe përparimi i metodave të zgjidhjeve alternative të kontesteve dhe me këtë edhe të nxitet medijacionit si metodë e zgjidhjes të kontesteve, kërkohet pikërisht që edhe gjyqtarët të kalojnë orë të caktuara në trajnime të cilët do të jenë frytdhënëse për atë që gjyqtarët të shohin medijacionin në një dritë më ndryshe. Kjo është kështu pasi që janë qëndrimet profesionale të gjyqtarëve se ato janë ato të cilët duhet të kryejnë funksionin e zgjidhjes të kontesteve dhe me këtë të sjellin vendimin meritor i cili do t'i jepte fund një kontesti dhe se gjykatat janë vendi ku palët duhet të drejtohen për të zgjidhur kontestin e tyre. Gjyqtarët luajn një rol të rëndësishëm për zhvillimin e medijacionit. “Ata duhet të japin informacione dhe të organizojnë sesione për dhënien e informacioneve lidhur me medijacionin dhe t'i ftojnë palët që të përdorin medijacionin dhe t'i udhëzoj që rastet e tyre ti zgjidhin me anë të medijacionit”.⁵⁴⁴ Kjo duhet të mirret parasysht pasi që me ligj veç më janë të obliguar gjyqtarët që palët t'i informojnë por edhe ti udhëzojnë që të provojnë që kontestin e tyre

⁵⁴⁴ Mediation Development Toolkit Ensuring implementation of the CEPEJ Guidelines on mediation, Mediation Pilot Monitoring Checklist, European Commission for the efficiency of justice (CEREJ), Council of Europe, CEREJ(2018)7, fq.8

ta zgjidhin me anë të medijacionit, si dhe duhet të miret gjithashtu parasysh edhe fakti tjetër se numri më i madh i procedurave të medijacionit zbatohen si rezultat i udhëzimit të palëve. Pikërisht përshkak të kësaj roli i medijatorit është shumë i madh në këto rastë pasi që ai është ai icili e sheh dhe e vleron përshtatshmërinë e një çështje kontestuese të zgjidhet me anë të medijacionit ose në procedurë kontestimore. Medijacioni në fakt konsiderohet shumëfitimprurëse, nga shkak se me anë të saj gjykatat do të jenë ato të cilët do të fillojnë të punojnë, funksionojnë por edhe të marrin frymë më lirshëm pasi që do të mundësohej shkarkimi i tyre dhe pastrimi i fiokave të tyre nga lëndë të tepërta dhe të vjetra të pazgjidhura. Kjo nga ana tjetër do të ndikonte në rritjen e efikasitetit të zgjidhjeve të lëndëve kontestuese në procedurë kontestimore, pasi që kur lëndët të cilët konsiderohen të përshtatshme për shkak të natyrës jo edhe aq të komplikuar do të dërgoheshin për zgjidhje në procedurë të medijacionit atëherë i gjith fokusi i gjykatave do të koncentroheshte vetëm në lëndët të cilët do të kishin nevoj për më shumë kujdes dhe përpjekje për t'u zgjidhur në procedurë kontestimore. Për këtë edhe konsiderohet e shumë rëndësisë së madhe përvoja e gjyqtarëve por edhe qëndrimi dhe besimi i tyre ndaj procedurës së medijacionit të cilët janë çelsi për zhvillimin dhe suksesin e medijacionit në shtetin tonë.

Faktori i dytë për përparimin e medijacionit janë edhe avokatët si praktikant të drejtësisë. Qëndrimet dhe opinion i avokatëve gjithashtu identifikohet si një arsye e cila do të kishte si pasojë suksesin ose mosuksesin e medijacionit në një shoqëri. Nga shkak se avokatët praktikën më të madhe e kanë të fituar nga procedurat gjyqësore, ato dëshirojnë që aftësitë e tyre t'i vazhdojnë në gjykatë ku edhe e shohin veten për një periudh të gjatë kohore. Ato janë të mendimit se nëse fillojnë të anojnë nga medijacionit si një metodë tjetër e zgjidhjes të kontesteve ajo do të ndikoj në reputacionin e tyre, dhe për këtë shkak ikin edhe këshillimit të palëve për medijacion. Por ajo e cila nuk miret parasysh nga po këto avokatë të cilët konsiderohen si faktori më kryesor i rezistencës ndaj medijacionit është se edhe në procedurë të medijacionit ato do të kenë po të njëjtën pozitë si në procedurë kontestimore. Si shkaqe jo të ligjshme mbi rezitencën e avokatëve ndaj medijacionit mundet të konsiderohen:” implikimet vetjake financiare; injoranca ndaj procesit dhe dobia e saj potenciale e lidhur me paragjykimet kulturore në praktikën ligjore tradicionale që militon kundër medijacionit.”⁵⁴⁵ Si arsye e dytë dhe e cila më shumë i shtynë ato që të vazhdojnë me punën si avokatë në procedura kontestimore është pikërisht frika e tyre për

⁵⁴⁵ Clark, B, *Lawyers and Mediation*, Springer, London, 2012, fq. 30

humbjen e mjeteve financiare, respektivisht zvogëlimi i tyre. Kjo është kështu përshkak se ato e dinë shumë mirë se procedurat e medijacionit zgjasin dukshëm më shkurt se sa procedurat kontestimore me ç'rast sa më pak orë në procedurë të medijacionit aq më pak edhe feedback-u monetar. Për këtë pikë ato edhe gabohen pasi që ato përveç se do të kenë lëndë të cilët palët do të duhet t'i përfaqësojnë në procedurë gjyqësore para gjykatësit, ato gjithashtu njëkohësisht mundet edhe të kenë lëndë të cilët zgjidhen në procedurë të medijacionit me ç'rast do të përfaqësojnë edhe klientët e tyre edhe në procedurë të medijacionit. Kuptohet për këtë do të kenë edhe benefite financiare, gjegjësisht do të kenë të drejtë për shpërblim të punës së tyre në bazë të tarifës e cila do të rregulloj shpërblimin e avokatëve në procedurë të medijacionit. Bile ato duhet të kenë parasysh edhe faktin se shpërblimi i tyre në procedurë të medijacionit në krahasim me atë në procedurë kontestimore vjen më shpejtë si rezultat i zgjidhjes së kontestit dhe përfundimit më të shpejtë të procedurës së medijacionit. Sidoqoftë edhe nga shumë hulumtime shkencore të cilët janë marrë me këtë problematikë por edhe në praktikë vërehet një mendim i përhapur publikisht në bazë të veprimeve të avokatëve të cilët na bëjnë të shohim qartë se rezistenca e tyre bëhet pikërisht për shkak të frikës së humbjes të të ardhurave. Por ajo që avokatët nuk arrijnë ta shohin përshkak se janë shumë të preokupuar me faktorin “para” në gjithë këtë mes është ajo se ato konsiderohen faktor më i madh edhe se gjyqtarët për zhvillimin e medijacionit sidomos për nga këshillimi i palëve që të drejtohen tek medijacionit për zgjidhjen e kontesteve të tyre. Ai duhet t'i informoj palët për benefitet dhe përparësitë që ka medijacionit si dhe zgjidhja e kontestit me anë të medijacionit. Gjithashtu rol të rëndësishëm luan edhe tek arritja e vendosjes të “balansit të fuqisë” ndërmjet palëve të cilët nuk konsiderohen të barabartë për nga ana emocionale, psiqike të cilën e përmendëm më lartë në këtë punim, me ç'rast do t'i mbroj ato gjat procedurës së medijacionit dhe do t'i bëj të ndjehen të fuqishëm gjat bisedimeve me palën tjetër kontestuese dhe medijatorin si palë e tretë neutral. Dhe në fund, avokatët njëjtë sinë procedurë kontestimore kanë një qëllim primar dhe atë: dhënja ndihmë palës që të mundet sa më shpejtë dhe sa më lehtë të arrij deri në një zgjidhje të pranueshme dhe të përshtatshme për të.

Faktori i tretë i cili kontribon në rezistencën ndaj procedurës së medijacionit janë pikërisht qytetarët përfshirë në këtë grup edhe ato qytetarë të cilët kanë ndonjë kontest të caktuar. Kjo është pasojë nga shkak i mosinformimit të mirë dhe mos dijes së tyre në lidhje me egzistimin e medijacionit si pikë e parë, e pastaj edhe nga mosdija e tyre për atë çka medijacionit si procedurë të jep. Se nuk kanë dijeni të mjaftueshme për medijacionin si praktikë e cila veç më

zbatohet dhe është e rregulluar me ligj flasin edhe të dhënat nga anketa kushtuar qytetarëve e përpunuar në pjesë e pestë respektivisht kapitullin e tetë të këtij punimi, rezultatet e të cilës konsiderohen shumëdëshpëruese. Bile bile, qytetarët janë shumë më pak të informuar nga gjyqtarët dhe avokatët e tyre për mundësinë që ato kanë që të zgjidhin kontestsin e tyre me jashta gjykatave. Sidomos në mosdijenin dhe mos marjen e guximit që të vendosin për medijacion vet qytetarët vjen si rezultat i rezistencës të cilët avokatët e bëjnë ndaj medijacionit.

Nga kjo mundemi të vijm në përfundimin se tek ne egziston ai aversion ndaj medijacionit nga ana e gjyqtarëve dhe më shumë nga ana e avokatëve të cilët dukshëm ndikojnë në psikikën dhe guximin e palëve por edhe në informimin e tyre për zgjedhjen e medijacionit si procedurë që përveç procedurës kontestimore me tëndihsta do të dëshironte të zgjidhte kontestin e tij. Kjo vjen ndoshta si pasojë e asaj se ato kanë frikë për pozicionet e tyre, për humbjen e privilegjeve të tyre si dhe e mendimit se medijacionit është një procedurë e cila e mohon procedurën kontestimore, kur në fakt është e kudnërta, ajo e ndihmon atë si alternativë e saj. Duhet të potencohet se në një shoqëri gjykatat gjithmon do të kenë vend të posaçëm sidomos në atë të zgjidhjeve të kontesteve, dhe shumë gjat do të konsiderohen si metoda primare e dhënies të mbrojtjes juridike ndërsa medijacionit do të jetë aty që t'ua liroj dhe lehtësoj rrugën që të konsiderohet procedura kontestimore procedurë efikase.

5. Interesim i vogël tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë për medijacionin si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve

Kaluan 13 vite nga viti kur medijacioni u kurorëzua me një kornizë ligjore me të cilën në atë kohë mendohej se i'u dha fund problemeve të cilët shkaktoheshin përshkak të mos rregullimit me një ligj, e cila do të zgjidhte shumë probleme sidomos atë të zbatimit në përmasa më të mëdha të medijacionit në shoqërin tonë. Mendohej se kështu do të rriteshte informimi i qytetarëve në lidhje me medijacionin dhe egzistimin e tij por edhe siguria e përdorimit dhe zgjidhjes së kontestit të tyre me procedurën e tillë. Kaluan po aq vite, brenda të cilës periudh deri diku proklamoheshin avantazhet e procedurës së medijacionit dhe promovoheshte e njejta. Dhe përsëri jemi në një situatë ku në krahasim me disa vite më herët, medijacionit nuk përdoret nga njerëzit në atë masë e cila priteshte që të përdoret. Nga viti 2016 kur edhe u vëndos detyrimi ligjor i medijatorëve të licencuar që të paraqesin procedurat e medijacionit të cilët ato kanë zbatuar pa mar parasysh suksesit përfundimtar të procedurës në Ministrinë e Drejtësisë, mundet

lirisht të konstatohet se ky numër i cili deri më sot shpreh procedurat e inicuar nga medijatorët në Republikën e Maqedonisë, nuk është edhe aq i kënaqshëm sa që priteshte të ishte. Janë 1462 lëndë kontestuese të cilët janë tentuar të zgjidhen me anë të medijacionit në gjithë teritorin e Republikës së Maqedonisë. Ky është një numër i cili konsiderohet shumë i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të lëndëve kontestimore të cilët janë zgjidhur dhe të cilët ende janë në pritje të zgjidhjes së tyre nëpër gjykatat kontestimore të Republikës së Maqedonisë.

Ku qëndron problemi i interesimit aq të vogël të qytetarëve për procedurat e medijacionit? Sot, kemi medijatorë të licencuar, kemi procedurë të medijacionit të rregulluar me ligj si dhe punohet në promovimin e saj e cila edhe nuk duhet të jetë problem nga shkakut se në dorë i kemi të gjithë mjetet me të cilët mundena të informohena shumë lehtë dhe shumë shpejtë: internetin, telefonët celular smart, televizor, radio e të ngjajshme. Me anë të medijacionit mundet të zgjidhen kontestet të spektrit të madh e të gjërë: kontestet civile, tregtare, pronëso- juridike, familjare, të punës, por edhe kontestet nga sfera penale me padi private, por edhe përkundër këtyre mundësive që u jepen qytetarëve të Republikës së Maqedonisë që sa më shpejtë dhe me më pak shpenzime të zgjidhin çështjet kontestuese të tyre, si dhe duke i ditur mangësit e gjyqësorit (edhe nëse nuk janë të informuar mirë nga ana tjetër për përparësit e procedurës së medijacionit), fatkeqësisht ato përsëri u drejtohen gjykatave nga të cilët kërkojnë zgjidhjen e kontestetit të tyre dhe t'u jepet mbrojtja e nevojshme e të drejtave të tyre. “ Shumë qytetarë ishin të interesuar për këtë procedurë, vinin tek unë në zyrë, më pyetnin për atë dhe tregonin entuziazëm. Por, pastaj, shumica prej tyre nuk u kthyen më. Nuk janë të sigurt, sepse kanë mentalitet: se vetëm kur gjykata do të sjellë aktgjykim, atëherë ka fuqi dhe sanksion.”⁵⁴⁶ Kjo e vërteton dhe e rivërteton konstatimin se palët drejtohen tek gjykatat kontestimore në shtetin tonësi mënyrë e vetme e realizimit të të drejtave të tyre si rezultat i frikës dhe pasigurisë që kanë ndaj procedurës së medijacionit.

Kështu, është i pakontestueshëm fakti se është mentaliteti ai në të cilën mundemi të kërkojmë shkaqet e mospjesëmërisë së medijacionit, dhe me këtë frika e tyre se nuk do të fitojnë atë të cilën ato e meritojnë nëse vendosen për medijacionin. Por kjo në masë të madhe ka lidhshmëri edhe me mosinformimin adekuat dhe të mjaftueshëm për medijacionin. Mediat e bëjnë punën e tyre gjë e cila shihet edhe në anketën e qytetarë, pasi që shumica prej tyre repsektivisht 31.76%

⁵⁴⁶ Intervistë me medijatorin Besnik Kamberi nga qyteti i Tetovës e realizuar në vitin 2012 nga Deutsche Welle, <https://www.dw.com/mk/каде-е-медиацјајата-во-полза-на-граѓаните/a-16181394>

janë përgjigjur se kanë fituar njohuri për medijacionin nga mass mediat, por ajo e cila është dëshpëruese është se numri më i vogël i qytetarëve më sakt vetëm 5.88% janë informuar për medijacionin nga gjykatat dhe nënpunësit e tyre. Se egziston medijacionit, se është e rregulluar me ligj dhe cilët janë benefitet e saj, më së miri janë të informuar dhe trajnuar gjithashtu gjyqtarët të cilët kanë edhe obligim ligjor për informim të palëve për medijacionin si metodë alternative e zgjidhjeve të konetsteve, nënpunësit gjyqësor, medijatorët, avokatët, juristët por edhe organet të cilët ndonjëherë janë pjesmarës në konetste të caktuara, si p.sh Qendra për punë dhe politikë sociale e të ngjajshme. Jemi të mendimit se ato janë faktori kyç të cilët mundet të ndikojnë direkt në informimin më të madh të qytetarëve për medijacionin. Kështu preferohet një angazhim më i madh dhe më aktiv i tyre nëpërmjet të kampanjave, puntorive, trajnimeve ku do të jenë pjesmarës edhe qytetarët e rëndomtë me qëllim që të njejtit të jenë më të informuar për këtë metodë alternative të zgjidhjes së kontestit të tyre. Me një fjalë, duhet të punohet në drejtim të afrimit sa më të madh të medijacionit tek qytetarët. Me promovimet, kampanjat, puntorit e të ngjajshme duhet të ndërmeren veprime të cilët do të promovojnë medijacionin nëpërmjet të reklamave nëpër medium në intervale kohore më të shpeshta gjat ditës ose javës, nëpërmjet fletave promovuese të cilët do të shpërndahen nëpër institucionet dhe organet e ndryshme në të gjitha qytetet e Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu jemi të mendimit që edhe Oda e medijatorëve duhet të punojë në këtë drejtim. Që nga themelimi i saj kanë kaluar dy vite, dhe konsiderohet se nuk kanë bërë ndonjë aktivitet plotësues për promovim të medijacionit. Sa i përket Odës së Medijatorëve në Republikën e Maqedonsië, jemi të mendimit që të njejtit të promovojnë veten e tyre dhe me këtë edhe medijacionin në Republikën e Maqedonsië duke përdorur mediat dhe internetin (afirmimi i tyre nëpërmjet tëwebfaqes së Odes së Medijatorëve, duke u paraqitur shpesh në formë të reklamimit dhe promovimit nëpër mediat sociale si Facebook, Instagram, Tëitter e të ngjajshme të cilët janë mjaft të përdorura dhe të vizituara nga ana e qytetarëve).

Edhe pse si fajtor kryesor të cilët konsiderohen se bartin përgjegjisin më të madhe për mos suksesin e medijacionit në Republikën e Maqedonisë nga kjo del se janë ato të cilët në përditshmëri miren me çështje juridike nga më të ndryshmet, janë pikërisht qytetarët ato të cilët në mënyrë të drejtperdrejtë kanë fajin më të madh për mos suksesin sa i përket zbatimit të madh të procedurës së medijacionit në shtetin tonë. Janë të menduarit e tyre, qëndrimet e tyre lidhur me medijacionin dhe nga ana tjetër për procedurën gjyqësore si dhe mentaliteti i tyre mbi gjithash

ajo që e pengon zhvillimin e medijacionit. Pra mentaliteti i tyre që t'i ikin drejtësisë, mentaliteti i tyre që të vonojë drejtësinë, mentaliteti i tyre qëhumbës të jetë pala tjetër kundërshtare, mentaliteti i tyre në lidhje me satisfaksionin që të shohin palën tjetër kundërshtare të sanksionuar, dhe shumë e shumë mendime e qëndrime të ulta e pa peshë që në fakt e pengojnë medijacionin. Kjo është realiteti në shtetin tonë.

PËRFUNDIM

Sot, egzistenca e medijacionit si metodë e zgjidhjes së kontesteve nuk mundet as të injorohet e as të mohohet. Edhe pse sot kushtet janë më të volitshme për funksionimin më të mirë të gjyqësorit, ku numri i gjyqtarëve dhe avokatëve është në rritje e sipër, problem i mbingarkesës është një çështje e cila në asnjë mënyrë nuk mundet të menjanohet nga shkaku se numri i kontesteve ndërmjet qytetarëve është shumë i madh dhe nuk ka tendenca të zvogëlohet. Fakti se palët me të madhe zgjedhin procedurën gjyqësore për të zgjidhur kontestet e tyre nuk arsyetohet aspak. Kontestet e gjata gjyqësore të cilët përfundojnë me rezultate jo të kënaqshme për palët dhe me shpenzime të mëdha nuk e arsyetojnë zgjidhjen me anë të procedurës gjyqësore klasike, por nga ana tjetër arsyeton futjen e metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve përfshirë këtu medijacionin. Në këtë periudhën e fundit, termi zgjidhje alternative e kontesteve në vete përmban edhe idenë e metodave bashkvepruese me procedurën kontestimore, sepse është e pamohueshme e drejta e qytetarëve që mbrojtjen juridike të mund ta kërkojnë në gjykatat ku ato jetojnë dhe veprojnë. Për atë shkak edhe në skenë me të madhe paraqiten dhe promovohen metodat e ADR ose metodat e zgjidhjes alternative të kontesteve të cilët veprojnë jashtë gjyqësorit edhe pse mundet të jenë të lidhur me të (p.sh medijacioni i ankesuar nga gjykata). Qytetarët duhet njëherë e përgjithmon të kuptojnë që zgjidhja e kontesteve të tyre në gjykatë të jetë zgjedhja e fundit e tyre, sidomos atëherë kur kontesti i tyre mundet të zgjidhet edhe në mënyra tjera. Ato gjithashtu duhet të kuptojnë se kjo nuk nënkupton se këto metoda zavendësojnë gjyqësorin gjegjësisht procedurën gjyqësore. Ajo do të vazhdojë të jetë procedura e rregullt dhe primare si dhe dominante e zgjidhjes të kontesteve. Por kjo nënkupton vetëm një mundësi që kontestet të zgjidhen më shpejtë, më lehtë dhe më lirë. Kështu, në masë të madhe arrihet i nejtë

qëllim si në procedurë kontestimore por me disa cilësi më të mira si mbrojtja më e shpejtë dhe më kualitative si dhe shkakrimi i gjyqësorit dhe mosprishja e marrdhënieve të palëve, por përkundrazi riregullimi i tyre.

Medijacioni në këtë punim u definua si një procedurë në të cilën palët me ndihmën e palës së tretë neutrale – medijatorit arrijnë që kontestit të tyre t'i japin fund me nënshkrimin e marrëveshtjes për medijacion. Ky person i tretë neutral në asnjë mënyrë nuk mundet të imponojë një mënyrë të zgjidhjes të kontestit si dhe i nejtë të përfundoj me vendimin e tij. Janë palët ato të cilët kanë fjalën e fundit këtu. Momenti kur ato kuptojnë se zgjidhja e gjith problemeve të tyre qëndron në duart e tyre, krijojnë një satisfaksion të papërshkrueshëm për to. Gjithashtu kjo ndikon edhe në sistemin juridik të shtetit e cila mundëson funksionim më të mirë dhe më të lehtë, dhe në fund të gjithë dalin të kënaqur, e mbi gjithash palët janë ato të cilët janë të kënaqur, sepse fundi i fundit mbi ardhmërinë e tyre vendoset. Kjo është edhe karakteristika më e fortë e medijacionit e cila e bën të dallojë jo vetëm nga procedura e rregullt gjyqësore por edhe nga rradhët e metodave tjera alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Medijacioni nisët nga ideja që të mos ngarkohet gjyqësori dhe njëkohësisht nga ana tjetër të zgjidhet kontesti i palëve, dhe në fund ato të dalin të kënaqur dhe të ruajnë raportet ndërmjet tyre.

Në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë, procedurat e medijacionit dhe procedura kontestimore nga ana tjetër janë dy procedura të pavarura të cilët veprojnë vet, të cilët kanë objektivat e veta dhe të cilët rregullohen me ligjet vetanake të tyre. Kështu as njëra as tjetra nuk e pengojnë zbatimin e njëra tjetrës. Por të dyja kanë një raport ndërmjet vete të cilët i ndihmojnë njëra tjetrës në fakt. Procedura e medijacionit duhet të kuptohet si një fenomen komplementar dhe i lidhur me procedurën kontestimore e cila nëpërmjet të bashkupimit ndërmjet tyre do të arrijnë që të bëjnë revolucion në sistemin juridik dhe atë gjyqësore në Republikën e Maqedonisë e mbi gjithash qytetarëve të saj t'u sigurojnë qasje të shpejtë në mbrojtjen juridike me një procedurë të shpejtë dhe kualitative. Përderisa ecën dhe është në zbatim e sipër procedura kontestimore, palët ose edhe gjykata në bazë të obligimit të tij ligjor që ka, mundet të inicohet procedura e medijacionit si procedurë alternative e zgjidhjes të kontestit. Edhe pse është e paraparë me ligj, kjo praktikë thuhet nuk praktikohet aspak. Mënyra më e shpeshtë e incimit të procedurës së medijacionit nga ana e palëve është rast më i shpeshtë i cili paraqitet në praktikën e përditshme të procedurës së medijacionit. Por, kur jemi tek iniciimi i

medijacionit nga ana e palëve si rast më i shpeshtë e kemi fjalën tek inicimi jasht procedurës kontestimore dhe pavarisht asaj. Inicimi i procedurës së medijacionit nga ana e palëve dhe me udhëzim të gjykatës në procedurë kontestimore gati se nuk zbatohet dhe kjo e vëndon në pikpyetje zbatimin e detyrueshëm të procedurës së medijacionit gjat procedurës kontestimore. Konsiderohet si e rëndësishme ndërmarja e disa veprimeve që të përmirësohet kjo gjendje e krijuar në gjyqësorin respektivisht në sistemin juridik të shtetit tonë të cilët do t'i shtjellojmë në vazhdim në këtë pjesë.

Proceset hulumtues udhëheqëse në këtë punim të doktoraturës të cilët dhanë kontributin e tyre në përpunimin dhe vërtetimin e hipotezave të cilët ishin edhe objektiva të këtij punimi, ishin dy, përpunimi i të dhënave statistikore – METODA STATISTIKORE dhe përpunimi i të dhënave të fituara nga anketat - ANKETA. Me metodën e parë, atë statistikore qëllimi kryesor ishte të arrihet deri në konstatime të sakta lidhur me pëdorimin real të procedurës kontestimore në Republikën e Maqedonisë dhe me këtë edhe në ç'far mase realizohen e pritshmërit dhe qëllimet të cilët dëshirohen të arrihen me anë të zbatimit të kësaj procedure. Nëse analizojmë të dhënat statistikore të përpunuara për çdo vitë duke nisur nga viti 2016 deri më sot do të vërejmë një situatë jo shumë të qartë, përfundimi i të cilës për t'u sjellur do të ishte “mission impossible”. Kjo është kështu pasi që nuk kemi një rritje/ulje jo shumë stabile të themi të numrit të lëndëve respektivisht të procedurave të medijacionit të inicuar nga ana e medijatorëve në Republikën e Maqedonisë. Kështu, në vitin 2016 kemi vetëm 64 procedura të medijacionit, e pastaj në vitin 2017 kemi njësituate të rritjes bombastike, rritje të numrit të procedurave të medijacionit për 902. Ndërsa pastaj në vitin pasues vjen edhe dëshpërimi më i madh, i uljes drastike të numrit të procedurave. Kështu, në vitin 2018 numri i përgjithshëm i procedurave të medijacionit ishte 293 procedura, çka është vetëm 1/3 e numrit të procedurave të vitit kalues. Sa i përket vitit 2019 nuk mundemi ta konsiderojmë këtë vit si një tregues dhe faktor i madh i cili do ta ndihmoj që të sjellim ndonjë konkludim kualitativ nga shkakun se të dhënat janë gjysmake përshkak të mospërfundimit të vitit. Mirpo kështu siç ka shkuar puna deri në shtator, besohet se nuk do të ketë ndonjë përmirësim të skajshëm për të mirë deri në fund të vitit. Pra, kemi nga një ulje, një rritje drastike e pastaj prap në ulje drastike. Si mundet të spjegohet kjo? Cilët faktor kanë ndikuar për një situatë të tillë? D.m.th trendi i medijacionit nuk është në rritje ashtu siç priteshte fillimisht me sjelljen e ligjit mbi medijacion, e pastaj edhe me organizimin e medijatorëve në Odën e medijatorëve të Republikës së Maqedonisë të cilët kishin të vetmin qëllim, të punohet për

zhvillim të medijacionit në Republikën e Maqedonisë. Nëse në vitin 2017 rritja e madhe e procedurave të medijacionit ikushtoheshte promovimit më të madh të medijacionit nga ana e medijave, gjykatave e institucioneve tjera, atëherë përse në vitin 2018 kemi ulje të procedurave, situatë e njejtë e cila vërehet edhe në vitin jo ende të përfunduar të 2019. Edhe pse nuk kemi të dhëna të cilët to ta vërtetonin një gjë të tillë, konsiderohet se situata e paraqitur si rezultat i të dhënave statistikore vjen përshkak të mospromovimit të mirë të medijacionit dhe me këtë ka mungesë të informimit tek publiku i gjërë se çka është procedura e medijacionit, kur përdoret, për çka përdoret, ç'far janë përparësit e saj e të ngjajshme. Kjo gjithashtu mundet lehtë të vërtetohet në anketën kushtuar qytetarëve në pyetjen se nga kush kanë marrë informacionet e para qytetarët për medijacionin, analiza e të cilës do të përpunohet më poshtë.

Nga viti 2016 deri më sot me procedurë të medijacionit janë zgjidhur 76% i kontesteve respektivisht nga 1462 procedura, 1105 procedura të medijacionit kanë përfunduar me sukses. Kjo është një tregues i mirë dhe shumë shprehshëm se medijacionit dhe qëllimet e saj funksionojnë në sistemin tonë juridik, edhe pse numri i procedurave të cilët zbatohen me anë të medijacionit nuk është aq i madh sa numri i përgjithshëm i procedurave kontestimore e cila do të ndikonte dukshëm në shkarkimin e gjykatave nga lëndët e tepërta të pazgjidhura. Gjithashtu në bazë të analizës të të dhënave për secilën vit për të cilët kemi të dhëna për procedura të inicuar të medijacionit, do të vërehet se procedurat tregtare janë ato të cilët mbizotrojnë në secilën vit përveç në vitin 2017 ku në vend të parësi procedura më të zbatuara ishin ato për konteste të punës. Numri i përgjithshëm i procedurave të zbatuara me medijacion për konteste tregtare nga viti 2016 deri në shtator të vitit 2019 janë 487. Ky numër i cili konsiderohet 1/3 e numrit të përgjithshëm të procedurave të kontesteve të bazave të ndryshme është si rezultat i bërjes të detyrueshme inicimi i procedurës së medijacionit për konteste tregtare me vlerë deri në një milion denarë, me ç'rast palët fillimisht duhet të tentojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të medijacionit.

Me metodën e dytë, pra më anë të anketës për qytetarët u mundësua që të mblidhen një numër i konsiderueshëm i të dhënave, përpunimi i të cilave na ndihmoj që të vim deri në disa përfundime konkrete. Është i pamohueshëm fakti se në shumë raste qytetarët të cilët në sferën e tyre private apo të punës të involvohen në marrdhënie të natyrave të ndryshme nga të cilët hasin shpesh konteste me subjekte tjera. Kjo situatë është kështu nga shkak se secila prej palëve

dëshiron që me pretendimet e tij të fitoj atë që dëshiron, duke mos marur parasysh faktin se çfarë dëmi mundet ti shkaktohet palës kundërshtare. Kontestet e tilla mundet të zgjidhen me anë të procedurës standard gjyqësore e cila njihet për nga zbatimi i gjat dhe shumë i kushtueshëm, dhe pikërisht për këto dy faktor u paraqit nevoja e gjetjes të alternativave tjera që do të mundësonin atë të cilën nuk mundet ta siguroj procedura kontestimore. E kush më mirë se sa procedura e medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve mund të realizoj këto dy qëllime? Qytetarët janë të mendimit se është zgjidhje e mirë që kontestet të zgjidhen me anë të marrëveshtjes jasht procedurave gjyqësore pasi që janë në dijeni se procedurat gjyqësore janë konsumues të mëdha të kohës dhe të mjeteve financiare gjithashtu. Ajo e cila është shqetësuese nga kjo anketë është fakti se qytetarët e Republikës së Maqedonisë kanë mungesë të informimit të egzistimit të medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve, rregullimin juridik të saj në sistemin tonë juridik si dhe për punën e medijatorëve si palë e tretë neutrale të cilët ndihmojnë palët të arrijnë deri në zgjidhjen e kontestit të tyre. Faji i kujt është shkaktimi i kësaj gjendje? Përdërisa mediat kanë bërë deri diku punën e tyre, janë pikërisht gjykatat, avokatët por edhe organet e institucionet ato të cilët nuk bëjnë promovimin në shkallë të duhur të medijacionit. Jo rastësisht numrat nga anketa janë ku të vogla në krahasim me atë se si duhet të ishin nëse këto kryenin obligimin ligjor në mënyrë të duhur, që do të mundësonte që medijacionit para qytetarëve të ishte një mundësi zgjedhjeje kur ato do të kishin një kontest për zgjidhje. Pra qytetarët nuk kanë mundësi që t'i njohin nga më afër përparësit e medijacionit dhe benefitet e saja. Për atë shkak jemi të mendimit se shteti edhe pse nga njëra anë mundohet që nëpërmjet të ligjeve dhe subvencioneve të ndihmoj medijacionin, përsëri është edhe një barrë plus për të investimi në këtë drejtim sepse shpenzimet të cilët janë shumë më të larta në procedurën klasike gjyqësore, paguhen nga vet palët dhe më këtë dëmtohet buxheti personal i tyre e cila ndikon në mënyrë të pashmangshme edhe në ekonominë e shtetit gjithashtu. Edhe pse shumica e të anketuarve kanë pasur kontakt të parë me konteste, të njëjtit nuk kanë pasur kontakt me medijacionin. Kjo është një situatë e cila përsëri ndërlidhet me çështjen e mungesës së informimit të tyre. Si faktor pozitiv në pranimin e novacioneve, në këtë rast të medijacionit në sistemin tonë juridik është se shumica janë për zgjidhjen e kontesteve të tyre në të ardhmen me anë të medijacionit, por nga ana tjetër numër shumë i përafërt me to është edhe ajo se ato nuk mundin të vendosin a do të drejtohen në gjykatë apo tek medijatori për të zgjidhur kontestin. Jo edhe rastësisht kjo mosvendosje sjell deri në pasiguri në lidhje me atë se si do të mundet të

zgjidhet kontesti i tyre me anë të medijacionit, a do të dalin të dëmtuar nga gjith ky proces, a do të fitojnë atë të cilën ato e kërkojnë. Suma-sumarum –pytja e tyre është: sa është e sigurtë medijacionit për të zgjidhur kontestin e tyre? Kjo pyetje ndërlihet edhe me ardhëmirinë e medijacionit në Republikën e Maqedonisë dhe me skepticizmin e mbijetesës së medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve në shtetin tonë.

Në rradhët e metodave empirike gjithashtu një njohuri të rëndësisë së madhe arritëm edhe nëpërmjet të anketës të cilës i'u përgjigjën medijatorët. Medijatorët janë të mendimit se edhe përkundër numrit jo shumë të madh të procedurave të medijacionit të zbatuara në këto 3-4 vite të fundit, medijacionit është metoda më e mirë për zgjidhjen e kontesteve duke i marrë parasysh gjithmon përparësit të cilët kjo procedurë i ka dhe të cilët gjithashtu realizohen. Sidomos përshtatshmërinë e kësaj metode të zgjidhjeve të kontesteve e shohin në zgjidhjen e llojit të madh të kontesteve sinë ato tregtare, të punës, pronësoror-juridike, familjare dhe nga sfera e sigurimeve. Analiza e të dhënave nga ky hulumtim gjithashtu tregojnë se medijacionit duhet të jetë obligativ edhe për kontestet tjera njëjt si është obligativ për kontestet tregtare të vlerës deri në një million denarë, pasi që atëherë numri i kontesteve të zgjidhura me anë të medijacionit do të rritet dukshëm njëjt si është rritur për kontestet tregtare. Edhe pse qëllimi kryesor e cila priteshte të realizohet me anë të futjes së medijacionit në sistemin juridik si rezultat i reformave të gjyqësorit në këtë shtet ishte shkarkimi i gjykatave nga lëndët e tepërta të cilët rëndojnë në fiokat e gjyqtarëve, medijatorët janë të njëzërit se ky rast nuk është me medijacionin gjë e cila vërtetohet edhe me numrin mjaft të vogël të procedurave të inicuar dhe të zgjidhura me anë të medijacionit të siguruara nga Minsitja e Drejtësisë në krahasim me numrin e madh të lëndëve kontestimore të cilët presin rradhë për zgjidhje nëpër gjykatat e Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu pretendimet e palëve se gjykatat në shtetin tonë nuk e bëjnë punën e tyre për sa i përket informimit të palëve për medijacionin dhe të njëjtëve t'u propozoj inicim të medijacionit për të zgjidhur kontestin e tyre, i vërtetojnë edhe medijatorët të cilët në asnjë rast nuk kanë pasur inicim të procedurës të medijacionit si rezultat i propozimit nga ana e gjykatave. Në këtë segment duhet të bëhet ndryshim nga ana e legjislatorit i cili duhet të siguroj ndonjë mehanizëm më të suksesshëm që gjyqtarët të ndryshojnë qëndrimin e tyre në lidhje me egzistimin dhe zbatimin e procedurës së medijacionit si një alternativë e procedurës të cilën ato e zbatojnë dhe e cila do t'u vinte në ndihmë shumë të madhe sidomos për heqjen nga qafa lëndët të cilët kinsiderohen të thjeshta për zgjidhje por të cilët edhe ato marrin një kohë të konsiderushme dhe

kualitative nga puna e gjyqtarëve. Medijacioni nuk zbatohet mjaftueshëm dhe nuk ka progress në këtë fushë aq sa pritet të zbatohet dhe aq sa pritet të ketë progres. Kjo vërtetohet nga mendimi i medijatorëve dhe njëkohësisht edhe nga numri i procedurave të zbatuara këto vitet e fundit. Kjo është si rezultat i rregullimit të pjesërishëm të medijacionit nga ana e ligjvënësit ku vërehen hapsira për rregullim plotësues të disa çështjeve tjera të cilët do të përmirësojnë gjendjen e krijuar sot nga zbatimi i pamjaftueshëm i medijacionit si, përshembull zgjerimi i zbatimit të medijacionit të detyrueshëm edhe në fusha tjera të të drejtës përveç se në atë tregtare. Optimizëm ka për perspektivën e medijacionit në Republikën e Maqedonisë në krahasim me qytetarët të cilët nuk ishin të sigurtë për një ardhmëri në sistemin juridik të këtij shteti, por me një punë më të madhe që të arrihet ky qëllim si nga ana e mediave ashtu edhe nga ana e gjykatave dhe institucioneve shtetërore me qëllim që t'i afrojnë qytetarët me medijacionin si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve të tyre.

Një pjesë të madhe në pjesën e fundit të punimit i'u kushtua përparësive dhe mangësive të medijacionit ose siç njihet me termin internacional avantazhe dhe disavantazhe të procedurës. Si pikë e parë u konstatua se nëse i peshojmë, në përparësi janë avantazhet e procedurës së medijacionit të cilët edhe e arsyetojnë inicimin dhe zbatimin e procedurës së medijacionit si metodë alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Gjithashtu konstatuam se ato dalin si rezultat i parimeve themelore në të cilët bazohet e gjithë procedura kontestimore të cilët parime janë të parapara si në ligjet nacionale ashtu edhe në dokumentet ndërkombëtare lidhur me medijacionin. Njejt siç janë parimet të lidhura njëra me tjetrën e cila lidhshmëri mundëson realizimin e qëllimeve të procedurës së medijacionit u konstatua se edhe këto përparësi lidhen njëri me tjetrin në mënyrë dijalektike duke u kushtëzuar dhe mbështetur njëri me tjetrin. Medijacioni vullnetar është njëra ndër parimet bazë të procedurës së medijacionit por njëkohësisht edhe përparësia e cila e bën që të dallohet nga procedura kontestimore për nga karakteri detyrues i saj. Karakteri vullnetar u'a lejon palëve që ato vetë të bëjnë çka të duan në lidhje me kontestin, kjo kështu me plotkuptimin e fjalës. Pra, kjo u'a lejon palëve që ato ta modelojnë dhe dizajnojnë procedurën dhe normalisht edhe përfundimin e saj sipas dëshirës dhe vullnetit të tyre. Sigurisht, duhet të potencohet se nuk është e prerë qartazi çështja e kuptimit të karakterit vullnetar. Kjo sidomos është vështirësuar edhe nga momenti kur filluan që kontestet tregtare me vlerë deri në një million denarë që zgjidhen në medijacion të detyrueshëm, por edhe me obligimin e gjykatës që palët t'i udhëzoj në procedurë të medijacionit me ç'rast medijacionit vullnetar u vë në masë të caktuar

nën hije. Kjo sidomos në rastet kur gjykata udhëzon palët të inicojnë procedurë të medijacionit, ose për shembull kur ligji obligon palët siç është rasti me kontestet tregtare që të zgjidhin kontestin në procedurë të medijacionit. Ose rast tjetër kemi kur palët me marrëveshje kanë paraparë klauzulën e medijacionit në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti të tyre, si edhe atëherë kur menaxheri ose drejtori i ndonjë kompanie i urdhëron puntorët e kompanisë së tij që kontestet e tyre në lidhje me aktivitetin të cilën e kryejnë në atë kompani ta zgjidhin me anë të medijacionit. A e cënon kjo karakterin vullnetar të medijacionit? Ashtu si edhe e përmendëm më lartë në punim, edhe pse në shikim të parë konsiderohet se medijacionit i detyrueshëm bie në kundërshtim me parimin por edhe përparësin e cila e bën të dallojë procedura e medijacionit nga procedura gjyqësore – karakterin vullnetar, në fakt nuk është ashtu pasi që ky shprehet në momentin kur palët nënshkruajnë marrëveshjen me të cilën dakordohen për medijacion. Detyrueshmërija nga ana tjetër shprehet vetëm në fazën e shtyrjes të palëve në procedurë të medijacionit por jo edhe të vendosjes së saj për medijacion. Me këtë palëve nuk u humbet e drejta që mbrojtjen juridike ta kërkojnë nëpër gjykatat e Republikës së Maqedonisë, por vetëm e shtynë këtë duke i dhënë shancë medijacionit por edhe palëve që vet të zgjidhin kontestin e tyre e cila është rezultati përfundimtar i një sërë veprimesh për të të cilët palët kanë privilegjin që vet të vendosin si rregullat e zbatimit të procedurës së medijacionit, zgjedhja e medijatorit i cili do t'u ndihmoj gjat gjithë kohës sa zgjat procedura, vendi dhe koha e mbajtjes së takimeve ndërmjet tyre dhe medijatorit e të ngjajshme.

Gjithashtu u konstatua se ashtu siç janë të ndryshme dita me natën ashtu edhe procedurat e medijacionit dhe ajo kontestimore janë të ndryshme kur vjen te ajo se çka meret për bazë për zgjidhjen e nje kontesti. Përderi sa në procedurë kontestimore kontesti zgjidhet duke u bazuar në aspektet juridike të saj, medijacioni shkon më tej se ajo. Në rend të parë i vendos nevojat dhe interesat e palëve. Kjo mundëson që në procedurë të medijacionit rezultati përfundimtar i zgjidhjes të kontestit të jetë i favorshëm për të dyja palët pasi që miren në konsideratë nevojat dhe interesat e të dyja palëve në kontest, që nuk është rasti në procedurë kontestimore. Në bazë të këtyre nevojave dhe intersave të cilët palët i shprehin gjat procedurës, atyre u jepet e drejta dhe privilegji që të mundet vet ta dizajnojnë zgjidhjen e cila do të jetë e përshtatshme për të dyja, një zgjidhje e cila do ti jepte fund kontestit të tyre, një zgjidhje e cila do të mundësonte rirregullimin e marrdhënieve ndërmjet tyre të cilët në një masë të madhe apo të vogël ishte e prishur dhe cënuar, si dhe një zgjidhje e cila shprehet në disa forma zgjedhja e të cilës përsëri është në duart

e palëve e cila laramani e zgjidhjeve vjen si pasojë e fleksibilitetit, jo formalitetit të procedurës, zgjidhjeve të shumta të cilët i kanë në duar palët dhe kontrolli ndaj procedurës të cilën përsëri në duar e kanë palët (përparësit veç më të shtjelluatra në pjesën e fundit).

Konfidencialiteti gjithashtu ka një vend të posaçëm në këtë punim. Në dy pjesë të ndryshme të punimit i është kushtuar rëndësi, një her tek shtjellimi i parimeve të procedurës së medijacionit e pastaj edhe tek përparësit e saj. Arsyet pse konfidencialiteti është i rëndësishëm në procedurë të medijacionit janë si dy anët e monedhës, gjithmon shkojnë bashkë. Njëra ka të bëjë me përgjegjësinë juridike e tjetra ka të bëjë me krijimin e një ambienti të favorshëm për palët për zbatim të medijacionit. Pra, konfidencialiteti ka ndikimin e tij si për palët ashtu edhe për medijatorin. Nga ajo që u përpunua për konfidencialitetin në këtë punim u konstatua fakti se konfidencialiteti është një faktor e cila së pari ndikon në ruajtjen e gjith asaj se çka është thënë gjat takimeve me palët dhe medijatorin si dhe jasht procedurës në atë se kur dhe çka mundet medijatori në cilësi të dëshmitarit të jep informacione në lidhje me procedurën e medijacionit, një veti apo karakteristikë që e bënë procedurën e medijacionit unike në krahasim me procedurat dhe metodat tjera të zgjidhjeve të kontesteve.

Hulumtimi krahasues ka dëshmuar se në këto vite të fundit medijacionit favorizohet në masë të madhe dhe në shumë vende të botës sidomos në SH.B.A, Australi legjislacioni i medijacionit i të cilëve ishte temë analizimi dhe shtjellimi në këtë punim, paraqet një ekspanzion të përjetshëm në sistemet juridike të tyre nga përvoja e të cilëve ne mundemi shumë të marrim dhe të njejtat t'i aplikojmë me ndihmën e ligjeve që do të mundësonte një zbatim më të suksesshëm në praktikë.

Nga shkakun se medijacioni doli në skenë shumë më vonë se sa procedura gjyqësore, i duhet shumë kohë dhe punë që të arrijë deri në atë gjendje e cila do mundësonte t'i përparoj avantazhet e saja dhe t'i largoj e ti modifikoj të gjitha mungesat të cilët pengojnë zbatim të gjërë në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë. Për mos zbatimin në masë të duhur të medijacionit fajin e hodhëm në qëndrimet refuzuese të avokatëve, të qëndrimeve të rezervuara të gjyqtarëve të cilët qëndrime janë shumë të dukshme, por edhe në mosinformimi i mjaftueshëm i qytetarëve. Kjo situatë aspak nuk na habit se përse qytetarët duan më shumë të gjykohen se sa të zgjidhin vet kontestin. Për atë edhe themi se medijacionit sot paraqet një mehanizëm i zgjidhjes së kontesteve e cila në Republikën e Maqedonisë duhet tek të ringjallet, të bëhet një praktikë e

përditshme e jo vetëm temë debate në shumë organizime dhe tryeza të rrumbullakta dhe temë e punimeve të ndryshme shkencore. Për një zbatim më të gjërë të medijacionit duhet që informimi të jetë në nivel të lartë për qëllimet e medijacionit, përparësit dhe dobitë e saj, të avancohet korniza ligjore me qëllim që të krijohet një mjedis i përshtatshëm normativ që do të lejonte që potencialet e procedurës së medijacionit në shtetin tonë të shfrytëzohen në maksimum me ç'rast medijacionit do të fitonte vendin e duhur në mesin e metodave të zgjidhjes të kontesteve.

REKOMANDIME

Medijacioni paraqet një veprimtari jashtëgjyqësore dhe mënyrë provate njëkohësisht e zgjidhjes të kontesteve juridike, në të cilën proces vullnetar dhe konfidencial palët arrijnë një zgjidhje të përbashkët të problemit të tyre me nihmën e një apo më shumë medijator të cilët i zgjedhin vet. Medijatorët janë ato të cilët me aftësitë e tyre të komunikimit u japin palëve mundësi që sa më shpejtë të arrijnë deri tek një zgjidhje reciprokisht të kënaqëshme për të dyja palët, e cila zgjidhje edhe pse nuk arrihet brenda hapsirave gjyqësore dhe në procedurë të rregullt gjyqësore, është detyruese për palët pasi që e njëjta mundet të vërtetohet te noteri dhe me këtë të fitoj fuqinë e dokumentit përmbarues. Paraqitjen e medijacionit në botë e ka kushtëzuar nevoja për ardhjen në të drejtën por edhe në kërkesën për dhëniën e mbrojtjes të nevojshme juridike të drejtave të lënduara sa më shpejtë, jo në mënyrë të komplikuar dhe me shpenzime sa më të vogla në krahasim me procedurën kontestimore. Pikërisht këto janë ato benefitet të cilët e kanë bërë që medijacioni të përfshihet në të gjitha sistemet juridike të shteteve bashkëkohore. Periudha nga vitet 80 në qoftë se e marim si piknisje e karakterizuar me zanafillën e medijacionit të rregulluar në mënyrë ligjore në aspekt ndërkombëtar dhe nga ana tjetër periudha nga viti 2006 në Republikën e Maqedonisë, karakterizohen me një promovim më të shprehur të medijacionit me qëllim të vendosjes në skenë si mënyrë e zgjidhjes alternative të kontesteve. Duke pasur parasysh përparësitë të cilët medijacioni i ofron si mehanizëm i mbrojtjes të të drejtave subjektive të njeriut, është një arsye e cila mban peshë që e njëjta të përdoret në shumicën e rasteve kur ndërmjet palëve paraqiten konteste të natyrave të ndryshme të cilët konsiderohen të përshtatshme për tu zgjidhur me anë të medijacionit. Por, medijacioni i ka edhe disavantazhet e veta të cilët e bëjnë që ajo të mos jep ato rezultate të cilët priten te arrihen me përdorimin e saj për zgjidhjen e secilit rast individualisht. Por nëqoftë se i vendosim në peshore përparësit dhe mangësit e medijacionit, do të vërehet një bilanc pozitiv e cila do t'a emëroj medijacionin si një metodë apo

mehanizëm me karakterisitika dhe veti e përshtatshme për tu konsideruar si metoda më e përshtatshme për zgjidhjen e kontesteve juridike civile e pse jo edhe të atyre penale. Arsyet të cilët e mbështesin këtë janë të shumta si: është procedurë fleksibile, ekonomike, efikase dhe e shpejtë, është procedurë jo formale dhe bi të gjitha konfidenciale.

Hulumtimi i bërë dhe rezultatet e fituara nga analiza e të dhënave të fituara mbështeten në disa rekomandime të cilët mendohet se do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në suksesin e medijacionit si metodë e zgjidhjeve alternative të kontesteve juridike në Republikën e Maqedonisë. Rekomandimet vijuese janë këto:

1. Ndërmarja e veprimeve dhe përpjekjeve që nëpërmjet të mehanizmave të duhur dhe të përshtatshëm të ndikohet në informimin dhe edukimin e publikut respektivisht të qytetarëve me qëllim që tek ato të arrihet deri në dijenin për të drejtën që ato kanë për të kërkuar shqrbime nga medijatori. Ky ndikim apo edukim lidhur me medijacioni mundet të realizohet nëpërmjet të organizimeve të trajnimeve të ndryshme në të cilën do të marin pjesë një numër i madh i qytetarëve të statuseve dhe pozitave të ndryshme, ndërsa nga ana tjetër ato të cilët do të jenë përgjegjës për vijimin apo organizimin e këtyre trajnimeve edukative duhet të jenë persona të cilët kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me medijacionin. Kjo do të ndikonte githashtu edhe në monitorimin e kualitetit të medijacionit dhe shërbimeve të cilët jepen me anë të medijacionit.
2. Më shumë të përdoren për publicitet dhe informim, publiciteti nëpërmjet të radios, mediave të printuara, internetit dhe platformave tjera të mediave.
3. Trajnimi i gjyqtarëve të gjykatave themelore të cilët merren me çështje civile të cilët kanë të bëjnë me kontestet të natyrave të ndryshme për të cilët shërbehet me ligje të ndryshme përveç se me Ligjin mbi medijacionin si p.sh Ligjin mbi marrdhënie të punës, Ligji i procedurës kontetsimore, Ligji për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës e të ngjajshme, me qëllim të përorimit më të madh të medijacionit si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve civile si dhe për zvoglimin sa më të madh të lëndëve të cilët janë të pazgjidhura nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë.
4. Ndërmarja e veprimeve edukative të atyre të cilët janë të profesioneve juridike, sidomos për të bërë të njohur qëllimin bazë të medijacionit dhe profesionit medijator e cila në asnjë mënyrë nuk duhet konsideruar si cënim i profesioneve tjera si të gjyqtarëve,

avokatëve dhe rolin të cilën ato kanë në procedurë kontestimore si dhe cënim i institucioneve respektivisht të gjykatës. Por përkundrazi medijacioni nuk është asgjë tjetër përveç se një metodë e cila i ofron ndihmë procedurës gjyqësore dhe me këtë edhe gjykatave, dhe nga ana tjetër zhvillimi i suksesshëm i medijacionit varet shumë nga gjykatat dhe pavarësia dhe transparenca e tyre, pasi që janë pikërisht gjyqtarët ato të cilët ndikojnë në atë sukses duke i drejtuar qytetarët në përdorimin e asaj si një alternativë e gjyqësorit. Prandaj thuhet se gjyqtarët në rradhë të parë si dhe avokatët gjithashtu në njëfarë mënyre konsiderohen si çelsi i suksesit të medijacionit. Kjo pasi që ato me dijen e tyre se çka në fakt është medijacioni dhe çka orfron ajo apo cilët janë benefitet e saj, ndikojnë në suksesin e kësaj metode alternative. Ato do të ndikojnë në atë mënyrë që klientëve apo palëve të cilët do t'u drejtoheshin fillimisht atyre për të zgjidhur një kontest të tyre ta informojnë për egzistimin e një mundësie – medijacionit dhe t'i ndihmoj ato që të bëjnë zgjidhjen e duhur duke u bazuar në nevojat që ato kanë.

5. Përfshirja më e madhe e avokatëve dhe gjyqtarëve në këshillimin e qytetarëve për zgjedhjen e medijacionit para procedurës gjyqësore e sidomos kur shohin se bëhet fjalë për persona me gjendje ekonomike të rënduar, ashtu që do t'i udhëzojnë dhe me këtë rast edhe do t'i njoftojnë për alternativën tjetër – medijacionin, se edhe kjo mënyrë është mënyrë se si mundet që ato të zgjidhin kontestin e tyre më shpejtë dhe me më pak shpenzime në krahasim me atë se si do të ishte nëse do të zgjidheshte në procedurë të rregullt gjyqësore.
6. Sektori për shërbime sociale si shëndetësia, sfera e edukimit si dhe ajo konsumatore kanë nevoj për pjesmarrje më të madhe në edukimin dhe trajnimin për medijacionin pasi që nevoja që medijacioni të përdoret në këto sfera është shumë më e madhe se sa në çdo sferë tjetër. Është kështu pasi që pikërisht këto sfera janë ato në të cilët në masë të madhe janë të përfshirë numri më i madh i popullatës të një shteti apo shoqërie. Dhe sidomos ky fakt e bën që kontestet, mosmarrëveshtjet nga më të voglat apo edhe tensionet ndërmjet qytetarëve të cilët janë pjesmarrës në këto sektore të jenë të shumta. Për atë shkak rekomandohet që medijacioni të jetë prezent në çdo rast për zgjedhjen e këtyre konflikteve, mosmarrëveshtjeve apo tensioneve pasi që vetëm në këtë mënyrë mendohet se e përshtatshme në rend të parë është për të gjithë palët respektivisht qytetarëve si dhe për ruajtjen e stabilitetit dhe mbarvajtës sociale.

7. Gjithashtu si një hap i rëndësishëm e cila dukshëm do të ndikonte në promovimin më të mirë të medijacionit në një shoqëri është që të krijohen parakushte për prezentimin e medijacionit në nivele të ndryshme të edukimit dhe arsimimit, duke nisur nga shkolla e mesme dhe arsimimin e lartë. Në këtë mënyrë ato do të kenë njohuri për egzistimin e medijacionit dhe përparsit e saja që nga fillimi i edukimit të tyre. Gjithashtu e rëndësishme është që njohurit e medijacionit të jenë të kapshëm edhe për ato të cilët janë në fillimet e profesioneve të tyre për atë shkak edhe konsiderohet si e nevojshme që medijacioni të përfshihet në systemin edukativ nëpërmjet të programeve të institucioneve të arsimit të lartë.
8. Universitetet në Republikën e Maqedonisë varësisht të mundësisë që ato kanë në programet e tyre studimore, të mundet të vendosin medijacionin si lëndë studimore e pse jo edhe nga lëndë zgjedhore të bëhet lëndë obligative në Fakultetin juridik në të dyja ciklet, ato deri diplomike dhe pasdiplomike. Edhe pse disa nga fakultet juridike në disa nga univerzitetet në shtetin tonë kanë të paraparë si lëndë zgjedhore “ Metodatat alternative të zgjidhjeve të kontesteve” në të cilën përfshihet edhe medijacioni si metodë, rekomandohet që kjo lëndë të parashihet si lëndë obligative pasi që qëllimi i cili arrihet nëpërmjet saj është identike me atë e cila arrihet me anë të procedurës civile. Sidomos kjo lëndë por dhe pse jo me emërim “ Medijacioni si metodë e zgjidhjes alternative të kontesteve” të bëhet obligative në ciklin e dytë të studimeve të drejtimit civil.
9. Të inkurajohen debate nga ana e sferës akademike në formë të paneleve të cilët debate do të eanë një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e medijacionit sidomos në fushën e të drejtës e sidomos nga shkak se vet profesorët univerzitar janë ato të cilët janë të inkorporuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e ligjeve të reja dhe me këtë kanë ndikuar edhe në krijimin e ligjit mbi medijacionin. Gjithashtu konsiderohet si mjaft frytëdhënëse edhe organizimi në kuadër të fakultetit juridik në të gjitha universitetet publike dhe ato private i konferencave në të cilën të ftuar do të thiren kryetari i Odës të medijatorëve si dhe medijator apo edhe përfaqësues të ministrisë të drejtësisë të cilët do të mbajnë ligjerata para studentëve të fakultetit të drejtësisë si dhe të fakulteteve tjera për medijacionin dhe vrytytet e saja.
10. Të bëhet publikim në masë sa më të madhe të punimeve shkencore dhe dokumenteve të ndryshme të cilët do të ndikojnë në promovimin e mënyrave alternative të zgjidhjeve të

kontesteve dhe me këtë edhe të medijacionit si metodë e tillë dhe me këtë edhe në rritjen e shkallës të përdorimit të medijacionit në fushën e të drejtës. Gjithashtu gjat punimeve të ndryshme shkencore të përfshihen edhe studentët e fakultetit juridik për të bërë hulumtime lidhur me medijacionin në Republikën e Maqedonisë.

11. Ndryshime në legjislacionin kombëtar në disa pika të cilët janë shtjelluar një nga një në pjesën e gjashtë e sidomos në përfshirjen e medijacionit të detyrueshëm me qëllim që të realizohet një qasje më e lehtë dhe më e shpejtë deri te e drejta.
12. Mundet të konsiderohet si një hap i mirë krijimi i një sistemi brenda në gjykatat e Republikës së Maqedonisë e cila do të ofroj shërbime por edhe do të shërbej si një informator për medijacionin si metodë e zgjidhjeve alternative të kontesteve sidomos për ato konteste për të cilët ndihma fillestare për zgjidhje kërkohet pikërisht në gjykatat. Si rezultat i kësaj mendohet se do të jetë mjaft frytdhënëse krijimi i info qendrave brenda përbrenda objektivi të gjykatave themelore në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë të cilët do të jenë të obliguar që gjat ditës të japin informacione për medijacionin. Gjithashtu kjo info qendër mundet që në bazë të rregullores të miratuar pikërisht për të mundet të kryej edhe punë tjera si p.sh të mbikqyr programet në lidhje me medijacionin, t'i informojnë qytetarët dhe palët të cilët drejtohen në gjykatë për shërbimet e medijatorit, të japin informata se kush janë medijator, kontaktet e tyre, mënyra se si mundet të zgjidhet një medijator. Gjithashtu kjo infoqendër mundet të jetë kompetente edhe për punë administrative të cilët kanë të bëjnë me shërbimet e medijacionit si p.sh të mbikqyrë dhe të vlersoj punën e medijatorëve si dhe të mbledh të dhënat statistikore të cilët do të jenë treguesi i sakt i suksesit të medijacionit në shtetin tonë. Kjo info qendër gjithashtu përveç se do të jetë përgjegjëse për informimin më të gjërë dhe më të detajuar për medijacionin si procedurë dhe për medijatorët si persona të cilët i ndihmojnë palët që të arrijnë deri në zgjidhjen e kontestit të tyre, ajo gjithashtu mundet që me mbështetjen e gjykatës të organizojnë ndonjë ditë të hapur ose një javë të tërë brenda vitit në të cilën ditë apo javë do ta promovojnë medijacionin si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve dhe e cila ditë ose javë varësisht asaj se si do të vendoset do të konsiderohet dita ose java e medijacionit dhe e njëjta do të bëhet traditë që të organizohet secilën vit në të ardhmen pikërisht për qëllim të promovimit të medijacionit.

Shtojca I Anketa për qytetarët

Hulumtim shkencor

“Medijacioni si metodë e zgjidhjeve alternative të kontesteve civile në Republikën e Maqedonisë“

ANKETË

Të dhënat personale:

Mosha: _____

Gjinia: M
F

Shkollimi: a) fillor
b) i mesëm
c) i lartë
d) fakultet

1. A keni pas ju ose ndonjë i afërt i juaji përvojë në gjykatë deri më sot?

- a) Po
- b) Jo

2. A mendoni se është ide e mirë që kontestet të zgjidhen me anë të marrëveshjeve në mes të palëve në kontest pa përzierjen e gjykatës në atë marrëveshje?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

3. Në sistemin tonë gjyqësor egziston mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve e njohur me termin “ Medijacion “. A keni dëgjuar për një alternativë të tillë?

- a) Po
- b) Jo

4. Medijacioni është procedurë e cila nënkupton atë se dy palët në kontest mes veti arrijnë marrëveshje për të gjetur një zgjidhje të kontestit të tyre pa ndihmën e gjykatës dhe me ndihmën e palës së tretë neutrale/Medijatorit. Pa mar parasysh a keni pasur ose jo përvojë të tillë, si ju duket ideja e zgjidhjes të kontestit?

- a) Ide e mirë
- b) Nuk është ide e mirë
- c) Nuk e di

5. Nëse keni dëgjuar për medijacionin, nga kush jeni njoftuar për këtë?

- a) Mediat
- b) Gjykata ose nëpunësit gjyqësor
- c) Institucione tjera
- d) Miq dhe të afërm
- e) Në mënyrë tjetër

6. A keni njohuri se medijacioni është i rregulluar me ligj në Republikën e Maqedonisë?

- a) Po
- b) Jo

7. A dini kush janë medijator dhe çka bëjnë ato?

- a) Po
- b) Jo

8. A keni pasur përvojë me medijatorë?

- a) Po
- b) Jo

9. Në qoftë se keni ndonjë kontest, a do të vendosni që të njëjtin t'a zgjidhni:

- a) Në gjykatë
- b) Me anë të medijacionit
- c) Nuk e di, nuk mundem të vendos

10. A mendoni se do të mbijetoj medijacioni si metodë alternative e zgjidhjeve të kontesteve?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk jam i/e sigurtë

Shtojca II Anketa për medijatorët

Hulumtim shkencor

“Medijacioni si metodë e zgjidhjeve alternative të kontesteve civile në Republikën e Maqedonisë“

ANKETË

Të dhënat personale:

Mosha:a) 25-40 b) 41-55 c) 56-70

Gjinia:a) M b) F

- 1. A është medijacioni metoda më e mirë për zgjidhje të kontesteve?**
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Pjesërisht

- 2. Në cilën fushë mendoni se medijacioni më shumë përdoret?**

- 3. A mendoni se duhet që medijacioni të jetë obligativ për disa lloje të kontesteve?**
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i/e sigurt

- 4. A mendoni se medijacioni ka kontribuar në efikasitetin e zgjidhjeve të kontesteve?**
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i/e sigurt

- 5. A mendoni se medijacioni ka kontribuar në shkarkimin e gjykatave?**
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i/e sigurt

- 6. Sipas përvojës tuaj si medijator, në të shumtën e rasteve:**
 - a) Gjykata u'a ka propozuar palëve medijacionin
 - b) Avokatët e palëve kanë propozuar medijacionin
 - c) Palët kanë propozuar medijacionin

- 7. A janë të kënaqur palët me medijacionin?**
- a) Shumica janë të kënaqur
 - b) Shumica janë të pakënaqur
 - c) Nuk e di
- 8. A është shkalla e zbatimit të medijacionit e mjaftueshme?**
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pjesërisht
- 9. A vëreni progres në fushën e medijacionit deri më sot?**
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pjesërisht
- 10. A mendoni se medijacioni në sistemin tonë është i rregulluar në mënyrë adekuate?**
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pjesërisht
- 11. A duhet të bëhen ndryshime dhe plotësime të rregullave ligjore në Ligjin për medijacionin?**
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i/e sigurt
- 12. A është niveli i trajnimit të medijatorëve i mjaftueshëm?**
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i/e sigurt
- 13. A mendoni se medijacioni si mënyrë alternative e zgjidhjeve të kontesteve ka perspektivë në Republikën e Maqedonisë?**
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i/e sigurt
- 14. Çka duhet të ndërmiret për zbatim më të gjërë dhe më të suksesshëm të medijacionit?**
- a) Njoftim më i mirë i qytetarëve nga ana e medias
 - b) Njoftim më i mirë i qytetarëve nga ana e gjykatës
 - c) Njoftim më i mirë i qytetarëve nga ana e institucioneve

Shtojca III

*Autorizim për përfaqësim në procedurë të medijacionit për personin juridik i cili
inicon procedurë të medijacionit*

AUTORIZIM

E autorizoj avokatin _____ (të dhënat personale) ta përfaqësoj personin juridik _____ (emri, selia, numri Amë, llogaria bankare, menaxheri, e-mail) në procedurën e medijacionit e cila do të zbatohet nga ana e medijatorit _____ (të dhënat e medijatorit të licencuar), për zgjidhjen e kontestit me personin juridik _____, lënda e kontestit _____ (përshkrim të shkurtër i kontestit) me vlerë të kontestit _____.

Përfaqësimi përfshin këto autorizime: (shembuj) parashtrimi i Kërkesës për zbatim të procedurës së medijacionit; Përfaqësimi në kundërshtime eventuale nës pala kundërshtare e pranon ftesën për medijacion, të pranoj ose të heq dorë nga ndonjë e drejtë ose obligim në lidhje me lëndën e kontestit në procedurë të medijacionit; lidhje dhe nënshkrim të marrëveshtjes së arritur gjat procedurës së medijacionit; përfaqësim gjat procedurës së solemnizimit të marrëveshtjes para noterit të autorizuar; ta pranoj deklaratën të sjellur nga ana e medijatorit nëse procedura e medijacionit nuk është përfunduar me sukses e cila deklaratë do të jetë parakusht për iniciimin e procedurës kontestimore e të ngjajshme.

Drejtor,

(nënshkrimi

dhe vula)

Shtojca IV

Kërkesë për zbatim të procedurës së medijacionit

Deri
Medijatori _____
(të dhënat dhe adresa)

LËNDA: Kërkesë për zbatim të procedurës së medijacionit

Në pajtim me rregullën e nenit 47 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurë kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/15), Ju lutem të zbatoni procedurën e medijacionit për zgjidhjen e kontestit me personin juridik _____, me seli _____, me numër Amë _____, me llogari bankare (nr. i llogarisë dhe banka), përfaqësuar nga drejtori _____ me e-mail _____, nr. celulari/telefon _____.

Lëndë e kontestit _____ (baza dhe përshkrim i shkurtër).

Vlera e kontestit është _____ denar (ose euro në kundërvlerë në denar).

Në shtesë me Kërkesën, ju dërgoj:

1. Autorizimin për përfaqësim nga avokati _____ nga _____ me nr. tel _____.
2. Statusi aktual nga RQRM për inicijatorin
3. Statusi aktual nga RQRM për palën kundërshtare

Me respekt,

Data dhe vendi
(nënshkrimi dhe vula)

(Drejtor)

Shtojca V

*Licenca për trajnues të medijatorëve*⁵⁴⁷



Образец

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
ОДБОР ЗА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ, СЛЕДЕЊЕ И ОЦЕНУВАЊЕ НА КВАЛИТЕТОТ
НА РАБОТИТЕ НА МЕДИЈАЦИЈАТА

Врз основа на член 59 став (1) точка г) од Законот за медијација („Службен весник на Република Македонија“ бр. 188/13, 148/15 и 192/15), Одбор за обезбедување, следење и оценување на квалитетот на работите на медијацијата, издава:

ЛИЦЕНЦА
ЗА
ОБУЧУВАЧ НА МЕДИЈАТОРИ

На _____ роден/и на _____ година во _____
(име, татково име и презиме) (датум на раѓање) (место и држава)

кој/а ги исполнува условите за обучувач на медијатори согласно Законот за медијација .

Број _____
Датум _____
Скопје

ПРЕТСЕДАТЕЛ,

_____ (потпис и печат)

Shtojca VI

*Licenca për medijator*⁵⁴⁸

⁵⁴⁷ Rregullores për formën dhe përmbajtjen e licencës për trajnues të medijatorëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 188/13, 148/15, 192/15. Kjo rregullores përcakton formën dhe përmbajtjen e licencës për trajnuesit e medijatorëve. Licenca përmban: stemën e Republikës së Maqedonisë në krye dhe teksti: Republika e Maqedonisë, Komisioni për sigurim, ndjekje dhe vlersim të kualitetit të punës së medijacionit; baza ligjore për lëshimin e licencës për medijator; titullin “ Licencë për trajnues për medijator”, të dhëna për emrin, emri i babait dhe mbiemri, data dhe vendi i lindjes i personit i cili i plotëson kushtet për trajnues të medijatorëve në përputhje me Ligjin mbi medijacion, numri i licencës me datë dhe vend të lëshimit, vendi për nënshkrim të Kryetarit të Komisionit për sigurim. ndjekje dhe vlersim të kualitetit të punëve të medijacionit dhe vendi për vulën.



РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
ОДБОР ЗА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ, СЛЕДЕЊЕ И ОЦЕНУВАЊЕ НА КВАЛИТЕТОТ
НА РАБОТИТЕ НА МЕДИЈАЦИЈАТА

Образец

Врз основа на член 59 став (1) точка г) од Законот за медијација („Службен весник на Република Македонија“ бр. 188/13, 148/15 и 192/15), Одборот за обезбедување, следење и оценување на квалитетот на работите на медијацијата, издава:

**ЛИЦЕНЦА
ЗА
МЕДИЈАТОР**

На _____ роден-а на _____ година во _____
(име, татково име и презиме) (датум на раѓање) (место)

општина _____ држава _____, со положен испит за медијатор на _____ година,
(датум на издавање на уверение за положен испит за медијатор)

кој/а ги исполнува условите за медијатор согласно Законот за медијација.

Се издава лиценца за медијатор од областа на _____

Лиценцата се издава со рок на важење до _____ година.
(ден, месец и година)

Број _____
Датум _____
Скопје

Претседател,

(потпис и печат)

Bibliografija

⁵⁴⁸ Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e licencës për meijator, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 188/13, 148/15, 192/15. Me këtë rregullore rregullohet forma dhe përmbajtja e licencës për medijator. Licenca përmban: stemën e Republikës së Maqedonisë në krye dhe teksti: Republika e Maqedonisë, Komisioni për sigurim, ndjekje dhe vlersim të kualitetit të punës së medijacionit; baza ligjore për lëshimin e licencës për medijator; titullin “Licencë për medijator”, të dhëna për emrin, emri i babait dhe mbiemri, data dhe vendi lindjes, komuna dhe shteti, data e lëshimit të Çertifikatës së provimit për medijatorë në pajtim me Ligjin mbi medijacionin, fusha për të cilën jepet licenca, dita, muaji dhe viti deri kur zgjatën licenca, numri i licencës, data dhe vendi i lëshimit të licencës, vendi për nënshkrimin e Kryetarit të Komisionit për sigurim. ndjekje dhe vlersim të kualitetit të punëve të medijacionit dhe vendi për vulën.

Literatura e vendit dhe e huaj

1. Aliu, A, (2013), E Drejta Civile – Pjesa e përgjithshme, Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina “, Prishtinë
2. B. Goldberg, Stephen, E.A. Sander, Frank, H. Rogers, Nancy, (1999), Mediation and other processes, third edition, Aspine Law and Business, Gathersburg and New York
3. Betancourt. J, A. Crook. J, ADR, Arbitration and Mediation, AuthorHouse, Bloomington USA
4. Betetto. N, (2007), Court-Based Mediation and its Place in Slovenia, Public and Private Justice, Dispute Resolution in Modern Societies, Intersentia, Oxford
5. Bilić. V, Drugaćiji put do pravde, Hrvatska Gospodarska Komora – Sektor za Trgovinu 27
6. Bollen. K, Euwema. M, Munduate. L, (2016), Advancing Workplace Mediation through Integration of Theory and Practice, Springer International Publishing, Switzerland
7. Boulle, L, A history of alternative dispute resolution, ADR Bulletin, Vol.1, nr.7, Article.3
8. Brestovci. F, (2004), E drejta procedurale civile I (Ribotim i katërt), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti juridik, Prishtinë
9. Bush. B, A. Robert, P. Folger, Joseph, (1996), Transformative mediation and third party in intervening, Ten halmmarks of transformative a approach to practice in Mediation Quarterly, col. 13, nr. 4
10. Čalija. B, Omanović. S, (2000), Građansko procesno pravo, Univerzitet u Sarajevu - Pravni fakultet, Sarajevo
11. Clark. B, (2012), Lawyers and Mediation, Springer, London
12. Combrink-Kuiters. L,(2011), Customized Conflict Resolution: Court-connected Mediation in the Netherlands 1999-2009, Judiciary Quarterly, Hagë
13. Coombe, George W. Jr. (1999) "The Resolution of Transnational Commercial Disputes: A Perspective from North America," Annual Survey of International & Comparative Law: Vol. 5: Iss. 1, Article 3
14. Curt resolve of the commercial disputes in the Kosovo in the period 2013-2015. In Book of Proceedings , pp. 1-17. Faculty of Law University of Split, Croatia / University of Split, Croatia / University Department , Split,Croatia, 6 / 2018. ISBN 1849-7535.

15. Di Matteo Larry, Routledge, (2017), International Business Law and the legal environmental: A Transactional Approach, New York
16. Đurović. R, (1991), Međunarodno privredno parvo, Beograd
17. F. Ali. Sh, (2018), Court Mediation Reform: Efficiency, Confidence and Perceptions of Justice, Edward Elgar Publishing, Cheltenham UK
18. F. Butler, Valerie, (2004), Mediation essentials and expectations, Domance Publishing Co Inc, Pittsburg, Pennsylvania
19. Ficks. E, (2008), Models of General Court-Connected Conciliation and Mediation for Commercial Disputes in Sweden, Australia and Japan, Deutsch-Japanische Juristenvereinigung e.V., Max-Planck-Institut für ausländisches und internationales Privatrecht, Nr. / No. 25, Hamburg
20. Folberg. Jay, L.Millne Ann, Peter Salem, (2004), Divorce and family mediation, Models, techniques and applications, The Guilford Press, New York
21. Goldberg. B S, Brett. M J, Blohorn-Brenneur. B, Rogers.H N, How mediation works: Theory, Research and Practice, Emerald Group Publishing, UK
22. Hagnes. M, John, Carlesworth. S, (1996), The fundamentlas of family mediation, The Federation Press, Sydney, Australia
23. Hardy. S, Randle. O, (2001), Mediation for Lawyers, CCH Australia Limited, Sydney Australia
24. Hussey. D, (2009), Conciliation: Coming out of the shadows? Commercial Law Practitioner, 16(3), CLP48
25. Iuris Dictio (Publicacion Periodica), Revista del Colegio de Jurispudencia de la Universidad San Francisco de Quito, Folberg, Jay, Año 16, Vol. 17, shkurt - korrik
26. J. Brown, Henry, L. Mariot, Arthur, (1997), ADR Principles and Practice, Second edition, EdSweet and Maxwell
27. Jagtenberg R, (2001), Cross-border mediation in Europe, in Barret G. Creating a European Judicial Space Series of Publications Academy of European Law Trier Vol 30, 2001.
28. Japunčić. T, (2016), Mirenje kao alternativni način rješavanja sporova u Republici Hrvatskoj, Pravnika, 50, 1 (100), Zagreb

29. Jashari. A, (2009), Subjektet e se drejtes afariste. In Tetove, , pp. 550. 2009. ISBN 978-9989-2967-0-3.
30. Jashari. A, E drejta afariste kontraktuese, Libër universitar. UEJL, 9 / 2016. ISBN 978-608-248-005-3.608-248-005-3.
31. Jashari. A, Legal treatment of commercial contracts, civil contracts and coemmercial transactions in the Republic of Macedonia. In 5 th international multidisiplinary scientific conference on social sciences and arts, SGEM 2018, pp. 124-131. SGEM, Vienna, Vienna , Austria, 3 / 2018. ISBN 978-619-7408-30-0.
32. Jerome T. Barnet, Joseph P. Barnet, (2004), A history of alternative dispute resolution: the story of a political, cultural and social movement, San Francisco CA
33. Jovanović. V, (2014), Pravni okvir primene medijacije u Srbiji, u: T. Džamonja Ignjatović (ur), Medijacija – principi, proces, primena, Beogra
34. Jovin Hrastnik. B, (2011), The Slovenian Legislation Implementing The EU Mediation Directive, Directorate General for Internal Policies, Brusel
35. Kis. Z, (2006), Mirenje u Republici Hrvatskoj i Republici Sloveniji, Pravni fakultet u Zagrebu, Zagreb
36. Kolb. R, (2014), The international Court of Justice, Hart Publishing, Gjenevë
37. Lee. J, Hwee Hwee. T, (2009), An Asian Perspecitve on Mediation, Singapore Mediation Center, Academy Publishing, Singapore
38. Lin. L, (2003), Mediation Styles and aproaches in Asian Culture, Conference Proceedings of the 2nd Asia Practic Forum: Developing of Mediation Culture, Singapore
39. Lovenheim. P, Guerin. L, (2004), Mediate don't litigate, Strategies for Successful Mediation, Berkeley
40. Malone A. L, (2008), International Law, Aspen Publishers, New York
41. Marion. S, (2000), Family Mediation: Working to Support Separated Families, y: M. Liebmann, Mediation In Cintext, Jessica Kingsley Publishers, London
42. Mieke, B, Stodulka, T, (2008), A comperative Analysis of the Practice of Mediation and Conciliation in Family Disputes Resolution in Australia: How praticioners practice across both processes, OUTLaw Review, [S.I], v.8, n.1, ISSN2201-7275
43. Milošević. M, (2014), Alternativno rešavanje sporova s posebnim osvrtom na medijaciju, Službeni Glasnik, Beograd

44. Morasso, Greco, Sara, (2011), *Argumentation in Dispute Mediation, A reasonable way to handle conflict*, Amsteran/Philadelphia
45. Pruitt, D.G, Rubin, D.Z, Kim, S.H (1996), *Taktike nadmetanja, dhe Socijalni konflikt i karakteristike i nacin resavanja*, Gupa Most, Beograd
46. R. Clarke, G, T. Davies. I, *ADR-Argument for and Against use of the Mediation Process particulary in family and neighbourhood disputes*, Queensland University Technology Law Journal, 7: 81-96
47. R. Niemic, D. Stienstra, R. Ravitz, (2001), *Guide to Judicial Menagement of Cases in ADR*, Federal Judicial Centar, Washington
48. Roberts. M, (2008), *Mediation in family disputes, Principles of practice*, Third edition, Ashgate Publishing limited
49. Rovine, W. A, (2011), *Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation: The Fordham Papers 2010*, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden-Boston
50. Rubin, J.Z, Sander, E.A (1998), *When should we use agents*, Negotiation Journal, a/1998.
51. Schmidt, V O, (2003), *Global trends in Mediaton*, Gjermani
52. Šimac, S, (2003), *Medijacija – alternativen nacin na rjesavanja sporova*, Hrvatska pravna revija, 3:5/2003
53. Šimac. S, (1991), *Mirenje - alternativni način rješavanja sporova*, Zb. Prav. fak. Sveuč. Rij. v. 27, nr. 1, 611-632
54. Šimac. S, (2004), *Zakon o mirenju – Pravni Okvir za Mirenje*, Hrvatska pravna revija broj 3
55. Šimac. S, *Mirenje i Suci, Kako suci mogu doprinijeti široj primjeni mirenja u svakodnevnoj praksi rješavanja sporova?*
56. Spaić, (2013), *Medijacija u privrednim sporovima - Praktikum*, Podgorica
57. Spencer. D, Brogan. M, *Mediation Law and Practice*, Cambridge University Press, Cambridge, 2006
58. Surya, P. S, Phil. B, (2012), *International Trade and Business Law, The people public security publishing house*, Hanoi
59. Triva. S, Dika. M, (2004), *Građansko parnično procesno parvo*, Narodne Novine, Zagreb, fq, 579

60. Uwazie. E, (2014), *Alternative Dispute Resolution and Peace - building in Africa*, Cambridge Scholars Publishing, Britania e Madhe
61. Uzelac. A, Aras. S, Maršić. M, Mitrović. M, Kauzlarić. Ž, Stojčević. P, (2010), *Aktualne trendove mirnog rješavanja sporova u Hrvatskoj: Dosezi i ograničenja*, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol. 60 No. 6
62. Uzelac. A, *Komentimi i Ligjit mbi medijacionin të Bosnjës dhe Hercegovinës*,
63. Uzelac. V, (2004), *Accelerating Civil Proceedings in Croatia – A history of attempts to improve the efficiency of civil litigation*, C.H. van Rhee, *History of Delays in Civil Procedure*, Maastricht, fq. 283-313
64. Van den Bossche. P, Memeti. A, Bilalli. A, Jashari. A, (2013), *E drejta e Organizatës Botërore të Tregtisë*, Shtip
65. Walter. R, (1972), *How Europe Underdeveloped Africa*, Howard University Press
66. Zameta. Z, (2016), *Styles of Mediation: Facilitative, Evaluative and Transformative Mediation* at www.mediate.com, reprinted with permission from the National Association for Community Mediation Washington DC
67. Бабић. И, (2013), *Увод у грађанско право и стварно право*, Београд
68. Г. Станковић, (2012), *Грађанско процесно право, прва свеска, Парнично процесно право*, Нис,
69. Георгиевски. С, (1984), *Парнична Постапка*, Shkup
70. Живановиќ, А, Бужанин, Обрен, (2009), *Алтернативно решавање спорови, медијација и арбитража, модул 3, Прирачник за стручни соработници и судови, Проект правосудна реформа Канада - Босна и Херцеговина*, Сарајево
71. Јаневски.А, Зороска-Камилоска. Т, (2009), *Граѓанско процесно право, книга прва, Парнични Право, Правен Факултет Јустиниан Први*, Shkup
72. Јездић. М, (1965), *Меѓународно Приватно Право*, Београд
73. Кадриу, О, (2007), *Осврт на некои новости на Законот за медијација, Адвокатура, Адвокатска Комора на Република Македонија*
74. Кобачевиќ. Л, (2006), *За медијација, Правен живот, Часопис за правна теорија и пракса, Право и културни разлики, нр. 12, Здруженињ на правници на Република Србија*, Београд

75. Марковић, А, Крстић. Е, Цветковић. Ј, Благојевић. М, Живковић. М, (2009), Медијација на територији града Ниша – ставови грађана и искуства професионалаца, Зборник радова Правног факултета у Нишу, број 53, Nish
76. Милутиновиќ, Љ, (2004), Медијацијата како алтернативен начин на решавање на спорови, Правен живот, Часопис за правна теорија и пракса, право и културна разлика, Здружение на правници на Србија, том 10, бр. 12, Београд
77. Николовски А, Плавшиќ С, (1994), Меѓународно стопанско (трговско) право, Скопје
78. Петрушиќ. Н, Медијација како метод на решавање правни спорови, Темида, Виктимолошко друштво Србије и Прометеј, vol.7, nr.2, Beograd
79. Сотироски, Љ, Задолжителен обид на медијација во Република Македонија, Решавање на спорови-Медијација, Научен труд, Original research paper, УДК: 347.919.1 (497.7), fq. 137
80. Узелац. А, (2004), Мирење како алтернатива на судењето, Мирење на граѓански, трговски, работни спорови, Тим Пресс, Zagreb
81. Цековска, Ј, (2006), Арбитража и медијацијата во решавањето на спорите, Judicial review, nr.1/2006, Здружение на судиите во Република Македонија, Shkup
82. Чавдар. К, (2011), Закон за парнична постапка со коментари, судска практика, обрасци за практична примена и предметен регистар, Второ изменето и дополнето издание, Скопје

Aktet dhe ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare

1. "Službeni list Republike Crne Gore", nr. 146/04
2. Alabama, USA, Title 91, Chapter 7, § 91-7-37
3. Alternative Dispute Resolution Act, Pub. L. No. 105-315, § 2, 112. Stat. 2993 (1998)
4. Assembly, Fifty-seventh Session, Supplement No. 17 (A/57/17), annex I.
5. Chapter 44, Florida Statutes
6. Civil Dispute Resolution Act of 2011
7. Commission Recommendation 2001/31/CC on the principles applicable to the bodies responsible for consensual commercial dispute resolution

8. Commission Recommendation of March 1998 on the principles applicable to the bodies responsible for out of court settlement of consumer disputes, 98/257/EC
9. Consultation Paper on Alternative Dispute Resolution, Law Reform Commission, 50 – 2008
10. Council Directive 2002/8/EC to improve access to justice in cross-border disputes by establishing minimum common rules relating to legal aid for such disputes
11. Direktiva 2008/52/EC e Këshillit Europian dhe të Parlamentit të 21 marsit 2008 në Aspekte të caktuara të Medijacionit në çështje civile dhe tregtare, OJ. Nr L.136/3, 24/5/2008
12. Federal Court of Australia Act. 1976
13. Green Paper - an alternative dispute resolution in civil law and commercial law, Commission of the European Communities, Brussels, 19.04.2002, COM (2002) 190final
14. Green Paper on alternative dispute resolution in civil and commercial law, Commission of the European Communities, Brussels, April 2004
15. Kodi Civil i Austrisë, nr. 946/1811
16. Kodi Civil i Koresë së Jugut, nr. 10645 AL Code § 26-1-1 (2017)
17. Kodi Civil i Republikës Islamike të Iranit, 23 maj 1928
18. Kodi Civil i Zvicrës, 10 dhjetor 1907
19. Kodi penal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 37/96, 82/99, 4/02, 43/03, 17/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13 dhe 82/13
20. Kodit Civil nr. 67, viti 1980
21. Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, LIGJ - Nr. 7850, datë 29.7.1994
22. Konventa e Vienës për ligjin e traktateve. Vienë, maj 1969.
23. Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirve themelore, Romë, 1950
24. Konventa për të drejtat e fëmijëve, CRC/C/15/Add.239 1 July 2004
25. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 52 i vitit 1991; Amandmanet I dhe II janë të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr.1 i vitit 1991; Amandmani III është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 31 u vitit 1998, Amandmanet IV, V,

VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII, XVIII janë të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 91 i vitit 2001, Amandmani XIX është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 84 i vitit 2003, Amandmanet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX, XXX janë të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 105 i vitit 2005, Amandmani XXXI është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 03 i vitit 2009 dhe Amandmani XXXII është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 07 i vitit 2011.

26. Ligji mbi arbitrazhin ndërkombëtar, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 39, 07.04.2006
27. Ligji mbi familjen, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14 dhe 115/14)
28. Ligji mbi Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 58/2006, 38/2008, 150/10
29. Ligji mbi marrdhëniet obligative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 18/01, 04/02, 05/03, 84/08, 81/09, 161/09
30. Ligji mbi mediacionin i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 60 i vitit 2006 dhe me ndryshimet dhe plotësimet nr. 117/06, nr. 22/07, nr. 34/07, nr. 114/09, nr. 138/09, nr. 188/13, nr. 148/15, nr. 192/15 dhe nr. 155/16.
31. Ligji mbi mediacionin i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 60 i vitit 2006 dhe me ndryshimet dhe plotësimet nr. 117/06, nr. 22/07, nr. 34/07, nr. 114/09, nr. 138/09, nr. 188/13, nr. 148/15, nr. 192/15 dhe nr. 155/16.
32. Ligji mbi notarijatin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 72/16, 172/16 и 233/18
33. Ligji mbi përmbarimin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 35/05, 50/06, 129/06, 08/08, 83/09, 50/10, 83/10, 88/10, 171/10, 148/11, 187/13 dhe 72/16
34. Ligji mbi procedurën kontestimore e shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 79 i vitit 2005, me ndryshime dhe plotësime 110/08, nr. 83/09 , nr. 116/10, nr. 7/11 dhe nr. 124/15
35. Ligji për arbitrazhën ndërkombëtare tërëtare në Republikën e Maqedonisë, Gazetëa Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 39, 2006

36. Ligji për mardhënie pune, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 62/2005, 161/2005, 139/2005, 134/2005, 187/2005, 111/2006, 188/2006, 170/2006, 106/2008, 161/2008, 200/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 176/2009, 20/2009, 16/2010, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 263/2009, 158/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 52/2012, 13/2013, 25/2013, 54/2013, 170/2013, 187/2013, 34/2014, 62/2013, 113/2014, 145/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 74/2015, 129/2015, 167/2015, 27/2016, 114/2014.
37. Ligji për mardhëniet detyrimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 18/01, 04/02, 05/03, 84/08, 81/09, 161/09,
38. Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurë kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 116, 01.09.2010
39. Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi procedurë kontestimore, nr. 124, 23.07.2015
40. Ligji për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 87/2007, 27/2014, 104/2014, 30/2016
41. Ligjit të moshës madhore 1970 tw Zelandës së Re, nr. 137
42. Mediation Development Toolkit Ensuring implementation of the CEPEJ Guidelines on mediation, Mediation Pilot Monitoring Checklist, European Commission for the efficiency of justice (CEREJ), Council of Europe, CEREJ(2018)7
43. Model Law on International Commercial Conciliation of the United Nations Commission on International Trade Law e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në raportin e Komitetit të Gjashtë A / 57/562 dhe Corr.1 në vitin 2002
44. Model ligji i UNCITRAL-it për Medijacionin ndërkombëtar tregtar dhe marrëveshtjet ndërkombëtare të medijacionit, 2018, Aneksi 2
45. Predlog Zakona o mediaciji v civilnih in gospodarskih zadevah), Ljubljana, 21.2.2008
46. Proposal for a directive of the European Parliament and of the Council on certain aspects of mediation in civil and commercial matters, SEC (2004) 1314, Brussels, 22.10.2004
47. Proposal for a directive of the European Parliament and of the Council on certain aspects of mediation in civil and commercial matters, Brussels, 2004, COM(2004) 712 final, 2004/0251 (COD).
48. Proposal for a Regulation concerning jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial and in matters of paternal responsibility.

49. Propozim ligji për përdorimin e gjuhëve
50. Propozim ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi familjen, Shkup, maj 2014
51. Recommendation no. R(99)19 of the Committee of Ministers to Members States concerning mediation in penal matters, Council of Europe - Committee of Ministers, 15 shtator 1999
52. Recommendation No. R (98) 1, Committee of Ministers to member States on family mediation, Council of Europe, 1998
53. Recommendation No. R(98)1 on family mediation, Council of Europe, Committee of Ministers, CoE Recommendation on Family Mediation
54. Recommendation No. R(99)19 on mediation in penal matters, Council of Europe, Committee of Ministers, CoE Recommendation in penal matters
55. Recommendation Rec (2002)10 of the Committee of Ministers to member States on mediation in civil matters, shtator 2002
56. Recommendation Rec(2001)9 on alternatives to litigation between administrative authorities and private parties, Council of Europe, Committee of Ministers, CoE Recommendation on alternatives to litigation between administrative authorities and private parties.
57. Rregullore për formën dhe përmbajtjen e licencës për trajnues të medijatorëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 188/13, 148/15, 192/15
58. Rregullorja mbi kriteriumet e përfaqësuesve për mënyrën e subvencionimit dhe forma për pagesën e shpërblimit dhe shpenzimeve të medijatorëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 50 e 15.03.2016
59. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e licencës për meijator, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 188/13, 148/15, 192/15.
60. Rregullorja për marrdhënie të punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 9/2008
61. Rregullorja për trajnim të medijatorëve dhe Rregullorja për mënyrën e mbajtjes të regjistrave për medijacion, "Službeni list Republike Crne Gore", nr. 18/03 dhe 146/04
62. Rules of Procedure of the Court of Justice, OJ2265, 29.09.2012
63. Rules on mediation procedure in domestic and cross-border consumer disputes of the mediation centre of the Slovenian Insurance Association, Ljubljana. 2019

64. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë
65. UNCITRAL Conciliation Rules, General Assembly Resolution 35/52 i vitit 1980
66. UNCITRAL Model Law on International Commercial Mediation and International Settlement Agreements Resulting from Mediation, 2018
67. Uniform Mediation Act, National Conference of Commissioners on Uniform State Laws, nr. 312/915-0195, Chicago Illionis.
68. United Nations Convention on International Settlement Agreements Resulting from Mediation, A/73/17
69. United Nations Convention on International Settlement Agreements Resulting from Mediation, United Nations, New York, 2019
70. United States Code Annotated Federal Rules of Civil Procedure for the United States District Courts.
71. WTO Agreement: Marrakesh Agreement Establishing the World Trade Organization, April, 15, 1994, 1867 U.N.T.S 154, 33 I.L.M (1994)
72. Zakon o alternativnem reševanju sodnih sporov, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, Nr. 97/2009, 30 Nëntor, 2009
73. Zakon o mirenju, Narodne Novine, nr. 163/03 dhe ligji i ri nr. 18/11
74. Zakon o notariatu Uradni list RS, št. 2/07 – uradno prečišćeno besedilo, 33/07 – ZSReg-B, 45/08 in 91/13
75. Zakon o obveznim odnosima, Narodne Novine, nr. 35/05, 41/08, 125/11 dhe 78/15
76. Zakon o parničnom postupku „Narodnenovine“, nr.53/91, 91/92, 58/93, 112/99, 88/01, 117/03, 88/05, 02/07, 84/08, 123/08, 57/11, 148/11, 25/13 i 89/14
77. Zakon o parničnom postupku, " Službeni list Republike Crne Gore", br. 22/2004, 28/2005 - odluka US i 76/2006 i br. 47/2015 - dr. zakon, 48/2015, 51/2017, 75/2017 - odluka US, 62/2018 - odluka US, 34/2019 i 42/2019
78. Zakon o parničnom postupku, "Sl. glasnik RS", br. 58/2003, 85/2003, 74/2005, 63/2007, 105/2008 - odluka US, 45/2009 - odluka US, 49/2009 i 61/2013
79. Zakon o parnicnom postupku, „Sl. Glasnik RS“, br. 125/04
80. Zakon o posredovanju u rešavanju sporova, “Sl. glasnik RS”, br. 55/2014
81. Zakon o posredovanju u rešavanju sporova, “Sl. Glasnik RS”, br.55/14
82. Zakon o posredovanju-medijaciju, “Sl. Glasnik RS”, br.18/05

83. Zakon o postupku medijacije, Službeni glasnik BiH, br. 37/04.
84. Zakon o pravdnem postopku Uradni list RS, št. 73/07, 45/08 – ZArbit, 45/08, 111/08 – odl. US, 57/09 – odl. US, 12/10 – odl. US, 50/10 – odl. US, 107/10 – odl. US, 75/12 – odl. US, 40/13 – odl. US, 92/13 – odl. US, 10/14 – odl. US, 48/15 – odl. US, 6/17 – odl. US, 10/17 in 16/19 – ZNP-1
85. Zakon o sodiščih, Uradni list RS, št. 94/07 – uradno prečiščeno besedilo, 45/08, 96/09, 86/10 – ZJNepS, 33/11, 75/12 – ZSPDSL-S-A, 63/13, 17/15, 23/17 – ZSSve, 22/18 – ZSICT in 16/19 – ZNP-1
86. Zakona o posredovanju, "Službeni list Republike Crne Gore", nr. 030/05, 29/12

Web faqe të përdorura

1. <http://alanuzelac.from.hr/izborni/radovi/KisZHrvSlomed.pdf>
2. http://mirenje.hr/wp-content/uploads/2018/06/mr.sc_.Sr%C3%84%E2%80%98an-%C4%B9-imac-Mirenje-i-suci.pdf
3. http://www.alanuzelac.from.hr/pubs/D01Zakon%20o%20mirenju_s_kom_biljeskama.pdf
4. <http://www.baseswiki.org/en/Netherlands.html#Mediation>
5. http://www.europarl.europa.eu/cmsdata/157003/EPRS_ATAG_627135_Mediation%20Directive-FINAL.pdf
6. <http://www.intracen.org/Netherlands-Mediation-Institute/>
7. <http://www.jplegal.com.uk/mediationreporturladded.pdf>
8. <http://www.mediationmatterssd.com/mediationmatters/history.html>
9. <http://www.mediationmatterssd.com/mediationmatters/history.html>
10. <http://www.nmi-mediation.nl>
11. <http://www.pravda.gov.mk/resursi/3>
12. <http://www.slo-med.si>
13. <https://adr.org/commercial>
14. <https://akademik.mk/postapkata-za-medijacija-nekolku-fazi-do-prifatlivo-reshenie/>
15. https://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo2_7024
16. https://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo2_7024
17. <https://definitions.uslegal.com/e/early-neutral-evaluation/>

18. <https://definitions.uslegal.com/j/judge-hosted-settlement-conferences/>
19. <https://definitions.uslegal.com/m/mandatory-arbitration/>
20. <https://doi.org/10.5204/qutlr.v7i0.3436>
21. https://ec.europa.eu/civiljustice/adr/adr_ec_code_conduct_en.pdf
22. <https://legalstudiesms.com/learning/court-certified-mediator-qualification-requirements/#FL>
23. <https://settlethedispute.com/cost-of-mediation-lawsuit>
24. https://uncitral.un.org/en/texts/mediation/modellaw/commercial_conciliation
25. <https://web.archive.org/web/20070928163824/http://www.leadr.com.au/ROBSON.PDF>
26. <https://www.americanbar.org/>
27. <https://www.cpradr.org/resource-center/rules/international-other/mediation/european-meditation-procedure>
28. <https://www.dw.com/mk/каде-е-медијацијата-во-полза-на-граѓаните/a-16181394>
29. <https://www.legislation.gov.au/Details/C2011A00017>
30. <https://www.lordhacking.com/Documentation/Can%20mediation%20become%20international.pdf>
31. <https://www.medios.si>
32. <https://www.posredovanje.me>
33. <https://www.pravdiko.mk/raboti-koi-treba-da-gi-znaete-za-medijatsijata/>
34. <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Tarifnik-za-medijatsija-1.pdf>
35. <https://www.reliasmedia.com/articles/143903-meditation-can-resolve-disputes-faster-at-less-cost-than-litigation>
36. <https://www.uww-adr.com/zupload/wp-content/uploads/2015/03/International-Meditation.pdf>
37. https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/displ_e.htm
38. https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/fact1_e.htm
39. https://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/tif_e/fact4_e.htm
40. www.mediate.com
41. www.settlethedispute.com

Burime tjera të përdorura

1. Family mediation in Europe, proceedings, 4th European conference on Family Law, Strasburg, 1998
2. Foley. K, Cronin. M, Professional conciliation in collective labor disputes: a practical guide, ILO Decent Work
3. Lincoln, Abraham, Notes for a lecture, July, 1850
4. Projekti MATRA " Mbështetje për avancim të implementimit të mediacionit në Maqedoni " i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në qershor të vitit 2013
5. Technical Support Team and Country Office for Central and Eastern Europe. - Budapest: ILO, 2015
6. Прирачник за обука на медијатори за обновување на знаењата за медијација, Проект Матра поддржуван од Амбасадата на Кралството Холандија